



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MBROJTJES**  
**SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA**  
**KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES**  
**AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA**  
**FAKULTETI I SIGURISË DHE MBROJTJES**

**Tezë në kërkim të gradës shkencore**  
**“Doktor: Në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes”**

# **E DREJTA PËR INFORMIM DHE SIGURIA** **KOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

**Autor:**  
**Alket JAUPI**

**Udhëheqës shkencor:**  
**Prof. Dr. Ermir DOBJANI**

**Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2018**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA  
KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES  
FAKULTETI I SIGURISË DHE MBROJTJES**

**PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”**

**NË FUSHËN E SIGURISË DHE MBROJTJES**

**“E DREJTA PËR INFORMIM DHE SIGURIA**

**KOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

**Komisioni shkencor:**

<b>Prof. Dr.</b>	<b>Skënder KAÇUPI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Prof. Dr.</b>	<b>Gjergj SINANI</b>	<b>Oponent</b>
<b>Prof. As. Dr.</b>	<b>Zaho GOLEMI</b>	<b>Oponent</b>
<b>Prof. Dr.</b>	<b>Sulo HADËRI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Prof. As. Dr.</b>	<b>Agim SULA</b>	<b>Anëtar</b>

**Punoi:  
Alket JAUPI**

**Udhëheqës shkencor:  
Prof. Dr. Ermir DOBJANI**

**Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2018**



**FAKULTETI I SIGURISË DHE MBROJTJES**

Adresa: “Rruga e Dibrës”, Tiranë, Tel/Fax: 355 (0) 42 22 66 01,

Email: afa@aaf.mil.al, Website: www.tradoc.mil.al

**© Copyright i autorit: Alket JAUPI, 2018.**

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cënues me çfarëdo lloj mjete apo forme, pa lejen përkatëse me shkrim të autorit.

Udhëheqësi i doktorantit Alket JAUPI vërteton se, ky është versioni  
i miratuar i disertacionit të mëposhtëm:

## **E DREJTA PËR INFORMIM DHE SIGURIA KOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Udhëheqës shkencor:  
Prof. Dr. Ermir DOBJANI

# **E DREJTA PËR INFORMIM DHE SIGURIA KOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Përgatitur nga: Msc. Alket JAUPI

Disertacion i paraqitur në  
Fakultetin e Sigurisë dhe Mbrojtjes,  
Akademia e Forcave të Armatosura, Tiranë,  
në përputhje të plotë  
me kërkesat  
për gradën “Doktor”.

Akademia e Forcave të Armatosura  
\_\_\_\_\_, 2018

*Për Livian dhe Esterin*

## **Mirënjohje dhe falenderim**

Duke punuar për realizimin e kësaj teze doktorature kam ndjerë kënaqësinë e bashkëpunimit me shumë kolegë dhe profesorë të nderuar, gjë e cila flet për faktin se ky punim nuk është vetëm një punë personale e imja si disertant, por fryt i kontributit e mbështetjes së disa personave, për të cilët do të doja të shprehja vlerësime dhe falenderime.

Falenderimi i parë shkon për Profesor Doktor Ermir Dobjani, si pedagog, koleg dhe udhëheqësi im i palodhur i tezës së doktoraturës. Është merita e tij që prej vitesh jam marrë gjerësisht me të drejtën për informim dhe që më ka nxitur dhe inspiruar të ndjek këtë rrugë, duke më dhënë vazhdimisht këshilla të vlefshme, si dhe ide mbi zhvillimin e thelluar të opinioneve, për të arritur në një punim sa më të arrirë shkencor.

Falënderimi im i dytë shkon për Profesor Doktor Pajtim Ribaj, si një prej pedagogëve të veçantë, i cili ka nxitur tek unë zgjerimin e studimeve mbi konceptin e sigurisë kombëtare dhe gjeopolitikës. Përmes një komunikimi të vazhdueshëm, profesional dhe shumë shoqëror njëkohësisht vlerësoj se, profesor Ribaj mbetet një nga frymëzuesit e mi në fushën e sigurisë kombëtare.

Së treti, do të doja të falenderoja të gjithë trupën e pedagogëve që na ka ndihmuar dhe ndenjur pranë gjatë gjithë programit mësimor të studimeve të doktoraturës, në veçanti profesor Agron Agolli, profesor Proletar Hasani, profesor Ruzhdi Gjatoja dhe shumë profesorë të tjerë të departamentit të Strategjisë dhe Historisë, në ish Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Mojsiu”, Tiranë (sot Akademia e Forcave të Armatosura), të cilët jo vetëm na kanë hapur horizonte të reja dijesh por edhe kanë shërbyer si shembull përkushtimi dhe serioziteti në trajtimin e çështjeve, qoftë në nivelin arsimor, shkencor, si edhe për formimin tim me njohuri të thella në fushën e sigurisë kombëtare.

Mirënjohje kolegëve të mij, të cilët kanë bashkëpunuar ngushtë në veprimtari të ndryshme për plotësimin e detyrimeve të programit të doktoraturës, ndihma dhe kontributi teknik i të cilëve më ka ndihmuar dhe më ka dhënë kurajën për përfundimin e punimit me sukses.

Një falënderim i veçantë i shkon edhe familjes sime, e cila më ka mbështetur fort në të gjitha përpjekjet e mija në këtë arritje.

Të gjithëve, faleminderit!

## **Deklaratë mbi originalitetin**

Alket JAUPI

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruajtura nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam i vetëdijshëm se në rast të mospërputhjeve, Këshilli i Profesorëve, të Akademisë së Forcave të Armatosura është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me “Rregulloren e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Doktoratë)”.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2018

Nënshkrimi



## **PËRMBLEDHJE**

Ky punim synon të analizojë të drejtën për informim, si të drejtë themelore të njeriut, në një këndvështrim evolues të njohjes dhe afirmimit, në kontekstin historik dhe në kuadrin normativ, të konkretizuar në akte të rëndësishme ndërkombëtare të transpozuar në legjislacionin shqiptar të pas viteve 90'. Identifikimi i çështjeve kryesore që lidhen me standardizimin institucional dhe praktik të njohjes dhe ushtrimit efektiv të kësaj të drejte, përballet me sfidat që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë për miratimin e një legjislacioni adekuat, që përcakton regjime juridike koherente, të cilat garantojnë në një ambient procesesh tranzicioni shoqëror, ekonomik, kulturor dhe politik, rolin që i takon kësaj të drejte.

E drejta për informim nuk është një e drejtë absolute ndaj edhe është shumë i rëndësishëm përcaktimi dhe aplikimi i kriterëve të mirëpërcaktuara ligjore, që synojnë një proces të ndershëm dhe të rregullt ligjor dhe që vendosin një raport bazueshmërisht balancues, me të drejtat e tjera themelore.

Siguria kombëtare si një kategori tjetër e paraqitur në punim ka njohur evoluimin historik në botë dhe në Shqipëri, të kuptimit si një përgjegjësi shtetërore, për miratimin e legjislacionit përkatës si ndëshkim por gjithashtu edhe për angazhimin e tërë strukturës shtetërore për garantimin e saj. Koncepti koherent i sigurisë kombëtare ka si komponent të qënësishëm sigurinë njerëzore, duke zhvendosur analizën e kuptimit të sigurisë nga i ashtëquajturit sovraniteti territorial, tek sovraniteti individual, që lidhet drejtëpërsëdrejti me liritë dhe të drejtave të njeriut. Siguria kombëtare vlerësohet tashmë si një e mirë personale dhe politike, një vlerë në fushën e konkurimit të vlerave, duke e trajtuar atë gjithnjë e më shumë si një të drejtë themelore e njeriut. Sfidat mbeten kërcënimet e jashtme dhe të brendshme, që çenojnë ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave demokratike, për mirëqënien e dëshiruar shoqërore.

Duke u paraqitur si vlera konkurrese, elementi bashkues dhe që krijon tensionin ndarës njëkohësisht ndërmjet të drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare është informacioni i klasifikuar zyrtar i sigurisë kombëtare, që përlligj apriori kufizimin e aksesit publik ndaj tij. Për këtë arsye punimi është fokusuar në standardet ndërkombëtare të vendosura në akte ndërkombëtare të rëndësishme të fushës, mbi të cilat raporti i diskutuar duhet të gjejë një balancë sa më të përshtatëshme në konkurimin e këtyre vlerave, duke analizuar njëkohësisht përputhshmërinë zhvillimore të legjislacionit të brendshëm, të mekanizmave institucionalë, ligjorë dhe kushtetues, në funksion të një zgjidhjeje të drejtë. Duke u fokusuar në disa çështje kryesore, punimi nuk merr përsipër të shterojë të gjitha problematikat e këtij raporti ekzistues, në dukje refraktar, ndërmjet të drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare por synon të shohë sigurinë kombëtare, si një përgjegjshmëri sa më transparente qeverisjeje, ndaj të komunitetit të të qeverisurve.

### **Fjalë Kyce:**

*E drejta për informim, akte ndërkombëtare, Kushtetutë, kufizim i së drejtës, siguri kombëtare, marrëdhënie e balancuar.*

## **ABSTRACT**

This paper aims to analyze the right to information as a fundamental human right in an evolving view of recognition and affirmation in the historical and normative context, concretized in important international acts transposed into Albanian legislation, after the 90's. The identification of key issues related to institutional and practical standardization of the recognition and effective exercise of this right faces the challenges that existed and exist, for the adoption of adequate legislation defining coherent legal regimes that guarantee into a transitory social, economic, cultural and political environment, the role that belongs to this right.

The right to information is not an absolute right, so it is very important to define and apply well-defined legal criteria that aim at a fair and orderly legal process and establish an essentially balancing report, with other fundamental rights.

National security as another category presented in the paper has recognized the historical evolution in the world and in Albania, of its understanding as a state responsibility, for the adoption of the relevant legislation as a punishment, but also for the commitment of the entire state structure to guarantee it. The coherent concept of national security has a crucial component of human security, shifting the analysis of the meaning of security from so-called territorial sovereignty, to individual sovereignty, directly related to human rights and freedoms. National security is now seen as a personal good and political asset, a value in the field of value competition, increasingly addressing it as a fundamental human right. Challenges remain the external and internal threats that affect the preservation and development of democratic values for the desired social well-being.

Presenting as a competitive value, the joining element and creating the separating tension at the same time, between the right to information and national security, is the classified official national security information that apriori restricts public access to it. For this reason, the paper focuses on international standards established in important international acts in the field, on which the discussed report should find the most appropriate balance in the competition of these values, while analyzing the development compliance of domestic legislation, of the institutional, legal and constitutional mechanisms, in function of a fair solution. Focusing on some key issues, the paper does not undertake to exhaust all issues of this seemingly refractory existing relationship between the right to information and national security, but seeks to see national security as a more transparent governance responsibility, to the governed community.

### **Key Words:**

*Right to information, international acts, Constitution, restriction of the right, national security, balanced relation.*

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

# **E DREJTA PËR INFORMIM DHE SIGURIA KOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

- Hyrje.....	XV
-Metodologjia.....	XXI
- Struktura e punimit .....	XXIII
- Literatura.....	XXXI
- Shkurtime .....	XXXII

## **KREU I**

### **REGJIMET JURIDIKE TË SË DREJTËS PËR INFORMIM**

1.1	Historiku dhe kuptimi i së drejtës për informim .....	1
1.2	Parimet ndërkombëtare të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe aktet kryesore ndërkombëtare për të drejtën e informimit .....	5
1.3	Legjislacioni shqiptar për të drejtën e informimit .....	10
1.4	Regjimi juridik i së drejtës për informim në Ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” .....	13
1.4.1	Subjektet e marrëdhënies juridike të së drejtës së informimit .....	13
1.4.2	Objekti i marrëdhënies juridike të së drejtës së informimit .....	19
1.4.3	Përmbajtja e marrëdhënies juridike të së drejtës së informimit .....	22
1.4.4	Afatet procedurale .....	30
1.4.5	Kufizimet e së drejtës për informim.....	32
1.4.6	Rrugët e ankimit për shkeljen e së drejtës për informim .....	33
1.5	Regjimi juridik i së drejtës për informim në Kodin e Proçedurave Administrative .....	38

1.6	Disa përfundime .....	43
-----	-----------------------	----

## **KREU II**

### **INSTITUCIONET KOMBËTARE PËR GARANTIMIN E SË DREJTËS PËR INFORMIM DHE DISA ASPEKTE TË MBROJTJES SË TYRE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.**

2.1	Avokati i Popullit në Shqipëri, garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe si institucion mbikqyrës i sektorit të sigurisë.....	46
2.1.1	Historiku i Ombudsmanit në botë dhe në Shqipëri .....	48
2.1.2	Baza ligjore për ngritjen dhe funksionimin e Avokatit të Popullit ...	50
2.1.3	Roli i Avokatit të Popullit në mbrojtjen e së drejtës për informim ...	53
2.1.4	Juridiksioni, kompetencat dhe mjetet ligjore të Avokatit të Popullit...	59
2.1.4.1	Ndërhyrjet “Amicus Curiae” .....	61
2.1.5	Mbikqyrja e sektorit të sigurisë nga Avokati i Popullit .....	69
2.2	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si një institucion i ri për mbrojtjen e së drejtës për informim .....	74
2.3	Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, çështje të shqyrtuara nga sistemi gjyqësor në vend dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese	
2.3. 1	Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut .....	75
2.3. 2	Sistemi gjyqësor dhe e drejta për informim .....	78
2.3. 3	Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese .....	80
2.4	Problematika e ndeshur në dispozitat e Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” .....	81
2.5	Problematika të ndeshura në përmbajtjen e dispozitave të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” .....	90
2.6	Mbrojtja ligjore e veçantë për individët “Bilbilfryrës” .....	92
2.6.1	Garantimi i mbrojtjes së “Bilbilfryrësve” në legjislacionin shqiptar .....	97

2.7	Disa përfundime .....	102
-----	-----------------------	-----

### **KREU III**

#### **KONCEPTI I SIGURISË KOMBËTARE DHE DISA NGA INSTITUCIONET GARANTE TË SAJ NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.**

3.1	Koncepti i sigurisë dhe sigurisë kombëtare .....	106
3.2	Siguria njerëzore .....	109
3.3	Evoluimi i koncepteve të sigurisë dhe sigurisë kombëtare .....	114
3.4	Siguria kombëtare në Shqipëri .....	118
3.5	Dokumenti i strategjisë së sigurisë kombëtare dhe Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë .....	119
3.6	Disa institucione garante të sigurisë .....	127
3.6.1	Shërbimi Informativ i Shtetit .....	127
3.6.2	Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes .....	130
3.6.3	Komisioni Parlamentar i Mbrojtjes .....	133
3.7	Siguria kombëtare dhe integrimi .....	136
3.8	Disa përfundime .....	138

### **KREU IV**

#### **RAPORTI NDËRMJET SIGURISË KOMBËTARE E SË DREJTËS PËR INFORMIM DHE DISA PROBLEMATIKA TË KËTIJ RAPORTI NË SHQIPËRI.**

4.1	Raporti ndërmjet sigurisë kombëtare dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut .....	142
-----	---	-----

4.2	Parimet e Johannesburgut dhe Parimet e Tshwane mbi sigurinë kombëtare, lirinë e shprehjes dhe aksesin në informacion .....	145
4.2.1	Parimet e Johannesburgut .....	146
4.2.2	Parimet e Tshwane .....	149
4.3	Sekreti shtetëror dhe siguria kombëtare .....	150
4.4	Legjislacioni shqiptar mbi informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” .....	155
4.5	Sistemet e video survejimit dhe aplikimi i tyre .....	159
4.6	Aksesi i publikut dhe medias në seancat e proceseve gjyqësore .....	166
4.7	Aksesi në informacion në çështjet penale .....	168
4.8	Aksesi në dosjet e organeve publike në procedurat administrative .....	169
4.9	Siguria ushqimore dhe prezenca e aflatoksinës .....	171
4.10	Çështja e kufirit detar me Greqinë .....	173
4.11	Tragjedia e Gërdecit .....	176
4.12	Disa përfundime .....	178

## **KREU I PESTË V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

5.1	Përfundime .....	182
5.2	Rekomandime .....	192

## **KREU I GJASHTË VI. BIBLIOGRAFIA.....195**

### **LISTA E TABELAVE**

2.1.5	Tabela 1 .....	72 - 73
-------	----------------	---------

### **LISTA E GRAFIKËVE**

2.1.3	Grafiku 1 .....	55
2.1.5	Grafiku 2 .....	73

*“They who can give up essential liberty to obtain a little temporary safety deserve neither liberty nor safety...”*

***Benjamin Franklin***

## **H Y R J E**

Marrëdhënia dhe raporti kompleks, i së drejtës për informim si një e drejtë themelore e njeriut dhe si një eksperiencë e re konceptuale për vendin tonë, me sigurinë kombëtare, duhet vlerësuar si një marrëdhënie shumë e rëndësishme e aplikimit dhe jetësimit të vlerave të shtetit të së drejtës në një shtet demokratik, në të gjitha sferat dhe dimensionet e veprimtarisë shtetërore.

Raporti i duhur ndërmjet së drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare duhet të sigurojë një “konkureshmëri vlerash dobiprurëse”, duke krijuar një raport të drejtë, të balancuar dhe të mirëmenduar, në përputhshmëri dhe zhvillim të standardeve më të mira ndërkombëtare në këtë fushë, me qëllim që t’i jepet dimensionimi i qartë dhe i prekshëm konceptit jetik të sigurisë njerëzore, si dhe për të përgatitur administratën shtetërore dhe shoqërinë shqiptare, për realizimin e proceseve integruese të vendit. Ky mesazh gjendet prezent gjatë gjithë këtij punimi shkencor.

Përpjekjet për ngritjen dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, janë të lidhura pazgjidhmërisht me një aspekt shumë të rëndësishëm të këtij procesi, me mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në tërësinë e këtyre të drejtave dhe lirive themelore, një rol gjithnjë e më shumë të rëndësishëm luan e drejta e informimit. Për vendin tonë e drejta e informimit prezanton një të drejtë relativisht të re dhe me traditë jo të gjatë të zbatimit të saj. Megjithatë, realiteti në vendin tonë po tregon se, publiku i gjerë ka filluar të ndërëgjegjësohet për të drejtat që ai ka dhe për garancitë kushtetuese të ushtrimit dhe mbrojtjes së tyre.

Çështja e respektimit të të drejtave të njeriut është sot një ndër prioritetet e rëndësishme të strategjive politike të shteteve, që aspirojnë integrimin në strukturat rajonale e globale dhe si e tillë përbën një çështje themelore për organet publike në vendin tonë, për programet e zhvillimit të qëndrueshëm e afatgjatë, për politikën qeverisëse në përgjithësi dhe për mirëqeverisjen në veçanti. Nga ana tjetër, proceset integruese kanë nxjerrë nevojën jo vetëm të përafrimit të legjislacionit specifik për mbrojtjen e tyre, me standardet ndërkombëtare dhe “Acquis Communautaire”, por edhe të sensibilizimit, promovimit dhe zbatueshmërisë korrekte të tij, në një mjedis ku aksesit vlerësohet primar.

Pa të drejtën e informimit nuk ka besim tek qeverisja dhe pa besim nuk mund të ketë demokraci. Në këtë mjedis social dhe ligjor është e rëndësishme të kuptohet se çfarë përfaqëson e drejta e informimit, cila është filozofia e saj, cilat janë standardet që duhet të aplikohen në adoptimin e legjislacionit për garantimin e saj dhe cilat janë problematikat aktuale të evidentuara deri tani, në respektimin e kësaj të drejte. Duke u përafruar me

standardet më të mira ndërkombëtare është e kuptueshme se, mirëqeverisja dhe mirëadministrimi, si një premisë e tagrit të çdo personi për një trajtim të çështjeve të tij nga organet publike, në mënyrë të paanshme, të ndershme dhe brenda një kohe të arsyeshme, përbën çelësin e suksesit në raportin e drejtë, që duhet të ekzistojë ndërmjet proceseve vendimmarrëse dhe zbatimit të vendimeve të miratuara, si dhe mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Mirëqeverisja pra, duhet të përfaqësojë një interes të përhershëm dhe dinamik, që inkurajon respektimin e shtetit të së drejtës, transparencën, besimin publik dhe pjesëmarrjen e gjerë në proceset demokratike vendimmarrëse.

Të drejtat e njeriut nuk janë vetëm rrjedhojë e mirëqeverisjes, ato janë dhe duhet të jenë edhe shkak dhe nxitje për progresin e saj. Mirëqeverisja është e mundur vetëm në një shtet e në një shoqëri të lirë, atje ku respektohet e vlerësohet njeriu, institucioni, shteti, ligji dhe e drejta. Atje ku dhunohet fjala e lirë e ku mungon liria e veprimit, nuk ka transparencë dhe ku dominon korrupsioni e kompromentimi rrënohen themelet e mirëqeverisjes. Qeverisësit kanë mbi vete një përgjegjësi të madhe për t'iu siguruar të qeverisurve vëllimin maksimal të të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara nga normat e së drejtës së brendshme, apo asaj ndërkombëtare, si dhe standardet optimale në fushën e shëndetit, kulturës, arsimit, banimit, jetesës në përgjithësi, të sigurisë së jetës, pjesëmarrjes në vendimmarrje, sigurimit të një gjyqësori të pavarur, të paanshëm e objektiv, si dhe të gjithë aspekteve të tjera të shërbimit publik në përgjithësi.

Spektri i gjerë i të drejtave dhe lirive themelore të shpallura dhe afirmuara në një varg dokumentesh juridiko-ndërkombëtare dhe të sanksionuara në të drejtën e brendshme të shumë shteteve gjejnë pasqyrimin edhe në legjislacionin shqiptar. Analiza që bëhet në këtë punim është konceptuar në këndvështrimin e përcaktimit të vendit që zë e drejta për informim në katalogun e njohur dhe të gjithëpranuar ndërkombëtarisht, të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Kjo analizë materializohet në trajtimin që i bëhet kësaj të drejte në aspektin e garantimit në instrumentat ndërkombëtare, si dhe në legjislacionin tonë në fuqi. Analiza krahasimore e rregullimeve normative si dhe eksperiencat e institucioneve mbikqyrëse për zbatimin e kësaj të drejte, identifikon problemet dhe nxjerr disa konkluzione, të cilat pasqyrohen në përfundime konkrete në kuadër të rregullimit ligjor por edhe administrativ të çështjeve.

I fokusuar në marrëdhënien ndërmjet një të drejte themelore të njeriut dhe konceptit të sigurisë, punimi kërkon të evindetojë lidhjen ndërmjet paradigmes shtetocentrike me objekt referues shtetin dhe zhvillimit bashkëkohor të argumenteve antropocentrike, të njohura si “siguria njerëzore”, me objekt referues individin. Në këtë këndvështrim del natyrshëm përfundimi që, ndërgjegjësimi i strukturave shtetërore duhet të jetë i tillë në ushtrimin e pushtetit të tyre shtetëror në çdo fushë të jetës, që të kuptojnë qartë dhe pa ekuivokë se, standardi për zbatimin e ligjit në një shtet të së drejtës duhet të jetë më i lartë për përfaqësuesit e organeve shtetërore, sesa për qytetarët.

Qasja e ofruar në punim ndaj së drejtës për informim, regjimit juridik të përcaktuar për të, kufizimit dhe problematikave të evidentuara, në nivel të zbatimit në jetën e përditëshme, apo edhe të interpretimit nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, si dhe të



jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe praktikës ekzistuese gjyqësore, ndërthuret me raportin ndërveprues me konceptin dhe realitetin e sigurisë kombëtare në vend.

Siguria kombëtare, si aftësi e shteteve sovrane për të siguruar ekzistencën mbijetuese me rezultatin më të mirë të mundshëm dhe të pritshëm ndaj interesave kombëtare, e materializuar në dokumente si Strategjia e Sigurisë Kombëtare, megjithëse në një këndvështrim të ngushtë interpretohet si kufizuese e mundësisë për akses në informacionin zyrtar që lidhet me çështjet e interesave të ligjshëm të sigurisë kombëtare, në një shtet demokratik rezulton të jetë një koncept i bazuar në të drejtat e njeriut dhe në funksion të garantimit të tyre. Veçanërisht në rastin e së drejtës për informim, marrëdhënia midis sigurisë kombëtare të zgjeruar me konceptin e sigurisë njerëzore, me të drejtën për informim, shfaqet si një forcë shtytëse që herë zvogëlon aksesin dhe herë e suporton atë, në varësi të konkurimit të interesit publik, për publikimin e informacionit zyrtar dhe të interesit publik për fshehjen e një pjese të këtij informacioni, të cilësuar dhe klasifikuar si sekret shtetëror.

Ky raport evidentohet në përcaktimet e bëra në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, apo edhe në Ligjin “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””. Sekreti shtetëror i vlerësuar si instrumenti ligjor për kufizimin e aksesit të publikut ndaj informacionit që lidhet me çështjet e sigurisë kombëtare, në fakt analizohet në këtë punim në kuadër të konkurrencës dhe harmonizimit të dy regjimeve në dukje të kundërta, por që në thelb ndihmojnë funksionimin e njëri-tjetrit, bazuar në parime ndërkombëtarisht të pranuar, që ruajnë një balancë logjike dhe proporcionale të interesit publik në akses dhe të interesit publik për siguri. Në vetvete pra, punimi kërkon ndër të tjera që të gjejë pikat e takimit dhe ato ndarëse të dy regjimeve juridike, atij të së drejtës për informim dhe atij të klasifikimit dhe deklasifikimit të informacionit zyrtar të klasifikuar. Analiza dhe krahasimi i veprimtarisë së disa institucioneve shtetërore, me kahje funksionale maksimalisht transparente, sikurse edhe me funksionalitet deri në kufijtë maksimalë të “hermetizimit formal institucional”, synon të ilustrojë këtë raport kompleks.

Në fakt të dyja konceptet e analizuar në marrëdhënien mes tyre, përkatësisht e drejta për informim dhe siguria kombëtare e perceptuar në kuadër të sigurisë njerëzore, prezantojnë dy fusha shumë të gjera krahasimore, ndaj edhe punimi është fokusuar në disa momente kryesore përfaqësuese të tyre në aktualitetin shqiptar, bazuar në teori dhe praktikë zbatuese të legjislacionit në fuqi. Thënë kështu, punimi nuk merr përsipër të ezaurojë gjerësisht dhe tërësisht fushat e prezantuara, por synon të sjellë një këndvështrim analitik të pasuar nga problematika të evidentuara konkrete. Të dyja konceptet e trajtuara janë koncepte në zhvillim, tepër të ndjeshme në efektet e tyre tek individët por edhe tek qeverisja e një vendi, me avantazhin historik dhe filozofik në rastin e Shqipërisë, të gjetjes së raportit të duhur balancues që ruan vlerat demokratike të një vendi, ku individi merr pjesë aktivisht në qeverisje.

Ky punim synon të prezantojë një studim me analizë retrospektive dhe perspektive, me këndvështrim afatgjatë, ku vlerat krahasuese dhe analizuese të ndërthurura me rekomandimet sugjerojnë dhe ofrojnë zgjidhje, për një standard bashkëkohor të raportit, e

drejtë për informim dhe siguri kombëtare. Për shkak të zgjatjes së periudhës kohore të përmbylljes së studimeve të doktoraturës, ky punim shkencor është pasuruar me një përditësim të zhvillimeve ligjore dhe institucionale që kanë ndodhur në kohë, në dinamikën e ecurisë së koncepteve bazë të përfshira në të. Kjo qasje i ka dhënë njëkohësisht punimit një natyrë krahasimore mes periudhash kohore, të analizuarra specifikisht në të.

Një konkluzion që ka mbisunduar përgjatë gjithë përgatitjes të këtij punimi ka qënë se, asgjë e kundërligjshme nuk mund të jetë çështje e sigurisë kombëtare dhe aq më pak e sigurisë njerëzore, ndaj edhe çdo shoqëri demokratike e ka të nevojshme në mënyrë të natyrshme që të ngrëjë mekanizma efektivë ligjorë dhe institucionalë për të parandaluar shkeljen, për të mbrojtur dhe për të rivendosur në vend, të drejtat e ligjshme të individit. Në këtë angazhim demokratik, e drejta për informim merr një rol shumë specifik. Një element në dukje simbolik në trajtim, por shumë i rëndësishëm për konkluzionin e punimit është ndikimi dhe rezultatet që sjellin proceset e anëtarësimit dhe integritimit njëkohësisht të vendit tonë, në organizata të rëndësishme ndërkombëtare.

## **QËLLIMI I PUNIMIT**

Të studiosh të drejtën për informim dhe sigurinë kombëtare do të thotë të thellohesh në koncepte shumë të hershme, të zhvilluara në rrjedha historike botërore por të reja dhe shpesh sfiduese, për specifikat e zhvillimit të shtetit shqiptar. Trajtimi dhe kërkimi në këtë kontekst bëhet më interesant, po të kemi parasysh fillesat e shtetit shqiptar. Si një shtet-komb në kuptimin e organizimit dhe funksionimit të tij, fillesat i gjejmë nga fundi i vitit 1912, sikundër nga ana tjetër, në një periudhë të mëvonshme gjendemi para faktit historik të qeverisjes së vendit për një kohë të gjatë, nga një regjim autoritar që nuk pranonte dhe zbatonte konceptet e përparuara, të të drejtave themelore të njeriut dhe të sigurisë kombëtare.

Qëllimi kryesor i punimit ka perceptuar dhe konkretizuar vënien në qendër të tij, pikërisht të raportit delikat dhe të diskutueshëm, të së drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare në vendin tonë, në kuadër të fokusimit tek siguria njerëzore si një koncept zgjerues dhe plotësues i sigurisë kombëtare, i mbështetur në respektimin e konceptit të të drejtave të njeriut. Në këtë këndvështrim, e drejta për informim si pjesë e konceptit të sigurisë njerëzore është qëllimuar të analizohet si pjesë e rëndësishme e kornizës normative dhe thelbit të sigurisë njerëzore. Punimi synon t'i japë zgjidhje paradigmes “E drejta për informim – Siguria Kombëtare”.

Në funksion të qëllimit kryesor kam patur si objektiva të punimit:

- Përcaktimin e konceptit të së drejtës për informim dhe evoluimit që ka pësuar ai, në kuadër të përkatësisë në familjen e madhe të të drejtave themelore të njeriut. Regjimi juridik i kësaj të drejte në legjislacionin e brendshëm të Republikës së Shqipërisë dhe përputhshmëria e tij, me parimet dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

- Analizimin dhe përcaktimin e konceptit të sigurisë kombëtare dhe evoluimin e kuptimit të saj të zgjeruar, duke përcaktuar rëndësinë e sigurisë njerëzore si komponent bazik të saj dhe si një zhvillim bashkëkohor, me dimension human.
- Analizimin e instrumenteve ndërkombëtare dhe parimeve standardizuese ndërkombëtare, për të drejtën e informimit dhe sigurinë kombëtare.
- Raportin që krijohet ndërmjet të drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare, në identifikimin e kuptimit teorik të konfliktit ekzistues ndërmjet dy koncepteve të dhëna, si dhe evidentimin e natyrës reale komplementare ndërmjet tyre.
- Identifikimin e institucioneve mbikqyrëse të respektimit të së drejtës për informim, organeve garante të sigurisë kombëtare dhe institucioneve mbikqyrëse të sektorit të sigurisë, në ndërveprimin “Check and Balance”.
- Zgjidhjet e ofruara për vendosjen e një raporti të balancuar dhe të mirëmenduar, me përfitim të dyanshëm dobiprurës, ndërmjet së drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare, në Shqipëri.

Duke hulumtuar dhe analizuar regjime juridike, standarde ndërkombëtare, praktika administrative dhe gjyqësore, si dhe duke sjellë në vëmendje ngjarje konkrete, që lidhen me zbatimin e koncepteve objekt studimi, jam përpjekur që me një zhvillim jo shterues të çështjes por të fokusuar në momentet kryesore, të përcjell mesazhin kryesor të punimit tim. Dy konceptet, përkatësisht e drejta për informim dhe siguria kombëtare, me një marrëdhënie të “baraslarguar” dhe konkurente ndaj njëra – tjetrës, nevojitet të kenë një ekuilibër të duhur ndërmjet tyre.

Mungesa konceptuale dhe ligjore në rregullimin standardizues bashkëkohor të së drejtës për informim dhe të ruajtjes së sekretit shtetëror, si një nga parakushtet për garantimin e sigurisë kombëtare, qëllimon të nxjerrë në pah nevojën për zgjidhje të normuara për mundësimin e përbaljes teorike dhe praktike, me problematikat komplekse të ekuilibrit ndërmjet të drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare.

Dilema e përparësisë së trajtimit dhe vlerësimit, kur flitet për çështje të sigurisë kombëtare dhe interesit publik për informim përballet me tendencën e rrezikshme të manipulimit politik të çdo çështjeje të kësaj fushe, si një koracë mbuluese e zhvillimeve antiligjore dhe shpesh korruptive dhe abuzuese. Për të zgjidhur këtë dilemë, punimi arrin në vlerësimin se, siguria kombëtare dhe e drejta për informim si e drejtë themelore e njeriut, nuk janë apriori përjashtuese të njëra – tjetrës, por koncepte komplementare. Në këtë vlerësim duhet të mbahet parasysh fakti se, siguria kombëtare është këndi fundor i sigurisë në kuptimin e saj të përgjithshëm. Siguria kombëtare plotësohet dhe përcakton më mirë qëllimin e saj final, nga siguria njerëzore. Në këtë këndvështrim edhe siguria është një e drejtë themelore e njeriut.

*Hipoteza kryesore e punimit:* “E drejta për informim dhe sekreti shtetëror në thelb ndihmojnë funksionimin e njëri – tjetrit”. Kjo hipotezë vërtetohet dhe mbështetet në parime

ndërkombëtarisht të pranuar që kondicionojnë legjislacionet e fushës si dhe praktikat administrative, për të vendosur dhe ruajtur një balancë proporcionale dhe të pranueshme logjikisht ndërmjet dy komponentëve shumë të rëndësishëm të interesit publik, pra interesit për aksesin në informacionin publik si një e drejtë themelore e njeriut dhe të interesit për siguri, garantimi i të cilit përbën detyrën themelore të shtetit. Vërtetimi i hipotezës bazohet edhe në trajtimin e kufizimeve të së drejtës për informim, e cila nuk është një një e drejtë absolute. Të dhënat e nxjerra dhe të sjella në punim nga praktika gjyqësore e sistemit gjyqësor në vendin tonë, nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, si edhe nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, janë trajtuar gjithashtu si pjesë e vërtetimit të hipotezës.

Informacioni nuk duhet konsideruar vetëm si instrument por edhe si e drejtë që i takon çdokujt, duke jetësuar kështu realizimin efektiv të së drejtës për informim. Nga analiza krahasuese ndërmjet konceptit të sigurisë kombëtare dhe së drejtës për informim, si pjesë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, siguria njerëzore përbën një kusht dhe ndjesi sigurie, ndërsa të drejtat themelore si interesa të mbrojtura nga ligji, janë jo vetëm thelbi i sigurisë njerëzore por ato përbëjnë edhe kornizën normative të sigurisë njerëzore. Hipoteza e ngritur konfirmohet dhe vërtetohet në rregullimin që i bëjnë këtij momenti, parimet e Johannesburgut dhe më pas parimet e Tshwane, të cilat vendosin një balancë normative udhëzuese, ndërmjet së drejtës për informim dhe masave kufizuese për shkak të sigurisë kombëtare, për informacionin “sekret shtetëror”, i njohur ndryshe si informacion i sigurisë kombëtare.

*Pyetjet kërkimore shkencore:*

- Çfarë përfaqëson e drejta për informim në sistemin normativ në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe si përputhet regjimi juridik i saj, me standardet më të mira ndërkombëtare të fushës?
- Cilat janë nevojat për përmirësime dhe ç’ rol luajnë institucionet garante të së drejtës për informim në këtë proces?
- Si konsiderohet kjo e drejtë në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, në çfarë standardi trajtohet ajo dhe a e ka gjetur dimensionin e duhur siguria njerëzore në këtë strategji?
- A duhet të jetë marrëdhënia mes së drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare një marrëdhënie kufizuese, apo një marrëdhënie me një balancë të mirëmennduar në favor të interesit publik?
- A janë përvetësuar parimet ndërkombëtare të ndërveprimit dobiprurës të kësaj marrëdhënieje?
- Çfarë përfaqëson sekreti shtetëror, si një instrument mbrojtës i interesave të ligjshme të sigurisë kombëtare?
- Cila është praktika e sektorit të sigurisë në këtë aspekt dhe si ndikon mbikqyrja e veprimtarisë së tij?
- Cili është raporti ndërmjet të drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare dhe çfarë duhet bërë për të rregulluar raportin ekzistues mbizotërues të sigurisë kombëtare mbi të drejtën për informim, në një vend anëtar të NATO dhe aspirues për anëtarësim në BE, si Shqipëria?

## METODOLOGJIA

Fillesat e punës për këtë tezë doktore janë më të hershme se sa fillimi i punës në kuadër të studimeve të doktoraturës, e cila ka nisur me miratimin e kërkesës sime nga Këshilli i Profesorëve të Akademisë së Mbrojtjes “Spiro Mojsiu”, në muajin Dhjetor 2010. Kreu i këtij punimi që i përket trajtimit të së drejtës për informim është trajtuar gjerësisht nga ana ime që në vitet e para të zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, si në trajtimin e punimeve të ndryshme shkencore, ashtu edhe në ekspertizën e dhënë në kuadër të projekteve për rishikimin e dispozitave të këtij ligji, i cili ka përbërë edhe bazën kryesore të regjimit juridik të së drejtës për informim, në Shqipëri. Ky kre është zgjeruar më tej me trajtimin e sigurisë kombëtare si koncept dhe realitet në vendin tonë e më gjerë, në raportin që ajo krijon me të drejtën për informim.

Sfidë për mua ka qënë qasja që unë kërkoj të ofroj në këtë punim, për marrëdhënien që ekziston dhe që duhet të ekzistojë ndërmjet së drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare, gjë që më ka drejtuar në kërkimin e një literature të pasur, në të gjitha format e mundshme shkencore hulumtuese të ofruara. Vështirësia nuk ka qëndruar tek mungesa e literaturës por tek përzgjedhja e saj, për t’ju afruar qëllimit të temës.

Metodat e përdorura në këtë punim janë metoda përshkruese, metoda hulumtuese, metoda shpjeguese, metoda analizuese dhe metoda e ilustrimit. Me gërshetimin e këtyre metodave është synuar nxjerrja e të dhënave. Analizimi i dokumenteve dhe fenomeneve të ndryshme që përcaktojnë regjime juridike të së drejtës për informim, rregullojnë veprimtarinë e institucioneve që mbikqyrin zbatimin, përcaktojnë prioritete dhe përmbajtje të dokumenteve strategjike të sigurisë kombëtare dhe të informacionit të klasifikuar, shërbejnë për të vërtetuar hipotezën dhe për t’i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore. Përfundimet e nxjerra bazohen nga gjetjet nga shqyrtimi i literaturës, krahasimi i normave ligjore, analiza e dokumenteve si dhe studimi i rasteve të jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë si dhe i praktikës gjyqësore në vend. Në këtë punim janë përdorur disa metoda kërkimi të gërshetuara mes tyre, për të arritur në dizejimin dhe përfundimet e dhëna në të.

Është përdorur *metoda përshkruese*, e cila ka qëllimuar evidentimin e gjendjes aktuale të kuptimit dhe realizimit të së drejtës për informim dhe konceptit të sigurisë kombëtare, specifikisht sigurisë njerëzore në vendin tonë. Metoda është lidhur me një vështrim të përgjithshëm të Kushtetutës, legjislacionit shqiptar, instrumenteve ligjorë të Bashkimit Europian, Këshillit të Europës, parimeve dhe standardeve kryesore ndërkombëtare për legjislacionin e së drejtës për informim por edhe për raportin, që ajo krijon me sigurinë kombëtare.

Kjo metodikë është ndërthurur me background-in historik, i cili sqaron edhe konceptet bazë globale për të dy kategoritë objektive të marra në punim. Kjo metodë është përdorur për kërkimin e gjetjes së zgjidhjeve praktike që do t’i përshtaten sistemeve ekzistuese, duke shkuar përtej interesit të thjeshtë teorik. Arsyeja bazike e përshkrimit doktrinor tejkalon interesin e thjeshtë teorik. Kjo pasi, doktrina juridike përfaqëson kompleksitetin e akteve normuese dhe faktin se, sa delikate mund të jetë norma ligjore në kuadër të ndryshimit të fakteve që mund të çojnë në përfundime krejtësisht të ndryshme.

**Metoda hulumtuese**, është një tjetër metodë komplekse e përdorur, pasi për çështje të caktuara kërkohet të shpjegohet se çfarë përfaqësojnë dhe pse ndodh kjo. Kjo metodë shërbeu për mbledhjen e të dhënave, që lidhen me çështjet që trajtohen në punim. Për këtë qëllim janë analizuar dhe hulumtuar disa çështje si, çfarë përfaqësojnë subjektet që kanë të drejtë të marrin informacion, apo “dokumenti zyrtar” në regjimin juridik të së drejtës për informim. Hulumtimi është fokusuar mbi çështje të tilla siç edhe, si janë aplikuar parimet ndërkombëtare të së drejtës për informim në legjislacionin tonë, veçanërisht për mbrojtjen e “Bilbilfryrësve”. Ç’është “Amicus Curiae”? Një tjetër element i kësaj metode është përdorur në shpjegimin se, çfarë përfaqëson Strategjia e Sigurisë Kombëtare, e Republikës së Shqipërisë dhe si është përfaqësuar dimension i të drejtave të njeriut dhe ai i sigurisë njerëzore në këtë dokument, etj. Janë identifikuar instrumente ligjore të Këshillit të Europës, Bashkimit Evropian dhe akte ndërkombëtare, që përcaktojnë rregulla dhe parime të rëndësishme të së drejtës së informimit. Kërkimi është fokusuar në gjetjen e çështjeve dhe vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, për rastet e trajtuara mbi të drejtën për informim. Kërkimi është pasuar edhe me aktet e legjislacionit shqiptar dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese në fushat e trajtuara në punim. Pjesë e punës ka qënë gjetja e literaturës, materialeve në formë të shkruar dhe elektronike, përzgjedhja e një serie librash të botuar, artikujsh shkencorë, punime doktorale të fushave të studimit, që i kanë shërbyer objektit dhe qëllimit të punimit.

Një pjesë të rëndësishme të këtij punimi e ka zënë studimi në internet, për të skicuar disa nga çështjet objekt i këtij punimi, duke lexuar intensivisht artikuj dhe punime on-line. Interneti është një vend i përshtatshëm për të analizuar çështje dhe debate, pasi sistemet dixhitale tentojnë të jenë më të organizuara, apo edhe të strukturuar për të krijuar terren më të përshtatshëm për kërkimin shkencor. Duke qënë një proces me karakter subjektiv por edhe interpretues, studimi në internet mundëson përfshirjen e perspektivave të objektit të studimit dhe ngjashëm, shërben për daljen në përfundime.

**Metoda shpjeguese**, është përdorur gjatë punimit në tërësi kur jepen sqarime për mënyra të ndryshme funksionimi të institucioneve shtetërore si Avokati i Popullit, apo Shërbimi Informativ Shtetëror, qëndrime ndaj qasjeve të ndryshme në formulimin, apo zbatimin e dispozitave ligjore, ose të regjimeve juridike të caktuara.

Në metodologjinë e ndjekur, në punimin e temës përfshihet edhe **metoda analizuese** gjithëpërfshirëse e akteve normative, në këto 23 vitet e fundit, duke u ndalur specifikisht në ligjet që përcaktojnë regjimin juridik të së drejtës për informim, si Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, Kodi i Procedurës Administrative, hyrë në fuqi në vitin 1999 dhe i shfuqizuar, nga Kodi pasues, që ka hyrë në fuqi në vitin 2015, si dhe ligjet që kanë miratuar strategjitë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, në vitin 2000, 2004 dhe së fundmi, në vitin 2014, apo edhe Ligjin nr.8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar, pa përjashtuar këtu një sërë aktesh të tjera nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të akteve normative. Po kështu është analizuar legjislacioni që mundëson ngritjen dhe funksionimin e një sërë institucionesh garantuese të së drejtës për informim, si dhe pjesë e sektorit të sigurisë, apo edhe të mbikqyrjes së këtij sektori. Është tentuar që të bëhet një analizë shumëplanëshe në drejtim të analizës së dispozitës konkrete, evidentimit të legjislacionit të posaçëm, evidentimit të anëve pozitive

dhe negative, si dhe të identifikimit të përvojës më të mirë, të referuar nga legjislacionet bashkëkohore. Kjo është një nga metodat më kryesore të punimit. Analiza e kryer ka si qëllim nxjerrjen e përfundimeve për situatën aktuale të së drejtës për informim, si dhe të konceptimit doktrinal dhe strategjik të sigurisë kombëtare, në Shqipëri.

*Metoda krahasuese*, është përdorur në punim për të nxjerrë në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet midis fenomeneve të ndryshme, duke i shërbyer hipotezës kryesore të kërkimit shkencor. Aplikimi i kësaj metode ka nxjerrë diferencat, ngjashmëritë apo edhe mangësitë në legjislacionin rregullator për të drejtën e informimit, të funksionimit të institucioneve mbikqyrëse të zbatimit të kësaj të drejte, të bazës mbi të cilën formulohet dhe miratohet një Strategji e Sigurisë Kombëtare, të funksionimit të institucioneve të inteligjencës, apo edhe të mbikqyrjes të sektorit të sigurisë, me legjislacionin korrespondues ndërkombëtar dhe kombëtar, të fushave të marra në studim.

Edhe *metoda e ilustrimit* ka gjetur një vend të caktuar me analizimin e rasteve të shqyrtuara nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, apo edhe të Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të sistemit gjyqësor në Shqipëri, për të arritur në konkluzione që lidhen me qëllimin e punimit. Konkretisht, metoda është përdorur për të arritur në konkluzionet se si ka evoluar mbrojtja e së drejtës për informim në Shqipëri. Ndërkohë, vendime të Gjykatës Kushtetuese janë analizuar edhe për të konkluduar në bazueshmërinë e ligjeve që rregullojnë çështje të caktuara të sigurisë kombëtare, apo edhe të praktikave të caktuara ligjore të ndjekura nga institucione të rëndësishme shtetërore, që lidhen drejtëpërsëdrejti me sigurinë kombëtare.

### ***Rëndësia dhe limitet e punimit***

Rëndësia e punimit lidhet me sjelljen në vëmendje të parimeve dhe standardeve më të përparuara, të gjithëpranuara dhe të adoptuara në nivel ndërkombëtar, për kuptimin dhe rregullimin parimor dhe praktik, të raportit ndërmjet së drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare. Jo vetëm kaq, por këto garanci zhvillimore dhe efikase të fushës referohen edhe në këndvështrim të legjislacionit rregullator për të drejtën e informimit, apo edhe të praktikës së punës së institucioneve mbikqyrëse të sektorit të sigurisë, si dhe të mbikqyrjes të zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit. Kjo qasje qëllimon nxjerrjen e rekomandimeve në këtë fushë studimore.

Punimi nuk merr përsipër të ketë karakter shterues për të gjitha çështjet që lidhen me kuptimin e koncepteve dhe raportin teorik apo edhe praktik, që krijohet ndërmjet së drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare, për shkak të dinamikës së vet koncepteve dhe të këtij raporti. Punimi lë të hapur dhe nxit debatin për këndvështrime të tjera studimore zhvilluese dhe analizuese.

### **STRUKTURA E PUNIMIT**

Punimi është realizuar në katër krerë kryesore, pa përfshirë këtu **Përfundimet dhe Rekomandimet**, si dhe **Bibliografinë**.

**Në kreun e parë, “Regjimet juridike të së drejtës për informim”,** është paraqitur një këndvështrim i përgjithshëm i konceptit të së drejtës për informim dhe rolit që ajo luan, qoftë në aktet më të rëndësishme ndërkombëtare ku afirmohet si e drejtë e njeriut, ashtu edhe të përcaktimit që ajo gjen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si e drejtë themelore e njeriut. Rëndësi në këtë trajtesë ka shpjegimi i parimeve ndërkombëtare të gjithëpranuara, mbi bazën e të cilave duhet të formulohet dhe miratohet legjislacioni kombëtar për të drejtën e informimit, që shërbejnë njëkohësisht edhe si një fillesë standardizuese për raportin e drejtë dhe të balancuar, që duhet të ekzistojë në marrëdhënien midis kësaj të drejte dhe sigurisë kombëtare.

Duke kaluar në legjislacionin tonë në fuqi dhe mbi bazën krahasimore të parimeve ndërkombëtare për legjislacionin e së drejtës për informim është trajtuar një zhvillim analizues, hulumtues, i regjimit juridik që përcaktohet nga Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Përcaktimi i subjekteve të së drejtës për informim që kanë të drejtë të kërkojnë dhe marrin informacion zyrtar, i subjekteve që kanë të drejtë dhe detyrim të japin informacion zyrtar dhe disa specifika për gjendjen juridike të subjekteve të caktuara, si për shembull, në rastin e lidhjes martesore mes dy individëve minorenë, nxjerrin në konkluzione përkatëse. Analiza e kryer për objektin e marrëdhënies së të drejtës për informim, që i referohet “dokumentit zyrtar”, nxjerr në pah paqartësi të ligjit në lidhje me përdorimin për t’ju referuar objektit të marrëdhënies të termave “informacion” dhe “dokument zyrtar”. Për këtë arsye në analizën retrospektive janë referuar edhe formulime të përshtatëshme për këtë terminologji, sikurse ai i dhënë në Rekomandimin 2002 (2), të Këshillit të Europës.

Lidhur me përmbajtjen e marrëdhënies juridike të së drejtës për informim janë prekur dhe trajtuar tërësia e të drejtave dhe detyrimeve, të subjekteve të kësaj marrëdhënie, si dhe janë trajtuar afatet procedurale ligjore për trajtimin e kërkesave për informim. Parashikimi i kufizimit të së drejtës për informim, përmbajtja e dispozitave të ligjit dhe krahasimi i tyre me përmbajtjen e Konventës së Këshillit të Europës “Për Aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso, sikurse evidenton faktin se kjo e drejtë nuk është absolute, evidenton çështjen se siguria kombëtare mund të shërbejë si shkak kufizues për realizimin e kësaj të drejte, sikurse nxjerr në dritë edhe mangësi të ligjit që kanë ekzistuar lidhur me mungesën e një listimi të qartë, të shkaqeve ligjore të kufizimit. Rrugët e ankimit ligjor ndaj rasteve kur pretendohet shkelje e së drejtës për informim, identifikojnë veç ankimit administrativ dhe atij gjyqësor, edhe ankimin me natyrë “sui generis”, tek Avokati i Popullit.

Hyrja në fuqi e Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, rezulton se ka përmirësuar regjimet juridike të së drejtës për informim, qoftë përsa i përket veprimtarisë së përgjithshme administrative të organeve publike, ashtu edhe në kuadër të procedurave administrative, të rregulluara përkatësisht më parë, nga Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nga Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Nga analiza e përmbajtjes së dispozitave të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në fuqi, vërehet jo vetëm përmirësim i regjimit juridik, krahasimisht me atë të përcaktuar



në ligjin që ai ka shfuqizuar, por konstatohet edhe krijimi i një institucioni të ri, të pavaruar, mbikqyrës për zbatimin e së drejtës për informim, tek i cili të gjitha subjektet e interesuara kanë të drejtë të ankohen në rrugë administrative, në rast se i është cënuar e drejta për informim. Institucioni emërtohet KDIMDhP dhe gëzon cilësinë e organit administrativ më të lartë, që shqyrton ankesat e subjekteve kërkues të informacionit. Vendimmarrja e tij është administrativisht përfundimtare, pasi ligji parashikon se kjo e fundit mund të ankimohet në gjykatën administrative. Regjimi juridik i së drejtës për informim, i përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative, rezulton më “i ngushtë” në disa elementë, se sa ai i përcaktuar nga Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i shfuqizuar, apo nga Ligji “Për të drejtën e informimit”, në fuqi.

**Në kreun e dytë, “Institucionet kombëtare për garantimin e së drejtës për informim dhe disa aspekte të mbrojtjes së tyre në Republikën e Shqipërisë”,** është trajtuar gjerësisht gjeneza dhe koncepti filozofik i ekzistencës së Avokatit të Popullit, si një institucion i ri për traditën institucionale të Shqipërisë. Baza ligjore e krijimit dhe funksionimit, fillon me parashikimin e institucionit shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe specifikohet në ligjin organik, “Për Avokatin e Popullit”. Ai ushtron mandatin e tij, në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individit, nga veprimet e parregullta dhe kundërligjshme të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Krahas kompetencave që, Avokatit të Popullit i jepen në një mandat të përgjithshëm dhe të gjerë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në ligjin e tij organik, vërehet se ligje specifike, sikurse ai “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ngarkonin atij rolin specifik të kujdestarit të zbatimit të kësaj të drejte. Veprimtaria e tij në këtë drejtim, e analizuar për një periudhë kohore relativisht të gjatë aktiviteti institucional, tregon se Avokati i Popullit ka luajtur një rol aktiv dhe proaktiv, për mbrojtjen dhe respektimin e së drejtës për informim.

Avokati i Popullit është edhe një institucion mbikqyrës i sektorit të sigurisë. Bazuar në mandatin e tij kushtetues, në këtë pjesë trajtohen kompetencat specifike dhe instrumentat ligjorë që këtij institucioni i jepen nga Ligji “Për Avokatin e Popullit”. Një vëmendje e posaçme në këtë trajtim i është kushtuar përdorimit të instrumentit “Amicus Curiae”, si një instrument i ri, shumë interesant për mënyrën e aplikimit të tij, në rastet e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve që lidhen me të drejtat e njeriut gjatë proceseve gjyqësore dhe jo vetëm. Ka raste në të cilat veçanërisht individëve të caktuar është e nevojshme t’ju refuzohet informacioni, mbi veprimet qeveritare ndaj tyre. Roli i këtij institucioni të pavarur, të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ekziston që të kontrollojë ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e veprimit qeveritar në rrethana të tilla dhe të garantojë qytetarët se nuk ka abuzime, apo keqveprim në punën e ekzekutivit, në kushtet e nevojës së ruajtjes së sekretit shtetëror ndaj individit dhe publikut në përgjithësi.

Të dhënat statistikore të dhëna në punim nga aktiviteti i Avokatit të Popullit, tregojnë për një peshë specifike të punës së tij, që lidhet me këtë sektor. Avokati i Popullit ka akses në informacionin e sigurisë kombëtare dhe kjo gjë kërkon që ai, sikurse çdo person tjetër i autorizuar të respektojë procedurat dhe normat e legjislacionit të mbrojtjes së sekretit, duke

mos rrezikuar ligjshmërinë dhe legjitimitetin e interesit të sigurisë kombëtare, të mbrojtur nga regjimi juridik i sekretimit. Ai duhet që të ketë procedura të mirëmenduara dhe komunikim me qytetarët, me qëllim që të mbrojë informacionin, ndërkohë që në të njëjtën kohë duhet që t'i sigurojë qytetarët se, të drejtat e tyre janë respektuar.

Në këtë pjesë të punimit trajtohet edhe risija e sjellë në aspektin institucional me parashikimin e një institucioni të ri, të pavarur, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili (ka zëvendësuar rolin e kujdestarit për respektimin e së drejtës për informim, që deri në këtë kohë mbahej nga Avokati i Popullit), ka marrë rolin e një autoriteti mbikqyrës për zbatimin e kësaj të drejte. Duke analizuar juridiksionin, kompetencat dhe mjetet ligjore që Komisioneri ka në dispozicion, arrihet në konkluzione mbi kompetencat ligjore, që ai ushtron për mbikqyrjen e zbatimit të së drejtës për informim.

Për zhvillimin e konceptit të së drejtës për informim në rang ndërkombëtar, si pjesë e lirisë së shprehjes është sjellë jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, e cila përfaqëson një mekanizëm shumë të rëndësishëm të “sistemit kontrollues”, të respektimit të detyrimeve që ju lindin nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, shteteve nënshkruese të saj. Jurisprudenca e gjykatave të sistemit tonë gjyqësor dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e analizuar në vazhdim, tregon se kjo jurisprudencë është e varfër dhe nuk mund të shërbejë si burim i mirëfilltë, për rregullimin e çështjeve që lidhen me të drejtën për informim, për shkak të këtij roli apatik.

Në këtë pjesë paraqitet një reflektim i nevojshëm mbi përmbajtjen e dispozitave të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” dhe nevojën e hershme të përmirësimit të tyre për; zgjerimin e rrethit të subjekteve që kanë detyrim dhënien e informacionit; ripërcaktimin e afateve për dhënien e informacionit; përcaktimin konkret të sanksioneve dhe dëmshpërblimit në rast shkeljeje të së drejtës; detyrimin për të ndihmuar subjektin kërkues të informacionit zyrtar; qartësimin e formave të dhënies së informacionit të kërkuar; qartësimin e konceptit të kostos së pagesës për dhënien e informacionit; shtesën e listuar të kriterëve që kufizojnë të drejtën për informim; harmonizimin me regjimet e klasifikimit të informacionit, si dhe krijimin e zyrave të informimit publik. Një analizë respektive i është bërë dispozitave të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, edhe mbi regjimin juridik të përcaktuar në to, që sikurse rezulton, megjithëse ka përmirësuar ndjeshëm këtë regjim, krahasimisht me Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përsëri ka momente përmbajtjeje dhe zbatimi praktik, që nxjerrin nevojën e ndryshimit dhe përmirësimit të tyre.

Një çështje specifike e trajtuar lidhet me, aplikimin e parimit për mbrojtjen e individëve “Bilbilfryrës”. Sikurse rezulton nga hulumtimi i kryer, nuk ka ekzistuar një legjislacion i mirëfilltë për mbrojtjen e “Bilbilfryrësve”, as në formën e dispozitave të shpërndara dhe as me parashikimin në një ligj të veçantë, deri në kohën e hyrjes në fuqi, të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Pavarësisht këtij zhvillimi pozitiv, nga analiza e dispozitave të tij dhe krahasimi i tyre me sisteme të tjera ligjore ndërkombëtare, del se është e nevojshme që; të zgjerohet gama e përcaktuar e veprimeve, apo praktikave që mund të sinjalizohen sipas këtij ligji; të riformulohet termi “Sinjalizues”, sipas

përkufizimit standardizues më të mirë; të pasqyrohen më mirë në dispozitat e ligjit elementët e kuptimit të “mirëbesimit” dhe “besimit të arsyeshëm se, informacioni ka qënë thelbësisht i vërtetë”, si kërkesa dhe komponentë bazë të legjitimitit të aktit të “bilbilfryrjes”, dhe të garantimit të mbrojtjes ligjore për individin që e kryen atë.

**Në kreun e tretë, “Koncepti i sigurisë kombëtare dhe disa nga institucionet garante të saj në Republikën e Shqipërisë”**, ofrohet fillimisht një qasje teorike ndaj kuptimit të konceptit të sigurisë kombëtare. Duke kaluar nga koncepti i sigurisë tek individët, si një nevojë dhe mekanizëm biologjik mbijetese dhe një përshtatje ndaj kërcënimeve, koncepti tek shtetet si subjekte vlerësohet si, aftësi e tyre për të mbrojtur vetveten ndaj kërcënimeve, apo veprimeve kundër integritetit të tyre territorial dhe sovranitetit. Siguria e shtetit ndikon në sigurinë e perceptuar të qytetarëve të tij, sikundër siguria e perceptuar mes shteteve në marrëdhëniet mes tyre, ndikon në sigurinë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Paradigma bashkëkohore e sigurisë analizohet në formën e tre kornizave themelore konceptuale; - siguria individuale, - siguria kombëtare, - siguria ndërkombëtare.

Sot siguria kombëtare konsiderohet si një vlerë parësore kolektive, një e mirë personale dhe politike dhe në një këndvështrim të zgjeruar, ajo trajtohet si një e drejtë themelore e njeriut. Koncepti i sigurisë ka evoluar historikisht duke tejkaluar çështjet tradicionale të luftës dhe kërcënimit dhe tashmë duke nxjerrë si kërcënime kryesore çështje si, degradimi mjedisor, varfëria, terrorizmi në shumë forma, armët e shkatërrimit në masë, HIV-Sidën, etj. Sot aktorët shtetërorë formulojnë dokumente të politikave të sigurisë kombëtare, sikundër edhe dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare. Elementët e sigurisë kombëtare ndryshojnë nga një vend në tjetrin, por duhet theksuar se në shumë vende përfshirë këtu strategjinë e sigurisë së Bashkimit Europian, koncepti i sigurisë kombëtare përfshin; sigurinë shtetërore, sigurinë sociale dhe sigurinë njerëzore. Siguria njerëzore bazohet në filozofinë e hershme të liberalizmit dhe vë në qendër individin, dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut. E përdorur për herë të parë si term, nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara në vitin 1994, siguria njerëzore ka zgjeruar thelbësisht konceptin e sigurisë kombëtare. Në varësi të kërcënimeve të reja të shfaqura, sot kur flasim për sigurinë ekonomike, sigurinë ushqimore, sigurinë shëndetësore, sigurinë individuale, sigurinë komunitare dhe sigurinë politike, kemi folur për sigurinë njerëzore.

Duke dhënë një trajtim evolutiv historik të konceptit të sigurisë kombëtare në Shqipëri, që nga krijimi e zhvillimi i shtetit-komb shqiptar, me shpalljen e pavarësisë më 28 Nëntor 1912, vlerësohet së pas viteve 90’ kemi një ridimensionim të konceptit të sigurisë. Zhvillimet në këtë fushë duhet që të konsiderojnë vendin, nga “konsumator sigurie”, në “prodhues sigurie” për qytetarët e tij, në rajon dhe më gjerë. Në këtë konsideratë, Strategjia e Sigurisë Kombëtare është një dokument kornizë, përcaktues, ku qëllimi parësor për garantimin e funksionit madhor të një shteti jepet në përshkrimin se si një vend ofron sigurinë dhe ku përfaqësohet një marrëdhënie e kujdesshme mes qëllimeve, mjeteve dhe mënyrave. Informacioni është një instrument shumë i rëndësishëm në këtë kontekst, krahas instrumentave diplomatikë, të zbatimit të ligjit, financiare dhe ekonomike. Strategjia e Sigurisë Kombëtare duhet të ruajë vlerat e parimet bazë, të mishëruara në Kushtetutë.

Republika e Shqipërisë ka miratuar dokumente të tillë, sikurse ai i miratuar me Ligjin nr.9322 datë 25.11.2004 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, përmbajtja e së cilës është trajtuar në këtë pjesë të punimit. Në këtë strategji mbizotëronte “Qasja dydimensionale”, që lidhte objektivin afatshkrutër e afatmesëm, siç është integrimi me perspektivën afatgjatë të shtetit ligjor. Në përmbajtjen e dispozitave vërehen; probleme që lidhen me përdorimin e termit “shtet ligjor”, term ky i tejkaluar tashmë; një lloj konfuzioni në përdorimin e terminologjive mbi të drejtat e njeriut që shërbejnë si udhërrëfytes për ndërtimin e konceptit të strategjisë; theksohet dukshëm kufizimi i së drejtës për informim; ka një kuptim të paqartë të termit “dezinformim publik”; nuk ka një kuptim dhe zhvillim të qartë të sigurisë njerëzore, e cila është shumë pak e përfshirë dhe aspak e priorizuar, krahasuar me kërcënimet e jashtme dhe rajonale. Për këto arsye ky dokument strategjik ka patur të nevojshëm rishikimin, përmes një procesi me shkallë të gjerë konsultimi, me të gjithë aktorët dhe faktorët e fushës.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare, e miratuar me Ligjin nr.103/2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, në ndryshim nga dokumenti strategjik i vitit 2004, përfaqëson strategjinë e një vendi anëtar të NATO-s, rrjedhimisht duke u mbështetur në Konceptin Strategjik të NATO-s, si dhe të një vendi kandidat potencial për në Bashkimin Europian. Nga ky këndvështrim, Strategjia e Sigurisë Kombëtare në fuqi, harmonizon rolin, misionin, përgjegjësitë, kapacitetet dhe organizimin e institucioneve të sigurisë, të Republikës së Shqipërisë, me realitetin e ri të sigurisë kolektive.

Në të gjithë komponentët e saj kemi të shpërndarë rregullime që lidhen me elementë të sigurisë njerëzore, sikundër afirmimi për respektimin e dinjitetit njerëzor, respektimin e të drejtave të njeriut, siguria shëndetësore, siguria ushqimore, siguria mjedisore, etj. Pavarësisht këtij zhvillimi përmbajtësor duhej që, në të të theksohej si një terminologji e veçantë, e drejta e informimit, e cila në qëllimin dhe objektin realizues të saj përbën thelbin e konceptit të transparencës. Po kështu, në përmbajtjen e saj vazhdon përdorimi i termit të tejkaluar “shtet ligjor”, ndërkohë që duke u fokusuar tek siguria njerëzore mendoj se, kërcënimet e përcaktuara mbi sigurinë e informacionit të klasifikuar, duhej të konceptoheshin në një raport më të ngushtë me “rrezikun dobipurës”, që mund t’i sjellë informacionit të sigurisë kombëtare, e drejta për informim. Pavarësisht këtyre konstatimeve, ky është një dokument i rëndësishëm konceptual, që identifikohet i mirëstrukturuar.

Një trajtim analizues dhe hulumtues është kryer për institucionet e inteligjencës në vend, Shërbimi Informativ Shtetëror dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, duke nxjerrë konkluzione dhe përjasje për formësimin e praktikave, si dhe të një roli më proaktiv të tyre, jo vetëm në prodhimin e produktit të inteligjencës por edhe të respektimit dhe shfrytëzimit në të mirë të sigurisë kombëtare, të publikimit të informacioneve të caktuara, që lidhen me aktivitetin e tyre. Në këto organe të shërbimit inteligjent, fshehtësia dhe sekretin janë elementi kryesor bazik i veprimtarisë së tyre. Këto institucione përjashtohen nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të informacionit, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve të emrave, të titujve zyrtarë, të pagave e të numrit të personelit. Një fushë në të cilën, rezultatet mund të

arrihen më thjesht do të ishte përmirësimi i legjislacionit për mbikqyrjen e shërbimeve informative. Një ligj specifik mbi mbikqyrjen e shërbimeve informative, i cili aktualisht mungon do të shërbente për rritjen e transparencës dhe të standardizimit të veprimtarisë së Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sikurse në institucionet homologe të vendeve të zhvilluara demokratike. Aktivitetet e nevojshme të shërbimeve inteligjente duhet të kryhen duke respektuar të drejtat e njeriut dhe në fakt vlerësoj se, kjo është sfida kryesore e kësaj veprimtarie.

Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet Komisionit për Mbrojtjen dhe Sigurinë, luan një rol kyç në mbikqyrjen e sektorit të sigurisë për ta bërë atë llogaridhënës dhe transparent, por kjo gjë nuk përlligj moskrijimin e nënkomisionit parlamentar, të parashikuar për t'u ngritur për mbikqyrjen dhe raportimin e veprimtarisë në të, të Shërbimit Informativ Shtetëror. Procesi i integritetit të vendit tonë me anëtarësimin në NATO dhe ecurinë e tij për anëtarësimin në BE, përfaqëson dhe vlerësohet si një mundësi por edhe në kufizime, që kanë potencialin të përmirësojnë sigurinë e vendit, nëse adoptohen politika dhe strategji adekuate.

**Në kreun e katërt, “Raporti ndërmjet sigurisë kombëtare dhe së drejtës për informim dhe disa problematika të këtij raporti në Shqipëri”,** është trajtuar raporti mes sigurisë kombëtare dhe së drejtës për informim. Gjëja më e rëndësishme në këtë raport është se, nga perspektiva e diferencave ndërmjet regjimit juridik ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe debatit të sigurisë njerëzore, konsiderimi i respektimit, mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të njeriut nuk duhet vlerësuar si zgjedhje e politikës, sidomos në kohë krizash të sigurisë kombëtare, ku shpesh shfaqet rreziku për cënimin e të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe cënimin e së drejtës për informim. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë, qartëson konsideratën se, të drejtat e shtetit nuk duhet të pengojnë aksionin e qëllimuar për dhënien e sigurisë ndaj njerëzve, në kohën kur siguria njerëzore është kthyer në një qëndër vëmendjeje dhe shqetësimi për komunitetin ndërkombëtar.

Parimet e Johaneshburgut (të adoptuara në Tetor 1995) dhe në vazhdim, parimet e Tshwane, mbi sigurinë kombëtare, lirinë e shprehjes dhe aksesin në informacion, përbëjnë një bazë shumë të mirë për ekuilibrimin e tensionit, ndërmjet masave të ndërmarra në kuadër të sigurisë kombëtare dhe minimizimit të abuzimit dhe cënimit të të drejtave të njeriut, në këto kushte. Kur flasim për marrëdhënien mes sigurisë kombëtare dhe së drejtës për informim, përplasja ndërmjet koncepteve ndodh në momentin e kufizimit të së drejtës për informim. Për këtë arsye është trajtuar në këtë pjesë, kuptimi dhe përdorimi i sekretit shtetëror, si informacion i sigurisë kombëtare dhe si një mjet ligjor që legjitimon kufizimin e së drejtës për informim. Duke patur një natyrë sfiduese ndaj së drejtës për informim, duhet theksuar se sekretit shtetëror nuk mund dhe nuk duhet përdorur abuzivisht, për të mbajtur larg syve dhe veshëve të publikut, kundërligjshmërinë e “përligjur” me justifikimin e mbrojtjes së çështjeve të sigurisë kombëtare.

Kjo përplasje nxjerr në pah caktimin e prevalencës së regjimeve juridike që rregullojnë të drejtën për informim dhe sistemin e mbrojtjes të sekretit shtetëror në tërësi, si dhe rast pas rasti. Në rrethana të caktuara, publikimi i informacioneve qoftë edhe sekrete dhe jo fshehja e tyre, mund t'i shërbejë më mirë sigurisë kombëtare. Në këtë pjesë trajtohet edhe regjimi juridik i klasifikimit të informacionit, për të cilin është arritur në konkluzionin se ka disa

problematika që kërkojnë përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, që përcaktojnë këtë regjim. Pengesë kryesore me pasojë mungesën e transparencës ndaj publikut është mungesa e harmonizimit të legjislacionit për deklasifikimin e informacioneve të klasifikuara. Për pasojë, deri më sot nuk ka një proces të rregullt deklasifikimi.

Duke prekur disa çështje konkrete të raportit ndërmjet sigurisë kombëtare dhe së drejtës për informim në Shqipëri, trajtohen në këtë kre momente, të cilat konsiderohen përkatëse dhe të rëndësishme për shpjegimin konkret të gjetjeve dhe konsideratave të shprehura në pjesët e tjera të punimit. Një analizë specifike është kryer mbi sistemet e video survejimit, si teknologji survejimi me video kamera stacionare, apo të lëvizëshme, që sikurse vlerësohet janë mjete teknike që i shërbejnë sigurisë dhe rendit publik. Aplikimi i këtyre sistemeve ngre pikëpyetje dhe hap debat mbi cënimin e të drejtave të ligjshme të individit, siç ndaj të drejtës për privatësi, të drejtës për lëvizje të lirë dhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Video survejimi si pjesë e sistemit kompleks të mbikqyrjes së veprimtarisë njerëzore ngre problemin e ndërthurjes së çështjes, me konceptin e sigurisë njerëzore. Shkalla e gjerë e përdorimit të video survejimit nga subjekte të ndryshme, shtetërore ose jo, specifikisht në rastin e ushtrimit si veprimtari nga ana e shtetit nxjerr nevojën e kuptimit të faktit se, jo gjithmonë jemi në kushtet ideale kur shteti vepron si garantues i sigurisë njerëzore. Për këtë arsye, qëllimi i përdorimit të sistemeve video survejuese dhe aplikimi i tyre ka të nevojshëm një bazë normative rregullatore, balancuese ndërmjet interesave të prezumuara shtetërore të sigurisë dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke paraparë dhe parandaluar shkaqet që prodhojnë pasiguritë njerëzore në praktikë.

Legjislacioni ynë në këtë fushë ka qënë i mangët dhe fragmentar, por është plotësuar me hyrjen në fuqi, të Ligjit nr.19/2016 “Për masat shpesh të sigurisë publike”. Ky ligj ndër të tjera, sipas vlerësimit të dhënë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në jurisprudencën e saj, ruan një balancë të drejtë dhe proporcionale ndërmjet interesave të tregtarëve si subjekte private, për të ushtruar lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe, e parë si pjesë e kësaj lirie, për të gëzuar qetësisht pronën e tyre, nga njëra anë, me interesat e shtetit për miratimin e një sërë normash rregulluese për marrjen e masave konkrete, si vendosje të sistemit të videove, me qëllim ruajtjen e sigurisë publike.

Problematika të tjera të trajtuara janë, aksesin e publikut dhe medias në seancat e proceseve gjyqësore; aksesin në informacion në çështjet penale; aksesin në dosjet e organeve publike në procedimet administrative, si dhe çështje konkrete që ngrenë pikëpyetje mbi sigurinë ushqimore; legjitimiteti i Marrëveshjes “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare”, nënshkruar në vitin 2009, mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë, si dhe tragjedia e Gërdecit, ndodhur në datën 15.03.2008.

## LITERATURA

Një pjesë thelbësore e procesit të kërkimit për temën e këtij punimi shkencor ka qënë literatura e përzgjedhur. Punimi është bazuar në një literaturë të pasur duke u mbështetur në burimet kryesore dhe dytësore. Pikërisht kjo literaturë ka shërbyer si pikënisje e analizës, këndvështrimit kritik, apo edhe e këndvështrimeve të reja të ofruara për të drejtën e informimit dhe sigurinë kombëtare. Risitë e sjella në kuadrin e trajtimit shkencor mbi bazën e punimeve të reja, apo pasurimit të punimeve ekzistuese të studiuesve të fushës me ide të reja janë ndërthurur me elementët klasikë të trajtimit të çështjeve, që lidhen me të drejtën e informimit dhe sigurinë kombëtare, apo me ngritjen dhe funksionimin e disa institucioneve në Shqipëri, të analizuar në këtë punim.

Punimi shkencor është bazuar në botimet e autorëve të huaj dhe atyre shqiptarë, me kontribut të dallueshëm në fushën e të drejtave të njeriut, apo të sigurisë kombëtare, të artikujve shkencorë të referuar në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, artikujve të botuar në revista shkencore të printuara, ose on-line (Political Science Quarterly), disertacione të ndryshme në fushën e së drejtës. Në punim janë përfshirë edhe raporte, apo publikime të organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare, me një rol të spikatur në fushën e së drejtës për informim, siç Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Amatosura (DCAF), Article 19, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Qendra “Res Publica”, apo të çështjeve të sigurisë. Po kështu janë përdorur publikime, apo raportime zyrtare të institucioneve të pavarura në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, si Avokati i Popullit, apo Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Aktet normative janë përdorur si një burim parësor në këtë punim. Të tilla janë aktet themelore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Europian, të Këshillit të Europës, direktiva, rregullore dhe rekomandime të ndryshme të Këshillit të Europës, me përkatësi koherente të fushës së studimit, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, apo edhe një tërësi aktesh normative të së drejtës në vendin tonë, në fushën e së drejtës për informim. Janë përdorur gjithashtu edhe opinione të rëndësishme të Komisionit të Venecias, pa përjashtuar edhe aktet bazë ligjore me të cilat janë miratuar Strategji të Sigurisë Kombëtare, apo mbi bazën e të cilave funksionojnë institucione të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe institucione të sektorit të sigurisë dhe të mbikqyrjes së këtij sektori, në vendin tonë. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, praktika konkrete të sistemit tonë gjyqësor, apo edhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kanë zënë vendin përkatës në literaturën e përdorur dhe të shfrytëzuar për këtë punim shkencor.

Për nga veçantia e punimit dhe temës që ai trajton janë shfrytëzuar edhe materiale të tjera të ndryshme të gjendura në rrugë “on-line”, si dhe libra të shkruar, apo artikuj të botuar në media, mbi çështje që në jetën e përditëshme lidhen me elementin e sigurisë njerëzore. Lista e plotë, e zgjeruar, e paraqitur dhe e kategorizuar sipas llojit të burimit të referuar dhe rendit alfabetik, gjendet në fund të punimit.

## SHKURTIME

DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
KEDNJ	Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
NATO	Aleanca Ushtarake e Atlantikut Verior
BE	Bashkimi Europian
KE	Këshilli i Europës
OSBE	Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Europian
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
KPrA	Kodi i Procedurave Administrative
KPrC	Kodi i Procedurës Civile
KPrP	Kodi i Procedurës Penale
KC	Kodi Civil
KP	Kodi i Punës
AP	Avokati i Popullit
KDIMDhP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
FA	Forcat e Armatosura
SSK	Strategjia e Sigurisë Kombëtare



# I. KREU I PARË

## REGJIMET JURIDIKE TË SË DREJTËS PËR INFORMIM

### 1.1 Historiku dhe kuptimi i së drejtës së informimit

Vetëm kohët e fundit e drejta për informim është njohur dhe afirmuar gjerësisht, por rrënjët dhe koncepti i saj datojnë që në shekullin e 18, në periudhën e Rilindjes Europiane. Në rrënjët e saj historike, kjo e drejtë është garantuar për herë të parë në legjislacionin suedez, në Ligjin e Lirisë së Shtypit, të Mbretërisë Suedeze.<sup>1</sup> Ideatori i këtij dokumenti historik që përfaqëson gurin e themelit të së drejtës së informimit, filozofi Chydenius, thekson se, “Liria është opozita e vërtetë e kufizimit, por si fjalë ajo ka kuptime të shumta, duke qënë e prirur për t’u përdorur dhe për t’u abuzuar ndaj edhe duhet përdorur me kujdesin më të madh, me qëllim që të mos shkaktojë më shumë dëm se sa dobi”.<sup>2</sup>

Në këtë kontekst historik vendet nordike njihen sot ndërkombëtarisht si, pararendësit në çështjet e transparencës dhe të aksesit në informacion. Njohja dhe pasqyrimi formal në dokumenta bazë të rrethave juridike i të drejtës së informimit, i përket kohës së sotme. Pra, e drejta për informim është vlerësuar si një instrument kundër sekretit dhe mungesës së besimit në qeverisje, në kushtet e ekzistencës së burokracisë mbytëse të shtetit autokratik, duke i paraprirë lindjes së shtetit administrativ dhe më pas atij administrativ modern, ku garantohet respektimi i të drejtave të njeriut, vendoset sistemi “Check and Balance”, krijohen tregjet e lira dhe ku konsolidohet demokracia.

Me krijimin e Kombeve të Bashkuara dhe të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, e drejta për informim filloi të përhapej. Liria e informimit garantohet në të drejtën ndërkombëtare. Si neni 19, i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ashtu edhe ai i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Politike dhe Civile, përcaktojnë se çdo person gëzon të drejtën të kërkojë dhe japë informacion. Ekziston një njohje në rritje mbi atë se, e drejta për të kërkuar informacion përfshin të drejtën e lirisë së informimit.<sup>3</sup> Ligji i parë bashkëkohor që siguron këtë të drejtë është Akti i Lirisë për Informim i SHBA, në vitin 1966.<sup>4</sup>

Tendenca e legjislacioneve kombëtare është që, gjithnjë e më shumë të garantojnë të drejtën për të siguruar informacionin që mbahet nga organet shtetërore dhe kjo duket në

---

<sup>1</sup> Ky akt njihet si, Ordinanca mbi Lirinë e të Shkruajturit dhe të Shtypit, nxjerrë në Stokholm në Dhomën e Këshillit, në 2 Dhjetor 1766, nga Mbreti i Suedisë, Adolphus Frederick.

<sup>2</sup> Manninen J., (2006): “Anders Chydenius and the Origins of World’s First Freedom of information Act”, cituar në “The World’s First Freedom of information Act-Anders Chydenius’ Legacy today”; Anders Chydenius Foundation, Art – Print Ltd, viti 2006, faqe 35.

<sup>3</sup> Anders Chydenius Foundation, “The World’s First Freedom of information Act-Anders Chydenius’ Legacy today”, Anders Chydenius Foundation, Art – Print Ltd, viti 2006, faqe 4.

<sup>4</sup> Instituti për Studime Publike & Ligjore, Komentari “Ligji për të drejtën e informimit”, Tiranë, viti 2003, faqe 13.

numrin gjithnjë në rritje të shteteve, të cilët kanë një ligj, apo garantojnë me ligj këtë të drejtë. Në grupimin e këtyre vendeve bën pjesë edhe vendi ynë.

Në legjislacionin shqiptar të deri para Luftës së Dytë Botërore, nuk ka ekzistuar një ligj për të drejtën e informimit. Kjo mungesë vazhdoi edhe gjatë regjimit komunist në vend, si pasojë e vetë natyrës së mbyllur dhe të izoluar të këtij sistemi politik. Kushtetuta, por edhe legjislacioni i kësaj kohe nuk afirmonte të drejtën e informimit, gjë që ndryshoi pas viteve 90', kur në legjislacionin në fuqi të kohës u njoh dhe garantua kjo e drejtë.

Formulimi, “E drejta për t’u informuar nuk mund t’i mohohet askujt”<sup>5</sup>, është parashikimi që i bëhet për herë të parë kësaj të drejte, në Ligjin nr.7692 datë 31.03.1993 “Për një shtojcë në Ligjin nr.7491 datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, garanton të drejtën e informimit si një nga të drejtat themelore të njeriut, ndërkohë që për herë të parë, ajo është rregulluar me Ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Koncepti i të drejtave themelore të njeriut i ka fillesat e tij tek ideja për dinjitetin njerëzor, e cila është po aq e vjetër sa edhe vetë historia e njerëzimit. Thelbi i shprehur në proverbin e vjetër afrikan, “*Unë jam qenie njerëzore, sepse sytë e tu më shikojnë si të tillë*”, zbulon lidhjen e dinjitetit njerëzor me ekzistencën humane të individit dhe me jetën shoqërore komunitare, që e pranon dhe respekton atë si të tillë.<sup>6</sup> Pavarësisht afirmimit të të drejtave të njeriut, si produkt i mendimit filozofik të kohës moderne, e bazuar në filozofinë e racionalizmit dhe iluminizmit dhe më pas të liberalizmit dhe demokracisë, e drejta për informim, nuk mund të konsiderohet një koncept i ri. Si pjesë e të drejtave themelore të njeriut, të origjinuara dhe modernizuara fillimisht në Europë dhe më pas në Amerikë,<sup>7</sup> e drejta për informim konsiderohet e lindur së bashku me qënien njerëzore, universale, e patjetërsueshme, e pandashme dhe e padhunueshme.

Në rrjedhën historike të përpjekjeve për njohjen dhe garantimin e të drejtave themelore të njeriut, ato dallohen si, “...një shprehje kuptimplotë e raportit midis pushtetit dhe individit”.<sup>8</sup> Ky raport, ka gjetur natyrshëm pasqyrimin e tij në afirmimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në dokumenta të rëndësishëm bazë të disa vendeve juridike, si në kushtetutat, apo kartat e deklaratat e të drejtave me rëndësi kushtetuese, “duke shënuar në këtë mënyrë kalimin nga shteti autoritar dhe absolut, në shtetin liberal, ose në shtetin e së drejtës”.<sup>9</sup>

---

<sup>5</sup> Shih nenin 2, të Ligjit nr.7692 date 31.03.1993 “Për një shtojcë në Ligjin nr.7491 datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

<sup>6</sup>Website:www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user\_upload/ETC

Hauptseite/manual/versionen/albanian/manual\_vollversion\_albanisch.htm

<sup>7</sup> Deklarata Amerikane e Pavarësisë (viti 1776), është një pranim solemn për atë kohë, i idesë për të drejtat e njeriut, kur në të shprehet se: “...Ne i konsiderojmë këto të vërteta si të pranueshme - të gjithë njerëzit janë të barabartë; të gjithë janë pajisur nga krijuesi i tyre me disa të drejta të patjetërsueshme; në mesin e të cilave janë jeta, liria dhe e kërkimi i lumturisë. Për të siguruar këto të drejta janë themeluar qeveritë, nga pushteti ligjor i të cilave rrjedh pajtimi i të qeverisurve . . .”.

<sup>8</sup> Omari L., (2004): “Shteti i së drejtës”, botim i dytë, Shtëpia botuese “Elena Gjika”, viti 2004, faqe 286.

<sup>9</sup> Anastasi A., (2004):“E drejta kushtetuese” - cikël leksionesh, Shtëpia botuese “Pegi”, viti 2004, faqe 67.

Ato janë lidhur ngushtë me kuptimin e shtetit të së drejtës, si një organizëm që përmban një tërësi parimesh dhe vlerash, të cilat kanë një sanksionim të përgjithshëm juridik dhe garant për të drejtat e njeriut. Prandaj, sot në të gjitha vendet liberale e demokratike, në të cilat fatmirësisht bën pjesë edhe vendi ynë, strumbullari i shtetit të së drejtës përbëhet nga një kompleks të drejtash themelore, që gjejnë shprehje në aktet juridike ndërkombëtare me një vlerë juridike të lartë dhe sanksionohen edhe në Kushtetutat e ndryshme.<sup>10</sup>

Bazuar në këtë sistem vlerash të afirmuara në kuptimin e tyre universal, e drejta e informimit është afirmuar si e tillë në një sërë aktesh ndërkombëtare, si në DUDNJ, në KEDNJ dhe natyrshëm edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta e miratuar në vitin 1998, në preambulën e saj shprehet për “vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”. Në katalogun e të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara në të, afirmohen kategoritë kryesore të të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë katalog bëjnë pjesë liritë dhe të drejtat vetjake, liritë dhe të drejtat politike si dhe liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

Nocioni i të drejtës së informimit do të thotë se, çdokush ka të drejtën që t’i bëhet i njohur informacioni i interesit publik, duke u prezantuar si një e drejtë që, jo vetëm ruan vlerat e individëve në një shoqëri demokratike, por edhe shërben si premisë për t’i zhvilluar ato më tej përmes vendosjes së standardeve më të mira. Transparenca e qeverisjes është një çështje themelore e demokracisë dhe një parakusht për ardhjen sa më afër qytetarëve të saj, të çdo qeverie. Për të bërë Qeverinë të besueshme, individët gëzojnë të drejtën e informimit, apo të njohur ndryshe si, të drejtën e njohjes me dokumentet zyrtare. Por nga ana tjetër, “...transparenca në procesin e vendimmarrjes është dobiprurëse edhe për vet qeveritë, duke rritur besimin e individëve në veprimet qeveritare”.<sup>11</sup>

Kjo lloj marrëdhënie parasheh se e drejta e informimit nuk është thjesht një e drejtë individuale që i shërben vetëm interesave të ngushta të individit, por ajo i shërben edhe vet qeverisësve për krijimin e besimit publik. Informacioni pra, nuk është thjesht një nevojë për njerëzit, ai është pjesë e domosdoshme e një qeverie të mirë, kjo për faktin se nëse njerëzit nuk dinë se çfarë është duke ndodhur në shoqërinë e tyre, ndaj edhe shpesh e drejta e informimit etikohet si oksigjen për demokracinë. Lidhja mes demokracisë dhe aksesit në informacionin zyrtar, është vlerësuar si vet-evidente në shumë vende dhe për një kohë të gjatë. Kjo lidhje duket sidomos në vendet në tranzicion, sikurse edhe vendi ynë, ku në proceset legjislativë çështja e aksesit në informacionin zyrtar është konfrontuar dhe shpesh konsideruar si pjesë e punës të ndërtimit të strukturave administrative, të cilat ngrihen për t’i shërbyer procesit demokratik të vendimmarrjes.

Mbrojtja e të drejtës së aksesit në informacionin publik, e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përcakton dhe vendos rregulla në mirëfunksionimin dhe transparencën, e administratës publike karshi publikut të gjerë, në veprimtarinë e saj të

<sup>10</sup> Omari L., (2004): “Shteti i së drejtës”, botim i dytë, Shtëpia botuese “Elena Gjika”, viti 2004, faqe 287.

<sup>11</sup> Anders Chydenius Foundation, “The World’s First Freedom of information Act-Anders Chydenius’ Legacy today”, Anders Chydenius Foundation, Art – Print Ltd, viti 2006, faqe 4.

përditshme. Momentet kryesore, në të cilat mbështetet principi i aksesit publik në informacionin publik, janë:

- 1- Lehtësimi i shkëmbimit të pikëpamjeve të lira demokratike, duke kontribuar kështu në legjitimitetin demokratik të vendimeve,
- 2- Forcimi i kontrollit të administratës nga publiku dhe media,
- 3- Kontributi në rritjen e efikasitetit të administratës.

Pjesëmarrja e publikut në diskutimet e informuara mbi çështjet e interesit të përgjithshëm publik është një nga kërkesat primare të demokracisë. Kjo mënyrë funksionimi kërkon që qytetarët të jenë të vetëdijshëm në ushtrimin e kontrollit mbi administratën, me qëllim që të nxisin efikasitetin e saj dhe të luftojnë korrupsionin. Në kuptimin e saj themelor, e drejta e informimit garanton të drejtën e çdokujt për të ditur dhe për të marrë informacion, pa asnjë lloj kufizimi dhe diskriminimi.

Një tjetër aspekt i të drejtës së informimit është se, ajo është e lidhur ngushtë me shumë të drejta të tjera. Ajo është një parakusht për realizimin e lirisë, shprehjes dhe njëkohësisht, është pjesë përbërëse e kësaj lirie. Është e kuptueshme që, në mungesë të informacionit një individ e ka të pamundur të krijojë bindje, ose opinione.<sup>12</sup> E drejta për informim si pjesë e lirisë së shprehjes vlerësohet më shumë si, virtyt publik dhe e drejtë individuale.

Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute, pasi edhe ajo kufizohet. Kufizimi i saj shihet në dy aspekte kryesore:

- Publiku ka të drejtë të njihet vetëm me ato lloj dokumentesh që vlerësohen si pjesë e informacionit publik.
- Informacioni publik i përmbajtur në një dokument zyrtar, mund të jetë sekret. Sipas përcaktimit ligjor përkatës për këtë term bëhen kufizimet përkatëse.

Si një e drejtë pozitive që bën pjesë në kategorinë e lirive dhe të drejtave vetjake, të sanksionuara në kreun e dytë të Kushtetutës, e drejta e informimit përfshihet në kategorinë ku, kufizimi i të drejtës kërkon “kapërcimin e provës të interesit detyrues”.

Kjo është prova më e vështirë dhe lidhet me interesin detyrues publik ose, qeveritar. Në këtë rast, kufizimi i të drejtave të njeriut duhet të jetë në atë masë, sa të përmbushë interesat publike e qeveritare.<sup>13</sup>

Kjo e drejtë dhe ushtrimi i saj ul rrezikun e veprimit arbitrar dhe për më tepër, sikurse përmendet shpesh, e drejta e informimit kontribuon në reduktimin dhe kthimin e korrupsionit në një fenomen të rrallë, në administratën publike. Si përfundim mund të thuhet se, “E drejta e informimit është një mekanizëm jetësor i zhvillimit të transparencës së vazhdueshme të qeverisjes, me përpunime të kohë pas kohëshme, për të përshtatur zhvillimet teknologjike dhe interesat e maturuara të shoqërisë, në një qeverisje të hapur dhe plotësisht të përgjegjshme, që nxit dhe zhvillon mënyrën tonë demokratike të jetesës”.<sup>14</sup>

<sup>12</sup> Instituti për Studime Publike & Ligjore, Komentar “Ligji për të drejtën e informimit”, Tiranë, viti 2003, faqe 12.

<sup>13</sup> Anastasi A., (2004):“E drejta kushtetuese” - cikël leksionesh, Shtëpia botuese “Pegi”, viti 2004, faqe 72.

<sup>14</sup> US Department of Justice, “Freedom of information Act Guide & Privacy Act Overview”, Washington DC, viti 2004, faqe 19.

Të drejtat e njeriut njihen sot si mjete të cilat, njerëzit mund t'i përdorin si instrumente për transformime shoqërore. Në parimet bazë të krijimit dhe funksionimit të BE dhe KE, në veçanti në rastet kur kemi të bëjnë me pranimin e anëtarëve të rinj, të drejtat e njeriut janë parësore. Ato kanë përbërë kusht edhe për nënshkrimin e MSA ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE,<sup>15</sup> si një hap konkret drejt anëtarësimit në familjen europiane dhe të të gjithë procedurave në vazhdim, të ndërmarra nga vendi ynë për këtë qëllim.

## **1.2 Parimet ndërkombëtare të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe aktet kryesore ndërkombëtare për të drejtën e informimit**

Parimet janë përcaktuar për vendosjen e një standarti me të cilin kushdo mund të masë nëse, ligjet kombëtare e lejojnë ose jo, në mënyrë të mirëfilltë, mundësinë e aksesit ndaj informacionit zyrtar dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Standardet, apo parimet kryesore janë të rëndësishme, pasi ato testojnë nëse ligji do të zgjerohet të drejtën e publikut për informacion.<sup>16</sup> Parimet e legjislacionit të së drejtës së informimit,<sup>17</sup> vendosin një standard udhëzues të përgjithshëm, mbi bazën e të cilit duhet të formulohet legjislacioni kombëtar për njohjen dhe garantimin e kësaj të drejte. Standardet ndërkombëtare janë norma të rëndësishme, të pranuar përgjithësisht nga shtetet, që shërbejnë si pika referimi për legjislacionin e brendshëm shtetëror. Ato ndihmojnë për krijimin e një legjislacioni të ngjashëm nga shtete të ndryshme dhe favorizojnë zbatimin e tij, brenda shtetit dhe në marrëdhëniet midis shteteve.<sup>18</sup> Parimet e legjislacionit të së drejtës së informimit, përcaktojnë se:

- 1. Legjislacioni mbi lirinë e informacionit duhet të udhëhiqet nga parimi thelbësor i hapjes maksimale.*

Sipas këtij parimi, gjithë informacioni i mbajtur nga organet publike duhet t'i nënshtrohet prezumimit të qënies i hapur. Në rrethana të caktuara informacioni mund të mos jetë i hapur, por gjithmonë interesi publik mund të tejkalojë këtë kufizim.

- 2. Institucionet publike duhet të kenë detyrimin të publikojnë informacionet e rëndësishme.*

Një ligj i të drejtës së informimit nuk mund të funksionojë vetëm në bazë të kërkesave të individëve.

---

<sup>15</sup> Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE, është nënshkruar në 12 qershor 2006, në Luksemburg.

<sup>16</sup> Article 19 & Qendra për Zhvillimin Demokratik të Institucioneve, "Liria e Informimit: Manual trajnimi për nëpunësit", Shtypshkronja "Flesh", Tiranë, viti 2004, faqe 26.

<sup>17</sup> Këto parime janë përgatitur nga organizata joqeveritare "Article 19"- Qendra Ndërkombëtare kundër Censurës, me qendër në Londër, e cila ka marrë emrin e saj dhe ka si qëllim veprimtarie respektimin dhe zbatimin e nenit 19, të DUDNJ, ku garantohet shprehimisht liria e shprehjes dhe e mendimit dhe si pjesë domethënëse e tyre, e drejta për informim. Parimet bazohen në ligje dhe standarte ndërkombëtare dhe rajonale, praktikën shtetërore në zhvillim dhe parimet e përgjithshme të ligjeve të miratuara nga komuniteti i kombeve. Ato janë produkt i një procesi të gjatë studimi, analize dhe konsultimi të mbikqyrrur nga Article 19 dhe nga shfrytëzimi i përvojës së gjerë dhe punës me organizata partnere, në mbarë botën. Website: [www.article19.org/data/files/pdfs/standards/righttoknow.pdf](http://www.article19.org/data/files/pdfs/standards/righttoknow.pdf)

<sup>18</sup> Islami H., Hoxha A., Panda I., (2003): "Procedura Penale-Komentar", Botimet Morava, viti 2003, faqe 28.

Autoritetet nuk kanë detyrën vetëm t'i përgjigjen kërkesave për akses, por ato kanë edhe një detyrim aktiv të vënë në dispozicion dhe promovojnë transparencën.<sup>19</sup>

*3. Institucionet publike duhet të nxisin në mënyrë aktive qeverisjen e hapur.*

Mënyra e organizimit të shërbimit civil, kufizimet kyçe ndaj ekspozimit të lirë të informacionit, nivelet e dijës, si dhe shkalla e ndërgjegjshmërisë së publikut të gjerë janë elementë që lidhen direkt me këtë princip. Realizimi i këtij principi kërkon veprimtari promovuese, si përbërës thelbësor të rregullave të së drejtës së informimit.

*4. Përjashtimet duhet të jenë përcaktuar qartë dhe t'i nënshtrohen testeve rigorozë për "dëmshmërinë" dhe "interesin publik".*

Përjashtimet duhet të jenë të kufizuara në kohë dhe duhet të mbështeten mbi përmbajtjen dhe jo mbi llojin e dokumentit. Në ligj duhet të përfshihet një listë e plotë e qëllimeve legjitime, që mund të justifikojnë mosekspozimin.

Kjo listë duhet të përfshijë vetëm interesat që përbëjnë baza legjitime për refuzim, si zbatimi i ligjit, siguria kombëtare, intimiteti, konfidencialiteti tregtar, dhe i llojit tjetër, siguria publike e individuale, si dhe efektshmëria dhe integriteti i proceseve qeveritare të vendim-marrjes.<sup>20</sup>

*5. Kërkesave për informim duhet t'u jepet përgjigje me shpejtësi dhe saktësi dhe në raste të pavaruara mund të ketë ndonjë refuzim.*

Ky parim është i lidhur ngushtë me momentet si, caktimi i një personi i cili merret me përpunimin e kërkesave për të siguruar respektimin e ligjit, riformulimin e kërkesave të paqarta, mundësinë e apelimit<sup>21</sup> administrativ të vendimit për refuzim dhe të kundërshtimit të tij në gjykatë.

*6. Individët nuk duhen penguar të bëjnë kërkesa për informacion përmes kostove të skajshme, të cilat miratohen nga vetë institucioni publik.*

Kostoja e aksesit në informacionin që mbahet prej institucioneve publike, nuk duhet të jetë aq e lartë, sa të pengojë aplikantët e mundshëm dhe ndërkohë kategori të caktuara aplikantësh mund ta përfitojnë informacionin falas.

*7. Takimet e institucioneve publike duhet të jenë të hapura për publikun.*

Publiku ka të drejtë të dijë se çfarë është duke bërë në emër të tij qeveria dhe të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes. Takimet mund të jenë të mbyllura, por vetëm në përputhje me procedurë të përcaktuara dhe atje ku ekzistojnë arsye ligjore. Termi "takim", i referohet një takimi formal, si për shembull, mbledhja e një institucioni publik me qëllim zhvillimin e punëve publike.

---

<sup>19</sup> Maenpaa O., (2006): "Openness and Access to Information in Finland", cituar në "The World's First Freedom of Information Act-Anders Chydenius' Legacy today", Anders Chydenius Foundation, Art – Print Ltd, viti 2006, faqe 61.

<sup>20</sup> Article 19, "E drejta e publikut për të ditur-Parime mbi Legjislacionin e Lirisë së Informacionit", Tiranë, viti 2001, faqe 6.

<sup>21</sup> Po aty, faqe 8. Në të gjitha rastet, ligji duhet të parashikojë të drejtën e një individi për të apeluar në një institucion të pavarur administrativ refuzimin e një institucioni publik për të ekspozuar informacionin. Ky mund të jetë një institucion ekzistues, siç AP... Si aplikanti ashtu edhe institucioni publik duhet të jenë në gjendje të apelojnë në gjykatë kundër vendimeve të institucionit administrativ.

8. *Ligjet që bien në kundërshtim me principin e hapjes maksimale, duhen amenduar apo shfuqizuar.*

Principi i sipërcituar është baza e lirisë së informimit. Përjashtimet që parashikohen në ligjin për të drejtën e informimit duhet të jenë të plota dhe nuk duhet lejuar që, ato të zgjerohen nga ligje të tjera. Në veçanti, ligjet për sekretshmërinë nuk duhet ta quajnë të paligjshme kur zyrtarët ekspozojnë informacion, të cilin u kërkohet ta ekspozojnë sipas ligjit të lirisë së informacionit.<sup>22</sup>

9. *Individët*, të cilët e dinë mirë se çfarë aktiviteti ushtrohet në një institucion të caktuar, janë pikërisht ata që punojnë aty. Informacioni që ky institucion zgjedh për t'i dhënë publikut, mund të pjesërisht i vërtetë, ose mund të jetë krejtësisht i pavërtetë. Për këtë arsye të rëndësishme e drejta e informimit përfshin të drejtën e zyrtarëve, për të bërë publik informacionin rreth shkeljeve të rënda,<sup>23</sup> të kryera në institucionin ku ata punojnë. Pikërisht këta individë, të cilët bëjnë publik në mirëbesim një informacion që lidhet me veprimtarinë e institucionit, duke thyer njëkohësisht detyrimet e tyre ligjore dhe kontraktuale ndaj punëdhënësit të tyre, pasi besonin që informacioni është i vërtetë dhe është një çështje serioze me interes publik, do të quhen “*bilbilfryrës*”. Për këta individë duhet të ekzistojë mbrojtje ligjore.

Këto parime përcaktojnë standarde për regjime kombëtare dhe ndërkombëtare,<sup>24</sup> të së drejtës së informimit ndaj ato prezantojnë një udhëzues të rëndësishëm për interpretimin se, si duhet të formulohet dhe zbatohet ligji për të drejtën e informimit. Të drejtat nuk janë shumë të dobishme për individët në rast se individët nuk kanë dijeni për to. E drejta për informim është një nga të drejtat themelore të njeriut, e sanksionuar dhe garantuar në akte ndërkombëtare, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në legjislacionin kombëtar të shumë vendeve, në forma të ndryshme dhe me modalitetet e përshtatshme.

Në këto akte, përcaktohen standartet ndërkombëtare të së drejtës për informim, të cilat bëjnë të detyrueshëm hartimin e ligjeve kombëtare të së drejtës për informim, në përputhje me to nga njëra anë, por që nga ana tjetër bëjnë të detyrueshëm hartimin e këtyre ligjeve kombëtare në atë mënyrë, që të ekzistojë një ekuilibër dhe harmonizim midis të drejtës për informim dhe informacioneve të një rëndësie të veçantë, të klasifikuar. Qënia palë në këto akte, sjell detyrimin e shtetit për marrjen e masave për respektimin e plotë, ose të pjesshëm, të detyrimeve të parashikuara në to. Disa nga këto akte ndërkombëtare kryesore që, afirmojnë të drejtën e informimit janë:

*-Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në 10 Dhjetor 1948. Ajo afirmon të drejtat më

---

<sup>22</sup> Article 19, “E drejta e publikut për të ditur - Parime mbi Legjislacionin e Lirisë së Informacionit”, Tiranë, viti 2001, faqe 10.

<sup>23</sup> Të tilla shkelje do të konsideroheshin; kryerja e një akti kriminal, injorimi i një detyrimi ligjor, korrupsioni, keqadministrimi i institucionit publik, rrezikshmëria ndaj shëndetit publik, kërcënimi i mjedisit etj. Shih, Article 19 & Qendra për Zhvillimin Demokratik të Institucioneve, “Liria e Informimit: Manual trajnimi për nëpunësit”, Shtypshkronja “Flesh”, Tiranë, viti 2004, faqe 35.

<sup>24</sup> Parimet janë hartuar në radhë të parë për legjislacionin kombëtar mbi lirinë e informacionit, por ato janë po aq të zbatueshme për informacionin e mbajtur nga organet ndërqeveritare të tilla si, Kombet e Bashkuara dhe BE.

themelore të njeriut, ndër të cilat edhe të drejtën për informim. Në nenin 19, të kësaj deklarate shprehet se: “Çdokush gëzon lirinë e mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur mendime pa ndërhyrje dhe për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacione dhe ide nëpërmjet çdo lloji mjeti dhe pa marrë parasysh kufijtë”. Duhet theksuar se ky është një ndër nenet më të njohura në fushën e lirisë së shprehjes dhe informimit. Një nga organizatat më të njohura dhe më aktive në fushat globale për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të informimit, me qendër në Londër, ka marrë emrin e këtij neni dhe pikërisht “Article 19”.

*-Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut*, e hartuar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, si një nga përpjekjet e para me efikasitet për të siguruar garancinë kolektive të disa të drejtave të afirmuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Në paragrafin e parë, të nenit 10, Konventa bën një riformulim dhe theksim të përcaktimit të bërë në nenin 19, të DUDNJ: “Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose mendime, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”. Zhvillimi kryesor në këtë Konventë, në kuadër të afirmimit ndërkombëtar të së drejtës për informim qëndron në përcaktimin e bërë në paragrafin e dytë, të nenit 10, ku për herë të parë shprehet se, kjo e drejtë ka edhe kufizime të saj dhe se, subjektet që gëzojnë këtë të drejtë por edhe ato që e zbatojnë këtë të drejtë, kanë përgjegjësi të tyre konkrete.

-Në mbështetje të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, palët nënshkruese të saj kanë nënshkruar në Dhjetor 1966, *Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike*. Edhe ky akt i rëndësishëm njeh dhe garanton të drejtën për informim.

*-Deklarata e Këshillit të Europës mbi Lirinë e Shprehjes dhe të Informimit*, e vitit 1982, shpreh si një nga përparësitë në veprimtarinë e Këshillit të Europës, aksesin në informacion. Në këtë deklaratë jepen parimet kryesore në lidhje me të drejtën e informimit dhe rolin që luan kjo e drejtë në shoqëri; “si një kusht i nevojshëm për zhvillimin e shoqërisë”. Objektivat kryesore të shteteve anëtare, në kuadër të parimeve të përcaktuara në këtë deklaratë janë:

- Mungesa e censurës/kontrollit mbi pjesëmarrësit në procesin e informimit,
- Ndjekja e një politike të hapur në sektorin publik, përfshirë aksesin në informacion,
- Ekzistenca e një shumëllojshmërie mediash të pavarura dhe autonome,
- Aksesin në informacion dhe zbatimin e tij në shkallë kombëtare.

*-Konventa e Aarhusit*, “Mbi të drejtën e publikut për informim, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin”, e nënshkruar në Konferencën e Ministrave të Mjedisit, të mbajtur në 25 Qershor 1998, në Aarhus, Danimarkë, nga tridhjetë e pesë shtete europiane dhe Bashkimi Europian. Duhet theksuar fakti se, në grupin përgjegjës për hartimin e materialit të kësaj konvente bënte pjesë edhe Shqipëria. Rëndësi të veçantë merr angazhimi dhe detyrimi, që iu lind palëve nënshkruese për respektimin e së drejtës së informimit ndaj publikut, në çështjet mjedisore. Ndër risitë që sjell kjo konventë në këtë fushë, janë:

- Pranimi i së drejtës për informim, pjesëmarrje e mundësi për t’iu drejtuar gjykatës, bazuar në të drejtën për një mjedis të përshtatshëm për shëndetin,



- Një përkufizim i gjerë për informacionin për mjedisin, duke përfshirë informacionin për shëndetin mjedisor,
- Garantimi i të drejtës së publikut për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve për mjedisin, përfshirë hartimin e politikave dhe legjislacionit mjedisor,
- Mbështetja e së drejtës për t'u informuar dhe pjesëmarrje në vendimmarrje, me të drejtën për t'u drejtuar gjykatës.<sup>25</sup>

*-Karta e të Drejtave të Njeriut e vendeve të Bashkimit European*, e miratuar në Samitin e Nisës në Dhjetor 2000, është teksti i parë zyrtar në botë në fushën e të drejtave të njeriut që sanksionoi zyrtarisht të drejtën e mirëadministrimit, si të drejtë themelore të njeriut.<sup>26</sup>

*-Kodi European i Sjelljes së Mirë Administrative*, i miratuar nga ana e Parlamentit European në 6 Shtator 2001, qëllimon shpjegimin në detaj të Kartës Themelore të të Drejtave të Njeriut, të Bashkimit European dhe më konkretisht, të së drejtës për mirëadministrim dhe asaj se, çfarë kupton kjo e drejtë në praktikë. Një pjesë të rëndësishme të përcaktimeve të dhëna në këtë Kod, zë trajtimin e së drejtës për informim, si një e drejtë solide me të drejtën e mirëadministrimit. Në nenet 22 dhe 23, të këtij Kodi, përcaktohet shprehimisht se:

“1. Zyrtari do t'u japë, kur ai ka përgjegjësinë për çështjen në fjalë, anëtarëve të publikut informacionin që ata kërkojnë. Kur i takon atij, zyrtari do të japë këshillë se si të fillohet një procedurë administrative brenda fushës së tij të kompetencës. Zyrtari do të kujdeset që informacioni i komunikuar të jetë i qartë dhe i kuptueshëm.

2. Nëse një kërkesë verbale për informacion është shumë e komplikuar apo shumë e gjithanshme për t'u trajtuar, zyrtari do të këshillojë personin e interesuar të formulojë kërkesën e tij me shkrim.

3. Nëse, për shkak të konfidencialitetit të tij, një zyrtar mund të mos e japë informacionin e kërkuar, ai apo ajo, në përputhje me nenin 18 të këtij Kodi, do t'i tregojë personit të interesuar arsyet se përse ai nuk mund t'ia komunikojë informacionin.

4. Zyrtari për më tej për kërkesat për informacion mbi çështjet për të cilat ai nuk ka përgjegjësi, do ta drejtojë kërkuuesin tek personi kompetent dhe do t'i tregojë emrin e tij dhe numrin e telefonit. Për kërkesat për informacion që kanë të bëjnë me një institucion apo organ tjetër të Komunitetit, zyrtari do t'a drejtojë kërkuuesin në këtë institucion apo organ.

5. Atje ku duhet, në varësi të subjektit të kërkesës, zyrtari do të drejtojë personin që kërkon informacion në shërbimin e institucionit përgjegjës për dhënien e informacionit publikut”;

“1. Zyrtari do të marrë në shqyrtim kërkesat për akses në dokumenta në përputhje me rregullat e adoptuara nga Institucioni dhe në përputhje me principet e përgjithshme dhe kufizimet e vendosura në Rregulloren (EC) no.1049/2001.

2. Nëse zyrtari nuk mund të veprojë në përputhje me një kërkesë verbale për akses në dokumenta, qytetari do të këshillohet për t'a formuluar atë me shkrim”.

<sup>25</sup> Ky informacion gjendet në, Website: [kos.rec.org/albanian/pdf/KosBuletini%20nr5.pdf](http://kos.rec.org/albanian/pdf/KosBuletini%20nr5.pdf)

<sup>26</sup> Përcaktimi në këtë Kartë i të drejtës së mirëadministrimit (neni 41), të drejtës së aksesit në dokumentet zyrtare (neni 42), të Institucionit të Ombudsmanit (neni 43), janë një zhvillim i ri dhe i konsiderueshëm në zhvillimin e të drejtave të njeriut, në gjirin e Komunitetit European.

-Rekomandimi 2002 (2) i Këshillit të Europës, për Aksesin në Dokumenta Zyrtare. Rekomandimi e specifikon të drejtën e informimit, duke u përqëndruar tek e drejta e aksesit në dokumentat zyrtare. Është e kuptueshme që kjo e drejtë zbatohet me kufizimet përkatëse në shërbim të interesit publik, por në rekomandim theksohet se, këto kufizime duhet të jenë sa më të pakta dhe duke përcaktuar kriteret për këto kufizime, si më poshtë:

- Kufizimet duhet të parashikohen me saktësi në ligj,
- Kufizimet duhet të jenë të nevojshme,
- Kufizimet duhet të jenë në përpjestim me qëllimin e mbrojtjes së informacionit.<sup>27</sup>

Parimi i përgjithshëm i dhënë në këtë rekomandim është se, shtetet anëtare duhet të garantojnë të drejtën e të gjithëve për të patur akses, sipas kërkesës, në dokumentat zyrtare që mbahen prej autoriteteve publike.

-Konventa e Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso, e adoptuar në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, më 27.11.2008,<sup>28</sup> krijon detyrime informative edhe për subjekte si, organet legjislative, autoritetet gjyqësore, apo edhe për personat fizikë apo juridikë, për aq sa ata kryejnë funksione publike, apo kur operojnë me fonde publike, në përputhje me legjislacionin vendas. Bazuar në parimet dhe standartet ndërkombëtare, legjislatori shqiptar ka miratuar legjislacionin specifik që përcakton regjimin juridik të së drejtës të informimit.

### **1.3 Legjislacioni shqiptar për të drejtën e informimit.**

Dokumenti më i rëndësishëm në kuptimin e akteve normative që afirmojnë dhe garantojnë të drejtën e informimit, është *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Në nenin 23 të saj, përcaktohet se:

- E drejta e informimit është e garantuar.
- Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
- Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Si një e drejtë bazë për një qeverisje demokratike në nivel ndërkombëtar, e drejta për informim ka gjetur rregullim specifik që detajon kuptimin e saj në jetën e përditëshme, në një grupim ligjesh të miratuara në respekt të hierarkisë dhe në harmoni me përmbajtjen e akteve më të larta normative, në vendin tonë.<sup>29</sup>

---

<sup>27</sup> Ky informacion gjendet në botimin, Council of Europe, “Access to official documents-Recommendation Rec (2002) 2 of the Committee of Ministers and explanatory memorandum”, Directorate General of Human Rights, Strasbourg, viti 2003.

<sup>28</sup> Website: [conventions.coe.it/Treaty/en/Treaties/Html/205.htm](http://conventions.coe.it/Treaty/en/Treaties/Html/205.htm). Për këtë Konventë kanë filluar procedurat nga ana e shtetit tonë për ratifikimin e saj. Në shkresat e Ministrit të Drejtësisë, nr.5053/1 datë 18.06.2009 dhe nr.5053/4 datë 18.11.2009, drejtuar ndër të tjera edhe A.P, kërkohet mendim nga ana e disa institucioneve shtetërore, lidhur me një projekt-vendim të Këshillit të Ministrave “Për miratimin në parim të Konventës së KE “Për të drejtën për informim në dokumentat zyrtare”. Ndërkohë kjo konventë nuk ka hyrë ende në fuqi, pasi nuk është arritur të ratifikohet nga numri minimal i kërkuar i vendeve për këtë qëllim.

Ky informacion gjendet në Website:

[conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=205&CM=1&DF=&CL=ENG](http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=205&CM=1&DF=&CL=ENG)

<sup>29</sup> Shih nenin 116, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar si bazë rregullatore kryesore, fillimisht Ligjin Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”,<sup>30</sup> si dhe Ligjin nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”. Miratimi dhe hyrja në fuqi e Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe i Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kanë përmirësuar regjimet juridike të së drejtës për informim në nivelet përkatëse të aplikimit të saj, të rregulluara përkatësisht më parë, nga Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nga Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Ndërkohë ekziston edhe një grupim ligjesh, që në dispozitat e tyre lidhur me realizimin e kësaj të drejte, i referohen regjimit juridik të përcaktuar në ligjet e sipërcituara.<sup>31</sup>

Pa kaluar tek analiza e regjimeve juridike të përcaktuara, fillimisht në Ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, dhe pas shfuqizimit të tij, në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konstatohet se një aplikim të drejtëpërdrejtë të realizimit të së drejtës për informim sipas këtyre regjimeve juridike, e gjejmë në Ligjin nr.9409 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Të gjitha të dhënat e përfituara nga deklarimi sipas këtij ligji, që kanë të bëjnë me pasurinë e të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë, burimet e krijimit të saj, si dhe të detyrimeve financiare të tyre, përfshirë këtu deklarimin për familjarët e tyre dhe personat e lidhur me ta, janë të lejueshme për publikun, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.<sup>32</sup>

Një tjetër ligj ku referohen rregullime të bëra në ligjet bazë të sipërcituara, është Ligji nr.9367 datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Deklarimi rast pas rasti, periodik, apo identifikimi i konfliktit të interesave për zyrtarët që ushtrojnë funksione publike, sipas mënyrave të parashikuara në këtë ligj, përbën objektin e këtij ligji. Veçanërisht në rastin e deklarimit dhe regjistrimit rast pas rasti të konfliktit të interesave,<sup>33</sup> parashikohet se këto regjistrime janë dokumente zyrtare, të cilat bëhen publike sipas dispozitave të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.<sup>34</sup> Ndërsa për qëllime të një procedure administrative, në pikën 2, të nenit 12, të po këtij ligji përcaktohet se, regjistrimet e interesave si dokumente zyrtare, u vihen në dispozicion, në kohë të arsyeshme, palëve në procedim, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në KPrA. Sikurse konstatohet, në të njëjtën dispozitë

---

<sup>30</sup> Është domethënë fakti se, Ligji “Për të drejtën e Informimit për dokumentet zyrtare”, është një nga ligjet e para të së drejtës të informimit, të miratuara nga parlamentet e vendeve paskomuniste të Europës Juglindore.

<sup>31</sup> Të tilla ligje janë, Ligji nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për kontrollin dhe deklarimin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar, Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar; Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar etj.

<sup>32</sup> Shih nenin 34, të Ligjit nr.9409 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

<sup>33</sup> Shih nenin 11, të Ligjit nr.9367 datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

<sup>34</sup> Po aty, pika 1, neni 12.

parashikohen rregullime që i nënshtrohen regjimeve juridike të dy ligjeve të ndryshme, të cilët kanë të njëjtin qëllim, por që diferencohen në elemente të tillë si, cilësitë e subjekteve të së drejtës dhe fusha e veprimit të së drejtës.

Zhvillimi dhe përmirësimi i legjislacionit në këtë fushë dhe nevoja për plotësimin e tij me akte normative rregullatore kanë sjellë në vazhdim, miratimin dhe hyrjen në fuqi edhe të dy ligjeve të tjera të rëndësishme, përkatësisht Ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe të Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish sigurimit të shtetit, të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Në Ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, objekti rregullator i tij lidhet me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik, të projektligjeve, projekt-dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe të politikave me interes të lartë, për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të organeve publike, dhe për të nxitur transparencën, përgjegjshmërinë dhe integritetin e autoriteteve publike.<sup>35</sup> Krahas procedurave specifike ligjore për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të njoftimit dhe të konsultimit publik, ligji përcakton se aksesin në dokumentacionin e nevojshëm që lidhet me projektaktin, nga ana e subjekteve të dhëna në këtë ligj, sigurohet edhe sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.<sup>36</sup> Sikundër parashikohet se, procesverbalet dhe regjistrimet e takimeve publike mund të bëhen publike, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit.<sup>37</sup> Në këtë ligj jepet për herë të parë në legjislacionin shqiptar kuptimi i termit “transparencë”, kur në pikën 2, të nenit 15 të ligjit, kuptimi i termit përcaktohet si një veprimtari e hapur e një organi publik për të informuar në lidhje me aktet me interes të lartë publik, me proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, që u siguron palëve të interesuara mundësinë për të marrë pjesë në këto procese.

Ligji nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, është një risi në kuadër të së drejtës për informim, pasi ai ka si objekt të tij, përcaktimin e rregullave dhe procedurave për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin, mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent ku mbrohet personaliteti i individit. Ky proces bazohet në vlerat e unitetit dhe pajtimit kombëtar.<sup>38</sup> Edhe ky ligj që në objektin e tij, përcakton se autoritetet publike i referohen dhe zbatojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, për aq sa është e mundur, si dhe legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, arkivat dhe informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”.

---

<sup>35</sup> Shih nenin 1, të Ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin Publik”.

<sup>36</sup> Po aty, pika 2, e nenit 13.

<sup>37</sup> Po aty pika 6, e nenit 18.

<sup>38</sup> Shih pikën 1, të nenit 1, të Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

## **1.4 Regjimi juridik i së drejtës për informim, në Ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.**

Grupimi i ligjeve të cilat afirmojnë dhe garantojnë në mënyrë të detajuar ushtrimin efektiv të së drejtës për informim, përbëjnë bazën përcaktuese të regjimit juridik të kësaj të drejte. Në këtë këndvështrim janë disa ligje që duhen analizuar dhe vlerësuar në kontekstin rregullator kohor, për të kuptuar veçantinë e regjimit juridik të së drejtës për informim në legjislacionin tonë të brendshëm dhe për të evidentuar mënyrën se si ka evoluar ai, deri në ditët e sotme.

Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, është një nga ligjet që gjatë kohës që ka qënë në fuqi, ka përbërë bazën e regjimit juridik të së drejtës së informimit në Shqipëri. Në thelb, ushtrimi i të drejtës për informim sipas këtij ligji ka të bëjë me marrëdhënien juridike ndërmjet individit dhe subjekteve të tjera, të njohura me termin “autoritete publike”. Si një marrëdhënie juridike administrative, kjo marrëdhënie prezanton tre elementë të saj; subjektet, objektin dhe përmbajtjen. Secili nga këta elementë ka veçoritë e tij gjë që sjell dallimin e kësaj marrëdhënieje nga marrëdhëniet e tjera juridike si, për shembull ato civile, apo penale.

### **1.4.1 Subjektet e së drejtës së informimit**

Duke u fokusuar tek subjektet, terminologjia e përgjithëshme e përdorur për kuptimin e subjekteve të së drejtës për informim, në Kushtetutë, në KPrA, dhe në Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”,<sup>39</sup> nxirrte nevojën e kryerjes së një analize mbi kuptimin e tyre. Nga ky këndvështrim, aspekti rregullator përgjithësues i dispozitave kushtetuese ka të nevojshëm që, për kuptimin konkret të subjekteve të së drejtës për informim, t’i drejtohem përmbajtjes së dispozitave të ligjeve specifike, të cilët rregullojnë dhe detajojnë realizimin e saj.

Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ka qënë një nga ligjet kryesore në këtë fushë, që detajonte kuptimin dhe realizimin e së drejtës për informim në jetën e përditëshme. Ky ligj garantonte të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare në përgjithësi, pa qënë nevoja që kërkuesi të vërtetonte interesin e vet personal për këtë çështje.<sup>40</sup> Në termat e përdorura në këtë ligj, lidhur me kuptimin e subjekteve, gjejmë përkufizimet:

- “autoritet publik”, kuptohet çdo organ i Administratës Shtetërore dhe i Enteve Publike,
- “person”, kuptohet çdo person, fizik ose juridik, vendas ose i huaj,

<sup>39</sup> Në pikat 2 dhe 3, të nenit 23, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përdoren përkatësisht termat, “*kushdo* ka të drejtë...”, “*kujtdo* i jepet mundësia...”. Në KPrA, (Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”), në nenin 51, përdorej termi “*çdo person* gëzon të drejtën për t’u informuar”, ndërsa në Ligjin “Për të drejtën e Informimit për dokumentet zyrtare”, në nenin 3, përdorej termi “*çdo person* ka të drejtë...”.

<sup>40</sup> Shih paragrafin e parë, të nenit 3, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet zyrtare”.

- “publik”, kuptohet të paktën edhe një person.<sup>41</sup>

Subjekte të përcaktuara të marrëdhënies juridike të normuar prej tij, “janë ato organe të Administratës Shtetërore dhe Entet Publike, të njohura të tilla nga ligji, si dhe personat fizikë apo juridikë, që duke qenë të veshur me të drejta dhe të ngarkuar me detyrime në fushën e veprimtarisë administrative hyjnë në marrëdhënie midis tyre”.<sup>42</sup> Subjektet e përfshira në këtë grupim, janë të vendosura në anë të ndryshme të marrëdhënies juridike të së drejtës për informim, ku një pjesë janë të detyruar të japin informacion, ndërsa pjesa tjetër ka të drejtën të kërkojë dhe të marrë informacion.

*“Autoriteti publik”, si subjekt që ka detyrimin të japë informacion, lidhej direkt me nocionin e administratës publike. Në KPrA<sup>43</sup> parashikohet se, në organet e administratës publike, përfshihen:*

- organet e pushtetit qëndror, të cilat kryejnë funksione administrative,
- organet e enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative ,
- organet e pushtetit vendor që, kryejnë funksione administrative,
- organet e forcave të armatosura, si dhe çdo strukturë tjetër, punonjësit e së cilës gëzojnë statusin e ushtarakut, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative.<sup>44</sup> Nisur nga këto përcaktime ligjore të kohës, nga studjues të caktuar është vërejtur se, “administrata publike, tashmë përfshin jo vetëm organet e administratës shtetërore, por edhe një sërë organesh të tjera të ndryshme nga të parat. Në këtë tërësi organesh të administratës publike përfshihen edhe entet publike”.<sup>45</sup>

Duke qenë se kuptimi i dhënë i organeve të administratës shtetërore ka qënë më i qartë, një sqarim më të detajuar meriton koncepti i entit publik. KPrA,<sup>46</sup> i cilëson ato si pjesë të organeve të administratës publike, ndërsa KC,<sup>47</sup> i parashikon si persona juridikë publikë. Ndërkohë, Ligji nr.8480 datë 27.05.1999 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, e përkufizon atë si subjekt të së drejtës publike, të krijuar me ligj.<sup>48</sup> Pra, enti publik është një organ i administratës publike, i krijuar me ligj si person juridik publik për të realizuar një interes publik. Parashikimi i entit publik si organ i administratës publike nga ligjet e sipërcituara, lë detyrë para

---

<sup>41</sup> Shih nenin 2, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet zyrtare”.

<sup>42</sup> Dobjani E., (2007): “E drejta Administrative” (botim i ripunuar), Shtypshkronja “Perlat Voshtina”, viti 2007, faqe 34.

<sup>43</sup> Këtu referimi bëhet për Ligjin nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

<sup>44</sup> Shih nenin 3, të Ligjit nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

<sup>45</sup> Methasani E., (2003): “Enti publik, organ i administratës publike si risi në legjislacionin shqiptar dhe doktrinën juridike”, Revista Juridike, Botim i Shkollës së Magjistraturës, Nr.3, faqe 1.

<sup>46</sup> Këtu referimi bëhet njëkohësisht për të dy ligjet, përkatësisht Ligjin nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

<sup>47</sup>Në nenin 25, të Kodit Civil, thuhet se:

“Persona juridikë publikë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik”.

<sup>48</sup> Në nenin 1, të Ligjit nr.8480 datë 27.05.1999 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, përcaktohet se: ”Me ent publik, për qëllimet e këtij ligji, do të kuptohet çdo subjekt i së drejtës publike, jo shtetëror, i krijuar me ligj dhe që synon realizimin e një interesi publik”.

legjislatorit të qartësojë më shumë nëse një person juridik është ent publik, apo jo.<sup>49</sup> Nocioni i administratës publike pra, përfshin një bashkësi personash juridikë publike, sipas përcaktimit të dhënë në nenin 25, të KC. Efektivisht përcaktimi i bërë në këtë nen të KC, përfshin bashkësinë e gjithë institucioneve shtetërore, pjesë e të cilave është grupimi i institucioneve që futen tek administrata publike. Kjo dispozitë flet edhe për ndërmarrje shtetërore, nocion i tejkualuar tashmë, po të kemi parasysh dispozitat për shoqëritë shtetërore,<sup>50</sup> në Ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Megjithatë, sipas nocioneve të dhëna në ligj, një autoritet publik është jo vetëm një subjekt që duhet të japë informacion, por ai ka të drejtën edhe të marrë informacion nga një autoritet publik tjetër. Gjendja juridike është karakteristika që kushtëzon llojin e informacionit që, një autoritet publik mund të kërkojë nga një tjetër, në kuadër të së drejtës për informim. Në doktrinën e së drejtës administrative, tagrat e pushtetit dhe kompetencat e organeve të administratës publike, përbëjnë në tërësi gjendjen juridike të tyre, e cila ndryshon nga një organ në tjetrin. Gjendja juridike përcakton fushën dhe kufijtë e veprimit, qëllimin konkret të veprimtarisë, si dhe të drejtat që organi gëzon dhe detyrimet që ai ka, për të realizuar veprimtarinë e për të arritur pasojat të caktuara juridike.

Megjithëse, Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, nuk kërkonte detyrimin për të treguar qëllimin për të cilin kërkohet informacioni, tërësia e akteve normative që përcaktojnë gjendjen juridike të autoritetit publik përkatës, shërbente edhe si gjendje përcaktuese dhe kufizuese për llojin e informacionit zyrtar që, organi mund të kërkojë për realizimin e së drejtës për informim. Në paragrafin e parë, të nenit 3, të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përcaktohej që, çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet. Në këtë kontekst edhe personat që ushtrojnë funksione shtetërore, brenda strukturës organizative të organit të administratës shtetërore, si dhe personat e zgjedhur në bazë të një procedure parlamentare në organet drejtuese të enteve publike, përfaqësojnë një nënkategori specifike subjektsh të së drejtës për informim.

Një çështje interesante për diskutim, në lidhje me përcaktimin e rrethit të “autoriteteve publike” ka qenë prej kohësh, nëse gjyqësori mund të konsiderohet apo jo, një subjekt i së drejtës për informim. Duke u nisur nga parimi i pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe duke u nisur nga arsyetimi se liria e shprehjes nuk duhet të kompromentojë dhënien e drejtësisë nga gjykatat, gjyqësori tradicionalisht mban një profil të ulët publik. Në fakt s’duhen pasur dyshime, sepse padyshim edhe gjyqësori duhet t’i nënshtrohet parashikimeve të ligjit për të drejtën e informimit.<sup>51</sup>

Grupimi i *subjekteve që kanë të drejtë të kërkojnë dhe marrin informacion*, në kuptim të përcaktimit si rreth subjektsh nga të dy ligjet, përkatësisht Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999

<sup>49</sup> Methasani E., (2003): “Enti publik, organ i administratës publike si risi në legjisllacionin shqiptar dhe doktrinën juridike”, Revista Juridike, Botim i Shkollës së Magjistraturës, Nr.3, faqe 8.

<sup>50</sup> Shih nenin 213, të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

<sup>51</sup> Avokati i Popullit, Botimi “Konferenca Kombëtare - E drejta e informimit e drejtë themelore e njeriut”, Shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë, viti 2003, faqe 43.

“Për të drejtën e Informimit për dokumentet zyrtare” dhe Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përfshin;

- Tregtarin si person fizik,<sup>52</sup> dhe shoqëritë tregtare<sup>53</sup>, përkatësisht shoqëritë kolektive, shoqërite komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare, të parashikuara në Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Tregtari si person fizik, nga njëra anë, fiton statusin dhe shoqëritë tregtare fitojnë personalitet juridik nga ana tjetër, për të qenë subjekte të së drejtës, pasi regjistrohen në Qendrën Tregtare të Regjistrimit, në përputhje me parashikimet specifike të bëra në Ligjin nr.9723 datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar.

- Organizatat jofitimprurëse dhe partitë politike, të parashikuara nga neni 26, i KC, si persona juridikë privatë. Këto subjekte, përkatësisht në bazë të Ligjit nr.8788 datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar, dhe në bazë të Ligjit nr.8580 datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, fitojnë personalitet juridik dhe dalin si subjekte të së drejtës, pas themelimit dhe regjistrimit në gjykatë;

- Persona fizikë, sipas përcaktimit të bërë në KC,<sup>54</sup> të cilët dallojnë nga tregtari si person fizik, i parashikuara në Ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Vlen të theksohet se, liritë dhe të drejtat e njeriut të shprehura në Kushtetutë, i referohen “lindjes gjallë” dhe “qënies njerëzore”, që gëzon një personalitet juridik. Momenti i personalitetit juridik përcaktohet nga KC dhe në ndihmë të tij vijnë përcaktimet e Kodit të Familjes, Ligjit “Për Gjendjen Civile”, etj.<sup>55</sup> Shtetësia si kriter, bazuar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe përcaktimit të bërë në gërmën “c”, të nenit 2, të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, nuk përbën kriter kushtëzues për qënien subjekt i kësaj të drejte. Pra, këtu kemi të bëjmë me individin si subjekt, në kuptimin e një qenie njerëzore dhe jo me ndonjë krijim juridik të posaçëm.

-Personat pa shtetësi, në përputhje me dispozita të parashikuara në Kushtetutë,<sup>56</sup> janë gjithashtu subjekte të së drejtës për informim, megjithëse ligji i sipërcituar nuk i përmend ata shprehimisht. Realizimi i procedurave administrative për shqyrtimin e kërkesës për të drejtën për informim, kërkon përcaktimin e zotësisë së subjekteve kërkuese, për t’u legjitimuar si palë në to. Meqënëse vete ligji nuk bën një rregullim konkret, atëherë kjo çështje do t’i referohet rregullimit të bërë në dispozitat e Ligjit nr.44/2015 “Kodi i

---

<sup>52</sup> Shih pikat 1-4, të nenit 2, të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

<sup>53</sup> Po aty, pika 1, neni 3.

<sup>54</sup> Shih nenet 1-4, të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>55</sup> Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, “Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të drejtave të fëmijës-Studim krahasues”, Tiranë, faqe 33.

<sup>56</sup> Në nenin 6, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, thuhet se: “Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëjloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare, ushtrimin e të drejtave dhe lirive të caktuara”. Ky konkluzion del më i qartë kur, Kushtetuta në nenin 23 të saj, nuk e lidh gëzimin e së drejtës për informim në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare.



Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.<sup>57</sup> Ky nen, zotësinë për të marrë pjesë në një procedim administrativ, e lidh me nocionin e gëzimit të zotësisë juridike për të vepruar, sipas së drejtës civile. Ndërkohë, e drejta për t’u informuar si një e drejtë kushtetuese është e garantuar sipas ligjit dhe ky i fundit nuk kufizon në asnjë moment gëzimin e kësaj të drejte në varësi të moshës, në rastin e subjekteve persona fizikë, apo thënë ndryshe individëve.

Në ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, tërësia e veprimeve të detyrueshme proceduriale për t’u kryer në rastet e kërkesave të paraqitura për informacion, ose kopje dokumenti zyrtar, afatet e vendosura dhe elementët që kanë të bëjnë me veprime të caktuara administrative, formësonin një procedurë administrative, që përfundonte me deklarimin e vullnetit të administratës publike. Në ligjin “Për të drejtën e Informimit për dokumentet zyrtare” kishte një sërë elementësh që flasin për këtë procedurë, sikurse Kufizimi (neni 4), Afati për mospranimin e kërkesës (neni 10), Afati për përgjigje (neni 11), Shtyrja e afatit (neni 12), Ankimi administrativ (neni 15), nen i cili specifikisht ankimin administrativ ndaj shkeljes së të drejtës për informim të parashikuar nga ky ligj, ia referon rregullimeve të bëra në KPrA.

Sipas ligjit dilte e qartë se, tregtari si person fizik dhe shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe partitë politike, si subjekte që gëzojnë të drejtën për informim, mund t’a realizonin atë drejtëpërdrejtë, që nga momenti i krijimit si entitete private. Në referencë të paragrafit të dytë, të nenit 34, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, realizimi i kësaj të drejte mund të bëhet edhe me anë të një përfaqësuesi ligjor të autorizuar prej këtyre subjekteve, në procedurën përkatëse administrative.<sup>58</sup> Pra, zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar është e kushtëzuar nga natyra e personit juridik që krijohet.

Në rastin e subjektit “person fizik”, sipas KC vlen të ndalemi në disa momente që legjislacioni parashikon për mënyrën e realizimit të së drejtës për informim nga ana e tij. Zotësia për të marrë pjesë drejtëpërdrejtë në procedimin administrativ, lidhet me gëzimin e zotësisë së plotë për të vepruar nga ana e këtij subjekti, në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 6, të KC. Me mbushjen e moshës 18 vjeç, personi fizik, fiton zotësi të plotë për të vepruar dhe rrjedhimisht, gëzon zotësinë për të marrë pjesë drejtëpërdrejtë në procedimin administrativ, për realizimin e së drejtes për informim. Kjo gjë nuk përjashton mundësinë që e drejta të realizohet përmes pjesëmarrjes së një përfaqësuesi ligjor, kur ai autorizohet nga ana e personit fizik në përputhje me kërkesat e ligjit.

Personi fizik, i mituri, që ka mbushur moshën 14 vjeç, apo që ende nuk e ka arritur këtë moshë, përkatësisht, për shkak të zotësisë së kufizuar për të vepruar, apo të pazotësisë për të vepruar, sipas përcaktimeve të neneve 7 dhe 8, të KC, të drejtën për informim e realizon me anë të përfaqësimit nga ana e prindit të tij, apo të përfaqësuesit të tij ligjor, në procedurat përkatëse administrative.

---

<sup>57</sup> Në nenin 34/2, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, thuhet se: “Zotësia për të vepruar në një procedurë administrative, e personave të tjerë, rregullohet sipas legjislacionit në fuqi”.

<sup>58</sup> Shih nenin 64, të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Rast përjashtimor do të përbënte, personi fizik, në cilësinë e të miturës, së cilës i është lejuar lidhja në martesë, pa arritur moshën madhore. Kodi i Familjes, ndërsa përcakton në mënyrë të prerë dhe të rreptë moshën e lejueshme për lidhjen e martesës, i ka dhënë pushtet të veçantë gjykatës në dhënien e lejes për lidhjen e martesës edhe përpara kësaj moshe.<sup>59</sup>

Një pasojë e rëndësishme juridike e lidhjes së martesës në këto kushte është se, e mitura fiton zotësi të plotë për të vepruar, e cila nuk humbet, as kur martesa është deklaruar e pavlefshme, as kur ajo është zgjidhur, para se e mitura të mbushë moshën madhore.<sup>60</sup> Kjo zotësi nuk humbet edhe pse regjimi pasuror martesor i përcaktuar taksativisht me ligj në këtë rast, është ai i bashkësisë ligjore, pa marrë në konsideratë vullnetin e palëve të lidhura në martesë.<sup>61</sup> Në këto kushte, gruaja minorene e lidhur në martesë sipas procedurave përkatëse ligjore është një nga subjektet e së drejtës për informim, e cila mund të realizojë këtë të drejtë me pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë, apo me një përfaqësues ligjor në procedurat administrative për këtë qëllim.

Megjithëse, legjislacioni në fuqi shprehet për fitimin e zotësisë së plotë për të vepruar vetëm nga gruaja minorene, gjykoj se pasojat e lidhjes së martesës duhet të jenë të njëjtat edhe për mashkullin, i cili ka lidhur martesë duke qenë minorene. Këndvështrimi i deritanishëm qartësohet nëse analizojmë dispozitat të Konventës së të Drejtave të Fëmijës,<sup>62</sup> sipas përcaktimeve të së cilës; "...me fëmijë do të kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshja madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin, të cilit ai i nënshtrohet".<sup>63</sup>

E drejta për të patur akses në informacionin e nevojshëm për fëmijët, parashikohet në nenin 17, të Konventës, duke u fokusuar në funksionet kryesore që luan media në jetën e fëmijëve, e balancuar kjo me rolin dhe përgjegjësinë e prindërve në drejtimin e fëmijëve të tyre. Vlerësuar në këtë këndvështrim nuk përjashtohet aksesin e fëmijës ndaj asnjë lloji informacioni lidhur me dokumentet zyrtare, që mbahen nga autoritetet publike dhe që duhet të kërkohet në interes të fëmijës nga ana e prindit të tij, apo përfaqësuesit të tij ligjor.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit",<sup>64</sup> vërehen ndryshime në grupimin e subjekteve që kanë detyrimin të japin informacion. Më konkretisht, veç rrethit të subjekteve të përcaktuara në mënyrë të njëjtë edhe në ligjin "Për të drejtën e

---

<sup>59</sup> Mandro A., (2009): "E Drejta familjare - Familja, Fëmijët, Martesa, Bashkëshortët", Shtypshkronja "Emal", viti 2009, faqe 104.

<sup>60</sup> Shih paragrafin 2, të nenit 6, të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

<sup>61</sup> Shih nenin 70, të Ligjit nr.9062 datë 8.05.2003 "Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

<sup>62</sup> Si pjesë e legjislacionit të brendshëm, kjo Konventë në kuptim të akteve normative që kanë fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë vjen menjëherë pas Kushtetutës, përse i përket fushës së rregullimit të marrëdhënieve specifike juridike dhe se, çdo ligj që hyn në fuqi pas ratifikimit të saj duhet të jetë në përputhje dhe të mos bjerë ndesh me dispozitat e saj. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB, në 20 Nëntor 1989, u ratifikua nga Kuvendi i Shqipërisë, në Shkurt 1992 dhe hyri në fuqi në Mars 1992.

<sup>63</sup> Shih nenin 1, të Konventës së të Drejtave të Fëmijës.

<sup>64</sup> Ky ligj me hyrjen në fuqi, shfuqizoi Ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

informimit për dokumentet zyrtare”, të shfuqizuar, për sa i referohet termit “Autoritet publik”, ky koncept zgjerohet më tej edhe me:

- a) Organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë të çdo niveli.
- b) Shoqëritë tregtare, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve, apo ku ushtrohen funksione publike,
- c) Çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.<sup>65</sup>

## 1.4.2 Objekti i marrëdhënies juridike të së drejtës së informimit

Objekti i kësaj marrëdhënie juridike administrative, “quhet ajo gjë mbi të cilën drejtohen të drejtat subjektive dhe detyrimet juridike të subjekteve të së drejtës administrative dhe për shkak të së cilës ata hyjnë në marrëdhënie midis tyre”.<sup>66</sup> Objekti i të drejtës së informimit, sipas Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ishin dokumentet zyrtare. Në këtë ligj jepej një përcaktim mbi termin “dokument zyrtar”, por gjykoj se është e rëndësishme të analizohet nëse ky përcaktim i dhënë ishte i qartë, apo nëse ai kishte paqartësi dhe mangësi.

Sipas ligjit, me termin “dokument zyrtar”, kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që kishte lidhje me ushtrimin e një funksioni publik.<sup>67</sup> Në zhvillimin doktrinal juridik të këtij koncepti, por edhe në praktikën e vendeve të tjera, kryesisht nordike, si Suedia, bëhet një ndarje paraprake e kuptimit të dy termave, “dokument” dhe “dokument zyrtar”.

Kështu, me termin “dokument” do të kuptohet një prezantim me shkrim, apo kopje, por gjithashtu edhe një regjistrim, i cili mund të lexohet, dëgjohet, apo kuptohet në një mënyrë tjetër por vetëm me anën e një ndihmese teknike përkatëse. Në këto rrethana, termi “dokument” për pasojë nuk i referohet vetëm letrave, shkrimeve apo kopjeve por edhe një regjistrimi në kasetë, apo një regjistrimi në rrugë elektronike. Nga ana tjetër, një dokument bëhet zyrtar vetëm nëse;

- Mbahet nga një autoritet publik
- Vlerësohet në përputhje me rregulla të veçanta se është marrë, apo hartuar, nga një autoritet publik.

Për këdo është mëse e evidentueshme mbajtja e një dokumenti zyrtar të shkruajtur në letër nga një autoritet publik i caktuar, ndërkohë që zhvillimi aktual i teknologjisë elektronike ka zgjeruar më tej konceptin e dokumentit zyrtar.

Problemi i përcaktimit të mbajtjes së këtij lloj dokumenti bëhet më i komplikuar, nëse kemi një informacion të ruajtur në kompjuterin e administruar nga një autoritet publik dhe nëse nëpërmjet rrjeteve teknike të aplikuara në rrjetin kompjuterik, informacioni në fjalë mund

<sup>65</sup> Shih pikën 1, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>66</sup> Dobjani E., (2007): “E drejta Administrative” (botim i ripunuar), Shtypshkronja “Perlat Voshtina”, viti 2007, faqe 34.

<sup>67</sup> Shih nenin 2, gërma “b”, Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

të gjendet edhe në ekranet e kompjuterave të një autoriteti publik tjetër, si pasojë e aksesit që ky i fundit ka në rrjetin kompjuterik të të parit. Ky është një problem që për vetë zhvillimin dhe futjen e metodave kompjuterike në punën e organeve tona të administratës publike, ka fituar rëndësi çdo ditë e më shumë, duke nxjerrë në pah nevojën e rregullimeve të duhura ligjore.<sup>68</sup>

Një moment tjetër i rëndësishëm ka qënë edhe përcaktimi, i cili në ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përfshihej si një i tërë në termin; “i mbajtur nga autoriteti publik”, por që në praktikën e përditshme njihet si grupim i dokumenteve të marra nga autoriteti publik. Në diskutimin teorik të këtij grupimi dokumentash zyrtare konsiderohet se, dokumenti quhet i marrë nga autoriteti publik, kur ai ka arritur në këtë autoritet, apo në duart e nëpunësit civil, që trajton çështjen për të cilën bëhet fjalë në dokument. Administrativisht, dokumenti duhet të regjistrohet (protokolohet), me qëllim që ai të cilësohet më pas si dokument zyrtar. Megjithatë, rregulli i mësipërm ka veçantinë e tij në rastin kur për shembull, letrat, apo mesazhet nuk i dërgohen direkt autoritetit publik por njërit prej nëpunësve të tij. Praktika dhe legjislacioni i vendeve të tjera për të drejtën e informimit në këtë rast, vlerëson se nëse ky mesazh, apo letër lidhet me veprimtarinë e autoritetit publik, ai përbën një dokument zyrtar edhe pse i është adresuar një personi specifik.

Duke u nisur nga këto përcaktime gjykoj se, ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, kishte mangësi në këtë aspekt. Këto mangësi, të paktën në lidhje me termin “marrë nga autoriteti publik”, bëheshin më të ndjeshme në rastin kur një letër a mesazh i dërgohej një nëpunësi të autoritetit publik dhe kur, zarfi përkatës ku ndodhej letra hapej dhe lexohej paraprakisht nga nëpunësi i protokollit të autoritetit publik, duke shkelur kështu njëherazi edhe të drejtën e privacisë së personit, përse i përket postës së ardhur në emër të tij. Ky rast mund të komplikohet edhe më tej, kur në këtë letër edhe pse mund të kërkohej informacion për veprimtari të autoritetit, përfshiheshin dhe ndërthureshin në të njëjtën kohë të dhëna, të cilat konsiderohen nga legjislacioni në fuqi, si të dhëna personale të personit në fjalë. Pikërisht këto shembuj tregojnë se përmirësimet ligjore në këtë fushë, kanë qënë të nevojshme.

Momenti i fundit i rëndësishëm, në kuptimin e termit “dokument zyrtar”, lidhet me hartimin, ose përpilimin e tij nga autoriteti publik. Parimi në këtë rast ka të bëjë me atë që, një dokument i krijuar në një autoritet publik është një dokument zyrtar, nëse ai ka marrë formën e tij përfundimtare. Një dokument i hartuar nga autoriteti publik, cilësohet si i tillë, kur autoriteti publik e dërgon apo e shpërndan atë jashtë tij. Po kështu edhe nëse dokumenti nuk i përket ndonjë çështje specifike, ai cilësohet si i hartuar, kur ai ka marrë formën finale të tij.<sup>69</sup>

---

<sup>68</sup> Si shembull mund të merret legjislacioni suedez, (Ligji i lirisë së shtypit), ku përcaktohet se, një regjistrim elektronik në kompjuter, mbahet nga një autoritet publik, nëse ai mund të sigurojë kopje të printuara të tij nga një autoritet tjetër publik, që kujdeset për këtë regjistrim, në emër të autoritetit të paracituar. Pra, nëse një autoritet publik ka vetëm funksionin e procesimit teknik, apo të ruajtjes së një regjistrimi elektronik, në emër të një autoriteti tjetër publik apo të një individi, një regjistrim i tillë nuk konsiderohet si një dokument zyrtar i mbajtur nga autoriteti publik që ka vetëm funksione teknike, për sa është përcaktuar më sipër.

<sup>69</sup> Nisur nga këto përcaktime, draftet, axhendat, apo shënimet, rrjedhimisht nuk mund të cilësohen dokumente zyrtare, përderisa ato nuk janë ruajtur apo protokolluar nga autoriteti publik.

Në konkluzion mund të thuhet se, përcaktimi që bëhej në ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, në termin “dokument i mbajtur nga autoriteti publik”, mund të derivonte në dy drejtime kryesore të ekzistencës së mundshme të një dokumenti zyrtar;

- a) Marrjen dhe përpilimin e tij nga autoriteti publik.
- b) Regjistrimin e tij në protokollin e autoritetit publik.

Megjithatë, nga rregulli i përgjithshëm i regjistrimit ka edhe përjashtime, në lidhje me dokumenta që s’është e nevojshme të protokollohen, për shkak të rëndësisë së vogël që kanë, si për shembull qarkoret, apo materialet reklamuese. Ky grupim dokumentash mund të marrë një rëndësi të caktuar, nëse do të gjendemi përpara kërkesës së publikut për të marrë një dokument, apo informacion të tillë, i cili deri në këtë moment realisht nuk mbahet nga autoriteti publik.

Paqartësitë në lidhje me kuptimin e termit “dokument zyrtar”, vlerësoj se në thelb kanë patur të bëjnë me përcaktimin nëse objekti i së drejtës për informim ishte informacioni, apo dokumenti zyrtar.<sup>70</sup> Praktika ndërkombëtare njihë përgjithësisht dy lloj regjimesh të së drejtës së informimit: ligjet e gjeneratës së parë (SHBA, Franca etj), njohin kryesisht të drejtën e njohjes me dokumentet administrative, ndërkohë që ligjet më të reja, duke përfshirë ato në shumicën e vendeve të Europës Lindore, garantojnë të drejtën e njohjes me tërësinë e informacioneve që disponohen nga autoritetet publike. Formulimi i dytë konsiderohet si më i plotë, megjithëse në praktikë kjo varet edhe nga përkufizimi i termit “dokument zyrtar”.<sup>71</sup>

Rekomandimi 2002 (2) i KE-së, “Për aksesin në dokumenta zyrtare”, i cili është formulimi më i qartë i standarteve europiane në këtë fushë, i plotësuar nga Konventa e KE-së, “Për aksesin në dokumentet zyrtare”,<sup>72</sup> e adoptuar në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të KE-së, më 27.11.2008, mendoj se mund të shërbenin si një shembull shumë i mirë për adoptimin e një standardi të ri, për zgjidhjen ligjore të kësaj çështjeje. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, objekt i së drejtës së informimit është “informacioni publik”, i përcaktuar si çdo lloj e dhëne, e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.<sup>73</sup> Përcaktimi i dhënë për objektin e marrëdhënies juridike të së drejtës për

<sup>70</sup> Në nenin 3, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, garantohet e drejta e; “çdo personi ...të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”.

Neni 2 i ligjit, e përkufizon “dokumentin zyrtar”, si “dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi, dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik”.

Megjithëse neni 7, i ligjit sqaron se, “kërkuesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar”, formulimi “të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare”, mund të krijojë probleme interpretimi në praktikë. Nga ana tjetër, duhet theksuar se, neni 23, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, garanton të drejtën “për të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore”, që është një koncept më i gjerë se “informacioni për dokumentet zyrtare”.

<sup>71</sup> Përkufizimi i dokumentit zyrtar i dhënë në nenin 2, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, është një kombinim i paqartë i këtyre dy modeleve.

<sup>72</sup> Në nenin 1, pika 2/b të Konventës, thuhet se: “Dokumentet zyrtare” nënkuptojnë gjithë informacionin e regjistruar në çdo formë, përpiluar, apo marrë dhe mbajtur nga autoritetet publike”.

<sup>73</sup> Shih pikën 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

informim, sipas këtij ligji afron shumë me përkufizimin e dhënë në Konventën e KE-së “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, për termin “dokument zyrtar”.

### 1.4.3 Përmbajtja e marrëdhënies juridike të së drejtës së informimit

Ky element i marrëdhënies juridike të së drejtës së informimit përbëhet nga tërësia e të drejtave dhe detyrimeve, të subjekteve që marrin pjesë në të. Në referencë të bazës ligjore rregullatore dhe ndryshimit të saj gjatë kohës së përgatitjes së këtij punimi, elementi i përmbajtjes së kësaj marrëdhënieje juridike do të analizohet fillimisht, sipas dispozitave të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe në vazhdim krahasues, sipas dispozitave të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Sipas kuptimit të dhënë për subjektet e së drejtës për informim, në Ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, të drejtat dhe detyrimet për *autoritetin publik* kanë qenë:

*-Respektimi i procedurës ligjore për shqyrtimin e kërkesës për informacion.*

Është kusht themelor që, autoriteti publik të zbatojë korrektësisht dispozitat ligjore që përcaktojnë veprime, apo mosveprime të nevojshme, për të mundësuar realizimin e të drejtës për informim. Rol kyç në këtë proces luante personi përgjegjës për trajtimin e kërkesave për informim. Me paraqitjen e një kërkesë për informim:

1. Personi përgjegjës për trajtimin e kërkesave për informim bënte shqyrtimin e kërkesës, duke vlerësuar nëse informacioni i kërkuar mbahej apo jo, në autoritetin publik. Nëse jo, ai e adresonte kërkesën tek autoriteti publik përkatës, mbajtës i informacionit.
2. Nëse autoriteti publik e dispononte informacionin e kërkuar, personi përgjegjës verifikonte nëse informacioni ishte publikuar apo jo, deri në atë moment nga autoriteti publik.
3. Personi përgjegjës vlerësonte nëse kërkesa për informim përmbante elementet e nevojshme, për të mundësuar dhënien e informacionit.
4. Personi përgjegjës vinte në dijeni kërkesin, lidhur me kohën maksimale brenda së cilës autoriteti publik do t'i jate përgjigje për kërkesën e tij sipas ligjit; mënyrën e dhënies së përgjigjes; tarifën e pagesës që duhet të kryente dhe afatin e pagesës së tarifës përkatëse.

Në varësi të llojit të informacionit që kërkohej për dokumentet zyrtare, veprohej si më poshtë:

- Kur informacioni i kërkuar ishte pjesë e informacionit që autoriteti publik e publikonte pa kërkesën e publikut, atëherë informacioni i jepet kërkuarit direkt, ose duke e drejtuar tek personi përkatës që mbante informacionin. Kërkuarit i jepeshin materiale të printuara, ose fletëpalosje, ose adresohet në faqen e internetit ku mund të gjendej informacioni i kërkuar.

- Kur në kërkesë identifikohet nevoja për informacion për dokumente të tjera zyrtare që mbaheshin nga autoriteti publik, informacioni i kërkuar i vihej plotësisht, ose pjesërisht<sup>74</sup>

<sup>74</sup> Shih nenin 10, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

në dispozicion kërkuesit, brenda afateve kohore që përcaktonte ligji dhe në formën për të cilën ishte rënë dakord më parë, mes kërkuesit dhe zyrtarit të informimit.

Këto këndvështrime të dhëna i referohen më tepër një praktike administrative normale të konceptuar në veprimtarinë e përditëshme të një organi të administratës publike, se sa një përcaktimi konkret, në Ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, mbi caktimin e një personi përgjegjës për trajtimin e kërkesave për informim. Efektivisht në këtë ligj ka munguar parashikimi për detyrimin e autoritetit publik, për caktimin e një personi përgjegjës për trajtimin e kësaj kategorie kërkesash, që kanë specifikën e tyre, në morinë e gjithë kërkesave të tjera që mund t’i drejtohen organeve të administratës publike.

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” është shumë i qartë në këtë pikë, pasi në nenin 10, përcakton detyrimin e autoritetit publik të caktimit të një prej nëpunësve të tij, si koordinator për të drejtën e informimit. Koordinatori i së drejtës për informim, është nëpunësi përgjegjës, për bashkërendimin e punës dhe garantimin e së drejtës për informim. Ai ka një sërë kompetencash të përcaktuara në ligj, për mundësimin e realizimit efektiv të së drejtës për informim ndaj kujtdo kërkuesi konkret. Për moszbatim të detyrimeve ligjore, krahas përgjegjësisë administrative të titullarit të autoritetit publik, përcaktohet edhe përgjegjësia administrative e koordinatorit për të drejtën e informimit, në rast shkeljeje të dispozitave të parashikuara shprehimisht nga ligji.<sup>75</sup>

*-Forma e dhënies së informacionit për dokumentet zyrtare të kërkuara.*

Sipas dispozitave të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, kërkesa për marrjen e një informacioni për dokumentat zyrtare shoqërohej me një përgjigje nga ana e autoritetit publik, të cilit i është drejtuar. Autoriteti publik ishte i detyruar t’i jepte kërkuesit një kopje të dokumentacionit të plotë të kërkuar, i cili mund të ruhej në forma të ndryshme. Forma e dhënies së kësaj kopje përfshinte printimin, riprodhimin fotografik, fotokopjimin, hedhjen e informacionit në disketë apo disk, në varësi të teknologjisë që përdorte institucioni për mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit. Ishte e drejta e kërkuesit të zgjidhte formën që i nevojitet për marrjen e informacionit të kërkuar, në varësi të mundësive objektive të vetë autoritetit publik për të ofruar atë dhe gjithmonë në kushtet kur kërkuesi jepte pëlqimin me shkrim për formën e ofruar. Një formë tjetër e dhënies së informacionit, ishte edhe forma verbale.<sup>76</sup> Informacioni i kërkuar mund të jepej në disa forma, në varësi të kërkesës së subjektit kërkues, ose me sugjerimin e personit përgjegjës, gjithmonë kjo e shoqëruar me pëlqimin me shkrim të kërkuesit për formën e ofruar të informacionit dhe pashmangshmërisht në varësi të mundësive objektive të autoritetit publik për të ofruar formën e kërkuar të dhënies së informacionit.

Sipas dispozitave të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, rregulli i përgjithshëm për marrjen e informacionit të kërkuar, parashikon konsultimin pa pagesë, të informacionit në mjediset e autoritetit publik, përmes portalit unik qeveritar e-albania.al, apo nëpërmjet

<sup>75</sup> Shih pikën 3, të nenit 19, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>76</sup> Shih nenin 7, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

faqes së autoritetit publik në internet.<sup>77</sup> Kërkesat për dokumente të shkruara trajtohen duke i vënë në dispozicion kërkuarit, një kopje të plotë të dokumentit sipas formatit të njëjtë, me të cilin e përdor atë autoriteti publik; një kopje të plotë të informacionit përmes postës elektronike kur informacioni gjendet në një formë të tillë të konvertueshme.<sup>78</sup>

Ndërkohë, sa i përket formave të tjera të dhënies së informacionit, pika 3, e nenit 14 të këtij ligji parashikon se, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik. Ky standard i ri i vendosur nga ky ligj, mendoj se përkeqëson pozitën e kërkuarit në raport me autoritetin publik. Sipas dispozitave të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, refuzimi i kërkesës për formën e kërkuar duhet bërë me shkrim dhe i arsyetuar.

*- Promovimi i aksesit në informim.*

Autoriteti publik nuk duhet t’ a kuptojë funksionin e tij në kuadër të së drejtës së informimit vetëm në dhënien e informacionit që kërkohet direkt nga kërkuari. Përkundrazi, ai duhet të jetë një shembull se si vetë respekton këtë të drejtë dhe se, si vetë bëhet promotor i përçimit të kuptimit të të drejtave dhe detyrimeve, që ky ligj i atribuon subjekteve të tjera, të ndryshme nga autoriteti publik.

Shpeshherë promovimi si aktivitet, ngatërrohet me termin “Publicitet”. Gjykoj se jo vetëm në atë çfarë këto dy terma përfaqësojnë, por specifikisht për të drejtën e informimit kemi të bëjmë me dy koncepte të ndryshme. Të promovosh do të thotë që të veprosh në përputhje me një rregull të caktuar dhe t’ju krijosh të tjerëve mundësinë që me veprimet konkrete, të kuptojnë se cilat janë të drejtat e tyre, cilat janë kufijtë e të drejtave, si realizohen ato dhe si mund të mbrohen ato. Vetëm në këtë mënyrë fushatat publicitare, mund të takohen me konceptin e promovimit për të drejtën e informimit. Të jesh një shembull praktik se si zbatohet e drejta e informimit është promovimi më i mirë që mund t’i bëhet kësaj të drejte. T’u flasësh të tjerëve me gjuhën e të drejtave të tyre është ajo pjesë e promovimit, që ka të nevojshme publicitetin në të gjitha format e tij, qoftë nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike, qoftë me botime të shkurtra përmbledhëse, apo edhe nëpërmjet internetit, si një mundësi e pashmangshme, e dobishme dhe efektive për t’iu drejtuar publikut.

Përpos trajtimit teorik të mësipërm që i përgjigjet një qasjeje proaktive ndaj fenomenit duhet thënë se, Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ka qënë dukshëm i kufizuar në dhënien e termave që lidhen me nxitjen e promovimit të së drejtës për informim nga ana e autoriteteve publike. Dispozitat dhe fryma e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, janë më konkrete dhe nxitëse në kuadër të promovimit si një aspekt i rëndësishëm i realizimit të së drejtës për informim. Ka një sërë elementësh që flasin për këtë gjë, por gjykoj se detyrimi ligjor i vendosur ndaj autoriteteve publike për caktimin e një koordinatori për të drejtën e informimit, si dhe detyrimi i vendosur, për përgatitjen dhe miratimin e programeve të transparencës, luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

<sup>77</sup> Shih pikën 1, të nenit 14, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>78</sup> Po aty, pika 2, e nenit 14.



*- Publikimi i informacionit pa qenë i kërkuar.*

Transparenca në qeverisje dhe liria e informimit mishërohen më së miri, në publikimin e informacionit që paraqet interes publik dhe shpërndarjen e tij gjerësisht nga ana e autoriteteve publike, pa patur nevojë për një kërkesë paraprake të subjekteve të interesuara. Në ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, parashikohet se: “Autoriteti publik është i detyruar të bëjë publike dhe të shumëfishojë vetë, në sasi të mjaftueshme dhe me formate të përshtatshme dokumente që lehtësojnë informimin e publikut për:

- a. Vendndodhjen e organeve qendrore dhe vendore, vendet si dhe emrat e punonjësve, nga të cilët publiku mund të marrë informacion, të paraqesë kërkesa apo të marrë përgjigje.
- b. Rregullat, procedurat dhe mënyrat se si mund të merren formularët e ndryshëm, shpjegime për qëllimin dhe përmbajtjen e tyre apo të dokumenteve dhe të vërtetimeve të nevojshme për plotësimin e formularëve;
- c. Rregullat e përgjithshme ligjore, sipas të cilave vepron autoriteti publik, politikat e përgjithshme, që zbaton autoriteti publik, si dhe ndryshimet e bëra në to,
- d. Shpjegimet e detajuara për metodat dhe procedurat e punës së autoritetit publik”.<sup>79</sup>

Ndërkohë në nenin 9 të tij, ku ligj i paraprinte kërkesave të mundshme të publikut në lidhje me një grupim dokumentash zyrtare, të cilat autoriteti publik duhet t’i përgatiste paraprakisht për t’ia vënë në dispozicion publikut, nëse do t’i kërkonte. Këto dokumente ishin; vendimet përfundimtare për një çështje të caktuar, përfshi qëndrimet e pakicës, si dhe urdhërat ose udhëzimet në zbatim të tyre; urdhërat dhe udhëzimet e brendshme që ndikojnë në marrëdhëniet e autoritetit publik me publikun; kopje të çdo dokumenti, i cili i është dhënë më parë të paktën një personi, pavarësisht nga formati i tyre dhe që autoriteti publik besonte se do të ishte me interes për persona të tjerë; indeksin apo skedarët e dokumenteve zyrtare.

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka bërë një hap përpara në këtë drejtim. Ai parashikon se, në përputhje me programin e transparencës, autoriteti publik përgatit paraprakisht në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vë në dispozicion të publikut në faqen e tij në internet, një listë të gjatë, të detajuar dhe shumë të qartë, të informacionit që bëhet publik pa kërkesë.<sup>80</sup>

*-Eficienca e sistemit të menaxhimit të dokumentave.*

Nuk mundet që krijimi i kapaciteteve njerëzore në autoritetet publike, të afta për të dhënë zgjidhje ndaj çdo çështje që lidhet me të drejtën e informimit, të mos shoqërohet me një sistem praktik dhe eficient, që ofron në çdo kohë lehtësi dhe hapësirë për të kërkuar dhe marrë informacion. Informatizimi i informacionit është një zgjidhje e shumë problemeve teknike, që lidhen me administrimin e tërësisë së dokumenteve zyrtare që prodhohen nga administrata publike. Megjithatë duhet theksuar se, mënyra manuale e administrimit të këtij dokumentacioni mbetet baza e sistemit. Kombinimi i mënyrave të menaxhimit të dokumenteve zyrtare, shpreh eficiencën e sistemit dhe kërkon që, administrata t’i krijojë,

<sup>79</sup> Shih nenin 8, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

<sup>80</sup> Shih nenin 7, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

lehtësi teknike vetvetes për të identifikuar dokumentacionin zyrtar të mbajtur prej saj dhe publikut mundësi aksesi sa më të mëdha në këtë dokumentacion.

Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i shfuqizuar, nuk ka patur shumë frymëmarrje në këtë këndvështrim në dispozitat e tij dhe kjo është e kuptueshme për kohën e hyrjes së tij në fuqi dhe të kushteve të vendit tonë, sa i takon informatizimit të veprimtarisë së autoriteteve publike, si dhe depërtimit të internetit si një mjet përdorimi masiv nga publiku. Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, është më i avancuar në këtë aspekt, pasi vendos detyrimin që të vihet në dispozicion të publikut një kategori e gjerë informacioni përmes faqes në internet të autoritetit publik. I rëndësishëm është edhe parashikimi për trajtimin e kërkesave për informacion edhe nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al.

*- Pagesat për ofrimin e shërbimit.*

Shërbimi i informimit mund të ketë shpenzime dhe autoriteti publik mund të vendosë paraprakisht tarifa të caktuara, për realizimin e këtij shërbimi. Ajo që duhet pasur parasysh është se, autoriteti publik në asnjë rast nuk duhet të pengojë kërkesit nëpërmjet tarifës së shërbimit dhe t’i detyrojë ata të heqin dorë nga kërkesa për informacion.

Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, njihet dy lloje tarifash:

-Tarifa për shërbimet standarte dhe ato për të cilat është krijuar një përvojë e caktuar, dhe të cilat bëhen publike.

-Tarifa për shërbimet e tjera përcaktohen rast pas rasti dhe i bëhen të njohura palës së interesuar në momentin e pranimit të kërkesës.<sup>81</sup>

Sipas Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, parashikohej se, tarifat për shërbimin nuk duhet të ishin më të larta se vetë kostoja për realizimin e shërbimit. Kjo kosto përfshinte vetëm, shpenzimet materiale për realizimin e shërbimit. Në këtë këndvështrim ishte detyrim i autoritetit publik të lëshonte faturën për pagesën në këtë rast dhe e drejtë e kërkesit të merrte faturën për shërbimin e informimit. Gjithashtu ligji përcaktonte se, për dokumentat zyrtare që autoriteti publik kishte detyrimin t’i publikonte pa kërkesën e publikut, nuk bëhej asnjë pagesë. Dokument zyrtar në termat e këtij ligji, ishte edhe informimi për procedurën dhe vendimet e marra për vendosjen e tarifave për shërbimin. Autoritetit publik i njihej e drejta që për shërbime të ofruara, në bazë të nenit 17, të KPrA,<sup>82</sup> të mos aplikonte tarifa të vendosura me ligj, në rastet kur provohej pamundësia e kërkesit për të paguar. “Rastet e pamundësisë” është e logjishme

---

<sup>81</sup> Shih nenin 13, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare". Kostoja materiale, përfshin vetëm këto shpenzime:

- Shpenzimet e riprodhimit të kopjes së dokumentit zyrtar, fotokopje, printime apo kopjimet në forma kompjuterike ose në forma të tjera.
- Shpenzimet për dërgimin e informacionit ku hyjnë posta, faksi, telefoni, posta elektronike, etj.

Ndërkohë, shpenzimet për përgatitjen e materialit nga nëpunësit, si shtypja në kompjuter apo në makinë, kostoja e kërkimit të dokumentit, kostoja e shqyrtimit të kërkesës e të tjera si këto, nuk mund të jenë pjesë e kësaj kostoje materiale të kërkuar nga ligji.

<sup>82</sup> Referenca këtu bëhet për Ligjin nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

të përcaktohen në rregulloret, ose vendimet e instancave përgjegjëse brenda autoritetit publik, për aq sa i takon shërbimit të informimit, duke plotësuar kështu kërkesën e nenit të sipërcituar: “rastet e pamundësisë përcaktohen me akte nënligjore”.<sup>83</sup>

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, që në fillim të dispozitës përkatëse që trajton koston e shërbimit, thekson parimin e shërbimit pa pagesë nga ana e organeve publike, por pa përjashtuar mundësinë e pagesës së një tarife shërbimi, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga ana e autoriteti publik. Edhe në këtë çështje ky ligj është më i qartë dhe më i avancuar se, Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, sepse jep një përcaktim më të plotë për tarifën e shërbimit të kërkuar, si dhe përcakton qartë termat “kosto riprodhimi” dhe “kosto dërgimi” të informacionit.<sup>84</sup> Ligji përcakton detyrimin dhe autoritetin e KDIMDhP, për shqyrtimin periodik të tarifave të bëra publike dhe kompetencën e tij për të urdhëruar ndryshimin e tyre.

*-Raportimi për aktivitetet e së drejtës së informimit.*

Autoriteti publik duhet që, çdo vit të krijojë një raport mbi veprimtarinë e tij, në lidhje me të drejtën e publikut për informim. Raportimi i autoritetit publik konsiderohet si një pjesë e informimit që ai i bën publikut në kuadër të së drejtës për informim, gjë që pasqyrohet edhe në parimet e kësaj të drejte themelore të njeriut. Raportimi, i cili mund të konsiderohet edhe si një mënyrë promovimi duhet të përmbajë informacionin rreth, numrit të kërkesave të marra për informim, përgjigjeve të plota, apo të pjesshme dhe refuzimeve; apelimeve të bëra në rastet e refuzimeve; pagesave të kryera për kërkesat e përmbushura; intensitetin e publikimit të informacionit; mbajtjen e dokumentave zyrtare; trajnimin në përgjithësi për të drejtën e informimit dhe se, si është informuar publiku mbi këtë të drejtë. Rrugët dhe mënyrat e këtij raportimi janë të shumta, e rëndësishme është që publiku të ketë dijeni sa më të gjerë për të.

Në Ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, mungonte një dispozitë për rregullimin e kësaj kërkesë primare të aktivitetit të autoriteteve publike, në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të së drejtës për informim. Kjo situatë është përmbysur krejtësisht me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Tashmë programet e transparencës sigurojnë një sasi informacioni të gjerë për publikun, duke rregulluar edhe mënyrat e bërjes së tij publike. Krijimi dhe mbajtja e një regjistri të posaçëm për regjistrimin e kërkesave për informim dhe përgjigjeve të dhëna, i detyrueshëm për tu bërë publik,<sup>85</sup> plotëson kuadrin e kërkuar të raportimit periodik mbi veprimtarinë e autoritet publik për realizimin e së drejtës për informim. Rëndësi parësore në këtë proces ka raportimi vjetor në Kuvendin e Shqipërisë, i KMDIMDhP, mbi çështjet dhe nivelin e zbatimit të së drejtës për informim.

---

<sup>83</sup> Instituti për Studime Publike & Ligjore, Komentar-Ligji për të drejtën e informimit, botim i Institutit për Studime Publike & Ligjore, Tiranë, viti 2003, faqe 78.

<sup>84</sup> Shih pikat 1 dhe 2, të nenit 13, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>85</sup> Po aty, pika 1, e nenit 8.

*-Nxjerrja e akteve nënligjore në funksion të krijimit të lehtësive strukturore për marrjen e informacionit.*

Në ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përcaktohej se: “Autoriteti publik nxjerr rregullore dhe krijon lehtësi strukturore e praktike për marrjen nga ana e publikut, në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë të informacionit për dokumentet zyrtare”.<sup>86</sup> Në këtë dispozitë, ligji nuk vendos kërkesa për përmbajtjen e rregullores, pasi kjo çështje duhet të zgjidhet nga vetë autoriteti publik por vendos një, “detyrim për cilësinë e shërbimit të informacionit”.<sup>87</sup> Në këtë pikëpamje i lihej diskrecionit të autoritetit publik për të përcaktuar përmbajtjen e rregullores.

Megjithatë, dy janë kërkesat që autoriteti publik nuk mund t’i anashkalojë në nxjerrjen e këtij akti, e para, kjo është një rregullore ekskluzivisht vetëm për të drejtën e informimit dhe nuk mund të trajtohet si një pjesë e rregullores së funksionimit të brendshëm të autoritetit publik, dhe e dyta, rregullorja duhet të përmbajë patjetër parashikime në lidhje me disa elementë thelbësorë të së drejtës së informimit.

Këta elementë janë: Struktura e posaçme për marrjen e proçedimin e kërkesave për informim, në organizimin e brendshëm të institucionit; proçedurat që duhet të ndiqen për depozitimin e kërkesës; rregullat dhe proçedurat për adoptimin e skemave të bërjes publike të informacionit si dhe formatet e ofrimit të tij; rregullat që lidhen me pagesat për shërbimin e informimit, duke renditur listën e tarifave, mënyrën e llogaritjes së tyre rast pas rasti dhe rastet e ofrimit të shërbimit falas.<sup>88</sup>

Mendoj se një hap konkret në ndihmë të autoriteteve publike për hartimin e kësaj rregulloreje, ka përbërë Rekomandimi i AP, nr. 177 datë 13.06.2006 “Për miratimin e rregullores tip për të drejtën e informimit”. Në një këndvështrim të pjesës së subjekteve të përmbledhura në termin “*Publiku*”, duhet theksuar parashikimi se marrëdhënia juridike e përcaktuar në ligj krijon të drejta për publikun por njëkohësisht edhe detyrime, të cilat janë të rëndësishme për të realizuar sa më mirë dhe efektivisht të drejtën për informim. Konkretisht, sipas këtij rekomandimi, publiku (subjekti kërkues) duhet që:

1. Përpara se t’i drejtohet një autoriteti publik me kërkesë për marrjen e një informacioni, të verifikojë për aq sa është e mundur, nëse është ky autoriteti që e mban informacionin dhe të saktësojë cili është personi përgjegjës, të cilit duhet t’i drejtohet kërkesa. Nëse informacioni i është dhënë më parë një personi tjetër, të identifikueshëm nga kërkuesi, atëherë kjo është një indicie që ndihmon për këtë pjesë, duke u shënuar në kërkesë identiteti i personit. Mund të shënohet gjithashtu referimi për burimet nga të cilat, kërkuesi ka marrë dijeni për ekzistencën e informacionit që kërkon.
2. Në kërkesë duhet të shënohet qartë identiteti i kërkuesit, adresa dhe mënyra e kontaktimit.

---

<sup>86</sup> Shih nenin 6, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

<sup>87</sup> Instituti për Studime Publike & Ligjore, Komentari-Ligji për të drejtën e informimit, botim i Institutit për Studime Publike & Ligjore, Tiranë, viti 2003, faqe 52.

<sup>88</sup> Po aty, faqe 52.

3. Të përshkruajë qartë dhe saktë,<sup>89</sup> informacionin që kërkon. Kjo gjë ndihmon personin përgjegjës tek autoriteti publik për identifikimin e dokumentacionit zyrtar të kërkuar dhe rrjedhimisht të identifikojë nëse autoriteti publik e zotëron, apo jo një dokumentacion të tillë. Për të dyja palët, si për subjektin kërkuar, ashtu edhe për autoritetin publik është e këshillueshme që, të evitohen kërkesat me objekt shumë të gjerë, pasi krijojnë pengesa për administratën publike, në aspektin kohor të përgatitjes dhe në rëndimin e kostos së përgatitjes së materialit të kërkuar, si dhe mund të shërbejë si shkak për refuzimin e kërkesës, apo mosplotësimin e saj.
4. E njëjta kërkesë mund të drejtohet në disa institucioneve, në rast se ajo trajton një problematikë të gjerë dhe përgjigja merret nga disa institucione sipas fushave përkatëse.
5. Motivi i kërkesës për informim, megjithëse nuk është një detyrim ligjor për kërkuar mund të identifikohet prej tij, nëse ky fakt mund të lehtësojë marrjen e informacionit, sidomos kur nevoja për informacionin është urgjente. Vendosja si kusht nga personi përgjegjës për trajtimin e kërkesave për informim, e dhënies nga ana e kërkuar të motivit pse kërkohet informacioni, përbën shkelje ligjore.

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka krijuar tashmë një kuadër të plotë për aktet nënligjore të nevojshme në funksion të krijimit të lehtësive strukturore për marrjen e informacionit. Veç detyrimit për miratimin dhe rishikimin e programeve të transparencës, ligji i njeh detyrimin KDIMDhP për miratimin e modeleve të programeve të transparencës,<sup>90</sup> për vendosjen e standardeve për formatin dhe përmbajtjen e regjistrimit për kërkesat dhe përgjigjet,<sup>91</sup> shqyrtimin dhe urdhërimin e ndryshimit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të tarifave për kostot e shërbimit.<sup>92</sup>

Përkundër praktikës së mangët të mëparshme, të parashikimeve ligjore për detyrimin e organeve të caktuara të administratës publike, për nxjerrjen e akteve nënligjore për lehtësimin e procedurave për aksesin në informacion, Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përcakton ndër të tjera edhe detyrimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Drejtësisë, për të nxjerrë udhëzim të përbashkët, për përcaktimin e numrit të faqeve të informacionit që jepet falas nga autoritetet publike,<sup>93</sup> si dhe detyrimin e nxjerrjes së një udhëzimi për kostot e shërbimit të ofruar në rast riprodhimi dhe dërgimi të informacionit kërkuar.<sup>94</sup>

<sup>89</sup> Shpesh pasaktësia në formulimin e kërkesës bën që, informacioni të refuzohet apo të jepet i paplotë, ose dhënia e tij të zvarritet.

<sup>90</sup> Shih gërmën “c”, të pikës 2, të nenit 4 dhe nenit 6, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>91</sup> Po aty, pika 2, e nenit 8.

<sup>92</sup> Po aty, pika 3, e nenit 13.

<sup>93</sup> Po aty, pika 5, e nenit 13.

<sup>94</sup> Po aty, pika 3, e nenit 16.

#### 1.4.4 Afatet procedurale

Realizimi i së drejtës për informim, sipas Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, lidhej proceduralisht me respektimin e disa afateve kohore të vendosura në ligj. Ky ligj përcaktonte një sistem dy fazësh afatesh dhe më konkretisht:

- *Afatin për mospranimin e kërkesës.* Autoriteti publik vendoste për mospranimin e plotë, ose të pjesshëm të kërkesës brenda 15 ditëve nga depozitimi i saj. Në rastin e mosprimit të kërkesës, përgjigjia negative, e plotë ose e pjesshme jepej e arsyetuar dhe me shkrim nga autoriteti publik.<sup>95</sup>

Afati 15 ditor, i përcaktuar nga ana e ligjit kishte disa funksione kryesore:

-Ai shërbente si kohë maksimale limit për të kushtëzuar shprehjen e vullnetit të autoritetit publik për mospranimin e plotë, ose të pjesshëm të kërkesës.

-Kushtëzonte ekzistencën e domosdoshme të elementëve të aktit administrativ që duhej të nxirrej në këtë rast, nga ana e autoritetit publik.

- Bënte një lidhje shkakësore mes kufizimit me ligj të informacionit dhe një kërkese esencialisht abuzive që mund t’i paraqitej autoritetit publik.

- Nxiste shqyrtimin e ankesave të paraqitura në radhë të parë nga pikëpamja e pranueshmërisë dhe pastaj nga pikëpamja e përmbajtjes së tyre.<sup>96</sup>

- I shërbente rrugës së ankimit administrativ, apo ankimit në rrugë gjyqësore, pa përjashtuar këtu me një specifikë ligjore, ankimin tek Avokati i Popullit, ndaj aktit administrativ që autoriteti publik nxirrte brenda këtij afati.

- *Afatin për përgjigje.*

Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, parashikonte se, “Kërkesa për informim duhet të plotësohet brenda 40 ditëve nga depozitimi i saj, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe”.<sup>97</sup> Pavarësisht afateve të përcaktuara nga ana e legjislatorit, është e qartë se qëllimi i tij dhe për pasojë, prirja që karakterizonte ligjin për të drejtën e informimit është padyshim, prevalimi në çdo rast i interesit të qytetarit.<sup>98</sup>

Përjashtimet nga ky afat për plotësimin e kërkesës për informacion, sikurse përcaktoheshin në ligj lidhen me dy arsye, veçantia e kërkesës dhe nga ana tjetër, domosdoshmëria e këshillimit me një palë të tretë. Ligji në këtë rast njihte termin “shtyrje” të afatit, çka do të thotë se realizimi i plotë, ose i pjesshëm i kërkesës për informim duhej të kryhej brenda këtij afati të ri, fundor. Kjo shtyrje natyrisht që shoqërohej me detyrimin e autoritetit publik për të njoftuar me shkrim kërkuesin për pamundësinë e respektimit të afatit ligjor, jo më vonë se 7 ditë nga afati i mëparshëm. Njoftimi duhet të përmbante gjithashtu edhe arsyet e

<sup>95</sup> Shih nenin 10, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

<sup>96</sup> Instituti për Studime Publike & Ligjore, Komentari-Ligji për të drejtën e informimit, botim i Institutit për Studime Publike & Ligjore, Tiranë, viti 2003, faqe 70.

<sup>97</sup> Shih nenin 11, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

<sup>98</sup> Instituti për Studime Publike & Ligjore, Komentari- Ligji për të drejtën e informimit, botim i Institutit për Studime Publike & Ligjore, Tiranë, viti 2003, faqe 71.

shtyrjes së afatit.<sup>99</sup> Propozimi i alternativave nuk lidhej domosdoshmërisht me dhënien e pëlqimit nga ana e kërkuarit, pasi ligji parashikonte që, nëse ky pëlqim nuk jepej para përfundimit të afatit të parë, atëherë autoriteti vendoste shtyrjen e afatit.

Praktika e zbatimit të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ka treguar se, terminologjia e përdorur në ligj nuk është kuptuar si përparësi ndaj interesit të individit, por si e drejtë e autoritetit publik që afatet e dhëna të shfrytëzoheshin ekstremisht deri në limit, si një mundësi për të shmangur detyrimin e tij ndaj publikut për dhënien e informacionit. Mund të thuhet edhe se shtyrja e afatit, jo në çdo rast mund të ketë patur si arsye të përligjur, të gjithë elementët e cituar më sipër.

E marrë në tërësinë e afateve të aplikueshme në bazë të ligjit, shtyrja e afatit mund të shërbente qëllimisht, si një shkak për humbjen e interesit nga subjekti i interesuar për marrjen e informacionit të kërkuar paraprakisht prej tij. Mbi këtë bazë nevojitej rishikimi në këtë ligj i afateve të përcaktuara në të, pasi ishin të shumta arsyet që flisnin për nevojën e parashikimit të afateve më të shkurtra dhe që shkonin në të njëjtën linjë me parimin e zhvillimit në një kohë të arsyeshme, të kësaj procedure.

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, për trajtimin e kërkesës për informim jep një afat më të shkurtër, pasi përcakton se, autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.<sup>100</sup> Përjashtimisht, kur autoriteti publik, që merr kërkesën për informim, ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.<sup>101</sup>

Këto afate të dhëna në ligj mund të zgjaten, sipas pikës 3, të nenit 15, të ligjit për arsye që lidhen me volumin e madh të dokumentacionit të shqyrtuar, nevojën për kërkim të informacionit publik të kërkuar, në zyra e mjedise fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit, nevoja për konsultim me autoritete të tjera publike para marrjes së vendimit për plotësimin ose jo, të kërkesës për informim të paraqitur. Zgjatja e afatit nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë pune. Risija në këtë ligj është se, mostrajtimi i kërkesës brenda afateve konsiderohet si refuzim i saj. Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, siguron një sistem një fazësh afatesh, që mendoj se është më fleksibël dhe më me vlerë për realizimin e së drejtës për informim, krahasimisht me Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, të shfuqizuar.

---

<sup>99</sup> Shih nenin 12, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare". Në njoftim, kërkuarit i propozohen dy alternativa nga autoriteti publik:

- Caktimin i një afati të ri, që fillon në mbarim të afatit të mëparshëm dhe që nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë, pa të drejtë përsëritjeje.
- Përshtatjen e kërkesës nga ana e kërkuarit, në mënyrë të tillë që të mund të respektohet nga ana e autoritetit publik afati i parashikuar në këtë ligj.

<sup>100</sup> Shih pikën 1, të nenit 15, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>101</sup> Po aty, pika 2, e nenit 15.

## 1.4.5 Kufizimet e së drejtës për informim

E drejta e informimit nuk është një e drejtë absolute dhe e pakufizuar, pasi të drejtat dhe liritë e të tjerëve, ose kërkesat morale, publike, ose të rendit publik dhe mirëqënies së përgjithshme të një shoqërie demokratike shërbejnë si kufizues të saj. Megjithëse, Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, shprehej në objektin e tij për të drejtën e çdo personi për të kërkuar informacion mbi dokumentet zyrtare, përsëri në dispozitat e tij gjendeshin kufizime të kësaj të drejte.

Në këtë ligj parashikohej se, çdo person kishte të drejtë të kërkonte:

- Informacion për dokumentat zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore;
- Informacion për një dokument zyrtar që më parë i është dhënë një personi tjetër;
- Informacion për subjektet me funksione shtetërore, pra për të dhënat vetjake të personave që kryejnë funksione shtetërore ose shërbime publike, të mbajtura në një dokument zyrtar, për aq sa këto të dhëna lidhen me cilësi të kërkuara nga ligji ose një akt nënligjor për personat që i ushtrojnë këto detyra.<sup>102</sup>

E drejta e çdo personi për të kërkuar informacion për dokumentat zyrtare nuk mund të shihet e shkëputur nga detyrimi i autoritetit publik, për të dhënë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe dhe që të mos refuzojë dhënien e një informacioni, nëse ai i është dhënë më parë një personi tjetër. Kufizimi i së drejtës për informim, si një e drejtë themelore mund të bëhet vetëm me ligj, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 17, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Të tilla ligje që kufizojnë këtë të drejtë janë, Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ligji nr. 8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar, Ligji nr.8839 datë 22.11.2001 “Për Grumbullimin, Administrimin dhe Ruajtjen e Informacionit të Klasifikuar Policor”, Ligji nr. 9154 datë 6.11.2003 “Për arkivat”, Ligji nr. 8116 datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar, Ligji nr.7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedures Penale”, i ndryshuar, Ligji nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për kontrollin dhe deklarimin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar, etj.

Ndërkohë, Ligji "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", në rast aplikimi të kufizimit përcaktonte detyrimin e autoritetit publik që; “t’i lëshojë kërkuarit një deklaratë me shkrim, në të cilën tregohen arsyet e mosdhënies së informacionit dhe rregullat në bazë të të cilave ai mund t’i kërkojë atë”.<sup>103</sup> Kufizimi që mund t’i bëhej aksesit në informacionin që kërkohej mund të ishte i plotë, apo i pjesshëm. Në këto rrethana vlerësoj se, ky ligj shkonte në të njëjtin drejtim logjik lidhur me kufizimet e të drejtës për informim që përcaktohen në Konventën e KE, “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso, por nuk listonte qartë shkaqet që justifikonin kufizimin ligjor rast pas rasti.

<sup>102</sup> Shih nenin 3, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

<sup>103</sup> Po aty, neni 4.



Më konkretisht, Konventa e KE, “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso, iu njeh të drejtën shteteve anëtare të kufizojnë të drejtën për akses në dokumentet zyrtare, por me kusht që kufizimet të jenë të përcaktohen qartë e të jenë të mbështetura në ligj, të jenë të domosdoshme në një shoqëri demokratike dhe të jenë në proporcion me qëllimin që të mbrojnë:

- a) Sigurimin kombëtar, mbrojtjen dhe marrëdhëniet ndërkombëtare,
- b) Sigurinë publike,
- c) Parandalimin, hetimin dhe përndjekjen e aktiviteteve kriminale,
- d) Hetimet disiplinore,
- e) Inspektimin, kontrollin dhe mbikqyrjen nga autoritet publike,
- f) Privatësinë dhe të tjera interesa private legjitime,
- g) Interesat tregtare dhe të tjera interesa ekonomike,
- h) Politikat ekonomike, monetare dhe të kursit të këmbimit të Shtetit,
- i) Barazinë e palëve në proceset gjyqësore dhe në administrimin efektiv të drejtësisë,
- j) Mjedisin; apo,
- k) Konfidencialitetin e diskutimeve brenda, apo midis autoriteteve publike, gjatë përgatitjes së brendshme të një çështjeje.<sup>104</sup>

Një model i ngjashëm listimi i shkaqeve që kufizojnë të drejtën për informim në ligj, ndoshta edhe me një gamë më të gjerë shkaqesh por gjithmonë duke respektuar kushtet e paracaktuara në nenin 17, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka identifikuar edhe një zgjidhje të duhur për këtë çështje. Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, paraqet një listim të mirë të shkaqeve ligjore që mund të kufizojnë të drejtën e informimit, me kushtin e paraparë që, kufizimi duhet të kryhet në rast se është i domosdoshëm, proporcional dhe nëse e kundërta, do të cënonte interesa të mirëpërcaktuara në ligj.<sup>105</sup>

Në nenin 17, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, vjen sërish si risi, aplikimi konkret i parimeve ndërkombëtare të hartimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, kur flitet për mosrefuzimin e informacionit të kërkuar edhe nëse ka shkaqe ligjore të përcaktuara për kufizimin e tij, në rastin kur interesi publik është më i lartë për dhënien e tij. Jo vetëm kaq por autoritetit publik i jepet diskrecion të konsiderojë si parësore procedurën e deklasifikimit të një dokumenti të kërkuar, por të klasifikuar paraprakisht si “sekret shtetëror”. Fillimi i procedurës për rishikimin e klasifikimit i njoftohet kërkuarit të informacionit të gjendur në një dokument të klasifikuar, duke vendosur për shtyrjen njëkohësisht të afatit për dhënien e informacionit, brenda 30 ditëve pune.

#### **1.4.6 Rrugët e ankimit ndaj shkeljes të së drejtës për informim**

Sipas Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, çdo shkelje e dispozitave të tij duhej trajtuar si kundërvajtje administrative, kur nuk përbënte vepër penale.<sup>106</sup> Dy ishin rrugët për të realizuar në këtë kontekst ankimin, ndaj shkeljes së të drejtës për informim:

- a) *Ankimi administrativ* dhe b) *Ankimi gjyqësor*.

<sup>104</sup> Shih nenin 3, pika 1, të Konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso.

<sup>105</sup> Shih nenin 17, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>106</sup> Shih nenin 14, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet zyrtare”.

Një vend të veçantë zinte e drejta e ankimit të subjekteve të interesuar, tek AP,<sup>107</sup> por kjo e drejtë parashikohej specifikisht në kuadër të mandatit të gjerë të AP për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individit, të parashikuar në Ligjin nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Në këtë rast parashikohej pranimi i ankesave, kërkesave, apo njoftimeve, nga individët për shkelje të së drejtës për informim nga ana e organeve të administratës publike si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, kompetencë kjo e përforcuar nga fakti se, AP njihej nga Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, si kujdestar për zbatimin e tij.

- *Ankimi administrativ*. Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, parashikonte të drejtën e çdo personi për t’u ankimuar në rrugë administrative,<sup>108</sup> çdo herë që çmonte se i ishin shkelur të drejtat e parashikuara prej tij. Ky nen paraqitet si një normë referuese, sepse nuk përcakton vetë procedurat e ankimit, por të referon tek procedurat që përcaktohen nga KPrA.

E drejta e ankimit është një e drejtë kushtetuese,<sup>109</sup> e subjekteve të së drejtës. Kjo e drejtë ankimi është një mjet juridik procedural që merr rëndësi të veçantë për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të subjekteve të së drejtës për informim, që ndihmon në realizimin efektiv të kësaj të drejte dhe që, realizon nga ana tjetër kontrollin e brendshëm administrativ. Në parim, veprimtaria e organeve të administratës publike prezumohet e ligjshme por nga ky rregull ka përjashtim, pasi gjatë kësaj veprimtarie mund të nxirren akte të kundërligjshme, që çenojnë të drejtat dhe liritë e ligjshme të individëve. Ajo që vlen të thuhet në këtë diskutim është se, ankimi administrativ ndaj veprimtarisë administrative të organeve të administratës publike për realizimin e së drejtës për informim, përbën një ndër rrugët themelore për garantimin e ligjshmërisë në punën e kësaj administrate, proces ky që konstaton dhe bën transparencën e veprimtarisë, duke analizuar dhe korrigjuar ligjërisht format e mundshme të abuzimit administrativ, rast pas rasti.

Shfrytëzimi i kësaj rrugë rezulton në parim me përfitime të dyanshme, pasi mund të rezultojë me zgjidhje të çështjes për subjektin e interesuar që ka paraqitur paraprakisht një kërkesë për informim, për të cilin ose ka marrë si përgjigje një refuzim të pjesshëm ose të plotë, sikundër vlen edhe për ligjshmërinë e veprimtarisë së organit të administratës publike ndaj të cilit është paraqitur kërkesa, për respektimin e ligjshmërisë, si dhe për krijimin e një precedenti vazhdues të mirëadministrimit në këtë drejtim. Ankimi administrativ në këtë kuptim, si një mjet juridik më i plotë, i referohet formulimit dhe paraqitjes së një kërkesë formale ndaj organit të administratës publike, që pretendohet se ka kryer shkelje të së drejtës për informim. Kjo pasi, paraqitja e një kërkesë jo formale nuk do të sjellë të njëjtat efekte ligjore proceduriale.

Ky ankim, sipas Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, i drejtohej drejtëpërdrejtë organit të administratës publike që kishte refuzuar pjesërisht apo plotësisht, përmbushjen e kërkesës për informim por mund t’i drejtohej edhe organit epror të organit konkret, nëse ligji e parashikonte një gjë të tillë. Paraqitja e ankimit administrativ kërkonte

<sup>107</sup> Kjo rrugë ankimi parashikohet në Ligjin nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

<sup>108</sup> Shih nenin 15, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”.

<sup>109</sup> Shih nenin 44, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

respektimin e një procedurë të veçantë shqyrtimi, që njihet ndryshe si zhvillimi i një procedimi administrativ gjatë të cilit, organi administrativ shqyrton paligjshmërinë e refuzimit të ndodhur nëpërmjet aktit përkatës administrativ, ose edhe parregullsinë e tij.

Koha e paraqitjes së këtij ankimi, në kuptim të afatit të përcaktuar nga ligji ndryshonte në varësi të llojit të pavlefshmërisë së aktit administrativ,<sup>110</sup> me të cilin organi i administratës publike kishte refuzuar pjesërisht apo plotësisht plotësimin e kërkesës për informim. Në rast se kishim të bënim me një akt refuzimi absolutisht të pavlefshëm, atëherë ankimi mund të paraqitej në çdo kohë, ndërkohë që nëse kishim të bënim me një akt refuzues, relativisht të pavlefshëm, ankimi administrativ duhej të kryhej brenda 30 ditëve, nga data e njoftimit të këtij akti, subjektit të interesuar të së drejtës për informim. Pas paraqitjes së ankimit administrativ, në respektim dhe procedurave të përcaktuara në ligj, organi i administratës publike që shqyrtonte këtë ankim duhej që të nxirrte një vendim pranues ose refuzues, brenda një muaji, nga data e depozitimit të ankimit.

Nëse nga shqyrtimi i çështjes organi i administratës publike nxirrte konkluzionin se, akti i refuzimit ishte i kundërligjshëm, atëherë subjekti i së drejtës për informim që kishte paraqitur ankimin administrativ, mund të përfitonte të drejtën e tij. Në rast të kundërt, sikurse është thënë më lart, në parim, vetëm pasi ishte ndjekur dhe shfrytëzuar konkretisht kjo rrugë ligjore mundej që, subjektet e interesuara të së drejtës për informim të ndiqnin rrugën e ankimit gjyqësor. Efektivisht nuk mundej që subjekti i interesuar t'i drejtohej gjykatës kompetente, pa ezauruar më parë shterimin e mjeteve administrative. Angazhimi i sistemit gjyqësor për të zgjidhur mosmarrëveshjet mes subjekteve të kësaj të drejte, që lidhen me respektimin e së drejtës për informim ishte një mundësi që mbetej në pritje, për sa kohë ekzistonte mundësia që, vetë administrata publike të korrigjonte veprimin, ose mosveprimin e saj të paligjshëm.

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në fuqi, përcakton se, çdo person kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë KDIMDhP, në përputhje me këtë ligj dhe KPrA.<sup>111</sup> Pra ligji, parashikon si shkallë ankimi administrativ, jo më organin publik që ka refuzuar pjesërisht apo plotësisht kërkesën për informim, as edhe organin publik epror të tij në hierarkinë administrative, por një organ tjetër publik, të pavarur, të krijuar nga ky ligj me emërtesën Komisioner. KDIMDhP, gëzon tashmë cilësinë e organit administrativ më të lartë që shqyrton ankesat e subjekteve kërkues të informacionit. Vendimmarrja e tij si organ është administrativisht përfundimtare, pasi ligji parashikon se kjo e fundit mund të ankimohet në gjykatën administrative.

- *Ankimi gjyqësor.* Një tjetër rrugë ankimi e parashikuar nga dispozitat e Ligjit “Për të drejtën për informim për dokumentat zyrtare”, është ankimi gjyqësor.<sup>112</sup> Përsëri për procedurat e ankimit në këtë ligj kemi një dispozitë me karakter referues, pasi

<sup>110</sup> Sipas parashikimeve të bëra në KprA (Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”), akte administrative absolutisht të pavlefshme (nenin 116), si dhe akte administrative relativisht të pavlefshme (neni 118).

<sup>111</sup> Shih pikën 1, të nenit 24, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>112</sup> Shin nenin 16, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”.

procedurat e ankimit gjyqësor nuk përcaktoheshin nga ligji për të drejtën e informimit, por nga dispozitat e KPrC,<sup>113</sup> që rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Sipas parashikimit të bërë në nenin 327, të KPrC, për shqyrtimin e mosmarrëveshjes nga ana e gjykatës kompetente, thuhet shprehimisht se: “Shqyrtimi i mosmarrëveshjes duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit në gjykatë”.

Me parashikimin e ankimit administrativ tek KDIMDhP, Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në fuqi, përcakton tashmë se, kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë të ankimojë vendimin e KDIMDhP, në gjykatën administrative kompetente.<sup>114</sup>

- *Ankimi tek Avokati i Popullit.* Funkcionimi i tij, si një institucion i pavarur kushtetues është një garanci për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtën për informim. Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, në nenin 18 të tij, parashikonte se, AP kujdeset për zbatimin e ligjit.

Trajtimi i ankimit ndërkohë, për cënim të pretenduar të së drejtës për informim, bëhet në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Këto parashikime ligjore i japin AP kompetenca specifike, që lidhen me një mbikqyrje të vazhdueshme ndaj veprimtarisë së të gjithë organeve të administratës publike, për realizimin dhe lehtësimin e ushtrimit efektiv të së drejtës për informim, sikurse njohin të drejtën për të shqyrtuar ankesa individuale apo edhe komunitare, që drejtohen tek ai nga subjekte të së drejtës për informim në rast pretendimi të shkeljes së kësaj të drejte. Në fakt, ankesa e paraqitur nga subjekte të interesuar në këto raste, tek AP, nuk konsiderohet si pjesë e paraparë e rregullimit të institutit të ankimit në KPrA dhe në këto rrethana, ajo nuk konsiderohet ankim administrativ. Aq më tepër kjo, kur Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, parashikon si rrugë ankimi administrativ në këto raste, ankimin tek KDIMDhP.

Kjo gjë bën që ankesa e paraqitur për shkeljen e së drejtës për informim tek AP, të ketë veçantinë e saj duke vënë në lëvizje një mekanizëm ligjor, që si produkt fundor nuk ka forcën detyruese nëpërmjet nxjerrjes së një akti administrativ, por rekomandimin si një produkt i institucioneve të njohura botërisht si “soft powers”. Duke qënë se paraqitja e ankesës tek AP nuk përbën ankim administrativ, rrjedhimisht edhe marrja dhe regjistrimi i kësaj ankese nga institucioni i sipërcituar dhe fillimi i procedurës së shqyrtimit administrativ të saj, sipas procedurave të dhëna në Ligjin nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, nuk pezullon afatet ligjore të parapara për shfrytëzimin e rrugës së ankimit administrativ, apo atij gjyqësor në vazhdim.

Shqyrtimi administrativ i kryer nga ana e Avokatit të Popullit dhe rekomandimi i mundshëm i nxjerrë prej tij, mund të shërbejnë si një bazë e mirë mbështetëse dhe

<sup>113</sup> Në nenin 328, të KPrC, thuhet shprehimisht se: “Afati për paraqitjen e padisë ndaj një akti administrativ është tridhjetë ditë nga dita e shpalljes ose e njoftimit të vendimit të organit më të lartë administrativ, që ka shqyrtuar ankesën në rrugë administrative...”.

<sup>114</sup> Shih nenin 25, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

argumentuese për pretendimet e ngritura nga ana e subjektit, që ka pretenduar shkeljen e së drejtës për informim, sidomos në fazën e ndjekjes së ankimit në gjykatë. Ndërfutja e një ndërhyrjeje të tillë gjatë procesit të realizimit të së drejtës për informim, mendoj se lidhet me dy momente kryesore; së pari, kuptimin real të filozofisë së ekzistencës së të drejtës për informim si një e drejtë themelore e njeriut, dhe së dyti, “formalizimin” e imponimit ligjor përmes aktivitetit të një institucioni që synon zgjidhjen e mosmarrëveshjes pa kaluar çështja për shqyrtim përfundimtar në gjykatë. Si rregull, vlefshmëria dhe interesi ndaj informacionit zyrtar të çfarëdo lloji qoftë ai, lidhet me disa rrethana. Në kuptim të interesit subjektiv të subjektit kërkues të së drejtës për informim, koha gjatë së cilës realizohet kërkesa për informim, apo refuzohet ajo, mund të ketë një rëndësi kyçe.

Ky interpretim teorik i veçantisë që paraqet ankimi tek AP, megjithatë paraqitet problematik, pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Megjithëse AP ka një mandat më të gjerë se KDIMDhP, sa i takon promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, juridiksioni i tij kufizohet vetëm tek sfera shtetërore, ndryshe nga institucioni tjetër juridiksioni i të cilit përfshin edhe sferën private. Nisur nga një “përplasje” e koncepteve të “kompetencës ekskluzive” dhe asaj të “kompetencës së gjerë”, mbetet shumë e diskutueshme fusha e veprimit të AP, sa i takon së mbrojtjes dhe promovimit të së drejtës së informimit.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, mbetet e paqartë kjo kompetencë, po ti referohemi përcaktimit ligjor ku thuhet se: “Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk çënon kompetencat e Avokatit të Popullit lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar”.<sup>115</sup> Një këndvështrim i ngushtë i çështjes çon në konkluzionin se, tashmë këto janë fusha specifike që mbulohen nga institucione të tjera, ndërsa një këndvështrim i gjerë konkludon se ka ende vend për punën e disa institucioneve për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave, duke ruajtur kështu një baraslargësi autonome në misionin e tyre.

Në këtë kontekst është shumë e rëndësishme të qartësohet në ligj kompetenca e AP,<sup>116</sup> në raport me të drejtën për informim, sipas regjimit juridik të përcaktuar në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sa i takon së drejtës së ankimit nga ana e subjekteve të interesuara. Në të gjitha rastet e tjera, AP duhet të jetë aktiv dhe proaktiv me ndërhyrjet përkatëse në Gjykatën Kushtetuese, apo edhe me rekomandimet për përmirësimin e bazës ligjore, që garanton të drejtën për informim. Ndërkohë të dy institucionet, AP dhe KDIMDhP, në këtë kontekst duhet të shërbejnë si “furnizues” të punës së njëri-tjetrit dhe si kontrollues të ndërsjellë të saj.

---

<sup>115</sup> Shih pikën 7, të nenit 24, të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcaktohet si, një organ administrativ, pjesë e ankimit administrativ ndaj vendimmarrjes së autoritetit përkatës shtetëror, në raste të trajtimit të kërkesave për informim.

<sup>116</sup> Me shkresën nr.698 datë 21.07.2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, të miratuar në datën 16.04.2015, mbi veprimtarinë e këtij institucioni për vitin 2014, është kërkuar lidhja e një marrëveshjeje bashkëpunimi me Avokatin e Popullit, me qëllim trajtimin e rasteve me objekt të drejtën e informimit, në referencë të përmbajtjes së nenit 24, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

## 1.5 Regjimi juridik i së drejtës të informimit, në KPrA.

E drejta e informimit si një e drejtë themelore e garantuar në Kushtetutë, është materializuar duke njohur një regjim juridik të ndryshëm,<sup>117</sup> në veprimtarinë e organeve të administratës publike, sa i përket asaj pjese të veprimtarisë administrative që njihet si, procedura administrative. Kjo e drejtë është kthyer në një detyrim për administratën publike, përmes përcaktimit të parimit të transparencës dhe parimit të informimit, si parime bazë të veprimtarisë së organeve publike.

Transparenca në veprimtarinë e organeve të administratës publike, nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë e qytetarëve për të patur informacion në lidhje me një procedurë administrative, ku këta të fundit janë palë, apo e drejta e qytetarëve për t'u informuar për të gjithë dokumentacionin e administratës, rregulluar me Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Kjo nënkupton gjithashtu të drejtën e qytetarit për t'u dëgjuar në një procedim administrativ, i cili prek interesat e tij, për të marrë pjesë aktive në procesin vendimmarrës të administratës, të njoftohet në kohën e duhur në lidhje me aktet që çënojnë interesat e tij. E drejta e aksesit në procedim, së bashku me institutet e tjera si, publikimi i aktit administrativ, pjesëmarrja në procedim, motivimi i akteve të nxjerra nga administrata, kanë për qëllim realizimin e parimit të transparencës dhe të publicitetit të veprimtarisë së organit të administratës publike.<sup>118</sup>

Konkluzioni i arritur se, origjina e parimeve të veprimtarisë administrative, (shtyllat e saj kryesore), derivojnë nga Kushtetuta, dhe se është përgjegjësi e madhe e ligjvënësit më pas për t'i detajuar dhe e organeve për t'i zbatuar. Është mjaft pozitive se kjo gjë reflektohet në Kushtetutën tonë duke qënë i njëjti standard me vendet e zhvilluara europiane.<sup>119</sup>

Duke analizuar paraprakisht përmbajtjen e dispozitave të Ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,<sup>120</sup> konstatohet se, ky ligj bënte një rregullim specifik të së drejtës për informim, duke i njohur këtë të drejtë subjekteve që janë palë në një procedim administrativ, ose atyre që kanë një interes të ligjshëm në lidhje me këtë proces. Sipas përcaktimeve të këtij ligji, në parim, të gjithë pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të marrin informacion dhe të njihen me dokumentet e përdorura në këtë procedurë, përveç rasteve kur me ligj janë vendosur kufizime.<sup>121</sup>

---

<sup>117</sup> Rregullimin specifik e drejta për informim gjen në nenet 50-55, të Ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar, dhe tashmë në nenet 45-52, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në fuqi, ku synohet sigurimi i transparencës në veprimtarinë e organeve publike dhe zhvillimi i një procesi vendimmarrës, sa më objektiv dhe të paanshëm, në të gjitha fazat dhe elementët e tij.

<sup>118</sup> Villata R., (1087): “La trasparenza dell’azione amministrativa”, in Diritto Procedurale Amministrativa, Atti del XXXII Convegno di studi di scienza dell’amministrazione, viti 1987, faqe 528.

<sup>119</sup> Faskaj-Vokopola A.: “Procedimi administrativ në Republikën e Shqipërisë”, Phd Dissertacion, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shqipëri, viti 2013, faqe 35.

<sup>120</sup> Ky ligj është shfuqizuar nga Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

<sup>121</sup> Shih nenin 20, të Ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Kjo e drejtë mund të ushtrohet, ose personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar prej subjekteve palë në procedimin administrativ. Organi i administratës publike që zhvillonte procedimin administrativ, duhet të mbante një qëndrim aktiv në lidhje me informimin e pjesëmarrësve për të drejtat dhe detyrimet e tyre në këtë procedim. Në grupimin e subjekteve që gëzonin dhe mund të ushtronin këtë të drejtë, përcaktoheshin ata persona që ishin drejtpërdrejtë të interesuar, pra që ishin palë në procedimin administrativ, pavarësisht nëse procedimi kishte filluar me iniciativën e organit të administratës publike, apo mbi bazën e kërkesës së të interesuarit.

Subjekte të legjitimuara sipas parashikimeve të këtij KPrA, përbënin edhe personat që, megjithëse nuk ishin palë të drejtëpërdrejtë në procedimin administrativ, kishin një interes të ligjshëm në të dhe e provonin këtë fakt para organit të administratës publike.<sup>122</sup> Terminologjia e përdorur në këtë rast dhe konkretisht termi “interes i drejtpërdrejtë” dhe “interes i ligjshëm”, n’a referon në parashikimet e bëra në nenet 44 dhe 45, të këtij ligji, ku trajtohet se, cilët subjekte do të konsideroheshin palë të interesuara në procedimin administrativ. Pra edhe në rastet kur themi që subjekti ka një interes të drejtëpërdrejtë dhe në ato raste kur themi që subjekti ka një interes të ligjshëm, jemi para faktit që subjekti kishte statusin e palës së interesuar. Dhe në këto kushte, në rast se ai ishte palë e interesuar, këtij të fundit nuk mund t’i mohohet e drejta për t’u informuar, pasi ai kishte një interes të ligjshëm.

Sipas kërkesës së drejtuar, njoftimi që jepej nga ana e organit të administratës publike, duhet të përmbante informacion të qartë dhe të saktë mbi organin administrativ që zhvillonte procedimin administrativ, hapat e ndërmarrë në të, vendimet e marra deri në atë moment dhe çdo informacion tjetër. Për dhënien e këtij informacioni ishte përcaktuar një afat prej 10 ditësh, nga dita e regjistrimit të kërkesës. Shprehimisht, legjislacioni rregullator nuk parashikonte faktin që kërkesa për akses duhet të ishte e motivuar, por nisur nga fakti që subjekti duhet të provonte që kishte një interes të drejtëpërdrejtë, apo të ligjshëm për dokumentat e kërkuara prej tij, detyrimisht ky informacion jepej në kërkesë.

E drejta për akses, pra, i sigurohet personave, të cilët ishin drejtpërdrejtë të interesuar dhe për këtë mjaftonte vetëm kërkesa, por nuk mund të lëmë pa përmendur këtu që edhe kur subjekti nuk kishte një interes të drejtëpërdrejtë për procedimin, por kishte një interes të ligjshëm, ata duhet t’a provonin këtë gjë. Informacioni i kërkuar mund të jepej, nëpërmjet mundësisë që ju krijohet palëve të interesuara për të inspektuar dosjet e disponuara nga administrata dhe marrjes së vërtetimeve, apo kopjeve të vërtetuara të dokumenteve,<sup>123</sup> që mbaheshin në këto dosje.

---

<sup>122</sup> Urdhëri i lëshuar nga ana e përgjegjësit të njësisë përkatëse administrative vendore, shoqëruar me kërkesën e shkruar dhe dokumentacion tjetër të kërkuar, përbënte bazën faktike që legjitimonte cilësimin e subjektit, si person që ka një interes të ligjshëm.

<sup>123</sup> Në nenin 53/1, të Ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet hollësisht se, çfarë mund të kërkohet si informacion në vërtetimet që lëshon administrata dhe më konkretisht;

- data e paraqitjes së aplikimeve, peticioneve, kërkesave për shqyrtim, apelineve dhe dokumenteve të tjera të ngjashme,
- përmbajtja e këtyre dokumenteve ose pretendimet e palëve,
- etapën në të cilën ndodhet zhvillimi i procedimeve,

Natyrisht që në këtë ligj parashikoheshin edhe rastet e kufizimit të së drejtës së informimit, gjatë inspektimit të dosjeve të disponuara nga ana e administratës, në kushtet e ekzistencës së dokumentave sekrete, apo të atyre dokumentave që kufizoheshin në akses nga një legjislacion tjetër në fuqi. Gjithmonë në këto raste, punonjësi përgjegjës i administratës ishte i detyruar t'i lëshonte një deklaratë palës së interesuar, ku të vërtetohej ky fakt. Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, në nenin 55, përcaktonte edhe një parim tjetër të rëndësishëm të funksionimit të administratës publike, parimin e “administratës së hapur”, duke referuar një lidhje organike që bëhej ndërmjet parashikimeve të këtij Kodi dhe Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”,<sup>124</sup> për garantimin e të drejtës së informimit, jo vetëm brenda kuadrit të zhvillimit të një procedimi administrativ, por edhe jashtë tij, apo edhe për forma të tjera të veprimtarisë së kësaj administrate që indikojnë një volum pune të ndryshëm dhe më të gjerë se kaq.

Nisur nga rregullimi që Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, i bënte të drejtës së informimit, arrihet në disa konkluzione:

- Subjektet e përcaktuara sipas këtij ligji, ishin nga njëra anë, një grupim individësh të caktuar që, ose merrnin pjesë në një procedim administrativ të dhënë, ose kishin një interes të ligjshëm për të, dhe nga ana tjetër organet e administratës publike, sikurse përcaktoheshin në nenin 3, të tij.
- Objekti i të drejtës së informimit ishin vërtetimet ku jepej informacioni i parashikuar në pikën 1, të nenit 53, të ligjit, apo kopje autentike të dokumentave zyrtare, të administruara në zhvillimin e një procedimi administrativ konkret që kishte filluar, ose me kërkesën e një subjekti të së drejtës administrative, ose me iniciativën e vet organit të administratës publike.
- Ushtrimi i kësaj të drejte nga ana e palëve të interesuara, sipas parashikimeve të këtij ligji, bëhej vetëm në rastin e zhvillimit të procedimeve administrative, për të cilat palët kishin një interes të drejtëpërdrejtë, ose të ligjshëm.
- Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, bënte një përcaktim më të ngushtë të detyrimit që ka organi administrativ, krahasuar me Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, për arsyetimin me shkrim të refuzimit të kërkesës për informim që mund t'i bëhet subjektit kërkuar. Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, detyronte zyrtarin përgjegjës që në rast refuzimi të kërkesës për informim, ky refuzim të paraqitet me shkrim dhe i arsyetuar për motivet e refuzimit. Ndërkohë, Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, e vendos këtë detyrim vetëm në rast se pala e interesuar e kërkon një deklaratë me shkrim që të vërtetojë këtë fakt. Kufizimi në dhënien e

---

- vendimet e marra, apo që duheshin marrë.

<sup>124</sup> Në paragrafin e dytë, të nenit 55, thuhej se: “E drejta për t'u njohur me dosjet dhe regjistrat e administratës rregullohet me ligj të veçantë”.



informacionit i parashikuar në këtë rast në këtë ligj, i referohet konceptit të sekretit shtetëror të përcaktuar në Ligjin “Për informacionin e klasifikuar”.

Ky koncept jepet edhe në përcaktimin tjetër të dhënë në po këtë ligj, sipas të cilit palët e interesuara kanë të drejtë të inspektojnë dosjet e disponuara nga administrata, kur këto nuk përmbajnë dokumenta të klasifikuara sekrete, dhe të marrin vërtetime apo kopje të vërtetuara të dokumentave që ato përmbajnë kundrejt pagesës.<sup>125</sup> Ndërsa në kufizimet që parashikohen për të drejtën e informimit sipas Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, referoheshin një sërë ligjesh të tjera, ky ligj referon vetëm Ligjin “Për informacionin e klasifikuar”, gjë që ka patur të nevojshme rregullimin ligjor të parashikimit të një listimi shkaqesh kufizuese, të parashikuara shprehimisht me legjislacion specifik.

- Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, vendoste detyrimin e administratës publike rast pas rasti, që t’i shpjegonte subjektit kërkuar rregullat, në bazë të të cilave ky subjekt mund të kërkonte një informacion, apo dokument që mbahej nga kjo administratë. Nga ana tjetër, Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, nuk vendoste një detyrim të tillë për organin administrativ që zhvillonte një procedim administrativ përkatës.
- Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përcaktonte se për kryerjen e shërbimit të informimit për dokumentet zyrtare, nëse kjo kërkonte shpenzime, autoriteti publik mund të vendoste tarifa, të cilat i përcaktonte paraprakisht. Këto tarifa nuk mund të ishin më të larta se kostoja për realizimin e shërbimit.<sup>126</sup> Përcaktimi i bërë në nenin 52, të Ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pagesën që duhet të bënin palët e interesuara gjatë inspektimit të dosjeve të disponuara nga administrata dhe të marrjes së vërtetimeve, apo kopjes së vërtetuar të dokumentave që lidheshin me këto dosje, gjithsesi gjykoj se ka qënë i paqartë. Kjo pasi, vetë ligji sanksiononte parimin e mospagimit të shërbimit nga ana e administratës publike, por nuk përcaktohet se kujt duhet t’i referohet përcaktimi i koston për këtë pagesë. Po kështu, ai nuk parashikonte raste përjashtimore në përputhje me parimin e mospagimit të shërbimit.
- Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, i përcaktonte të drejtës së informimit një regjim juridik më të ngushtë në disa elementë, krahasuar me regjimin juridik që përcaktonte për këtë të drejtë, Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Pas hyrjes në fuqi, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa e parimeve të përgjithshme bazë për veprimtarinë e organeve publike është rikonceptuar duke përcaktuar si parime të veçanta, parimin e transparencës<sup>127</sup> dhe

---

<sup>125</sup> Shih nenin 52, të Ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

<sup>126</sup> Shih nenin 13, të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

<sup>127</sup> Shih nenin 5, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

parimin e informimit.<sup>128</sup> Kjo ndarje mendoj se ka dashur të theksojë mënyrën e një sjelljeje normale administrative në veprimtarinë e përditëshme administrative të organeve publike, që ka në bazë transparencën e konceptuar jo thjesht si një imponim, por si një natyrshmëri që duhet të vijë edhe nga bashkëpunimi i ngushtë me personat fizikë dhe juridikë.

E drejta e informimit dhe transparencja janë elementë të pandara të sistemit qeverisës dhe prandaj mendojmë se legjislacioni përkatës pothuajse asnjëherë nuk ka arritur që ta realizojë pasqyrimin dhe formulimin e tyre, të ndara nga njëra tjetra...Kështu që edhe ndarja e tyre në dy parime të veçanta sipas KPrA të ri, është bërë jo vetëm për të përforcuar kuptimin dhe rëndësinë e tyre si parime që janë njëkohësisht parime të së drejtës administrative, të administratës publike dhe të procedimit administrativ, por edhe për lehtësi gjatë zbatimit të tyre në praktikën e përditshme.<sup>129</sup>

Ndërkohë transparencja e pritshme sipas parimit të informimit, lidhet në vazhdim me konceptin e hapjes maksimale, kur dispozita që materializon këtë parim të referon tek rregullimet e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit. Duke ruajtur konceptin bazë të së drejtës për informim, renditja e dhënësive dhe parimeve në vazhdim ndjek në mënyrë logjike kufizimin e së drejtës për informim kur flitet për, parimin e mbrojtjes së sekretit shtetëror,<sup>130</sup> parimin e mbrojtjes së konfidencialitetit,<sup>131</sup> dhe parimin e mbrojtjes së të dhënave.<sup>132</sup>

Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ruan të njëjtin përcaktim mbi rrethin e subjekteve që kanë të drejtë të marrin informacion në një procedurë administrative, sikurse edhe Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Ajo që ndryshon në këtë ligj lidhet me, kohën e dhënies së informacionit të kërkuar, e cila tashmë është më e shkurtër dhe që parashikohet të realizohet brenda 5 ditëve, nga paraqitja e kërkesës për këtë qëllim.

Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nuk përdor termat “interes i drejtpërdrejtë” dhe “interes i ligjshëm”, por i nënkupton ato, në terminologjinë e përdorur “të gjitha palët në një procedurë administrative”, duke kuptuar njëkohësisht detyrimin e subjekteve që kërkojnë informacion, që të vërtetojnë faktin se gëzojnë cilësinë e palës në një procedurë administrative.<sup>133</sup> Kufizimin e palëve për njohjen me dosjen ku mbahen dokumentet e procedurës administrative, ky ligj e referon në nenin 46, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ku jepen shkaqet ligjore të kufizimit rast pas rasti.

Ky ligj është më i detajuar dhe konkret se sa, Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar, në përcaktimin e rregullave për organin publik mbi lëshimin e kopjeve, ose të pjesëve të njësuara me origjinalin të akteve të nxjerra nga ky organ, apo të dokumenteve të tjera nën administrimin

<sup>128</sup> Shih nenin 6, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

<sup>129</sup> Dobjani E., (2016): “E drejta Administrative – Pjesa e Përgjithshme”, Botues “Emal”, viti 2016, faqe 83.

<sup>130</sup> Shih nenin 7, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

<sup>131</sup> Po aty, neni 8.

<sup>132</sup> Po aty, neni 9.

<sup>133</sup> Kuptimi dhe përcaktimi i palëve në procedurën administrative, jepet në nenin 3 dhe nenin 33, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

e tij, sikundër parashikon si një risi normuese, rregullime edhe mbi njësimin në lidhje me dokumentet elektronike.<sup>134</sup> Rregullimet ligjore avancojnë më tej, kur përcaktohet njësimi i dokumenteve të lëshuara nga organe të tjera publike, apo vërtetimi i nënshkrimeve, sipas autorizimit përkatës me vendim të Këshillit të Ministrave. Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcakton një regjim juridik të së drejtës së informimit më të ngushtë në disa elementë, krahasuar me regjimin juridik që përcakton tashmë për këtë të drejtë, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

## 1.6 Disa përfundime:

- E drejta për informim është një koncept që ndeshet herët në vendet nordike, e lidhur ngushtë me respektimin e dinjitetit njerëzor dhe si një vlerë e qënësishme e shtetit të së drejtës. Ajo është afirmuar tashmë në një sërë aktesh të rëndësishme ndërkombëtare, si DUDNJ dhe KEDNJ dhe natyrshëm në kuadrin e legjislacionit tonë të brendshëm, së pari e afirmuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në aktet ndërkombëtare, ajo njihet si pjesë përbërëse e lirisë së shprehjes, ndërsa në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ajo afirmohet si një e drejtë e veçantë, në grupin e të drejtave themelore e njeriut.
- E drejta për informim, si një e drejtë pozitive gjen realizimin e saj në marrëdhënien ndërmjet individit dhe organeve publike, sa i përket marrjes së informacionit zyrtar të mbajtur nga këto organe, duke përbërë në këtë mënyrë një element jetik të transparencës së qeverisjes dhe pjesëmarrjes publike në qeverisjen demokratike.
- E drejta për informim është një instrument kundër sekretit dhe mungesës së besimit në qeverisje, në kushtet e ekzitencës së burokracisë mbytëse të shtetit autokratik. Ajo i ka paraprirë lindjes së shtetit administrativ dhe zhvillimit të shtetit administrativ modern në të cilin mbrohen dhe respektohen të drejtat e njeriut, vendoset sistemi “Check and Balance”, krijohen tregjet e lira dhe ku konsolidohet demokracia.
- Rëndësia e saj ka tejkaluar prej kohësh kufijtë kombëtarë dhe është bërë një çështje e sanksionimit të parimeve ndërkombëtarisht të pranuara, të cilat vendosin standarde mbi të cilat duhet të formulohet dhe bazohet legjislacioni për të drejtën e informimit. Mbështetur në këto parime, legjislacioni kombëtar mbi të drejtën e informimit, duhet të ketë qëllim kryesor hapjen maksimale të informacionit qeveritar, ndaj publikut.
- Regjimi juridik bazë i kësaj të drejte është përcaktuar fillimisht në Ligjin Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, si dhe në Ligjin nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”. Pas shfuqizimit të këtyre ligjeve, regjimi juridik bazë i së drejtës për informim përcaktohet nga dispozitat e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

---

<sup>134</sup> Këto rregullime gjenden në nenet 49 dhe 50, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Këto ligje rregullojnë aksesin në informacion mbi veprimtarinë e përgjithshme administrative të administratës publike dhe në kuadër të kodeve, aksesin në informacionin për procedurën administrative. Ligje të tjera në fuqi në vendin tonë, përcaktojnë regjime juridike specifike të së drejtës për informim, që referojnë në dispozitat e tyre regjimin bazë juridik të kësaj të drejte, të përcaktuar në ligjet e sipërcituara.

- Realizimi i së drejtës për informim, sipas regjimit juridik bazë të saj konkretizon një marrëdhënie juridike administrative, me subjektet, objektin dhe përmbajtjen e saj. Efektivisht tërësia e subjekteve të legjitimuara, që kanë të drejtë të kërkojnë informacion mbi dokumentet zyrtare, nga ana e administratës publike, prezanton një dimension individual të së drejtës që plotësohet me pozitivitetin dhe mundësinë e shfrytëzimit të saj edhe nga vet administrata publike, në funksion të besueshmërisë dhe transparencës publike. Kjo marrëdhënie me të drejtat dhe detyrimet e palëve pjesëmarrëse mbart në vetvete elementët e procesit të rregullt ligjor, në aspektin administrativ, në kuadër të procedurave, afateve të realizimit dhe rrugëve të ankimit ligjor.
- Hyrja në fuqi e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, gjykoj se ka përmirësuar në shumë elementë regjimin juridik bazë të së drejtës për informim, qoftë përsa i përket veprimtarisë së përgjithshme administrative të organeve publike, qoftë edhe në kuadër të procedurave administrative.
- Subjekte të caktuara që kanë të drejtën të marrin informacion nga administrata publike, sikurse media, vlerësoj se nuk gëzojnë ndonjë përparësi nga legjislacioni në fuqi, në trajtimin e kërkesave të tyre për informim, pavarësisht rolit që luajnë në përcimin e informacionit në publik.
- Legjislacioni ynë i mbas viteve 90’ ka parashikuar si një mundësi ankimi në rastet e shkeljes së të drejtës për informim, ankimin e subjektit të interesuar tek AP. Specifika e këtij ankimi qëndron në faktin se ai nuk ka cilësinë dhe efektet e ankimit administrativ, por gjykoj se është një mjet ligjor, i cili ezaurohet në termat e ndërmjetësimit institucional, të rregulluar mbi bazën e parashikimeve të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.
- Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përcakton se, çdo person kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative, pranë KDIMDhP. Si një institucion i ri, i pavarur, KDIMDhP gëzon kompetenca ekskluzive tashmë, për mbrojtjen dhe respektimin e së drejtës për informim.
- Megjithëse AP ka një mandat më të gjerë se KDIMDhP, sa i takon promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, juridiksioni i tij kufizohet vetëm tek sfera shtetërore, ndryshe nga juridiksioni i KDIMDhP, ku përfshihet edhe sfera private. Nga ana tjetër KDIMDhP rezulton të ketë mjete më të shumta ligjore që i japin

kompetenca ekzekutive detyruese, krahasimisht ndaj kompetencave rekomanduese të AP, lidhur me mbrojtjen e së drejtës për informim.

- Përmbajtja e dispozitave të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, krijon paqartësi në lidhje me kompetencat dhe fushën e veprimit që AP, ka për sa i takon promovimit, parandalimit të shkeljes dhe mbrojtjes të së drejtës për informim.
- Nga analiza e kryer për regjimet juridike të së drejtës për informim të përcaktuara nga, Ligji Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, dhe Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, pas shfuqizimit të tyre, regjimet juridike që përcaktohen nga dispozitat e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vërehet se kanë dallime në disa elementë. Krahasimisht, regjimi juridik për të drejtën e informimit, i përcaktuar nga KPrA respektiv sipas prodhimit kohor të efekteve juridike, është më i kufizuar në disa elementë nga regjimi juridik që përcaktohet në ligjet, që rregullojnë aksesin në informacionin e veprimtarisë së përgjithshme administrative, të organeve publike. Ky dallim vërehet në rrethin e subjekteve që kanë të drejtë të kërkojnë informacion, marzhin e informacionit objekt kërkimi, afatet, etj.
- E drejta për informim nuk është një e drejtë e pakufizuar, pasi në legjislacionin rregullator parashihet elementi i “kapërcimit të interesit detyrues”, si kusht për këtë qëllim. Në çdo rast, përparësia që shfaqet në raportin midis interesit individual dhe interesit publik, përcakton zbatimin, apo kufizimin e saj.
- Kufizimi i të drejtës për informim, si një e drejtë themelore mund të bëhet vetëm me ligj, sipas kriteve të përcaktuara në nenin 17, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Kufizimi që mund t’i bëhet aksesit në informacion mund të jetë i plotë, apo i pjesshëm. Kufizimi duhet arsyetuar gjithmonë me aktin përkatës administrativ të nxjerrë nga ana e autoritetit publik.

## II. KREU I DYTË

### INSTITUCIONET KOMBËTARE PËR GARANTIMIN E SË DREJTËS PËR INFORMIM DHE DISA ASPEKTE TË MBROJTJES SË TYRE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.

#### 2.1 Avokati i Popullit, garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Institucionet e krijuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë aktorë të rëndësishëm shtetformues në sistemet demokratike. Ombudsmani si njëri prej tyre luan rol të pazëvendësueshëm, duke qenë tregues i shkallës së pjekurisë të klasës politike dhe të mentalitetit të shoqërisë që e krijon atë. Modeli i Ombudsmanit klasik parlamentar, i bazuar në konceptin e ndarjes së pushteteve të formuluar nga Monteskje, përbën bazën e krijimit të Ombudsmanëve të sotëm, të cilët në varësi të specifikave të kompetencave të tyre marrin emërtesa të ndryshme,<sup>135</sup> sinonime të fjalës “Ombudsman”.

Në këtë kuptim, ngritja dhe funksionimi i institucionit të Ombudsmanit në Shqipëri përfaqëson përpjekjet për ndërtimin e shtetit të së drejtës, që “konsiderohet si mjete me anë të të cilit sistemi i vlerave demokratike depërton në mekanizmat juridikë”.<sup>136</sup> Krijimi i këtij institucioni në vendin tonë është përqaftuar si ide dhe realizuar me parashikimin në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, miratuar në vitin 1998. Duke ndjekur modelin klasik të Ombudsmanit parlamentar, “Parlamenti shqiptar miratoi ligjin përkatës “Për Avokatin e Popullit”, i cili është një kombinim midis ligjit Danez dhe atij Suedez”.<sup>137</sup>

AP është një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt, ose jo në Shqipëri, refugjat, si dhe të personave pa shtetësi që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike. AP i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë, është organ i administratës publike, ekstra-gjyqësor, lëndë e parë e funksionimit të të cilit janë ankesat dhe kërkesat e qytetarëve, por ai mund të veprojë edhe me inisiativë.<sup>138</sup>

Thelbi i filozofisë së veprimit mbetet mbikqyrja për mirëfunksionimin e administratës publike, si oponencë për mirëqeverisje dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.

---

<sup>135</sup> Emërtesa të tilla janë; Avokati i Popullit (Shqipëri), Avocatul Poporului (Rumani), Commissioner for Citizen's Rights and Citizen's Aide (vendet anglo-amerikane), Defensor del Pueblo Spanje dhe ne shumicen e vendeve latino-amerikane), Mediator de la Republique (France dhe vendet frankofone), Commissioner for Local Administration (Britani e Madhe), Eduskunnan Oikeusasiamies (Finlande), Volksanwaltschaft (Austri), etj. Ky informacion gjendet në botimin: Palla W. (2002): “Gli organi di controllo e di ricevimento delle proteste dall’antichità fino al sinonimi nel presente, passando attraverso l’ombudsman della Scandinavia”, Edizioni Athesia, Bolzano, 2002, Nr.45 (1) , faqe 20-21.

<sup>136</sup> Omari L., (2004): “Shteti i së drejtës”, botim i dytë, Shtëpia botuese “Elena Gjika”, viti 2004, faqe 27.

<sup>137</sup> Avokati i Popullit, “Avokati i Popullit në Shqipëri”, Botim i dytë, Tiranë, viti 2003, faqe 5.

<sup>138</sup> Shih nenin 13, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Objektiv i përhershëm i tij është që të realizohet transparenca e administratës publike, ashtu siç e kërkon ekologjia e demokracisë.<sup>139</sup> Për këto arsye, AP bën pjesë në ato institucione, jo vendimmarrëse, “garante të demokracisë, të shtetit ligjor dhe të të drejtave të njeriut”.<sup>140</sup> Natyra unike e institucionit të Ombudsmanit do të thotë që, në aspekte të rëndësishme ai ndryshon nga të gjitha organet e tjera shtetërore. Ai nuk është as gjykatë dhe as agjenci administrative. Por ai faktikisht ushtron pushtet kontrolli në marrëdhëniet që ka me administratën publike si dhe e përdor atë si pushtet moral për të kërkuar reagimin pozitiv të kësaj administrate, ndaj rekomandimeve të tij.<sup>141</sup>

Në ditët e sotme marrja në konsideratë e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut është e dukshme dhe e ndjeshme në çdo sferë të aktivitetit qeverisës dhe në shumë sfera të tjera të jetës publike dhe private. Numri dhe shkalla e përhapjes së institucioneve që merren me të drejtat e njeriut reflekton këtë realitet. Megjithatë është e kuptueshme që, një institucion ligjërishit dhe efektivisht i pavarur dhe i shkëputur nga përgjegjësitë e qeverisjes ekzekutive dhe nga administrata gjyqësore, mund të luajë një rol unik dhe të mbajë një pozicionin udhëheqës në fushën e të drejtave të njeriut. Duke ruajtur distancën reale të perceptuar nga qeverisja e ditës, një institucion i tillë jep një kontribut të pazëvendësueshëm në përpjekjet e një vendi për të mbrojtur shtetasit e tij dhe për të zhvilluar një kulturë që respekton dhe zhvillon të drejtat e njeriut.

Prej kohësh Kombet e Bashkuara kanë mbajtur një qëndrim aktiv mbi ekzistencën dhe veprimtarinë e këtyre institucioneve të njohura ndryshe si, institucione kombëtare të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Ata janë të gjithë me natyrë administrative si dhe kanë përgjithësisht autoritet këshillues, lidhur me të drejtat e njeriut në nivel kombëtar. Koncepti i institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, me funksione specifike të përcaktuara në termat e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut është shumë specifik. Ato kanë natyrë administrative dhe nuk janë direkt nën autoritetin e pushtetit ekzekutiv, gjyqësor dhe atij legjislativ, megjithëse si rregull përgjigjen, apo raportojnë tek legjislativi në mënyrë direkte, ose indirekte.

Një përkufizim i dhënë mbi institucionet kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut është se: “Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut janë organe shtetërore me një mandat kushtetues dhe/apo ligjor për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut. Ato janë pjesë e aparatit shtetëror dhe ato financohen nga shteti”.<sup>142</sup> Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut nuk janë organizata jofitimprurëse, pasi ato janë zbulues neutral faktesh dhe jo avokatë të një pale, apo një tjetre. Një institucion i tillë duhet të jetë i pavarur nga sektori i organizatave jofitimprurëse, sikurse duhet të jetë i pavarur edhe nga qeveria. Në investigim, një institucion kombëtar i mbrojtjes së të drejtave të njeriut duhet të operojë brenda një kuadri të përcaktuar ligjor dhe duhet të jetë në përputhje me parimet e përgjithshme të drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës.<sup>143</sup> Këto institucione shërbejnë si urë

<sup>139</sup> Avokati i Popullit, “Raporti Vjetor 2003 i Avokatit të Popullit”, viti 2004, Tiranë, faqe 7.

<sup>140</sup> Avokati i Popullit, “Raporti Vjetor 2007 i Avokatit të Popullit”, Prill 2008, Tiranë, faqe 10.

<sup>141</sup> Dobjani E., (2016): “E drejta Administrative – Pjesa e Përgjithshme”, Botues “Emal”, viti 2016, faqe 270.

<sup>142</sup> Kjaerum M., “What is a national human rights institution?”.

Website: [www.humanrights.dk/about+us/what+is+a+nhri](http://www.humanrights.dk/about+us/what+is+a+nhri) (6 Tetor 2010)

<sup>143</sup> United Nations publication, “National Human rights Institutions – History, Principles, Roles and Responsibilities”, New York and Geneva, 2010, ISSN 1020-1688, faqe 13.

lidhëse ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë, kur në të njëjtën kohë kritikojnë veprimet e vet qeverive që i kanë krijuar dhe i financojnë ato. Ato i ndjekin qëllimet e tyre, ose përmes opinioneve dhe rekomandimeve, ose përmes vlerësimit dhe vendimmarrjes ndaj ankesave të paraqitura nga individët.

Në disa vende, Kushtetuta parashikon themelimin e një institucioni kombëtar të të drejtave të njeriut, ndërkohë që më shpesh këto institucione krijohen me ligj. Ky është një kriter që vjen në përputhje me kriteret e përcaktuara tek Parimet e Parisit,<sup>144</sup> të cilat vendosin një minimum standardesh për rolin dhe përgjegjësitë e këtyre institucioneve. Sipas këtyre parimeve një institucion kombëtar i të drejtave të njeriut, duhet që; të mbrojë dhe promovojë të drejtat e njeriut, të ketë mandat të gjerë të bazuar në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të ketë autonomi ligjore, autonomi operacionale dhe autonomi financiare nga qeveria, pavarësi të garantuar nga ligji apo Kushtetuta, pluralizëm në anëtarësi, burime adekuate, fuqi adekuate investigimi. Sot ekzistojnë emërtesa të ndryshme të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, në varësi të traditës ligjore, rajonit apo edhe faktorëve të tjerë. Si rregull, këto institucione kanë një autoritet këshillues përmes rekomandimeve tek qeveria dhe ligjvënësia, përta i përket të drejtave të njeriut në nivel kombëtar.

Qeveritë kanë përgjegjësinë parësore mbi respektimin e të drejtave të njeriut, por ato nuk mundet që të gjejnë gjithmonë një hapësirë neutrale, në të cilën të ndërveprojnë dhe shkëmbejnë ide me aktorë të tjerë, veçanërisht me shoqërinë civile. Kjo hapësirë neutrale zotërohet nga institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat sigurojnë një pikë neutrale takimi dhe “pikë fokale” për të drejtat e njeriut, duke inkurajuar dialogun dhe lehtësuar bashkëpunimin.

Në Shqipëri ekzistojnë prej vitesh disa institucione të tilla, ku veçohen AP, KDIMDhP, apo edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me një tendencë në rritje të numrit të tyre. Megjithatë AP ka një mandat më të gjerë nga institucionet e tjera të sipërcituara, sa i takon promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ai shfaqet me juridiksion të kufizuar vetëm tek sfera shtetërore.

### **2.1.1 Historiku i Ombudsmanit në botë dhe në Shqipëri**

Gjeneza e këtij institucioni përkon me fillesat e zhvillimit të shtetit suedez. Megjithatë para kësaj periudhe, antikiteti njih autoritete të veçanta që operonin si organe kontrolli, të ngjashme me Ombudsmanin.

Në qytet-shtetin e Athinës, njihet sistemi i “Euthynoi”, si dhe ekzistenca e “Logistai”, si të ngarkuar të veçantë me punë, të cilëve iu besohesh rishikimi i çështjeve të administruara nga funksionarët publikë. Në qytet-shtetin e Spartës, organi i kontrollit më i njohur është

---

<sup>144</sup> Angazhimi i OKB për krijimin e institucioneve kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, i cili fillon që në vitin 1946, njohu një zhvillim shumë të rëndësishëm me work-shopin e organizuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, në Tetor 1991, në Paris. Në këtë aktivitet u përcaktuan disa parime për rritjen e efektivitetit të punës së institucioneve kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të cilat njihen ndryshe si, Parimet e Parisit.



“Eforati” i Spartës. Në Perandorinë Romake, një rëndësi të veçantë kishte “Tribunati i Plebejve”, me detyrën e mbrojtjes së qytetarëve, nga padrejtësitë. Në perandorinë Kineze, aktiviteti i funksionarëve u bë subjekt kontrolli për mëse dy mijëvjeçare, përmes një mekanizmi kontrolli të veçantë, të përfaqësuar nga arkivistët perandorake dhe me vonë nga individët, “yu schi tai”. Në periudhën e mesjetës, veçojmë “Lo justicia Major” në Aragonë, “Këshillin e të Dhjetëve” në Republikën e Venecias, si dhe “Censorët”, në vendet e Amerikës së Veriut. Në vendet e së drejtës islamike, përmendim “Muhtasib”, “Hisbah”, “Diwan al-Mazalim”, etj.<sup>145</sup>

Ombudsmani klasik i takon një periudhe të mëvonshme, kur mbreti suedez Karli XII, krijoi në vitin 1713, Zyrën e Ombudsmanit Suprem, ndërkohë që vonë, në vitin 1719, ky institucion u shndërrua në Këshilluesin e Drejtësisë. Në rrjedhën e tyre historike shumë prej këtyre institucioneve u shndërruan në instrumente me pushtet të dukshëm, ndërkohë që një pjesë tjetër u dobësua deri në nulizim. Ombudsmani Parlamentar i Suedisë, i njohur ndryshe si modeli klasik, u krijua në vitin 1809, nga Parlamenti Suedez. Ky model u ndoq fillimisht nga vendet Skandinave<sup>146</sup> dhe më pas u adoptua në mbarë botën.

Koncepti i Ombudsmanit në vitet 50’, ka qenë praktikisht i panjohur në pjesën më të madhe të vendeve të botës, ndërkohë që sot ai është gjerësisht i përdorur, përfshirë këtu edhe shumë institucione ndërshtetërore.<sup>147</sup> Instituti i ri i Ombudsmanit, i funksionarit të cilit i besohet mbikqyrja dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, u vendos që nga fillimet e viteve 90’ të shekullit të kaluar në demokracitë e reja që u krijuan në vendet e Europës Lindore, pas shembjes së regjimeve komuniste.<sup>148</sup>

Mungesa e traditës, e kushtëzuar nga një sërë faktorësh politikë, ekonomikë, socialë, si edhe gjeopolitikë, evidenton mungesën e një institucioni të ngjashëm me Ombudsmanin deri në historinë e vonëshme të shtetit shqiptar. Traumata sociale që ndodhën në Shqipëri, gjatë 10 viteve të parë të tranzicionit, si pasojë e ndryshimit të sistemit politik, duhet thënë për hir të së vërtetës, nuk mundën të menaxhoheshin me përgjegjshmëri nga institucionet tradicionale të shtetit. Për këtë arsye mesazhi i komunitetit ndërkombëtar i pranishëm dhe me ndikim të madh në vend ishte i qartë: jo më ndihmë ekonomike për mbijetesë, jo më ndihma financiare të pakushtëzuara ndaj qeverive shqiptare, por programe zhvillimi për ngritjen dhe forcimin e institucioneve të reja demokratike të shtetit shqiptar.<sup>149</sup>

---

<sup>145</sup> Palla W., (2002): “Gli organi di controllo e di ricevimento delle proteste dall’antichità fino al sinonimi nel presente, passando attraverso l’ombudsman della Scandinavia”, Edizioni Athesia, Bolzano, 2002, Nr.45 (1), faqe 5-12.

<sup>146</sup> Po aty, faqe 15-17. Finlanda në Kushtetutën e 17 Korrikut 1919, parashikon figurën e Ombudsmanit. Danimarka parashikoi për herë të parë institucionin e Ombudsmanit në ndryshimin që iu bë Kushtetutës Daneze, më 5 Qershor 1953. Në Norvegji, u krijuan fillimisht nga ana e parlamentit në 21 Prill 1952, Ombudsmani për forcat e armatosura, dhe në 22 Qershor 1962 edhe Ombudsmani për administratën.

<sup>147</sup> Neni 138E i Traktatit të Mاستrihtit (Maastricht Treaty), krijoi institucionin e Ombudsmanit Europian, me kompetencën e marrjes së ankesave dhe kryerjes së hetimeve mbi institucionet, apo organet e Bashkimit Europian.

<sup>148</sup> Omari L., (2004): “Shteti i së Drejtës”- botim i dytë, Shtëpia botuese “Elena Gjika”, viti 2004, faqe 304.

<sup>149</sup> Institucioni i Avokatit të Popullit-Avokati i Popullit në Shqipëri në 10 vjet veprimtari-viti 2009, Tiranë, faqe 5.

Në këto kushte, si bazë juridike për krijimin e institucionit të AP, shërbeu Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me referendum më 28 Nëntor 1998. Në Shkurt të vitit 1999, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i cili deri tani ka pësuar disa shtesa dhe ndryshime. Ky institucion ka krijuar tashmë fizionominë e tij që e dallon nga një sërë institucionesh të reja të krijuara në vend, në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Duke patur parasysh se çfarë parashikon legjislacioni shqiptar, duke patur parasysh edhe përputhshmërinë e këtij të fundit me legjislacionin Europian, duke patur parasysh edhe angazhimet e marra nga Shqipëria për t’u asociuar dhe integruar në BE, themi se Avokati i Popullit, krahas organeve të tjera administrative, ka luajtur dhe po luan rol të madh në përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri.<sup>150</sup> Krahas Avokatit të Popullit, prej disa vitesh janë krijuar disa institucione të reja të mbrojtjes së të drejtave të njeriut siç, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale, miratuar në bazë të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 ”Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; Ombudsmeni i Prokurimeve, krijuar në bazë të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, krijuar në bazë të ligjit nr.10221 date 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, apo edhe Ombudsmeni i Taksapaguesve etj.

### **2.1.2 Baza ligjore për ngritjen dhe funksionimin e Avokatit të Popullit**

Ekzistenca dhe veprimtaria institucionale e AP mbështetet në bazën ligjore që mundëson krijimin, funksionimin dhe përcakton juridiksionin dhe kompetencat e tij. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,<sup>151</sup> është akti bazë normativ në këtë kuptim. Ndërkohë, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,<sup>152</sup> parasheh një dimension aktiv në kuadër të promovimit të të drejtave të njeriut, sidomos në veprimtarinë parandaluese në luftën kundër korrupsionit.

Megjithëse lufta kundër korrupsionit nuk përmendet qartë në mandatin e Ombudsmanit, ajo është pjesë e punës së tij gjatë monitorimit të veprimtarisë së administratës publike. Në frymën e Konventës së Kombeve të Bashkuara, kundër Korrupsionit, veprimtaria e Ombudsmanit përputhet me masat parandaluese ndaj këtij fenomeni. Në kapitullin 2, veçanërisht në nenet 7 dhe 8, që lidhen me sektorin publik dhe detyrave të përmendura në kuadër të parandalimit në Konventë, vërehet se shumë nga praktikat e Ombudsmanit në botë janë të qëlluara në këtë kuadër. Gjithashtu në nenin 8, të kësaj konvente thuhet se shtetet palë, kuptuar këtu edhe Ombudsmanin, duhet të promovojnë vlera që përçojnë standarde dhe respektojnë të drejtën për mirëadministrim.

---

<sup>150</sup> Dobjani E., (2016): “E drejta Administrative – Pjesa e Përgjithshme”, Botues “Emal”, viti 2016, faqe 275.

<sup>151</sup> Shih nenet 60-63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>152</sup> Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka ratifikuar me Ligjin nr.9492 datë 13.03.2006, Konventën e Kombeve të Bashkuara, kundër Korrupsionit.

Veprimtaria e AP, rregullohet nga Ligji nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.<sup>153</sup> Ky ligj organik parashikon se, AP veç detyrave të caktuara në dispozitat e tij mund të kryejë edhe detyra të tjera të caktuara në ligje të veçanta.<sup>154</sup> Veprimtaria në fusha specifike njeh si bazë rregullatore aktet normative, sikurse ligji që i njeh këtij institucioni, cilësinë e Mekanizimit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të egër, ose poshtërues.<sup>155</sup> Parashikimi si një institucion i veçantë ku mund të drejtohen ankesat e konsumatorëve evidenton si bazë rregullatore edhe Ligjin nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.<sup>156</sup> Roli i kujdestarit,<sup>157</sup> për zbatimin e Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, tashmë të shfuqizuar, konstatonte një tjetër akt normativ në këtë kuptim.

Refoma në drejtësi pozicionoi Avokatin e Popullit si një institucion të besuar dhe realizues të procedurave paraprake, për fillimin e proceseve të përzgjedhjes së kandidatave, për krijimin e institucioneve të rëndësishme të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,<sup>158</sup> në Ligjin nr.84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Në veprimtarinë e tij, AP udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizimit dhe pavarësisë, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të individit. Pavarësia e institucionit është një tipar i garantuar, në radhë të parë tek parashikimi si institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutë. Në teorinë e së drejtës administrative është pranuar fakti që, parashikimi shprehimisht në Kushtetutë i organeve të caktuara shtetërore tregon për një qëndrueshmëri më të madhe të tyre, pasi të paktën teknikisht për çdo ndryshim që kërkohet në mënyrën e funksionimit të tyre, si në juridiksion apo kompetenca, është e nevojshme dhe duhet të realizohet procedura e votimit me shumicë të cilësuar dhe jo me shumicë të thjeshtë, në Kuvendin e Shqipërisë.

Tipar themelor i AP është pavarësia nga Qeveria dhe nga çdo ndikim politik. AP në Shqipëri, ofron oponencë për mirëqeverisje, por nuk është në opozitë me Qeverinë. Ky është thelbi i filozofisë së funksionimit të këtij institucioni. Ky parim garantohet në kriteret

---

<sup>153</sup> Në Shkurt të vitit 1999, Kuvendi miratoi Ligjin Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”. Kurse me Ligjin 8600 datë 10.04.2000, bëri një plotësim në nenin 35 të këtij ligji me qëllim që të mbronte pavarësinë e tij nga Qeveria. Pas thujtjes pesë vitesh veprimtari, me propozim të një grupi deputetësh, më 12 Maj 2005, me ligjin nr.9398, Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për Avokatin e Popullit”, duke forcuar më shumë kompetencat e tij. Ajo që është për t’u evidentuar në lidhje me objektin e veprimtarisë së këtij institucioni, është se në ligjin organik të tij, specifikohet rrethi i subjekteve, të cilët janë nën juridiksionin e këtij ligji, ku veç administratës publike, përfshihen administrata e pushtetit gjyqësor dhe “të tretët që veprojnë për llogari të saj”. Ndryshime dhe shtesa i janë bërë këtij ligji edhe me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.155/2014.

<sup>154</sup> Shih paragrafin 3, të nenit 2, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

<sup>155</sup> Shih Ligjin nr.9888 datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të ndryshuar.

<sup>156</sup> Shih gërmën “c”, të nenit 56, të Ligjit nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

<sup>157</sup> Shih nenin 18, të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

<sup>158</sup> Shih pikën 3, të nenit 149/d, pikën 11, të nenit 179, dhe pikën 6, të nenit C, të Aneksit-Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

e zgjedhjes së AP, kohëzgjatjes së mandatit të tij, imunitetit që gëzon pas zgjedhjes në detyrë, si dhe kriterëve të shkarkimit të tij nga detyra.<sup>159</sup> Garanci e kësaj pavarësie është ndalimi që i bëhet AP gjatë ushtrimit të detyrës së tij, për të mos bërë pjesë në asnjë parti politike, për të mos kryer veprimtari tjetër politike, shtetërore ose profesionale dhe për të mos marrë pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare, me përjashtim të ushtrimit të së drejtës së autorit dhe të mësimdhënies.<sup>160</sup>

Element shumë i rëndësishëm i kësaj pavarësie është raporti i vendosur mes këtij institucioni dhe Kuvendit të Shqipërisë.<sup>161</sup> Një specifikë e kësaj marrëdhënieje del nga fakti se, AP ka buxhet të veçantë që e vetadministron, të cilin e propozon në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, për t'u paraqitur më pas për miratim në Kuvend, në përputhje me Ligjin nr.8379 datë 29.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit". Po kështu, përcaktimi i strukturës dhe organikës së zyrës, si kompetencë e AP është një element ligjor i cili garanton pavarësinë e tij.<sup>162</sup>

Dy tiparet e tjera paanësia dhe profesionalizmi janë të lidhura ngushtë midis tyre, në kuadrin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Përzgjedhja e kriterëve profesionale për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, të Komisionerëve dhe fakti që personeli i Avokatit të Popullit, bën pjesë në shërbimin civil, flet për një kuadër ligjor që garanton profesionalizmin dhe paanësinë e këtij institucioni.

Tregues i garantimit ligjor të paanësisë dhe profesionalizmit njëkohësisht është kompetenca diskreciale që ligji "Për Avokatin e Popullit", i jep këtij të fundit për të filluar shqyrtimin e çështjeve të caktuara me inisiativën e tij, ose e njohur ndryshe si "ex-officio". Ndër procedurat që ndiqen për shqyrtimin e një çështjeje janë edhe ndërmarrja e proceseve të hetimit duke kërkuar shpjegime, si nga organet e administratës, ashtu edhe nga prokuroria; kërkimi i informacioneve apo dokumentave sekrete, hyrja dhe inspektimi në çdo kohë i organeve të administratës publike, burgjeve, ambienteve të paraburgimit, spitaleve, azileve, shtëpive të fëmijës dhe e çdo vendi tjetër, ku ka të dhëna se ekziston shkelje e të drejtave të njeriut etj.

Parimi i konfidencialitetit gjen shprehjen e tij direkte, në paragrafin e dytë të nenit 12, të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet që: "Avokati i Popullit duhet të ruajë fshehtësinë nëse e sheh të arsyeshme, si dhe nëse kjo kërkohet nga personi që bën ankesën, kërkesën apo njoftimin". Aplikimi i këtij parimi por edhe i parimeve të tjera të analizuara më sipër,

---

<sup>159</sup> Në nenet 61 dhe 62, të Kushtetutës dhe më specifikisht në nenet 3-9, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, janë të përcaktuara të gjitha kriteret e zgjedhjes dhe shkarkimit të AP. Mandati i tij 5 vjeçar, tejkalon mandatin e vetë anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, që e zgjedhin në detyrë. Ndërkohë A.P gëzon imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe paga e tij barazohet me atë të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

<sup>160</sup> Këto parashikime bëhen në nenin 61/4, të Kushtetutës, si dhe në nenin 10, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

<sup>161</sup> Avokati i Popullit është i detyruar që të paraqesë përpara Kuvendit të Shqipërisë, raportin vjetor të veprimtarisë së tij, apo të raportoje para tij kur kjo gjë i kërkohet nga Kuvendi, si dhe t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme. Këto parashikime bëhen në nenin 63/1/2 të Kushtetutës, si dhe në nenet 23, 26 dhe 27, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar

<sup>162</sup> Shih nenin 35, paragrafi i dytë, i Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

gjen rregullimin e tij në aktet nënligjore që janë kompetencë e AP, siç edhe Rregullorja e Brendshme, apo Kodi Etik, i institucionit të AP.

Përtej mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve nga padrejtësitë dhe abuzimet e administratës ose të nëpunësit publik, AP zhvillon atë që quhet *kultura e qeverisjes së mirë*, që do të thotë administrim i mirë, çiltërsi, transparencë dhe llogaridhënie e administratës publike.<sup>163</sup> Mjeti ligjor kryesor i këtij institucioni mbetet rekomandimi, i cili me ndryshimet që ka pësuar Ligji “Për Avokatin e Popullit”, paraqitet si një akt zyrtar me efekt pezullues.<sup>164</sup> Kuadri ligjor garanton funksionimin e AP, si një institucion kombëtar në mbrojtje të të drejtave të njeriut, në përputhje me Parimet e Parisit dhe përbën garanci për mbrojtjen dhe respektimin e së drejtës së informimit.

### **2.1.3 Roli i Avokatit të Popullit për mbrojtjen e së drejtës për informim**

Një nga tiparet më të rëndësishme të demokracive perëndimore është garantimi i të drejtave themelore, përmes funksionimit dhe respektimit të shtetit të së drejtës dhe zbatimit të parimit të së drejtës. Konsolidimi i shtetit të së drejtës në Shqipëri është një proces i lidhur pazgjidhshmërisht me afirmimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe krijimin e instrumentave juridikë institucionalë, garantë për ushtrimin e tyre efektiv.

E drejta për informim dhe AP përfaqësojnë eksperiencën të reja konceptuale dhe ligjore për shoqërinë tonë, në kuadër të regjimeve juridike dhe institucioneve garantuese kushtetues të të drejtave të njeriut, që rregullojnë dhe monitorojnë marrëdhëniet jetike për demokraci të reja në zhvillim dhe në procese integruese, ku standardet ndërkombëtare luajnë një rol orientues, pozitiv dhe evolues. Eksperiencat ekzistuese në marrëdhënien ndërmjet të drejtës për informim dhe AP në Shqipëri, nuk mund të mbeten jashtë kuadrit zhvillimor standardizues ndërkombëtar, sikurse nuk mund të konsiderohen të mirëpërcaktuara dhe të pandryshueshme, për shkak të specifikës që paraqet realiteti shqiptar.

Kjo lidhje natyrale ndërmjet tyre kërkon jo vetëm veprim reaktiv institucional, por edhe një reagim konceptual zhvillimor për regjimin juridik të së drejtës për informim dhe të mënyrës bazike dhe proaktive të funksionimit të institucionit të Avokatit të Popullit. Në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, Ligji “Për Avokatin e Popullit”, por në veçanti Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, i ngarkonin AP misionin e veçantë të kujdestarit të zbatimit dhe respektimit të së drejtës për informim nga ana e administratës publike, një rol ky që merr kuptimin e një mbikqyrjeje të përgjithshme tashmë, me hyrjen në fuqi të Ligjit “Për të drejtën e informimit”.

---

<sup>163</sup> Avokati i Popullit në Shqipëri-Botim i Institucionit të Avokatit të Popullit, botim i dytë, Tiranë, viti 2003, faqe 9.

<sup>164</sup> Në nenin 21, të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ndër të tjera parashikohet se paraqitja e rekomandimeve pezullon aktet ose veprimet e parregullta, deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit. Mosshqyrtimi i rekomandimit brenda 30 ditëve pezullon aktet, ose veprimet e paligjshme, e të parregullta.

Veprimtaria e institucionit në këtë fushë deri para hyrjes në fuqi të Ligjit “Për të drejtën e informimit”, ka qënë e orientuar në këto drejtime kryesore; observim i zbatimit të ligjit që garanton ushtrimin efektiv të së drejtës për informim, kjo si nëpërmjet shqyrtimit të çështjeve konkrete, apo edhe nëpërmjet rekomandimeve me natyrë përgjithësuese drejtuar organeve të administratës publike; promovim i së drejtës së informimit dhe zbatim konkret i kësaj të drejte nga vetë institucioni.

Për këtë qëllim ka shërbyer, organizimi i Konferencës Kombëtare “E drejta e informimit, e drejtë themelore e njeriut”, në Dhjetor të vitit 2002, nga ana e Institucionit të AP. Konferenca, synoi të rrisë ndërgjegjësimin e administratës publike në nivel qendror dhe vendor për të drejtat dhe detyrimet e saj, gjatë kryerjes së funksioneve të njohura me ligj, me qëllim që puna e nëpunësve civil të orientohet drejtë dhe t’i garantojë palëve pjesëmarrëse në procedurat administrative, jo vetëm shërbim të kualifikuar, por dhe një qëndrim korrekt, për realizimin e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individëve. Konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, që dolën gjatë punimeve të saj, i janë dërguar organeve të administratës qendrore dhe vendore, të shoqëruar me një kalendar të vitit 2003, i cili në çdo fletë të tij ka patur të cituar nga një nen të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Gjatë viteve 2000-2017, nga ana e AP, rezulton të jenë marrë në shqyrtim për problematikën që lidhet direkt me të drejtën e informimit, 781 ankesa, apo kërkesa. Çështjet të cilat janë shqyrtuar nga ana e tij lidhur me të drejtën e informimit, mund të kategorizohen në;

- Çështje që kanë objekt të drejtëpërdrejtë shkeljen e së drejtës për informim.
- Çështje që për nga shqyrtimi i kryer rezulton se, veç konsatimeve të tjera ekziston edhe shkelje e së drejtës për informim.

Kjo shkelje ka rezultuar në mosdhënien e dokumentacioneve zyrtare të ndryshme, të kërkuara nga subjektet e interesuara, apo mosinformim lidhur me informacionet, të cilat duhet të jepen pa kërkesën e personave të interesuar, gjë që ka sjellë shkelje të të drejtave të tjera të ligjshme. Lidhur me këtë grupim nuk mund të përmendet një numër i saktë, pasi këto çështje janë shqyrtuar në kuadrin e një objekti tjetër. Një veçori e vërejtur në praktikën e punës për shqyrtimin e këtyre çështjeve nga AP është se, zgjidhja pozitive në shumë raste është realizuar përmes procesit të ndërmjetësimit, pa qënë nevoja e dërgimit të rekomandimeve përkatëse.

Çështjet e shqyrtuara për shkelje të së drejtës për informim, kanë nxjerrë në pah edhe problematikën e zbatimit të ligjit në administratën publike, nga e cila konstatohet se:


- Nuk janë zbatuar afatet ligjore për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion, qoftë për refuzimin, apo edhe për përmbushjen e tyre.
- Legjislacioni mbi të drejtën e informimit, njihet pjesërisht dhe në nivel jo të kënaqshëm nga administrata publike dhe për më tepër, ai nuk zbatohet korrektësisht.

Megjithatë gjykoj se, pavarësisht punës konkrete që është bërë në lidhje me çështjet përkatëse në këtë fushë, duhet kuptuar fakti se vetë procesi i shqyrtimit të çështjeve në tërësi, nga ana e AP dhe informimi që i bëhet ankuesve, apo kërkuesve që i drejtohen atij,

rast pas rasti, në thelb përbën realizim direkt të së drejtës për informim ndaj individit. Pra, në thelb, veprimtaria e këtij institucioni mbart realizimin efektiv të së drejtës për informim.

Për një vlerësim të numrit të çështjeve dhe shpërndarjes së tyre në vite, shërben grafiku i dhënë më poshtë: (*shih Grafikon 1*)

**Grafiku 1**



Lidhur me rregullimin që i bën KPrA, të drejtës për informim, nga çështjet e marra në shqyrtim prej AP rezulton se, nga ana e administratës publike nuk është respektuar dhe zbatuar kjo e drejtë gjatë zhvillimit të procedurës administrative, ndaj atyre subjekteve që kanë patur një interes të drejtëpërdrejtë, ose të ligjshëm në këtë procedurë.

Veprimtaria e AP, ka qënë aktive në kuadër të mbrojtjes dhe garantimit të së drejtës për informim, duke u konkretizuar me hapa konkrete në këto drejtime:

- Fillimi i veprimtarisë së AP është paraprirë nga futja në fuqi e Rregullores së Brendëshme të funksionimit të institucionit, si dhe të Kodit të Etikës, të cilët sanksionojnë elementë të rëndësishëm të transparencës ndaj publikut.<sup>165</sup>
- Që në vitin 2000, me anë të një rekomandimi drejtuar gjithë organeve të administratës publike është kërkuar nxjerrja e rregulloreve dhe të të gjitha akteve të tjera në zbatim të nenit 6, të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Rekomandimi është përsëritur nga ana e AP, në vitin 2001, 2002 dhe 2006, për shkak të mangësive të vërejtura në këtë drejtim.
- Ngritja e zyrës të pritjes së qytetarëve, sot Zyra për Marrëdhëniet me Publikun dhe Informimin. Kjo zyrë është ngritur që në fillim të vitit 2001, e emërtuar fillimisht si zyra e pritjes së qytetarëve me qëllim informimin e tyre, për kompetencat dhe punën e

<sup>165</sup>AP ka rishikuar dhe përmirësuar me kalimin e kohës këto akte nënligjore, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe transparencës në veprimtarinë e tij.

institucionit, sikurse edhe të realizimit të kontaktit të parë me ankuesit që i drejtohen këtij institucioni.

- Është realizuar një cikël spotesh dhe një dokumentar i shkurtër, mbi kuptimin dhe pasqyrimin e punës së institucionit, të cilët janë shfaqur në televizionet kombëtare, por edhe në një shumicë të televizioneve lokale, ku një vend të rëndësishëm ka zënë spoti për të drejtën e informimit. Jo pa qëllim, logoja e institucionit ka qënë “Avokati i Popullit, në shërbimin tuaj”. Prej kohësh janë përgatitur dhe shpërndahen fletë-palosje, nëpërmjet të cilave publiku informohet, jo vetëm për punën e institucionit por edhe për të drejtat që gëzon çdo individ, përfshirë këtu të drejtën për informim.
- Krijimi dhe përditësimi krijues i faqes zyrtare të AP në internet, ku mund të gjenden informacione të larmishme dhe shumë të vlefshme për punën e këtij institucioni,<sup>166</sup> si dhe realizimi ndër vite, i botimeve të ndryshme me natyrë promovuese mbi të drejtat e njeriut.<sup>167</sup>
- Gjatë gjithë kësaj kohe, është zhvilluar një pjesëmarrje e gjerë në të gjitha takimet, aktivitetet, apo tryezat e organizuara nga aktorë të ndryshëm, lidhur me të drejtën e informimit, si nga vetë AP, ashtu edhe nga përfaqësues të këtij institucioni. Organizimi dhe pjesëmarrja e AP dhe e shumë përfaqësuesve të këtij institucioni, në takime apo debate të ndryshme televizive, gjithmonë ka qënë në funksion të informimit të publikut. Bashkëpunimi me median është parë si një përparësi afatgjatë, jo vetëm për promovimin e punës, por në veçanti si një mjet informimi dhe presioni pozitiv ndaj organeve të administratës publike.
- Nuk ka munguar dhe vazhdon bashkëpunimi me OJF-të në trajnimet që organizohen prej tyre, për të drejtën për informim, duke marrë pjesë direkte me specialistë të institucionit në rolin e trajnuesit. Bashkëpunimi me OJF-të në kuadër të respektimit dhe mbrojtjes të të drejtës për informim, është zhvilluar dhe vazhdon të zhvillohet në kuadër të projekteve të përbashkëta që kanë ndikim në promovimin e kësaj të drejte.<sup>168</sup>
- Trajtimit të kërkesave për informacion dhe kopje dokumentash zyrtare, iu është dhënë prioritet, duke i përmbushur në afate shumë të shkurtra kohore dhe natyrisht falas. Një sërë dokumentash zyrtare janë në dispozicion dhe të aksesueshme pa kërkesë nga publiku, në çdo kohë.

---

<sup>166</sup> Website: [www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

<sup>167</sup> Të tilla janë botimi “Avokati i Popullit në Shqipëri” i vitit 2003, “Të drejtat e punonjësve” i vitit 2004, apo botimi “Të gjithë së bashku në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve” i vitit 2005, si dhe botimi që iu është shpërndarë të burgosurve shtetas shqiptarë, që kryejnë dënime penale në vende të tjera, me titull “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve jashtë Shqipërisë”.

<sup>168</sup> Një nga projektet ka qënë ai i realizuar në vitin 2007, në bashkëpunim me projektin e USAID, “Për shtetin ligjor në Shqipëri” dhe me Institutin për Studime Politike dhe Ligjore, për hartimin e një draft rregulloreje për të drejtën e informimit. Po kështu, gjatë viteve 2012-2016, në kuadër të një projekti të Qeverisë Daneze për rritjen e kapaciteteve të institucionit të AP, janë zhvilluar trajnime me nëpunës publikë të organeve të qeverisjes vendore në të gjithë vendin.



Një kërkesë permanente në veprimtarinë e AP, ka qënë nxjerrja e një rregulloreje të brendshme tip për të drejtën e informimit, nga organet e administratës publike, e cila do të shërbente si përcaktuese e mënyrës së organizimit të punës, për funksionimin sa më të mirë të administratës dhe për një komunikim transparent dhe të lehtësuar me publikun. Studime të kryera nga OJF që veprojnë në këtë fushë,<sup>169</sup> kanë theksuar nevojën e konceptimit dhe hartimit të një rregulloreje të tillë. Në këto kushte, AP në bashkëpunim me projektin e USAID, “Për shtetin Ligjor në Shqipëri” dhe me Institutin për Studime Politike dhe Ligjore, ka hartuar një projekt rregullore që do t’i shërbente këtij qëllimi.<sup>170</sup> Në këtë rregullore tip, gjejmë risi në lidhje me përshkrimin e nominuar të organeve që përfshin termi “Administratë Publike”, dhënien e përkufizimit për “dokumentin zyrtar”, përcaktimin e saktë të rasteve të kufizimit të së drejtës për informim, konceptimin e ri për “zyrat për marrëdhëniet me publikun dhe informimin”, si dhe për përcaktimin e procedurave për trajtimin e kërkesave për informim.

Ndër synimet e tjera rregullatore të saj mund të përmendet se ajo ka për qëllim që; të nxisë organet e administratës publike që të krijojnë infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e ligjit; të ndërgegjësojë këto organe për detyrimin e zhdëmtimit të subjekteve në rastet e vërtetuara të shkeljes të së drejtës për informim; të aplikojë formularët model si një mënyrë efektive për respektimin e afateve ligjore; të sigurojë aksesin e publikut; të unifikojë rrugën procedurale që ndjekin kërkesat për informim dhe të sigurojë zbatimin e ligjit, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe transparencës së organeve të administratës publike. Risitë e kësaj rregulloreje lidheshin me:

- *Kuptimin e termit “dokument zyrtar”.*

Përcaktimi i dhënë në këtë rregullore tip është një përpjekje serioze për të dhënë një përkufizim të termit “dokument zyrtar”, për të lehtësuar në këtë mënyrë kuptimin dhe zbatimin e ligjit, nga ana e administratës publike. Megjithatë më i gjerë në përcaktim, ai vjen në të njëjtë linjë me përkufizimin e dhënë në Konventën e KE, “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso.<sup>171</sup>

---

<sup>169</sup> Studimi i Qendrës së Studimeve Parlamentare, në vitin 2005, me objekt “Monitorimi mbi zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, në institucionet qendrore shtetërore”. Sipas këtij studimi të kryer në 20 institucione qendrore të monitoruara rezultoi se, vetëm 2 institucione kishin miratuar rregullore të veçanta për të drejtën e informimit, por në to nuk përcaktoheshin rregulla të detajuara për realizimin e kësaj të drejte, madje njëra nga rregulloret kufizonte parashikimet ligjore. Gjithashtu, nuk kishte një unifikim të praktikës së punës dhe të emërtesës së zyrave që kryenin shërbimin e marrëdhënies me publikun.

<sup>170</sup> Rekomandimi me anë të të cilit është rekomanduar miratimi i rregullores tip, për të drejtën e informimit, gjendet në Website: [www.avokatipopullit.gov.al/Rekomandime/Rekomandime%202007.htm](http://www.avokatipopullit.gov.al/Rekomandime/Rekomandime%202007.htm)

<sup>171</sup> Në përkufizimin e dhënë në nenin 4, të rekomandimit nr.177 datë 13.06.2006, të AP, “Për miratimin e rregullores tip për të drejtën e informimit (RTDI)”, thuhet se:

“Me termin “dokument zyrtar” për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të kuptohet çdo dokument, pavarësisht nga forma e regjistrimit (shkresore, elektronike, filmike, fotografike etj), i cili:

-Përpilohet nga organi, në përputhje me ligjin nr.9154 datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, “Norma Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”,

-Merret nga organi, në kuadrin e korrespondencës me organet e tjera dhe regjistrohet në formën e dokumentit hyrës në regjistrin e korrespondencës, në përputhje me ligjin “Për arkivat” dhe Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave,

- *Trajtimin e përshpejtuar të kërkesave për informim.*

Në rregulloren tip është synuar që të vihet në lëvizje mekanizmi i diskrecionit që ligji i njeh organeve të administratës publike,<sup>172</sup> për përmbushjen e kërkesave për informim, brenda afateve të përcaktuara në nenet 11 dhe 12, të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

- *Zyrat për marrëdhëniet me publikun dhe informimin.*<sup>173</sup>

Unifikimi i emërtesës së këtyre zyrave, ka qenë hapi i parë në këtë drejtim, pasi eksperiencia në organe të ndryshme të administratës publike, njëjtte emërtesa nga më të ndryshmet. Njëkohësisht nëpërmjet kësaj emërtese është tentuar që në fillim, të ndahej roli i zëdhënësit nga ai i punonjësit që kujdesej për zbatimin dhe respektimin e së drejtës për informim.<sup>174</sup> Në këto parashikime jepeshin shprehimisht edhe detyrat që kanë sektorët e kësaj zyre, ku sektori i marrëdhënieve me protokoll arkivat dhe strukturat e brendshme, realizon kërkimin dhe gjetjen në mënyrë manuale dhe elektronike, të dokumentacionit të specifikuar në kërkesën për informim.

- *Protokollimi i veçantë i kërkesave për informim.*

Në rregulloren tip parashikohet krijimi i një regjistri të veçantë, ku do të regjistroheshin sipas rregullave të protokollimit, kërkesat për informim. Sipas nenit 10, të rekomandimit nr.177 date 13.06.2006 të AP, “Për miratimin e rregullores tip për të drejtën e informimit (RTDI)”, regjistri kryen dy funksione. I pari lidhet me dhënien përparësi të trajtimit të kërkesave për informim, ndaj kërkesave të një natyre tjetër që paraqiten në organet e administratës publike, duke iu përcjellë drejtëpërdrejtë sektorit përkatës që i përket të sigurojë përgjigje për to. Nga ana tjetër, ky regjistër mund të vihet në dispozicion të

---

-Dërgohet nga organi, në kuadrin e korrespondencës me organet e tjera dhe regjistrohet në formën e dokumentit dalës në regjistrin e korrespondencës në përputhje me ligjin “Për arkivat” dhe Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave,

-Administrohet në çfarëdo mënyre tjetër nga organi,

-Në kuptimin e termi “dokument zyrtar”, për qëllimet e rregullores përfshihen edhe të dhënat e disponuara nga subjektet private dhe që janë rezultat i punës kërkimore-shkencore të financuar nga secili prej organeve të përcaktuara në nenin 2, të kësaj rregulloreje (organet e nominuara të Administratës Publike).

<sup>172</sup> Sipas përcaktimit të dhënë në nenin 7, të rekomandimit nr.177 date 13.06.2006, të AP, “Për miratimin e rregullores tip për të drejtën e informimit (RTDI)”, ky diskrecion synon të realizojë përmbushjen e kërkesave të caktuara, me përparësi ndaj kërkesave të tjera të paraqitura në rastet;

“- kur kërkuesi argumenton se mosmarrja në kohë e të dhënave do t’i shkaktonte atij një dëm të pariparueshëm në gëzimin e të drejtave themelore;

-kur kërkuesi është punonjës i mjeteve të informimit publik dhe argumenton për nevojën që publiku të informohet urgjentisht në lidhje me një problem të caktuar”.

<sup>173</sup> Struktura e përcaktuar për këto zyra në nenin 9, të rekomandimit nr.177 datë 13.06.2006, të AP, “Për miratimin e rregullores tip për të drejtën e informimit (RTDI)”, njeh dy sektorë, atë të marrëdhënieve me publikun dhe sektorin e marrëdhënieve me protokoll arkivat dhe strukturat e brendshme të organeve të Administratës Publike.

<sup>174</sup> Qëllimet që synohet të arrihen përmes veprimtarisë së Zyrës për Marrëdhëniet me Publikun dhe Informimin, janë:

-zbatimi i parimit të transparencës të veprimtarisë administrative, të drejtës për akses në dokumentat zyrtare dhe informimi korrekt i publikut,

-vlerësimi sistematik i nevojave të publikut dhe nivelit të plotësimit të tyre, për shërbimet dhe bashkëpunimi për të përshtatur vazhdimisht faktorët që përcaktojnë cilësinë,

-propozimi i ndryshimeve për të favorizuar modernizimin e strukturave, thjeshtësimin e gjuhës, azhormimin me modalitetet që administrata i propozon publikut.

publikut në çdo kohë, duke përbërë kështu një tjetër mjet që siguronte transparencën në zbatimin e ligjit nga ana e organeve të administratës publike.

#### **2.1.4 Juridiksioni, kompetencat dhe mjetet ligjore të AP**

Mbikqyrja e veprimtarisë së sektorit të sigurisë e realizuar nga institucione të pavarura, të krijuara me ligj, përbën një pjesë funksionale dhe kryesore të qeverisjes demokratike së këtij sektori. Mbikqyrja e ushtruar nga këto institucione, e kordinuar me veprimtarinë e ekzekutivit dhe pushtetit gjyqësor, formëson sistemin “Check and Balance” në sektorin e sigurisë dhe ndikon në respektimin e parimeve të përgjegjshmërisë dhe transparencës në të. Marrëdhënia institucionale që krijohet në këtë rast është tre planëshe, pasi institucionet mbikqyrëse kontrollojnë dhe kërkojnë zbatimin e masave rregulluese nga gjetjet, u japin rekomandime institucioneve juridiksionale të sektorit të sigurisë, institucionet e sigurisë zbatojnë këto gjetje apo rekomandime, ndërkohë që, institucionet e pavarura të mbikëqyrjes raportojnë rregullisht para Kuvendit, sikurse ndodh edhe për një pjesë,<sup>175</sup> të institucioneve mbikëqyrjes.

Në vendin tonë institucionet mbikqyrëse të sektorit të sigurisë, veprojnë në drejtim të mbikëqyrjes të zbatimit të legjisllacionit që, garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të zbatimit të legjisllacionit mbi buxhetin, prokurimet dhe luftën ndaj korrupsionit.<sup>176</sup> AP zë një rol parësor në kuadrin mbikqyrës të sektorit të sigurisë, sa i përket mbrojtjes dhe respektimit, por edhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit, në veprimtarinë e këtij sektori. Ky rol natyrshëm dhe për shkak të detyrimit ligjor të raportimit në Kuvend, ndërthuret me mbikëqyrjen parlamentare ndaj sektorit të sigurisë.

Juridiksioni i AP, është hapësira brenda së cilës shqyrton çështje të ndryshme institucionale. Juridiksioni administrativ mandaton mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të individit, në kuadër të veprimtarisë së administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, me përjashtimet e parashikuara në ligj.<sup>177</sup>

AP ushtron veprimtarinë në bazë të ligjit të tij organik, sipas të cilit:

- Ka kompetencën diskreciale për të filluar shqyrtimin e çështjeve të caktuara “ex-officio”;<sup>178</sup>
- Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi që e ka kryer atë, apo tek organi epror, si dhe i rekomandon prokurorisë fillimin e hetimeve kur konstatohet konsumimi i nje vepre penale;<sup>179</sup>

---

<sup>175</sup> Aktualisht në Shqipëri, sipas legjisllacionit specifik SHISH dhe Prokurori i Përgjithshëm, kanë detyrimin e paraqitjes së një raporti mbi veprimtarinë e tyre vjetore, para Kuvendit të Shqipërisë.

<sup>176</sup> Mund të përmendim si institucione të pavarura mbikqyrëse, AP, KDIMDhP, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektoriatin e Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive.

<sup>177</sup> Shih paragrafin e parë, të nenit 2, dhe nenin 25, të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

<sup>178</sup> Po aty, neni 13.

<sup>179</sup> Po aty, gërmat “b”, “c” dhe “ç”, të nenit 21.

- Ka të drejtë, t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse,<sup>180</sup> të bëjnë propozime për ndryshimin e përmirësimin e ligjeve;
- T’u propozojë organeve të administratës ndryshimin, ose përmirësimin e akteve nënligjore, kur ai vëren se është vetë përmbajtja e ligjit apo e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre, shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut;<sup>181</sup>
- Pranon ankesa për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe procedurat gjyqësore;
- Vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e akteve normative, përmbajtja e të cilave përbën premisë për shkelje të të drejtave të njeriut;<sup>182</sup>
- Merr pjesë dhe ndihmon në përgatitjen e raporteve dhe dokumenteve të tjera, të hartuara nga shteti shqiptar, për të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe bashkëpunon me organizatat joqeveritare për marrjen periodikisht të mendimeve të tyre lidhur me gjendjen e të drejtave, si dhe për organizimin e veprimtarive kombëtare për këtë qëllim;<sup>183</sup>
- Përcakton strukturën dhe organikën e zyrës së AP.<sup>184</sup>

Mjetet e reagimit ligjor që aplikon AP, janë:

- a) Rekomandimi,
- b) Propozimi për shkarkimin e funksionarëve,<sup>185</sup>
- c) Kërkesa për marrje masash disiplinore,<sup>186</sup>
- d) Propozimi për ndryshim apo përmirësim të ligjeve,
- e) Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese,
- f) Kërkesat për t’u dëgjuar në Kuvendin e Shqipërisë për probleme të ndryshme,
- g) Raportet Vjetore dhe Raportet e Veçanta, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë,<sup>187</sup>
- h) Ndërhyrjet “Amicus Curiae” drejtuar gjykatave.

Të gjitha këto mjete ligjore kanë rëndësinë e tyre specifike dhe në fund të fundit janë çështje e diskrecionit të AP, për shfrytëzimin e tyre në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankesave, kërkesave apo njoftimeve që i drejtohen atij. Një rëndësi të veçantë marrin gjatë kësaj veprimtarie çështjet e filluara me inisiativë, apo të njohura ndryshe si çështjet “ex-officio”.

<sup>180</sup> Referenca këtu bëhet në kuptim të pikës 1, të nenit 81, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku ndër të tjera, të drejtën për të propozuar ligje e ka edhe Këshilli i Ministrave, si organ që përfshihet në juridiksionin e AP.

<sup>181</sup> Shih gërmat “a” dhe “b”, të nenit 24, të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

<sup>182</sup> Sipas parashikimit të bërë në nenin 134/2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e amenduar në vitin 2016, vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese nga ana e AP, nuk kushtëzohet më vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij.

<sup>183</sup> Shih nenet 29 dhe 30, të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

<sup>184</sup> Po aty, paragrafet 1 dhe 2, të nenit 35.

<sup>185</sup> Po aty, gërma “d”, e nenit 21.

<sup>186</sup> Po aty, neni 22/1.

<sup>187</sup> Po aty, nenet 23, 26 dhe 27.

### 2.1.4.1 Ndërrhyrjet “Amicus Curiae”

Duke u ndalur veçanërisht tek ndërrhyrjet “Amicus Curiae”, duhet të bëhet një trajtim më specifik dhe i zgjeruar i kupimit të konceptit të këtij mjeti ligjor, që sot po luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm, në çështjet e debatueshme mbi respektimin e të drejtave të njeriut. Aplikimi i ndërrhyrjes “Amicus Curiae” dhe trendi në rritje i lejimit të ndërrhyrjeve të këtij lloji, përballet sot me pikëpamje të debatueshme mbi origjinën historike dhe kuptimin e tij.

Kjo ndodh kur numri i ndërrhyrjeve “Amicus Curiae”, si dhe kur numri i opinionëve të paraqitura prej tyre, të njohura ndryshe si “Amicus”, është rritur në mënyrë graduale dhe të qëndrueshme me kalimin e kohës. Aktualisht kjo lloj pjesëmarrje procedurale ka gjetur përhapje në nivel të gjykatave kombëtare, por edhe të gjykatave ndërkombëtare, për çështje që lidhen më të drejtat e njeriut. Për më tepër zhvillimi i konceptit dhe aplikimit të ndërrhyrjes “Amicus Curiae” ka tendencën të mos ngelet në kuadër të përkufizimeve të tij klasike, por të ketë një natyrë dinamike dhe të shfaqet edhe në procedurat e zhvilluara nga institucione të ndryshme, nga gjykatat.

Në ditët e sotme ndërrhyrja “Amicus Curiae”, pranohet nga shumica e gjykatave ndërkombëtare. Megjithëse, procedura për ndërrhyrje në këtë cilësi është e ndryshme në secilën prej këtyre gjykatave, instrumenti i pjesëmarrjes “Amicus Curiae” pranohet si i tillë, nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Gjykata Inter-Amerikane e të Drejtave të Njeriut, nga mekanizmi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në Organizatën Botërore të Tregtisë, Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve dhe Arbitrazhi i Traktatit Ndërkombëtar të Investimeve.<sup>188</sup> Megjithëse kjo procedurë do ende të “zërë rrënjë”, ajo po shfaqet gjithnjë e më shumë në procedurat ndërkombëtare të arbitrazhit, si ato të Organizatës Botërore të Tregtisë (WTO), Marrëveshjes së Lirë të Tregtisë Amerikano Veriore (NAFTA) dhe Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit (ICSID). Mbi këtë bazë po parashikohet se, paraqitja e opinionëve “amicus curiae” do të bëhet një praktikë universale në të ardhmen.<sup>189</sup>

Individët dhe organizatat joqeveritare të të drejtave të njeriut, në Europë dhe kontinentin Amerikan, kanë shfrytëzuar konceptin e “Amicus Curiae”, si një mekanizëm për pjesëmarrje dhe formësim të gjykimit të të drejtave të njeriut, para Gjykatës Europiane të të drejtave të Njeriut dhe Gjykatës Inter-Amerikane të të Drejtave të Njeriut. Edhe në kontinentin Afrikan, kjo praktikë po zhvillohet me të njëjtin trend.

“Amicus Curiae”, është një instrument praktik ligjor dhe efektiv ndërrhyrës i subjekteve të interesuara në rolin e “Amicus Curiae”, si palë të treta, pranë gjykatave kombëtare dhe ndërkombëtare, si pjesë e gjykimeve të shumëanshme të çështjeve gjyqësore strategjike mbi të drejtat e njeriut. Në këtë këndvështrim vlen të analizohet se, ku ndodhet aktualisht aplikimi i kësaj ndërrhyrjeje në kontekstin e Shqipërisë dhe se, si mundet që kjo ndërrhyrje

<sup>188</sup> Levine A., “Amicus Curiae in International Investment Arbitration: The implications of an increase in third-Party participation”, Berkley Journal of International Law, viti 2011, Nr. 29, faqet 200-208.

<sup>189</sup> Gomez KF., (2012): “Rethinking the role of amicus in International Investment Arbitration: How to draw the Line Favorably for the Public Interest Litigation”, Fordham International Law Journal, viti 2012, Vol.n35, faqe 510.

të shërbejë si një instrument i vlefshëm, për respektimin dhe realizimin efektiv të të drejtave të njeriut.

a) *Kuptimi i termit “Amicus Curiae”.*

Kuptimi klasik gjendet në termin latin “Amicus Curiae”, që do të thotë “mik i gjykatës”. Në përdorim të përgjithshëm, termi përdoret si “Amicus”. Megjithatë ka qëndrime të ndryshme lidhur me origjinën e këtij termi.

Një prej këtyre qëndrimeve mbron argumentin se, “Amicus Curiae” ka origjinën nga fjala e vjetër romane “consilium” dhe është zhvilluar me kohë në kuadër të sistemeve ligjore, në kuptimin e një “miku të gjykatës”. Në praktikën e lashtë romake gjykatat lejoheshin të caktonin palë të treta si këshilltarë të pavarur, të cilët mund të sillnin informacion ligjor, apo faktues, mbi çështje pak të njohura. Besohet se kjo praktikë të jetë futur në sistemin Common Law, në shekullin e 14-të.<sup>190</sup>

Përkundër të parit, një qëndrim tjetër parashtron argumentin se, ky term e ka origjinën nga sistemi “common law” dhe është krijuar për të kapërcyer vështirësi të zbatimit të parimit të kontradiktorialitetit, përmes komplementimit të provave dhe fakteve nga “Amicus Curiae”. Pavarësisht qëndrimeve të ndryshme, pikëpamja e përgjithshme është se, origjina e këtij termi vjen nga e drejta romake. Opinioni i shkurtër i subjektit që luan rolin e “Amicus Curiae”, njihej në të Drejtën Romake dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në sistemin dhe traditën ligjore Angleze dhe atë Amerikane. Përdorimi i tij ka luajtur një rol të rëndësishëm në sistemin e të drejtës zakonore angleze që në shekullin e 15-të, si dhe ka njohur zhvillim të mëtejshëm në sistemin ligjor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Duke u zhvilluar dhe evoluar në kohë, kjo lloj ndërhyrjeje është prezente tashmë natyrshëm, që prej viteve 90’ pranë gjykatave ndërkombëtare. Megjithëse procedurat “Amicus” nuk përmbahen tradicionalisht në sistemet ligjore të së drejtës civile, në këto vende gjykatat po lejojnë gjithnjë e më shumë ndërhyrje të tilla.

Sot mund të gjenden përkufizime të ndryshme për “Amicus Curiae”. Mellinkoff’s Dictionary of American Legal Usage, përcakton se, ky mik i gjykatës është, “Dikush jo palë në çështje gjyqësore, por që zakonisht favorizon një prej palëve dhe që lejohet t’i bëjë një argumentim gjykatës”. Një përkufizim tjetër në vazhdim, përcakton se: “Amicus Curiae” është ai, që si një vrojtues, mund të informojë gjykatën kur një gjykatës është në dyshim, apo në gabim, për një çështje ligjore. Ai dëgjohet vetëm me leje dhe në ndihmë të gjykatës, mbi një çështje që i është parashtruar gjykatës...(praktika është), që të lejojë një avokat, apo një person tjetër, që të paraqitet si një mik i gjykatës në një çështje, për të vepruar si një këshillues i gjykatës dhe për të bërë sugjerime ...”.<sup>191</sup>

Në vazhdim mund të përmendim përcaktimin sipas të cilit, subjekti që ndërhyr në këtë cilësi është: “Person me interesa ose opinione të forta mbi objektin e një padie...që faktikisht sugjeron një arsytim në përputhje me pikëpamjet e veta. Një “Amicus Curiae”

<sup>190</sup> Gao HS., (2006): “Amicus Curiae in WTO Dispute Settlement: Theory and Practice”, China Rights Forum, viti 2006, Nr. 1, faqe 51.

<sup>191</sup> Quasi –Party In the Guise of Amicus Curiae, (Cumberland Law Review, Volume 7, 293 (1976-1977), faqe 294. Ky informacion gjendet në Website: <http://heionline.org>.

informon gjykatën mbi pikat e diskutueshme të ligjit, mbledh ose organizon informacionin apo ndërgjegjëson mbi disa aspekte të çështjes që, në të kundërt, gjykatës mund t'i shpëtonin...".<sup>192</sup> Një tjetër përkufizim është ai sipas të cilit, "Një "Amicus Curiae" mund të përshkruhet si një person apo entitet, që ka për qëllim të kontribuojë në procedurat ligjore, por pa u bërë "palë", në këto procedura".<sup>193</sup>

Ndërhyrja "Amicus Curiae" është parashtrimi i një eseje në një gjykatë, quajtur ndryshe "Opinion i shkurtër Amicus", i cili u jep gjyqtarëve një informacion të ri, apo një perspektivë të ndryshme, nga ajo që palët i kanë prezantuar gjyqtarit.<sup>194</sup> Ai është qëllimuar të jetë një metodë ku, një palë e tretë, pa interes të drejtëpërdrejtë në një çështje mund të citojë në interes të drejtësisë, rastet të cilat gjykata mund t'i anashkalonte.<sup>195</sup> Këto opinione të shkruara, që kanë të bëjnë me çështje ligjore të rëndësishme në gjykim dhe çështje të informacionit dokumentues, mund të paraqiten nga palë të treta me pëlqimin e gjykatës dhe pas konsultimit me palët. Parashtrimi i një ndërhyrjeje të tillë nuk nisët nga interesi i ngushtë i çështjes, por nga një interes shumë më i gjerë se sa ai, që paraqitet në çështjen konkrete.

#### *b) Mënyra e përdorimit*

Për të patur një ndikim maksimal në ecurinë e procesit në gjykatë, një ndërhyrje "Amicus Curiae", duhet të paraqitet në shkallën e parë të gjykimit, por kjo gjë nuk përjashton ndërhyrjen në shkallë më të larta të gjykimit. Paraqitja e një ndërhyrje "Amicus Curiae", përfaqëson një proces me dy faza:

- Së pari, sigurimi i lejes nga gjykata për të paraqitur një ndërhyrje të tillë, e cila jepet zakonisht.
- Së dyti, paraqitja e ndërhyrjes "Amicus Curiae", pas marrjes së lejes.<sup>196</sup>

Proceduralisht, një ndërhyrje e tillë kuptohet si një përmbledhje e shkruar e argumenteve që sjell në proces ndërhyrësi "Amicus Curiae" dhe jo si një parashtrim verbal i kësaj përmbledhjeje, para gjykatës. Ndërhyrësi "Amicus Curiae", nuk mund të ketë cilësinë klasike të një palë të tretë, ndërhyrëse në proces, por ata sidoqoftë ndikohen nga përfundimi i procesit gjyqësor dhe vendimmarrja respektive, që në fakt mund të kthehet në një "precedent" për çështje të tjera gjyqësore në të ardhmen. Opinioni "Amicus" duhet të paraqitet në gjykatë gjatë kohës që, palët paraqesin pretendimet e tyre. Kjo përmbledhje kërkon një studim të gjerë ligjor, si dhe një formulim të kujdesshëm, që duhet të kalojë paraprakisht në disa rishikime. Rregulli i dhënë për këtë ndërhyrje është se, pala ndërhyrëse me këtë cilësi nuk duhet të komentojë mbi faktet ose themelin e çështjes, pasi në kundërt humbet thelbi bazik i kësaj ndërhyrjeje.

<sup>192</sup> Website: <http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/amicus+curiae>

<sup>193</sup> Bartholomeusz L., (2005): "The amicus curiae before international courts and tribunals", Non-State Actors and International Law, viti 2005, Vol. 209, faqe 273.

<sup>194</sup> Website: <http://www.rbs2.com/amicus.htm>

<sup>195</sup> History, Purpose and Philosophy of Amicus Advocacy: The AELE Amices Brief Program, by Wayne W. Schmidt. Ky informacion gjendet në Website: [www.aele.org/history.html](http://www.aele.org/history.html)

<sup>196</sup> Po aty.

Shpesh për këtë lloj ndërhyrjeje jepen termat e ndërhyrjes, të palës së tretë. Në fakt ky përcaktim është më i gjerë, por nuk përjashton edhe ndërhyrjen “Amicus Curiae”. Megjithëse mund të ketë mbivendosje ndërmjet roleve të ndryshme, duhet bërë një dallim midis një “Amicus Curiae” nga njëra anë dhe një dëshmitari, apo eksperti, nga ana tjetër. Ndërhyrësi më cilësinë e “Amicus Curiae”, nuk është palë me të drejta të plota në proces dhe nuk mban anën e asnjë pale në proces. Argumentet mbi përmasat e të drejtave të njeriut në çështjen ku ai ndërhyrja janë roli i tij, rol që mund të kryejë në fakt disa funksione. Këto funksione lidhen me, ofrimin e informacionit në formën e ekspertizës ligjore, njohurive ligjore ose informacionit faktik; ndihmesën për kuptimin e parimeve dhe hollësive të legjislacionit mbi të drejtat e njeriut dhe barazinë; ndihmesën në zbatimin korrekt të legjislacionit në çështje të caktuara; krijimin e një platforme për ndërhyrje të mëtejshme në rrafshin e mbrojtjes juridike; përfaqësimin e interesit publik; rritjen e besimit, respektit, sigurisë dhe reputacionit të ndërhyrësir dhe marrësit gjyqësor; rritjen e vëmendjes për ndërhyrjen si “watchdog” të të drejtave; etj.

Koncepti i “Amicus Curiae” dhe aplikimi i tij ka avantazhet dhe disavantazhet e tij, duke marrë parasysh parimet dhe politikën e ndryshme mbi të cilat funksionojnë gjykatat dhe tribunat në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Avantazhet e përdorimit të këtij instrumenti nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut lidhen me; sfidat e mëdha me të cilat përballen këto institucione në kuadër të volumit të madh të jurisprudencës së krijuar nga instrumentet ndërkombëtare, rajonale dhe lokale të mbrojtjes së këtyre të drejtave, gjë që mund të plotësohet dhe saktësohet nga Amicus Curiae; sasia e madhe e ligjeve, konventave, vendimeve dhe praktikave shtetërore, parimeve të përgjithshme të së drejtës përbëjnë një problem madhor për gjykatat, ndaj edhe Amicus Curiae mund të sjellë informacion të vlefshëm për to; një nga të drejtat e njeriut brenda konceptit të procesit të rregullt ligjor, lidhet me gjykimin brenda në një kohe të arsyeshme të çështjeve në gjykim, ndaj edhe Amicus Curiae mund të ndihmojë gjykatat e të drejtave të njeriut me prova materiale domethënëse; Amicus Curiae mund të jetë një mjet për teknikën e lobimit për të influencuar politikën dhe mbuluar koston efektive të aksesit në informacion,<sup>197</sup> numri i çështjeve dhe ngarkesa e punës në tribunalët ndërkombëtarë mund të menaxhohet duke përdorur Amicus Curiae.

Nga ana tjetër, mendimi kundër përdorimit të këtij instrumenti, lidhet me faktin se; mund të krijohen argumente të dyzuara që çojnë në konfuzion dhe përplasje, procedura e konfidencialitetit mund të rrezikohet, mungesa e besueshmërisë në anën e Amicus Curiae mund të çojë në padrejtësi dhe mungesë objektiviteti në gjykim. Pavarësisht argumenteve pro dhe kundër për përdorimin e kësaj ndërhyrjeje, argumentet në favor janë më të shumta dhe praktika po tregon se, përdorimi korrekt sjell dobishmëri në administrimin e drejtësisë.

Subjektet ndërhyrëse, në cilësinë “Amicus Curiae”, në varësi të sistemit të aplikuar ligjor të të drejtave të njeriut mund të jenë të ndryshëm. Si të tillë mund të jenë, organizatat jo qeveritare me objekt veprimtarie mbrojtjen e të drejtave të njeriut, klinika dhe qendra universitare, akademike të vjetër të fushës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut, avokatë, institucione të pavarura të të drejtave të njeriut, organizata të specializuara ndërkombëtare

---

<sup>197</sup> Williams S., Woolaver H., (2006): “The Role of the Amicus Curiae before International Criminal Tribunal”, International Criminal Law Riview, viti 2006, Vol. 6, faqe 151-189.



të të drejtave të njeriut, etj. Sikurse shihet, numri i tyre është me një përfaqësim të gjerë dhe ka tendencën të rritet duke zgjeruar rrethin e subjekteve, që mund të marrin këtë cilësi.

“Amicus Curiae” mund të jetë një ndërhyrje individuale nga vetëm një prej subjekteve të sipërcituara, por kjo ndërhyrje mund të marrë edhe formën e ndërhyrjes së përbashkët nga më shumë se sa një subjekt. Avantazhi i veprimit në këtë mënyrë është se pala e tretë mund të mbështetet në një ekspertizë më të gjerë, të ndajë ngarkesën e punës, të shmangë përsëritjet dhe t’i japë më shumë peshë ndërhyrjes, me qëllim që të shmangë rrëzimin e saj. Procedura e ndërhyrjes Amicus, mund të përdoret për të mbushur boshllëkun që lidhet me aksesin e kufizuar në drejtësi, të të varfërve. Ndërhyrja në këto kushte mund të përdoret për të sjellë në qendër të vëmendjes interesat e të varfërve dhe shtresave vulnerabël, në çështje ligjore në të cilat, interesa të tillë mund të jenë neglizhuar, ose injoruar.

*c) Sistemet ligjore të të drejtave të njeriut dhe përdorimi i Amicus Curiae*

Shtrirja e përdorimit të “Amicus” në një sërë sistemesh ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, jep një perceptim të qartë të faktit se, kjo ndërhyrje nuk është dhe nuk mund të konsiderohet si një paraqitje formale dhe pa peshë, por si një ndihmesë dhe kërkesë komplementare, që ndikon në përfaqësimin e një spektri të gjerë pikëpamjesh dhe interesash, në të njëjtën linjë me vlerën demokratike të pjesëmarrjes së barabartë. Duke depërtuar në këtë mënyrë në procedurat ligjore gjyqësore dhe jo vetëm, “Amicus Curiae” kthehet vetvetiu në një element praktik, të konkretizimit të vlerave të shtetit të së drejtës, në një shoqëri demokratike. Sot, sistemet e të drejtave të njeriut në botë kanë dëshmuar dhe dëshmojnë pranimin dhe pjesëmarrjen gjithnjë e në rritje të “Amicus Curiae”. Le të analizojmë disa prej tyre;

*- Sistemi European i të drejtave të njeriut*

Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e hartuar në vitin 1950 nga Këshilli i Europës, përfaqëson një traktat ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në kontinentin evropian. Ajo ka hyrë në fuqi më 3 Shtator 1953 dhe është nënshkruar nga të gjitha shtetet anëtare, të Këshillit të Evropës.<sup>198</sup> Konventa ka krijuar Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si një organ garantues për zbatimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të afirmuara prej saj.

Çdo individ që beson se të drejtat e tij, të afirmuara në këtë konventë, janë shkelur nga një shtet anëtar i Konventës, mund të ngrejë një padi pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në historikun e saj, kjo gjykatë deri në vitin 1998, ka qënë një organ gjyqësor me kohë të pjesëshme që dëgjonte çështjet, vetëm pasi ato ishin marrë në konsideratë nga Komisioni European i të Drejtave të Njeriut, si dhe nuk ka qënë direkt e aksesueshme nga individët dhe organizatat jo qeveritare.

Vetëm pas hyrjes në fuqi në vitin 1998, të Protokollit nr.11, të Konventës, kjo gjykatë u transformua në një organ gjyqësor me kohë të plotë dhe direkt e aksesueshme prej “viktimave” të shkeljes së të drejtave të njeriut. Pikërisht ky protokoll qartësoi rregullat e aplikueshme mbi ndërhyrjet “Amicus Curiae”, duke i dhënë mundësi presidentit të gjykatës

---

<sup>198</sup>Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Ligjin Nr.8136 datë 31.07.1996.

që të ftojë, ose për t'u dhënë leje shteteve anëtare të Konventës Europiane, jo palë në një procedurë, si dhe çdokujt tjetër të interesuar, veç aplikantëve, për të paraqitur komente të shkruara apo në raste përjashtimore për të marrë pjesë në dëgjesa.<sup>199</sup> Mbi këtë bazë rregullatore, individë dhe organizata joqeveritare me fokus veprimtarie mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kanë mundur të kryejnë ndërhyrje “Amicus”, në procedurat e gjykimit të kësaj gjykate.

Është fakt historik se, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka pranuar një ndërhyrje “Amicus”, për herë të parë në vitin 1981, në çështjen Young, James & Webster vs. United Kingdom. Kjo gjykatë e pranon ndërhyrjen “Amicus”, vetëm nëse është “në interes të administrimit të duhur të drejtësisë”,<sup>200</sup> por nëse kjo ndërhyrje nuk i shërben drejtësisë kur ka një precedent të qartë që e bën ndërhyrjen të panevojshme, apo kur kërkesa për ndërhyrje përsërit thjesht atë që palët, apo ndërhyrje të tjera “Amicus” kanë prezantuar, si dhe kur kërkesa për ndërhyrje nuk ka ndonjë lidhje të ngushtë me çështjen në gjykim, atëherë gjykata i refuzon aplikimet për të paraqitur opinionet “Amicus”, para saj. Pranimi i kërkesave për paraqitjen e opinionëve “Amicus Curiae”, duhet të përmbushë disa kërkesa procedurale, si për shembull kërkesa sipas së cilës, ato duhet të paraqiten, “jo më vonë se 12 javë pasi është bërë njoftimi i aplikimit, tek Pala Kontraktuese përkatëse”.<sup>201</sup>

Normat e procedurës, në nenin 44/5, kërkojnë që komentet me shkrim të paraqitura nga “Amicus”, duhet të jenë në një prej gjuhëve zyrtare të gjykatës, përkatësisht gjuhës angleze dhe asaj franceze. Gjykata në përgjithësi i pranon kërkesat e paraqitura për leje, për të ndërhyrë si “Amicus Curiae”. Ndërkohë që është evidente se, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, kurdo që lejon këto ndërhyrje, i përmbledh pikëpamjet e “Amicus” në vendimin e saj përfundimtar.

- *Sistemi Inter-Amerikan i të drejtave të njeriut*

Organet kryesore të këtij sistemi janë Komisioni Inter-Amerikan i të Drejtave të Njeriut<sup>202</sup> dhe Gjykata Inter-Amerikane e të Drejtave të Njeriut e krijuar në vitin 1979. Sipas rregullave të aksesit në këtë gjykatë, vetëm shtetet anëtare dhe organet e Organizatës së Shteteve Amerikane, përfshirë Komisionin Inter-Amerikan, mund t'i drejtohen gjykatës, por megjithatë një qasje më liberale e gjykatës, lidhur me opinionet “Amicus Curiae”, ka pranuar edhe ndërhyrjet nga ana e individëve dhe organizatave jo qeveritare.

Gjykata Inter-Amerikane e të Drejtave të Njeriut, ka një “praktikë Amicus” më të gjerë se sa homologia e saj në Europë.<sup>203</sup> Faktikisht kjo gjykatë nuk ka refuzuar asnjëherë aplikimet për të paraqitur opinionet “Amicus”. Rregullat procedurale të gjykatës lejojnë në mënyrë

<sup>199</sup> Shih nenin 36, të Protokollit 11, të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

<sup>200</sup> Normat e Procedurës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rregulli 44 (2), (a).

<sup>201</sup> Po aty, rregulli 44 (1), (b). Megjithatë afati 12 javor mund të zgjatet nga presidenti i gjykatës, nëse ka një shkak të bazuar për këtë shtyrje.

<sup>202</sup> Komisioni Inter-Amerikan i të drejtave të njeriut është themeluar në vitin 1959, si organ autonom i Organizatës së Shteteve Amerikane (OSHA) dhe më pas u bë organ i saj. Kjo organizatë, pra OSHA, i ka fillesat e saj që në Konferencën e parë të Shteteve Amerikane, në vitet 1889-1890.

<sup>203</sup> Shelton D., (1994): “The participation of nongovernmental organizations in international judicial proceedings”, American Journal of International Law, viti 1994, Vol.88/4, faqe 638.

të qartë “Amicus Curiae”, për të paraqitur komente mbi faktet që përmbahen në aplikim, apo vlerësime ligjore mbi objektin e gjykimit në procedurë nga gjykata në çdo pikë, gjatë procedurave kontradiktoriale.<sup>204</sup>

Opinionin “Amicus”, duhet të paraqitet brenda 15 ditëve, nga kryerja e një dëgjese publike. Nëse gjykata nuk mban një dëgjese publike, opinionin “Amicus” duhet të paraqitet brenda 15 ditëve, nga data në të cilën vendoset afati për paraqitjen e argumenteve përfundimtare. Nëse aprovohet nga presidenti i gjykatës, opinionin i përcillet menjëherë palëve për vlerësimin e tyre. Në ndryshim nga praktika dhe rregullat e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, normat e procedurës së kësaj gjykate nuk parashikojnë ndonjë kërkesë substanciale, sikurse “interesi i administrimit të duhur të drejtësisë”. Megjithatë rregullat procedurale të kësaj gjykate nuk janë shumë të qarta për lejimin e ndërhyrjeve “Amicus Curiae”, këto ndërhyrje janë pranuar përgjithësisht.

- *Sistemi Afrikan i të Drejtave të Njeriut*

Ngjashëm sikurse në sistemin Inter-Amerikan të të drejtave të njeriut, në sistemin Afrikan organet kryesore të tij janë Komisioni Afrikan<sup>205</sup> dhe Gjykata Afrikane e të Drejtave të Njeriut.<sup>206</sup> Në mungesë të parashikimit nga Karta Afrikane, normat e procedurës të Komisionit Afrikan të miratuara në vitin 2010, lejuan për herë të parë qartësisht, ndërhyrjet “Amicus Curiae”.<sup>207</sup> Para këtij viti parashikimet e dispozitave të Kartës Afrikane kishin mungesë dhe nuk ishin një bazë ligjore e qartë për lejimin nga ana e Komisionit Afrikan dhe pranimin e opinionëve “Amicus”, gjë që nuk e ka penguar Komisionin Afrikan, që në disa raste, të lejojë paraqitjen e opinionëve “Amicus”.<sup>208</sup>

Megjithatë nga studime të kryera mbi përdorimin e “Amicus Curiae” në këtë sistem, rezulton se numri i këtyre ndërhyrjeve ka qënë i pakët dhe se, Komisioni është treguar i gatshëm që të pranojë këto ndërhyrje në çështjet në shqyrtim, por nga ana tjetër impakti i tyre është e vështirë të vlerësohet në vendimet përfundimtare. Komisioni ka diskrecionin të ftojë autorët e opinionëve “Amicus” të prezantojnë pikëpamjet e tyre në procedurën verbale, pa u bërë ndonjë dallim nëse kjo gjë ndodh kur opinionin mund të jetë paraqitur me shkrim paraprakisht. Nuk ka të përcaktuar një afat se, kur duhet të paraqitet opinionin “Amicus”, sikundër nuk ka një udhëzues, nëse opinionin duhet të paraqitet në një gjuhë të veçantë.

Gjykata Afrikane e të Drejtave të Njeriut u krijua për të plotësuar mandatin protektiv të Komisionit Afrikan, duke ushtruar juridiksion këshillimor dhe kontradiktorial. Vetëm

---

<sup>204</sup> Normat e procedurës të Gjykatës Inter-Amerikane të të Drejtave të Njeriut, neni 44.

<sup>205</sup> Karta Afrikane krijoi Komisionin Afrikan të të Drejtave të Njeriut. Komisioni filloi aktivitetin në 2 Nëntor 1987, në Adis Abeba, Etiopi. Shih [www.achpr.org/about/](http://www.achpr.org/about/)

<sup>206</sup> Gjykata Afrikane e të Drejtave të Njeriut është një gjykatë kontinentale e themeluar nga vendet afrikane për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Afrikë. Ajo plotëson dhe forcon funksionet e Komisionit Afrikan të të Drejtave të Njeriut.

<sup>207</sup> Normat e procedurës të Komisionit Afrikan, miratuar në Maj 2010, rregullat 85 dhe 96 (1).

<sup>208</sup> Në nenin 52, të Kartës Afrikane gjendet një bazë fillestare mbështetëse, që autorizon komisionin të marrë informacion që e gjykon të nevojshëm për të zgjidhur një çështje në shqyrtim nga “Shtetet e interesuara dhe nga burime të tjera”, plotësuar kjo nga neni 46, i Kartës, që e lejon komisionin të dëgjojë nga “çdo person i aftë për ta sqaruar atë”.

vendet e Unionit Afrikan, Unioni Afrikan, çdo organ i këtij unioni, ose organizatat afrikane të njohura prej unionit, mund të kërkojnë një opinion këshillues mbi çdo çështje ligjore, lidhur me Kartën Afrikane, apo ndonjë instrumenti tjetër përkatës ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Megjithatë, nuk ka një procedurë të qartë sipas së cilës, individët dhe organizatat joqeveritare mund të marrin pjesë në procedurat gjyqësore si “Amicus Curiae”, për të ndihmuar gjykatën të arrijë në vendimin e drejtë për çështjet të kontestuara ligjore. Ndërhyrësi “Amicus” mund të paraqesë një opinion të shkruar në parim dhe mund të marrë pjesë gjatë dëgjësës verbale.

*d) Ndërhyrjet “Amicus Curiae” në kontekstin shqiptar.*

Duke prezantuar një koncept të ri për kontekstin shqiptar, koncepti i ndërhyrjes “Amicus Curiae” ndeshet me një situatë të paqartë dhe të mangët ligjore, që rregullon përciptazi dhe në mënyrë të pjesëshme procedurën e ndërhyrjes në këto raste. Ndonëse e “eksploruar” më herët në vende të tjera, kjo ndërhyrje është një koncept dhe praktikë e re për vendin tonë dhe mund të thuhet se është ende në fillesat e saj.

Më konkretisht mund të thuhet se, KPrC bën fjalë për konceptin e ndërhyrjes nga një palë e tretë në procesin civil, por jo për ndërhyrjen “Amicus”. Koncepti i ndërhyrjes së palës së tretë në Kod, lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e padisë, ose me përfundimin e gjykimit, duke i dhënë të drejtën kësaj pale edhe të ngritjes së padisë, sikundër legjitimohet ndërhyrja për të mbështetur njërën ose tjetrën palë në proces, duke u bashkuar në gjykim për ta ndihmuar atë.<sup>209</sup>

Një dispozitë ligjore që ofron konceptin e ndërhyrjes “Amicus Curiae”, gjendet në ligjin “Për Mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet se: “Gjykata mund t’i kërkojë komisionerit në çdo fazë të procedimit të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”.<sup>210</sup> Në këtë mënyrë dispozita e sipërcituar krijon mundësinë që, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndërhyjë me cilësinë e palës së tretë në një proces gjyqësor, por edhe të paraqesë opinione “Amicus”, mbi bazën e kërkesës së gjykatës.

Veç faktit se kemi mungesë rregullimesh ligjore për mundësimin e ndërhyrjes “Amicus”, ka situata faktike kur institucione të pavarura të të drejtave të njeriut, në Shqipëri, kanë ndërhyrë me opinione “Amicus”. Të tilla ndërhyrje ka kryer institucioni i Avokatit të Popullit, në dy raste me iniciativën e tij, pranë gjykatës dhe pranë organit të prokurorisë.<sup>211</sup> Kjo ndërhyrje nuk ka ardhur si pasojë e kërkesës nga ana e gjykatës, por duhet thënë gjithashtu se, rezulton që gjykata jo vetëm që nuk e ka refuzuar paraqitjen e opinionit “Amicus”, por edhe e ka marrë në konsideratë këtë opinion në vendimin përfundimtar. Megjithëse këto ndërhyrje janë emërtuar si “Amicus Curiae” nga ana e Avokatit të Popullit,

<sup>209</sup> Shih nenet 189 dhe 191, të KC.

<sup>210</sup> Shih nenin 36/4, të Ligjit nr.10221 datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<sup>211</sup> Sipas të dhënave nga sistemi “doculive”, i administrimit të ankesave në institucionin e Avokatit të Popullit, rezulton se, Avokati i Popullit i është drejtuar me një ndërhyrje “Amicus”, Gjykatës së Apelit Durrës. Po kështu, në çështjen me nr.doc.201203967, Avokati i Popullit i është drejtuar me një ndërhyrje “Amicus”, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

në momentin kur në to është shprehur një qëndrim në mbështetje të një prej palëve në gjykim, atëherë ndërhyrja nuk mund të konsiderohet më si e tillë.

Duke qënë se tashmë në Shqipëri ekzistojnë dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre disa institucione të pavaruara të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, konstatohet se KDIMDhP, në dallim nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe AP, ende nuk ka krijuar një profil “Amicus Curiae”. Një konkluzion i tillë mund të nxirret edhe për organizatat jofitimprurëse, apo për çdo subjekt tjetër që, mund të paraqitet me ndërhyrje “Amicus”.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, është një prej rasteve që flasin për praktikën pozitive të pranimit dhe konsiderimit të opinioneve “Amicus Curiae”, megjithëse i takon kësaj të fundit të vendosë se kujt t’i kërkojë një opinion “Amicus”. Megjithëse, Ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar në vitin 2016, nuk parashikonte shprehimisht para këtij ndryshimi se, kjo gjykatë mund të kërkonte opinion “Amicus Curiae”, nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, ose nga organizma të tjerë, kuptuar këtu çdo organizatë shtetërore ose private që ka mundësinë të ofrojë ndërhyrjen dhe opinionin “Amicus”, përsëri kjo gjë nuk e ka penguar Gjykatën Kushtetuese të kërkojë opinionin “Amicus”, nga organizma ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut. Në shumë raste rezulton se, Gjykata Kushtetuese ka parashtruar kërkesën për të pasur një opinion “Amicus Curiae”, nga ana e Komisionit të Venecias, i cili përfaqëson një organ të specializuar rajonal ndërkombëtar, të të drejtave të njeriut.<sup>212</sup>

Ajo që del e qartë nga kjo tablo konstatuese është se, ende nuk janë përcaktuar disa principe bazë, të cilat duhet të ndiqen për të vitalizuar konceptin dhe ndërhyrjen “Amicus”, në legjislacionin vendas në fuqi. Koncepti i “Amicus Curiae” përcaktohet në një kuptim të ngushtë, duke nënkuptuar një person që merr pjesë në zhvillimin e procedurave me ftesë të gjykatave. Kjo situatë evidenton pamjaftueshmëri dhe mungesë të parashikimeve në ligj, për mundësimin e procedurës “Amicus”, jo thjesht dhe vetëm në kuptimin e ngushtë të saj, por si një procedurë me parime të elaboruara, ku çdo person mund të aplikojë në gjykatë për t’u pranuar në një çështje si “Amicus Curiae”, mjafton që ai t’i përmbahet parimeve bazë të kësaj ndërhyrjeje. Në këtë këndvështrim ligji duhet të përcaktojë procedura për ndërhyrjen “Amicus” dhe t’i japë gjykatave mandatin ligjor, që duhet të përdoret për përcaktimin e parakushteve ligjore proceduriale për pranimin, ose refuzimin, e kërkesës për ndërhyrje të tilla.

### **2.1.5 Mbikqyrja e sektorit të sigurisë nga Avokati i Popullit**

Bazuar në ligjin organik “Për Avokatin e Popullit”, objekti i veprimtarisë së tij, lidhet ngushtësisht me juridiksionin administrativ ndaj organeve të administratës publike, ku

---

<sup>212</sup> Mund të përmendet këtu opinionin no.517/2009, i Komisionit të Venecias “Opinionin Amicus Curiae për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë mbi pranueshmërinë e një referendumi për të abroguar ndryshimet kushtetuese”, i miratuar nga Komisioni i Venecias, në 13-14 Mars 2009.

institucionet e sigurisë,<sup>213</sup> zënë vendin e tyre specifik. Duke përfaqësuar një institucion kombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, lind pyetja se përse në një shoqëri demokratike, një institucion i pavarur dhe me kompetenca jo ekzekutive, ka autoritetin të ketë akses në informacionin e sigurisë kombëtare?

Argumentat janë të shumta për të dhënë një përgjigje. Një argument i dhënë është se aksesin në këtë lloj informacioni është një kërkesë esenciale për zhvillimin dhe konsolidimin e një shoqërie demokratike. Aksesin siguron një mbikqyrje konstante kundër abuzimeve, keqqeverisjes dhe korrupsionit. Aksesin ndaj informacionit të sigurisë kombëtare, i kuptuar në kuadër të procesit të vendimmarrjes ndihmon në rritjen e besimit të publikut ndaj veprimeve të qeverisë së tij.

Argumente të tilla ndërmjet arsyeve të tjera, bënë që presidenti i sapozgjedhur i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Obama, në ditën e parë të punës në zyrën e tij, të shprehej se: “Prej një kohe të gjatë ka patur shumë fshehtësi dhe se administrata e tij, në ndryshim të kësaj gjendjeje, nuk do të qëndrojë në krah të atyre që kërkojnë të fshehin informacionin, por të atyre që kërkojnë që ai të bëhet i ditur”. Për të kuptuar gjendjen që krijon një situatë fshehtësie ekstreme në një shoqëri të caktuar, është me vend të citoj një gjyqtar të njohur amerikan, Stewart Potter, i cili ka shkruajtur se: “Kur çdo gjë është sekret – asgjë nuk është sekrete”.

Përkundrajt këtij vlerësimi duhet marrë në konsideratë fakti se, ana tjetër e medaljes ka të bëjë me tendencën që ligjet mbi sekretimin e informacionit të fitojnë përparësi dhe rëndësi, ndaj ligjeve për lirinë dhe të drejtën e informimit, në vende të ndryshme të botës. Në këtë kontekst, rëndësi të veçantë merr një nga parimet e Johaneshburgut,<sup>214</sup> dhe pikërisht parimi me nr.14, në të cilin thuhet shprehimisht se: “Shteti detyrohet të marrë masa të duhura, për ushtrimin efektiv të së drejtës për të marrë informacion. Në rast refuzimi, autoritetet shtetërore duhet të specifikojnë arsyet në një kohë sa më të shpejtë. E drejta e ankimit ndaj një vendimi refuzimi duhet të shqyrtohet nga një autoritet i pavarur në aspektin administrativ, pa përjashtuar rishqyrtimin gjyqësor të ligjshmërisë së refuzimit. Autoriteti rishqyrtues duhet të ketë të drejtën të ekzaminojë informacionin e ndaluar”.

Por si mund të ndërfitet veprimtaria e Ombudsmanit në këto procese dhe si mund të luajë ai rolin e një garantuesi të respektimit të të drejtave të njeriut? Shembulli më i mirë për të kuptuar qasjen ndaj kësaj çështjeje është Suedia, ku institucioni i Ombudsmanit ka një akses të plotë dhe jo të kufizuar në çdo informacion të mbajtur nga ekzekutivi, pavarësisht nivelit të tij të sekretimit. Në përgjithësi këtë rregullim e gjejmë edhe për Ombudsmanët e tjerë kryesisht në zonën europiane, por mund të ketë edhe raste të rralla kur Ombudsmanit i ndalohej të kryejë hetime të këtij lloji.<sup>215</sup>

---

<sup>213</sup> Përfshihen këtu, FA, Agjencitë e zbatimit të ligjit dhe Shërbimet dhe Agjencitë Informative, si pjesë e organeve të administratës publike, për aq sa ato kryejnë funksione administrative, në përputhje me përcaktimin e bërë në nenin 3, të KPrA.

<sup>214</sup> Këto parime do të trajtohen në vazhdim të punimit.

<sup>215</sup> Një rast i tillë ndodh me Ombudsmanin në Etiopi.

Sikurse e kemi theksuar gjatë këtij punimi ka disa pjesë informacioni që duhet të mbeten sekrete dhe që nuk mund të bëhen publike. Ka raste në të cilat veçanërisht individëve të caktuar është e nevojshme t'ju refuzohet informacioni mbi veprimet qeveritare ndaj tij. Ombudsmeni, ekziston që të kontrollojë ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e veprimit qeveritar në rrethana të tilla dhe të garantojë qytetarët se nuk ka abuzime, apo keqveprim në punën e ekzekutivit, e cila është e nevojshme që të mbahet diskrete ndaj individit dhe publikut në përgjithësi.<sup>216</sup> Investigimi dhe kontrolli i ushtruar nga Ombudsmeni në këto rrethana ka treguar se, si ekzekutivi dhe shërbimet sekrete kanë kuptuar që kjo ndërhyrje ka sjellë një përfitim për një legjitimitet të shtuar të veprimeve të tyre, gjë që rrjedh nga fakti se ata janë mbikqyrur nga një institucionin i pavarur i të drejtave të njeriut, që funksionin si garant për qytetarët dhe të drejtat e tyre.

Ka më shumë se një mënyrë për të siguruar aksesin e Ombudsmanit në informacionin e sigurisë kombëtare, por nuk ka një mënyrë të duhur për Ombudsmanin për të kryer plotësisht funksionin tërësor të tij, nëse atij i ndalohej aksesin në këto informacione. Aksesin në informacionin e sigurisë kombëtare kërkon që Ombudsmeni, sikurse çdo person tjetër i autorizuar, të ruajë fshehtësinë e informacionit. Në këto kushte, ai është i detyruar të respektojë procedurat dhe normat e legjislacionit të mbrojtjes së sekretit. Çdo gjë që bën Ombudsmeni nuk duhet të rrezikojë ligjshmërinë dhe legjitimitetin e interesit të sigurisë kombëtare, të mbrojtur nga regjimi juridik i sekretimit.

Institucionet e Ombudsmanit pra, duhet që të kenë procedura të mirëmenduara dhe komunikim me qytetarët me qëllim që të mbrojnë informacionin e sigurisë kombëtare, ndërkohë që në të njëjtën kohë duhet që t'i sigurojë qytetarët se, të drejtat e tyre janë respektuar. Nëse gjatë shqyrtimit të çështjeve që i janë adresuar, Ombudsmeni zbulon se informacioni i klasifikuar fsheh shkelje të ligjit, abuzim me të drejtat e njeriut, mungesë efijence apo keqadministrim, atëherë roli i tij është që të adresojë me forcë, së pari çështjen fillestare dhe njëkohësisht abuzimin me ligjin e sekretimit. Mënyrat e realizimit të këtij adresimi janë të shumta, por duhet theksuar se ky këndvështrim i jep rolin të Ombudsmanit një karakter parandalues.

Duke u rikthyer tek AP në Shqipëri, rezulton se seksioni i veçantë,<sup>217</sup> si pjesë strukturore e këtij institucioni merret me shqyrtimin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve për vënien në vend të së drejtës, ose lirisë së shkelur, nga ana e punonjësve të Policisë Shtetit, institucioneve të inteligjencës, burgjeve, FA dhe pushtetit gjyqësor, prokurorisë, etj. Nga ana tjetër duhet theksuar fakti se, që nga muaji Janar i vitit 2008, AP ka atributin e funksionit si Mekanizëm Kombëtar i Parandalimit të Torturës.<sup>218</sup> Funksioni ka të bëjë me mbikëqyrjen kryesisht të veprimtarisë së organeve që disponojnë ambiente të privimit të lirisë së individit. Mbikqyrja e sektorit të sigurisë, ndër të tjera mundësohet edhe nga kompetenca e AP dhe aksesin e pakufizuar që, atij dhe stafit të tij i garantohet për hetimin

---

<sup>216</sup> Një rast i mundshëm mund të jetë paraqitja e një ankese nga individë të caktuar ku ngrihet pretendimi për interceptim të aparatit të tyre celular, apo për ndjekje dhe survejim nga ana e punonjësve të SHISH.

<sup>217</sup> Shih pikën 2, të nenit 31, të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

<sup>218</sup> Kuvendi i Shqipërisë i caktoi me ligj të posaçëm AP, funksionin e Mekanizimit Kombëtar të Parandalimit të Torturës, në zbatim të Protokollit Opsional të Parandalimit të Torturës (OPCAT), të ratifikuar nga vendi ynë, me Ligjin nr.9094 datë 3.07.2003.

në mjediset dhe ndaj stafit administrativ të organeve të administratës publike, si dhe ndaj gjithë personave të tjerë që nuk gëzojnë imunitet, si dhe hetim mbi çdo dokumentacion të mbatjur nga ana e organeve të administratës publike, qoftë edhe i klasifikuar.<sup>219</sup>

Veç praktikës së përditshme, raportet e veprimtarisë vjetore që ky institucion i drejton Kuvendit të Shqipërisë tregojnë se, mbikqyrja e institucioneve të sektorit të sigurisë zë një pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së AP. Sipas të dhënave zyrtare,<sup>220</sup> rezulton se çështjet e shqyrtuara për institucionet dhe organet e sistemit të sigurisë, gjatë 17 viteve nga AP, zënë një numër të madh krahasuar me mesataren e çështjeve në tërësi të shqyrtuara në një vit kalendarik nga ky institucion. (Shih Tabelën 1)

**Tabela 1**

**Numri i çështjeve të marra në shqyrtim për sektorin e sigurisë për periudhën 2000-2017**

Viti	Organet Policore	Prokuroria	Burgjet/Paraburgimi	Ministria e Mbrojtjes	SHISH
2000	76	28	34	45	0
2001	198	100	126	190	12
2002	283	196	147	220	11
2003	284	163	147	154	0
2004	177	159	177	69	12
2005	157	197	99	107	8
2006	215	197	115	61	11
2007	274	169	98	141	5
2008	233	214	314	149	1
2009	173	169	244	78	3
2010	137	113	233	121	0
2011	173	101	250	71	0
2012	361	304	307	104	3
2013	300	116	212	32	0

<sup>219</sup> Shih nenet 19, 19/1 dhe 20, të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.


<sup>220</sup> Të dhënat e pasqyruara në këtë pjesë të punimit referohen në Raportet Vjetore, që AP i ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë, për periudhën 2000-2017, si dhe sistemit të administrimit elektronik të çështjeve “Doculive”, të aplikuar nga ky institucion.



2014	214	111	217	3	0
2015	197	86	235	14	0
2016	180	102	214	6	0
2017	147	90	230	3	1

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se, numrin më të madh të çështjeve të shqyrtuara e zënë çështjet me organet policore, ndërsa numrin më të vogël çështjet me institucionin e SHISH. Numri i lartë i çështjeve tregon për ekzistencën e problematikave të shumta në veprimtarinë e institucioneve të sektorit të sigurisë dhe ndërkohë ai mund të interpretohet si një tregues i besimit të publikut ndaj AP. Megjithëse objekti i trajtimit të çështjeve është kompleks gjatë këtyre viteve,<sup>221</sup> vlen të theksohet se numri i çështjeve të trajtuara që lidhen me respektimin e së drejtës për informim është sinjifikativisht shumë më i vogël se, totali i çështjeve të trajtuara për institucionet e sistemit të sigurisë. (Shih Grafikon 2)

## Grafiku 2



Në raportet vjetore të AP nuk gjendet një analizë kaq e detajuar për sektorin e sigurisë, por gjykoj se shkak kryesor për këtë numër të ulët çështjesh vjen në radhë të parë, si pasojë e mosnjohjes të së drejtës për informim nga ana e publikut në raport me veprimtarinë e këtyre institucioneve, dhe nga ana tjetër si pasojë e një lloj “hermetizimi institucional”, që aplikohet nga këto institucione me justifikimin e mbrojtjes së sekretit shtetëror, në veprimtarinë e tyre. Efektivisht organet dhe institucionet shtetërore në sektorin e sigurisë në vendet demokratike janë subjekt i të njëjtit legjislacion mbi të drejtën për informim, ashtu si çdo institucion tjetër në administratën publike.

<sup>221</sup> Objekt trajtimi ka qënë dhuna e ushtruar policore, ndalim të personave në kundërshtim me ligjin dhe trajtim ç’ njerëzor në ambientet e izolimit, probleme të punësimit të stafit të institucioneve, të përfitimeve nga sistemi i ndihmës shoqërore, sistemi i sigurimeve shoqërore, etj.

## **2.2 Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si një institucion i ri për mbrojtjen e së drejtës për informim.**

Hyrja në fuqi e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, jo vetëm që shfuqizoi Ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, por solli risi në kuadër të rregullimeve të regjimit juridik të së drejtës për informim, ndër të tjera edhe me krijimin e një institucioni të ri, të pavarur, me rolin e mbikqyrësit të zbatimit dhe respektimit të së drejtës për informim, të emërtuar KDIMDhP.

KDIMDhP identifikon një institucion që me kohë ka zgjeruar mandatin dhe rrjedhimisht, juridiksionin dhe kompetencat që i ngarkohen me ligj. Fillimisht ky institucion u krijua në bazë të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke patur si objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e të dhënave personale, fushë kjo e mbuluar deri në këtë kohë përsëri nga ana e AP. Më pas, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”,<sup>222</sup> mandati i tij u zgjerua me mbrojtjen e së drejtës për informim, e mbuluar deri atëherë nga ana e AP.

KDIMDhP në rolin e një autoriteti mbikqyrës për zbatimin e së drejtës për informim është autoriteti përgjegjës i pavarur, me cilësinë e personit juridik publik.<sup>223</sup> Ai e mbështet veprimtarinë e tij në dy shtylla kryesore, atë të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtës për informim, si një e drejtë themelore e njeriut e afirmuar në nenin 23, të Kushtetutës, si dhe në promovimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, gjithashtu një e drejtë themelore e njeriut, e afirmuar në nenin 35, të Kushtetutës. KDIMDhP ka juridiksion në sferën publike dhe në atë private. Procedura e zgjedhjes së tij bazohet në propozimin e kandidaturës nga Këshilli i Ministrave dhe e votimit me shumicë të thjeshtë nga shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, me mandat 5 vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje.<sup>224</sup> Funkcioni i tij ka papajtueshmëri me çdo funksion tjetër shtetëror, me anëtarësimin në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtarinë e tyre, si dhe me çdo veprimtari tjetër fitimprurëse, përjashtuar mësimdhënien.<sup>225</sup>

Komisioneri ka kompetenca të ndara brenda kuptimit të mandatit të tij, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe në fushën e së drejtës për informim. Specifikisht, në fushën e mbrojtjes së të drejtës për informim ai, shqyrton kërkesat e personave që pretendojnë për shkelje të kësaj të drejte; kryen hetime të nevojshme administrative, njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet objekt hetimi, përfshirë edhe informacionet e klasifikuara “sekret shtetëror”; merr vendim për ankesën e paraqitur;<sup>226</sup> vendos sanksione administrative me gjobë; nxit parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike; monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit; kryen sondazhe për këtë fushë; bën

---

<sup>222</sup> Ky ligj shfuqizoi ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, sipas nenit 18, të të cilit, Avokati i Popullit ishte institucioni që ngarkohej me “kujdestarinë” e zbatimit të dispozitave të tij.

<sup>223</sup> Shih nenin 29, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr.9887 datë 10.03. 2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me Ligjin nr.48/2012 dhe Ligjin nr.120/2014.

<sup>224</sup> Po aty, neni 33.

<sup>225</sup> Po aty, neni 34.

<sup>226</sup> Shih nenin 24, pika 4 dhe 5, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

rekomandime për autoritetet publike; parashtron mendim me shkrim për gjykatën kur kjo i kërkohet për çështje për të drejtën për informim.<sup>227</sup>

Një mjet ligjor që ai përdor në këtë fushë është propozimi i masave disiplinore ndaj personave përgjegjës për shkelje të dispozitave të ligjit, që përbëjnë kundërvajtje administrative. KDIMDhP i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij.<sup>228</sup> Sipas dispozitave të Ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ai ka buxhet të pavarur që financohet nga buxheti i shtetit dhe nga donacione të ndryshme. Kuvendi vendos mbi pagën e Komisionerit, strukturën organizative dhe klasifikimin e pagave të punonjësve të institucionit. Ai është i detyruar t’i raportojë komisioneve të Kuvendit një herë në vit, si dhe sa herë që kjo gjë i kërkohet nga ky i fundit. Udhëzimet, vendimet e KDIMDhP botohen në Fletoren Zyrtare.

Nga të dhënat e publikuara në Raportet Vjetore të veprimtarisë së KDIMDhP, lidhur me ankesat e marra në shqyrtim për të drejtën e informimit, rezulton se, për vitin 2014 janë marrë në shqyrtim 26 ankesa, për vitin 2015 janë marrë në shqyrtim 274 ankesa, për vitin 2016 janë marrë në shqyrtim 684 ankesa dhe për vitin 2017 janë marrë në shqyrtim 560 ankesa.<sup>229</sup> Nga të dhënat e publikuara në këto raporte bie në sy fakti se, nuk ka një përshkrim të diferencuar analizues dhe raportues, të ankesave për të drejtën e informimit që i adresohen sektorit të sigurisë.

Ky është një moment që mendoj se duhet të reflektohet në të ardhmen, në mënyrën e pasqyrimit të veprimtarisë së këtij institucioni, për vet raportin delikat që paraqet natyra e punës së sektorit të sigurisë, ndaj informacionit që duhet bërë publik dhe së drejtës për informim. Me vetëm pak vite veprimtari në mbrojtje të së drejtës për informim, ky institucion është ende në fazat e krijimit të një fizionomie institucionale me profil promovues dhe mbrojtës të kësaj të drejte, ndërkohë që mund të thuhet se, ai e ka krijuar tashmë këtë profil sa i takon promovimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

## **2.3 Jurisprudenca e GJEDNJ dhe raste të shqyrtuara nga sistemi gjyqësor dhe Gjykata Kushtetuese në Shqipëri.**

### **2.3.1 Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut**

Një nga aktet e rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut është KEDNJ, e cila përfaqëson një vlerë të përbashkët të demokracive europiane dhe përcakton kritere guidë për sistemet qeverisëse me drejtim demokratik. Konventa nuk mjaftohet vetëm me shpalljen e të drejtave dhe lirive, por kujdeset edhe për sigurimin e respektimit të detyrimeve të marra nga shtetet që e firmosin atë. Ajo krijon një Komision European të të Drejtave të Njeriut dhe një Gjykatë Europiane të të Drejtave të Njeriut.<sup>230</sup>

<sup>227</sup> Shih nenin 31/1, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>228</sup> Shih nenin 134, pika 1/e dhe pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>229</sup> Ky informacion gjendet në Website: [www.idp.al/raporte-vjetore/](http://www.idp.al/raporte-vjetore/)

<sup>230</sup> Anastasi A., (2004): “E drejta kushtetuese” - cikël leksionesh”, Shtëpia botuese “Pegi”, viti 2004, faqe 76-77

Këto institucione përbëjnë atë që quhet “mekanizëm kontrollues”, apo “sistem kontrollues”, të detyrimeve që lindin prej Konventës, nga ana e shteteve nënshkruese, detyrime që lidhen me garantimin e respektimit të katalogut të të drejtave themelore të njeriut të përfshira në tekstin origjinal të saj dhe të plotësuar nga Protokollat shtesë. Për shumë vjet organet e Konventës; Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut dhe GJEDNJ, kanë shqyrtuar disa dhjetëra mijëra ankime, duke ndryshuar në një shkallë të gjerë mënyrën e mendimit dhe sistemet juridike të shteteve europiane, të cilat i mbrojnë shumë më mirë se më parë, të drejtat themelore të individit.<sup>231</sup>

Në këtë kontekst jurisprudenca e GJEDNJ në mënyrë të padiskutueshme mbetet një burim i çmuar për krijimin e një rendi juridik sa më efikas në sferën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për informim, sidomos në kushtet kur vendi ynë po përballet me vendimet e kësaj gjykate, me palë shtetin shqiptar. Neni 10 i Konventës, jep një përkufizim të lirisë së shprehjes, e cila në jurisprudencën e GJEDNJ, nënkupton lirinë e mendimit, lirinë për të marrë informacion dhe mendime, si dhe lirinë për të dhënë informacion dhe mendime. Këto liri janë vitale në një shoqëri demokratike pasi, “liria e shprehjes përbën një nga kushtet bazë për progresin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu.”<sup>232</sup>

Liria për të dhënë informacion dhe ide ka rëndësi madhore për jetën politike dhe strukturën demokratike të një vendi. Ushtrimi i plotë i kësaj të drejte i hap rrugën kritikës së lirë ndaj qeverisjes dhe qeverisë. Kuptimi i lirisë për të dhënë informacion dhe ide është mbështetur hapur nga GJEDNJ, e cila vëren se është detyra e shtypit; “të japë ide dhe informacion mbi çështjet politike ashtu edhe mbi ato në fushat e tjera të interesit publik. Jo vetëm shtypi ka detyrën të japë informacione të tilla dhe ide; edhe publiku ka një të drejtë për t’i marrë ato”.<sup>233</sup> Për më tepër, neni 10 i Konventës garanton lirinë për të dhënë informacion dhe ide në çështjet ekonomike, por duke i dhënë liri më të gjerë vlerësimi autoriteteve vendase.<sup>234</sup>

GJEDNJ ka zhvilluar konceptin e mbrojtjes së lirisë për të dhënë informacion, jo vetëm përse i përket përmbajtjes së informacionit, por edhe formës në të cilën realizohet, me argumentimin se liria artistike dhe qarkullimi i lirë i artit, kufizohen vetëm në një shoqëri jodemokratike. Duke përkrahur këtë konceptim të krijtarisë artistike dhe të performancës së saj, GJEDNJ ka vendosur se neni 10, “...përfshin lirinë e shprehjes artistike, veçanërisht brenda lirisë për të marrë e dhënë informacion dhe ide, ç’ka ofron mundësinë për të marrë pjesë në shkëmbime publike të informacionit dhe ideve kulturore, politike, sociale të të gjitha llojeve”.<sup>235</sup>

GJEDNJ e trajton të drejtën për të dhënë informacion, si plotësuese të së drejtës për të marrë informacion. Konkretisht për median e shkruar dhe transmetimet, ajo është shprehur

---

<sup>231</sup> Novicki MA., Lloha E., (2003): “Komentar i shkurtër mbi Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut”, botuar nga Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, viti 2003, faqe 20.

<sup>232</sup> Çështja Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, 7 Dhjetor 1976.

<sup>233</sup> Çështja Lingens kundër Austrisë, 8 Korrik 1986.

<sup>234</sup> Çështja Mark Intern kundër Gjermanisë, 20 Nëntor 1989.

<sup>235</sup> Çështja Muller dhe të Tjerë kundër Zvicrës, 24 Maj 1988.

se shtetet nuk duhet të ndërhyjnë midis transmetuesit dhe marrësit, duke qenë se ata kanë të drejtën për të hyrë në kontakt të drejtëpërdrejtë me njëri-tjetrin, sipas dëshirës së tyre.<sup>236</sup> Një shkallë e gjerë mbrojtjeje i është dhënë medias, për vetë faktin se praktikat kombëtare kanë treguar në një shkallë të gjerë se, viktimat më të shpeshta të dhunimit të kësaj të drejte janë gazetarët. Kjo mbrojtje është bazuar në supozimin se interesi i publikut mbrohet më mirë, nëse atij i ofrohet shkalla më e gjerë e informacionit, referuar këtu rolit mbikqyrës së shtypit ndaj politikës.

GJEDNJ është shprehur se; "...është detyra e shtypit të shpërndajë informacion dhe ide mbi çështjet e interesit publik" dhe se, "nuk ka asnjë motiv në precedentin e tij për të dalluar...midis diskutimit politik dhe diskutimit të çështjeve të tjera të interesit publik."<sup>237</sup> Po kështu GJEDNJ vëren se, neni 10 mbron gjithashtu edhe burimet e gazetarëve, sepse kjo mbrojtje është një nga kushtet bazë të lirisë së shtypit.<sup>238</sup>

Gjithmonë duke ju referuar rolit dhe rëndësisë së gazetarëve, pra të shtypit dhe medias në realizimin e kësaj lirie, GJEDNJ shprehet se; "...Ndërsa nuk duhen tejkualuar kufijtë e vendosur, ndër të tjera, për "interesat e sigurisë kombëtare", ose për "të ruajtur autoritetin e pushtetit gjyqësor", gjithsesi ata kanë detyrën të japin informacion dhe ide mbi çështjet me interes publik. Jo vetëm që shtypi ka detyrim të japë informacione dhe ide të tilla, por edhe publiku gjithashtu ka të drejtë t'i marrë ato. Përndryshe, shtypi nuk do të jetë në gjendje të luajë rolin e tij jetik të "Rojtarit publik"."<sup>239</sup>

GJEDNJ është shprehur edhe për lirinë për të marrë informacion, ku përfshihet e drejta për të mbledhur informacion e për të kërkuar atë përmes të gjitha burimeve të mundshme ligjore, duke e interpretuar atë si të drejtë të publikut për t'u informuar në mënyrën e duhur, sidomos për çështjet me interes publik. Sipas GJEDNJ, "...kjo liri mbulon edhe transmetimet televizive ndërkombëtare".<sup>240</sup> Autoritetet mund të ndërhyjnë në ushtrimin e lirisë së shprehjes kur plotësohen njëkohësisht tre kushte: - ndërhyrja parashikohet me ligj; - ajo synon të mbrojë një ose më shumë interesa, ose vlera të caktuara;<sup>241</sup>- ajo është e nevojshme në një shoqëri demokratike.

<sup>236</sup> Makovei M., (2003): "Manualet e të drejtave të njeriut nr.2 - Liria e shprehjes, Një udhëzues për zbatimin e nenit 10 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut", Botimi i dytë, Gent Grafik, viti 2003, faqe 13.

<sup>237</sup> Çështja Thorgeirson kundër Islandës, 25 Qershor 1992. Në këtë çështje kërkuesi kishte bërë dëshmi në shtyp për brutalitetin e përhapur të policisë në Islandë, dhe i quajti policët "bisha në uniformë", duke iu referuar "individëve që u shndërruan në moshë mendore të një të porsalinduri, si rezultat i shtrëngimit mbytës që policët dhe rojet e klubeve mësojnë dhe vënë në përdorim me spontanitet brutal" si "veprime tiranizuese, fallso, të paligjshme, të pamatura dhe të përshtatshme". Ai u ndoq penalisht dhe u dënua me gjobë.

<sup>238</sup> Çështja Goodvin kundër Mbretërisë së Bashkuar, 27 Mars 1996.

<sup>239</sup> Çështja Voskuil kundër Holandës, 22 Nëntor 2007.

<sup>240</sup> Çështja Autronic kundër Zvicrës, 22 Maj 1990.

<sup>241</sup> Këto interesa, sipas Gjykatës janë; siguri kombëtar, integriteti territorial, siguria publike, ndalimi i krimit dhe mbrojtja e rendit, mbrojtja e shëndetit, moralit, reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve, ndalimi i zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë dhe garantimi i autoritetit të paanshëm të gjyqësorit. Ndërhyrja e shtetit konsiderohet e ligjshme kur përmbushen tre kushtet e mësipërme dhe shteti ka barrën e provës për të vërtetuar këtë përmbushje.

### 2.3.2 Sistemi Gjyqësor dhe e drejta për informim

Kontrolli administrativ i gjykatës mbi veprimtarinë administrative, lidhet me garancinë që ofron ndërhyrja e pushtetit gjyqësor për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat kushtetuese dhe ligjore të individit.<sup>242</sup> Në nenet 324-333 të KPrC, përcaktohen rregullat e shqyrtimit gjyqësor të akteve administrative. Nga ana tjetër në nenin 18, KPrA përcakton si parim, kontrollin gjyqësor të akteve administrative.

Një nga gjykimet e posaçme të parashikuara në KPrC, është ai që ka të bëjë me mosmarrëveshjet administrative.<sup>243</sup> Një nga paditë që mund të paraqiten në gjykatë në këto raste është padia me të cilën kërkohet shfuqizimi, ose ndryshimi i një akti administrativ.<sup>244</sup> Në lidhje me afatin e shqyrtimit të mosmarrëveshjes nga ana e gjykatës kompetente, në paragrafin e dytë të nenit 327, të KPrC, përcaktohet se: “Shqyrtimi i mosmarrëveshjes duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit në gjykatë”.

Megjithëse një nga mënyrat e rivendosjes së të drejtës për informim është ajo e ankimit në rastin e shkeljeve në rrugë gjyqësore, sikurse parashikohet në legjislacionin në fuqi, përsëri duhet theksuar se praktika gjyqësore në këtë drejtim mbetet shumë e varfër.<sup>245</sup> Është fakt se, deri para fare pak vitesh, në gjykatat e të tre shkallëve nuk gjeje të regjistruar çështje gjyqësore me objekt, shkeljen e të drejtës për informim. Çështjet e regjistruara që kanë për objekt shqyrtimi gjyqësor shkeljen e të drejtës për informim, janë të pakta. Përveçse një veprimtarie të vazhdueshme nga ana e OJF-ve të caktuara në vend,<sup>246</sup> që qëllimon sensibilizimin e publikut në lidhje me këtë të drejtë, shfrytëzimi i ankimit në rrugë gjyqësore nga ana e individëve, mbetet në nivele mjaft të ulëta.

Kjo nuk do të thotë se gjithçka shkon mirë dhe se, të gjitha shkeljet e mundshme të kësaj të drejte arrijnë të rivendosin në vend të drejtën gjatë shqyrtimit administrativ të çështjeve. Përkundrazi, veprimtaria e institucioneve mbikqyrëse për zbatimin e së drejtës për informim dhe angazhimi i qëllimuar i disa organizatave jo qeveritare në këtë drejtim kanë treguar se, jo vetëm që shkeljet ekzistojnë dhe ato nuk arrijnë të rregullohen gjatë shqyrtimit administrativ, por ka një mungesë dijenie mbi rolin e gjyqësorit në këtë fushë. Edhe eksperiencia e deritashme e KDIMDhP, flet për një profil të ulët të gjyqësorit në këtë drejtim.

Nga gjykimet e zhvilluara në gjykatat shqiptare vërehet tejkalim i dukshëm i afateve të gjykimet, të përcaktuara në ligj. Shkelja e dispozitave procedurale nga ana e gjykatës,

---

<sup>242</sup> Shih nenin 42/2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>243</sup> Shih titullin III, kreu I, neni 320/a, i KPrC.

<sup>244</sup> Shih nenin 324/a, të KPrC.

<sup>245</sup> Shkaqet për këtë gjendje janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga mungesa e dijenisë së publikut për mënyrat e mbrojtjes së të drejtës për informim, dhënia më tepër përparësi rrugës së ankimit administrativ, paqartësitë, apo magësitë e legjislacionit specifik mbi të drejtën e informimit, procedurat e tejzgjatura gjyqësore dhe mungesa e besimit tek gjyqësori etj.

<sup>246</sup> Sipas një informacioni të marrë nga Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve (QZHDI), rezultoi se kjo e fundit ka paraqitur për shqyrtim gjyqësor 11 kërkesa, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2003-2008, me objekt detyrimin e dhënies së informacionit, apo dokumenteve zyrtare nga autoritete të ndryshme shtetërore.

gjykoj se ndikon negativisht për realizimin e efektivitetit të ankimit të palës së interesuar lidhur me të drejtën e informimit dhe nuk përmbush një nga kërkesat primare për respektimin e së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Kjo tregon se edhe vetë gjyqtarët nuk kanë një kuptim të qartë të rëndësisë të së drejtës për informim dhe nuk arrijnë të bëjnë diferencën për përparësinë që, legjislacioni në fuqi i njej të drejtës për të marrë informacion zyrtar.<sup>247</sup> Zvarritja që ndodh në gjykimin e çështjeve për të drejtën e informimit është një nga treguesit për domosdoshmërinë e reformimit të pushtetit gjyqësor, i cili pavarësinë në ushtrimin e kompetencave të veta, shpesh e njehson me mosrespektim të së drejtës individuale për një proces të rregullt ligjor, gjë që sjell pasoja për të drejtat e individit.

Në një monitorim të kryer për transparencën e institucioneve publike, në periudhën Shtator 2016 – Qershor 2017, nga ana e Qendrës “Res Publica”, ndër të tjera ka rezultuar se, kryesisht në rastet e refuzimit të informacionit të kërkuar nga gazetarët prej institucioneve publike, gazetarëve iu është dashur të shkojnë në gjykatë për të kërkuar respektimin e së drejtë të tyre për informim. Megjithatë, sipas monitorimit, procesi gjyqësor në shkallë të parë zgjat me muaj të tërë, ndërkohë që ndaj vendimit të gjykatave të shkallës së parë, institucionet përkatëse ankohen në Gjykatën Administrative të Apelit, duke e vonuar kështu dhënien e informacionit të kërkuar me vite. Gjatë kësaj periudhe monitoruese, Qendra “Res Publica” ka përfaqësuar gazetarë të ndryshëm në 7 procese gjyqësore, të

---

<sup>247</sup> Në vitin 2006, Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve si palë paditëse ka paraqitur një kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë të paditur, Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës. Objekti i Kërkesë-Padisë, ka qenë: Detyrimi i palës së paditur, Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, për të dhënë informacionin e kërkuar në lidhje me Marrëveshjen e Konfidencialitetit, të nënshkruar midis Shoqërisë “Calik Enerji Telekomunikasyon A.S”, e cila fitoi tenderin e privatizimit të Shoqërisë Altelecom Shqiptar sh.a, me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, si dhe me dosjen e depozituar në tender nga firma „Calik Enerji Telekomunikasyon A.S“. Kërkesa për informacionin e paraqitur paraprakisht nga ana e QZHDI-së në Ministrinë e Privatizimit (sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës), ishte vënia në dispozicion e dosjes së plotë me dokumentacionin ligjor që, shoqëria “Calik Enerji Telekomunikasyon A.S” kishte paraqitur në tenderin e organizuar në muajin Nëntor 2004, nga Ministria e Privatizimit, për privatizimin e “Altelekom” sh.a.

Baza ligjore e ku mbështetet kërkesa padia është neni 23, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 238, i KPrC, neni 141/2, i KPrA dhe neni 16, i Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Me vendimin nr.7548 datë 26.12.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Gjatë rrugës së ankimit administrativ që QZHDI-ja ka ndjekur në këtë çështje është bërë i ditur fakti se, midis firmës “Calik Enerji Telekomunikasyon A.S” dhe institucioneve shtetërore që kanë lidhje me procesin e privatizimit të „Altelekom sh.a“, është nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti. Gjykata në pjesën arsyetuese të vendimit, arsyeton se: “Duke ju referuar nenit 290 të Kodit të Procedurës Civile, marrëveshja dhe kontrata janë ligj dhe në këto kushte dhe në rastin konkret duhet respektuar kushti i kësaj marrëveshjeje konfidencialiteti, që i përket në proces duhet t’u ruajnë këtë deri në dy vjet pas nënshkrimit të saj”.

Pa u futur në diskutimin nëse kjo marrëveshje është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk ka forcë detyruese, është evident fakti se, baza ligjore e përdorur për të mbështetur arsyetimin nuk qëndron, për më tepër nuk korrespondon me llogjikën e përdorur në arsyetim nga ana e gjykatës. Në nenin 290, të Kodit të Procedurës Civile, bëhet fjalë për të drejtën e gjykatës për të siguruar sende e të dhëna të nevojshme në kqyrje, dispozitë e cila nuk ka lidhje me arsyetimin e dhënë nga ana e gjykatës në këtë vendim gjyqësor. Këto fakte tregojnë se gjykata nuk është thelluar në shqyrtimin e çështjes, përkundrazi zvarritja e pajustificuar në zhvillimin e këtij procesi gjyqësor dhe përcaktimet e dhëna në arsyetimin e vendimit, flasin për inkompetencë apo në rastin më të keq, për shmangie të qëllimshme në zbatimin e ligjit.

gjithë të fituar nga gazetarët në shkallën e parë dhe të gjithë të ankimuar nga institucionet përkatëse publike, në shkallën e dytë.<sup>248</sup>

Një tjetër problem që mund të ndikojë në gjykimin e çështjeve për të drejtën e informimit ka të bëjë me aksesin fillestar, që palët e interesuara kanë për paraqitjen e këtyre çështjeve për gjykim. Ky akses lidhet me tarifën gjyqësore që duhet parapaguar si kusht për fillimin e procesit gjyqësor. Kjo tarifë veprimtarie gjyqësore, gjykoj se mund të përbëjë pengesë që personat e interesuar t'i drejtohen gjykatës në këto raste, sidomos po të kemi parasysh faktin se ka ardhur gjithnjë e në rritje, vit pas viti.<sup>249</sup>

### **2.3.3 Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese**

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, evidenton vetëm dy gjykime të zhvilluara nga kjo gjykatë, lidhur me kërkesa të subjekteve të interesuara mbi të drejtën e informimit. Më konkretisht:

-Gjykata Kushtetuese ka marrë në shqyrtim kërkesën e parashtruar prej subjekteve përkatësisht; Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, Lidhja e Gazetarëve Shqiptarë, Shoqata e Gazetarëve Profesionistë, Sindikata e Gazetarëve Shqiptarë, me objekt : “Deklarimin antikushtetues të Urdhërit nr.226, datë 20.08.2002, të Kryeministrit, “Për komunikimin me organet e Medias së Shkruar dhe Elektronike””. Kjo gjykatë me anë të vendimit nr.34 datë 8.12.2003, ka vendosur pushimin e çështjes me arsyetimin se kërkesa e paraqitur nuk kishte më objektin e saj në kohën e shqyrtimit, sepse urdhëri që kontestohet nuk ekzistonte më, pasi ai ishte revokuar nga vetë organi që e kishte nxjerrë. Gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë nga ana e Gjykatës Kushtetuese rezultoi se Kryeministri, me Urdhërin nr.157, datë 12.11.2003, kishte revokuar Urdhërin nr.226, datë 20.08.2002 “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”, i cili kërkohej të deklarohet si antikushtetues nga kërkuessit.

-Po kështu, vendimi nr.16 datë 11.11.2004, i bazuar në kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, me objekt: “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 34, të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, përbën një pjesë të vlefshme të jurisprudencës në këtë fushë, në referim të marrëdhënies ekzistuese ndërmjet të drejtës së informimit dhe privatësisë. Në këtë rast u bë e qartë se, deklarimi i pasurive dhe bërja publike e të dhënave mbi pasurinë e zyrtarëve vjen për shkak të interferimit me njëra-tjetrën të dy të drejtave themelore, të drejtës për privatësi dhe të drejtës së informimit.

Gjykata Kushtetuese në këtë vendim ka arsyetuar se, mungesa e konfidencialitetit të asaj pjese të dhënash që kishin të bënin me emra konkretë të pjestarëve të familjes së deklaruesit

<sup>248</sup> Ky informacion gjendet në, Website: [www.respublica.org.al/informacioni-i-vonuar-eshte-informacion-i-mohuar](http://www.respublica.org.al/informacioni-i-vonuar-eshte-informacion-i-mohuar)

<sup>249</sup> Shih Ligjin nr.98/2017 “Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.



nuk është më e nevojshme për të arritur qëllimin e informimit të publikut. Për këtë arsye, këto të dhëna duhet të jenë të fshehta ndaj publikut.<sup>250</sup>

## **2.4 Problematika të ndeshura në dispozitat e Ligjit nr. 8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.**

Megjithë përpjekjet e bëra gjatë kësaj periudhe tranzicioni, funksionimi i regjimit juridik të informimit publik ka shfaqur probleme të dukshme dhe ka treguar se mbetet pas standardeve ndërkombëtare në zhvillimin e një demokracie pjesëmarrëse. Kjo gjendje është krijuar prej një sërë arsyesh, të cilat kanë ngadalësuar procesin e përshtatjes të legjislacionit të brendshëm me zhvillimet koherente të legjislacionit ndërkombëtar.

Në këtë këndvështrim, në planin global kanë ndodhur zhvillime të rëndësishme me miratimin e akteve të ndryshme ndërkombëtare. Kështu, në vitin 2002, Komiteti i Ministrave i KE ka aprovuar rekomandimin “Për aksesin në dokumentet zyrtare”. Ndërkohë, KE ka miratuar Konventën “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso, të adoptuar në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të KE, më 27.11.2008, si i pari traktat ndërkombëtar që e njeh të drejtën e informimit, si një të drejtë të veçantë nga liria e shprehjes, e detyrueshme për vendet anëtare të KE-së. Nga ana tjetër, Raporteri Special i Kombeve të Bashkuara mbi Lirinë e Shprehjes, në interpretimin e përgjithëm të nenit 19, me efekte detyruese që nga Janari 2012, (viti 2004-2005), të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike ka mbajtur qëndrimin se, liria e shprehjes nënkupton të drejtën e informimit mbi dokumentet që mbahen nga qeveria.

Në këtë aktualitet problematik ku vërehej ngadalësi në përafrimin dhe integrimin në legjislacionin e brendshëm të standardeve më të mira ndërkombëtare të fushës, si dhe ku edhe vetë regjimi juridik i së drejtës për informim tregonte se kishte nevojë për rregullime të qënësishme, mbetej një kërkesë e detyrueshme rishikimi dhe përmirësimi i dispozitave, të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Përmirësimi i regjimit juridik të së drejtës për informim, i përcaktuar në këtë ligj konsistonte në:

*- Zgjerimin e rrethit të subjekteve që kanë detyrim dhënien e informacionit.*

Parimet e gjithëpranuara ndërkombëtare për formulimin e legjislacionit për të drejtën për informim, si dhe zhvillimet ndërkombëtare në këtë drejtim, përcaktojnë mundësinë e aksesueshmërisë në një sasi sa më të madhe të informacionit zyrtar dhe me sa më pak kufizime, pa përjashtuar mundësinë e detyrimit të një rrethi më të gjerë subjektsh private apo shtetërore, që operojnë në fushën publike, për të dhënë informacion për subjektet që gëzojnë të drejtën ta marrin atë.

Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, respektonte përgjithësisht këto parime por mbetej për t’u reflektuar në lidhje me rrethin e subjekteve që kanë detyrimin të japin informacion. Përkufizimi i dhënë në këtë ligj për subjektet që kanë detyrimin për dhënie informacioni, ishte relativisht i ngushtë në krahasim me legjislacionin e vendeve që

---

<sup>250</sup> Përmbajtja e vendimit nr.16 datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, gjendet në, Website: [www.gjk.gov.al/](http://www.gjk.gov.al/)

kishin zhvilluar legjislacionin e tyre në këtë fushë. Për më tepër, Konventa e KE “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso, e adoptuar në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, më 27.11.2008, jepte ndërkohë një përkufizim më të gjerë të kuptimit të termit “autoritetit publik”.

Duhet theksuar edhe fakti se, Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, në fuqi në atë kohë, në dispozitat e tij parashikonte se, parimet e përgjithshme të sanksionuara në të, përfshirë këtu parimin e së drejtës për t’u informuar, me ligj mund të bëhen të detyrueshme për zbatim edhe për veprimtarinë e subjekteve private kur këto veprimtari kanë efekte mbi interesat publike.<sup>251</sup>

Konventa e KE “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, krijon detyrime informative edhe për subjekte, si organet legjislative, autoritetet gjyqësore, apo edhe për personat fizikë apo juridikë, për aq sa ata kryejnë funksione publike, apo kur operojnë me fonde publike në përputhje me legjislacionin vendas. Veçanërisht në rastin e personave fizikë ose juridikë, si kompanitë private që kanë monopole ose koncesione për furnizimin me ujë, energji elektrike etj,<sup>252</sup> apo edhe në rastin e personave juridikë që operojnë, tërësisht ose pjesërisht, me fonde publike, përfshirja e tyre në rrethin e subjekteve që kanë detyrim informimin për publikun merrte një rëndësi specifike. Përfshirja e këtyre subjekteve të reja në rrethin e subjekteve të së drejtës për informim që kanë detyrim të japin informacion, konsiderohej e rëndësishme, pasi shumë funksione ose shërbime publike që tradicionalisht janë ushtruar nga shteti, gjithmonë e më tepër kanë tendencën të delegohen në duart e subjekteve private, apo partneriteteve shtet-privat, si një tendencë e zhvillimit të shtetit modern administrativ. Praktikrat më të mira do të diktonin që, për qëllim të dhënies së informacionit, përkufizimi i “autoritetit publik”, të përqëndrohet në llojin e shërbimit të ofruar dhe jo në emërtimet formale.<sup>253</sup>

Konventa e KE, “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, jep një përkufizim më të gjerë të subjektit “autoritetit publik”. Sipas saj, me “autoritet publik”, do të kuptohet;

- Qeverisja dhe administrimi në nivel kombëtar, rajonal ose lokal,
- Organet legjislative dhe autoritetet gjyqësore, për aq sa ato kryejnë funksione administrative në përputhje me ligjin vendas,
- Personat fizik ose juridik, për aq sa ata ushtrojnë autoritet administrativ.<sup>254</sup>

Si një hap i duhur për këtë qëllim do të shërbente ratifikimi i Konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, proces i filluar nga ana e Këshillit të Ministrave por ende i papërfunduar. Ratifikimi i kësaj konvente do ta kthente atë në një akt normativ rregullator edhe për regjimet e tjera juridike

---

<sup>251</sup> Shih nenin 1, të Ligjit nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

<sup>252</sup> Në nenin 1, të Ligjit nr.9663 datë 18.12.2006 “Për koncensionet”, është përcaktuar se qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat, duke rritur transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike.

<sup>253</sup> Article 19, Memorandum për ligjin shqiptar “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, Londër, Shtator 2004, faqe 8.

<sup>254</sup> Neni 1, pika 2, gërma “a”/”i”, i Konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso, të adoptuar në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, më 27.11.2008.

për të drejtën e informimit, gjë që do të kushtëzonte zgjerimin e rrethit të subjekteve që kanë detyrim të japin informacion edhe në Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Në këtë këndvështrim, duhet theksuar se, në fakt zgjerimi i rrethit të subjekteve që kanë detyrim dhënien e informacionit, sipas parashikimit të bërë në Konventën e KE “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, ishte kryer në Ligjin nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, për aq sa ky kod mund të rregullonte në lidhje me të drejtën e informimit.

Këto argumente krijojnë mundësinë e ndërhyrjes në dispozitat e Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, për zgjerimin e rrethit të subjekteve që kanë detyrimin të japin informacion, që përfshihen në termin “autoritet publik”. Si një marrëdhënie e dykahëshme ndërmjet subjekteve që japin dhe marrin informacion, zgjerimi i rrethit të subjekteve që kanë detyrimin të japin informacion, si një grupim që herë pas here mund të shfaqet edhe si kërkues informacioni, nuk ka ndonjë efekt në zgjerimin e rrethit të subjekteve që gëzojnë të drejtën që të kërkojnë dhe marrin informacion. Rrethi i subjekteve që gëzojnë të drejtën të marrin informacion mbetet ai grupim që është analizuar me sipër në këtë punim.

*- Afatet për dhënien e informacionit.*

Sistemi i afateve për trajtimin e kërkesave për informim sipas Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”,<sup>255</sup> njihet një ndarje dy fazëshe, ndarje e cila për nga mënyra e përcaktimit në ligj evidentonte një lloj kundërshtie në konceptin e ndërtimit kohor të një procedimi administrativ. Nga ana tjetër, diskrecioni i dhënë administratës publike në kuptim të shfrytëzimit të afateve për trajtimin e kërkesave për informim, kishte rezultuar në abuzim me afatet dhe për më tepër, nuk kishte justifikuar një veprimtari normale të administratës për këtë qëllim.

Praktika e zbatimit të këtyre afateve, ka evidentuar gjithashtu konfondimin e termit “ditë pune” me “ditë kalendarike”, gjë që ka sjellë vonesa, apo zgjatje të afateve ligjore edhe përtej asaj çfarë ishte e përcaktuar shprehimisht. Po në këtë linjë, zbatimi i afateve nuk është vlerësuar si një opsion i shfrytëzueshëm brenda hapësirës së lejueshme kohore të dhënë, por si një opsion i shfrytëzueshëm në limitin ekstrem përfundimtar të afatit të dhënë. Për të gjitha këto arsye, paraqitet si një kërkesë e arsyeshme dhe praktikisht e mundshme, shkurtimi i afateve, brenda të cilave do të trajtohej kërkesa për informim, me një mundësi të vetme shtyrje. Përderisa kishim të bënim me një ligj specifik që rregullonte një të drejtë specifike, atëherë mund të vendoseshin afate specifike për rregullimin e marrëdhënies juridike konkrete, të cilat jo domosdoshmërisht duhet të referoheshin në ligje të tjera.

Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, parashikonte një sistem afatesh me dy faza për dhënien e informacionit: “autoritetet duhet të marrin vendim “për mospranimin e plotë ose të pjesshëm të kërkesës brenda 15 ditëve nga depozitimi i saj”.<sup>256</sup> Në rast se kërkesa pranohej, autoriteti kishte në dispozicion 40 ditë për plotësimin e saj (neni 11). Për shkak të “veçantisë së kërkesës ose të nevojës për t’u këshilluar me një palë

<sup>255</sup> Shih nenet 10 dhe 12, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

<sup>256</sup> Po aty, neni 10.

të tretë” autoriteti mund të zgjaste afatin edhe 10 ditë të tjera. Këto afate janë konsideruar nga më të lartat në praktikën europiane dhe atë ndërkombëtare, ku afati mesatar për dhënien e informacionit është më pak se 15 ditë kalendarike. Në fakt, zakonisht zbatimi i kriterëve të ligjit, dokument për dokument kërkon së pari, mbledhjen dhe studimin e tyre në mënyrë që të merret një vendim ligjor për dhënien/mosdhënien e tyre të plotë ose të pjesshme. Si rrjedhim, në momentin që merret vendimi institucioni duhet të ketë mbledhur pjesën dërrmuese të informacionit.<sup>257</sup>

Në këtë kuptim, është më e përshtatshme që trajtimi i kërkesës për informim të bëhet brenda një afati shumë më të shkurtër kohor se ai ekzistues, ku do të përfshihej kryerja e veprimeve dhe marrja e vendimeve të domosdoshme nga ana e organeve të administratës publike, qoftë për refuzimin e kërkesës, apo edhe për plotësimin e pjesshëm, apo të plotë të saj. Për shkaqe që lidhen me kërkesa veçanërisht komplekse, mund të parashikohej një mundësi shtyrjeje nga afati i sipërcituar fillestar, me kushtin që kërkuuesi të vihej paraprakisht në dijeni për këtë shtyrje, brenda afatit 15 ditor.

*- Sanksionet dhe dëmshpërblimi.*

Në ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përcaktoheshin disa dispozita, shkelja<sup>258</sup> e të cilave, përbënte kundërvajtje administrative, ose vepër penale. Në rast se shkelja vërtetohej, të dëmtuarit i lindte e drejta e kërimit të dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar. Duke pasur parasysh që e drejta e informimit mund të përdoret nga individët për të mbrojtur interesat e tyre private është mëse e logjikshme që, pamundësia për të përfituar nga kjo e drejtë të përkthehet në dëm për qytetarët.

Në kontekstin e së drejtës së informimit do të mjaftonte të vërtetohej që, refuzimi i administratës për të servitur dokumentacionin e kërkuar të ishte i pambështetur në ligj, si dhe të tregohej një lidhje shkakësore midis këtij veprimi të paligjshëm të administratës dhe një dëmi të pësuar nga personi privat, që ky i fundit të legjitimohej për një dëmshpërblim nga administrata fajtoare, sipas parashikimeve të Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.<sup>259</sup> Në fakt, eksperiencia e zbatimit të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ka evidentuar se, zbatimi i këtyre dispozitave mbi sanksionet dhe dëmshpërblimin ka qenë jo efektiv. Ligjit i mungonte parashikimi konkret që, për çdo shkelje të cilësuar në kushtet e kundërvajtjes administrative të përcaktohej një nga llojet e dënimeve, si ndëshkime administrative të parashikuara shprehimisht në legjislacionin për kundërvajtjet administrative. Parashikimi në ligj, i sanksioneve të posaçme për shkeljen e dispozitave të tij do të bënte që, ato të njiheshin më mirë nga subjektet e interesuara dhe që, ato të kishin

---

<sup>257</sup> Ky informacion gjendet në Website:

[www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf](http://www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf)

<sup>258</sup> Shih nenet 14 dhe 17, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Sanksionet për moszbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, nëse shkelja nuk përbënte vepër penale, caktoheshin sipas ligjit nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Lidhur me shpërblimin e dëmit parashikohej se: “Çdo person, që ka pësuar një dëm për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga subjekti që shkel të drejtën. Procedurat për ankim dhe për shpërblimin e dëmit rregullohen me ligj”.

<sup>259</sup> Instituti per Studime Publike & Ligjore, Komentar “Ligji për të drejtën e informimit”, Tiranë, viti 2003, faqe 90.

potencial më të madh për zbatim. Ky vlerësim konsiderohej i njëjtë edhe për procedurat e shpërblimit të dëmit.

Në këto kushte lindte nevoja që, sikurse ndodhte edhe në një sërë ligjesh të tjera në fuqi, për çdo shkelje të cilësuar në kushtet e kundërvajtjes administrative, të përcaktohej një nga llojet e dënimeve administrative, si penalitete të caktuara në ligjin përkatës rregullator, referues.<sup>260</sup> Kjo situatë ka kërkuar ndyshim dhe përmirësim të dispozitave të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, për të shërbyer si mjet garantues për zbatimin dhe respektimin e të drejtës së informimit.

*- Detyrimi për të ndihmuar kërkuesin për saktësim, ose përcjellje të kërkesës.*

Parimet e së të drejtës për informim përcaktojnë detyrimin e subjekteve administrative që detyrohen për të dhënë informacion, për të ndihmuar kërkuesin e informacionit që të identifikojë dokumentet që kërkon, pasi ato kanë njohuri të plota se çfarë dokumentesh zyrtare mbajnë. Në fund të fundit, sqarimi i kërkesës thjeshtëson procesin për të dyja palët, ose për pranim të kërkesës për informim,<sup>261</sup> ose për refuzimin e saj. Ky moment lidhet me krijimin e infrastrukturës organizative të nevojshme, që do të trajtojë kërkesat e këtij lloji, apo që do të realizojë kontaktin e parë me kërkuesin në kohën e hartimit, apo të paraqitjes të kërkesës për informim prej tij, pra të “zyrës”, ku do të jepet edhe ndihma për identifikimin nga kërkuesi të dokumentave që kërkon.

Krijimi si koncept, i “zyrës”, që do të trajtojë kërkesat e këtij lloji, apo që do të marrë kontaktin e parë me kërkuesin në kohën e hartimit apo të paraqitjes nga ana e tij të kërkesës për informim, realisht do të ezaurojë edhe dhënien e ndihmës për identifikimin nga ana e tij të dokumenteve që kërkon. Lidhur me kushtet e paraqitjes dhe pranimit të kërkesës që i paraqitet në këto raste autoritetit publik nga ana e individëve të veçantë, mund të identifikohen dy raste specifike;

- Kur personi është prezent në institucion dhe ai merr kontakt direkt me “Zyrën” e informimit.
- Kur kërkesa për informim vjen me postë, apo në rrugë elektronike.

Në rastin e pranimit të kërkesës, ndihma është e drejtëpërdrejtë dhe jepet menjëherë nga ana e punonjësve që kujdesen dhe janë të ngarkuar me zbatimin e të drejtës së informimit. Në rastin e refuzimit është i nevojshëm komunikimi në të njëjtën mënyrë, sikurse është paraqitur kërkesa. Për këtë rast vinte në ndihmë edhe parashikimi i bërë në Ligjin nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, ku përcaktohej se, për kërkesën, ankesën apo peticionin e një individ, drejtuar si rezultat i një gabimi të pranueshëm tek një organ i administratës që nuk ka juridiksion për çështjen që parashtrohet në to, bëhet dërgimi i tyre mbrapsht tek ankuesi, kërkuesi apo peticionisti, maksimalisht brenda 48 orësh, duke e shoqëruar me informacionin se kujt organi specifik të administratës mund t’i drejtohet.<sup>262</sup>

<sup>260</sup> Referimi bëhet në Ligjin nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

<sup>261</sup> Lidhur me pranimin e kërkesës që i paraqitet në këto raste autoritetit publik nga ana e individëve të veçantë, mund të identifikohen dy raste specifike;

- Kur personi është prezent në institucion dhe ai merr kontakt direkt me “Zyrën” e informimit.
- Kur kërkesa për informim vjen me postë, apo në rrugë elektronike.

<sup>262</sup> Shih nenin 26, të Ligjit nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, nuk ka patur parashikime specifike për rregullimin e këtyre çështjeve.

*- Format e dhënies së informacionit.*

Sipas parashikimeve të bëra në Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, kërkuesit i jepej një “kopje e plotë” e dokumenteve që kërkonte, ose një përgjigje “në formë verbale”.<sup>263</sup> Megjithëse në ligj shprehej se, “kërkuesit i jepet informacioni në formën më të përshtatshme”, mendoj se në rastet e personave me aftësi të kufizuar duhej të parashikohej shprehimisht dhënia e informacionit në formën më të përshtatshme për ta, në varësi të paaftësisë që ata kishin. Për shembull, në rastin e të verbërve mund të jepej në formën e shkrimit “Brail”, që aplikohet në shkollat e të verbërve. Gjithashtu një parashikim që duhej shtuar në Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ishte ai sipas të cilit, “kërkuesit i jepen dokumentet në formatin e preferuar prej tij, duke përfshirë dhe formatin elektronik, përveçse kur kjo paraqet vështirësi teknike të konsiderueshme”.

*- Kostoja e pagesave për dhënien e informacionit.*

Në Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përcaktohej se, marrja e informacionit nga autoritetet publike ofrohej prej tyre kundrejt tarifave që, përcaktoheshin vetëm nga shpenzimet materiale për realizimin e shërbimit.<sup>264</sup> Abuzimet e vërejtura ndërkohë në praktikë nga subjekte që, caktonin tarifa tepër të larta dhe artificiale për të vështirësuar marrjen e informacionit nxirrnin në përfundimin se, formulimi i dispozitave përkatëse ligjore nuk ishte i saktë dhe kishte nevojë për përmirësim.

Termi i dhënë në Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, “shpenzimet materiale” mund të interpretohej në mënyra të ndryshme, për shembull, kostot fillestare të mbledhjes apo prodhimit të informacionit janë në një farë mënyre “shpenzime materiale”. Ndërkohë marrja e informacionit njezh edhe forma të tjera, për të cilat nuk është i nevojshëm aplikimi i pagesave të ndryshme, siç p.sh inspektimi i dokumenteve pranë subjektit që i mban ato, ose dërgimi i tyre në formë elektronike, raste në të cilat shërbimi i ofruar duhet të jetë pa pagesë.<sup>265</sup>

Në këto kushte, vlerësoj se ishte i nevojshëm ndryshimi që duhej bërë në ligj, sipas të cilit termi “kosto për realizimin e shërbimit”, duhej të përcaktohej si, “kosto të riprodhimit”. Ky ndryshim duhej të bëhej për disa arsye; në radhë të parë, në vetë principet e së drejtës së informimit termi i parashikuar në lidhje me tarifën e shërbimit nga ana e administratës publike për dhënien e informacionit në këto raste, është “kosto e riprodhimit të dokumentave”; së dyti, termi që jepej në ligj mund të shtonte artificialisht pagesën që përcaktonte autoriteti publik për dhënien e informacionit të kërkuar, pasi në të mund të shtohej edhe koha e punës që i duhej punonjësit përkatës për të prodhuar kopjen e dokumentit të kërkuar, ndërkohë që kjo gjë s’kishte pse të shtohej pasi është punë e paguar nga fondi i pagave të parashikuara për punonjësit; dhe së treti, ky koncept mbështet më mirë edhe të drejtën e subvencionimit,<sup>266</sup> që shteti aplikon për ofrimin e shërbimeve të

<sup>263</sup> Shih nenin 7, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

<sup>264</sup> Po aty, neni 13.

<sup>265</sup> Ky informacion gjendet në Website:

[www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf](http://www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf)

<sup>266</sup> Shih nenin 17, të Ligjit nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

caktuara të administratës, ndaj individëve, apo subjekteve në pamundësi financiare për të paguar detyrimin e tarifës të vendosur për shërbimin e kryer nga ana e administratës.

*-Shtesa e kriterëve përjashtimore.*

Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, në përmbajtjen e tij nuk parashikonte kriterë materiale specifike për kufizimin e së drejtës së informimit; siç arsyet për mosdhënien e dokumenteve/informacioneve zyrtare të kërkuara nga individët, të kushtëzuara nga kërkesa të sigurisë kombëtare, jetës private, sekretit hetimor etj.<sup>267</sup> Në nenin 3 të ligjit përdorej vetëm kriteri ndalues i përcaktuar shprehimisht: “përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe”. Ky formulim i dhënë duke patur një natyrë shumë të përgjithshme identifikonte një perceptim jo të drejtë, të diskrecionit të organeve të administratës publike dhe mund të konsiderohej si një pjesë problematike e këtij ligji.

Ligjet për të drejtën e informimit kanë gjithmonë një natyrë disi radikale për arsyen se përmbysin prezumimin dhe mendësinë tradicionale burokratike se, informacioni i shtetit është sekret, përveçse në raste të veçanta kur ai mund të bëhet publik. Ligjet specifike në këtë fushë e thyjnë këtë mendësi dhe koncept duke sanksionuar parimin se, si rregull, informacioni shtetëror është publik, përveç disa rasteve përjashtimore kur, për arsye të përcaktuara qartë, informacioni mund të konsiderohet i rezervuar.

Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përmbante atë formë kufizimi në aksesin për dokumentet zyrtare, që shpreh hartimin e përmbajtjes së tij në një masë të dukshme në kulturën e të ashtuquajturave “reflekte të sekretit”.<sup>268</sup> Reformimi i ligjit në këtë pjesë të tij mund të referohej tek Ligji nr.9154 datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i cili në nenin 65 të tij, përmbante një listë kriteresh për mosdhënien e informacionit arkivor, të përcaktuara në përmbajtje gati fjalë për fjalë, me përcaktimet respektive të Rekomandimit (2002)2, të Këshillit të Europës.

Përvoja e krahasuar në këtë fushë mund të përmbliidhet në parimet e mëposhtme:

- ligji i informimit duhet të parashikojë një listë shteruese të kriterëve për mosdhënien e informacionit;
- lista duhet të përfshijë vetëm interesa të rëndësishme publike ose private, mbrojtja e të cilave bën të domosdoshme ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit;
- kriteret e ligjit operojnë në mënyrë autonome dhe përgjithësisht kanë epërsi mbi kufizimet e përcaktuara në ligje të tjera;
- në çdo rast që refuzon një kërkesë për informacion, subjekti që detyrohet të japë informacion sipas ligjit, duhet të bëjë të ditur arsyen konkrete të refuzimit të parashikuar në ligji;
- pavarësisht nga dëmi që mund t'i shkaktohet interesave publike apo private të parashikuara në ligj, në respektim të parimit të interesit publik superior informacioni duhet të jepet në qoftë se, publikimi i tij i shërben një interesi publik më të madh;<sup>269</sup>

<sup>267</sup> Shih nenin 4, të Rekomandimit (2002) 2, të KE.

<sup>268</sup> Ky informacion gjendet në Website:

[www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf](http://www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf)

<sup>269</sup> Shih nenin 66, të Ligjit nr.9154 datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

- përveçse kur ligji parashikon kufizime taksaktive ose cënohen interesat e të tretëve, dhënia ose jo e informacionit duhet të mbetet në diskrecionin e institucionit.

*- Harmonizimi me regjimet e klasifikimit të informacionit*

Miratimi i një ligji që përcakton regjimin juridik bazë për të drejtën e informimit ka si kërkesë parësore në momentin e miratimit dhe të hyrjes në fuqi, harmonizimin me legjislacionin tjetër ekzistues në fuqi, i cili ndalon ose kufizon publikimin e informacioneve shtetërore. Si parim, që informacioni të jetë sa më i hapur për publikun, duhet të kalojë barrierat e kufizimit të aksesit të publikut në të. Kjo kërkesë shtrohet edhe në rastin e klasifikimit të informacionit për motive të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Referenca për këtë kërkesë të hamonizimit mund të bëhet tek Ligji nr.8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar, i cili krijon një sistem klasifikimi me katër nivele: informacione “tepër sekret”, “sekret”, “konfidenciale” dhe “i kufizuar”, por edhe në ligje të tjera ku gjenden klasifikime të ngjashme të sekretit policor, hetimor etj. Rregulli i përgjithshëm në praktikën e krahasuar është që, klasifikimi i një dokumenti të caktuar, si rregull, nuk duhet të rezultojë automatikisht në refuzimin e kërkesës për informim.

Pra, pavarësisht nga klasifikimi, kërkesa e individit duhet të shqyrtohet në bazë të kriterëve të ligjit për informim dhe rrethanave konkrete; në rast se interesi publik kërkon publikimin e dokumentit në fjalë, ai duhet të deklasifikohet sipas rregullave dhe t’i jepet kërkuarit. Rishikimi i klasifikimit në këto rrethana bëhet akoma më i rëndësishëm po të kemi parasysh se, një pjesë e madhe e dosjeve të klasifikuara, sidomos në arkiva, janë klasifikuar sipas rregullave dhe praktikave të vjetra tashmë që i nështroheshin rregullimeve të tjera ligjore. Në këtë këndvështrim mbetet parësore që, kuadri i transparencës të mbisundohet nga përparësia që ka interesi publik për njohjen dhe marrjen e dijenisë për çështje që ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në tërësinë e elementeve që ndikojnë në standardin, apo cilësinë e marrëdhënies të së drejtës për informim, ndaj interesave të kufizuara që shpesh mbartin interesa individuale, apo edhe të një grupimi të pakrahasueshëm me termin “publik”.<sup>270</sup>

Megjithë kategorizimin e disa dokumenteve zyrtare dhe kriterin e vendosur të një afati kohor si kusht për kufizimin e aksesit në këto dokumente, të përcaktuara shprehimisht në Ligjin “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, apo në Ligjin “Për arkivat”, përsëri legjislatori ka parashikuar mjetin ligjor të veprimit diskrecial, që konsiston në deklasifikimin e informacionit nga të klasifikuar në të paklasifikuar, si dhe lejen për shfrytëzim të parakohshëm të dokumenteve, apo të drejtën e deklasifikimit, që ka Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për dokumentet e klasifikuara “sekret shtetëror”.

Megjithëse legjislacioni në fuqi në kohën e efektshmërisë juridike të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, e jepte këtë mundësi, administrata e ngarkuar me zbatimin e tij nuk e ushtronte diskrecionin ligjor të dhënë, jo vetëm për shkak të një mentaliteti “tërheqjeje”, por edhe si pasojë e mungesës së harmonizimit të parashikimeve

<sup>270</sup> Ky informacion gjendet në Website:

[www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf](http://www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf)



të dispozitave të Ligjit “Për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare”, me dispozitat e legjislationit të sipërcituar në fuqi. Në këtë kuptim, duhet të dalë i qartë momenti kur individi me kërkesën e tij për ushtrimin e të drejtës së informimit bëhet bartës i interesit publik, fakt i cili mund dhe duhet të shërbejë si shtytës për vënien në lëvizje të kësaj të drejte diskrecioni, që kanë autoritetet e sipërcituar për deklasifikim, apo për dhënie leje për shfrytëzim të parakohshëm të dokumenteve që u kufizohet shërbimi.<sup>271</sup>

Sa herë që paraqitet një kërkesë për informacion në këto kushte, mekanizmi ligjor që duhet të veprojë, duhet të shërbejë për fillimin e një procedimi administrativ për deklasifikimin e dokumentit zyrtar rast pas rasti dhe të mos lidhet shprehimisht, me afatet e paracaktuara të maturimit (psh tek arkivat), apo me faktin e klasifikimit paraprak që i është bërë dokumentit përkatës. Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, rezultonte në këto kushte, pasi i mungonte parashikimi i kriterit sipas të cilit, vendimi për dhënien ose jo të dokumenteve duhet të jepej pas vlerësimit rast pas rasti, të kriterëve ligjore dhe interesit publik, dhe jo në bazë të afateve arbitrare.

#### *- Krijimi i zyrave të informimit publik*

Lehtësirat strukturore e praktike për marrjen nga ana e publikut të informacionit për dokumentet zyrtare, ishin një detyrim i përcaktuar nga dispozitat e Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Fakti është se, identifikimi i lehtësive strukturore dhe praktike bëhet nëpërmjet zyrave të informimit, si struktura të specializuara për marrjen dhe trajtimin e kërkesave për informim.

Eksperienca dhe praktika administrative dhe legjislative e vendeve ku ka kohë që aplikohet një ligj për të drejtën e informimit, njeh krijimin e zyrave të informimit si struktura të domosdoshme bashkërenduese të të gjitha proceseve që lidhen me realizimin e së drejtës për informim rast pas rasti, me strukturat e tjera brenda një institucioni, përgjegjëse për dhënien e informacionit. Për këtë arsye është e nevojshme që në bazë të përcaktimeve ligjore të krijohet dhe të funksionojë infrastruktura për lehtësimin dhe zbatimin korrekt të ligjit, me pasojë respektimin dhe zbatimin e të drejtës për informim.

Eksperienca e zbatimit të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, tregonte një lloj konfuzioni në këtë drejtim, pasi mungonin aktet nënligjore që vetë organet e administratës publike duhej të nxirrnin në zbatim të ligjit, ku edhe do të parashikohej ndër të tjera krijimi i këtyre zyrave specifike. Nga ana tjetër evidentohet se, mungonin personat zyrtarë përgjegjës, të ngarkuar me një funksion kryesor të punës së tyre, zbatimin dhe respektimin e së drejtës për informim. Koncepti i zyrës përfshin në vetvete ambientin konkret, pajisjet konkrete dhe personat konkretë që punojnë brenda saj. Kjo gjë do të ishte ideale për qëllimin e realizimit sa më korrekt të së drejtës për informim.

---

<sup>271</sup> Ky informacion gjendet në Website:

[www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimineligjineinformimit.mars07.pdf](http://www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimineligjineinformimit.mars07.pdf)

Në këto kushte, krijimi i zyrës mund të mbetet si koncept, minimalisht tek caktimi i një personi zyrtar “key person”, i cili qoftë me kohë të plotë pune, apo edhe të pjesshme, do të përgjigjej për të drejtën e informimit. Kjo mënyrë strukturimi, duhej të synonte rritjen e përgjegjësisë për zbatimin e ligjit, dhe adresimin e saktë të përgjegjësisë, në rast të shkeljes së të drejtës për informim. Krijimi dhe modalitetet bazë të funksionimit të këtyre zyrave duhet të përcaktoheshin në ligj, gjë që mungonte në përmbajtjen e dispozitave të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

## **2.5 Problematika të ndeshura në përmbajtjen e dispozitave të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”**

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” vlen të ndalemi dhe analizojmë regjimin juridik, që ky ligj rregullon shprehimisht. Thelbi i ushtrimit të kësaj të drejte, lidhet me të drejtën e çdo personi për t’u njohur me informacionin publik të mbajtur nga “autoriteti publik”, nëpërmjet dokumentit origjinal, ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin, që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit dhe pa u detyruar të shpjegojë motivet.<sup>272</sup> Nisur nga përmbajtja e dispozitave të këtij ligji vërehet se ka përmirësim të regjimit të së drejtës për informim, sa i takon:

- *Përcaktimit të programit të transparencës*, si një dokument i detyrueshëm për autoritetet publike, me qëllim garantimin e transparencës dhe të konkretizimit të zbatimit të Ligjit “Për të drejtën e informimit”.

-*Zgjerimit të rrethit të subjekteve që kanë detyrim dhënien e informacionit*. Bazuar në kërkesat për zgjerimin e rrethit të subjekteve që kanë detyrimin për dhënie informacioni, përkufizimi i dhënë tashmë në Ligjin “Për të drejtën e informimit”, për “autoritetin publik”,<sup>273</sup> është më i gjerë dhe përfshin një spektër më të plotë subjektësh seç parashikonte Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

- *Shtesës së kriterëve përjashtimore*. Aktualisht neni 17, i Ligjit “Për të drejtën e informimit” jep një listë kriteresh specifike kufizuese, por autorizon edhe një proces deklasifikimi rast pas rasti, për dokumentet e klasifikuara “sekret shtetëror”, nga ana e autoritetit publik.

- *Afatet për dhënien e informacionit*. Sistemi aktual i afateve për trajtimin e kërkesave për informim sipas Ligjit “Për të drejtën e informimit”,<sup>274</sup> ka një shkurtim të ndjeshëm, krahasuar me afatet e mëparshme të dhëna në Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

- *Caktimit të një personi përgjegjës për trajtimin e kërkesave për informim*. Koordinator i së drejtës për informim, luan tashmë një rol kyç për zbatimin e ligjit, si dhe për bashkërendimin e punës për garantimin e të drejtës së informimit.<sup>275</sup>

---

<sup>272</sup> Shih nenin 3, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>273</sup> Po aty, pika 1, e nenit 2.

<sup>274</sup> Po aty, neni 15.

<sup>275</sup> Po aty neni 10.

- *Sanksioneve dhe dëmshpërblimit*. Në Ligjin “Për të drejtën e informimit”, kemi një rregullim të qartë, të parashikimit të kundërvajtjeve administrative dhe sanksioneve përkatëse, në kuptim të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative.<sup>276</sup>

Megjithatë, sikurse është evidentuar në pjesë të mëparshme të këtij punimi, pavarësisht përmirësimit të regjimi juridik të së drejtës për informim, me hyrjen në fuqi të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, zbatimi i ligjit ka evidentuar problematika që nxjerrin nevojën e ndryshimit dhe përmirësimit të dispozitave të tij. KDIMDhP ka një rol shumë specifik në zbatimin e dispozitave të këtij ligji, duke u shfaqur në rolin mbikqyrës apo të kujdestarit të zbatimit të dispozitave të tij, ndërkohë që përcaktohet si një organ administrativ, pjesë e ankimit efektiv administrativ ndaj vendimmarrjes së autoritetit përkatës publik, në rastet e trajtimit të kërkesave për informim.<sup>277</sup>

Mbi bazën e këtij përcaktimi mbetet e paqartë kompetenca që i njihet Avokatit të Popullit, në pikën 7, të nenit 24, të ligjit ku thuhet shprehimisht se: “Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk çënon kompetencat e Avokatit të Popullit lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar”. Si një çështje shumë e rëndësishme mbetet saktësimi dhe qartësimi i kompetencave të Avokatit të Popullit, në raport me të drejtën për informim, sipas regjimit juridik të kësaj të drejte, të përcaktuar në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Një tjetër problematikë e ndeshur konsiston në mënyrat e dhënies së informacionit të kërkuar, nga ana e autoritetit publik. Aktualisht ligji i lë “dorë të lirë” autoritetit publik për të vendosur ndaj formës së dhënies së informacionit, që nuk ka të bëjë me një dokument të shkruar. Vështirësia qëndron në këtë parashikim, në rastet kur personi kërkues ka të nevojshme një formë shumë specifike të dhënies së informacionit të kërkuar për shkak të paaftësisë fizike së tij. Sa i përket formave të tjera të dhënies së informacionit, pika 3, e nenit 14 të këtij ligji, parashikon se, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

Ky standard i ri i vendosur nga ligji, mendoj se përkeqëson pozitën e kërkuesit në raport me autoritetin publik, pasi parësor në formën e dhënies së informacionit nuk konsiderohet më interesi i kërkuesit, por interesi i autoritetit publik, që sidoqoftë në këto rrethana nuk mund të konsiderohet në kushtet e interesit publik. Ligji i shfuqizuar tashmë, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përcaktonte një rregullim më të mirë në këtë drejtim, pasi varësisht mundësive objektive të autoritetit publik për formën e ofruar së informacionit, interesi i subjektit kërkues trajtohej si parësor në këtë moment procedural. Për këtë arsye, është e nevojshme të ketë një rregullim specifik në ligj, apo me ndonjë akt tjetër nënligjor, për lehtësirat për formën e dhënies së informacionit, në rastet kur ai kërkohet nga personat me aftësi të kufizuar, pa lënë një marzh diskrecioni tërësisht të

<sup>276</sup> Shih nenin 18, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>277</sup> Po aty, neni 24.

papërcaktuar në duart e autoriteteve publike mbi këtë çështje, sikurse aktualisht ndodh në dispozitat e ligjit “Për të drejtën e informimit”.<sup>278</sup>

Refuzimi i kërkesës për formën e kërkuar duhet bërë sipas dispozitave të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, me shkrim dhe i arsyetuar. Kjo mënyrë e zgjedhur për trajtimin e përcaktimit të formës së dhënies së informacionit të kërkuar, mendoj se zgjat në vetvete procedurat ligjore të shqyrtimit të një kërkesë për informim. Kjo pasi krijon mundësinë që kërkuuesi formalisht të ankimojë në rrugë administrative apo edhe gjyqësore, aktin administrativ të refuzimit, por gjithmonë në dëm të afateve dhe rëndësisë që ka marrja e informacionit në kohën e duhur. Informacioni i vonuar është informacion i mohuar dhe në konkluzion të qëllimit konceptual të së drejtës për informim, vonesa në dhënien e informacionit përbën shkelje të së drejtës për informim. Ky është një konkluzion që vlen specifikisht në diskutimin e kësaj çështjeje.

Nga monitorimi që i është bërë deri tani nga shoqëria civile zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” është konstatuar se, një nga problemet më të mprehta që buron nga mangësitë e ligjit mbetet vështirësia e ekzekutimit të vendimeve të KDIMDhP. Ligji nuk parashikon asnjë mjet ligjor për vënien në ekzekutim të vendimeve, por vetëm ekzekutimin e gjobave, vendimi për të cilat njihet si titull ekzekutiv. Për këtë arsye del i nevojshëm shtimi i një parashikimi në ligj për të mundësuar ekzekutimin me forcë të vendimeve të KDIMDhP.<sup>279</sup>

## **2.6 Mbrojtja ligjore e veçantë, për individët “Bilbilfryrës”.**

Megjithëse, tendenca e përgjithëshme tregon rritje të garancive për ushtrimin e së drejtës të informimit në shumë vende,<sup>280</sup> përsëri në shumë prej tyre aksesit në informacion është i pamjaftueshëm, sidomos në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”. Në rajonin gjeografik të Europës qendrore dhe lindore, “një numër domethënës vendesh kanë miratuar me sukses legjislacionin e së drejtës për informim, por jo të gjithë ata kanë parë përfitimet e pritshme të një kulture të përmirësuar të transparencës dhe të besueshmërisë në qeverisje”.<sup>281</sup>

Kësaj pamjaftueshmërie aksesit, shpesh i shtohet tendenca në rritje për kufizimin e së drejtës për informim. Kufizimet janë të nevojshme në një shoqëri demokratike për të mbrojtur interesa të sigurisë kombëtare, të zbatimit të ligjit, privatësisë, sekretit tregtar, apo të sigurisë publike ose individuale dhe ato duhet të aplikohen vetëm për informacionin për të cilin mund të demonstron se mund të shkaktojë një dëm specifik, që lidhet me të, të njohur ndryshe si informacion në termat e sekretimit. Në këtë kuptim, rol të rëndësishëm për vendosjen e një raporti të drejtë ndërmjet aksesit në informacion dhe kufizimit të tij

<sup>278</sup> Shih nenin 14, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>279</sup> Këto konstatime janë bërë nga Qendra “Res Publica”, në botimin “E drejta e informimit në bankoprovë – studim mbi efektivitetin e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe një krahasim me Ligjin nr.8503/1999”, Dhjetor 2015.

<sup>280</sup> Mbi 90 shtete kanë adoptuar ligje që garantojnë të drejtën për informim, ndërkohë që kjo e drejtë është njohur dhe garantuar në shumë marrëveshje ndërkombëtare.

<sup>281</sup> Article 19, Global Campaign for Free Expression, “Promoting practical access to democracy – A survey of Freedom on Information in Central and Eastern Europe”, London, October 2002, page 3. Website:europa@article19.org

luajnë parimet ndërkombëtarisht të pranuar, për hartimin dhe efektivitetin e zbatimit të legjislacionit të së drejtës për informim, ku vend specifik zë parimi i mbrojtjes të individëve “Bilbilfryrës”.<sup>282</sup>

Pikërisht, një kuadër i plotë ligjor i së drejtës për informim, përfshin mbrojtjen e “Bilbilfryrësve”, pasi ata marrin përsipër të thyejnë një rregull ligjor për të mbrojtur një interes madhor, duke bërë publik një informacion të klasifikuar. Akti civil i këtyre individëve plotëson dimensionin universal të së drejtës për informim. Pa “Bilbilfryrësit”, ne nuk do të mund të mësonim për problemet e mëdha, derisa të vinte koha për të vuajtur pasojat e tyre. Në përpjekjen për të mbrojtur ata, në fakt shoqëria përpiqet të mbrojë vetveten.

Por çfarë përfaqësojnë këta individë? Fjala “Bilbilfryrës”, i referohet një veprimi të kryer me këtë mjet sinjalizues, nga një individ, për të treguar një veprim që bie në kundërshtim me rregullin ose ligjin, apo për të treguar një krim. Termi “Bilbilfryrës”, është një hyrje relativisht e re në fjalorin e çështjeve të interesit publik, megjithëse vet fenomeni nuk është i tillë. Përkufizimet që jepen për “Bilbilfryrësit”, si një fenomen universal janë të ndryshme.

Ndër to mund të përmenden: “Bilbilfryrësit” janë ata, të cilët bëjnë publik një informacion rreth diçkaje që ata besojnë se është e dëmshme për interesin publik, e cila është duke ndodhur në biznes, apo në qeverisje.<sup>283</sup> Sipas një përkufizimi tjetër; “Një Bilbilfryrës është një person, i cili ngre shqetësimin në lidhje me, apo zbulon keqadministrimin që, është duke ndodhur në një vend pune, apo organizatë. Duke marrë përsipër një rrezik personal të madh, ata “i fryjnë bilbilit” për të bërë të ditur keqmenaxhimin në vendin e punës.<sup>284</sup> Një “Bilbilfryrës” është një individ, i cili raporton keqmenaxhimin apo keqbërjen, tek njerëzit apo entitetet që kanë pushtetin për të ndërmarrë veprime korrektuese, përfshirë këtu juristët e “Bilbilfryrësve”, të cilët përfaqësojnë ata në prezatimin e çështjeve të tyre në qeveri dhe në përgatitjen e një kërkesë-padie. Zakonisht keqmenaxhimi është një shkelje e rregullave apo e ligjit, që kërcënon në mënyrë të drejtëpërdrejtë interesin publik.<sup>285</sup>

Organizata joqeveritare “Article 19”, në një model-ligj për lirinë e informimit të hartuar në vitin 2001, jep një tjetër përkufizim të “Bilbilfryrësit”. Sipas tij, askush nuk mund të jetë subjekt i ndonjë sanksioni ligjor, administrativ ose i sanksioneve në lidhje me punën, pavarësisht nga ndonjë shkelje e detyrimeve ligjore ose atyre të punës, për dhënien në mënyrë jo të rregullt të informacionit që mund të zbulojë një rrezik serioz për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin, për sa kohë ata kanë vepruar në mirëbesim dhe me besimin e

---

<sup>282</sup> Në parimin 9, si pjesë e parimeve të legjislacionit për të drejtën e informimit, parashikohet se: “Individët që japin informacion mbi kundërvajtjet, bilbilfryrësit, duhet të mbrohen”.

Website: <http://www.gn.apc.org/article19>.

<sup>283</sup> Ky përkufizim gjendet në Website: [www.canadianlawsite.ca/whistle-blower.htm](http://www.canadianlawsite.ca/whistle-blower.htm)

<sup>284</sup> Ky përkufizim gjendet në Website: [www.ehow.com/about\\_6587381\\_definition-whistleblowers.html](http://www.ehow.com/about_6587381_definition-whistleblowers.html)

<sup>285</sup> Ky përkufizim gjendet në Website: [www.consumerinjurylawyers.com/whistleblower/famous.html](http://www.consumerinjurylawyers.com/whistleblower/famous.html)

arsyeshëm se informacioni garantonte vërtetësinë dhe se nxirrte fakte për rrugën e gabuar ose një kërcënim serioz për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin”.<sup>286</sup>

Pavarësisht diferencave të vogla në përkufizime, qëndrimi i përbashkët është se, këta individë duke vepruar në mirëbesim dhe me besimin e arsyeshëm se informacioni ka qenë thelbësisht i vërtetë dhe ekspozon fakte që përbëjnë një çështje serioze në interes të publikut, bëjnë publike informacione që zbulojnë shkelje të ligjit, shpërdorim të fondeve publike, korrupsion, rrezik ndaj shëndetit, kryerjen e një akti kriminal, keqadministrim të institucionit publik apo privat, rrezikshmëri ndaj shëndetit publik, kërcënim ndaj mjedisit, apo çdo shkelje tjetër.

Akti i kryer në këto kushte, nuk mund të konsiderohet si mungesë besnikërie ndaj punëdhënësit, por si një përmbushje dhe ushtrim i përgjegjësisë civile, të lidhur pazgjidhshmërisht me dobishmërinë reale ndaj interesit publik. Në këtë kontekst, “interesi publik”, do të përfshinte situatat ku përfitimet e ekspozimit të informacionit tejkalojnë dëmin, ose atje ku një mjet alternativ për nxjerrjen e informacionit është i nevojshëm për të mbrojtur një interes kyç.<sup>287</sup>

Edhe nëse informacioni mund të jetë konfidencial, apo i rezervuar në bazë të një përcaktimi normues, veprimi i “Bilbilfryrësve” kapërcen kufijtë e ngurtë të ligjit, me qëllim që të sjellë tek publiku të vërtetën që, shpesh fshihet për të mbuluar abuzimin me pushtetin, apo mbizotërimin e interesave të ngushta, në dëm të interesit publik. Aplikimi real i këtij parimi shërben për të provuar se, pavarësisht ekzistencës së kufizimeve në ushtrimin e së drejtës ka përjashtime, të cilat zhvlerësojnë kufizimin e informacionit të çfarëdolloj kategorie goftë ai, për aq sa ky i fundit realisht nëse aksesohet flet dukshëm në interes të publikut.

Një individ, i cili bën publik një shpërdorim, apo shkelje ligji, mbi bazën e një shqetësimi të ndershëm për interesin publik ka të drejtë për më shumë respekt se dikush tjetër që vepron për arsye, thjesht të vetat. Realiteti ka treguar se, në të shumtën e rasteve arsyet e një personi për t’u bërë “Bilbilfryrës”, nuk mund të përcaktohen objektivisht, pasi ato mund të jenë një përzierje motivesh fisnike dhe egoiste. Në përkufizimet e dhëna për “Bilbilfryrësit”, shihet qartë se mirëbesimi dhe besimi i arsyeshëm se informacioni ka qenë thelbësisht i vërtetë janë kërkesat dhe komponentët bazë të legjitimitetit të këtij akti dhe të garantimit të mbrojtjes për individin që e kryen atë. Megjithatë, rreziku i kërkesës së mirëbesimit është se, ky akt mund të dekurajohet, nëse te punësuarit ndjejnë frikën se motivet e tyre për kryerjen e tij do të vihen në pikëpyetje.

Në Britaninë e Madhe, hetimi për çështjen Shipman, ku u hetua se si një doktor ishte i aftë të vriste mbi 200 prej pacientëve të tij para se të kapej, rekomandoi heqjen e kërkesës së “mirëbesimit” nga Ligji i Deklarimit të Interesit Publik. Ai paralajmëroi se, nëse një anëtar

---

<sup>286</sup> “Article 19”, Qendra për Politika Alternative, Inisiativa për të Drejtat e Njeriut në Komonuelth, Komisioni i të Drejtave të Njeriut në Pakistan- “Një model ligji për lirinë e informimit”, (neni 47/1, pjesa VII) - Korrik 2001, Website: <http://www.article19.org>.

<sup>287</sup> Article 19, “Parime mbi legjislacionin e lirisë së informacionit”- botim si pjesë e një projekti rajonal të financuar nga BE, “E drejta e informimit”, me pjesëmarrje të Shqipërisë, Bullgarisë, Malit të Zi, Rumanisë dhe Kroacisë, Tiranë 2001, faqe 11.

i stafit të Shipman, i cili personalisht nuk e pëlqente atë do të kishte dyshuar në sjelljen e tij, atëherë ky person nuk do të kishte gëzuar mbrojtjen e ligjit.<sup>288</sup>

Diskutimi që bëhet në këtë rast është nëse, duhet të ndodhë një marrëdhënie e ndërsjelltë e padiskutueshme ndërmjet mirëbesimit dhe motivit, të cilët shtojnë një individ për të kryer aktin e “bilbilfryrjes”. Edhe nëse një “Bilbilfryrës” vepron për arsye egoizmi, siç është dëshira për t’u rritur në detyrë, informacioni që ai bën publik mund të jetë me përfitim sinjifikativ për publikun. Një qasje më racionale dhe objektive, është të kërkohet që një “Bilbilfryrës”, “ka arsye të mirë për të besuar” se, bërja publike që ai po realizon është në të mirë të interesit publik, në vend që të kërkohet se, motivi “aktual” i personit është që t’i shërbejë interesit publik. Një punëmarrësi i cili bën publik një informacion, për të cilin ai ka dijeni se është fals, me qëllim që të dëmtojë reputacionin e një personi fizik, apo juridik, nuk mund t’i jepet një mbrojtje e tillë.

Në datën 28 Nëntor 2010, Wikileaks filloi publikimin e 251.287 informacioneve të marra nga kabllot e Ambasadave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sasia me e madhe e dokumentave konfidenciale që janë bërë ndonjëherë publike. Ndërkohë, 391.832 raporte konfidenciale për luftën në Irak, u bënë publike në 22 Tetor 2010, pa harruar këtu ditarin e luftës në Afganistan të bërë publik në 25 Korrik 2010. Për këto arsye, përfaqësuesi i Wikileaks, Julian Assange është diabolizuar nga individë, apo grupe të caktuara si një anarkist i shkujdesur, “me duar të përgjakura”, por gjithashtu është lavdëruar nga të tjerë si një “Bilbilfryrës” i guximshëm, i gatshëm të rrezikojë jetën e tij për të treguar të vërtetën”.<sup>289</sup>

“Bilbilfryrësit” qëndrojnë ballas për t’u dalluar dhe ngrejnë shqetësimet e tyre hapur. Ata janë e kundërta e informatorëve anonimë, të cilët janë të përkëdhelurit e sistemeve autoritare. Ata janë gjithashtu të ndryshëm nga burimet konfidenciale, apo “off-the record”, tek të cilat varen gazetarët për të informuar historitë e tyre.<sup>290</sup> Në kushtet kur “Bilbilfryrësit” bëjnë publike informacione të klasifikuara, realisht ata marrin përsipër një rrezik të madh personal. Për këtë arsye, është e nevojshme t’u garantohet mbrojtje ligjore. Është gatishmëria për të qëndruar për një princip dhe rreziku i hapur i gjykimit, që dallon aktin e këtyre individëve nga praktika të tilla si, kritikizmi i brendshëm, apo rrjedhjet anonime të informacionit.

“Bilbilfryrësi” konsiderohet si një hero, apo një tradhtar, një mirëbërës apo një ekscentrik, një luajtës roli apo një trazovaç, jo konformist, në varësi të këndvështrimit të gjithkujt.<sup>291</sup>

---

<sup>288</sup> Hetimi Shipman, 11.32; Website: [www.the-shipman-inquiry.org.uk/5r\\_page.asp?id=4667](http://www.the-shipman-inquiry.org.uk/5r_page.asp?id=4667)

<sup>289</sup> Ky informacion gjendet në, Website: [www.canadianlawsite.ca/whistle-blower.htm](http://www.canadianlawsite.ca/whistle-blower.htm). Në të vërtetë është e vështirë të gjykojnë arsyet që shtojnë drejtuesit e “Wikileaks”, të kryenin aktin e “bilbil-fryrësit”. Por pavarësisht kësaj, mbarë bota njohu informacione realisht të interesit publik, të cilat kanë vijuar të botohen në këtë faqe kohë pas kohë. Për të nxjerrë një konkluzion paraprak, mjafton të shihen reagimet e një sërë figurash publike në SHBA, apo edhe në Shqipëri e vende të tjera për këtë ngjarje, si dhe se çfarë ka ndodhur me Assange në dyert e gjykatave.

<sup>290</sup> Dehn G., & Calland R.: “Whistleblowing the State of the Art-The role of the individual, organizations, the state, the media, the law and civil society”.

Website: [www.baselgovernance.org/fileadmin/docs/pdfs/Brownbag/WHISTLEBLOWING\\_intro.pdf](http://www.baselgovernance.org/fileadmin/docs/pdfs/Brownbag/WHISTLEBLOWING_intro.pdf)

<sup>291</sup> Website: [www.hindu.com/thehindu/op/2003/03/25/stories/2003032500110200.html](http://www.hindu.com/thehindu/op/2003/03/25/stories/2003032500110200.html)

Por kjo veprimtari, krahas dobisë së madhe për publikun njih pritshmërinë dhe tendencën e ndëshkimit prej palës, e cila rezulton “e dëmtuar” nga publikimi i informacionit. Punëdhënësit mund të tentojnë të “marrin hak” ndaj “Bilbilfryrësve” nëpërmjet intimidimit, prerjes së orëve të pagueshme, mohimit të pagesës së orëve të kryera jashtë orarit të punës, mohimit të promovimit, pushimit nga puna, apo edhe duke kërkuar fillimin e ndjekjes penale. Në këto kushte është e nevojshme dhënia e garancisë ligjore për mbrojtjen e këtyre individëve,<sup>292</sup> nëpërmjet miratimit të ligjeve që parandalojnë këto veprime, mbrojnë punën dhe sigurinë e “Bilbilfryrësve” dhe që njëkohësisht u jep mbrojtje gjatë proceseve gjyqësore, që mund të ndërmerren kundër tyre.

Pavarësisht njohjes ndërkombëtare në rritje të kontributit që japin “Bilbilfryrësit” për çrrënjosjen e zhvillimeve gërryese të shoqërive moderne, legjislacioni në këtë fushë është ende në fillimet e tij, ndërkohë që vetëm një numër i vogël vendesh kanë miratuar deri më tani një legjislacion të plotë për këtë qëllim.<sup>293</sup> Nisur nga eksperiencia e vendeve që kanë miratuar një legjislacion të tillë, ligji për mbrojtjen e “Bilbilfryrësve”, duhet të shtrijë aplikimin e tij mbi të gjitha institucionet apo organizatat, private apo publike,<sup>294</sup> si dhe të përcaktojë procedura të thjeshta, që duhet të ndiqen nga të punësuarit në sektorin publik, kur ata dëshirojnë të bëjnë publikim të informacionit.

Një tjetër kategori e mundshme së cilës mund t’i jepet mbrojtje është ajo, e cila nuk gjendet në një marrëdhënie punësimi, por që për shkak të kryerjes së aktit të “bilbilfryrjes”, rrezikon ndëshkimin. Këtu mund të përfshihen, ish punonjësit, vullnetaret, studentet, konsulentët e pavarur, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët mund të kenë dijeni për shkeljet e ndodhura në një institucion apo organizatë, por që nuk do të jenë në gjendje të bëjnë deklarin publik, nëse për ta nuk garantohet mbrojtja ligjore e përshtatëshme.

Kjo mbrojtje konsiderohet tashmë një çështje jo vetëm e së drejtës së brendshme, por një çështje e së drejtës ndërkombëtare. Për këtë arsye, instrumenta të ndryshëm ndërkombëtare, si marrëveshje shumëpalëshe, rregullore të institucioneve ndërkombëtare dhe kode etike të sjelljes, parashikojnë në dispozitat e tyre mbrojtje ligjore për ta. Mbrojtja ligjore u jep këtyre individëve forcën dhe kurajon për të bërë publike aktivitete joligjore, të cilat në të kundërt mund të kalonin pa u vënë re.

---

<sup>292</sup> Qëllimi i ligjit është dhënia e garancisë së besueshme se, “bilbilfryrësit” do të mbrohen nga ndëshkimi i çdo lloji, si dhe dhënia e garancisë se, sjellja kriminale, apo edhe sjellja jo kriminale, e cila mund të dëmtojë interesin e gjerë publik do të luftohet në mënyrë efektive.

<sup>293</sup> Ky informacion gjendet ne Website: [www.article19.org/publications/law/legal-analyses.html](http://www.article19.org/publications/law/legal-analyses.html).

<sup>294</sup> Shkelja e ligjit që dëmton interesin publik mund të ndodhë në çdo lloj institucioni apo organizate, ndaj është me vend që, fusha e veprimit të ligjit për mbrojtjen e “bilbilfryrësve” të mos kufizohet vetëm në sektorin publik, siç është rasti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, (megjithëse kjo është një çështje që varion nga shteti në shtet-Whistleblower Protection Act of 1989), në Kanada, Australi, Korenë e Jugut, Argjentinë, Rusi, Sllovakia, Meksikë ose Nigeri, apo t’i referohet vetëm sektorit privat, siç është rasti në Japoni (Whistleblower Protection Act No.122 of 2004). Ndërkohë ka ligje të kësaj fushe, si në Britaninë e Madhe (Public Interest Disclosure Act of 1998), apo në Afrikën e Jugut ((Protected Disclosures Act of 2000), që parashikojnë mbrojtje të “bilbilfryrësve”, si në sektorin privat edhe në atë shtetëror.

Këto informacione gjenden përkatësisht në: Website: [www.article19.org/publications/law/legal-analyses.html](http://www.article19.org/publications/law/legal-analyses.html). Website: [www.cas.go.jp/jp/seisaku/hourei/data/WPA.pdf](http://www.cas.go.jp/jp/seisaku/hourei/data/WPA.pdf)

Website: [www.hindu.com/thehindu/op/2003/03/25/stories/2003032500110200.html](http://www.hindu.com/thehindu/op/2003/03/25/stories/2003032500110200.html)



## 2.6.1 Garantimi i mbrojtjes së “Bilbilfryrësve” në legjislacionin shqiptar

Aplikimi i parimit për mbrojtjen e “Bilbilfryrësve” në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, deri para më pak se dy vitesh,<sup>295</sup> duhet vlerësuar së pari, në ekzistencën e mundshme të *dispozitave të shpërndara në akte të ndryshme normative*, të cilat garantojnë këtë mbrojtje dhe, së dyti, në ekzistencën e *një ligji specifik për mbrojtjen e “Bilbilfryrësve”*.

- a) Sa i përket *mbrojtjes së garantuar në dispozita të shpërndara në akte të ndryshme normative*, një formë e kufizuar e mbrojtjes së “Bilbilfryrësve” mund të parashikohet kryesisht, në ligjet që garantojnë specifikisht të drejtën për informim.

Referuar Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, si një prej ligjeve kryesore në këtë fushë, konstatohet se pavarësisht kohës relativisht të gjatë të zbatimit të tij, përsëri në të nuk gjeje asnjë parashikim për mbrojtjen e “Bilbilfryrësve”. Edhe në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili shfuqizoi ligjin e sipërcituar, vërehet se nuk ka asnjë dispozitë që t’i referohet, apo të parashikojë një mbrojtje, qoftë edhe minimale, për individët “Bilbilfryrës”. Nga një këndvështrim më i gjerë i çështjes, analiza mund të lidhet me faktin nëse informacioni i bërë publik lidhur me funksionimin e përditshëm të administratës publike dhe entiteteve private, nuk bën pjesë në informacion “e klasifikuar” me ligj të posaçëm. Nga ana tjetër, çfarë ndodh në të dyja sistemet e punësimit, publik dhe atë privat, në rast se ky informacion njih një regjim klasifikimi të rregulluar me ligj të posaçëm?

Duke ju referuar kohës së hyrjes në fuqi dhe fillimit të efekteve juridike të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, evidentohet se marrëdhëniet e punës në sektorin privat janë rregulluar në bazë të KP, ndërsa në sektorin publik, këto marrëdhënie janë rregulluar në bazë të KP, si dhe të ligjit nr.8549 datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, të shfuqizuar nga Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në fuqi, përveç rastit të të punësuarve që gëzojnë statusin e ushtarakut, marrëdhënia e cila rregullohet me legjislacion të veçantë. Marrëdhënia juridike e punës, sipas dispozitave të KP, lind në momentin e nënshkrimit të kontratës së punës, ku ndër të tjera mund të bëhen parashikime për detyrimin e punëmarrësit për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të fshehtësisë, për informacione që kanë lidhje me punën e tij duke parashikuar sanksione në rast të shkeljes së këtij detyrimi. Ndërkohë, KP parashikon rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në varësi të shkeljeve që ka kryer punëmarrësi. Respektivisht në nenin 146, të KP, ku parashikohet zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme si një nga mënyrat e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nuk gjen asnjë përcaktim, i cili do të mbronte një punëmarrës, për të cilin si shkak mund të konsiderohet kryerja e aktit të “Bilbilfryrësit”.

---

<sup>295</sup> Kjo referencë bëhet duke konsideruar kohën e hyrjes në fuqi, të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, që i ka shtrirë efektet juridike të tij, prej datës 1 Tetor 2016, përsa i përket detyrimeve të autoriteteve publike dhe prej datës 1 Korrik 2017, për sinjalizimin e brendshëm për subjektet private.

Koncepti i shkeljes së detyrimeve kontraktore në këtë Kod është i gjerë dhe nuk përjashton ndërprerjen e marrëdhënies së punës në rastin e kryerjes së aktit të “Bilbilfryrësit”.<sup>296</sup> Marrëdhënia e punësimit në këto kushte, mund të zgjidhet prej punëdhënësit, i cili ka një justifikim ligjor në termat e shkaqeve të arsyeshme, siç mund të jetë, bërja publike e një informacioni të ndaluar, apo të rezervuar nga ana e punëmarrësit, në kundërshtim me detyrimet kontraktore.

Marrëdhënia e punësimit në sektorin publik, për “nëpunësit civil”, bazohet kryesisht në Ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”, të shfuqizuar nga Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe për rregullime të veçanta, në KP. Pas përfundimit të procedurës së konkurimit, me nënshkrimin e aktit të emërimit, fillon marrëdhënia e punësimit, në bazë të së cilës nëpunësit civil i linden një sërë detyrimesh ligjore,<sup>297</sup> mospërbushja e të cilave mund të shërbejë si shkak për marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga shërbimi civil. Një detyrim i tillë është mosbërja publike në asnjë formë e informacionit “sekret shtetëror”, konfidencial, ose për përdorim të brendshëm, në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore.

Në kategorinë e të punësuarve që gëzojnë statusin e ushtarakut mund të përmenden të gjithë individët, pjesë e FA të Republikës së Shqipërisë, apo pjesë e forcave të Policisë së Shtetit. Legjislacioni në fuqi, që normonte të drejtat dhe detyrimet e ushtarakëve të FA, deri në kohën e hyrjes në fuqi dhe fillimit të efekteve juridike të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, në asnjë dispozitë të tij, nuk garantonte mbrojtjen e atyre ushtarakëve që, në një moment të caktuar mund të viheshin në rolin e “Bilbilfryrësit”. I njëjti konstatim mund të bëhet edhe për legjislacionin që parashikon të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të Policisë së Shtetit.<sup>298</sup> Madje, “për shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore...ushtaraku mban përgjegjësi penale, civile, administrative dhe disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi”.<sup>299</sup> Ndërkohë, sipas një dispozite tjetër ligjore: “Punonjësi i Policisë nuk duhet të japë informacione të klasifikuara, për të cilat ka marrë

---

<sup>296</sup> Në pikat 2 dhe 3, të nenit 153, të Ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, thuhet se:

“2) Vlerësohen si shkaqe të justifikuar të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënies së punës.

3) Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuar për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit.

<sup>297</sup> Si në Ligjin nr.9549 datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, të shfuqizuar, ashtu edhe në Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, në fuqi, detyrimi i nëpunësit civil mbetet respektimi i parimit të konfidencialitetit dhe i parimit të mbrojtjes së sekretit shtetëror.

<sup>298</sup> Duke ju referuar gamës së gjerë të ligjeve dhe akteve nënligjore në këtë fushë, përmendim Ligjin nr.8671 datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të forcave të armatosura së Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr.8930 datë 25.07.2002 “Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr.9171 datë 22.01.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Ligjin nr.9210 datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ku në veçanti rregullohet marrëdhënia e punësimit për këta individë dhe ku nuk gjendet asnjë dispozitë që parashikon mbrojtje për “Bilbilfryrësit”. Edhe në Ligjin nr.9749 datë 4.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, nuk gjen asnjë parashikim të tillë.

<sup>299</sup> Shih nenin 18, të Ligjit nr.9210 datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

dijeni gjatë kryerjes së detyrës ose edhe jashtë saj në mënyrë të rastësishme. Ky është një detyrim zbatim edhe për punonjësit e Policisë, të liruar ose të përjashtuar nga Policia”.<sup>300</sup>

Pra, në të tre rastet marrëdhënia e punësimit është e cënueshme njëanshmërisht nga ana e punëdhënësit, kur punëmarrësi në cilësinë e “Bilbilfryrësit”, bën publik një informacion që nuk i nënshtrohet regjimit të klasifikimit. Edhe ajo pjesë e administratës publike, e cila emërohet në postet që njihen ndryshe si “poste politike”, realisht nuk gëzon mbrojtje në rastin e kryerjes së aktit të “Bilbilfryrësit”.

Çfarë do të ndodhte në rast se, informacioni i bërë publik nga punëmarrësi, i nënshtrohet një regjimi juridik klasifikimi, me ligj të posaçëm? Në ligjin nr.8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, përcaktohet se shkelja e rregullave për administrimin, ruajtjen, nxjerrjen e asgjësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, dënohet sipas ligjeve në fuqi.<sup>301</sup> Shkeljet e kryera, në rast se nuk përbëjnë kundërvajtje administrative, në varësi të rrezikshmërisë shoqërore që ato paraqesin, cilësohen si vepra penale të parashikuara në Seksionin IV, “Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore”, të ligjit nr.7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, apo në Kreun V, “Vjedhje, Shpërdorime, Falsifikime”, të Ligjit nr.8003 datë 28.09.1995 “Kodi Penal Ushtarak”, i ndryshuar.

Në dispozitat e Kodit Penal, si subjekte të kryerjes së veprave penale, përcaktohen; Tregimi i sekretit shtetëror nga *personi që i është besuar*; Tregimi i sekretit shtetëror nga *shtetasit*; dhe Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete; sipas përcaktimit, “personi që i është besuar informacioni sekret shtetëror ose që ka mundur të vijë në dijeni për shkak të detyrës; cilido që ka mundur të vijë në dijeni me këtë informacion; funksionari publik, personi i ngarkuar me një shërbim publik, personat publikë, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, persona të tjerë që kanë dijeni për të dhëna për procedimin penal e që janë lajmëruar nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore”.<sup>302</sup> Në dispozitat e Kodit Penal Ushtarak, thuhet se: “...Shkelja me dashje e këtyre rregullave për administrimin ose ruajtjen e sekretit (*nga ana e ushtarakut të ngarkuar të mbajë nën ruajtje ose administrim sekretin shtetëror apo ushtarak*), kur këto vepra mundësojnë ose lehtësojnë kryerjen e veprimeve në dëm të ruajtjes së sekretit, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet”.<sup>303</sup>

Një përjashtim nga e gjithë kjo zbrazëti ligjore për mbrojtjen e “Bilbilfryrësve”, kanë përbërë dy dispozita ligjore, përkatësisht, në Ligjin nr.9367 datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar<sup>304</sup>

<sup>300</sup> Shih nenin 67, të Ligjit nr.9749 datë 4.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

<sup>301</sup> Shih nenin 30, të Ligjit nr.8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar.

<sup>302</sup> Shih nenet 294, 295 dhe 295/a, të Ligjit nr.7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>303</sup> Shih nenin 68, të Ligjit nr.8003 datë 28.09.1995 “Kodi Penal Ushtarak”, i ndryshuar.

<sup>304</sup> Në germën “a”, të nenit 20, të Ligjit nr.9367 datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, thuhet se:

“Çdo zyrtar apo subjekt, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga subjektet e këtij ligji, përfiton, sipas rastit, një mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:

dhe në Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.<sup>305</sup> Pavarësisht këtyre dispozitave të parashikuara beftas në legjislacion, evidentohet lehtësisht fakti se, para hyrjes në fuqi të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, nuk ka ekzistuar një sistem i mirëfilltë dispozitash ligjore, të shpërndara në legjislacionin në fuqi deri këtë kohë, që do të përfaqësonte një grupim të plotë normash juridike për mbrojtjen e individëve “Bilbilfryrës”.

- b) Sa i përket *mbrojtjes së garantuar në një ligj specifik për mbrojtjen e “Bilbilfryrësve”*, mund të konstatohet lehtësisht se, në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, deri në kohën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, nuk ka patur një ligj specifik për mbrojtjen e individëve “Bilbilfryrës”.

Për më tepër, nuk mund të pretendohet që dispozita të caktuara të ligjeve të tilla si, Ligji nr.9205 datë 15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, Ligji nr.9508 datë 3.04.2006 “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”, apo Ligji nr.10221 date 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,<sup>306</sup> arrinin të krijojnë një kuadër ligjor efektiv, qoftë edhe të pjesshëm, për të garantuar mbrojtjen e individëve “Bilbilfryrës”. Miratimi i një ligji specifik, në këto rrethana paraqitje si një nevojë për vetë fazën e reformimit në të cilën paraqitej përmirësimi i sistemit ligjor në vend. Mungesa e mbrojtjes së posaçme të këtyre individëve në legjislacionin shqiptar, kërkonte një veprim të shpejtë për ndërmarrjen e inisiativës legjislative nga organet shtetërore kompetente.

Gjykoj se, veç shkaqeve të natyrës sociale, kulturore, politike, mungesa e këtij legjislacioni ka përbërë një nga shkaqet kryesore të mungesës së efikasitetit të shfaqur në luftën ndaj korrupsionit dhe përhapjes së tij në vend. Kjo kërkesë bëhej edhe më imperative në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër me ratifikimin e akteve ndërkombëtare, të cilat kërkojnë adoptimin e sistemit të brendshëm ligjor, në përputhje me parashikimet e bëra në to.<sup>307</sup>

Sistemi i përzgjedhur në legjislacionin e brendshëm për mbrojtjen e “Bilbilfryrësve”, është një çështje kritike e transparencës, si dhe një çështje e konkretizimit të vullnetit politik,

---

a) zyrtari, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi subjektin informues dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit, për shkak të dhënies së informacionit”.

<sup>305</sup> Në pikën 2, të nenit 18, të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, thuhet se: “Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave më të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik”.

<sup>306</sup> Shih pikën 8, të nenit 3, të Ligjit nr.10221 datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<sup>307</sup> Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka ratifikuar me Ligjin nr.9492 datë 13.03.2006, Konventën e Kombeve të Bashkuara, kundër Korrupsionit. Në nenin 33, të Konventës thuhet shprehimisht se: “Secili shtet palë shqyrton përfshirjen në sistemin e tij të brendshëm ligjor të masave të përshtatshme për të garantuar mbrojtjen kundër çdo trajtimi të pajustificuar për çdo person që raporton në mirëbesim dhe për shkaqe të arsyeshme te organet kompetente, çdo fakt në lidhje me veprat penale që parashikohen në pajtim me këtë Konventë”.

sidomos në vendet ku rënia e komunizmit dhe tranzicioni politik në demokraci ndeshen me mentalitetin e vjetër qeverisës, të sekretit ndaj publikut. Sado të mira të jenë aftësitë investiguese të aktorëve që mbrojnë dhe promovojnë transparencën, informacioni i brendshëm fillestar i siguruar nga një “Bilbilfryrës”, mbetet kritik në të mirë të transparencës së qeverisjes, të veprimtarisë dobiprurëse publike të biznesit dhe ndërvepron me agjencitë qeveritare në të mirë të publikut, të sigurisë kombëtare dhe të reduktimit të korrupsionit.

Përkundër kësaj situate që ka vazhduar si e tillë deri në muajt e fundit të vitit 2016, Kuvendi i Shqipërisë, miratoi Ligjin nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Miratimi dhe hyrja në fuqi e këtij ligji, gjykoj se ka qënë një kërkesë imediate dhe finalizimi i një nisme të domosdoshme, që duhej të ndërmerrej nga ana e Këshillit të Ministrave, pas përmirësimit të regjimit juridik bazë të së drejtës për informim, me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Qëllimi i përcaktuar i këtij ligji është parandalimi dhe goditja e korrupsionit në sektorin publik dhe atë privat, mbrojtja e individëve që sinjalizojnë veprimet apo praktikave të dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës dhe nxitja e sinjalizimit të veprimeve, ose praktikave të dyshuara të korrupsionit.<sup>308</sup> Pa dashur të jepet një analizë e mirëfilltë e detajuar strukturore e dispozitave të këtij ligji, gjykoj se është e rëndësishme që, mbi bazën e hulumtimit mbi kuptimin dhe sistemet ligjore të garantimit të mbrojtjes së aktit dhe individit “Bilbilfryrës”, të evidentohen disa momente që lidhen me përputhshmërinë dhe standardin e regjimit juridik të ofruar në këtë fushë, nga ana e legjislatorit tonë.

Në përcaktimin e bërë në nenin 1, të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, thuhet se: “Ky ligj përcakton rregullat për sinjalizimin e një veprimi apo praktike të dyshuar të korrupsionit nga sinjalizuesit...”. Në fakt kryefjala e gjithë kësaj veprimtarie është lufta kundër korrupsionit, por jo çdo veprim, apo praktikë e sinjalizuar mund të futet në aspektin e veprave penale të korrupsionit. Sot në botë dhe në legjislationet përkatëse të qëlluara për mbrojtjen e “Bilbilfryrësve” – “Sinjalizuesve”, siç është trajtuar më sipër në këtë punim njihen disa përkufizime mbi këta individë. Pavarësisht diferencave të vogla në përkufizime, e përbashkëta që gjendet në to është se, “Bilbilfryrësit”- “Sinjalizuesit” duke vepruar në mirëbesim dhe me besimin e arsyeshëm se, informacioni ka qënë thelbësisht i vërtetë dhe ekspozon fakte që përbëjnë një çështje serioze në interes të publikut, bëjnë publike informacione të cilat zbulojnë shkelje të ligjit, shpërdorim të fondeve publike, korrupsion, kryerjen e nje akti kriminal, keqadministrim të institucionit publik, apo privat, rrezikshmëri ndaj shëndetit publik, kërcënim ndaj mjedisit, apo çdo shkelje tjetër.

Parë nga ky këndvështrim mendoj se duhet zgjeruar gama e përcaktuar e veprimeve, apo praktikave që mund të sinjalizohen sipas këtij ligji.<sup>309</sup> Përkufizimi i dhënë më sipër, mund

---

<sup>308</sup> Shih nenin 2, të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

<sup>309</sup> Kjo logjikë pasqyrohet edhe në përmbajtjen e pikës 8, të nenit 13, të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Pasqyrimi i rishikimit të sugjeruar duhet të përfshijë edhe një sërë nenesh si, pikën 15, të nenit 3; nenin 4; nenin 5; gërmën “ç”, të pikës 1, të nenit 7; nenin 8; si dhe nenin 11, të këtij ligji.

të shërbejë edhe si një model për të riparë përkufizimin e dhënë në pikën 13, të nenit 3, të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, mbi termin “sinjalizues”.

Në pikën 1, të nenit 6, të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, jepet përcaktimi se: “Sinjalizuesit i ofrohet mbrojtja për sinjalizimin e kryer në kushtet e mirëbesimit, të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni, sipas kritereve të parashikuara në këtë ligj”. Më tej, në këtë nen të Ligjit, jepen detaje të përcaktimit të kushteve të mirëbesimit. Gjykoj se, akti i sinjalizuesit lidhet me mirëbesimin dhe besimin e arsyeshëm se, informacioni ka qënë thelbësisht i vërtetë, si kërkesa këto dhe komponentë bazë të legjitimitetit të këtij akti dhe të garantimit të mbrojtjes për individin që e kryen atë. Mbi këtë bazë mendoj se, këto komponentë duhet të pasqyrohen të plotë në përmbajtjen e nenit 6. Një qasje më racionale dhe objektive është të kërkohet që, një “sinjalizues”, “ka arsye të mirë për të besuar” se, bërja publike që ai po realizon, është në të mirë të interesit publik.

Duke gjykuar se, këto konstatime janë të nevojshme për përmirësimin e dispozitave të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ndaj mendimin se miratimi i këtij ligji është një tjetër ndërmarrje e dobishme në kuadër të transparencës dhe të një demokracie funksionale. Garancia e nevojshme ligjore për mbrojtjen e aktit dhe individëve “Bilbilfryrës” – “Sinjalizues”, kërkon një standard sa më të përputhshëm me praktikën më të mira ligjore në këtë drejtim.

## **2.7 Disa përfundime:**

- Institucioni i AP në Shqipëri, është një risi institucionale e traditës së munguar të krijimit të institucioneve të pavarura, garante kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave lirive dhe interesave të ligjshëm të individit. Thelbi i filozofisë së veprimit, nisur nga modeli klasik i Ombudsmanit, mbetet mbikqyrja për mirëfunksionimin e administratës publike, si oponencë për mirëqeverisje dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.
- Misioni i veçantë i AP, si kujdestar i zbatimit dhe respektimit të së drejtës për informim, i konkretizuar me veprimtarinë e tij në kuadër të promovimit dhe mbrojtjes të së drejtës për informim, derisa kjo kompetencë i ka kaluar KDIMDhP, vlerësoj se ka treguar një rol aktiv, jo vetëm në kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë, por edhe për ekspozimin e një modeli pozitiv zbatues dhe promovues të së drejtës për informim nga ana e AP.
- Mbikqyrja e ushtruar nga ana e AP ndaj institucioneve të sektorit të sigurisë, për zbatimin e legjislationit që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, e koordinuar me veprimtarinë e ekzekutivit, legjislativit dhe pushtetit gjyqësor, vlerësoj se formëson sistemin “Check and Balance”, në sektorin e sigurisë dhe ndikon në respektimin e parimeve të përgjegjshmërisë dhe transparencës në të.

- Mbikqyrja e AP, mendoj se ka arritur të mbulojë gjerësisht pjesën shtetërore të sektorit të sigurisë dhe zë një peshë specifike në punën e këtij institucioni, nëpërmjet mjeteve ligjore si rekomandimet, apo raportet vjetore të veprimtarisë, për vënien në vend të të drejtave të shkelura ndaj individëve, apo trajtimit të ankesave individuale.
- Megjithëse marzhi i mjeteve ligjore në dispozicion të AP përfshin një varietet mjetesh me karakter jo detyrues, vërehet se ai ende nuk po përdor me efektivitet mjete të tilla koherente, sikurse ndërhyrja “Amicus Curiae”. Kjo lidhet me çështje që ndërthurin respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në çdo nivel, përtej kuptimit dhe përdorimit të “Amicus Curiae”, para gjykatës, kuptuar këtu edhe çështjet e sigurisë njerëzore.
- Me qëllim që të sigurohet një pjesëmarrje më e madhe nga subjektet “Amicus”, në kontekstin shqiptar nevojitet një qasje e re, që duhet të krijojë pa mëdyshje mundësinë ligjore për këtë ndërhyrje, me qëllim që baza e pranimit apo kundërshtimit të saj të jetë e parashikuar qartësisht.
- Numri i ulët i ankesave të paraqitura tek AP, mbi shkeljen e së drejtës për informim nga institucionet shtetërore të sektorit të sigurisë, deri në kohën kur kjo kompetencë trajtimi i ka kaluar ekskluzivisht KDIMDhP, gjykoj se ka si shkaqe kryesore mosnjohjen e kësaj të drejte nga ana e publikut dhe një lloj “hermetizimi institucional”, që aplikohet nga këto institucione me justifikimin e mbrojtjes së sekretit shtetëror.
- KDIMDhP identifikon një institucion të ri, të pavarur, të krijuar me ligj që ka zëvendësuar rolin e kujdestarit dhe ka marrë rolin e një autoriteti mbikqyrës për zbatimin e së drejtës për informim, rol ky që mbahej nga AP. KDIMDhP identifikon një institucion që me kohë ka zgjeruar mandatin dhe rrjedhimisht juridiksionin dhe kompetencat që i ngarkohen me ligj, duke përfshirë në kompetencat e tij mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e së drejtës për informim.
- Veprimtaria e shkurtër kohore në mbrojtje të së drejtës për informim, e identifikon KDIMDhP me më shumë mjete ligjore në dispozicion, se sa AP, përfshirë këtu edhe ato me karakter ekzekutiv. Megjithatë KDIMDhP është ende në fazat e krijimit të një fizionomie institucionale me profil promovues dhe mbrojtës të së drejtës për informim, ndërkohë që mund të thuhet se, ai e ka krijuar tashmë këtë profil sa i takon promovimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
- Jurisprudenca e GJEDNJ trajton gjerësisht kuptimin e të drejtës për informim, si pjesë përbërëse e lirisë së shprehjes, si dhe kriterëve për kufizimin e saj. Një mbrojtje dhe rol i veçantë, krahas individit i njihet medias, e cila ka një rëndësi specifike në realizimin efektiv të lirisë së shtypit dhe lirisë së marrjes së informacionit në interes të publikut.

- Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese mbetet e varfër në këtë drejtim. Roli i sistemit gjyqësor, gjykoj se mbetet i panjohur nga individët, sa i përket mbrojtjes të së drejtës për informim. Numri i ulët i çështjeve të trajtuara nga sistemi gjyqësor mbi shkelje të pretenduara të së drejtës për informim mendoj se vjen si pasojë e mosrespektimit nga gjykatat të afateve të shqyrtimit, të kërkesë padive me objekt shkeljen e kësaj të drejte. Kjo gjë mendoj se ndikon negativisht për realizimin e efektivitetit të ankimit të palës së interesuar dhe nuk përmbush një nga kërkesat primare, për respektimin e së drejtës themelore të procesit të rregullt ligjor.
- Vlerësoj se, problematika e konstatuar e përmbajtjes së dispozitave të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” dhe e zbatimit të legjisllacionit mbi të drejtën e informimit, e kondicionuar nga trashëgimia e “hermetizimit” institucional, si dhe kërkesa për përjasje me standardet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë, kanë gjetur pasqyrim në përmirësimin e regjimit juridik të së drejtës për informim, me hyrjen në fuqi, të Ligjit “Për të drejtën e informimit”.
- Ligji “Për të drejtën e informimit”, ka përmirësuar regjimin juridik të së drejtës për informim në lidhje me; Përcaktimin e një rrethi më të zgjeruar të subjekteve që kanë detyrim dhënien e informacionit; Ndryshimin dhe shkurtimin e sistemit të afateve për dhënien e informacionit; Parashikimin konkret që, për çdo shkelje të cilësuar në kushtet e kundërvajtjes administrative, të përcaktohet një nga llojet e dënimeve administrative të parashikuara shprehimisht në legjisllacionin në fuqi rregullator për kundërvajtjet administrative; Harmonizimin me regjimet juridike të klasifikimit të informacionit; Detyrimin për të ndihmuar kërkuesin për saktësim, ose përcjellje të kërkesës për informim; Përcaktimin e saktë të kostos së pagesave për dhënien e informacionit.
- Pavarësisht këtij përmirësimi të regjimit juridik të së drejtës për informim, nevojitet ende ndërhyrje në dispozitat e Ligjit “Për të drejtën e informimit”, për sa i takon; Saktësimin dhe qartësimin të kompetencave të Avokatit të Popullit, në raport me të drejtën për informim, sipas regjimit juridik të kësaj të drejte, të përcaktuar në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”; parashikimit të një rregullimi specifik në ligj, apo me ndonjë akt tjetër nënligjor, për lehtësirat për formën e dhënies së informacionit, në rastet kur ai kërkohet nga personat me aftësi të kufizuara, pa lënë një marzh diskrecioni tërësisht të papërcaktuar në duart e autoriteteve publike mbi këtë çështje; trajtimin të refuzimit të kërkesës për formën e kërkuar të dhënies së informacionit; parashikimit të mjeteve ligjore për vënien në ekzekutim të vendimeve të KMDIDhP.
- Boshllëku ligjor për mbrojtjen e individëve “Bilbilfryrës”, i vërejtur deri në fund të vitit 2016, është plotësuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Pavarësisht sistemit normativ që ai ofron tashmë për mbrojtjen e aktit dhe individit “Bilbilfryrës”-“Sinjalizues”, është e nevojshme që; të zgjerohet gama e përcaktuar e veprimeve, apo praktikave që mund të sinjalizohen sipas këtij ligji; të riformulohet termi “Sinjalizues”, sipas përkufizimit standardizues më të mirë; të pasqyrohen më mirë në dispozitat e ligjit të elementëve



të kuptimit të “mirëbesimit” dhe “besimit të arsyeshëm se, informacioni ka qënë thelbësisht i vërtetë”, si kërkesa dhe komponentë bazë të legjitimitetit të aktit të “bilbilfryrjes” dhe të garantimit të mbrojtjes për individin që e kryen atë.

## V. KREU I TRETË

### KONCEPTI I SIGURISË KOMBËTARE DHE DISA NGA INSTITUCIONET GARANTE TË SAJ NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.

#### 3.1 Koncepti i sigurisë dhe sigurisë kombëtare

Bota nuk është vetërregulluar në mënyrë paqësore, ndaj koncepti i sigurisë shfaqet i lashtë sa vetë ekzistenca njerëzore, duke përfaqësuar një vlerë themelore të marrëdhënieve njerëzore. Ekzistenca në një botë të mbushur plot sfida dhe rreziqe ka nxitur evoluimin e procesit të të menduarit, i cili përmes formave të organizimit shoqëror i ka paraprirë krijimit të mjeteve dhe gjetjes së zgjidhjeve të nevojshme, për më shumë siguri. E lidhur natyrshëm me mbijetesën, ekzistenca ka kushtëzuar shumë procese, përfshirë këtu edhe sjelljen njerëzore.

Nga këndvështrimi evolutiv, siguria nënkuptohet si mekanizëm biologjik, sepse tendenca e organizimit është të mbijetojë, si përshtatje e organizmit ndaj kërcënimeve, të cilët vijnë nga mjedisi jetësor.<sup>310</sup> Siguria si koncept dhe studimet mbi të, sot lidhen me shfaqjen dhe procesin e mbijetesës të aktorëve shtete sovraane dhe sistemit të shteteve në nivel global, duke i patur ata si objekt referues dhe çështje thelbësore, për shkak të rëndësisë së tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe për faktin se, siguria vlerësohet si shqetësimi i tyre më i rëndësishëm. Në kuptim të së Drejtës Ndërkombëtare Publike, shteti është një entitet i bazuar në një territor dhe me një qeveri, e cila administron territorin e saj dhe që njihet në një cilësi të tillë nga shtetet e tjerë. Duke i konsideruar shtetet si objektiva të domosdoshëm të politikës së jashtme dhe asaj të brendshme, studimet mbi sigurinë kanë të përbashkët evidentimin dhe analizimin e kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj mbijetesës së tyre, si në planin e kërcënimeve të jashtme, ashtu edhe në planin e kërcënimeve të brendshme.

Në këtë sens formësohet marrëdhënia zinxhir, individ-shtet, shtet-shtet dhe sistem ndërkombëtar, brenda konceptit të sigurisë. Siguria pra, është vlerësuar si aftësia e Shteteve për të mbrojtur vetveten ndaj kërcënimeve, apo veprimeve kundër integritetit të tyre territorial dhe sovranitetit politik.<sup>311</sup> Siguria e një shteti ndikon së tepëmi në sigurinë që perceptojnë se shijojnë qytetarët e tij.<sup>312</sup> Anasjelltas siguria që perceptojnë shtetet në marrëdhëniet mes tyre ndikon në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Edhe në rastin e aktorëve shtete, mbijetesa është një qëllim kulmor kryesor që, në një ambient të caktuar kushtëzon sjelljen e tyre.

---

<sup>310</sup> Mitrevska M., Grizold A., Buckovski V., Vanis E., (2009): “Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve-Rasti i Maqedonisë (paradigma e re e sigurisë)”, Bomat Grafiks, viti 2009, faqe 29.

<sup>311</sup> Oberleitner G., (2002): “Human Security and Human Rights”, Occasional Paper Series, viti 2002, Vol. nr.8, faqe 8.

<sup>312</sup> Collins A., (2010): “Studime Bashkëkohore të sigurisë”- Titulli në origjinal “Contemporary security studies”, Oxford Press University – (përkthyer) UET Press, viti 2010, faqe 28.

Siguria është çështje e politikave të larta, ndaj ajo është qendrore për debatet qeveritare dhe shumë e rëndësishme për prioritetet e përcaktuara prej tyre.<sup>313</sup> Nga ky këndvështrim, paradigma bashkëkohore e sigurisë, tradicionalisht është analizuar në formën e tri kornizave themelore konceptuale: 1) siguria individuale; 2) siguria kombëtare; 3) siguria ndërkombëtare.<sup>314</sup>

Në vetëdijen e tij individi ka të nevojshme që, individualisht të plotësojë disa nevoja që mundësojnë ekzistencë cilësore, mes tjerave edhe nevojën për siguri. Nga ana tjetër, siguria kombëtare është fokusuar në përpjekjet e vendit komb për të dhënë siguri për të gjithë anëtarët e shoqërisë dhe t'i mbrojë ata, nga kërcënimet e jashtme dhe ato të brendshme. Megjithatë, për shkaqe objektive dhe subjektive, individit nuk mund t'i sigurohen njëkohësisht, si siguria individuale edhe siguria kombëtare.

Siguria kombëtare, sidoqoftë, është një vlerë politike në vetvete dhe është e përshtatur sipas aspiratave dhe interesave specifike sociopolitike. Ajo nuk mund të matet objektivisht dhe as të bihet dakord objektivisht mbi të. Sot siguria kombëtare është e mirë personale dhe politike. Në vendet me industri të zhvilluar, ajo trajtohet si e drejtë themelore e njeriut. Këto të drejta janë përgjegjësi e shtetit, jo vetëm me miratimin e legjislacionit përkatës, si ndëshkim, por gjithashtu edhe me angazhimin e tërë strukturës për siguri kombëtare. Kjo strukturë e pasqyron aftësinë e shtetit që t'i mbrojë vlerat dhe të sigurojë kushte për zhvillim socio-ekonomik shoqërisë së vet nga kërcënimet e jashtme dhe të brendshme, si dhe mirëqënie sociale për qytetarët.<sup>315</sup>

Nga kjo perspektivë, siguria kombëtare duhet të konceptohet si një tjetër vlerë në fushën e konkurimit të vlerave. Evoluimi historik i konceptit të sigurisë ka zbehur ekskluzivitetin e çështjeve tradicionale të luftës dhe kërcënimit, për të përdorur forcën si kërcënimin kryesor ndaj mbijetesës dhe tashmë konsideron rreziqe serioze ndaj sigurisë edhe degradimin mjedisor, varfërinë, pandemitë e ndryshme, HIV-Sidën, terrorizimin e shfaqur në shumë forma, armët e shkatërrimit në masë, krimin transnacional dhe sinonimin e “Luftës së Ftohtë”, konfliktin ndërshtetëror.

Ndër përkufizimet që i referohen pikërisht ekskluzivitetit të luftës dhe kërcënimit për të përdorur forcën si kërcënim kryesor ndaj mbijetesës mund të citohen:

“Një komb konsiderohet i sigurtë kur nuk ekziston asnjë rrezik që ta detyrojë atë të sakrifikojë vlerat e tij themelore nëse do të donte të shmangte luftën dhe është i aftë – nëse sfidohet - në një luftë të tillë, t'i mbajë ato nëpërmjet fitores”.<sup>316</sup>

---

<sup>313</sup> Collins A., (2010): “Studime Bashkëkohore të sigurisë”- Titulli në origjinal “Contemporary security studies”, Oxford Press University – (përkthyer) UET Press, viti 2010, faqe 15.

<sup>314</sup> Hinsley F.H., (1963): “Power and Pursuit of Peace”, Cambridge University Press, viti 1963, faqe 20-29; Schiffer W., (1954): “The legal Community of Mankind: A critical analysis of the Modern World Organization”, Columbia University Press, viti 1954, faqe 3;

Claude I.L., (1956): “Swords in Plowshares. The problems and Progress of International Organization”, Random House, viti 1956, faqe 44;

<sup>315</sup> Mitrevska M., Grizold A., Buckovski V., Vanis E., (2009): “Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve-Rasti i Maqedonisë (paradigma e re e sigurisë)”, Bomat Grafiks, 2009, faqe 19.

<sup>316</sup> Buzan B., (1991): “People, States, and Fear. An agenda for international security studies in the post-cold war era”, first published by Harvester Wheatsheaf, viti 1991, faqe 16.

“Vetë siguria është një liri relative nga lufta, e shoqëruar nga një pritshmëri relativisht e lartë se, humbja nuk do të jetë pasojë e asnjë lufte që, duhet të ndodhë”.<sup>317</sup>

“Siguria kombëtare mund të konsiderohet si aftësia për t’u përballur me agresionin e jashtëm dhe për t’i rezistuar atij”.<sup>318</sup>

Ndryshimet e mëdha në nivel ndërkombëtar dhe zhvillimi i shumë konceptimeve të reja gjatë dekadave të fundit kanë vënë në diskutim konceptin e objektit tradicional të sigurisë dhe të gamës së rreziqeve e kërcënimeve që i kanosen sigurisë, kjo nisur nga fakti se, “procesi i globalizimit ka çuar në jashtësimin e çështjeve të brendshme dhe në brendësimin e çështjeve të jashtme”.<sup>319</sup> Megjithëse mendimi perëndimor është mbisundues në studimet mbi sigurinë, dinamika e zhvillimit global, e cila ka tejkaluar caqet e një fenomeni ekonomik ka sjellë në dritë kuptime dhe konceptime të reja të sigurisë në botën në zhvillim, e cila shihet si një qasje e re sfiduese ndaj konceptit bazë. Aspekti që duhet vlerësuar është zgjerimi i konceptit të sigurisë që identifikon më shumë se një kërcënim, apo rrezik për mbrojtjen shtetërore dhe atë ushtarake.

Këtë qasje e gjejmë në një sërë përkufizimesh të reja për sigurinë, siç edhe:

“Emancipim do të thotë çlirim i njerëzve (si individë dhe grupe) nga kufizimet fizike dhe njerëzore që i ndalojnë të realizojnë atë që do të zgjidhnin të bënin në kushte lirie...Siguria dhe emancipimi janë dy anë të së njëjtës monedhë. Prandaj emancipimi, dhe jo fuqia, apo rendi është ai që prodhon sigurinë e vërtetë. Kësisoj, teorikisht, emancipimi është siguri”.<sup>320</sup>

“Siguria ...nënkupton si mjetet shtrënguese për të kontrolluar, apo balancuar një agresor, ashtu edhe ato bindëse, të mbështetura nga perspektiva e ndarjes së përfitimeve të ndërsjellta, për të transformuar agresivitetin dhe armiqësinë në bashkëpunim”.<sup>321</sup>

Sot aktorët shtete formulojnë dokumente të politikave të sigurisë kombëtare ku përshkruhet mënyra e realizimit të qëllimeve që vendos një shtet në politikën e tij të brendshme dhe të jashtme, në funksion të garantimit të sigurisë shtetërore dhe për rrjedhojë edhe të qytetarëve të tij. Këto dokumente përfshijnë marrjen e masave për garantimin e përdorimit të diplomacisë konstruktive dhe të qëndrueshme me shtete aleate, si dhe efikase për izolimin e kërcënimeve të ndryshme, fuqizimin e ekonomisë së brendshme për të përballur konkurrencën dhe mbështetur mbarëvajtjen e politikave dhe institucioneve të sigurisë, mirëfunksionimin e FA, sigurimin e infrastrukturës kritike për mbrojtjen civile dhe përgatitjen ndaj situatave të papritura e me rrezik, si dhe përdorimin e shërbimeve inteligjente, për të grumbulluar informacion dhe për të parandaluar rreziqet e mundshme.

---

<sup>317</sup> Bellamy I., (1981): “Towards a theory of International Security”, Political Studies, viti 1991, Vol.nr. 29/1, faqe 102.

<sup>318</sup> Luciani G., (1989): “The economic content of security”, Journal of Public Policy, viti 1989, Vol.nr.8/2, faqe 151.

<sup>319</sup> Collins A., (2010): “Studime Bashkëkohore të sigurisë”- Titulli në origjinal “Contemporary security studies”, Oxford Press University – (përkthyer) UET Press, viti 2010, faqe 16.

<sup>320</sup> Booth K., (1991): “Security and emancipation”, Review of International Studies, viti 1991, Vol. nr.17/4, faqe 319.

<sup>321</sup> Kolodziej E.A., (2005): “Security and International Relations”, Cambridge University Press, viti 2005, faqe 25.

Si pasojë e debateve dhe qasjeve të ndryshme teorike që ekzistojnë, elementët përbërës të sigurisë kombëtare ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, ndërkohë që në përgjithësi në shumë vende europiane, përfshirë këtu edhe Strategjinë e Sigurisë së BE, koncepti i sigurisë kombëtare përfshin sigurinë shtetërore, sociale dhe atë njerëzore. Në këtë diskutim nuk duhen harruar marrëdhëniet ndërmjet bazave të demokracisë në një vend dhe sigurisë kombëtare si një vlerë parësore kolektive. Së paku teorikisht pranohet se, liberalizmi zvogëlon prioritetin e dhënë sigurisë kombëtare si një vlerë kolektive, sepse ai inkurajon të drejtat individuale, duke i dhënë atyre përparësi krahasimisht ndaj të drejtave kolektive.

Megjithatë liberalizmi nuk shfuqizon vlerën kolektive të sigurisë kombëtare, përkundrazi ai presupozon se siguria kolektive është e kushtëzuar nga ruajtja dhe artikulumet e lirisë individuale. Në praktikë vërehet se, sa më i fortë perceptohet të jetë një kërcënim sigurie në komunitet, aq më e fortë mund të bëhet tendenca për të kufizuar liritë individuale.

### 3.2 Siguria Njerëzore

Siguria njerëzore bazohet në filozofinë e hershme të liberalizmit, e cila vë në qendër individin dhe jep kushte të nevojshme për garantimin e kësaj sigurie. Kushte të tilla si, liria dhe siguria të mbujtura në parimin e universalitetit të të drejtave të njeriut dhe të normuara në dokumente të rëndësishme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përbëjnë thelbin e konceptit të sigurisë individuale të implementuar gradualisht në sistemin ndërkombëtar, pas vitit 1945.

Për këtë arsye, respektimi i të drejtave të njeriut është bërë një element shumë i rëndësishëm i funksionimit të shtetit modern liberal dhe demokratik dhe e ka kthyer sigurinë njerëzore në moton e debatit global, mbi ndryshimin e konceptit të sigurisë. Siguria njerëzore vë në plan të parë sigurinë e individëve kundrejt konceptit tradicional të sigurisë kombëtare, që ka të bëjë me sigurinë e shtetit.

Termi aktual, “Siguria njerëzore”, u përdor për herë të parë nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në vitin 1994,<sup>322</sup> ndërkohë që fillesat e tij mund të gjenden në komisionet e hershme të Kombeve të Bashkuara për mjedisin, zhvillimin dhe qeverisjen globale.<sup>323</sup> Termi “siguri njerëzore” u prezantua në debatin ndërkombëtar në vitet 90’, si një përgjigje ndaj “rreziqeve të reja të rënies”, të cilat mund të preknin këdo.<sup>324</sup> Administrata e Klintonit përdori termin në shumë fjalime të politikës së jashtme në vitet

---

<sup>322</sup> Raporti i viti 1994, i Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), i referohet të drejtave të njeriut në seksionin mbi sigurinë politike duke deklaruar se, “Një prej aspekteve më të rëndësishme të sigurisë njerëzore është që njerëzit duhet të jenë në gjendje të jetojnë në një shoqëri, e cila nderon të drejtat e tyre themelore”.

<sup>323</sup> Gerd O., (2005): “Human security: a Challenge to international Law?” Global Governance, viti 2005, Vol. nr. 11 (2), faqe 185.

<sup>324</sup> Rhoa E. Howard – Hassmann R. E., “Human security: Undermining human rights?”, faqe 1. Website: [www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2011/63-hassmann-2011.pdf](http://www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2011/63-hassmann-2011.pdf)

1993 dhe 1994.<sup>325</sup> Edhe më herët, Traktatet e Helsinkit të vitit 1975, lidhën sigurinë shtetërore me të drejtat njerëzore individuale.<sup>326</sup>

Koncepti i sigurisë kombëtare është zgjeruar thelbësisht me njohjen e konceptit të sigurisë njerëzore e cila, "...perceptohet si realizim i të drejtave themelore të njeriut, i udhëhequr nga parimet e universales dhe neutrales. Këto parime, janë konfirmuar me proceset e ndërkombëtarizimit dhe globalizimit, të mbështetura në qëndrimin se, të drejtat e njeriut janë të pacënueshme dhe të patjetërsueshme dhe si të tilla, janë autonome nga vlerësimet subjektive të ligjëvendësve në shtete të veçanta".<sup>327</sup> Ai ndërthur elementin thelbësor të lirisë nga nevoja, me elementin e lirisë nga frika.

Për më tepër katër karakteristikat bazë të sigurisë njerëzore të shprehura në faktin se, "ajo është universale, komponentët e saj janë të pavarur, sigurohet më mirë pëmes parandalimit dhe se përqëndrohet tek njerëzit",<sup>328</sup> nxjerrin lidhjen e ngushtë që ekziston mes saj dhe të drejtave të njeriut, që kanë të njëjtat karakteristika. Theksi mbi sigurinë njerëzore ish menduar të ishte një kundërpeshë ndaj pikëpamjes se, e vetmja formë e sigurisë që vlente ishte siguria shtetërore, e përcaktuar shumë ngushtë si, "mbrojtja ushtarake e interesave shtetërore dhe territorit".<sup>329</sup>

Në ditët e sotme siguria njerëzore përfaqëson një koncept gjerësisht të debatur, në përkufizimin, fushën dhe dobishmërinë, këndvështrimet, interpretimet dhe indikacionet që i atribuohen marrëdhënies së saj, me të drejtat themelore të njeriut. Përkufizimet e dhëna të sigurisë njerëzore variojnë nga konceptet e ngushta që fokusohen tek integriteti fizik dhe një numër i kufizuar kërcënimesh, tek një kuptim më i gjerë që përfshin edhe aspekte emocionale dhe psikologjike të sigurisë. Mendimi teorik është zhvilluar shumë edhe në këtë drejtim përmes shkollës së konceptimit të ngushtë dhe asaj të konceptimit të gjerë të sigurisë njerëzore, të cilat veç dallimeve kanë të përbashkët kërcënimin e ushtrimit të dhunës politike ndaj njerëzve dhe mjetet për administrimin e këtij kërcënimi.

Këndvështrimi i ngushtë për sigurinë njerëzore, i cili origjinon nga Raporti i Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), i vitit 1994, kërkon aksionin shtetëror dhe ndërkombëtar kundër kërcënimeve serioze ndaj të drejtave të njeriut, me aspektin kyç të fokusimit mbi lirinë nga frika dhe lirinë nga nevoja. Duke iu referuar pasigurive dhe shqetësimeve të jetës së përditëshme të njerëzve, mbi sigurimin e jetesës normale të përditëshme përmes punësimit, jetës së qetë dhe të patrazuar nga krimi, ndërhyrjeve represive dhe torturës së ushtruar nga strukturat shtetërore, dhunës së ushtruar për shkak të gjinisë, apo persekutimit për shkak të besimit fetar dhe origjinës etnike, raporti identifikon një numër kërcënimesh që i kanosen të drejtave individuale njerëzore. Nisur nga këto

---

<sup>325</sup> Ema R., (1995): "What is Security?", Daedalus, viti 1995, Nr. 124 (3), faqe 55.

<sup>326</sup> Donnelly J., (2003): "Universal Human Rights in Theory and Practice"- Second edition, Cornell University Press, viti 2003, faqe 249.

<sup>327</sup> Mitrevska M., Grizold A., Buckovski V., Vanis E., (2009): "Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve-Rasti i Maqedonisë (paradigma e re e sigurisë)", Bomat Grafiks, viti 2009, faqe 20.

<sup>328</sup> Gary K., Murray Ch. J.L., (2001-2002): "Rethinking Human Security", Political Science Quarterly, viti 2001-2002, Vol. nr. 116 (4), faqe 589.

<sup>329</sup> Paris R., (2001): "Human Security: Paradigm Shift or Hot Air?", International Security, viti 2001, Vol.nr.26 (2), faqe 87.

indicie vetëkuptoheq që është detyra e shtetit, që të ndreqë dhe marrë masa për zgjdhjen e këtyre shqetësimeve të jetës së përditëshme.

Këndvështrimi i gjerë, përsërit dhe ndoshta minon regjimin e tashëm të zgjeruar të të drejtave të njeriut, veçanërisht duke konvertuar detyrimet e shtetit, sa i përket respektimit të të drejtave të patjetërsueshme të individëve në vendimet politike, në lidhje me atë se, cilat aspekte të sigurisë njerëzore duhen mbrojtur në rrethana të caktuara. Ndërsa këndvështrimi i ngushtë i sigurisë njerëzore sygjeron përjashtimin nga mbrojtja të disa të drejtave të njeriut, këndvështrimi i gjerë është aq i shpërndarë sa i lejon shteteve të deklarojnë se po mbrojnë sigurinë njerëzore edhe në rast se vazhdojnë të shtypin qytetarët e tyre.<sup>330</sup>

Megjithesë nuk ka ende një përkufizim të gjithëpranuar të konceptit ka qëndrime se, “Siguria njerëzore është në thelb, një përpjekje për të ndërtuar një shoqëri globale ku siguria e individit është qendra e prioriteteve ndërkombëtare dhe një forcë motivuese për veprimin ndërkombëtar; ku standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe shteti i së drejtës kanë avancuar dhe janë ndërthurur në një rrjet koherent të mbrojtjes së individëve; ku ata që dhunojnë këto standarde kanë përgjegjësi të plotë; dhe ku institucionet tona globale, rajonale dhe bilaterale – aktuale dhe të së ardhmes – janë ndërtuar dhe pajisur për përmirësimin dhe zbatimin e këtyre standardeve”.<sup>331</sup> Debatimi mbi sigurinë njerëzore nuk është një prej detyrimeve të shtetit dhe një prej të drejtave të njeriut; është një debat që i lejon shteteve të bëjnë zgjedhje se, cilët aspekte ata duan të mbrojnë.<sup>332</sup>

Duke derivuar nga viti 1994, sot koncepti i sigurisë njerëzore evidenton kërcënime të reja ndaj mirëqënies njerëzore, në kuptimin që ato janë më ekstreme se sa në dekadat e shkuara, apo janë të tilla që kohë më parë nuk janë konsideruar si një kërcënim për sigurinë njerëzore. Sot një nga kërcënimet për sigurinë njerëzore mund të konsiderohet migracioni masiv. Me këtë rrezik të ri janë përballur dhe po vazhdojnë të përballen vendet e BE-së, sidomos pas zhvillimeve më të fundit të njohura si “Pranvera arabe”, të cilat kanë nxitur migrim masiv të popullsisë të disa vendeve të afrikës veriore dhe të zonës arabe, drejt shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

Megjithatë duhet kuptuar se koncepti dhe realizimi efektiv i të drejtave të njeriut tejkalon teorinë e lirisë prej frikës dhe nevojës, të identifikuar në gjenezën e sigurisë njerëzore. Qëllimi thelbësor i sigurisë njerëzore është të shtrijë konceptin e sigurisë përtej sigurisë kombëtare, si një mënyrë për të detyruar shtetet që t’i kushtojnë më shumë vëmendje nevojave të shtetasve të tyre, pasi siguria e shtetasve është siguri shtetërore.

---

<sup>330</sup> Horta K., (2002): “Rhetoric and Reality: Human Rights and the World Bank”, Harvard Human Rights Journal, viti 2002, Vol.nr. 15, faqe 237.

<sup>331</sup> Axworthy L., on the Canadian approach, in Canada World View, Special Edition, Fall 1999. Website: [www.dfait-maeci.gc.ca/canada-magazine/wv-se1/se1t3-e.htm](http://www.dfait-maeci.gc.ca/canada-magazine/wv-se1/se1t3-e.htm)

<sup>332</sup> Rhoa E.Howard-Hassmann, “Human security: Undermining human rights?”, faqe 19. Website: [www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2011/63-hassmann-2011.pdf](http://www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2011/63-hassmann-2011.pdf)

Nga ana tjetër siguria njerëzore tregon, "...se të drejtat e njeriut dhe siguria e shteteve kombëtare ... nuk janë qëllime të kundërta por në fakt ato konvergojnë".<sup>333</sup> Nëse shtetasit janë të pasigurtë, atëherë shtetet janë të pasigurtë, ndaj si një çështje që i vetë-intereson, qeveritë duhet të marrin pjesë në mbrojtjen e shtetasve të shteteve të tjera kundër kërcënimeve të standartit të sigurisë së tyre.<sup>334</sup> Në frymën e globalizimit çështja e sigurisë njerëzore merr dimensionin e obligimit të komunitetit ndërkombëtar që të ndërhyjë për të mbrojtur sigurinë e shtetasve kur vet shtetet e tyre nuk mund ta japin atë, sikurse në rastin e Kombeve të Bashkuara.

Koncepti i sigurisë njerëzore është një model analize që po merr një rëndësi në gjithnjë në rritje për t'iu përgjigjur sfidave globale dhe që përpiqet të tejkalojë në mënyrë të dukshme nocionin tradicional të sigurisë kombëtare, që kishte në qendër të tij më së shumti shtetin në vetvete.<sup>335</sup> Siguria njerëzore është një formë e "mbrojtjes paraprake" kundër kërcënimeve të përbashkëta ndaj njerëzimit, duke shfrytëzuar mjete të reja diplomatike dhe mjete të tjera.<sup>336</sup>

Duke patur një fokus mbi individin dhe mbrojtjen e tij nga kërcënimet në një mjedis të sigurt, siguria njerëzore shkrin në vetvete shqetësimin për sigurinë e njerëzve në vend të sigurisë territoriale shtetërore dhe shqetësimin mbi, "mbijetesën, jetën e përditëshme dhe dinjitetin e qenieve njerëzore".<sup>337</sup> Veçanërisht dinjiteti njerëzor përbën një lidhje të fortë ndërmjet të drejtave të njeriut dhe sigurisë njerëzore. Në këtë mori diskutimesh, një problematikë polemizuese e cila është ngritur në mes të viteve 1990 është ajo se, çfarë përbën dhe çfarë do të kuptojmë me pasiguri njerëzore. Edhe në këtë aspekt qëndrimet ndahen në këndvështrime të ndryshme.

Një këndvështrim i ngushtë i termit, përqëndrohet në situatat e krizave që kërkojnë ndërhyrje ndërkombëtare, të tilla si asistencë zhvillimi, zgjidhje konflikti, apo advokim mbi të drejtat e njeriut. Megjithatë ekzistojnë edhe këndvështrime të tjera, të cilat ofrojnë një qasje më të gjerë të termit, sikundër ai për mbrojtjen kundër varfërisë ekstreme, sigurimin e arsimimit bazë, të mbrojtjes shëndetësore dhe asaj sociale, apo nga dhuna familjare. Të tjerë studiues zgjerojnë konceptin, duke iu referuar pothuajse çdo aspekti të jetës individuale që mund t'a bëjë atë të pasigurtë, duke identifikuar kështu kërcënime të reja që, i kanosen mirëqënies së individëve. Kjo gjë mund të shihet më qartë në idenë se siguria njerëzore vlerësohet tek, "faktorët socialë, psikologjikë, politikë dhe ekonomikë që promovojnë dhe mbrojnë mirëqënien njerëzore gjatë kohërave".<sup>338</sup>

---

<sup>28</sup> Oberleitner G., (2005): "Human security: a Challenge to international Law?", Global Governance, viti 2005, Vol.nr. 11 (2), faqe 604.

<sup>334</sup> Rhoa E. Howard - Hassmann, "Human security: Undermining human rights?", faqe 3. Website: [www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2011/63-hassmann-2011.pdf](http://www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2011/63-hassmann-2011.pdf)

<sup>335</sup> Krause K., (2008): "Drejt një axhende praktike të sigurisë njerëzore, Çështje të sigurisë/Security issues", Botim i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim/Revistë e përtremuajshme, viti 2008, nr.7, faqe 56.

<sup>336</sup> Heinbecker P., (2000): "Human Security: the Hard Edge", Canadian Military Journal, viti 2000, faqe 13. Website: [www.heinbecker.ca/Speeches/HumanSecurity2000forcesjournal.pdf](http://www.heinbecker.ca/Speeches/HumanSecurity2000forcesjournal.pdf)

<sup>337</sup> Sen A. A., "Why human Security?", presentation at the International Symposium on Human Security, Tokyo, Qershor 2000, Website:[www.humansecurity-chs.org/doc/Sen2000html](http://www.humansecurity-chs.org/doc/Sen2000html)

<sup>338</sup> Jennifer L., (2004): "Psychological Well-Being over time", Security Dialogue, viti 2004, Nr. 35, faqe 355.



Koncepti i sigurisë njerëzore tregon se, realizmi shtetocentrik nuk përbën një argument të mjaftueshëm sigurie, sepse ai nuk i adresohet në mënyrën e duhur sigurisë së njerëzve brenda shteteve nga dhuna politike. Prandaj ai nuk meriton të jetë kuptimi dominues i sigurisë. Në kontekstin bashkëkohor koncepti i sigurisë duhet të përshtohet në mënyrë të përshtatshme funksionimin e shteteve dhe individëve brenda tyre.<sup>339</sup>

Zhvillimi dhe garantimi i konceptit të sigurisë njerëzore ka zgjeruar konceptin e sigurisë, duke përfshirë në të, jo vetëm dimensionet ndërkombëtare të sigurisë njerëzore, por edhe ato që zhvillohen brenda shteteve. Siguria njerëzore kërkon një konsiderim të kujdesshëm të koncepteve të tjera të sigurisë ekonomike, të ndryshimit dhe thellimit të rreziqeve të reja jotradicionale ndaj njerëzve dhe shteteve, të sigurisë së ushqimit, mjedisit, pabarazisë ekonomike, shkeljes së të drejtave të njeriut, sigurisë individuale dhe politike, katastrofat natyrore dhe katastrofa të tjera. Ndaj edhe kur flasim për sigurinë njerëzore, flasim për sigurinë ekonomike, sigurinë ushqimore, sigurinë shëndetësore, sigurinë mjedisore, sigurinë individuale, sigurinë komunitare, si dhe sigurinë politike.

Demokracia është një tërësi parimesh dhe praktikash që institucionalizojnë dhe mbrojnë lirinë, ndaj edhe siguria politike si element i rëndësishëm i sigurisë njerëzore bazohet në mënyrën demokratike të qeverisjes dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Jetësimi i demokracisë liberale në vend kërkon aplikimin real të pluralizmit politik, barazisë para ligjit, procesit të rregullt ligjor, respektimit dhe garantimit të të drejtave të njeriut, zgjedhje të lira, të drejta dhe të ndershme, garantimit të lirisë së shprehjes dhe së drejtës të informimit. Kjo analizë është e nevojshme sidomos kur flasim për vende në tranzicion ku aplikohet demokracia liberale, sikurse Shqipëria.

Siguria njerëzore përbën motivin e një morie normash globale si të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Konventës së Gjenezës, Traktatit të Otavës, si dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve. Siguria Njerëzore shpeshherë shërben si një normë për traktate dhe konventa të ndryshme që, synojnë të mbrojnë njerëzit e pambrojtur prej aktorëve persekutues, sidomos prej shtetit. Zhvillimi i normave të mira globale nuk është i rëndësishëm vetëm për shkaqe morale dhe etike por edhe sepse, sikurse tregojnë shumica e vendeve demokratike, ato i shërbejnë forcimit të sigurisë shtetërore dhe asaj ndërkombëtare.<sup>340</sup>

Si e tillë, siguria njerëzore duhet të fokusohet në thelbin e mbrojtjes vitale të, “ të gjithë jetëve njerëzore nga kërcënimet kritike dhe të përhapura”,<sup>341</sup> të cilat nuk mbrohen, apo janë të mbrojtura në mënyrë jo të duhur nga të drejtat e njeriut. Perspektiva e të drejtave të njeriut që nga miratimi i DUDNJ, konvergjon me perspektivën e sigurisë njerëzore, e cila thekson se, “shteti është një instrument kolektiv për të mbrojtur jetën njerëzore dhe për të

---

<sup>339</sup> Kerr P., (2010): “Siguria Njerëzore”, përfshirë në botimin e Alan Collins, “Studime Bashkëkohore të sigurisë”- Titulli në origjinal “Contemporary security studies”, Oxford Press University – (përkthyer) UET Press, viti 2010, faqe 128.

<sup>340</sup> Po aty, faqe 130.

<sup>341</sup> Taylor O., (2004): “Human Security-Conflict, Critique and Consensus: Colloquium Remarks and a Proposal for e Threshold-Based Definition, Security Dialogue, viti 2004, Nr. 35, faqe 382.

rritur mirëqënien njerëzore”.<sup>342</sup> Në fund të fundit një shoqëri e cila, nuk ka besim tek shteti i vet është një shoqëri parashtetërore, që krijon vazhdimisht probleme.

### 3.3 Evoluimi i koncepteve të sigurisë dhe sigurisë kombëtare

Fillesat e mbrujtjes së analizave bashkëkohore të sigurisë reflektohen që në analizën e problemeve të lirisë së individit dhe sigurisë së tij, në raport me mjedisin shoqëror dhe konceptimin e luftës si instrument të politikës së jashtme shtetërore, vlerësuar në një kontekst social dhe historik deri në përmasa ndërkombëtare, prej përfaqësuesve të filozofisë politike klasike,<sup>343</sup> pasuar nga mendimi politik i krishterë dhe më pas ai modern, me teorinë realiste dhe atë liberale.

Ndryshimet e mëdha globale kanë ndikuar ndër të tjera edhe në ndryshime sinjifikative në konceptet që lidhen me sigurinë. Kjo gjë shprehet në konkurrencën e dukshme të teorive “të hedhura tashmë në treg” në fushën e sigurisë, në kohën e luftës globale ndaj një sërë fenomenesh kërcënuese për njerëzimin, si terrorizmi, armët e shkatërrimit në masë, ndryshimet klimaterike etj, duke e kthyer atë në një disiplinë të ridimensionuar që po merr vëmendje në rritje.

Këto studime shfaqen hershëm në periudhën mes dy luftërave botërore, ndërkohë që deri rreth fundit të Luftës së Dytë Botërore, mendimi strategjik i kërcënimeve ndaj sigurisë ka qënë fokusuar mbi çështje si, lufta dhe paqja, apo mirëqënia dhe epidemitë. Megjithatë, risia e viteve 40’-të ishte lindja e një kategorie të veçantë studimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bazuar në gërshetimin e ekspertizës ushtarake dhe shkencave sociale me bazë universitare. Si pasojë e implikimeve të paprecedenta të armëve bërthamore për zhvillimin e luftërave, por edhe për shkak të sfidave të një spektri të gjerë (ideologjik, ekonomik, ushtarak) të Bashkimit Sovjetik në drejtim të Shteteve të Bashkuara, shkencëtarët që kishin fituar prestigj gjatë Luftës së Dytë Botërore (si autorë të armëve të reja, thyerjeve të kodeve etj.), ata të fushave sociale (si këshillues të prioriteteve të bombardimeve strategjike), dhe ekspertët civilë do të specializoheshin tanimë në çështje ushtarake nën kupolën e sigurisë.<sup>344</sup>

Menjëherë mbas Luftës së Dytë Botërore, problemi mbeteshin ekuacionet e sigurisë të kushtëzuara nga prania e armëve bërthamore dhe Lufta e Ftohtë, të cilat të kombinuara bashkë shërbenin si mjet presioni imponues dhe manipulativ për shmangien e luftërave dhe nxjerrjen e përfitimeve politike dhe për koordinimin e vlerësimeve ushtarake, me ato joushtarake. Në aspektin historik, periudha 1950-1960 njihet si “epoka e artë” e studimeve të sigurisë, e përqëndruar në zhvillimin e mendimit strategjik mbi të ashtëquajturën “teori e lojës”, apo “teori e “përmbajtjes” dhe “strategjinë bërthamore”. Ideja e Xhon Herc mbi dilemën e sigurisë tërhoqi vëmendjen mbi faktin se realizimi i nevojave të sigurisë të shtetit-komb individual, shpie në nivel më të lartë të pasigurisë së shteteve të tjera.

<sup>342</sup> Thakur R., (2004): “A Political Worldview”, Security Dialogue, viti 2004, Nr. 35, faqe 347.

<sup>343</sup> Mund të përmenden këtu veprat e Ruso-s, Loku-t, Makiaveli-t, Monteskie-së, Hobs-it etj.

<sup>344</sup> Waever O., Buzan B., (2010): “Pas rikthimit në teori: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e studimeve të sigurisë”, përfshirë në botimin e Alan Collins, “Studime Bashkëkohore të sigurisë”- Titulli në origjinal “Contemporary security studies”, Oxford Press University – (përkthyer) UET Press, viti 2010, faqe 481- 482.

Çdo shtet i identifikon masat dhe aksionet e veta që të sigurojë siguri vetjake, si pjesë të interesave të veta vitale për ekzistencë, ngaqë ato janë domosdoshmëri dhe janë tërësisht mbrojtëse, ndërkohë që aktiviteti i njëjtë nga shtetet e tjera, perceptohet si kërcënim.<sup>345</sup> Një orientim i hershëm tipik i teksteve të viteve 1960-70' për studimet strategjike sillet rreth strategjisë dhe pëmbajtjes si nënfusha të mëdha, por drejtimi i dytë më i madh do të ishte "ekonomia e mbrojtjes".<sup>346</sup>

Analiza e konceptit shumështrësor të sigurisë në botën bashkëkohore, në kuadër të diskutimit të sigurisë kombëtare i njihet si meritë, studjuesit Arnold Wolfers.<sup>347</sup> Më vonë gjatë viteve 70'-të u shfaqën perceptimet, teoritë e garës së armatimeve, përhapja e shpejtë e armëve bërthamore, përhapja e shpejtë e teknologjisë së përparuar ushtarake, dobishmëria e dhunës, inteligjenca strategjike, strategjia konvencionale dhe vetërefleksionet e fushës.<sup>348</sup>

Vitet 1970-80', përfaqësojnë vitet e krizës, në studimet e sigurisë, ku vendin kryesor në studime e zinin Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe ku studiuesit vinin nga një kompleksitet fushash si, matematika, psikologjia, sociologjia, ekonomia, shkenca politike etj. Studimet e zhvilluara në këtë kontekst njohin karakteristika dalluese midis Europës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me specifikën se, "...në përgjithësi gjatë Luftës së Ftohtë, europianët i drejtuan argumentat e tyre rreth strategjisë politike dhe asaj ushtarake-shpeshherë kundër Shteteve të Bashkuara-bazuar në teori të prodhuara në Shtetet e Bashkuara".<sup>349</sup>

Kritika gjithëpërfshirëse e koncepteve të sigurisë ushtarake, nisur specifikisht nga këndvështrimi i studimeve paqësore u parashtua në këtë kohë nga Gert Krell, ndërkohë që Krause dhe Nye paralajmëruan se, teoricienët ekonomikë dhe politikë nuk i përkushtuan vëmendje të konsiderueshme themeleve gjithëpërfshirëse të sigurisë kombëtare, të cilat luajnë rol aktiv në theksimin e vlerave të tjera shoqërore. Ndërkohë, një tjetër qasje paralele e ndryshme teorike nga ajo perëndimore, u zhvillua në Bashkimin Sovjetik.

Një element final për t'u mbuluar në këtë fazë është trajektorja paralele e përbërë nga kërkimet e paqes në lidhje me studimet e sigurisë...kërkimet me rrënjë paqen u realizuan më së shumti në shkencat sociale, si sociologjia dhe psikologjia, me studiues pionierë si, Herbert Kelman dhe Johan Galtung.<sup>350</sup> Ndërkohë në vitet 80' dhe 90', studimet kryesore të sigurisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që analizuan marrëdhëniet shkak-pasojë, përfshinë debatet rreth realizimit ofensiv dhe defensiv dhe debatin mbi fuqinë ndaj

---

<sup>345</sup> Herz J. H., (1950): "Idealist internationalism and the security dilemma", World Politics, viti 1950, Nr. 3, faqe 157-180.

<sup>346</sup> Waeber O., Buzan B., (2010): "Pas rikthimit në teori: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e studimeve të sigurisë", përfshirë në botimin e Alan Collins, "Studime Bashkëkohore të sigurisë"- Titulli në origjinal "Contemporary security studies", Oxford Press University – (përkthyer) UET Press, viti 2010, faqe 486.

<sup>347</sup> Wolfers A., (1952): "National Security" as an Ambiguous Symbol", Political Science Quarterly, viti 1952, Vol. 67, Nr.4, faqe 481-502.

<sup>348</sup> Hedley B., (1968): "Strategic Studies and its Critics", World Politics, viti 1968, nr. 20, faqe 599-600.

<sup>349</sup> Waeber O., Buzan B., (2010): "Pas rikthimit në teori: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e studimeve të sigurisë", përfshirë në botimin e Alan Collins, "Studime Bashkëkohore të sigurisë"- Titulli në origjinal "Contemporary security studies", Oxford Press University – (përkthyer) UET Press, viti 2010, faqe 488.

<sup>350</sup> Po aty, faqe 490.

institucioneve në ndërtimin e rendit. Në Europë u ravijëzua më shumë fryma kritike në teoritë mbi feminizmin, Shkollës së Kopenhagës, apo asaj të Parisit. Në këtë mënyrë koherenca e shfaqur në të dy kontinentet në qëndrimet mbi sigurinë gjatë Luftës së Ftohtë, pësoi devijacione të dukshme, sidomos pas erës së kësaj lufte.

Aktualisht studimet e sigurisë ndodhen në një pozitë të fuqishme. Ato kanë kaluar përmes një dekade të dytë produktiviteti teorik. Çuditërisht kjo ka ndodhur në shkallë thuajse paralele në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara, pavarësisht lidhjeve shumë minimale midis këtyre dy grupeve të zhvillimeve teorike.<sup>351</sup>

Përtej teorive ekzistuese, me shfaqjen e kërcënimeve të reja ndaj sigurisë, që mund të kthehen, apo janë kthyer tashmë në çështje bazike siç është për shembull terrori dhe rendi, sfida që shtrohet në të dy kontinentet dhe në gjithë botën është adresimi adekuat i tyre në axhendën politike të shteteve, që do të vazhdojnë të ndeshin problemin e pasigurisë, pasi, “Shtetet, sikurse individët, janë të pasigurtë në proporcion me shkallën e lirisë së tyre. Nëse dëshirohet liria, atëherë duhet të pranohet pasiguria”.<sup>352</sup>

Megjithë daljen dhe zhvillimin e teorive të shumta në fushën e sigurisë, ende deri në ditët e sotme nuk gjendet një përkufizim i gjithëpranuar mbi “Siguri Kombëtare”, i cili nga baza konceptuale e kërcënimit të lirisë nga lufta dhe përdorimi i diplomacisë ka evoluar në një konsiderim të formave të tjera të kërcënimit ndaj sigurisë, të shfaqura në varësi të rrethanave dhe kohës. Ndonëse një koncept modern, siguria kombëtare origjinon herët në formulimin e saj.

Origjina e konceptit modern të “sigurisë kombëtare”, si filozofi e sigurimit të një shteti komb të qëndrueshëm i ka fillesat e saj në traktatet e paqes të nënshkruara në kuadër të dokumentit të njohur si “Paqja e Westfalisë”,<sup>353</sup> ku koncepti i një shteti sovran, të drejtuar nga një Sovran, u bë baza e rendit të ri ndërkombëtar të shteteve kombe. Tomas Hobbes në vitin 1651 në punimin “Leviathan”, mbështet këtë ide të qeverisjes së qytetarëve nga një sovran i fuqishëm i cili, në shkëmbim premton fund të luftës civile dhe religjioze dhe vendosjen e një paqe të gjatë, gjë që i jep atij të drejtën për të bërë politikë apo të bisedojë për paqe. Dy shkolla që patën ndikim në konceptimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të ndërthurjes së sigurisë kombëtare në zhvillimin e tyre, kanë qënë ajo e “realizmit klasik”<sup>354</sup> dhe e “idealizmit”.<sup>355</sup>

---

<sup>351</sup> Waeber O., Buzan B., (2010): “Pas rikthimit në teori: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e studimeve të sigurisë”, përfshirë në botimin e Alan Collins, “Studime Bashkëkohore të sigurisë”- Titulli në origjinal “Contemporary security studies”, Oxford Press University – (përkthyer) UET Press, viti 2010, faqe 498.

<sup>352</sup> Waltz K. N., (1979): “Theory of international Politics”, McGraw-Hill, viti 1979, faqe 112.

<sup>353</sup> Kjo seri traktatesh paqeje u nënshkrua në periudhën Maj - Tetor 1648, në Osnabruck dhe Munster. Këto traktate i dhanë fund luftimeve shumëvjeçare ndërmjet Spanjës dhe Republikës së Hollandës, duke bërë që Spanja të njohë formalisht pavarësinë e Republikës Hollandeze. Traktatet iniciuan një sistem të ri të rendit politik në Europën qëndrore, të emërtuar më vonë Sovraniteti Westfalian dhe krijuan së paku një bazë për vetë-vendosjen kombëtare.

<sup>354</sup> Klausewitz-i, si përfaqësues i kësaj shkolle konsideroi diplomacinë dhe luftën si instrumenta që zgjerorin çështjen kombëtare, me pikëpamjen e tij të “realizmit klasik” në marrëdhëniet ndërkombëtare.

<sup>355</sup> Immanuel Kant, përfaqësuesi i shkollës së “idealizmit”, propozoi një sistem ku shtetet-kombe dhe interesat dominantë kombëtarë do të zëvendësoheshin nga një rend botëror i normuar, bazuar në të mirën e përgjithshme dhe angazhimin moral.

Vetëm në Luftën e dytë Botërore e pas saj, termi “siguri kombëtare” u bë pjesë e fjalorit strategjik, si një koncept akademik më së shumti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me hyrjen në fuqi, në vitin 1947, të Ligjit “Për Sigurinë Kombëtare”, i cili megjithatë nuk jepte një përkufizim të sigurisë kombëtare. Koncepti i sigurisë kombëtare u bë një parim udhërrëfyes zyrtar për politikën e jashtme të Shteteve të Bashkuara, me nënshkrimin në 26 Korrik 1947, nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Harry S. Truman, të ligjit të sipërcituar.

Nocioni i sigurisë kombëtare, madje edhe në nivelin aktual të zhvillimit shoqëror, thuhet ekskluzivisht ka të bëjë me shtetin-komb sovran, nga aspekti i mbrojtjes së integritetit të vet fizik dhe territorial. Kjo gjë konstatohet në një sërë përkufizimesh mbi sigurinë kombëtare të dhëna nga Lippman, Wolfers, Nobilo, apo Booth, të cilat vijnë hershëm nga koha e përdorimit fillestar të konceptit modern e deri në ditët e sotme. Kështu Lippman mendon se, shteti është i sigurtë deri në atë shkallë kur ai nuk është në rrezik që t’i viktimizojë vlerat e veta themelore, pa marrë parasysh nëse kjo bëhet për qëllim të evitimit të luftës, apo nëse detyrohet për t’i mbrojtur vlerat e tij në një luftë potenciale.<sup>356</sup> Siguria Kombëtare përkufizohet nga Wolfers nga aspekti objektiv i cili, bën matjen e mungesës së kërcënimit ndaj vlerave themelore dhe nga aspekti subjektiv, i cili, lidhet me mungesën e frikës së shoqërisë ndaj rrezikimit të vlerave të saj.<sup>357</sup>

Siguria e qëndrueshme mund të arrihet vetëm nga ana e kombeve dhe shteteve, të cilët këtë nuk ua privojnë të tjerëve, thekson Booth. Megjithatë, kjo mund të arrihet vetëm në rastin kur siguria do të shqyrtohet si proces i çlirimit.<sup>358</sup>

Gjatë pjesës më të madhe të shekullit të njëzetë siguria konceptohej ekskluzivisht si siguri kombëtare dhe fokusohet në probleme që buronin prej kërcënimit, përdorimit dhe kontrollit të fuqisë ushtarake në kontekstin e konkurrencës ndërkombëtare shtetocentrike.<sup>359</sup> Në ditët e sotme, pas transformimit që pësoi koncepti i “interesit kombëtar”, siguria kombëtare veç dimensionit politiko-ushtarak, përfshin edhe dimensione të tjera më të gjera si, mbrojtjen e jetës dhe pronësisë së popullsisë së vet, praktikimin e funksioneve që lidhen me sigurinë e individit si ato ekonomike, socio-politike, kulturore, ekologjike, si funksione themelore të shoqërisë, si dhe me grupe shoqërore në nivele të ndryshme.

Në vitin 2010, Shtëpia e Bardhë përfshiu një këndvështrim ndërkombëtar në strategjinë e sigurisë kombëtare, e cila identifikon “Sigurinë”, si një prej “Katër interesave kombëtarë të qëndrueshëm” dhe “të gërshetuara pashmangshmërisht”. Ndërthurja e elementëve evolutiv të konceptimit të sigurisë kombëtare dhe vlerave burimore dhe zhvillimore njerëzore evidentohen qartë në ndërthurjen e katër interesave të qëndrueshëm kombëtarë, ku përfshihen, siguria, prosperiteti, respekti për vlerat ndërkombëtare në vend dhe nëpër botë dhe së fundi, rendi ndërkombëtar.

<sup>356</sup> Lippman W, (1943): “US Foreign Policy: Shield of the Republic”, Little Brown, viti 1943, faqe 51.

<sup>357</sup> Wolfers A., (1952): “National Security” as an Ambiguous Symbol”, Political Science Quarterly, viti 1952, Vol.67, Nr.4, faqe 481-502.

<sup>358</sup> Booth K., (1991): “Security Emancipation”, Review of International Studies, viti 1991, Vol. 17 (4), faqe 313-326.

<sup>359</sup> Henk D., (2005): “Human Security: Relevance and Implications”, Parameters Summer, viti 2005, faqe 91-106.

### 3.4 Siguria Kombëtare në Shqipëri

Zhvillimi i konceptit të sigurisë kombëtare në vendin tonë është i lidhur ngushtë me krijimin dhe zhvillimin e shtetit-komb shqiptar dhe rolit që, ai ka luajtur dhe përpiqet të luajë në sistemin ndërkombëtar, ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë. Shpallja e pavarësisë në 28 Nëntor 1912 dhe krijimi i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, në 4 Dhjetor të të njëjtit vit, nxirrnin nevojën e organizimit të mbrojtjes territoriale, si dhe ruajtjen e institucioneve kryesore shtetërore. Në planin e brendshëm, gjendja kërkonte ngritjen dhe zhvillimin e shtetit, si dhe ruajtjen e rendit të brishtë që, ushtrohej vetëm në një pjesë të territorit të vendit. Në marrëdhëniet me jashtë, shtetit shqiptar të kohës i duhej një përfaqësim aktiv, që do të siguronte njohje sa më të gjerë në arenën ndërkombëtare. Kjo situatë bëhej edhe më e rëndë me zhvillimin e Luftës së Parë Ballkanike dhe synimet që vendet e rajonit kishin ndaj territoreve shqiptare. Krijimi i FA ishte hapi i parë strategjik i detyrueshëm për qeverinë e kohës, që lidhej me një proces kompleks të krijimit dhe ruajtjes së ekzistencës shtetërore shqiptare, në një hapësirë gjeografike jo stabil dhe konfliktuale.

Gjatë viteve 20' të shekullit të kaluar, zhvillimi dhe konsolidimi i shtetit shqiptar, kërkonte një rikonceptim të mbrojtjes së territorit si dhe të ruajtjes së rendit. Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës, riorganizoi forcat e xhandarmarisë dhe ato të armatosura për këtë qëllim. Ndërkohë në periudhën kohore 1925-1928 dhe 1929-1939, “organizimi ushtarak mori një prirje dhe drejtim të ri, atë drejt një ushtrie të rregullt, gjë që rrëzoi sistemin e mëparshëm, të kushtueshëm për një vend si Shqipëria, e vogël dhe me rezerva ekonomike e financiare të kufizuara”.<sup>360</sup> Eventualisht, deri në pushtimin fashist në prill 1939, shteti shqiptar përballej me kërcënimin e vazhdueshëm të agresionit nga jashtë dhe trazira të brendshme, të cilat kishin fokusuar konceptin e sigurisë kombëtare tek ruajtja e sovranitetit shtetëror.

Periudha nga vitet 1945-1990, njih disa etapa të zhvillimit të konceptit të sigurisë kombëtare. Kështu, ruajtja e tërësisë territoriale dhe sovranitetit të vendit doli në pah si interesi parësor kombëtar menjëherë pas përfundimit të luftës, sidomos pas zhvillimeve të tilla si incidenti i Korfuzit, apo provokacionet greke, të 2 Gushtit 1949. Nga ana tjetër ekonomia e dobët, prapambetja arsimore, infrastruktura e dobët, nxorrën nevojën e shndërrimit të ushtrisë në një forcë të armatosur për kohë paqeje.

Etapa e dytë (1950-1960), nga pikëpamja e sigurisë dhe e mbrojtjes ka si dukuri kryesore forcimin e stabilitetit politik dhe ekonomik të vendit, anëtarësimin në OKB, si dhe vendosjen dhe ecurinë pozitive të marrëdhënieve diplomatike me pothuajse të gjitha shtetet e Europës.<sup>361</sup> Në periudhën e tretë 1960-1990, ndodhën zhvillime të tilla si shkëputja nga Traktati i Varshavës, ndërprerja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, ndërkohë që vendi ishte në një trysni dhe kërcënim gjithnjë e më evident për agresion territorial nga të dy aleancat, NATO dhe Traktati i Varshavës. Neutraliteti i shpallur veç pasojave negative, sollti edhe intesifikimin e përpjekjeve për përmirësim të marrëdhënieve ndërkombëtare me

<sup>360</sup> Gjunksi Xh., (2012): “Sfidat e Forcave të Armatosura në 100 vjet Shtet Shqiptar”, Revista Ushtarake (Qendra e doktrinës), viti 2012, nr.4, faqe 10.

<sup>361</sup> Karoli K., Doda E., (2012): “Mbi konceptin e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit në periudhën e Luftës së Ftohtë”, Revista Ushtarake (Qendra e doktrinës), viti 2012, nr.4, faqe 27.

fqinjët e më gjerë, në funksion të zgjidhjes së problemeve të sigurisë dhe mbrojtjes, ku rol luajti vendosja e marrëdhënieve dhe bashkëpunimi me Republikën Popullore të Kinës. Megjithatë, ky qëndrim solli vetizolim që ndikoi dukshëm në rënien e ekonomisë në vendin tonë.

Koncepti i sigurisë kombëtare, nga vitet e para të çlirimit të vendit deri në vitin 1990 ishte i ngushtë dhe i bazuar në organizimin e shpërndarë të forcave ushtarake në të gjithë territorin e vendit, të mbështetur në vetizolim dhe vetëmbrojtje. Mbas viteve 90', vendi ynë aplikoi konceptin e "Sigurisë së ndërruar", përmes zhvillimit të politikës së bashkëpunimit me struktura ndërkombëtare për mbrojtjen dhe sigurinë si NATO, OSBE, KE etj, megjithëse në kushtet e një vendi "konsumator i sigurisë". Megjithatë paqartësia, politizimi i institucioneve dhe mungesa e eksperiencës dhe e konceptimit bazik të sigurisë kombëtare bëri që vendi ynë të vuante pasojat të rënda, sikurse ngjarjet e vitit 1997.

Zhvillimet e shfaqura në formën e kërcënimeve të brendshme, apo të jashtme, ndaj sigurisë kombëtare dhe asaj shtetërore siç, trazirat politike të 14 Shtatorit 1998, lufta e Kosovës, trafiku i qënieve njerëzore, krimi i organizuar, korrupsioni, bënë që shteti shqiptar të rikthejë vëmendjen ndaj rivlerësimit të koncepteve të sigurisë kombëtare që, qeveria kishte përshtatur në dokumentet e politikës së sigurisë kombëtare të viteve 2000 dhe 2004.<sup>362</sup> Zhvillimet politike në vend dhe ngritja e nivelit të marrëdhënieve të vendit tonë në rang partneriteti me NATO-n,<sup>363</sup> si dhe hyrja në fuqi në vitin 2009, e MSA me BE, nxorri nevojën e rivlerësimit të koncepteve të deriatëhershme të sigurisë kombëtare, si dhe të dokumenteve politikë strategjike që formësojnë atë, për një konceptim më të gjerë dhe gjithëpërfshirës të saj, me qëllim që Shqipëria të ofronte pozicionin e "prodhueses së sigurisë", për qytetarët e saj, rajonin dhe më gjerë.

### **3.5 Dokumenti i strategjisë së sigurisë kombëtare dhe Strategjia e Sigurisë kombëtare, e Republikës së Shqipërisë**

Terminologjia për kuptimin e "Strategjisë", ka një origjinë të hershme të trashëgimisë ushtarake, fakt që për shkak të zhvillimeve komplekse njerëzore nuk ia ka lënë përdorimin e saj vetëm kësaj fushe, por e ka shtrirë atë gjerësisht në veprimtarinë shtetërore politike, ekonomike, ambientale, shëndetësore, sociale, apo edhe në atë të informacionit. Termi është i rëndësishëm dhe i gjerë ndaj edhe deri sot, "nuk ekziston një konsensus i gjerë në lidhje me përkufizimin e tij; madje kjo nuk është arritur as edhe në fushën e sigurisë kombëtare".<sup>364</sup>

Strategjia e sigurisë kombëtare është një dokument kornizë, përcaktues, ku qëllimi parësor për garantimin e funksionit madhor të një shteti jepet në përshkrimin se si një vend ofron sigurinë. Janë pesë arsye përse shtetet duhet të kenë një politikë gjithëpërfshirëse e të

<sup>362</sup> Shih Ligjin nr.8572 datë 27.01.2000 "Për miratimin e Dokumentit të Strategjisë së Sigurimit të RSH" (Fletore Zyrtare nr.3, viti 2000, faqe 43), dhe Ligjin nr.9322 datë 25.11.2004 "Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSH" (Fletore Zyrtare nr.98, viti 2004, faqe 6696).

<sup>363</sup> Shqipëria u anëtarësua në NATO, në 2 Prill 2009.

<sup>364</sup> Ramadani R., Shehu N., Lleshi A., Miftari I., (2009): "Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare"-Vëllimi I, Akademia e Mbrojtjes "Spiro Mojsiu", viti 2009, faqe 19.

hollësishme të sigurisë kombëtare: që të japë sigurinë se, qeveria do t'i trajtojë të gjitha rreziqet në mënyrë gjithëpërfshirëse; të rrisë efikasitetin e sektorit të sigurisë duke maksimalizuar kontributet e të gjithë aktorëve të sigurisë; të drejtojë zbatimin e politikës; të ndërtojë konsensusin e brendshëm të vendit; të rrisë besimin dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.<sup>365</sup> Ky dokument njihet si strategjia, politika, apo doktrina e sigurisë kombëtare, megjithatë pavarësisht emërtesave të dhëna ai, "...është një dokument i përgjithshëm dhe orientues i vendimmarrjes politike që, përshkruan mënyrën e garantimit të sigurisë për një shtet dhe për qytetarët e tij, duke përcaktuar interesat e së tashmes për atë vend dhe duke projektuar linjat kryesore të politikës së tij të sigurisë (të brendshme dhe të jashtme), në të ardhmen e parashikueshme".<sup>366</sup>

Veç ekzistencës si një dokument formal përgjithësues për qëllime të sigurisë, strategjia e sigurisë kombëtare duhet të ketë një vizion të gjerë që lidhet me të tashmen dhe me të ardhmen, të orientuara sipas renditjes dhe priorizimit të interesave<sup>367</sup> dhe të vlerave kombëtare që mbrohen dhe zhvillohen, sipas udhëzimeve për eliminimin dhe trajtimin e rreziqeve që u kanosen, apo do t'i kanosen atyre në të ardhmen. Në përmbajtjen e saj, strategjia veç vizionit të një shteti racional për sistemin ndërkombëtar dhe rolin që luan ai në të bën vlerësimin e rreziqeve dhe mundësive aktuale e të ardhshme, si dhe përshkruan qartë fushën e përgjegjësisë së çdo aktori zbatues, trajton kompetencën dhe krijimin e organeve mbikqyrëse të zbatimit të saj në aspektin politik, institucional dhe atë të shoqërisë civile, transparencën e procesit të formulimit dhe qartësinë e koncepteve të dhëna, pa përjashtuar garantimin e konfidencialitetit në fusha të caktuara të sigurisë kombëtare dhe rolin e demokracisë dhe të zhvillimit ekonomik, në vizionin e vendit për sigurinë.

Duke patur parasysh këto komponentë përbërës, arrijmë në konkluzionin se, "strategjia është marrëdhënie e shqyrtuar me kujdes ndërmjet qëllimeve, mënyrave dhe mjeteve".<sup>368</sup> Normalisht strategjitë e sigurisë kombëtare të konceptuara ndryshëm në vende të ndryshme,<sup>369</sup> janë në hierarki superiore dhe prevalojnë ndaj politikave të tjera të sigurisë, si ndaj doktrinës ushtarake, strategjisë së sigurisë së brendshme, apo çdo lloj dokumenti tjetër të këtij niveli, për shkak të tërësisë së temave të trajtuara dhe mënyrës së

<sup>365</sup> DCAF Backgrounder, "Politika e Sigurisë kombëtare". Website: [bg\\_national-security\\_alb\(3\).pdf](#)

<sup>366</sup> Law D., (2007): "Praktikat më të mira në fushën e strategjisë së sigurisë kombëtare", "Mbi zhvillimin e strategjisë së sigurisë kombëtare", Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim, Tiranë, viti 2007, faqe 12.

<sup>367</sup> Interesat e sigurisë kombëtare përcaktohen si: Bazat për zhvillimin e objektivave kombëtar. Interesat e sigurisë kombëtare përfshijnë mbrojtjen e popullit, territorit, identitetit politik, të strukturës dhe institucioneve demokratike; nxitjen e mirëqënies ekonomike; mbështetja e vlerave demokratike dhe mbështetjen e rendit ndërkombëtar që mbështet interesat jetike kombëtare. Natyra e mjedisit strategjik sugjeron një përkufizim më të përgjithshëm si për shëmbull - nevojat dhe dëshirat e perceptuara të një shteti sovran në raport me shtetet e tjera sovraane, aktorët jo shtetëror, dhe shanset në një mjedis strategjik të dhene, të shprehura si gjendje të dëshiruara përfundimtare. Shih Ramadani R., Shehu N., Lleshi A., Miftari I., (2009): "Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare"-Vëllimi I, Akademia e Mbrojtjes "Spiro Mojsiu", viti 2009, faqe 41.

<sup>368</sup> Po aty, faqe 22.

<sup>369</sup> Disa shtete si Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Kina, nuk kanë dokument të veçantë e të unifikuar të strategjisë së sigurisë kombëtare, por mbështeten në politika të mbrojtjes, ose në "dokumente të bardha" – projekt dokumente të politikave që përqëndrohen vetëm në mbrojtjen kombëtare. Shtete të tjera nuk i bëjnë publike dokumentet e politikave të tyre ose nuk i kanë të shkruara politikat gjithëpërfshirëse për sigurinë, apo mbrojtjen. Shih, DCAF Backgrounder, "Politika e Sigurisë kombëtare", shih Website: [bg\\_national-security\\_alb\(3\).pdf](#)



këndvështrimit të çështjes. Sfidat kryesore të strategjisë së sigurisë kombëtare si një dokument burimor dhe zhvillimor lidhen me, baraspeshimin e hapjes dhe fshehtësisë, konfliktit mes nevojës për të ruajtur lirinë e veprimit dhe kufizimeve, nevojën e baraspeshimit të shqyrtimeve të politikës së sigurisë kombëtare kundrejt kostove të tyre dhe baraspeshimit të debatit publik me kontributin e ekspertëve.

Republika e Shqipërisë ka një dokument të strategjisë së sigurisë kombëtare, të miratuar me ligj nga ana e Kuvendit të Shqipërisë,<sup>370</sup> ndërkohë që, legjislacioni në fuqi përcakton një proces të sigurisë kombëtare, të bazuar në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe me një bashkëpjesëmarrje të gjerë të institucioneve demokratike. Modeli i hartimit dhe miratimit të këtij akti, përputhet me modelin e autorizimit të strategjisë së sigurisë kombëtare me legjislacion të veçantë, pas përgatitjes së tij nga ana e ekzekutivit, përkundër modeleve të tjera që njohin instanca të tjera formuluese dhe miratuese, apo edhe rishikuese të këtij dokumenti.

Modeli gjatë formulimit të tij mbështetet në procesin e brendshëm politikëbërës me një vëmendje të veçantë ndaj analizës së peshës dhe rolit të institucioneve demokratike dhe procesit ndër-agjensi, në procesin e politikëbërjes të sigurisë kombëtare. Një konsideratë e vlefshme në këtë proces i kushtohet përcaktimit të ndikimit të disa faktorëve në të, si media, shoqëria civile dhe grupet e interesit. Në varësi të harmonizimit dhe konsiderimit specifik të të gjithë elementëve dhe faktorëve të nevojshëm për formulimin, miratimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të një strategjie kombëtare, kjo e fundit mund të rezultojë e efektshme, ose jo. Për formulimin e një strategjie të efektshme duhen njohur mirë edhe burimet e fuqisë që disponon vendi, për përmbushjen e objektivave të SSK.

Kjo kërkon të njohim mirë konceptin e fuqisë kombëtare dhe të instrumenteve të ndryshëm të saj-ushtarakë, të informacionit, diplomatike, zbatimit të ligjit, zbulimit, financiare dhe ekonomike.<sup>371</sup> Informacioni si instrument ka vlerë të pazëvendësueshme në një shoqëri demokratike, ku mbisundojnë parimet e shtetit të së drejtës dhe ku individit dhe media shihen si faktorë të rëndësishëm në procesin shtetformues. Informacioni nuk duhet kuptuar thjesht si një instrument, por si një e drejtë që i takon çdo subjekti ligjor që, vitalizon marrëdhënien e së drejtës të informimit, qoftë në marrjen, apo dhënien e tij për interesa individuale, ose publike. Roli i medias dallon në këtë kontekst pasi për shkak të funksionit të saj publik, ajo ndikon mbi mjedisin e sigurisë kombëtare në shumë forma. Media si aktor, “...duhet të ketë një funksion mbikqyrës, mbrojtjen kundër çdo tendence të shtetit për rritjen e fuqisë dhe abuzimin me të drejtat e shtetasve të tij. Mbështetja e brendshme e publikut vendas për nismat e politikës së jashtme është vendimtare për çdo përpjekje të rëndësishme dhe media mund të krijojë një forum të dobishëm, për krijimin e konsensusit kombëtar në mbështetje të politikave shtetërore”.<sup>372</sup>

---

<sup>370</sup> Shih Ligjin nr.9322 datë 25.11.2004 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë” dhe Ligjin nr.103/2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

<sup>371</sup> Ramadani R., Shehu N., Lleshi A., Miftari I., (2009): “Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare”-Vëllimi I, Akademia e Mbrojtjes “Spiro Mojsiu”, viti 2009, faqe 57.

<sup>372</sup> Po aty, faqe 57.

SSK si një dokument konceptual përgjithësues, nuk mund të shihet e shkëputur dhe me një marzh pavarësie ndaj bazës normative rregullatore të nevojshme për veprimtarinë krijuese dhe funksionuese të një shteti, ku mbisundojnë vlerat dhe parimet demokratike dhe të afirmohen dhe mbrohen të drejtat themelore të njeriut. Ky është shkaku se përse sot flitet për një politikë të efektshme dhe demokratike, në fushën e sigurisë kombëtare. Në konkluzion mund të thuhet se, SSK në të gjitha fazat e formulimit, miratimit dhe zbatimit të saj duhet të ruajë dhe respektojë vlerat dhe parimet bazë të mishëruara në dokumentin themeltar të një vendi, që në rastin tonë përfaqësohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Vendi ynë vjen nga një eksperiencë mbylljeje totale shumëvjeçare ndaj realitetit ndërkombëtar, ku mbrojtja dhe forcat e armatosura gëzonin përparësi kryesore dhe ku përqëndrimi i pushtetit krijonte kontroll të rreptë e të shtrirë në të gjitha nivelet, strukturat shtetërore dhe shoqërinë shqiptare. Ky realitet politik ka ndikuar në mënyrën e konceptimit të politikës së sigurisë kombëtare, deri në pjesën e parë të viteve 90'. Konceptimi i ngushtë i sigurisë kombëtare në këto vite, veç këtij realiteti politik është ndikuar edhe si pasojë e një sërë zhvillimesh sociale dhe politike brenda vendit,<sup>373</sup> që të ndërthurura me zhvillimet jashtë kufijve shtetërorë,<sup>374</sup> sollën në një fazë të mëvonshme ndryshime në rikonceptimin e sigurisë kombëtare dhe rolit që, Shqipëria mund të luajë në rajon dhe më gjerë, në kuadër të sigurisë ndërkombëtare.

Për herë të parë, në vitin 2000 u hartua dhe miratua një dokument kornizë i strategjisë kombëtare, i pasuar në vitin 2004, nga SSK e Republikës së Shqipërisë, dhe së fundmi në vitin 2014, i pasuar nga një dokument i ri, i SSK të Republikës së Shqipërisë, ku pasqyrohet një këndvështrim i ridimensionuar tashmë i sigurisë kombëtare. Duke u ndalur në Ligjin nr.9322 datë 25.11.2004 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, mund të thuhet se kjo SSK synonte të ruante një raport të drejtë mes sfidave e rreziqeve, mundësive aktuale dhe të së ardhshmes, si dhe rolit të Shqipërisë në sistemin ndërkombëtar, si faktor rajonal e më gjerë që “prodhon dhe eksporton siguri”,<sup>375</sup> përmes politikës së fqinjësisë së mirë dhe dialogut rajonal, duke u përpjekur në ruatjen e një lloj baraslargësie në këtë kuadër në rajon, për shkak të shpërndarjes gjeografike të vendbanimeve të popullsisë me kombësi shqiptare.

Mbizotërimi i një “qasjeje dydimensionale”, që lidh një objektiv afatshkurtër e afatmesëm siç është integrimi, me perspektivën afatgjatë të respektimit të shtetit ligjor, përbën

---

<sup>373</sup> Si të tilla mund të vlerësohen në radhë të parë, kalimi nga një sistem qeverisës bazuar në diktaturën e proletariatit dhe centralizimin e pushtetit tek partia-shtet, në një sistem demokratik që synon vendosjen dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës, lejimi dhe funksionimi i pluralizmit politik, zhvillimi i proceseve të para të zgjedhjeve të lira, rënia e firmave piramidale, trazirat politike të Shtatorit 1998, përballja më një sërë fenomenesh të reja për shoqërinë shqiptare, si trafiku i fëmijëve dhe vajzave të reja, emigracioni ilegal, korrupsioni, etj.

<sup>374</sup> Lufta që filloi midis vendeve të ish Jugosllavisë dhe veçanërisht kriza e Kosovës e vitit 1999, që u pasua me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s.

<sup>375</sup> Në paragrafin 5, të Ligjit nr.9322 datë 25.11.2004 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, thuhet se: “Strategjia mbështet krijimin e një sistemi të planifikimit të sigurisë me përparësi arritjen e një rezultati konkret nën konceptin; “Kush bën, çfarë, kur dhe në bashkëpunim me kë”.

strukturën bazë që parashikon kjo strategji e sigurisë kombëtare.<sup>376</sup> Në pjesën hyrëse të SSK, bëhet një identifikim i interesave të shtetit që, në harmonizim me interesat kombëtare synojnë përsosjen e demokracisë dhe forcimin e shtetit ligjor. Ky është edhe momenti bazik nga ku mendoj se duhet filluar një analizë e përmbajtjes të këtij dokumenti të rëndësishëm.

Me vendosjen e pluralizmit politik në vend dhe përqaftimit të modelit të demokracisë liberale, ideja bazë e artikuluar dhe e transmetuar në të gjithë veprimtarinë shtetërore është vendosja dhe krijimi i të ashtëquajturit “shtet i së drejtës”, apo siç njihet ndryshe “shtetit juridik”, si shprehje që bashkojnë shtetin me të drejtën. Megjithatë jo në pak raste, sikurse edhe në këtë SSK, përdoret termi “shtet ligjor”, madje respektimi i tij përcaktohet edhe si tipar themelor,<sup>377</sup> i këtij dokumenti.

Në zbërthim të kuptimit të termit, “shtet ligjor cilësohet ai shtet që u formësua si rrjedhojë e fitores së Revolucionit anglez dhe sidomos të atij francez, që sanksionoi epërsinë absolute të Parlamentit dhe të ligjit, si shprehje e vullnetit të përfaqësuesve të popullit”.<sup>378</sup> Nxjerrja e ligjeve dhe zbatimi i tyre lidhen me mitin e plotfuqishmërisë së Parlamentit, tashmë si një koncept i kapërcyer, ndaj edhe sot, “mjaft nga teoricienët më të shquar të së drejtës pajtohen me pohimin se shteti juridik ka zëvendësuar shtetin ligjor”.<sup>379</sup> Për më tepër, fakti që SSK shpreh se mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,<sup>380</sup> gjykoj se do të justifikonte përdorimin e termit në të “shtet i së drejtës” dhe jo termin “shtet ligjor”.

Bie në sy fakti se, që në hyrje të këtij dokumenti të SSK, një nga misionet themelore të tij është mbrojtja e jetës dhe e pasurisë së qytetarëve, ndërkohë që në vazhdim konfirmohet se, Shqipëria mbron dhe respekton me ligj të drejtat dhe liritë e njeriut. Zhvillimi i dimensionit të dinjitetit njerëzor,<sup>381</sup> artikullohet si një nga nënelementët e konceptit të kësaj strategjie, konceptuar brenda kuadrin e jodiskriminues, të respektimit të të drejtave të njeriut dhe konsolidimit dhe thellimit të respektimit të të drejtave të njeriut dhe të një shoqërie demokratike.

Ndër interesat jetike të vendit, në këtë dokument veç të tjerash identifikohet edhe mbrojtja e jetës së qytetarëve dhe e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.<sup>382</sup> Në vazhdim, në pjesën e tretë të dokumentit ku flitet për elementët e fuqisë kombëtare, në pikën 51, të kapitullit të shtatë, flitet për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve, si dhe të pronës, si garanci për funksionimin normal të shtetit ligjor. Nisur nga një vështrim analitik, mendoj se ka patur një lloj konfuzioni në përdorimin e terminologjive dhe të përcaktimit të tërësisë së të drejtave dhe lirive të individit që, shërbejnë si udhërrëfyes për ndërtimin e konceptit

---

<sup>376</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN), “Çështje të reformave në sektorin e sigurisë në Shqipëri-Rreth zhvillimit të konceptit të sigurisë kombëtare”, Volumi I, Tiranë, viti 2009, faqe 98.

<sup>377</sup> Shih pikën 2, Pjesa e Parë-Koncepti i Strategjisë së Sigurisë, të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, miratuar me ligjin nr.9322 datë 25.11.2004.

<sup>378</sup> Omari L., (2004): “Shteti i së drejtës”, - botim i dytë, Shtëpia botuese “Elena Gjika”, viti 2004, faqe 2.

<sup>379</sup> Po aty.

<sup>380</sup> Në hyrjen e Kushtetutës përdoret termi “Shtet i së drejtës”, ndërkohë që në nenin 4/1 të saj, thuhet se: “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”.

<sup>381</sup> Shih pikën 7, Pjesa e Parë-Koncepti i Strategjisë së Sigurisë, të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, miratuar me ligjin nr.9322 datë 25.11.2004.

<sup>382</sup> Po aty, pika 33.

të strategjisë kombëtare. Diku përdoret termi referues i drejtëpërdrejtë i të drejtës së jetës, apo i mbrojtjes së pronës, diku përmenden liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, ndërsa diku tjetër citohet thjesht termi, të drejtat dhe liritë e njeriut. E gjitha kjo ndodh në pjesë të ndryshme të të njëjtit dokument, i cili mendoj se nuk ka patur një kuptim dhe zhvillim të qartë të konceptit të sigurisë njerëzore.

Është më se e kuptueshme që siguria njerëzore si një element i zhvilluar mirë në një dokument të strategjisë kombëtare, duhet të referojë një kuptim të qartë dhe të njëjtë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, me një fushëpamje më të gjerë se sa koncepti i të drejtave dhe lirive themelore, pasi kemi theksuar se, kur flasim sigurinë njerëzore, flasim për sigurinë ekonomike, sigurinë ushqimore, sigurinë shëndetësore, sigurinë mjedisore, sigurinë individuale, sigurinë komunitare, si dhe sigurinë politike.

Duke u fokusuar tek e drejta për informim evidentohet se, “Strategjia e vlerëson informacionin si faktor shumë të rëndësishëm për forcimin e sigurisë kombëtare, duke respektuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese të qytetarëve, si dhe lirinë e mediave...Do të vazhdohet të kërkohet garantimi me ligje të veçanta i mbrojtjes së informacionit shtetëror të klasifikuar në fusha të veçanta, të atij ndërshtetëror, pa përjashtuar shkëmbimin e informacionit me organizmat ndërkombëtarë që burojnë nga marrëveshje mes palëve”.<sup>383</sup> Megjithëse i shprehur përgjithshëm, informacioni i përmendur në këtë dispozitë është produkti i marrëdhënies së të drejtës për informim. Por ndërsa në fillim flitet për respektim të së drejtës për informim, në vazhdim dispozita thekson me forcë kufizimin e kësaj të drejte, lidhur me informacionin e klasifikuar shtetëror, në kuptim të cënimit të mundshëm të sigurisë kombëtare.

Në këtë dokument mund të indentifikohet si, i paqartë, i diskutueshëm dhe si konstatim kërcënimi në sektorin e sigurisë, i elementit të “dezinformimit të opinionit publik”. Efektivisht, dezinformimi i opinionit publik është konsideruar në dokumentin e SSK si një kërcënim dhe rrezik për sigurinë, pa përcaktuar qartë kuptimin e tij dhe për më tepër kur një situatë e tillë, mund të ndodhë kryekëput si një informim në favor të opinionit publik, nga një individ “Bilbilfryrës”. Shqetësimi mbi këto formulime bëhet më serioz, kur media konsiderohej shprehimisht si rrezik potencial për stabilitetin e vendit, sikurse krimi i organizuar, emigrimi legal, paqëndrueshmëria politike dhe ekonomike, etj. Ekzistenca e një elementi që censuron lirinë e fjalës, gjykoj se mund të prishë ekuilibrin që siguron transparencën në sektorin e sigurisë. Kjo ndodh kur, ky dokument strategjik parashihte transparencën si standard, në marrëdhënien e institucioneve shtetërore me publikun, për dhënien e informacionit.

Pa u ndalur specifikisht në elementë të tjerë të këtij dokumenti strategjik, mendoj se në të kanë qënë paraparë më së shumti kërcënime tradicionale të sigurisë dhe është më shumë i orientuar nga shteti, se sa nga individ. Ndaj edhe siguria personale si pjesë vitale e sigurisë njerëzore evidenton një çështje që, gjykoj se nuk gjente hapësirën e duhur në këtë

---

<sup>383</sup> Shih pikën 12, Pjesa e Parë-Koncepti i Strategjisë së Sigurisë, të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, miratuar me ligjin nr.9322 datë 25.11.2004.

dokument. Në konkluzion mendoj se, siguria njerëzore ka qënë pak e përfshirë dhe aspak e prioritizuar, krahasimisht me kërcënimet e jashtme dhe rajonale.

Nga ky këndvështrim gjykoj se kanë qënë të shumta arsyet për të cilat ka qënë i nevojshëm rishikimi i SSK, të miratuar me Ligjin nr.9322 datë 25.11.2004, si në planin kohor, ashtu edhe në atë të zhvillimeve të brendshme dhe të jashtme, të cilat përshfaqën një panoramë të ndryshme të sfidave dhe rreziqeve që i kanoseshin sigurisë kombëtare. Domosdoshmëria e rishikimit nxitej edhe si pasojë e vazhdimësisë së përballjes me fenomenet si, trafiku i fëmijëve dhe vajzave të reja, emigracioni ilegal, korrupsioni, zhvillimeve të reja në vend, siç edhe trazirat politike të Janarit 2011, anëtarësimi në NATO, fillimi dhe vazhdimi i procesit të anëtarësimit në BE, liberalizmi i vizave për lëvizjen e lirë brenda vendeve të sistemit Shengen, kriza ekonomike që pllakosi Europën dhe veçanërisht vendet fqinje si Greqia, apo Italia dhe që, ende ndihet me pasojat e saj në rajon e më gjerë.

Nga ana tjetër në aspektin konceptual, vlerësoj se ligji për miratimin e SSK nuk përfaqësonte një strukturë gjithëpërfshirëse për formulimin në sistem dhe miratimin si standard transparence, të këtij dokumenti. Kjo është një arsye më shumë, sipas së cilës mendoj se rishikimi i nevojshëm i SSK, duhej të konsideronte një rikonceptim edhe të mënyrës se si dokumenti ligjor miratues duhet të paraqiste, kuptimin, sistemin e sigurisë kombëtare, identifikimin e aktorëve të sigurisë dhe kompetencave të tyre, si dhe planifikimin e veprimit zinxhir, në rast kërcënimi dhe rreziku potencial ndaj sigurisë kombëtare.<sup>384</sup>

Si një dokument strategjik që miratohet në një proces legjislativ, vlerësoj se formulimi i dokumentit të rishikuar të SSK, duhej të shoqërohej nga një shkallë e gjerë konsultimi me publikun, aktorë kryesorë dhe të interesuar të fushës, ekspertë etj, për të siguruar pranimin e gjerë dhe lehtësimin e zbatimit të tij. Aksesi i lirë i qytetarëve në legjislacion dhe informimi me të përbën një proces mjaft të rëndësishëm për qytetarin në vendimmarrjen shtetërore që duhet të konkretizohet me konsultimin e ndryshimeve, që duhet të pësojë miratimi i një dokumenti kornizë SSK. Ky aspekt, karakterizohet nga një boshllëk ligjor, deri në fund të vitit 2014, i plotësuar tashmë me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt-dokumente strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe të politikave me interes të lartë publik.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.103/2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, është miratuar dokumenti kornizë i strategjisë të sigurisë kombëtare, i cili shfuqizon, Ligjin nr.9322 datë 25.11.2004 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”. Sikurse shprehet që në hyrje të këtij dokumenti të rëndësishëm strategjik; “Në themel të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë është aspirata e popullit shqiptar dhe vullneti politik për të realizuar vizionin e përbashkët, për një atdhe që garanton siguri, drejtësi, barazi dhe mirëqënie për të sotmen dhe brezat e ardhshëm; një vend i lirë, demokratik dhe i zhvilluar, anëtar i përkushtuar i NATO- dhe i integruar në Bashkimin European”. Në ndryshim nga

---

<sup>384</sup> Një strukturë e tillë sistematike gjendet në Ligjin “Për Sigurinë Kombëtare”, të Letonisë, no.473/476 datë 14 Dhjetor 2000, i amenduar 9 herë, deri në vitin 2005.

dokumenti strategjik i mëparshëm, i shfuqizuar, kjo SSK përfaqëson strategjinë e një vendi anëtar të NATO-s, rrjedhimisht duke u mbështetur në Konceptin Strategjik të NATO-s, si dhe të një vendi kandidat potencial në BE. Nga ky këndvështrim, SSK në fuqi, harmonizon rolin, misionin, përgjegjësitë, kapacitetet dhe organizimin e institucioneve të sigurisë së Republikës së Shqipërisë me realitetin e ri të sigurisë kolektive. SSK ka në themel të saj bashkëpunimin dhe jo konfrontimin. Ajo bazohet në qasjen e bashkëpunimit me vendet e rajonit, me partnerët strategjikë të RSH dhe organizmat e sigurisë ndërkombëtare.

SSK mbështetet në dy shtyllat moderne të sigurisë për qytetarët: transparenca dhe përgjegjshmëria/llogaridhënia në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, me një spektër gjithëpërfshirës të aktorëve të sigurisë kombëtare. Ky dokument koncepton Shqipërinë në proceset e integritimit në organizmat rajonale e ndërkombëtarë dhe si një pjesë të realitetit rajonal dhe global në fushën e sigurisë. Nuk mund të ketë siguri kombëtare pa siguri rajonale dhe globale. Në këtë kontekst, sistemi i sigurisë së Republikës së Shqipërisë i përmbahet konceptit të gjerë të sigurisë, i cili përbëhet nga Siguria Shtetërore, Siguria Shoqërore, si dhe Siguria Njerëzore.

Si një përparësi e shprehur në këtë SSK, veçohet “sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë” që duhet të zbatohen në mënyrë të njëtrajtëshme për të gjithë qytetarët shqiptarë pa përjashtim. Si objekt mbështetës për këtë përparësi shihet ndër të tjera; “Shtimi dhe promovimi i shërbimeve digjitale dhe e-shërbimeve për qytetarët dhe biznesin, me qëllim rritjen e transparencës dhe përmirësimin e shërbimeve të administratës publike”.<sup>385</sup> Ndërkohë në pikën 2, të SSK, “Forcimi i institucioneve publike”, përcaktohet se ky qëllim do të arrihet duke vendosur standarde dhe kritere të matshme për të garantuar përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe transparencën e administratës publike, si dhe duke krijuar një mjedis të përshtatshëm dhe inkurajues për mediat, shoqërinë civile dhe qytetarët, në mbështetje të rolit të tyre informues e mbikqyrës, për të garantuar llogaridhënien e institucioneve para publikut.

Në të gjithë komponentët e SSK kemi të shpërndarë rregullime që lidhen me elementë të sigurisë njerëzore, sikundër afirmimi për respektimin e dinjitetit njerëzor, respektimin e të drejtave të njeriut, siguria shëndetësore, siguria ushqimore, siguria mjedisore, etj. Pavarësisht se këto elementë të rëndësishëm gjenden të shpërndarë në këtë dokument të rëndësishëm, mendoj se duhej theksuar si një terminologji e veçantë e drejta e informimit, që në qëllimin dhe objektin realizues të saj përbën edhe thelbin e konceptit të transparencës.

Nga ana tjetër, vihet re një lloj disproporcioni në përdorimin e termave “sundim i ligjit” dhe “forcim i shtetit ligjor”, në përmbajtjen e këtij dokumenti strategjik. Sikundër është theksuar në analizën e kryer për SSK e miratuar në vitin 2004, koncepti i “shtetit ligjor”, nuk është më korelativ, pasi edhe nocionet e dhëna në tekstin e SSK të miratuar në vitin 2014, korrespondojnë me nocionin e “shtetit të së drejtës”. Duke u fokusuar tek siguria njerëzore mendoj se, kërcënimet e përcaktuara mbi sigurinë e informacionit të klasifikuar, duhej të konceptoheshin në një raport më të ngushtë me “rrezikun dobiprurës”, që mund t’i sjellë informacionit të sigurisë kombëtare e drejta për informim. Pavarësisht këtyre

---

<sup>385</sup> Website: [www.mod.gov.al/images/PDF/strategjia\\_sigurise\\_kombetare\\_republikes\\_se\\_shqiperise.pdf](http://www.mod.gov.al/images/PDF/strategjia_sigurise_kombetare_republikes_se_shqiperise.pdf)

konstatimeve, duhet vlerësuar se kjo SSK përbën një dokument të rëndësishëm konceptual, që identifikohet i mirëstrukturuar.

### **3.6 Disa institucione garante të sigurisë**

Për të kuptuar rëndësinë e ushtrimit efektiv të së drejtës për informim dhe realizimin e transparencës në veprimtarinë e organeve publike, veç trajtimit të konceptit teorik është e nevojshme të shihet konkretisht se si institucionet shtetërore, garante të sigurisë, kryejnë veprimtarinë e tyre konkrete dhe bazën ligjore ku mbështetet kjo veprimtari. Sikundër është kryer një analizë në pjesët e mëparshme të këtij punimi, për funksionin e dyfishtë të AP, si një institucion i pavarur i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por edhe si mbikqyrës i veprimtarisë së sektorit të sigurisë, në këtë këndvështrim duhet të kryhet edhe një analizë e disa institucioneve, që me veprimtarinë e tyre japin produkt të drejtëpërdrejtë inteligjence, apo të institucioneve, të cilat mbikqyrin në një kuadër më të gjerë veprimtarinë e sektorit të sigurisë.

#### **3.6.1 Shërbimi Informativ i Shtetit**

Në kuptimin klasik, shërbimi i inteligjencës zhvillohet në fshehtësi të plotë. Megjithatë, zhvillimet më të fundit që kanë ndodhur në vendet e demokracive të vjetra liberale, apo proceset demokratike në vendet me një të kaluar qeverisëse autoritare, sikurse vendet e europës juglindore, mendoj se kanë rikonceptuar funksionin dhe kompetencat e shërbimeve inteligjente duke dhënë një panoramë më transparente për to dhe nga ana tjetër, për mbikëqyrjen e tyre më së shpeshti, nga një strukturë parlamentare në veprimtarinë e tyre.

Hetimet mbi ngjarjet që ndodhën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në 11 Shtator 2001, nga sulmet terroriste që goditën disa qendra vitale të ekonomisë amerikane dhe asaj botërore, apo të ndërtesës së Pentagon-it, si dhe preteksti për luftën në Irak mbi ekzistencën e armëve të shkatërrimit në masë, kanë nxjerrë në dritë shumë pikëpyetje mbi shërbimet sekrete dhe mënyrën e funksionimit të tyre. Proceset e ndjekura nga shërbimet sekrete gjatë veprimtarisë së tyre, lidhen me ekzistencën e sekreteve shtetërore dhe njihen si zhvillime potencialisht cënuese ndaj të drejtave të njeriut, që ndër të tjera kufizojnë mundësinë për transparencë.

Terminologjia që përdoret sot për të caktuar një raport të drejtë mes veprimtarisë së shërbimit inteligjent dhe të drejtave të njeriut është përcaktimi, “shërbimi inteligjent demokratik”, ku çdo akt normativ, apo ligj që rregullon veprimtarinë e tyre njeh dhe respekton kuptimin e të drejtave të njeriut, duke paraparë struktura mbikqyrëse të ligjshmërisë së kësaj veprimtarie. Ligji në këtë fushë është kushti i nevojshëm për kontrollin demokratik të shërbimeve, por gjykoj se ai duhet të komplementohet me politika institucionale dhe në detajim, me zbatimin e tyre. Në këtë kuptim aktivitetet e nevojshme të shërbimeve inteligjente duhet të kryhen duke respektuar të drejtat e njeriut dhe në fakt vlerësoj se, kjo është sfida kryesore e kësaj veprimtarie. Sikurse në shumicën e shteteve

demokratike, veprimtaria e shërbimit inteligjent në Shqipëri rregullohet me ligj të veçantë.<sup>386</sup>

SHISH,<sup>387</sup> është një institucion i rëndësishëm i sektorit të sigurisë në një shoqëri demokratike, me funksion kryesor grumbullimin dhe analizimin e informacioneve që, lidhen me kërcënime ndaj sigurisë kombëtare. Roli i SHISH është i kufizuar në grumbullimin e informacionit, i cili lidhet me aktivitetet që përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare, siç janë terrorizimi, prodhimi dhe trafiku i narkotikëve, armët e dëmtimit në masë, krimet kundër mjedisit, krimin e organizuar etj, duke zhvilluar veprimtari zbulimi dhe kundërzbulimi. Kjo veprimtari për të siguruar paanshmëri dhe dobishmëri publike udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe sekretit.<sup>388</sup>

Rregullimi me ligj specifik i veprimtarisë së këtij institucioni përcakton qartë rolin, kompetencat dhe funksionin e tij, krijon legjitimitetin në sytë e publikut, shërben si tregues përgjegjshmërie për veprimtarinë konkrete dhe më e rëndësishmja, promovon thelbësisht transparencën institucionale.<sup>389</sup> Ligjet për shërbimet e inteligjencës duhet të përkufizojnë mandatin dhe kompetencat e këtij shërbimi, duhet të përshkruajnë strukturën dhe përgjegjësitë organizative të strukturave institucionale, përcaktojnë subjektet mbikqyrëse si dhe raportet institucionale me organizatat e tjera qeveritare dhe jo qeveritare, ofrojnë rregulla për përdorimin e të dhënave personale nga këto shërbime dhe së fundi, përshkruajnë proceset që mund të shfrytëzohen nga individët për t'u ankumuar ndaj veprimeve që, këto shërbime ndërmarrin ndaj tyre.

Me fillesat e tij historike më 17 Dhjetor 1912,<sup>390</sup> aktualisht SHISH, është një organ informativ në funksion të sigurisë kombëtare dhe një institucion qëndror, që varet nga Kryeministri. Shërbimi drejtohet nga kryetari, i cili emërohet nga Presidenti i Republikës me propozim të Kryeministrit dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me procedurat e hartuara nga kryetari dhe të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm.<sup>391</sup> Veprimtaria e SHISH kontrollon nga Kuvendi, nëpërmjet komisionit përkatës parlamentar të ngritur për këtë qëllim.<sup>392</sup> Parlamenti ka pushtet të gjerë kushtetues mbi ekzekutivin, përfshirë sektorin e sigurisë. Parlamenti miraton buxhetin dhe ligjet që lidhen më këtë sektor, aprovon strategjinë dhe politika të rëndësishme të sigurisë kombëtare dhe ndryshimet e saj.

---

<sup>386</sup> Shërbimi informativ në Republikën e Shqipërisë, përfaqësohet nga institucioni i SHISH, veprimtaria e të cilit rregullohet me Ligjin nr.8391 datë 28.10.1998 “Për shërbimin informativ kombëtar”, i ndryshuar, dhe ish Shërbimi Informativ Ushtarak, sot Agjencia e Inteligjencës së Sigurisë së Mbrojtjes, veprimtaria e të cilit rregullohet me Ligjin nr.9074 datë 29.05.2003 “Për shërbimin informativ ushtarak”.

<sup>387</sup> Vendimi nr.61 datë 22.11.1999 i Gjykatës Kushtetuese, ndryshoi emërtimin e këtij institucioni nga Shërbim Informativ Kombëtar, të përcaktuar në Ligjin nr.8391 datë 28.10.1998, në SHISH.

<sup>388</sup> Shih nenin 3, të Ligjit nr.8391 datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar.

<sup>389</sup> Wills A., (2007): “Udhëzues - Të kuptuarit e mbikqyrjes së inteligjencës”, Qendra e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Amatosura (DCAF), viti 2007, faqe 7-8.

<sup>390</sup> Qeveria e krijuar nga Ismail Qemali pas shpalljes së pavarësisë në 28 Nëntor 1912, më 17 Dhjetor 1912, vendosi themelimin e Shërbimit Sekret Shqiptar.

<sup>391</sup> Shih nenet 4, 5 dhe 6, të Ligjit nr.8391 datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar.

<sup>392</sup> Po aty, paragrafi 1, neni 7.



SHISH përjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të informacionit, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve të emrave, të titujve zyrtarë, të pagave e të numrit të personelit. Veprimtaria informative mbështetet me strukturat legale dhe të fshehta.<sup>393</sup> Përcaktimi përjashtues ndaj aksesit në informacionin zyrtar të mbajtur nga ky institucion, kërkon që aktet normative që rregullojnë këto elementë të veprimtarisë të jenë në përputhje me, Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, duke garantuar të drejtat e njeriut dhe duke ruajtur dhe respektuar parimet kushtetuese dhe ato ndërkombëtare, në rastet e kufizimit të mundshëm të tyre. Efektivisht, e drejta për informim mbi veprimtarinë e SHISH futet në grupimin e atyre të drejtave të njeriut që, mund të kufizohen për arsye specifike dhe në pajtim me kritere rreptësisht ligjore.

Një rol kyç në kontrollin e veprimtarisë së këtyre organeve mendoj se luan ekzekutivi, gjyqësori, parlamenti si dhe institucionet e pavaruara të kontrollit. Forma e kontrollit të ushtruar ndaj këtij shërbimi gjykoj se i shërben edhe të drejtës për informim pasi, raportimi para Këshillit të Ministrave, apo para Komisionit përkatës parlamentar krijon një mundësi informimi dhe kontrolli njëkohësisht, për përmbushjen e mandatit dhe kompetencave ligjore, të mjeteve financiare buxhetore të nevojshme dhe përdorimit të tyre, të politikave dhe aktiviteteve.

Për më tepër, në rastin e Kuvendit, ligjbërja si një atribut kryesor që karakterizon veprimtarinë e këtij institucioni kryesor, përfaqësues të pushtetit legjislativ në Shqipëri, krijon mundësi për respektim dhe mbizotërim të të drejtave të njeriut në të gjithë veprimtarinë e SHISH. Duke ndërmarrë një rol aktiv në kuadër të transparencës institucionale, SHISH mund të shkruajë dhe bëjë publike, raporte për publikun që, zakonisht publikohen në faqen zyrtare të internetit për institucionin.<sup>394</sup>

Ndërkohë kontrolli që ushtrohet nga institucione të pavaruara të mbikqyrjes në sektorin e sigurisë, sikurse Avokati i Popullit, gjykoj se luan rol informues me detyrimin e ruajtjes së sekretit shtetëror për veprimtarinë e SHISH. Kompetenca për konsiderimin si subjekt kontrolli të SHISH nga ana e AP, bazohet në faktin se, SHISH është pjesë e administratës publike në Republikën e Shqipërisë, për aq sa ai kryen funksione administrative. AP shërben njëkohësisht si kontrollues me iniciativë dhe si trajtues i ankimeve që, individët paraqesin për veprime të ndërmarra ndaj tyre, nga ana e SHISH.

Forma e parë e kontrollit mund të realizohet përmes ankesave individuale që i paraqiten AP, nga individë apo subjekte përkatëse, ku përfshihen edhe ankesat për mosrespektimin e të drejtës së infomimit nga ana e këtij organi. Forma e dytë e kontrollit, lidhet me ushtrimin e kompetencës të AP, për paraqitjen e rekomandimeve legjislative. Megjithëse është një institucion rekomandues pa fuqi ekzekutive, moszbatimi i rekomandimeve për rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut i jep mundësinë AP të informojë mbi këto shkelje, organet e tjera të kontrollit si, Kryeministrin, apo Kuvendin e Shqipërisë, apo edhe kur gjykohet e drejtë, të publikojë rastin në media.

<sup>393</sup> Shih paragrafin 1 dhe 2, të nenit 10, të Ligjit nr.8391 datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar.

<sup>394</sup> Website: [www.shish.gov.al](http://www.shish.gov.al)

Padyshim që kontrolli i ushtruar nga ana e gjyqësorit, shërben si një mjet efikas për zgjidhjen e ankesave që mund të paraqiten ndaj shërbimeve informative.

Në shumë shtete demokratike, individët dhe organizatat e shoqërisë civile janë në gjendje të kërkojnë informata mbi secilën agjenci qeveritare. Qasja e fituar në këto informata mund t'i mundësojë shoqërisë të mbikqyrë aktivitetet e qeverisë, duke përfshirë aktivitetet e saj të inteligjencës. Gjykatave mund t'u kërkohej të gjykojnë mbi ato pretendime në lidhje me informatat për, apo të mbajtura nga shërbimet e inteligjencës.<sup>395</sup>

Megjithëse ligji “Për Shërbimin Informativ Shtetëror” nuk parashikon shprehimisht mundësitë ligjore që, subjektet e legjitimuara mund të shfrytëzojnë për t'u ankimuar ndaj veprimtarisë së këtij organi, efektivisht ligji “Për të drejtën e informimit”, parashikon mundësinë e ankimit të refuzimit të kërkesës për informim tek KDIMDhP dhe më pas, në gjykatë. Edhe në këtë rast, konflikti ndërmjet të drejtës për informim dhe ruajtjes së sekretit shtetëror, gjykoj se duhet t'i nënshtrohet respektimit të parimeve të trajtuara në pjesët e mëparshme të punimit. Një fushë në të cilën, rezultatet mund të arrihen më thjesht mendoj se është përmirësimi i legjislacionit për mbikqyrjen e shërbimeve informative.

Aktualisht, jo i gjithë legjislacioni mbi aktorë të ndryshëm të sigurisë parashikon dispozita për kontrollin dhe mbikqyrjen e tyre nga Parlamenti.<sup>396</sup> Një ligj specifik mbi mbikqyrjen e shërbimeve informative, i cili mungon, vlerësoj se do të shërbente për rritjen e transparencës dhe të standardizimit të veprimtarisë së SHISH, sikurse në institucionet homologe të vendeve të zhvilluara demokratike.

### **3.6.2 Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes**

Inteligjenca ushtarake është një koncept dhe veprimtari që ka evoluar me ndryshimin e natyrës së kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare. Sistemet e dikurshme të inteligjencës të mbështetura në informacionin e vlefshëm mbi kundërshtarin, janë përshtatur dhe sofistikuar, si në metodat operacionale, ashtu edhe në shfrytëzimin e mjeteve të teknologjisë së lartë, në një mjedis ku nocioni i armikut konceptohet tashmë bazuar mbi bazën e aleancave me një sërë partnerësh rajonalë e më gjërë, në çështje strategjike ushtarake dhe në një realitet gjeopolitik të ndryshuar.

“Në ambientin e ri të sigurisë, ku vetë natyra e kërcënimeve ka ndryshuar, misioni i Forcave të Armatosura ka evoluar, jo vetëm në misione të karakterit sulmues, mbrojtës ushtarak por edhe paqeruajtëse, menaxhim krizash, menaxhim situatash emergjencash natyrore etj, bën që nevoja për mbështetje me inteligjencë të evoluojë nga një inteligjencë strikt ushtarake në nevojën për një inteligjencë më fleksible, të ndërveprueshme, gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese, më e hapur dhe dhe e bazuar jo vetëm në sekrete...”<sup>397</sup>

<sup>395</sup> Wills A. “Udhëzues - Të kuptuarit e mbikqyrjes së inteligjencës”, Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), viti 2007, faqe 26.

<sup>396</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, “20 vjet reforma në sektorin e sigurisë-Harmonizimi i kuadrit kushtetues dhe ligjor të sektorit të sigurisë”, Gent Grafik, Tiranë 2012, faqe 24.

<sup>397</sup> Xharo M., (2013); “Një paradigmë e re në inteligjencë...”, Akademia e Forcave të Armatosura, viti 2013, faqe 81, ISBN: 978-9928-4097-7-5

Zhvillimi historik i konceptit dhe institucioneve të inteligjencës ushtarake në vendin tonë pas viteve 90', bazohet në një proces reformimi të Forcave të Armatosura. Në këtë frymë janë krijuar institucione të reja të inteligjencës ushtarake, sikurse Shërbimi Informativ Ushtarak, i krijuar në vitin 1991, si një organ i specializuar informativ, i depolitizuar që ka ndryshime të rëndësishme të përcaktuara konceptualisht në misionin e tij të veprimtarisë. Sipas misionit të tij, Shërbimi Informativ Ushtarak, grumbullon, analizon dhe administron të dhëna për veprimtaritë që çenojnë sigurinë kombëtare, kërcënime të mundshme ose rreziqe ndaj Forcave të Armatosura, që vijnë nga jashtë ose shfaqen brenda vendit, për t'i paraqitur tek autoritetet e drejtimit dhe të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura, për t'i mbështetur gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre.<sup>398</sup>

Anëtarësimi i vendit tonë në NATO ka sjellë ndërkohë edhe kërkesën dhe nevojën njëkohësisht, për një bashkëkoordinim të rrjeteve kombëtare me rrjetet e kësaj organizate, për të realizuar konceptin e inteligjencës gjithëpërfshirëse në kuadër të këtij koalicioni. Dhe është e kuptueshme tashmë se, çdo rikonceptim i inteligjencës brenda kuadrit të NATO sjell natyrshëm dhe domosdoshmërisht edhe ndryshime në strukturën e inteligjencës së vendeve anëtare. Duke qënë ende një demokraci e re dhe në proces konsolidimi, në Shqipëri aktualisht po ndodh procesi i krijimit dhe konsolidimit të mekanizmave që përballen dhe zgjidhin konfliktin që lind nga veprimi i shërbimeve të inteligjencës shpesh cënues për të drejtat e njeriut, në një mjedis demokratik, i cili ka si kërkesë bazë llogaridhënien dhe transparencën. Një rol të rëndësishëm në këtë kontekst merr kontrolli demokratik parlamentar mbi shërbimet e inteligjencës që e bën këtë të fundit, më të përgjegjshme dhe më transparente.

Reformat e ndërmarra në fushën e inteligjencës ushtarake por edhe detyrimet që vendi ynë ka ndërmarrë si vend anëtar i NATO, kanë sjellë në riformatimin dhe rikonceptimin e funksionit të këtij shërbimi. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.65/2014 "Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes", është krijuar prej pak vitesh institucioni i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si vazhdimësi e Shërbimit Informativ Ushtarak, me cilësinë e personit juridik publik, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Ajo mbështet autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura dhe Forcat e Armatosura, me inteligjencë në fushën e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë, në përmbushje të misionit të tyre kushtetues.

Agjencia vepron në fushën e sigurisë së mbrojtjes si pjesë aktive e Forcave të Armatosura, duke i mbështetur në misione në kuadër të NATO, BE dhe OKB. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ushtron kompetencat e saj mbi veprimtari që lidhen me kërcënime ose rreziqe që synojnë të çenojnë, ose që çenojnë Forcat e Armatosura në realizimin e misionit të tyre kushtetues.<sup>399</sup>

Parimet e veprimtarisë së kësaj agjencie kanë të bëjnë me, ligjshmërinë, objektivitetin dhe paanësinë, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, asnjënjësinë politike, menaxhimin dhe kontrollin e centralizuar, bashkëveprimin ndërinstitucional, ruajtjen e

<sup>398</sup> Shih nenin 2, të Ligjit nr.9074 datë 29.05.2003 "Për shërbimin informativ ushtarak", i ndryshuar.

<sup>399</sup> Website: [www.mod.gov.al/index.php/agjencia-e-inteligjences-se-mbrojtjes-aim/41-agjencia-e-inteligjences-se-mbrojtjes-aim](http://www.mod.gov.al/index.php/agjencia-e-inteligjences-se-mbrojtjes-aim/41-agjencia-e-inteligjences-se-mbrojtjes-aim)

informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, formave dhe metodave të punës, si dhe të kontrollit dhe mbikqyrjes së veprimtarisë së saj.<sup>400</sup> Ndër detyrat kryesore të kësaj agjencie mund të përmendim, grumbullimin, përpunimin, vlerësimin, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave dhe informacioneve si dhe paraqitjen e produktit të inteligjencës gjithëburimëshe për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, lidhur me sisteme mbrojtjeje, grupe e organizata me kapacitete kërcënuese të vendeve të huaja, aktivitete të subjekteve, të cilat mund të kërcënojnë ose të rrezikojnë verpimtarinë e Forcave të Armatosura; i njëjti produkt inteligjence jepet për kërcënime të natyrës së terrorizmit, ekstremizmit, spiunazhit, sabotazhit, diversionit, subversionit, armëve të shkatërrimit në masë, kërcënimeve kibernetike e krimit të organizuar ndaj kapaciteteve mbrojtëse të vendit; shkëmbimin e produktit të inteligjencës, bashkëpunimin dhe kryerjen e operacioneve të përbashkëta me struktura të inteligjencës së NATO dhe BE, me shërbime dhe agjenci të inteligjencës së vendeve anëtare të NATO e të BE dhe agjencitë partnere në interes të mbrojtjes kolektive; paraqet produkt inteligjence për gjendjen e sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcat e Armatosura.<sup>401</sup>

Veprimtaria e kësaj agjencie nuk shihet e shkëputur në kuadër të sigurisë kombëtare nga institucionit e tjera homologe dhe partnerë të inteligjencës, jashtë dhe brenda vendit, pasi parashikohet bashkëpunimi me to. Njëkohësisht gjatë veprimtarisë së saj ndalohe kryerja e veprimtarisë me karakter policor, si dhe kryerja e veprimeve që synojnë realizimin e qëllimeve dhe objektivave, që nuk kanë lidhje me misionin e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Informacioni i klasifikuar i përfutur nga veprimtaria e kësaj agjencie ruhet në pëputhje me legjislacionin në fuqi për këtë kategori informacioni. Për më tepër, është e ndaluar që kjo agjenci të japë informacion që ka të bëjë me të dhëna të klasifikuara, duke u përjashtuar kështu sipas parashikimeve ligjore në fuqi, për publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të të dhënave, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, si dhe të numrit të punonjësve të agjencisë.<sup>402</sup>

Veprimtaria e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, mbikqyret dhe kontrollohet në formën e mbikqyrjes parlamentare, kontrollit administrativ të ushtruar nga ana e Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes, përkatësisht për veprimtarinë operacionale në përgjithësi dhe përdorimin e burimeve financiare, si dhe kontrollit ligjor për ushtrimin e saj në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Duke patur një mbikqyrje dhe kontroll shumëplanësh, veprimtaria e agjencisë synon përmbushjen e misionit të saj por njëkohësisht edhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ligjërisht, informacioni që grumbullohet prej saj nuk përbën bazë ligjore për kufizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe të personave fizikë dhe juridikë.

Duke patur një karakter informativ të veprimtarisë së saj, e cila krahasimisht me SHISH kufizohet në një fushë më të ngushtë veprimi mund të thuhet se, kjo veprimtari shfaqet si një kufizues potencial i së drejtës për informim për të dhëna dhe informacione që lidhen

<sup>400</sup> Shih nenin 5, të Ligjit nr.65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”.

<sup>401</sup> Po aty, neni 7.

<sup>402</sup> Po aty, nenet 24 dhe 25.

me të. Konkluzionet që janë nxjerrë mbi raportin që ekziston ndaj veprimtarisë së SHISH si një organ i inteligjencës dhe së drejtës për informim, vlejnë në të njëjtën masë edhe për raportin e veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe së drejtës për informim.

### 3.6.3 Komisioni Parlamentar i Mbrojtjes

Mbikqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë luan një rol shumë të rëndësishëm për krijimin dhe ruajtjen e parametrave ligjorë të veprimtarisë së këtij sektori. Kjo mbikqyrje është pjesë e kërkesës së përgjithshme parësore në vendet demokratike, ku mirëqeverisja kërkon natyrshëm mbikqyrjen e vazhdueshme parlamentare. Duke qënë se Parlamenti është organi kryesor përfaqësues i pushtetit legjislativ, ai luan një rol thelbësor legjislativ dhe mbikqyrës mbi ekzekutivin dhe jo vetëm. Ky funksion i tij ushtrohet përmes të zgjedhurve të mandatuar të popullit, parlamentarëve, të cilët në veprimtarinë e tyre, "...ushtrojnë funksion thelbësor në ndërlidhjen mes qeverisë dhe qytetarëve në formësimin e dialogut kombëtar mbi sigurinë. Ata janë të vetmit trupa të zgjedhur nga populli që mund të flasin për të gjithë qytetarët dhe të mbrojnë interesat e tyre të sigurisë".<sup>403</sup>

Një përkufizim i konceptit të mbikqyrjes parlamentare të sektorit të sigurisë thekson se: "Legjislatura ushtron mbikqyrje parlamentare duke aprovuar ligje që përcaktojnë dhe rregullojnë shërbimet e sigurisë dhe fuqitë e tyre, si dhe duke adoptuar buxhete të caktuar korresponduese. Një kontroll i tillë mund të përfshijë edhe themelimin e ombudspersonit parlamentar, ose një komision, që mund të nisë hetime mbi bazën e ankesave publike".<sup>404</sup> Në një këndvështrim më të zgjeruar, Parlamenti mund të luajë një rol të qënësishëm në parandalimin dhe mbajtjen e institucioneve të sigurisë, të përgjegjshme për garantimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut gjatë veprimtarisë së tyre.

Në fakt gjatë ushtrimit dhe realizimit të kësaj veprimtarie mbikqyrëse që përmbledh një sërë mekanizmesh proceduralë dhe ligjorë,<sup>405</sup> parlamentarët nuk janë aktorët e vetëm të përfshirë në proces, pasi veç tyre në të përfshihen edhe partitë politike, si shtylla kryesore ndërlidhëse ndërmjet të zgjedhurve vendimarrës dhe shoqërisë civile; stafi mbështetës parlamentar, si pjesë e mekanizimit të brendshëm të organizimit të Parlamentit që siguron ndihmesën teknike dhe mekanizimin e brendshëm të ekspertizës të nevojshme për

<sup>403</sup> Luciak I., (2008): "Mbikqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia-Mjet praktik për Gjininë dhe Reformën e Sektorit të Sigurisë", Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Amatosura (DCAF), OSCE/ODIHR, UN-INSTRAW, viti 2008, faqe 7.

<sup>404</sup> Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF) and Inter Parliamentary Union (IPU), Parliamentary Oversight of the Security Sector: Principles, Mechanisms and Practices (DCAF and IPU: Geneva), viti 2003, faqe 22.

<sup>405</sup> Këto mekanizma përfshijnë, aprovim, ndryshim apo mosmiratim të politikave të sigurisë apo edhe të ligjeve në këtë fushë; zhvillimin e debateve dhe interpelancave parlamentare; zhvillimin e proceseve investiguese nga Komisionet e përhershme apo të përkohëshme parlamentare; miratimin e legjislacionit dhe miratimin e buxhetit për sektorin e sigurisë; autorizimin për vendosjen dhe përfundimin e gjendjes së emergjencës; miratimin apo mosmiratimin e propozimeve nga ana e Qeverisë për marrëveshjet ndërkombëtare, aleancat dhe dërgimin e trupave ushtarake jashtë vendit, emërimin e funksionarëve të lartë të sigurisë, prokurimet e rëndësishme për armatimet; monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve të qeverisë përmes, fillimin e hetimit parlamentar, krijimin dhe raportimin nga ana e institucioneve mbikqyrëse sikundër Ombudsmeni parlamentar etj.

parlamentarët; Ombudsmani parlamentar një shembull konkret i të cilit është funksionimi i AP në vendin tonë; si dhe shoqëria civile që shpesh paraqitet në kontekstin e partnerit efektiv, apo edhe të oponentit, në veprimtarinë mbikqyrëse të Parlamentit ndaj sektorit të sigurisë.

Në këtë kuadër, komisionet parlamentare për mbrojtje dhe siguri paraqiten si struktura të specializuara të Parlamentit me karakter këshillues dhe rekomandues për seancën plenare, për çështje që kanë të bëjnë me legjisllacionin apo vendimmarrjen, që lidhet me sigurinë kombëtare. Pavarësisht llojit të tyre, si të përhershëm apo të përkohshëm, këto komisione parlamentare kanë specifika funksionimi krahasimisht të ndryshme nga komisionet e tjera parlamentare në një legjisllaturë. Ato merren me forcat e armatosura, sigurinë publike dhe shërbimin inteligjent, por duhet theksuar se aktiviteti i komisioneve parlamentare për mbrojtje dhe siguri nuk përjashton evidentimin dhe trajtimin e problematikave dhe çështjeve të sigurisë edhe nga komisione të tjera të përhershme parlamentare. Sikundër aktiviteti i tyre po përfshin tashmë si një tendencë në rritje, mbikqyrjen mbi struktura jo shtetërore si, kompanitë private të sigurisë, krimin e organizuar, organizatat terroriste, rrjete trafikuese etj.

Këto specifika lidhen me, shumëllojshmërinë e institucioneve dhe çështjeve me të cilat komisioni lidhet gjatë veprimtarisë së tij për sigurinë; të drejtës për më pak publikim të veprimtarisë së tij për shkak të mbrojtjes së informacionit të sigurisë kombëtare; përfshirjes efektive të ekzekutivit gjatë kësaj veprimtarie; një përfshirje të dobët të shoqërisë civile në këtë veprimtari, në vendet ku mungojnë OJF-të që merren me sektorin e sigurisë, gjë që sjell si pasojë një publik më pak të interesuar dhe të informuar.

Në shoqëritë në tranzicion, meqënëse reforma politike zakonisht i paraprin reformës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, mekanizmat demokratikë mund të ndeshen me qëndrimet institucionale që barten nga regjimet e kaluara. Duke qënë se, parlamentet janë institucionet e para dhe më të lehta për t'u reformuar, komisionet e përhershme mund të jenë një instrument i efektshëm për të ofruar mbikqyrje dhe për të kontribuar në nxitjen e reformës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.<sup>406</sup> Krijimi i këtyre komisioneve bazohet në parashikimin e bërë për këtë qëllim në rregulloren e parlamentit, në ligje të veçanta apo edhe në Kushtetutë. Ndërkohë, organizimi i tyre mund të ketë të parashikuar edhe ngritjen e nënkomisioneve të ngarkuara me ndjekjen e çështjeve të veçanta apo mbikqyrjen e institucioneve të caktuara të sigurisë.

Në strukturën zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë bën pjesë edhe Komisioni për Sigurinë Kombëtare. Baza e ngritjes së këtij komisioni të përhershëm të Kuvendit të Shqipërisë vjen nga parashikimet e bëra në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,<sup>407</sup> ndërsa kompetencat e tij në kuadër të përgjithshëm dhe emërimi i komisionit përcaktohen në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë.<sup>408</sup> Në fushën e veprimtarisë së tij përfshihen

---

<sup>406</sup> DCAF Backgrounder, Komisionet Parlamentare për Mbrojtje dhe Siguri, 01/2006, faqe 2.

Webiste: [www.dcaf.ch/publications/backgrounders](http://www.dcaf.ch/publications/backgrounders)

<sup>407</sup> Shih nenin 77/1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>408</sup> Shih nenin 18 dhe 19/1, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.166 datë 16.12.2004. Ky vendim është ndryshuar disa herë, deri në 27.11.2014.

organizimi i mbrojtjes kombëtare dhe Forcat e Armatosura, bashkëpunimi ushtarak, punët e brendshme, emergjencat civile, rendi publik dhe shërbimet sekrete. Ndërkohë anëtarësia në komision, përbërja e tyre, organizimi dhe funksionimi i brendshëm përcaktohen në dispozita të tjera, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.<sup>409</sup>

Procedura e zhvillimit të mbledhjeve të këtij komisioni të përhershëm parashikojnë ndër të tjera të drejtën e kryetarit të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, me pëlqimin e kryesisë së komisionit, ose me kërkesën e shumicës së anëtarëve të komisionit, për të thërritur për raportim ose informim para komisionit drejtuesit e institucioneve shtetërore ose publike.<sup>410</sup> Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur në to merr pjesë me shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të komisionit. Për çështje që lidhen me kalendarin e punimeve, miratimin e raportit që do të paraqitet seancës plenare, për projektrezoluta ose projektdeklarata që i paraqiten Kuvendit për miratim, apo për çështje të tjera që lidhen me funksionimin e komisionit, vendimet merren me votim të hapur dhe me shumicë të votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të komisionit. Edhe mendimi i pakicës shënohet në procesverbalin e mbledhjes së komisionit duke iu bashkëngjitur mendimit të shumicës.<sup>411</sup>

Si rregull mbledhjet e komisionit janë publike, të hapura për median, grupet e interesit, apo vizitorë. Ato mund të bëhen të mbyllura vetëm nëse komisioni vendos për këtë gjë, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Publiciteti i veprimtarisë së komisionit parashikohet nëse kjo kërkohet nga një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit, në organizimin e seancave dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, të grupeve të interesit si dhe grupeve të tjera të interesuara.<sup>412</sup>

Një tjetër parashikim i rëndësishëm lidhet me regjistrimin dhe bërjen publike të mbledhjes së komisionit, me vendim të këtij të fundit, në rast se çështja e diskutuar në mbledhjen përkatëse është me interes të veçantë. Në çdo rast procesverbalet e përmbledhura të mbledhjes së komisioneve, me përjashtim të atyre që përmbajnë informacion të klasifikuar sekret shtetëror, bëhen publike dhe u shpërndahen përfaqësuesve të medias ose personave të tjerë.<sup>413</sup> Komisionet e Kuvendit mund të organizojnë seanca dëgjimore publike me qëllim marrjen e vërejtjeve dhe mendimeve nga institucione, persona ose grupe të interesuara për projektligjin e buxhetit të shtetit dhe projektligjet financiare që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me të.<sup>414</sup> Kontrolli i komisioneve të përhershme, sipas nenit 102, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, parashikon të drejtën për thërritjen e ministrave për të dhënë shpjegime dhe sqarime për probleme të fushave që ata mbulojnë, si dhe kryerjen e kontrolleve, apo kërkimin e dokumentacionit që konsiderohet i nevojshëm për shqyrtimin e një çështjeje të caktuar.

---

<sup>409</sup> Shih nenet 18 dhe 19/1, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

<sup>410</sup> Po aty, pika 1 e nenit 33.

<sup>411</sup> Po aty, neni 34.

<sup>412</sup> Po aty, neni 35 dhe neni 36.

<sup>413</sup> Po aty, pikat 3 dhe 4, të nenit 39.

<sup>414</sup> Po aty, pika 2 e nenit 80.

Duke reflektuar për çështje që lidhen me objektin e veprimtarisë mbikqyrëse të Kuvendit të Shqipërisë, por edhe të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, vlen të sillej në vëmendje fakti se, veprimtaria e SHISH përcaktohet taksativisht se kontrollohet nga Kuvendi, nëpërmjet Nënkomisionit të Përhershëm Parlamentar, të ngritur për këtë qëllim.<sup>415</sup> Efektivisht pra jemi në kushtet kur për vet rëndësinë që paraqet veprimtaria e këtij institucioni është paraparë, ngritja e një nënkomisioni parlamentar që ndihmon në thelb dhe për logjikë, punën e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Po sipas ligjit, ky nënkomision ka të drejtë të kontrollojë përdorimin e fondeve publike që i kalojnë SHISH, nga buxheti i shtetit, çdo vit kalendarik.<sup>416</sup>

Mungesa e këtij nënkomisioni parlamentar gjykoj se, nuk duhet të vlerësohet vetëm si një çështje e moszbatimit të ligjit prej kaq vitesh, por edhe si një mangësi serioze e procesit mbikqyrës ndaj veprimtarisë së SHISH, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë. Kjo mangësi cungon procesin e raportimit shumëplanësh të nevojshëm për veprimtarinë e këtij institucioni, si dhe humbet frymën e ligjit për vlerësimin si çështje specifike mbikqyrjeje të veprimtarisë së SHISH, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë. Ndërkohë duhet vlerësuar se, mbikqyrja parlamentare jo vetëm rrit përgjegjshmërinë në veprimtarinë e sektorit të sigurisë, por shërben edhe si një mjet informimi për çështje të rëndësishme për interesin publik.

### **3.7 Siguria kombëtare dhe integrimi**

Siguria kombëtare është sot një nga temat e paprekura ende konkretisht dhe në themel, kur flasim për integrim të Shqipërisë në organizma rajonale, europiane dhe globale. Vendi ynë është pjesë e organizatave rajonale si, Iniciativa e Adriatikut dhe Jonit, Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore, Iniciativa për Bashkëpunim në Europën Juglindore, Iniciativa për Europën Qendrore. Në nivel europian është anëtar i Këshillit të Europës dhe OSBE-së. Prej vitit 2009 është anëtar i NATO-s, ndërsa prej vitesh në nivel global është anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organizmave të krijuara prej saj.

Sidomos pas zhvillimeve demokratike në fillim të viteve 90', pyetja që shtrohet është se, çfarë dobie i sjell sigurisë kombëtare hapja globale që, vendi ynë ka aplikuar dhe aplikon në planin ndërkombëtar, kur ai luan një rol pasiv në procesin e vendimarrjes për çështje të sigurisë. Historia e afërt e izolimit i ka bërë skeptikë disa individë, sikurse ka nxitur pritshmëri tej logjikës së ftohtë. Megjithatë, dy pikat kulmore të proceseve integrale të vendit lidhen me anëtarësimin në NATO,<sup>417</sup> dhe procesin e filluar të anëtarësimit në BE.<sup>418</sup>

---

<sup>415</sup> Shih paragrafin e parë, të nenit 7, të Ligjit nr.8391 datë 28.10.1998 "Për shërbimin informativ kombëtar", i ndryshuar.

<sup>416</sup> Po aty, paragrafi i fundit i nenit 8.

<sup>417</sup> Shqipëria mori ftesën e anëtarësimit në NATO, në Samitin e Bukureshtit të zhvilluar në 2 Prill 2008 dhe u anëtarësua me të drejta të plota, në Samitin e Strasburg & Kehl, në 2 Prill 2009.

<sup>418</sup> Marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian kanë filluar me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, Shqipëri-Komuniteti Ekonomik Europian, në Qershor 1991. Si pika kulmore dhe përmes një procesi intesiv mund të përmenden; 12 Qershor 2006, vendi ynë nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit me Komunitetet Europiane dhe vendet e tyre Anëtare; 1 Janar 2008, nënshkrimi i marrëveshjes së lehtësimit të vizave mes vendit tonë dhe BE-së; 28 Prill 2009, Qeveria shqiptare dorëzon Aplikimin e Shqipërisë për anëtarësimin në BE; 10 Qershor 2011, Qeveria shqiptare miraton Planin e Veprimit që adreson



Për të kuptuar se cili është ndikimi i anëtarësimit në këto dy organizata, duhet kuptuar se çfarë përfaqësojnë ato dhe situatën e krijuar në të ashtëquajturin “forum shopping”.<sup>419</sup> Në bazën e krijimit dhe funksionimit, dy organizatat janë aleanca vendesh të bazuara në vlera dhe sisteme qeverisjeje demokratike, njëra kryesisht në aspektin ushtarak dhe tjetra në aspektin ekonomik, që përmes standardeve garantojnë sigurinë e çdo vendi anëtar dhe jo vetëm, të rajonit si dhe në nivel ndërkombëtar.

Nisur nga një qasje racionale, si NATO edhe BE përdoren nga vendet anëtare për realizimin e interesit kombëtar, ndërkohë që ato janë thjesht dy organizata ndërkombëtare në nivel të njëjtë horizontal, asnjnjëse dhe ndërhyrëse rast pas rasti në varësi të ekspertizës specifike ofruese. Nga një këndvështrim realist i bazuar në argumentin e luftës për pushtet, si NATO edhe BE gjenden në një treg konkurrence të ashpër për pushtet, burime dhe ndikim.

Nga një perspektivë konstruktiviste, marrëdhënia midis BE dhe NATO është në radhë të parë, e orientuar ndaj përhapjes sa më të gjerë të vlerave të demokracisë liberale, drejt shoqërizimit të elitave politike dhe ushtarake, në vendet partnere.<sup>420</sup> Megjithatë, kjo nuk përjashton rivalitetet vlerash ofruese të sigurisë në nivel ndërkombëtar, kundrejt kostos konkurrese të oportunitetit,<sup>421</sup> për vendin përfitues. Ajo çka mund të thuhet me siguri është se, anëtarësimi në NATO, si dhe eksperiencia në vazhdim për anëtarësimin në BE kanë ofruar mundësi të reja dhe kanë nxitur një sërë reformash standardizuese perëndimore, në administratën publike, FA, drejtësi, luftën kundër korrupsionit, njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, etj.

Këto anëtarësime kanë një impakt të padiskutueshëm dhe janë të lidhura ngushtë me zhvillimin ekonomik, me sigurinë e vendit dhe të rajonit, me gjithë zhvillimin që duhet të përfshijë të gjitha fushat, sociale, politike, kulturore, arsimore, ushtarake etj. Pa mohuar efektet pozitive, kjo qasje ka edhe efektet negative që lidhen me humbjen e sovranitetit kombëtar, disproporcionalitetet standardizuese në adoptimin e legjislacionit kombëtar, apo dhe të vendosjes së prioriteteve konverguese, gjë që nxjerr nevojën e qartësimin të pritshmërive ndaj anëtarësimeve përkatëse. Bashkësia e vlerave që këto dy organizata përfaqësojnë, vlerësohen, “si mundësi dhe kufizime, të cilat kanë potencialin të përmirësojnë sigurinë e Shqipërisë, nëse adoptohen politika dhe strategji adekuate”.<sup>422</sup>

---

12 prioritetet kyçe të Opinioneve të BE-së, ku ndër të tjera kërkohet përfundimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Vendi ynë është ende në proces, duke kaluar gjithë fazat e domosdoshme për plotësimin e “kriterëve të Kopenhagenit”, për anëtarësimin në BE.

<sup>419</sup> Busch M., (2007): “Overlapping Institutions, Forum Shopping and Dispute Settlement in International Trade”, International Organization, Cambridge University Press, viti 2007, Vol.61, faqe 735-761.

<sup>420</sup> M. Rousselin, “Rruga drejt komunitetit EuroAtlantik: Efektet e marrëdhënieve BE-NATO mbi sigurinë e Shqipërisë”, faqe 118, cituar në botimin e Institutit për Ndërmjetësim dhe Demokraci “Çështje të sigurisë-9”. Website: idmalbania.org/publications/alb/Çështje\_të\_sigurisë\_9.pdf

<sup>421</sup> Kostoja e oportunitetit është një term që përdoret gjerësisht sot në marrëdhëniet ndërkombëtare në rastet kur vendet e vogla, për qëllime përfitimi në çështjet e sigurisë dhe për të rritur influencën e tyre, “lëshojnë” me ndërgjegje të plotë nga sovraniteti i tyre kombëtar.

<sup>422</sup> M. Rousselin, “Rruga drejt komunitetit EuroAtlantik: Efektet e marrëdhënieve BE-NATO mbi sigurinë e Shqipërisë”, faqe 127, cituar në botimin e Institutit për Ndërmjetësim dhe Demokraci “Çështje të sigurisë-9”. Website: idmalbania.org/publications/alb/Çështje\_të\_sigurisë\_9.pdf

### 3.8 Disa përfundime:

- Siguria si koncept është një reagim njerëzor, i lidhur ngushtë me mbijetesën e individit në ambientin rrethues, ndërkohë që siguria kombëtare që në fillimet e saj dhe madje edhe në nivelin aktual të zhvillimit shoqëror, thuhet ekskluzivisht ka të bëjë me shtetin-komb sovran nga aspekti i mbrojtjes së integritetit të vet fizik dhe territorial, në sistemin e shteteve në nivel global.
- Siguria kombëtare përshfaq aftësinë e shteteve për t'u mbrojtur ndaj kërcënimeve të brendshme dhe atyre të jashtme, të cilat kanë tejkaluar rrezikun tradicional të luftës dhe përdorimit të forcës, të zgjeruara sot me degradimin mjedisor, varfërinë, pandemitë e ndryshme, HIV-Sida, terrorizimin e shfaqur në shumë forma, armët e shkatërrimit në masë, krimin transnacional dhe konfliktin ndërshtetëror. Kjo dinamikë e kohëpaskohëshme kërcënimesh dhe rreziqesh ka kondicionuar përcaktime të shumta mbi konceptin e sigurisë.
- Paradigma bashkëkohore e sigurisë, analizohet në formën e tri kornizave themelore konceptuale, përkatësisht të sigurisë individuale; sigurisë kombëtare dhe sigurisë ndërkombëtare, pasi siguria e një shteti ndikon në sigurinë e qytetarëve të tij, por ndikon edhe në sigurinë e shteteve të tjerë në sistemin ndërkombëtar.
- Zhvillimi historik i konceptit dhe elementët përbërës të sigurisë kombëtare, që nga krijimi i shteteve sovraane, mbarimi i Luftës së Ftohtë, e deri sot ndryshon nga një vend në tjetrin, në varësi të veçantive përfaqësuese shtetërore, shfaqja e kërcënimeve të jashtme dhe të brendshme si dhe të interesave kombëtare që kërkohet të mbrohen.
- Duke origjinuar që nga Traktatet e Helsinkit të vitit 1975, siguria njerëzore e shumëpërkufizuar mbështetet në respektimin e konceptit të të drejtave të njeriut dhe vë në plan të parë sigurinë e individëve, kundrejt konceptit tradicional të sigurisë kombëtare, i cili vë në plan të parë sigurinë e shtetit.
- Zhvillimi i konceptit të sigurisë njerëzore ka zgjeruar konceptin e sigurisë, duke përfshirë në të jo vetëm dimensionet ndërkombëtare të sigurisë njerëzore, por edhe ato që zhvillohen brenda shteteve. Siguria njerëzore kërkon një konsiderim të kujdesshëm të koncepteve të tjera të sigurisë ekonomike, të ndryshimit dhe thellimit të rreziqeve të reja jotradicionale ndaj njerëzve dhe shteteve, të sigurisë së ushqimit, mjedisit, pabarazisë ekonomike, shkeljes së të drejtave të njeriut, sigurisë individuale dhe politike, katastrofat natyrore dhe katastrofa të tjera. Ky konsiderim ecën paralel me binomin siguri-pasiguri, i cili përcakton dukshëm edhe politika dhe prioritetet në drejtim të sigurisë njerëzore.
- Veç ngjashmërive të koncepteve të sigurisë njerëzore dhe atij të të drejtave të njeriut, duhet theksuar se, koncepti dhe realizimi efektiv i të drejtave të njeriut

- tejkalon teorinë e lirisë prej frikës dhe nevojës, të identifikuar në gjenezën e sigurisë njerëzore.
- Qëllimi fundor i sigurisë kombëtare të shtetit shqiptar, për ruajtjen e tërësisë territoriale dhe sovranitetit, materializohet që nga koha e krijimit të Qeverisë së parë, pas shpalljes së pavarësisë, deri në çlirimin e vendit, duke vazhduar në vitet e para të çlirimit të vendit, e deri në vitin 1990, i konkretizuar në vetizolim dhe vetëmbrojtje. Aspiratat për anëtarësim në BE dhe anëtarësimi në NATO, rikthyen vëmendjen ndaj rivlerësimit të koncepteve të sigurisë kombëtare të përshtatura në dokumentet e politikës së sigurisë kombëtare të viteve 2000 dhe 2004, si dhe së fundmi në vitin 2014.
  - Siguria kombëtare materializohet në dokumentin e sigurisë kombëtare, si një dokument kornizë, burimor dhe zhvillimor, prevalues ndaj politikave të tjera të sigurisë, ku përshkruhet se si një vend ofron sigurinë, bazuar në një vizion të gjerë aktual dhe të së ardhmes. E udhëhequr nga vlerat dhe parimet bazë të mishëruara në dokumentin themeltar të një vendi si dhe interesat kombëtare, një strategji e efektshme duhet të bëjë vlerësimin e rreziqeve dhe mundësive aktuale e të ardhshme, të përshkruajë qartë fushën e përgjegjësisë së çdo aktori zbatues, të trajtojë kompetencën dhe krijimin e organeve mbikqyrëse të zbatimit të saj në aspektin politik, institucional dhe atë të shoqërisë civile, transparencën e procesit të formulimit dhe qartësinë e koncepteve të dhëna, pa përjashtuar garantimin e konfidencialitetit në fusha të caktuara të sigurisë kombëtare dhe rolin e demokracisë dhe të zhvillimit ekonomik, në vizionin e vendit për sigurinë.
  - Gjykoj se, konfuzioni i vërejtur në SSK e miratuar me Ligjin nr.9322 datë 25.11.2004, në përdorimin e termonologjive të caktuara dhe përcaktimi i tërësisë së të drejtave dhe lirive të individit që shërbejnë si udhërrëfyes të ndërtimit të konceptit të strategjisë kombëtare; këndvështrimi më së shumti ndaj kërcënimeve tradicionale të sigurisë dhe mospasqyrimi i duhur i kërcënimeve dhe rreziqeve të reja; mungesa e dimensionit të duhur të sigurisë njerëzore, si dhe mosrespektimi i afatit taksativ kohor për rishikimin e këtij dokumenti, kanë evidentuar domosdoshmërinë e rishikimit dhe rikonceptimit të dokumentit të SSK.
  - SSK e miratuar me Ligjin nr.103/2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, në ndryshim nga dokumenti strategjik i vitit 2004, përfaqëson strategjinë e një vendi anëtar të NATO-s, rrjedhimisht duke u mbështetur në Konceptin Strategjik të NATO-s, si dhe të një vendi kandidat potencial në BE. Nga ky këndvështrim, SSK në fuqi, harmonizon rolin, misionin, përgjegjësitë, kapacitetet dhe organizimin e institucioneve të sigurisë së Republikës së Shqipërisë, me realitetin e ri të sigurisë kolektive.
  - Në të gjithë komponentët e SSK të vitit 2014, kemi të shpërndarë rregullime që lidhen me elementë të sigurisë njerëzore, sikundër afirmimi për respektimin e dinjitetit njerëzor, respektimin e të drejtave të njeriut, sigurinë shëndetësore, sigurinë ushqimore, sigurinë mjedisore, etj. Pavarësisht këtij zhvillimi

- përmbajtësor mendoj se, duhej theksuar si një terminologji e veçantë në të, e drejta e informimit, që në qëllimin dhe objektin realizues të saj përbën edhe thelbin e konceptit të transparencës. Po kështu, në përmbajtjen e saj vazhdon përdorimi i tejkaluar i termit “shtet ligjor”, ndërkohë që, duke u fokusuar tek siguria njerëzore mendoj se, kërcënimet e përcaktuara mbi sigurinë e informacionit të klasifikuar, duhej të konceptoheshin në një raport më të ngushtë me “rrezikun dobiprurës”, që mund t’i sjellë informacionit të sigurisë kombëtare realizimi i së drejtës për informim. Pavarësisht këtyre konstatimeve, duhet vlerësuar se kjo SSK përbën një dokument të rëndësishëm konceptual, që identifikohet i mirëstrukturuar.
- Veprimtaria e shërbimeve sekrete lidhet me ekzistencën e sekreteve shtetërore dhe njihen si zhvillime potencialisht cënuese ndaj të drejtave të njeriut, mohuese të mundësisë për transparencë. Si sistem rregullator i “shërbimit informativ demokratik” është përshtatur sistemi i rregullimit të veprimtarisë së këtij shërbimi me ligj dhe mbikqyrja e ligjshmërisë së kësaj veprimtarie.
  - SHISH, është një institucion i rëndësishëm i sektorit të sigurisë në një shoqëri demokratike, me funksion kryesor grumbullimin dhe analizimin e informacioneve që, lidhen me kërcënime ndaj sigurisë kombëtare. Ngjashëm, por e kufizuar në fushën e sigurisë së mbrojtjes, si pjesë aktive e Forcave të Armatosura, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ka si funksion kryesor grumbullimin, përpunimin, vlerësimin, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave dhe informacioneve si dhe paraqitjen e produktit të inteligjencës gjithëburimëshe për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura. Ngritja dhe funksionimi i këtyre dy institucioneve bazohet në ligje specifike. Spektri i kontrollit dhe mbikqyrjes së veprimtarisë së tyre lidhet me një sërë institucionesh të përcaktuara shprehimisht në ligj, ku veçohet mbikqyrja që ushtrohet nga Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet strukturave dhe mekanizmave përkatëse të tij që realizojnë këtë proces.
  - Megjithëse SHISH dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përjashtohen nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të informacionit, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve të emrave, të titujve zyrtarë, të pagave e të numrit të personelit, mendoj se kjo gjë nuk i kthen ato në institucione hermetike. Kontrolli i ushtruar ndaj tyre nga ana e ekzekutivit, gjyqësorit, Kuvendit, si dhe nga institucionet e pavaruara të kontrollit i shërben jo vetëm rritjes së përgjigjësisë dhe ligjshmërisë së veprimtarisë por edhe realizimit të së drejtës për informim, për publikun. Të dyja institucionet në kuadër të kësaj të drejte, mund të ndërmarrin një rol më proaktiv në përgatitjen dhe bërjen publike, të raporteve për publikun përmes raportimit të tyre në faqen zyrtare përkatëse të internetit.
  - Konflikti në dukje ndërmjet të drejtës për informim dhe ruajtjes së sekretit shtetëror, lidhur me veprimtarinë e SHISH dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, gjykoj se duhet t’i nënshtrohet respektimit të parimeve mbi sigurinë kombëtare, lirinë e shprehjes dhe aksesin në informacion. Kjo pasi, Ligji “Për Shërbimin Informativ Shtetëror”, apo edhe Ligji “Për Agjencinë e Inteligjencës

dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, nuk parashikojnë shprehimisht mundësitë ligjore që, subjektet e legjitimuara mund të shfrytëzojnë për t’u ankimuar ndaj veprimtarisë së këtyre institucioneve.

- Rritja e transparencës në veprimtarinë e SHISH dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, gjykoj se do të ndihmohej dhe promovohet me hyrjen në fuqi të një ligji specifik, mbi mbikqyrjen e shërbimeve informative.
- Mbikqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë në Shqipëri, jo vetëm rrit përgjegjshmërinë në veprimtarinë e sektorit të sigurisë, por shërben edhe si një mjet informimi për çështje të rëndësishme për interesin publik. Kuvendi i Shqipërisë e ushtron këtë funksion në format dhe përmes strukturave të tij, ku vend të rëndësishëm luan veprimtaria e Komisionit të përhershëm për Sigurinë Kombëtare.
- Eksperienca e anëtarësimit në NATO, si dhe ajo në vazhdim për anëtarësimin në BE kanë nxitur si efekte pozitive në vendin tonë një sërë reformash standardizuese perëndimore, në administratën publike, FA, drejtësi, luftën kundër korrupsionit, njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, etj. Por kjo qasje ka edhe efekte negative që lidhen me humbjen e sovranitetit kombëtar, disproporcionaliteteve standardizuese në adoptimin e legjislationit të brendshëm, apo dhe të vendosjes së prioriteteve konverguese, dinamikë kjo që mendoj se nxjerr nevojën e qartësimin të pritshmërive ndaj proceseve integruese.

## VI. KREU I KATËRT

### RAPORTI NDËRMJET SIGURISË KOMBËTARE DHE SË DREJTËS PËR INFORMIM DHE DISA PROBLEMATIKA TË KËTIJ RAPORTI NË SHQIPËRI.

#### 4.1 Raporti ndërmjet Sigurisë Kombëtare dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut

Sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara, siguria e shteteve bazohet në integritetin territorial dhe në sovranitet, ndaj në të drejtën ndërkombëtare ajo njihet si siguri kombëtare, apo siguri shtetërore. Në botën e sotme ku shfaqen kërcënime jotradicionale, jokonvencionale dhe transnacionale, mbrojtja e kufijve dhe ruajtja e integritetit territorial nuk mund të jetë më qëllimi fundor i sigurisë.

Me fokusimin tek individët në vend të shteteve, siguria njerëzore tenton të sfidojë konceptet tradicionale të sigurisë dhe nxit debatin mbi faktin se, “kufizimet e sovranitetit Shtetëror, mobilizimi i shoqërisë civile ndërkombëtare në mbrojtje të normave ndërkombëtare dhe ndarja e pushteteve midis shtetit dhe aktorëve joshetërorë në një botë globalizuese... japin një mesazh të qartë: shteti nuk është më në gjendje të monopolizojë konceptin dhe praktikën e sigurisë”.<sup>423</sup> Megjithatë siguria njerëzore nuk është një koncept zëvendësues i sigurisë kombëtare, pasi ajo e redukton këtë koncept në vetëm një koncept të mundshëm të sigurisë dhe në fund të fundit, siguria kombëtare nuk është një kënd fundor në vetvete.

Siguria njerëzore plotëson sigurinë kombëtare dhe përcakton më mirë qëllimin e saj bazë për mbrojtjen e njerëzve dhe jo të një entiteti abstrakt. Ky korelacion nxjerr në dukje lidhjen mes konceptit të sigurisë njerëzore dhe shtetit sovran, si dy nocione harmonike, pasi “siguria njerëzore garantohet shumë më mirë në Shtetin sovran, i cili qeveriset nga shteti i së drejtës, me respekt të plotë për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të atyre që banojnë në territorin e tij”.<sup>424</sup>

Më shumë se çdo gjë tjetër, siguria kombëtare dhe siguria njerëzore i përkasin marrëdhënieve njerëzore, pasi ato shprehin ide madhore morale që tregojnë se, si duhet të zhvillohet komunikimi njerëzor duke zhvendosur vëmendjen dhe analizën e kuptimit të sigurisë nga i ashtëquajtimi sovraniteti territorial, tek sovraniteti individual. Krause pohon se, “Përdorimi i konceptit të sigurisë njerëzore nga shtetet dhe vendimmarrësit nuk është thjesht një çështje e parëndësishme etiketimi. Thënë më mirë, ai i udhëheq shtetet dhe

<sup>423</sup> Lodgaard S.: “Human Security: Concept and Operationalization”.

Website: [www.hsph.harvard.edu/hpcr/events/hsworshop/lodgaard.pdf](http://www.hsph.harvard.edu/hpcr/events/hsworshop/lodgaard.pdf) (faqe 4).

<sup>424</sup> Correll H.: From Territorial Sovereignty to Human Security, Address to the Annual Conference of the Canadian Council of International Law 1999. Website: [www.un.org/law/counsel/ottawa.htm](http://www.un.org/law/counsel/ottawa.htm)

politikë-bërësit që të përqëndrohen në çështje të ndryshme, të bëjnë pyetje të ndryshme dhe madje të promovojnë politika të ndryshme...”.<sup>425</sup>

Sovraniteti shtetëror, në kuptimin e tij më bazik, po ripërkufizohet – jo më pak prej forcës së globalizimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Është kuptuar gjerësisht tani se shtetet janë instrumenta në shërbim të popujve të tyre dhe jo e kundërta. Në të njëjtën kohë, sovraniteti individual – me të cilin kuptohet liria themelore e çdo individit, e afirmuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe traktatet pasuese ndërkombëtare – po rritet nga një ndërgjegje e rilindur dhe e përhapur për të drejtat e individit. Kur ne lexojmë Kartën sot, bëhemi edhe më shumë të ndërgjegjshëm se, qëllimi i saj është të mbrojë qëniet njerëzore individuale dhe jo të mbrojë ata që abuzojnë me to.<sup>426</sup>

Qendra e vëmendjes së sigurisë njerëzore dhe të të drejtave të njeriut mbetet individi. Të drejtat e njeriut, në princip u njihen të gjitha qënieve njerëzore duke u mbështetur thjesht në qënien biologjike njerëzore. Ato nuk kanë pse të fitohen e kufizohen, veç në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës. Qëniet individuale njerëzore mund të mbrojnë të drejtat e tyre, ndërkohë që shtetet dhe entitetet e tjera janë të detyruara të respektojnë, mbrojnë dhe realizojnë ato. Të respektosh të drejtat e njeriut do të thotë t’i mbrosh ato, të mbrosh ato do të thotë të japësh sigurinë se ato nuk dhunohen nga të tjerët dhe të realizosh ato do të thotë të zbatosh masa pozitive, për të siguruar gëzimin e të drejtave të tyre nga individët. Të drejtat e njeriut janë të pacënueshme.

Gjëja më e rëndësishme nga perspektiva e diferencave ndërmjet regjimit juridik ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe debatit të sigurisë njerëzore është se, respektimi, mbrojtja dhe realizimi i të drejtave të njeriut nuk janë zgjedhje të politikës...Shtetet që kanë nënshkruar dhe ratifikuar traktatet relevante të të drejtave të njeriut nuk u lejohet ti japin përparësi një të drejte apo një grupi të drejtash, ndaj një tjetre, në përmbushjen e objektivave politikë.<sup>427</sup> Këto të drejta afirmohen dhe sigurohen përmes regjimeve të të drejtave të njeriut, që përbëjnë një tërësi të drejtash dhe lirish ndërkombëtarisht të pranuar, si një koncept dinamik dhe i zgjeruar i mbrojtjes, promovimit dhe realizimit të të drejtave, dinjitetit, nevojave, jetesës, mirëqënies, lirisë dhe sigurisë të individit si qenie njerëzore.

Në referencë të DUDNJ,<sup>428</sup> siguria perceptohet si një e drejtë e njeriut dhe kjo e fundit afirmohet në kuadër të të drejtave të njeriut duke u vlerësuar njëkohësisht edhe si një detyrim i vendosur ndaj shtetit, për të mos ndërhyrë në integritetin e individit.

Në ligjëratën e sigurisë njerëzore, të drejtat e njeriut janë vetëm një prej shumë ”sigurive”, që individët duhet të gëzojnë, ndërkohë që ata jetojnë nën mbrojtjen, apo edhe nën kërcënimin e shteteve të tyre. Shumë qeveri shkelin të drejtat individuale njerëzore dhe i ndalojnë individët të bëjnë publike, apo të protestojnë, ndaj këtyre shkeljeve. Margjinalizimi i të drejtave individuale të njeriut në ligjëratën e sigurisë njerëzore, përkrah

<sup>425</sup> Krause K., (2005): “Human Security: An idea Whose Time has come?”, Security Dialogue, viti 2005, Nr.35, faqe 1.

<sup>426</sup> Kofi Annan: Two concepts of Sovereignty, The Economist, 18 Shtator, viti 1999.

<sup>427</sup> Oberleitner G., (2005): “Porcupines in Love: The Intricate Governance of Human Rights and Human Security”, European Human Rights Law Review, viti 2005, Nr.6, faqe 596.

<sup>428</sup> Në nenin 3, të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, thuhet se: “Çdokush ka të drejtën e jetës, lirisë dhe sigurisë së personit”.

këto qeveri dhe ua bën më të lehtë dhunimin e të drejtave të njeriut në emër të sigurisë njerëzore.<sup>429</sup>

Një sistem ligjor demokratik nuk mund të rezistojë në një mjedis jo demokratik dhe në këtë kuptim edhe një shtet liberal i së drejtës nuk mund të ruajë vlerat e tij civile, ndërkohë që shteti angazhohet gjerësisht në një situatë krize të sigurisë kombëtare. Sa më shumë që elitat politike përdorin sistemin ligjor për të mbështetur qëllimet e tyre gjatë një krize të sigurisë kombëtare, aq më pak liberale do të jetë baza ligjore, aq më shumë rritet rreziku për shkelje të të drejtave të njeriut. Krizat e sigurisë kombëtare rrezikojnë potencialin dhe atributet ekzistuese demokratike të shtetit të së drejtës. Ato shpesh kërkojnë një mobilizim të madh të burimeve ekonomike dhe njerëzore, në një mënyrë të tillë që shpesh hedh poshtë dhe çënon të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtën për informim. Në këto rrethana, një demokraci duhet të përpiqet të zhbëjë imponimin e kufizimeve mbi autonominë individuale dhe mbi identitetin bazik të komunitetit, mbi bazën e ligjeve abuzive.

Në kushtet e një krize të sigurisë kombëtare, ekziston rreziku i manipulimit të sistemeve ligjore me qëllim që të legjitimojë masa jo demokratike, në emër të ruajtjes së demokracisë. Duke e zgjeruar këtë diskutim nuk ka dyshim se, në koncept ligji dhe siguria kombëtare janë të mira publike. Të dy konceptet janë kuptuar si idealizimi dhe artikulimi i vullnetit të përgjithshëm. Të dyja perceptohen si nocione objektive që reflektojnë nevojat kolektive. Termat “siguri kombëtare” dhe “ligji” apo “shteti ligjor”, mbarten, gjenerohen artikulohe dhe ushtrohen përmes komuniteteve dhe organizatave profesionale, siç edhe ato të ushtarakëve, zyrtarëve, ekspertëve ushtarakë, gjyqtarëve, juristëve dhe ekspertëve ligjor. Por kjo gjë nuk duhet të dëmtojë dhe zhvleftësojë besimin publik dhe kritikizmin publik, të cilat janë vlera shumë të rëndësishme për demokracinë.

Në gjithë këtë ndërthurje të elementëve të përbashkët dhe dallues të sigurisë njerëzore dhe të të drejtave të njeriut del e nevojshme të kuptohet vendi që, këto dy koncepte zënë në marrëdhënien ndërmjet tyre, pasi në thelbin e tyre, të drejtat e njeriut janë “interesa të mbrojtura nga ligji”,<sup>430</sup> ndërsa siguria njerëzore është “një kusht sigurie apo ndjesi”.<sup>431</sup> Nga kontrasti i përkufizimeve, siguria njerëzore duket se përmban kërcënime kryesisht për të cilat të drejtat e njeriut nuk shfaqin shqetësim dhe shtrihet njëlloj drejt kërcënimeve që vijnë nga shteti dhe aktorët jo shtetërorë. Ky fakt të nxjerr në konkluzionin se, të drejtat e njeriut janë pjesë e sigurisë njerëzore dhe se, “siguria njerëzore përbën kështu një koncept më të gjerë, të përbërë nga të drejtat themelore, si dhe aftësitë themelore dhe nevojat absolute”.<sup>432</sup>

Siguria njerëzore ka të bëjë me nevojat bazë që, njerëzit kanë në çdo kënd të botës, nevoja këto që pas shumë kohërash janë riformuluar dhe përshtatur në konceptin e të drejtave të

---

<sup>429</sup> Rhoa E. Howard - Hassmann, “Human security: Undermining human rights?”, faqe 23. Website: [www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2011/63-hassmann-2011.pdf](http://www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2011/63-hassmann-2011.pdf)

<sup>430</sup> Von Jhering, marrë nga Bas de Gaayu Fortman: “Rights-Based Approaches”; Any New thing under the Sun? IDEA Newsletter 2000, faqe 3. Website: [www.carleton.ca/idea/newsletter/reports\\_122000\\_8.html](http://www.carleton.ca/idea/newsletter/reports_122000_8.html)

<sup>431</sup> The Modern Oxford English Dictionary, Oxford (Oxford University Press), viti 1992.

<sup>432</sup> Alkire S., Conceptual Framework for Human Security paper presented at Kennedy School, Harvard University, 2002. Website: [www.humansecurity-chs.org/doc/0206harvard.html](http://www.humansecurity-chs.org/doc/0206harvard.html)



njeriut. Ndaj sot të drejtat e njeriut konsiderohen si “thelbi i sigurisë njerëzore”,<sup>433</sup> dhe si “një kornizë normative për sigurinë njerëzore”.<sup>434</sup>

Ndërhyrja e kryer nga NATO në Kosovë evokon edhe një herë konsideratën se, të drejtat e shtetit nuk duhet të pengojnë aksionin e qëllimuar për dhënien e sigurisë ndaj njerëzve dhe se si siguria njerëzore është kthyer në një qendër vëmendjeje dhe shqetësimi për komunitetin ndërkombëtar. Megjithëse situata e fund viteve 90’ nuk përbënte një kërcënim direkt për sigurinë e ndonjë vendi anëtar të NATO, dhunimi sistematik dhe madje ekstrem i të drejtave të shqiptarëve nga shteti Serb në Kosovë, binte ndesh me vlerat e vetë aleancës në respekt të të drejtave të njeriut. Aksioni i NATO riafirmoi parimin e vjetër se, detyrimet ndaj qenieve njerëzore shtrihen përtej kufijve kombëtarë. Edhe zhvillimet më të fundit në Siri dhe ndërhyrja e mundshme e NATO-s, tregojnë se të drejtat e njeriut dhe siguria njerëzore nuk mund të trajtohet si një çështje thjesht kombëtare e një vendi, por si një shqetësim ndërkombëtar kur konstatohen shkelje të rënda.

## **4.2 Parimet e Johaneshburgut dhe Parimet e Tshwane, mbi Sigurinë Kombëtare, Lirinë e Shprehjes dhe Aksesin në Informacion**

Ruajtja e sovranitetit dhe vetëvendosjes nga ana e shtetit në çështjet e funksionimit të tij, krijon tensionim të vazhdueshëm ndërmjet pozitës së shtetit dhe të drejtave dhe lirive themelore të individit, një tensionim prezent ky në marrëdhënien ndërmjet sigurisë kombëtare dhe së drejtës për informim. Megjithëse masat e ndërmarra për sigurinë kombëtare imponohen për të mbrojtur shoqërinë në tërësi, shumë nga këto masa kufizojnë të drejtat dhe liritë e individëve në shoqëri.

Ndodhur para këtij rreziku eminent çështja që shtrohet ka të bëjë me, vendosjen e një balance të gjithëpranuar dhe normative për minimizimin e abuzivizmit me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në emër të mbrojtjes së çështjeve të sigurisë kombëtare, specifikisht në rastin tonë në marrëdhënien ndërmjet së drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare. Si mjeti i duhur në këtë përpjekje kanë shërbyer vendosja e disa parimeve ndërkombëtarisht të pranuar, të njohura si, Parimet e Johaneshburgut mbi Sigurinë Kombëtare, Lirinë e Shprehjes dhe Aksesin në Informacion dhe në vazhdim të tyre, Parimet e Tshwane.

Parimet e Johaneshburgut u adoptuan në 1 Tetor 1995, nga një grup ekspertësh të së drejtës ndërkombëtare, sigurisë kombëtare dhe të drejtave të njeriut, të mbledhur nga organizata “Article 19”, Qendra Ndërkombëtare Kundër Censurimit, në bashkëpunim me Qendrën për Studimet e Aplikuara Ligjore të Universitetit të Witwatersrand, në Johaneshburg. Ato bazohen në ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe vendase që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës, të njohura nga komuniteti i Kombeve të Bashkuara. Parimet e Johaneshburgut pranojnë zbatimin e qëndrueshëm të

---

<sup>433</sup> Alkire S., Conceptual Framework for Human Security paper presented at Kennedy School, Harvard University, 2002. Website: [www.humansecurity-chs.org/doc/0206harvard.html](http://www.humansecurity-chs.org/doc/0206harvard.html)

<sup>434</sup> Deklarata e adoptuar në Workshopin, “Mbi Marrëdhëniet mes të Drejtave të Njeriut dhe Sigurisë Njerëzore”, San Jose, Kosta Rika, 2 Dhjetor 2001. Website: [www.humansecurity-chs.org/doc/sanjosedec.html](http://www.humansecurity-chs.org/doc/sanjosedec.html)

Parimeve të Sirakuzës, mbi Dispozitat Kufizuese dhe Përjashtuese në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Standardet Minimum të Parisit, të Normave të të Drejtave të Njeriut, në një Gjendje të Jashtëzakonshme. Qëllimi mbetet, “draftimi i një seti parimesh që do të mund të mbrojnë në mënyrën e duhur, të drejtën për lirinë e shtypit dhe të informimit si edhe të drejtën e qeverive për të kufizuar të drejtën kur është e nevojshme për të mbrojtur një interes të ligjshëm të sigurisë kombëtare”.<sup>435</sup>

#### 4.2.1 Parimet e Johannesburgut

Parimet e Johannesburgut përmbledhin parime të përgjithshme të kuptimit të lirive dhe të së drejtës njëkohësisht, të kufizimit dhe konsiderimit të tyre në kuadër të shtetit të së drejtës, si dhe të mjeteve ligjore për rivendosjen e së drejtës së shkelur, rast pas rasti. Ato nuk duhen interpretuar si kufizim i ndonjë të drejtë dhe lirie njerëzore, të afirmuar në të drejtën, apo standardet ndërkombëtare, rajonale apo kombëtare.<sup>436</sup> Në këto parime përcaktohet se:

-“Çdokush ka të drejtën për liri të shprehjes, e cila përfshin lirinë për të kërkuar, marrë dhe ndarë informacion dhe ide të të gjitha llojeve, pa marrë parasysh kufijtë, ose gojarisht, me shkrim, apo printim, në formën e artit, ose përmes çdo medie tjetër, sipas zgjedhjes së tij/saj”.<sup>437</sup> Kjo liri, e cila nuk është absolute, mund të kufizohet mbi baza specifike ndërkombëtarisht të pranuar, ku përfshihet edhe siguria kombëtare. Kufizimi në kuadër të sigurisë kombëtare kushtëzohet nga parashikimi i tij në ligj<sup>438</sup>, dhe i qënies si nevojshmëri në një shoqëri demokratike,<sup>439</sup> i kryer për qëllime të mbrojtjes së një interesi të ligjshëm të sigurisë kombëtare.

Një konkluzion llogjik i marrëdhënies fundamentale ndërmjet shoqërisë demokratike, të drejtave të njeriut dhe lirisë së shprehjes është se, kufizimet ndaj lirisë së shprehjes dobësojnë themelet e një shoqërie demokratike. Siç vërehet nga GJEDNJ, kufizimet e vendosura ndaj lirisë së shprehjes dhe ndaj të drejtave të tjera, në emër të sigurisë kombëtare paraqesin një rrezik të vërtetë të minimumit, apo edhe shkatërrimit të demokracisë, mbi llogjikën e mbrojtjes së saj.<sup>440</sup>

<sup>435</sup> Colliver S., Hoffman P., Fitzpatrick J., Bowen S., (1999): “Secrecy and Liberty: National Security, Freedom of Expression and Access to Information”, Kluwer Law International, viti 1999, faqe 13.

<sup>436</sup> Ky parashikim gjendet në Parimin 25.

<sup>437</sup> Article 19, “The Johannesburg Principles on National Security, Freedom of Expression and Access to Information”, International Standard Series, London, November 1996, General Principles, Principle 1, gërma “b”, faqe 7.

<sup>438</sup> Ligji duhet të jetë i qasshëm, i qartë, i kuptueshëm dhe i saktë në mënyrë që t’u mundësojë individëve të parashikojnë nëse, një veprim i veçantë është i kundërligjshëm. Ai duhet të parashikojë mbrojtje adekuate ndaj abuzimit dhe shqyrtimin e menjëhershëm, të plotë dhe efektiv gjyqësor të vlefshmërisë së kufizimit nga një trup gjykues, apo gjykatë e pavarur. Po aty, Principle 1.1.

<sup>439</sup> Po aty, Principle 1.2, Principle 1.3, faqe 8.

Barra e vlefshmërisë së kufizimit të vendosur si të nevojshëm në një shoqëri demokratike i mbetet qeverisë. Për këtë qeveria duhet të provojë se:

- shprehja apo informimi në fjalë paraqet një kërcënim serioz për një interes legjitim të sigurisë kombëtare
- kufizimi i vendosur është mjete më i pakët, i mundshëm kufizues, për mbrojtjen e këtij interesi; dhe
- kufizimi është në përputhje me parimet demokratike.

<sup>440</sup> Colliver S., Hoffman P., Fitzpatrick J., Bowen S., (1999): “Secrecy and Liberty: National Security, Freedom of Expression and Access to Information”, Kluwer Law International, viti 1999, faqe 17.

-Koncepti i sigurisë kombëtare që shërben si premisë për kufizim të së drejtës, duhet të përkufizohet në mënyrë të saktë në ligj (parimi 2). Interesat legjitimë të sigurisë kombëtare mund të shërbejnë si të tillë kur, qëllimi i tij i vërtetë dhe efekti tregues është për të mbrojtur ekzistencën e një vendi, apo integritetin e tij territorial kundër përdorimit apo kërcënimit të forcës, apo të aftësisë së tij për t'iu përgjigjur përdorimit, apo kërcënimit të forcës, qoftë nga një burim i jashtëm, i tillë si një kërcënim ushtarak, apo një burim i brendshëm, i tillë si nxitja për të përmbysur me dhunë qeverinë. Nuk mund të konsiderohet interes legjitim nëse qëllimi i tij i vërtetë, apo efekti tregues është që të mbrojë interesa që nuk lidhen me sigurinë kombëtare, siç për shembull, për të mbrojtur një qeveri nga shqetësimi apo ekspozimi i gabimeve, apo për të fshehur informacion mbi funksionimin e institucioneve të saj publike, apo për të dhunuar një ideologji të veçantë, ose për të shtypur trazirat industriale.

-Gjendja e jashtëzakonshme, duhet të plotësojë disa kushte që të cilësohet si e tillë (parimi 3). Ajo realisht kërcënon jetën e vendit dhe ekzistenca e saj duhet të shpallet zyrtarisht në përputhje me ligjin kombëtar dhe të drejtën ndërkombëtare.<sup>441</sup>

-Si një parim universal, kufizimi qoftë edhe mbi baza të sigurisë kombëtare, nuk mund të ketë indicie diskriminimi (parimi 4).

-Ndalimi i aksesit në informacionin që lidhet me sigurinë kombëtare nuk mund të jetë absolut, por me ligj duhet të përcaktohen vetëm ato kategori specifike të ngushta të informacionit që është e nevojshme të ndalohen, me qëllim mbrojtjen e një interesi të ligjshëm të sigurisë kombëtare (parimi 12). Sipas parimit, interesi publik për njohjen e informacionit do të jetë konsiderata mbizotëruese, në miratimin e legjislacionit që rregullon regjimin juridik të së drejtës për informim (parimi 13). Sapo informacioni është bërë përgjithësisht i disponueshëm, në çfarëdolloj kuptimi, qoftë apo jo i ligjshëm, çdo justifikim për të provuar ndalimin e publikimit të mëtejshëm do të parandalohet prej së drejtës së publikut për të ditur (neni 17).

-Shteti detyrohet të marrë masa të duhura, për ushtrimin efektiv të së drejtës për të marrë informacion. Në rast refuzimi, autoritetet shtetërore duhet të specifikojnë arsyet në një kohë sa më të shpejtë. E drejta e ankimit ndaj një vendimi refuzimi duhet të shqyrtohet nga një autoritet i pavarur në aspektin administrativ, pa përjashtuar rishqyrtimin gjyqësor të ligjshmërisë së refuzimit. Autoriteti rishqyrtues duhet të ketë të drejtën të ekzaminojë informacionin e ndaluar.<sup>442</sup>

-Ndër këto parime dhe në përjashtim në fakt nga rregulli i përgjithëm, parimi 15, legjitimon pandëshkueshmërinë për publikimin e informacionit që sekretohet për shkak të sigurisë kombëtare kur; (1) bërja publike nuk dëmton në fakt dhe nuk ka gjasa të dëmtojë një interes

---

<sup>441</sup> Sipas këtij parimi lejohet vendosja e kufizimeve në këto kushte ndaj lirisë së informimit, “por vetëm në masën e kërkuar rreptësisht nga ekzigjencat e situatës dhe vetëm kur dhe për aq kohë sa ato nuk janë në kundërshtim me obligimet e tjera të qeverisë, sipas të drejtës ndërkombëtare”. Si një kufizim parashikohet vendosja e censurës paraprake ndaj shtypit, siç parashikohet në Parimin 23.

<sup>442</sup> Article 19, “The Johannesburg Principles on National Security, Freedom of Expression and Access to Information”, International Standard Series, London, November 1996, Restrictions on Freedom of Information, Principle 14, faqe 11.

legjitim të sigurisë kombëtare, ose (2) interesi publik për të ditur informacionin, ka më shumë peshë, sesa dëmi që vjen nga bërja e tij publike.<sup>443</sup> Askush nuk mund të jetë subjekt ndëshkimi mbi bazat e sigurisë kombëtare, për bërjen publike të informacionit që ka marrë për shkak të kryerjes së shërbimit publik, nëse interesi publik për të ditur informacionin ka më shumë peshë sesa dëmi që vjen nga bërja e tij publike. Mbrojtja e sigurisë kombëtare mund të mos përdoret si një shkak për të detyruar një gazetar që të zbulojë një burim konfidencial (neni 18).

-Çdo kufizim në rrjedhjen e lirë të informacionit, në zonat e kufizuara,<sup>444</sup> nuk duhet të jetë i një natyre të tillë që të pengojë qëllimet e realizimit të të drejtave të njeriut dhe të drejtën humanitare.

-Çdo person i akuzuar për një krim që lidhet me sigurinë, ku përfshihet liria e shprehjes, apo ajo e informacionit gëzon të gjitha mbrojtjet ligjore të shtetit të së drejtës, të cilat janë pjesë e të drejtës ndërkombëtare (parimi 20). Këtu përshihen, e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm; e drejta për të mos u mbajtur në burg (ndaluar) arbitrarisht; e drejta për t'u informuar menjëherë në një gjuhë që personi mund të kuptojë mbi akuzat dhe dyshimet kundër tij/saj; e drejta për akses të menjëhershëm për këshillën e zgjedhjes; e drejta për zhvillimin e një procesi gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme; e drejta për të patur një kohë të arsyeshme për të përgatitur mbrotjen e tij/saj; e drejta për një gjykim të drejtë dhe publik nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme; e drejta për të ekzanimuar dëshmitë e prokurorisë; e drejta për të mos patur paraqitje provash në gjyq, derisa ato t'i bëhen me dije të akuzuarit dhe që, ai apo ajo të ketë mundësinë për të hedhur poshtë ato; dhe e drejta për të apeluar në një gjykatë të pavarur, që ka pushtetin të rishikojë vendimin mbi bazën e ligjit dhe të fakteve dhe për ta shfuqizuar atë. Të gjitha mjetet, përfshirë ato speciale, të tilla si "habeas corpus", apo mbrojtja, do të jenë të disponueshme për personat e akuzuar për krime të lidhura me sigurinë, përfshirë ato të ndodhura gjatë gjendjes së emergjencës publike.

-E drejta për gjykim nga një Gjykatë e pavarur, si parim evidenton elementë të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor mbi veprat penale me objekt sigurinë, si gjykimi nga një juri, apo gjyqtar realisht i pavarur dhe që kanë sigurinë e qëndrimit në detyrë; ndalimi i gjykimit të një personi civil për një krim që lidhet me sigurinë, nga ana e një gjykate ushtarake; ndalimi që një civil apo një pjesëtar i trupave të armatosura, të gjykohet nga një gjykatë "ad hoc", apo një gjykatë speciale. Ndëshkueshmëria duhet të jetë proporcionale me

---

<sup>443</sup> Jo vetëm që parimi ndërthur rregulla të caktuara në parimet e sipërcituara por parashikon edhe një pjesë të rëndësishme të regjimit të së drejtës për informim, e cila njihet në parim të veçantë të së drejtës për informim, që lidhet me mbrojtjen e individëve "Bilblifryrës", gjë që shpjegohet konkretisht në nenin 16, pasues.

<sup>444</sup> Shih nenin 19, të Parimeve të Johaneshburgut. Në veçanti, qeveritë nuk mund të ndalojnë gazetarët, apo përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, apo ndërqeveritare me një mandat, për të monitoruar zbatimin e të drejtave të njeriut, ose standardeve humanitare, për hyrjen në zonat ku ekzistojnë baza të arsyeshme për të besuar se shkeljet e të drejtave të njeriut, apo të së drejtës humanitare janë kryer, ose po kryhen. Qeveritë nuk mund të përjashtojnë gazetarët, apo përfaqësuesit e organizatave të tilla nga zonat të cilat po përjetojnë dhunë apo konflikt të armatosur, përveç kur prezenca e tyre mund të paraqesë një rrezik të pastër për sigurinë e të tjerëve.

rëndësinë e krimit të kryer ndaj sigurisë kombëtare, pasi e kundërta përbën shkelje të Parimit 24.<sup>445</sup>

## 4.2.2 Parimet e Tshwane

Këto parime janë një përpunim i mëtejshëm i parimeve të Johannesburgut. Ato njihen si Parimet Globale mbi Sigurinë Kombëtare dhe të Drejtën për Informim-Parimet e Tshwane. Këto parime janë përpjekja më e fundit për t'iu përgjigjur këtij trendi dhe janë draftuar nga 22 organizata dhe qendra akademike, në konsultim me më shumë se 500 ekspertë nga më shumë se 70 vende, në 14 takime të organizuara në mbarë botën, nga “Open Society Justice Initiative”. Ato janë finalizuar në 12 Qershor 2013.<sup>446</sup> Në linja të përgjithshme, këto 50 parime përcaktojnë se:

- Publiku ka të drejtën e aksesit në informacionin qeveritar, përfshirë informacionin nga entitetet private që kryejnë funksione publike, ose marrin fonde publike.
- I takon qeverisë të provojë nevojshmërinë e kufizimit ndaj të drejtës për informim. (Parimi 4)
- Qeveritë mund të fshehin informacion në mënyrë ligjore në fusha ngushtësisht të përcaktuara, të tilla si planet e mbrojtjes, zhvillimi i armatimit, dhe operacionet e burimet e përdorura nga shërbimet e inteligjencës. Ato mund të mbajnë të fshehtë edhe informacion konfidencial të dhënë nga qeveritë e huaja që, lidhet me çështjet e sigurisë kombëtare. (Parimi 9)
- Qeveritë nuk duhet të fshehin asnjëherë informacionin që ka të bëjë me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të drejtën humanitare, përfshirë informacionin mbi rrethanat dhe shkaktuesit e torturës dhe krimeve kundër njerëzimit, si dhe vendndodhjen e burgjeve sekrete. Këtu përfshihet informacioni mbi abuzimet dhe regjimet e shkuara dhe çdo informacion që, ato kanë mbi shkeljet e kryera nga përfaqësuesit e tyre, apo të tjerët. (Parimi 10A)
- Publiku ka të drejtë të dijë rreth sistemeve të mbikqyrjes dhe rreth procedurave të autorizimit të përdorimit të tyre. (Parimi 10E)
- Asnjë strukturë qeveritare nuk duhet përjashtuar nga kërkesat e hapjes, përfshirë këtu sektorin e sigurisë dhe autoritetet e inteligjencës. Publiku ka të drejtë

---

<sup>445</sup> Sipas parimit nr.24; Një person, një botim i medias, organizatë politike apo organizatë tjetër, nuk mund të jetë subjekt i sanksioneve, kufizimeve apo dënimeve për një krim që lidhet me sigurinë, ku përfshihet liria e shprehjes apo informimit, në rast se ato janë joproporcionale me rëndësinë e krimit në fjalë. Article 19, “The Johannesburg Principles on National Security, Freedom of Expression and Access to Information”, International Standard Series, London, November 1996, Rule of Law and Other Matters, Principle 24, faqe 14.

<sup>446</sup>Website: [www.opensocietyfoundations.org/publications/global-principles-national-security-and-freedom-information-tshwane-principles](http://www.opensocietyfoundations.org/publications/global-principles-national-security-and-freedom-information-tshwane-principles).

gjithashtu, të dijë rreth ekzistencës të të gjithë entiteteve të sektorit të sigurisë, ligjeve dhe rregulloreve që trajtojnë ato dhe buxhetet e tyre. (Parimi 5 dhe 10C)

- Blilbilfryrësit në sektorin publik nuk duhet të përballen me ndëshkim, nëse interesi publik për informacionin e bërë publik ka peshë më shumë se, interesi publik për sekretim. Megjithatë, ata duhet që paraprakisht të kenë bërë një përpjekje për të adresuar çështjen në mekanizmat e ankimit zyrtar, me kusht që të ekzistojë një mekanizëm i tillë efektiv. (Parimet 40, 41 dhe 43)
- Ndjekja penale ndaj atyre që përhapin informacion duhet të fillojë vetëm nëse informacioni ka një “rrezik real dhe të identifikueshëm për shkaktim të një dëmi të dukshëm”, që tejkalon interesin publik të bërjes publike. (Parimi 43 dhe 46)
- Gazetarët dhe të tjerët që nuk punojnë për qeverinë nuk duhet të ndiqen penalisht për marrjen, pasjen, apo përhapjen në publik të informacionit të klasifikuar, apo për komplotim, ose krime të tjera, bazuar në kërkimin e tyre për, apo aksesimin në informacionin e klasifikuar. (Parimi 47)
- Gazetarët dhe të tjerët që nuk punojnë për qeverinë nuk duhet të detyrohen të zbulojnë një burim konfidencial, apo një informacion të papublikuar në një rrjedhje informacioni gjatë një investigimi. (Parimi 48)
- Aksesit publik në proceset gjyqësore është thelbësor: “thelbi i sigurisë kombëtare nuk mund të mbështetet mbi minimin e të drejtës themelore të publikut për akses në proceset gjyqësore”. Media dhe publiku duhet të lejohen të kundërshtojnë çdo kufizim të aksesit publik, në proceset gjyqësore. (Parimi 28)
- Qeveritë nuk duhet të lejohen të mbajnë sekrete shtetërore, apo informacione të tjera konfidenciale të cilat, pengojnë viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut në kërkimin dhe sigurimin e kompensimit ndaj shkeljes që u ka ndodhur. (Parimi 30)
- Duhet të ekzistojnë organe mbikqyrëse të pavarura për sektorin e sigurisë, të afta për të aksesuar gjithë informacionin e nevojshëm për një mbikqyrje efektive. (Parimi 6, 31-33)
- Informacioni duhet të klasifikohet vetëm për atë sa nevojitet dhe asnjëherë pa afat të përcaktuar. Periudha maksimum e lejueshme për klasifikim duhet të rregullohet me ligj. (Parimi 16)
- Kërkimi i deklasifikimit duhet të ketë procedura të qarta, duke i dhënë përparësi procedurave për deklasifikimin e informacionit të interesit publik. (Parimi 17)

### **4.3 Sekretit shtetëror dhe Siguria kombëtare**

Mbrojtja e çështjeve dhe interesave të sigurisë kombëtare për nga natyra dhe qëllimi madhor që mbartin, legjitimojnë në një masë të caktuar kufizimin e të drejtave të njeriut,

në përputhje me rregullat normative që parakushtëzojnë këtë zhvillim. Kur flasim për marrëdhënien ndërmjet sigurisë kombëtare dhe të drejtës për informim, përplasja ndërmjet koncepteve, teorikisht dhe praktikisht ndodh në momentin e kufizimit të së drejtës për informim, për shkak të mbrojtjes së interesave të ligjshëm të sigurisë kombëtare. Objekti i këtij kufizimi lidhet me konceptin e informacionit të sigurisë kombëtare.

Termi, informacion i sigurisë kombëtare, pavarësisht mënyrave të përdorimit në vende të ndryshme apo edhe në tekste të ndryshme, nënkupton çdo të dhënë, pavarësisht mjetit të përdorur për ruajtjen e saj, apo çdo njohuri, që mund të komunikohet dhe që ka të bëjë me sigurinë e një kombi apo një shteti dhe që është në të njëjtën kohë e klasifikuar. Informacioni i sigurisë kombëtare lidhet zakonisht me mbrojtjen apo punët e jashtme të një shteti, por ai mund t'i atribuohet gjithashtu edhe integritetit territorial dhe sovranitetit, mbrojtjes së rendit kushtetues, punëve të brendshme, ekonomisë, apo edhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Duke u ndalur në këtë moment duhet theksuar se, fokusimi tek tendenca për të përdorur informacionin e sigurisë kombëtare për të mbrojtur shtetin mbi gjithçka ka rezultuar në konceptin e “sigurisë shtetërore”. Por nën hijen e këtij termi të ri, pra të “sigurisë shtetërore”, janë kryer shkelje të shumta, të rënda, të të drejtave të njeriut në të gjithë botën. Legjislatori ka krijuar për realizimin e këtij momenti ndërhyrjeje në fushën e drejtave të njeriut, një marrëdhënie juridike të posaçme, me objekt informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” dhe mbrojtjen e tij nga aksesimi publik. Në konotacionin e përditshëm, ajo gjë e cila mbahet e fshehtë njihet si sekret.

Efektivisht ka disa lloje informacionesh që përjashtohen nga aksesimi ndaj publikut, të tilla si sekretet tregtare, të dhënat personale, të dhëna mbi detyrimet dhe shlyerjet tatimore, etj. Informacione të caktuara mbahen të fshehta, pasi aksesimi i publikut në to mund të kompromentojë privatësinë e një individi të caktuar. Aksesimi publik i informacioneve të tjera mund të krijojë shkelje të pronësisë intelektuale, apo të konfidencialitetit. Në rastin e sigurisë kombëtare, diferenca qëndron në faktin se informacioni është cilësisht i ndryshëm nga gjithë kategoritë e sipërcituara për disa arsye: sepse aksesimi i tij i paautorizuar mund të përbëjë një kërcënim për sigurinë kombëtare; për shkak të rëndësisë së tij për mbikqyrjen dhe besueshmërinë e qeverisjes dhe për shkak se, mund të ekzistojë një interes detyrues publik për deklasifikimin dhe bërjen e tij publike.

Në këtë kuptim informacioni i mbajtur dhe i përpunuar nga ana e qeverive, nëse fshihet dhe nuk i lejohet akses për publikun përbën atë që njihet në terma të përgjithshëm, si sekret shtetëror. Konflikti që ndodh, “...nuk është një konflikt ndërmjet sekretit shtetëror dhe demokracisë në vetvete, por më tepër një konflikt që lind brenda idesë së procesit demokratik në vetvete. Konflikti është ky: besueshmëria demokratike kërkon publicitet, por qeveritë demokratike mund të shpallin ligjërisht nevojën për sekretin”.<sup>447</sup>

Nga një këndvështrim racional pra, mund të thuhet se, e drejta për informim sfidohet prej ekzistencës së sekretit shtetëror. Natyrisht që një nivel sekretimi është i domosdoshëm për

---

<sup>447</sup> Sugar R., (2007): “On Combating the Abuse of State Secrecy”, The Journal of Political Philosophy, Harvard University, viti 2007, Vol. 15, nr.4, faqe 405.

mbrojtjen e interesave të vendit nga armiqtë potencialë dhe kjo justifikon faktin që, çdo vend, përfshirë edhe shoqëritë më të hapura kufizojnë publikimin e informacionit për publikun që gjykohet se paraqet një kërcënim për sigurinë kombëtare. Çështja që ngrihet gjithmonë gjatë këtij diskutimi është nëse qeveria e përdor sekretin për të fshehur gjëra, të cilat njerëzit duhet t'i dinë, fakt që nëse ndodh shpie në mungesën e besimit ndaj qeverisë. Pikërisht besueshmëria është ajo që vihet në pikëpyetje, pasi historia botërore dhe ajo kombëtare njeh shkelje të këtij besimi të ndërsjelltë, shumë të rëndësishëm për demokracinë.

Me qëllim që të qeverisurit të formojnë opinionet e tyre mbi çështjet politike është e nevojshme që ata të kenë akses në informacionin politik dhe kjo kërkon që, vendimet qeveritare të bëhen publike. Nesë ata që janë në qeveri marrin vendime në fshehtësi, të qeverisurit kanë vetëm mjete jo të duhura për formimin e opinionit mbi çështjet publike.<sup>448</sup> Nga ana tjetër, sekretimi i skajshëm që qeveritë mund të ndërmarrin në realizimin e objektivit të sigurisë kombëtare, mund të minojë parimet e qeverisjes demokratike. Për këtë arsye, sot mbrojtësit e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, theksojnë se, “sekreti shtetëror është i papajtueshëm me një demokraci të shëndetëshme. Ai është një koncept plotësisht në kundërshtim me idenë e besueshmërisë së qeverisë. Demokracia vdes pas dyerve të mbyllura”.<sup>449</sup> Diskutimi publik, si element i marrjes së informacionit është konsideruar gjithashtu si një prej mekanizmave efikasë të mbikqyrjes demokratike të veprimtarisë së qeveritarëve, nga të qeverisurit. Rrjedhimisht nesë duam të arrijmë qëllimin e diskutimit publik, atëherë ne duhet t'u japim qytetarëve, ose aksesin ndaj të dhënave tepër të kufizuara, ose besimin se ato janë fshehur ndershmërisht.<sup>450</sup>

Pushteti ekzekutiv ka patur tradicionalisht privilegjin e aksesimit dhe përdorimit të informacionit të sigurisë kombëtare. Kjo lloj e drejte shpjegohet si e natyrshme, pasi qeveria posedon njohuri dhe mjete të specializuara dhe mund të veprojë me shpejtësi dhe efektivitet për të mbrojtur interesat e sigurisë kombëtare. Nga ana tjetër, kjo gjë justifikohet edhe me faktin se, qeveria posedon informacionin e sigurisë kombëtare sepse agjencitë që mbledhin, përpunojnë dhe shpërndajnë këto pjesë të informacionit, i përkasin qeverisë.

Ndër vite pushteti gjyqësor ka fituar të drejtën për të mos ju mohuar aksesin në informacionin e sigurisë kombëtare. Kjo e drejtë ka ardhur natyrshëm si kërkesë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, që në vetvete përfaqëson një nga të drejtat themelore të njeriut në një shoqëri demokratike. Që një gjyqtar të jetë i aftë të autorizojë një masë ndaj një personi që akuzohet për spiunazh apo tradhti, apo të autorizojë interceptimin e komunikimeve për mbrojtjen e interesave të sigurisë kombëtare, ai duhet të dijë dhe të njohë konkretisht se çfarë vihet në rrezik.

E drejta e autoriteteve të pushtetit legjislativ, pra parlamentit, për të patur akses në informacionin e sigurisë kombëtare është fituar në një kohë të mëvonshme. Arsyet që i

---

<sup>448</sup> Manin B., (1997): “The principles of Representative Government”, Cambridge University Press, viti 1997, faqe 167-168.

<sup>449</sup> Website: [www.aclu.org/national-security/secretcy](http://www.aclu.org/national-security/secretcy)

<sup>450</sup> Sugar R., (2007): “On Combating the Abuse of State Secrecy”, The Journal of Political Philosophy, Harvard University, viti 2007, Vol. 15, nr.4, faqe 407.



japin të drejtën parlamentarëve për të patur akses në këtë informacion janë politikat që hartohen nga parlamenti dhe roli mbikqyrës i parlamentit. Sa më shumë që parlamenti merr pjesë në bërjen e politikave shtetërore, aq më shumë duhet që ai të ketë akses dhe t'i lejohej informacioni i sigurisë kombëtare. Parlamenti ushtron mbikqyrje ndaj ekzekutivit. Mbikqyrja parlamentare e shërbimeve të sigurisë është një pjesë e kontrollit demokratik civil të forcave të armatosura dhe një kërkesë demokratike e rëndësishme.

Në një shoqëri demokratike të drejtën për akses në informacionin e sigurisë kombëtare e kanë edhe organe jo ekzekutive, të pavarur, siç edhe komisionerët apo ombudsmanët parlamentarë me mandat specifik si komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale, institucionet e auditimit shtetëror me çështjet që lidhen kryesisht me menaxhimin e fondeve publike dhe së fundmi, institucionet e Ombudsmanit me mandatin e gjerë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Mbrojtësit e konceptit të sekretit theksojnë nga ana tjetër, rëndësinë e tij dhe pamundësinë që ai i shkakton kundërshtarit për të goditur dhe dobësuar sigurinë kombëtare të një vendi. Sekretit luan një rol kyç dhe vendimtar në çështjet e sigurisë kombëtare. Përdorimi i sekretit si një mjet për sigurinë kombëtare ka të nevojshëm përcaktimin e disa parimeve që duhen respektuar. Dilema e diskutuar në këtë këndvështrim është kujdesi për të vendosur, çfarë të thuhet, si dhe mungesa e kontrollit mbi ata që marrin mesazhin e dhënë, që përkthehet në fitim apo humbje të avantazhit të sigurisë kombëtare. Sipas tyre, "...thuhet se heshtja, në fund të fundit, është flori".<sup>451</sup> Sipas kësaj rryme, vendosja e niveleve të caktuara të sekretimit, lejon ruajtjen dhe mbrojtjen e një avantazhi të sigurisë kombëtare. Kjo do të thotë se, sekretit është i përshtatshëm dhe i nevojshëm kur trajtohen çështje të sigurisë kombëtare.

Në fakt historia ka treguar se, shpesh sekretit u shkakton dëme të mëdha kombeve duke i privuar politikëbërësit dhe publikun nga informacioni kritik para marrjes së vendimeve dhe duke nxitur paligjshmërinë, mungesën e efikasitetit dhe mungesën e efektivitetit në organet dhe agjencitë shtetërore. Në një shoqëri të lirë, njerëzit kanë të drejtë të dinë se, çfarë po bën qeveria e tyre dhe përse. Ekziston një tezë shoqërore e cila supozon se, njerëzit presin nga qeveria që të mbajë sekret gjëra të caktuara dhe nëse vepron kështu do të krijojë një avantazh të përgjithshëm të sigurisë kombëtare. Kjo do të thotë se qeveria përcakton si të aplikojë sekretin dhe mban të informuar pushtetin legjislativ, mbi operacionet sekrete. Ekzistojnë kategori të përgjithshme gjërash që duhet të mbahen sekret, si për shembull, planet dhe veprimet ushtarake, planet dhe veprimet e shërbimit të inteligjencës, etj. Nga përplasja e këtyre dy kampeve, gjykoj se vjen nga mungesa e një sistemi, apo teorie të gjithëpranuar që përcakton se, çfarë duhet të mbahet sekret dhe në ç'nivel duhet të ruhet sekretit.

"Teoria" mund të sygjerojë "një kullë të fildishtë", por në realitet teoritë janë gjithmonë bazike për politikat e shëndetëshme... Teoritë përshkruajnë si të pajtojmë dy qëllime, të dy të dëshirueshëm por njëkohësisht përjashtues: për shembull, dilema që sekretit mund të

---

<sup>451</sup> Miller M. G., (2005): "Attaining and Maintaining National Security Advantage: Information Operations and Secrecy", Joint Information Operations Center, viti 2005, Nr.38, faqe 32.  
Website: [www.au.af.mil/info-ops/iosphere\\_spring05\\_miller.pdf](http://www.au.af.mil/info-ops/iosphere_spring05_miller.pdf)

sjellë një avantash informacioni ndaj një kundështari, ndërkohë që rregullat e sekretit thuajse gjithmonë vështirësojnë përdorimin e informacionit që po mbrohet”.<sup>452</sup>

Diskutimi mbi një teori të tillë gjykoj se duhet të japë zgjidhje mbi një sërë çështjesh si, dobishmëria në dilemën e ruajtjes së informacionit, apo bërjes së tij publike, kohëzgjatja e mbajtjes së fshehtë të informacionit dhe marrëdhënia që duhet vendosur ndërmjet sekretit të kërkuar për qëllime të sigurisë kombëtare dhe informacionit të kërkuar, si një tregues i demokracisë funksionale. Kjo përplasje debatesh mendoj se nxjerr në konkluzionin se, marrëdhënia ndërmjet të drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare, sa i përket përdorimit të mjetit të sekretimit duhet të ruajë një raport të mirëmennduar dhe të normuar, për të krijuar balancën reale mes regjimit juridik të së drejtës për informim dhe regjimit juridik të sistemit të mbrojtjes së sekretit. Përplasja reale që ndodh është përcaktimi i qartë dhe i përshtatshëm i balancës ndërmjet dy komponentëve të rëndësishëm të interesit publik dhe pikërisht ndërmjet interesit publik për transparencë në veprimtarinë e organizmit shtetëror dhe interesit publik, për ruajtjen e disa informacioneve nëpërmjet sekretit shtetëror. Përplasja që ndodh brenda konceptit të interesit publik, gjykoj se nxjerr në pah caktimin e prevalencës të regjimeve juridike që rregullojnë të drejtën për informim dhe sistemin mbrojtës të sekretit shtetëror, në tërësi dhe rast pas rasti.

Pikërisht një sistem mbrojtjeje sekreti, “...duhet të ketë katër karakteritika bazë. Së pari ai duhet të ketë parasysh se, sa kohë dhe para jemi ne të gatshëm të shpenzojmë për mbrojtjen e sekreteve. Së dyti, rregulli në mbrojtjen e sekretit duhet të jetë kontrolli i rrezikut dhe jo përjashtimi i rrezikut. Së treti, n’a nevojiten standarde të gjera qeverisëse dhe së katërti, kemi të nevojshme si transparencën, ashtu edhe sistemin “Check and Balance”.<sup>453</sup> Çështja më delikate në funksionimin e sistemit të mbrojtjes së sekretit është se, çfarë ekzaktësisht duhet klasifikuar si informacion sekret. Për këtë qëllim shërbejnë disa aksioma që duhet të shërbejnë si udhërrëfyes në krijimin e këtij sistemi. “Natyrisht ekzistojnë rrethana, të tilla si bisedimet diplomatike, burime dhe metoda të caktuara të inteligjencës, apo operacione sekrete të ndryshme sensitive ushtarake, që kërkojnë sekretim strikt”.<sup>454</sup> Ndaj edhe në këto kushte aksioma e parë, pranon se sekreti i sigurisë kombëtare mund t’i shërbejë interesit publik.

Aplikimi i sekretimit varet nga gjykime subjektive. Sikurse kemi theksuar informacioni që lidhet me sigurinë kombëtare mund të klasifikohet, kur në mënyrë të arsyeshme pritët t’i shkaktojë një dëm sigurisë kombëtare. Por mospasja e një përkufizimi shterues të sigurisë kombëtare dhe të kuptimit të dëmit të mundshëm nxjerr në pah natyrën subjektive të procesit. Varësisht nga gjykimi subjektiv nevojitet një mbikqytje e pavarur që korrekton këtë gjykim. Kjo aksiomë kërkon krijimin e mundësive për një konfirmim, apo kundërshtim të pavarur, të vendimeve sekretuese.

---

<sup>452</sup> Miller M. G., (2005): “Attaining and Maintaining National Security Advantage: Information Operations and Secrecy”, Joint Information Operations Center, viti 2005, Nr.38, faqe 29.

Website: [www.au.af.mil/info-ops/iosphere\\_spring05\\_miller.pdf](http://www.au.af.mil/info-ops/iosphere_spring05_miller.pdf)

<sup>453</sup> Berkowitz B.: “Secrecy and National Security”, Hoover Institution-Stanford University, National Security nr.3, July 2004. Website: [www.hoover.org/publications/hoover-digest/article/8014](http://www.hoover.org/publications/hoover-digest/article/8014)

<sup>454</sup> Ellsberg D., (2002): “A Memoir of Vietnam and the Pentagon Papers”, Viking Penguin, viti 2002, faqe 205.

Meqë llogaritja e dëmit të shkaktuar nga publikimi i informacionit nuk mund të bëhet në publik pa zbuluar informacionin e vërtetë, shoqëritë demokratike janë detyruara të delegojnë këtë detyrë tek ekzekutivi. Kjo marrëveshje nënkupton se, vetëm ekzekutivi është i autorizuar të gjykojë dëmin potencial të shkaktuar nga bërja publike. Një sistem klasifikimi i informacionit të sigurisë kombëtare sapo krijohet ka tendencën të rritet në përmasa, fushë dhe kompleksitet. “Çdo burokraci kërkon të rrisë superioritetin e të informuarit profesionalisht duke mbajtur qëllimet dhe njohuritë e saj, sekrete”,<sup>455</sup> ndaj edhe aksioma afirmon se, sekretin zyrtar tenton të zgjerojë gamën e tij në vetvete.

Sekreti zyrtar mund të shërbejë si mbrojtës ndaj abuzimit. Ka prova të shumta kohore se, aplikimi i sekretit mund të ulë efikasitetin dhe rolin e kontrollit ndaj abuzimit të zyrtarëve. Klasifikimi i informacionit si sekret shtetëror duhet të minimizohet për shumë arsye, pasi një sistem klasifikimi i zgjeruar, minimizon kontrollin demokratik dhe privon publikun ndaj informacionit. Ndaj edhe aksioma vazhduese përcakton se duhet të shmangët klasifikimi i panevojshëm.

Në disa rrethana, gjykoj se vetëm bërja publike e informacioneve qoftë edhe sekrete dhe jo fshehja e tyre, mund t’i shërbejë më mirë sigurisë kombëtare. Kjo aksiomë është vërtetuar më së miri me situatën e krijuar nga sulmet terroriste që ndodhën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo edhe në disa vende të Europës në fillim të viteve 2000’. Raportime dhe analiza të ndryshme që janë bërë pas këtyre ndodhive të rënda kanë nxjerrë përfundimin se, ndarja paraprake e informacionit me publikun, mbi kërcënimet e mundshme të pritshme, do të rriste vigjilencën publike dhe do të mobilizonte publikun për marrjen e masave mbështetëse.

Transparenca kërkon që qeveritë të kufizojnë nivelin në të cilin ato fshehin informacionin ndaj publikut. Kjo kërkesë nuk do të thotë se qeveritë duhet të jenë absolutisht transparente me qëllim që të gjykojnë si demokratike. Përderisa demokracitë në fakt, zgjedhin të lejojnë qeveritë e tyre të mbajnë sekrete me qëllim që të japin siguri, instituti i sekretit shtetëror është ndoshta i pajtueshëm, sesa në kundërshtim, me idealin e qeverisjes demokratike. Rrjedhimisht, qëllimi i kërkesës për transparencë në qeverisje është që të sigurojë se, informacioni i mbajtur në fshehtësi po mbahet sekret, vetëm për arsye legjitime të sigurisë kombëtare.<sup>456</sup>

#### **4.4 Legjislacioni shqiptar mbi informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.**

Eksperiencia ndërkombëtare nuk njih një praktikë të njëjtë lidhur me sistemin e mbrojtjes së sekretit shtetëror, për shkak të natyrës konkurruese që, e drejta për informim ka në marrëdhënien e vazhdueshme me sigurinë kombëtare, në mbrojtje të interesave publike. Në vendin tonë regjimi juridik i sekretit shtetëror, rregullohet në Ligjin nr.8457 datë

---

<sup>455</sup> Weber M., (1946): “Bureaucracy”, in Essays in Sociology, Oxford University Press, viti 1946, faqe 233-234.

<sup>456</sup> Bentham J., (1999): “Political Tactics”, New York, University Press, viti 1999, (II: 4), faqe 39.

11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar,<sup>457</sup> duke prezantuar një regjim të ndryshëm nga regjime juridike të tjera që trajtojnë informacione të kufizuara në akses. Regjimi juridik përcakton rregulla për klasifikimin, përdorimin, ruajtjen dhe deklasifikimin e sekretit shtetëror si një disponim ekskluziv i shtetit duke balancuar atë, më të drejtën e publikut për informim, me qëllimin madhor të mbrojtjes së pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues dhe marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë.<sup>458</sup>

Dy elementët kulmorë proceduralë, klasifikimi i informacionit dhe deklasifikimi i tij janë instrumentët juridikë që vendosin balancën ndërmjet të drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare, në një kohë kur ato komplementohen nga përdorimi dhe ruajtja e sekretit shtetëror. Ligji parashikon se, ekspozimi i paautorizuar i sekretit shtetëror mund të rrezikojë sigurimin kombëtar, ndaj edhe në varësi të rëndësisë së informacionit dhe dëmit që parashihet të sjellë rreziku i ekspozimit janë përcaktuar katër nivele klasifikimi; “Tepër sekret”, “Sekret”, “Konfidencial” dhe “I kufizuar”.<sup>459</sup>

Çështja e klasifikimit është një kërkesë e domosdoshme e regjimit juridik të sekretit shtetëror, ndaj edhe nëse do të shohim legjislacionin e vendeve të tjera në këtë fushë do të vërejmë se, ndryshimi qëndron vetëm në numrin e niveleve të klasifikimit.<sup>460</sup> Megjithatë në ligjin tonë mendoj se, përcaktimi i bërë për sekretin shtetëror të klasifikuar si “i kufizuar”, kur ekspozimi i paautorizuar mund të dëmtojë veprimtarinë, ose efektivitetin e institucioneve shtetërore në fushën e sigurisë kombëtare është problematik, duke patur parasysh natyrën subjektive të procesit të sekretimit dhe rrezikun e përdorimit të tij si një “koracë”, ndaj abuzimit. Ky nivel klasifikimi nuk përbën problematikë në aspektin formal, se sa përbën problematikë përmbajtja e dispozitës përkatëse që e përcakton atë, sidomos në lidhje me të drejtën për informim.

Identifikimi i sekretit shtetëror ka të përfshirë elementët e nivelit të klasifikimit, identitetin dhe pozitën e autoritetit klasifikues, institucionin e origjinës dhe udhëzimet e deklasifikimit.<sup>461</sup> Megjithatë vlerësoj se, për një proces transparent dhe për hir të krijimit të besueshmërisë së publikut ndaj procesit të klasifikimit do të ishte e nevojshme që, të jepej edhe arsyeja justifikuese për klasifikimin e aplikuar, gjë e cila mungon në ligj. Për

---

<sup>457</sup> Deri para miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij ligji, regjimi juridik i sekretit shtetëror rregullohej me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243 datë 28.07.1982.

<sup>458</sup> Shih nenin 1, paragrafin e dytë, të nenit 2 dhe nenin 6, të Ligjit nr.8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar.

<sup>459</sup> Shih nenin 3, të Ligjit nr.8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar.

<sup>460</sup> Ligji Belg, “Për klasifikimin dhe autorizimet e sigurisë”, i datës 11.12.1998, parashikon vetëm tre nivele klasifikimi; Ligji Kroat, “Ligji i të dhënave sekrete”, i datës 13 Korrik 2007, ka katër nivele klasifikimi; Ligji Lituanëz “Për sekretet shtetërore dhe sekretet zyrtare”, i datës 25.11.1999, i ndryshuar, ka katër nivele klasifikimi; Ligji Rumun “Për mbrojtjen e e informacionit të klasifikuar”, nr.182 datë 12.04.2002, seksioni 2, gërma “F”, ka tre nivele klasifikimi; Ligji Maqedonas “Për informacionin e klasifikuar”, i vitit 2004, ka katër nivele klasifikimi; Ligji Bullgar “Për mbrojtjen e e informacionit të klasifikuar”, nr.45 datë 30.04.2002, ka katër nivele klasifikimi; Ligji i Republikës së Kosovës “Për klasifikimin e informacionit dhe hapësirës së sigurisë”, nr.03/L-178, ka katër nivele klasifikimi.

<sup>461</sup> Shih nenin 9, të Ligjit nr.8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar.

më tepër, kjo do të ishte llogjike kur vetë ligji në nenin 16 të tij, përcakton edhe rastet e përjashtimit nga deklasifikimi. Sikurse parashikon një sistem klasifikimi, ligji natyrshëm dhe në harmoni me legjislacionin që garanton të drejtën për informim, parashikon edhe rastet e ndalimit të klasifikimit.<sup>462</sup>

Pavarësisht se ligji vendos kritere për deklasifikimin e sekretit shtetëror, publikimi i informacionit sekret mund të ndodhë kur diktohet nga interesa shtetërore më të rëndësishme, se sa nevoja për ta mbajtur atë të klasifikuar.<sup>463</sup> Por nëse ky përjashtim vjen në të njëjtën linjë me parime të gjithëpranuara rregullatore të balancës në marrëdhënien siguri kombëtare dhe e drejtë për informim, mendoj se mbetet problematik parashikimi për mosdeklasifikimin e informacionit të klasifikuar, kur kemi ekspozim të pautorizuar të një informacioni identik, apo të ngjashëm.

Pyetja që shrohet është nëse a ka vlerë më klasifikimi, nëse informacioni është bërë publik dhe sidomos, nëse kjo ka ndodhur nga një “Bilbilfryrës”? Mungesa deri në vitet e fundit, e legjislacionit rregullator për mbrojtjen e individëve “Bilbilfryrës”, gjykoj se ndër të tjera ka sjellë këtë parashikim, sikurse ndodh që informacioni i deklasifikuar sipas nenit 19, të jetë i hapur për publikun. Tashmë, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, kjo çështje ngre edhe problemin e harmonizimit të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Një informacion nuk mund të mbahet i fshehur nga publiku përgjithmonë, ndaj është e nevojshme vendosja e afateve kohore të klasifikimit, siç përcaktohet në nenin 7, të ligjit. Sistemi i klasifikimit sipas ligjit është kompleks, pasi ai parashikon autoritetet klasifikuese, procedurat klasifikuese, korrektimin e parregullsisve në proces, procedura deklasifikuese, procedura të përdorimit dhe ruajtjes së informacionit sekret, si dhe autoritete që kujdesen në tërësi për procesin. Por gjykoj se, ligji nuk përmban asnjë dispozitë që do t’i siguronte publikut mjetin e duhur për kundërshtimin e vendimeve të autoriteteve përkatëse, nëse një informacion i caktuar duhet të jetë sekret, ose kundërshtimin e vendimeve për të mos dhënë informacion të deklasifikuar,<sup>464</sup> ose për të shqyrtuar vendime të tilla.<sup>465</sup>

Mendoj se, një pengesë kryesore me pasojë mungesën e transparencës ndaj publikut është mungesa e harmonizimit të legjislacionit për deklasifikimin e informacioneve të klasifikuara. Për pasojë deri më sot nuk ka një proces të rregullt deklasifikimi. Parashikimet

---

<sup>462</sup> Shih nenin 10, të Ligjit nr.8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar.

<sup>463</sup> Po aty, paragrafi 4, i nenit 13 dhe neni 14.

<sup>464</sup> Në këtë kontekst është i pakuptueshëm përcaktimi i bërë në paragrafin e fundit, të nenit 8, të Ligjit “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar, ku thuhet se: “Informacioni i deklasifikuar konsiderohet i zakonshëm”.

<sup>465</sup> Sipas Rekomandimit të KE, No.R (81) 19, Mbi Mundësinë për të marrë Informacione të Mbajtura nga Autoritetet Publike, refuzimi i dhënies së një informacioni duhet të motivohet dhe duhet t’i nënshtrohet rishikimit mbi bazën e një kërkesë. Edhe sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1998, mbi Mundësinë e Marrjes së Informacionit, Pjesëmarrjen e Publikut në Marrjen e Vendimeve dhe Mundësinë për t’iu drejtuar Drejtësisë për Çështjet e Ambientit, e ratifikuar nga vendi ynë, publiku ka të drejtën të marrë informacion për mjedisin dhe një mundësi e tillë mund të refuzohet për arsye të caktuara. Refuzimet ndaj kërkesave duhet të deklarohen arsyet e refuzimit (neni 4). Publiku duhet të ketë mundësinë e një procedure rishikimi përpara një gjykate, ose një organi tjetër të pavarur, të krijuar me ligj (neni 9).

e bëra në ligj për deklasifikimin kanë në dukje karakter taksativ, ndërkohë që nga analiza e legjislacionit në fuqi vlerësoj se nuk rezulton të jetë kështu.<sup>466</sup>

Për më tepër edhe aktet nënligjore<sup>467</sup> të dala në zbatim të ligjit për pjesën e deklasifikimit mendoj se kanë një përmbajtje rregullatore, të detajuar jo mjaftueshëm, për të siguruar një proces të rregullt deklasifikimi. Klasifikimi i informacionit me propozimin e shtetasve që nuk kanë autoritet klasifikimi, parashtron një rregullim që në thelb nuk ka të bëjë me klasifikimin, se sa me pranimin ligjor të mangësive eventuale të regjimit juridik të sekretit shtetëror. Sidoqoftë, mendoj se nuk mund të thuhet se, klasifikimi i një informacioni në këto kushte ruan vlerën e sekretit shtetëror, ndërkohë që ky informacion është në dijeninë, apo ka qënë më parë në posedimin e shtetasit propozues, apo ngjashëm edhe të individëve të tjerë.<sup>468</sup>

Kufizimi i informacionit vetëm mbi baza të përcaktuara dhe legjitime përkon me zbatimin e parimeve të shtetit të së drejtës, të përgjegjshmërisë dhe transparencës. Eksperienca e sektorit të sigurisë gjykoj se tregon që ka mungesë vullneti për dhënien e aksesit në informacion, duke e përdorur si mjet për arritjen e këtij qëllimi, klasifikimin e informacionit si sekret shtetëror. Megjithëse informacioni themelor nuk duhet të gjejë pengesë për t'u aksesuar nga publiku dhe media, ligji ynë mbi klasifikimin si sekret shtetëror, gjykoj se nuk i njeh shoqërisë dhe sidomos medias, të drejtën për të marrë atë, në rast se informacioni prek interesat e publikut.

Në rastin e Shqipërisë hapësirat ligjore dhe mungesa e eksperiencës në këtë fushë, e bënë këtë proces të vështirë e mjaft të diskutueshëm. Këto dukuri shpesh mbështeten në aplikimin që i bëhet ligjit “Për informacionin e klasifikuar si “Sekret shtetëror”, i cili i delegon institucioneve të sektorit të sigurisë të drejtën për të klasifikuar informacionin për publikun.<sup>469</sup>

Për më tepër në Shqipëri ndryshe nga demokracitë perëndimore, korniza ligjore nuk i jep të drejtë organeve të drejtësisë të aplikojnë testin e interesit publik për të vlerësuar nëse pretendimet e qeverisë janë të drejta në klasifikimin e një dokumenti. Procedurat dhe praktikat e klasifikimit dhe deklasifikimit të informacionit zyrtar në të gjitha nivelet e tij, janë jo transparente dhe të pazbuluara ndaj aktorëve të tjerë. Në këtë kontekst, qeverisja e sektorit të sigurisë nuk ka një përjasje uniforme për të imponuar respektimin e praktikave transparente në institucionet publike të sektorit të sigurisë.<sup>470</sup>

---

<sup>466</sup> Përcaktimi i bërë në paragrafin 3, të nenit 13, të Ligjit nr.8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar, se autoriteti i klasifikimit origjinal është njëkohësisht edhe autoritet deklasifikues, në raste të caktuara nuk qëndron dhe kjo do të analizohet në vazhdim të punimit.

<sup>467</sup> Shih VKM nr.124 datë 15.03.2001 “Për deklasifikimin e zhvlerësimit e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” që ndodhet në rrjetin kombëtar të arkivave” dhe VKM nr.81 datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për asgjësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror””.

<sup>468</sup> Shih nenin 5, të Ligjit nr.8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar.

<sup>469</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, “20 vjet reforma në sektorin e sigurisë-Harmonizimi i kuadrit kushtetues dhe ligjor të sektorit të sigurisë”, Gent Grafik, Tiranë 2012, faqe 34.

<sup>470</sup> Po aty, faqe 35-36.

## 4.5 Sistemet e video survejimit dhe aplikimi i tyre

Sistemet e video survejimit, si teknologji survejimi me video kamera stacionare, apo të lëvizëshme kanë potencial shumë të madh survejues ndaj ato zgjidhen, vendosen dhe përdoren nga autoritetet publike, apo subjekte private për parandalimin dhe investigimin e krimit, apo ruajtjen e sferës private. Sistemi përbëhet nga një numer video-kamerash të lidhura në një rrjet të mbyllur televiziv, ku imazhet e përfutuara nga përdorimi i tij, dërgohen, regjistrohen dhe ruhen në një monitor qëndror televiziv të vëzhguar nga operatorë të caktuar. Të njohura ndryshe si kamera të survejimit, këto video kamera përdoren për qëllime të mbikqyrjes së një zone të caktuar.

Është e qartë tashmë se shteti nuk është i vetmi agjent i mbikqyrjes dhe se, jo e gjithë mbikqyrja shtetërore motivohet nga shqetësimet që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare.<sup>471</sup> Sistemet e para të video survejimit u instaluan në fillim të viteve 70' për të asistuar në rregullimin e trafikut rrugor dhe parandaluar grabitësit e bankave. Sot, kamerat e instaluar në këto sisteme po bëhen gjithnjë e më të fuqishme. Disa kanë një pamje vizibiliteti 360 gradë, disa janë të pajisura me lente përqëndruese, të cilat mund të lexojnë të dhëna si, numrat e targave të makinës deri në 300 m largësi. Ka edhe kamera “inteligjente”, të cilat janë të pajisura me sensorë që aktivizojnë sisteme alarmi në rast të ndodhjes së incidenteve.<sup>472</sup> Me zhvillimin teknologjik, kostoja e posedimit të këtyre sistemeve është bërë gjithnjë e më e lirë, gjë që i ka dhënë mundësi çdo subjekti, të posedojë e përdorë sisteme të tilla, për qëllime sigurie.

Video survejimi i vendeve publike dhe atyre private, mund të rezultojë në kufizime të së drejtës për privatësi, të së drejtës për lëvizje të lirë dhe së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.<sup>473</sup> Privatësia si e drejtë themelore e njeriut është afirmuar fuqishëm në kohët moderne dhe ndoshta është më e vështira për t'u përkufizuar. Privatësia është një koncept i rëndësishëm, por edhe iluziv i dhënë në ligj.<sup>474</sup> Ajo lidhet ngushtë dhe influencohet nga konceptet e autonomisë individuale, dinjitetit, individualitetit dhe integritetit.<sup>475</sup>

Nga ana tjetër, e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është një koncept më i ngushtë dhe komponent përbërës, i cili krijon një nënndarje të principit të përgjithshëm të privatësisë personale. Kjo e drejtë mbrohet nga instrumente ndërkombëtare<sup>476</sup> dhe specifikisht në nivel konstitucional, në pothuajse gjithë vendet anëtare të KE. Sfera private përfshin të drejtën për të vendosur dhe zhvilluar marrëdhënie me qenie të tjera njerëzore,

---

<sup>471</sup> Whitaker R., (1999): “The End of Privacy: How Total Surveillance is Becoming a Reality”, The New Press, viti 1999, faqe 29.

<sup>472</sup> Vitalis A., “Big brother is watching you on video”, Le monde Diplomatique- English Edition 1998. Website: [mondediplo.com/1998/03/11video?var\\_s=surveillance](http://mondediplo.com/1998/03/11video?var_s=surveillance)

<sup>473</sup> Venice Commission, “Opinion on Video Surveillance in Public Places by Public Authorities and the Protection of Human Rights”, Study no.404/2006, Strasbourg 23 March 2007, page 11.

<sup>474</sup> Stratford J. S., (2002): “Data protection and privacy in the United States and Europe”, IASSIST Quarterly, viti 2002, faqe 17.

<sup>475</sup> Bygrave L. A., (2002): “Data protection Law: Approaching its Rationale. Logic and Limits”, Kluwer Law Intl., viti 2002, faqe 23.

<sup>476</sup> Shih nenin 17, të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 18, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

veçanërisht në fushën emocionale për zhvillimin e formimit e personalitetit të individit.<sup>477</sup> Jeta private përfshin gjithashtu integritetin moral dhe fizik të një personi, lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.<sup>478</sup>

Survejimi si aktivitet nxjerr një sërë çështjesh që lidhen me privatësinë. Kështu, kur një individ hyn në një hapësirë publike apo qëndron atje, ai është i ndërgjegjshëm se, së paku do të shihet nga të tjerët, madje se do të njihet dhe se sjellja e tij do të vëzhgohet nga të tjerët. Kjo gjë bën që ai të reagojë ndaj kësaj gjendjeje dhe të përshtasë sjelljen e tij në mënyrë të ndërsjelltë. Një fenomen i tillë, i hasur rëndom në jetën e përditëshme njihet si vëzhgimi njerëzor. Por çështja bëhet më komplekse në rastin e përdorimit të sistemeve video survejuese.

Në këtë kontekst, GJEDNJ vlerëson se: “Ekzistojnë një numër elementësh përkatës për të vlerësuar nëse jeta private e një personi ndikohet nga masat e marra jashtë banesës së tij, apo lokaliteteve private. Meqënëse ekzistojnë rrethana kur njerëzit me dijeninë e tyre, apo qëllimisht përfshijnë veten në aktivitete që mund të regjistrohen, apo raportohen në një mënyrë publike, pritshmëritë e arsyeshme të një personi për privatësinë mund të jenë një faktor sinjifikativ, megjithëse jo domosdoshmërisht përfundimtar. Një person që ecën përgjatë rrugës, në mënyrë të paevitueshme do të jetë vizibël për çdo anëtar të publikut, i cili është prezent në këtë zonë publike. Monitorimi, në kuptimin teknologjik, i së njëjtës shfaqje publike të personit ka një karakter të ngjashëm. Megjithatë, vlerësimi i privatësisë mund të vijë në plan të parë, menjëherë sapo ndonjë regjistrim i përhershëm, apo sistematik realizohet si një material i tillë nga një sferë publike”.<sup>479</sup>

Në përgjithësi nuk është monitorimi si i tillë, që shfaqet si më problematik, por regjistrimi i të dhënave dhe përpunimi i tyre, i cili mund të krijojë një ndërhyrje të paligjshme ndaj së drejtës për privatësi, veçanërisht në rast se e dhëna është marrë përmes metodave të fshehta të survejimit.<sup>480</sup> Kur të dhënat e mbledhura përdoren për qëllime të tjera nga ai fillestari, apo thënë ndryshe, qëllime të mbrapshta, lindin probleme specifike.<sup>481</sup> E drejta për privatësi

---

<sup>477</sup> Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut, Çështja X kundër Islandës, 18 Maj 1976. Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut, Çështja Klass dhe të Tjerëve kundër Gjermanisë, 6 Shtator 1978. Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut, Çështja Leander kundër Suedisë, 26 Mars 1987. Çështja P.G dhe J.H kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 Shtator 2001.

<sup>478</sup> Kjo kategori lirisht të individit përcaktohet, qoftë sipas nenit 18, të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, ashtu edhe duke u mbështetur në nenin 9, të KEDNJ.

<sup>479</sup> Çështja P.G and J.H kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 Shtator 2001.

<sup>480</sup> Çështja Amann kundër Zvicrës, 16 Shkurt 2000.

<sup>481</sup> Çështja Peck kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 Janar 2003. Çështja Peck: Një burrë që vuante nga depresioni po ecte i vetëm në rrugë, me një thikë gatimi në dorë dhe tentoi vetëvrasjen. Ai nuk kishte dijeni se ishte filmuar nga një rrjet i mbyllur televiziv i instaluar nga autoritetet lokale. Operatori i kamerës lajmëroi policinë, e cila arriti në vendngjarje, ku mori thikën dhe ndaloi personin, por duke dyshuar për gjendje të paqëndrueshme mendore faktikisht e liruan atë më pas. Pas kësaj, u publikuan fotografi të marra nga filmimet e rrjetit të mbyllur televiziv duke bërë një publicitet mbështetës për përdorimin e survejimit përmes kamerave me rrjet të mbyllur televiziv nga ana e policisë. Për këtë arsye, materiali i siguruar u përdor në disa media, me pak, apo aspak përpjekje për të fshehur fytyrën e personit. GJEDNJ, konstatoi se, gjatë shfaqjes së filmimeve të rrjetit të mbyllur televiziv, veprimet e individit ishin parë në një masë, e cila kishte tejkaluar së tepërmi çdo ekspozim nga një transmetues, apo observim sigurie dhe në një shkallë të tejkajshme, nga ç’ mund të kishte parashikuar individi. Bërja publike e filmimit përkatës përbënte ndërhyrje serioze në privatësinë e individit.



mbron një qenie njerëzore në të gjitha rrethanat dhe ka të bëjë me dinjitetin e individit në të gjithë vendet, ndaj video survejimi shkakton probleme serioze nëse i shërben një qëllimi, i cili mund të jetë çënues ndaj privatësisë.

Video survejimi në vendet publike çënon gjithashtu, të drejtën për lëvizje të lirë të individëve legalë, në territorin e një shteti.<sup>482</sup> Kjo e drejtë nuk ka të bëjë vetëm me të drejtën për të lëvizur lirisht në një hapësirë fizike, por gjithashtu edhe me të drejtën për të lëvizur pa qënë i gjurmuar vazhdimisht.<sup>483</sup> Në një nivel tjetër këndvështrimi, video survejimi si pjesë e sistemit kompleks të mbikqyrjes së veprimtarisë njerëzore ngre problemin e ndërthurjes së çështjes me konceptin e sigurisë njerëzore dhe veçanërisht, me përpjekjen e vendeve në zhvillim për të vënë në plan të parë çështjet e sigurisë, para atyre që kanë të bëjnë me mirëqenien, apo realizimin e të drejtave të njeriut.

Për shkak të qëllimit parësor, aktiviteti i video survejimit gëzon një shkallë të lartë legjitimiteti, pasi siguria është një e drejtë themelore e njeriut. Në këto kushte është e nevojshme që aktiviteti i video survejimit të kryhet konform kërkesave të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, duke treguar se është “i ligjshëm” dhe “jo arbitrar”, si dhe duke u justifikuar specifikisht sipas kushteve të dhëna në nenin 8.2, të KEDNJ.<sup>484</sup> Në përputhje me këto kërkesa;

*-Kufizimet e të drejtave duhet të parashikohen me ligj.* GJEDNJ ka vendosur se, neni 8.2, i KEDNJ nuk kërkon si bazë ligjore një akt të nxjerrë nga legjislatori në kuptimin formal. Dekretet qeveritare dhe rregulloret ndërkombëtare mund të përbëjnë gjithashtu, një bazë të mjaftueshme<sup>485</sup>, siç edhe ligjet e pashkruara, të njohura si të tillë në sistemin “common law”.<sup>486</sup>

*- Kufizimet duhet të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike.* Ndërhyrja duhet të korrespondojë me “një nevojë të ngutshme sociale” dhe duhet të jetë “proporcionale me qëllimin e ligjshëm të ndjekur”.<sup>487</sup> Kjo nënkupton kërkesën që, arsyet e nxjerra nga autoritetet për justifikimin e ndërhyrjes, duhet të jenë “relevante dhe të mjaftueshme”.<sup>488</sup>

*-Kufizimet duhet të jenë të justifikuar, për parandalimin e trazirave apo krimit, për interesa të sigurisë kombëtare.*<sup>489</sup>

<sup>482</sup> E drejta për lëvizje të lirë, parashikohet në nenin 2, të Protokollit shtesë nr.4, të KEDNJ.

<sup>483</sup> Masa e cila kërkon që një person të mbajë një rrip elektronik si një alternativë për ndalimin e tij është vlerësuar si, një kufizim i lirisë personale të tij.

<sup>484</sup> Në nenin 8.2 të KEDNJ, thuhet se: “Nuk duhet të ketë ndërhyrje nga një autoritet publik në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në rastet kur kjo e fundit është në përputhje me ligjin dhe është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike apo mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e trazirave apo krimit, për mbrojtjen e shëndetit dhe moralit, apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.

<sup>485</sup> Çështja De Wilde, Ooms dhe Versyp kundër Belgjikës, 18 Qershor 1971.

<sup>486</sup> Çështja Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar, 26 Prill 1979.

<sup>487</sup> Çështja Landvreugd kundër Hollandës, 4 Qershor 2002.

<sup>488</sup> Çështja Olsson kundër Suedisë, 24 Mars 1988.

<sup>489</sup> Çështja Leander kundër Suedisë, 26 Mars 1987. GJEDNJ në këtë gjykim mbajti qëndrimin se: “Nuk ka dyshim për nevojshmërinë, për qëllime të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, që shtetet kontraktuese të kenë ligje, të cilat i japin autoriteteve kompetente vendore fuqinë, së pari, për të mbledhur dhe ruajtur në regjistra

*-Proporcionaliteti.* Duhet të konsiderohet fakti nëse masat më pak ndërhyrëse në privatësi, janë të vlefshme dhe mjaftueshëm efektive, për t'i shërbyer të njëjtit qëllim. Detyra parësore e shtetit dhe autoriteteve publike sipas nenit 8, të KEDNJ është që të shmangë ndërhyrjet në të drejtën e individit për të respektuar jetën e tij private. Sidoqoftë, shteti duhet të ndërmarrë hapa pozitive për të siguruar, apo mbrojtur gëzimin e të drejtave sipas nenit 8.1 të kësaj Konvente, duke parandaluar gjithashtu të tjerët nga bërja e së njëjtës gjë.<sup>490</sup>

Për të arritur një balancë midis interesit publik dhe atij privat të përfshirë në survejim dhe që të mbrohet privatësia, shteti duhet të aplikojë një test proporcionaliteti, përmes legjislacionit dhe praktikës së duhur administrative, si dhe nëpërmjet kontrollit administrativ dhe gjyqësor. Ky test kërkon që, legjislacioni kombëtar të përkufizojë qartë bazën ligjore të survejimit dhe nevojshmërinë e kufizimit të të drejtave përkatëse, duke patur parasysh interesat e mbrojtura dhe duke mos mundur në asnjë mënyrë të dobësojë nivelin e mbrojtjes së të drejtave, të parashikuar nga KEDNJ. Kuptohet që justifikimi i ndërhyrjes duhet të shqyrtohet mbi bazën e kriterëve të nenit 8.2, të KEDNJ. Në raste të tjera, testi do të jetë nevojshmëria sipas kërkesave të nenit 1.2, të Protokollit no.1, të po kësaj Konvente.<sup>491</sup>

Vende të ndryshme anëtare të KE kanë miratuar tashmë rregullore specifike, apo parashikime ligjore për video survejimin dhe mbikqyrjen e tij.<sup>492</sup> Disa vende si, Holanda dhe Franca kanë miratuar rregullime ligjore specifike me parakushte strikte,<sup>493</sup> për instalimin e sistemeve të video survejimit në vendet publike.

---

jo të arritshëm nga publiku, informacion mbi personat, dhe së dyti, për të përdorur këtë informacion kur vlerësohet përshtatshmëria e kandidatëve për punësim në postet që kanë rëndësi për sigurinë kombëtare. Duke patur parasysh rezervën e gjerë të vlerësimit të vlefshëm për të, shtetit përgjegjës i është dhënë e drejta për të konsideruar që, në çështjen prezente interesi i sigurisë kombëtare prevalon mbi interesat individuale të aplikantit”.

<sup>490</sup> Venice Commission, “Opinion on Video Surveillance by Private Operators in Public and Private Spheres and by Public Authorities in the Private Sphere and Human Rights Protection”, Study no.430/2007, Strasbourg 8 June 2007, page 6.

<sup>491</sup> Neni 1.2, i Protokollit no.1, të KEDNJ, përcakton se:

“Çdo person fizik apo juridik ka të drejtën e gëzimit të qetë të pasurisë së tij. Askush nuk do të privohet nga pasuria e tij përveçse për interesin publik dhe duke qënë subjekt i kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Parashikimet paraprake, sidoqoftë, nuk do të pengojnë në asnjë mënyrë të drejtën e shtetit për të zbatuar ligje të tilla, nëse e sheh të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm, apo për të siguruar pagimin e taksave, apo kontributeve të tjera, apo dënimeve-gjobave”. Pra, për t'i mundësuar autoriteteve që të instalojnë dhe të operojnë me video kamerat për të realizuar survejimin e nevojshëm, duhet të veprohet mbi bazën e një ligji dhe më pas të procedohet mbi bazat e një konsultimi dhe bashkëpunimi të mirë me palët private përgjegjëse, kur kemi të bëjmë me pronësinë private.

<sup>492</sup> Venice Commission, “Opinion on Video Surveillance by Private Operators in Public and Private Spheres and by Public Authorities in the Private Sphere and Human Rights Protection”, Study no.430/2007, Strasbourg 8 June 2007, page 12. Vende të tilla janë; Danimarka, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Spanja, Suedia.

<sup>493</sup> Ligji No. 95-73, 28.01.1995, akti nënligjor No. 96-926, Francë. Parakushtet janë: duhet të ketë një kërkesë sigurie me qëllim që të vendoset një sistem video survejimi në një zonë publike. Sipas ligjit, qëllimet e sigurisë duhet të jenë shumë të qarta dhe të sakta. Instalimi i pajisjeve të tilla i nënshtrohet aprovimit nga ana e Prefektit, pas vendimeve pozitive nga një komision në rang departamenti të kryesuar nga një magjistrat. Duke mbajtur parasysh respektimin e privacisë, pajisjet e videos duhet të vendosen në një mënyrë të tillë që, të mos lejojnë ndonjë pamje në brendësi, apo hyrje të banesave. Përveçse në kontekst të procedimeve penale,

Shkalla e gjerë e përdorimit të video survejimit nga subjekte të ndryshme, shtetërore ose jo, specifikisht në rastin e ushtrimit si veprimtari nga ana e shtetit gjykoj se nxjerr nevojën e kuptimit të faktit se, jo gjithmonë jemi në kushtet ideale kur shteti vepron si garantues i sigurisë njerëzore. Roli qëndror i shtetit për të dhënë siguri në kuptim të realizimit efektiv të sigurisë njerëzore, do të thotë se, “objekti parësor i sigurisë njerëzore nuk është rritja e sigurisë shtetërore në vetvete, por dhënia e sigurisë që njerëzit nuk vuajnë nga ato versione të sigurisë shtetërore, të cilat injorojnë dhunën e brendshme dhe shkaqet e saj”.<sup>494</sup>

Për këtë arsye, qëllimi i përdorimit të sistemeve video survejuese dhe aplikimi i tyre, mendoj se ka të nevojshme një bazë normative rregullatore, balancuese ndërmjet interesave të prezumuara shtetërore të sigurisë dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke paraparë dhe parandaluar shkaqet që prodhojnë pasiguritë njerëzore në praktikë. Por si është rregulluar në vendin tonë çështja e përdorimit të sistemeve të video survejimit?

E drejta për privatësi, e afirmuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë përfshin garancinë që i jepet individit për të mos u vetinkriminuar,<sup>495</sup> të drejtën e individit për të bërë publike të dhënat e tij personale kur ai dëshiron, si dhe mbrojtjen e këtyre të dhënave,<sup>496</sup> të drejtën për mbrojtjen e fshehtësisë së banesës nga ndërhyrjet jovullnetare dhe të paautorizuara të policisë,<sup>497</sup> si dhe fshehtësinë e korrespondencës.<sup>498</sup> Ndërkohë, kufizime të të drejtave themelore të njeriut, mund të vendosen vetëm në përputhje me përcaktimet e bëra në Kushtetutë.

Legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë ka parashikuar disa shkaqe që përlligjin kufizimin e së drejtës për privatësi, përfshirë këtu si shkak edhe përdorimin e sistemeve të video survejimit. Konkretisht, KPrP parashikon përgjimin e bisedimeve, komunikimeve telefonike dhe formave të tjera të telekomunikacionit, përgjime me audio dhe video, në rastet kur procedohet për hetimin e disa veprave penale, vetëm nëpërmjet procedurave të përcaktuara në ligj.<sup>499</sup>

Në një retrospektivë të bazës ligjore rregullatore, konstatohet se Ligji nr.9749 datë 4.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, parashikonte marrjen e masave të veçanta nga strukturat e Policisë së Shtetit, me miratimin e prokurorit përkatës, për hetimin dhe parandalimin e veprimtarive kriminale, ku përfshihet edhe përgjimi nëpërmjet regjistrimit audio dhe video, në përputhje me legjislacionin përkatës.<sup>500</sup> Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.108/2014 “Për

---

regjistrimet mund të ruhen për një maksimum kohor prej një muaji. Publiku duhet të jetë i informuar qartësisht dhe në mënyrë të përherëshme për prezencën e pajisjeve të video survejimit dhe të autoritetit, apo personit ligjërisht përgjegjës për përdorimin e këtyre pajisjeve.

<sup>494</sup> Kerr P., (2007): “Human Security”, përfshirë në A.Collins “Contemporary Security Studies”. Oxford & New York: Oxford University Press, viti 2007, faqe 101.

<sup>495</sup> Shih nenin 32/1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>496</sup> Po aty, neni 35.

<sup>497</sup> Po aty, neni 36.

<sup>498</sup> Po aty, neni 37.

<sup>499</sup> Shih nenet 221-226, të Ligjit nr.7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>500</sup> Shih nenin 116, të Ligjit nr.9749 datë 4.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Për më tepër, në nenin 123, të këtij ligji, gjejmë rregullime shumë specifike dhe të sakta, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale

Policinë e shtetit”, i cili shfuqizoi ligjin e sipërcituar, parashikohet mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale nga policia për ndalimin e një rreziku real ndaj rendit dhe sigurisë publike, si dhe për parandalimin, zbulimin, ndjekjen dhe hetimin e veprave penale. Mbledhja e këtyre të dhënave, ndër metoda të tjera të parashikuara nga ligji përfshin edhe regjistrimin me kamera në ambiente publike, në përputhje me KPrP.<sup>501</sup> Ndërkohë në nenin 131, të po këtij ligji, parashikohet marrja e masave të veçanta me qëllim parandalues për kryerjen e një krimi, ku përfshihet si masë, edhe përdorimi i pajisjeve teknike për fotografim, regjistrim audio ose video, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Edhe në Manualin “Për rregullat e trajtimit dhe sigurimin e të ndaluarve dhe arrestuarve në njësitë policore”, përcaktohet se: “Në ambientin e parashikuar janë të vendosura e instaluar pajisjet e mëposhtme: e) pajisje audiovizive (kamera) për survejimin dhe mbajtjen në kontroll të personit të arrestuar/ndaluar”.<sup>502</sup> Një tjetër akt normues në këtë fushë është Udhëzimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nr.3 datë 5.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, i ndryshuar.<sup>503</sup>

Udhëzimi ka përcaktuar rregulla në zbatim të të cilave, përpunimi i të dhënave personale që regjistrohen dhe ruhen nga sistemi i kamerave regjistruese të video survejimit, bëhet i ligjshëm.<sup>504</sup> Ndërkohë, në pikën 5 të tij, veç të tjerash përcaktohen disa rregulla për vendosjen e sistemit të video survejimit në sferën publike dhe private, duke njehsuar kështu dy akte të ndryshme e konkretisht, aktin e “përpunimit të të dhënave” plotësisht ose jo me mjete automatike dhe aktin e instalimit për përdorim të rrjeteve të mbyllura televizive, ky i dyti, potencialisht cënues ndaj disa të drejtave themelore të njeriut.<sup>505</sup>

Në këto kushte, ky akt normativ nënligjor, gjykoj se veç mbrojtjes së të dhënave personale, ka marrë përsipër për aq sa parashikonte, legjitimitimin e kufizimit të disa të drejtave të tjera individuale. Instalimi apo vendosja e rrjeteve të mbyllura televizive, potencialisht kufizuese të të drejtave të sipërcituara të njeriut, në rastin e Udhëzimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nr.3 datë 5.03.2010, justifikohet me një akt nënligjor, në kundërshtim me parashikimet e nenit 17, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke

---

nga ana e Policisë së Shtetit gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj, kur këto të fundit janë të nevojshme për parandalimin e rrezikut real, ose parandalimin e një vepre penale.

<sup>501</sup> Shih pikat 1 dhe 2, të nenit 124, të Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e shtetit”.

<sup>502</sup> Shih Manualin “Për rregullat e trajtimit dhe sigurimin e të ndaluarve dhe arrestuarve në njësitë policore”, miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.64 datë 25.01.2010, në pikën 1/e, të pjesës IV, të Kreut V, “Për normat e parametrat e ndërtimit dhe të funksionimit të dhomave të sigurisë”.

<sup>503</sup> Udhëzimi është nxjerrë mbi bazën e kompetencës që KDIMDP, i jepet në gjermën “c”, të pikës 1, të nenit 30 dhe të gjermave “ç” dhe “f”, të pikës 1, të nenit 31, të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Objekti i Ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, sikurse përcaktohet në nenin 1, të tij është: “...përcaktimi i rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale”. Udhëzimi nr.3 datë 5.03.2010, ka ndryshuar me Udhëzimin nr.13 datë 22.12.2011, ku në bazë të pikës 1, ka ndryshuar edhe titulli i tij duke u emërtuar; “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.

<sup>504</sup> Në gjermën “a”, pika 4, të Udhëzimit, thuhet se: “Sistemi i video survejimit nuk duhet të ndërhyjë në jetën private të individëve”.

<sup>505</sup> Megjithëse pas ndryshimeve me nxjerrjen e Udhëzimit nr.13 datë 22.12.2011, kjo pjesë është saktësuar disi, përsëri ka parashikime që përcaktojnë rregulla për vendosjen e kamerave të video survejimit.

evidentuar në këtë mënyrë edhe një tejkalim të juridiksionit dhe kompetencave të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me nxjerrjen e këtij akti.

Kjo situatë juridike fragmentare, për vendosjen dhe aplikimin e sistemeve të video survejimit, në një ambient publik, apo privat, sipas legjislacionit të analizuar më sipër, nuk mbulonte gjithë subjektet e mundshme që mund të shfrytëzonin sistemet video survejuese, duke identifikuar kështu rregullime ligjore të shpërndara, të paqarta dhe të mangëta, në këtë fushë. Situata e ekzistencës së një legjislacioni rregullator që nuk përmbante rregullime thelbësore ligjore, në përputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë, nxirrte nevojshmërinë e plotësimit dhe përmirësimit të tij dhe kjo situatë ka ekzistuar deri në kohën e hyrjes në fuqi, të Ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Ligji nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, i miratuar dhe hyrë në fuqi, në fund të vitit 2016, përbën një bazë të mirë rregullatore në këtë këndvështrim. Ai detyron subjektet private që të marrin masa shtesë sigurie, pas vlerësimit të analizës së rrezikut të bërë nga ana e Policisë së Shtetit, detyrim ky i vendosur edhe për subjektet publike, përfshirë këtu edhe parashikimin e detyrimit për marrjen e masave shtesë, në ambientet e përbashkëta të banimit.<sup>506</sup>

Në përcaktimin e terminologjisë “masa shtesë”, ligji parashikon se një prej tyre është, “përdorimi i sistemit të kamerave CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe, që ruajnë imazhet filmike në NRV/Server, deri në 2 muaj”.<sup>507</sup> Veç faktit se në nenin 12 të tij, ligji parashikon vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të kamerave të sigurisë nga subjekte të regjistruara në Regjistrin Kombëtar Tregtar dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit, duke e formalizuar dhe identifikuar ekzistencën e tyre sipas subjektit posedues dhe përdorues, ligji parashikon edhe detyrimin që këto subjekte kanë për njoftimin e KDIMDhP dhe bërjen transparent ndaj tij të procesit, në rast instalimi të sistemit të kamerave.

Parashikimi i subjekteve private, në rrethin e subjekteve që i nënshtrohen dispozitave të Ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, është kundërshtuar megjithatë nga këta të fundit dhe kjo gjë është konkretizuar me një kërkesë që, Shoqata për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe Tregut, i ka drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me objekt, shfuqizimin si antikushtetues të këtij ligji. Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj lidhur me këtë kërkesë, ndër të tjera ka vlerësuar shprehimisht se; “...në rastin konkret ballafaqohen interesat e tregtarëve për të ushtruar lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe, e parë si pjesë e kësaj lirie, për të gëzuar qetësisht pronën e tyre, nga njëra anë, me interesat e shtetit për miratimin e një sërë normash rregulluese për marrjen e masave konkrete, si vendosje të sistemit të videove, me qëllim ruajtjen e sigurisë publike. Për të vlerësuar nëse në këtë rast kushti i baraspeshës është respektuar apo është përmbysur, pra nëse anëtarët e shoqatës për mbrojtjen e tregtarëve dhe të tregut janë ngarkuar me një barrë apo peshë individuale tej masës ose shkallës së duhur, sado i rëndësishëm të jetë interesi publik ose i komunitetit në përgjithësi, në jurisprudencën e saj gjykata ka çmuar të nevojshme të vlerësojë nëse strategjia e ndërhyrjes së ligjvënësit respekton kriteret e mëposhtme: (i) nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së

<sup>506</sup> Shih nenet 4, 5 dhe 6, të Ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

<sup>507</sup> Po aty, pika 1/a, e nenit 8.

drejtës; (ii) nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin-ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar- sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme".<sup>508</sup> Duke gjykuar mbi bazën e të gjithë këtyre kriterëve standardizuese, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, ka vendosur me Vendimin nr.60 datë 31.07.2017, rrëzimin e kërkesës.

Baza rregullatore për këtë çështje është plotësuar me Udhëzimin nr.46 datë 28.03.2017, të KDIMDhP, "Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të Ligjit nr.19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike". Duke u fokusuar tek ruajtja dhe mirëadministrimi i të dhënave personale, Udhëzimi përcakton në këtë aspekt edhe disa detyrime të subjekteve publike apo private që lidhen me instalimin dhe vënien në funksionim të sistemeve të video survejimit, si dhe për detyrimin e publikimit të "politikës së vëzhgimit me kamera", në faqen zyrtare të subjektit publik, ose privat.<sup>509</sup>

Faza aktuale e zbatimit të Ligjit nr.19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike", e rendit atë tek ligjet ende në "bankoprovë", pasi mbetet për t'u vlerësuar efektshmëria dhe lehtësia e zbatimit të dispozitave të tij. Tashmë qëndron vlerësimi se është krijuar dhe ka hyrë në fuqi baza ligjore që rregullon specifikisht instalimin dhe funksionimin e sistemeve të video-survejimit.

#### **4.6 Aksesi i publikut dhe medias në seancat e proceseve gjyqësore**

Publiku dhe media gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në të gjitha seancat gjyqësore, për të cilat ato si subjekte janë të interesuara, me përjashtim të disa rasteve kur publiciteti i seancave është i kufizuar. KEDNJ, në nenin 6 kërkon që, seancat gjyqësore të zhvillohen publikisht dhe të jenë të hapura. Prania në sallën e gjyqit mund t'i ndalohe shtypit, ose publikut gjatë gjithë procesit ose një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik, ose të sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces e kërkon këtë gjë, ose në masën e quajtur absolutisht të domosdoshme nga gjykata kur, në rrethana të veçanta, publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka plotësuar këto kërkesa në paragrafin e dytë, të nenit 42 dhe në nenin 146. Po kështu nenet 26 dhe 173, të KPrC, pasqyrojnë këto kërkesa. Kjo është një e drejtë që specifikisht, mundëson informimin e publikut dhe të medias, me elementë të çështjeve të caktuara me interes për to, ndërkohë që shërben edhe si një presion pozitiv dhe formë kontrolli mbi veprimtarinë e gjykatave.<sup>510</sup>

<sup>508</sup> Shih pikën 18, të Vendimit nr.60 datë 31.07.2017, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

<sup>509</sup> Shih nenin 6 dhe nenin 8, të Udhëzimit nr.46 datë 28.03.2017, të KDIMDhP "Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të Ligjit nr.19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike".

<sup>510</sup> Shih pikën 1, të nenit 339 dhe pikën 1, të nenit 340, të KPrP.

Rastet e kufizimit të këtij aksesi, lidhen kryesisht me të dhënat individuale të palëve në proces që nëse bëhen publike gjatë gjyqimit shkaktojnë dëm; dëmit që mund t'i shkaktohet moralit shoqëror, apo ruajtjes së sekretit shtetëror, si p.sh në çështjet penale ku gjykohen krime ku përfshihen në procedura hetimore të mitur; disa çështje të së drejtës familjare, apo paqëndrueshmëria mendore e subjektit që kërkon të jetë prezent gjatë zhvillimit të seancës etj.<sup>511</sup> Kur në një gjykim, publiciteti mund të shkaktojë përhapjen e të dhënave sekret shtetëror i takon gjykatës të vendosë, nëse publiku do të ketë akses në seancën përkatëse gjyqësore apo jo, gjë që tregon se në parim, në proceset gjyqësore penale nuk ka akses të kufizuar të publikut, sikurse i njëjti parim funksionin edhe në seancat gjyqësore civile.<sup>512</sup>

Megjithatë, ndalimi më taksativ që parashikohet për publikimin në shtyp të akteve sekrete, gjendet në përcaktimet e bëra në KPrP.<sup>513</sup> Për më tepër ndalimi i publikimit, qoftë i plotë, apo i pjesshëm i akteve sekrete, gjatë hetimeve paraprake ndalohet edhe për aktet josekrete. Ndalimi i publikimit të plotë, apo të pjesshëm përfshin edhe aktet e shqyrtimit gjyqësor, kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura.<sup>514</sup> Kjo do të thotë se, gjykata nuk ka detyrimin të informojë publikun kur ka një kërkesë, mbi çdo çështje që gjykohet në gjykatë.

Nga ana tjetër, për ruajtjen e së drejtës të privatësisë së palës, apo mbrojtësit të saj dhe të efektivitetit të hetimit, dosjet gjyqësore nuk bëhen publike. Sipas përcaktimeve të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, gjykatat si institucione shtetërore nuk përfshiheshin në kuptimin e subjektit “Autoritet shtetëror”, me detyrimin për të dhënë informacion mbi dokumentacionin zyrtar që mbahej prej tyre. Kjo situatë ka ndryshuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, që përfshin organet gjyqësore në termin “Autoritet publik”.

Marrëdhëniet me median dhe informimi i shtypit mbi çështje në interes të publikut, janë përgjegjësi dhe oportunitet njëkohësisht i vetë gjykatave, apo prokurorëve që trajtojnë dhe

---

<sup>511</sup> Në nenin 173, të KPrC dhe nenin 340, të KPrP, thuhet përkatësisht se:

“Nuk lejohet qëndrimi në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura i të miturve nën 16 vjeç, përveç kur ata thirren nga Gjykata. Gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e organeve të medias dhe publikut gjatë një pjese, ose gjatë gjithë zhvillimit të procesit gjyqësor; në interes të moralit; të rendit publik; të ruajtjes së informacionit të klasifikuar ose sigurisë kombëtare; kur e kërkojnë interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve dhe pjesëmarrësve në gjyq; kur përmenden sekrete tregtare ose shpikje industriale, nga publikimi i të cilave mund të cenohen interesa që mbrohen me ligj; në masën e çmuar nga gjykata në rrethana të veçanta, publikimi mund të paragjykojë interesat e drejtësisë”; “Gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor, ose disa veprime të tij të zhvillohen me dyer të mbyllura:

Kur publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror, ose mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të shtetit, në qoftë se një gjë e tillë kërkohet nga organi kompetent; kur nga ana e publikut ka shfaqje që prishin zhvillimin e rregullt të seancës; kur është e nevojshme të mbrohet siguria e dëshmitarëve ose e të pandehurve; kur gjykohet e nevojshme për pyetjen e të miturve.”

<sup>512</sup> Konstatimi i referohet karakterit publik të procesit gjyqësor, të sanksionuar në dispozitat përkatëse të KPrP dhe KPrC.

<sup>513</sup> Shih nenin 103, të KPrP.

<sup>514</sup> Vazhdimi i përcaktimit të pikës 3, të nenit 103, të KPrP, nënkupton se kufizimi në këtë rast i referohet informacioneve të klasifikuara, pasi aksesi në to mundësohet kur, “...ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e përcaktuara me ligj për arkivat e shtetit, ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që, vendimi ka marrë formën e prerë por me kusht që, publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.

zhvillojnë ato. Si element i transparencës së veprimtarisë, promovimit të drejtësisë dhe informimit të publikut, vendimet gjyqësore bëhen publike on-line, megjithëse në to fshihen të dhëna të caktuara personale të palëve të përfshira.

Por mund të gjendemi para faktit që, vendimi mbahet i fshehtë ndaj palëve të treta, kur në gjykim është përpunuar, apo përdorur informacion, që ka të bëjë me sekretin shtetëror. Legjislacioni ynë avancon në këtë drejtim deri edhe tek urdhërimi i publikimit të një vendimi gjyqësor, në media. Kështu, në KPrC përcaktohet se, kur çmohet se publikimi i vendimit përfundimtar i shërben rehabilitimit dhe/ose zhdëmtimit, gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, urdhëron publikimin e vendimit në media.<sup>515</sup>

#### **4.7 Aksesi në informacion në çështjet penale**

Realizimi i këtij lloji aksesi përfshin disa subjekte, të cilat kanë të drejtën të njihen me materiale, prova dhe fakte që mblidhen, trajtohen dhe analizohen gjatë procedimit penal<sup>516</sup> dhe shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale në gjykatë.<sup>517</sup> Megjithatë, sipas KPrP, lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit.

Për çdo akuzë penale dhe për çdo ndalim, personi i akuzuar, apo i ndaluar ka të drejtën e aksesit në provat që janë sjellë në gjykatë kundër tij, gjë që në fakt do të thotë akses në dosjet e gjykatës. Për këtë arsye, gjatë hetimeve të zhvilluara para se çështja të dërgohet në gjykatë, kur personi ndiqet penalisht në gjendje të lirë dhe pas lirimit nga një akuzë, për arsye sigurie, apo për të mbrojtur efektivitetin e hetimeve të mëtejshme, aksesi i të akuzuarit në dosje mund të kufizohet.<sup>518</sup> Por duhet theksuar se, kufizimi i aksesit të të pandehurit në provat e gjykatës kur kemi të bëjmë me informacionin e klasifikuar, nënkupton natyrshëm faktin se, ai nuk ka akses as në dokumentet, apo informacionet e këtij lloji, të pa dorëzuara nga ana e prokurorit, apo organit përkatës shtetëror, në gjykatë.<sup>519</sup>

Ndërkohë, sipas parashikimit të bërë në nenin 6, të KEDNJ, fshehja e informacionit, si ndaj gjykatës dhe ndaj të pandehurit, nga ana e organeve shtetërore është përgjithësisht e ndaluar. Pamundësia e aksesit në këtë rast, dëmton të drejtën e aksesit të individit në drejtësi, veçanërisht në çështjet ku kemi elementë të sigurisë shtetërore, duke parashtuar kështu problematikën e ndershmërisë së gjykimit dhe barazisë së armëve, në dëm të të akuzuarit, apo mbrojtësit të tij, për përgatitjen e mbrojtjes gjatë një procesi gjyqësor.

Në KPrP gjenden parashikime interesante lidhur me kompetencat e Gjykatës, për të dhënë akses ndaj prokurorit kërkues gjatë një procesi hetimi, Ministrit të Rendit Publik, apo kryetarit të Shërbimit Informativ, për kopje aktesh, apo informacione me shkrim, që janë të klasifikuara sekret shtetëror. Sipas këtij përcaktimi, prokurori ka të drejtë, kur është e nevojshme të kryhen hetime të kërkojë nga gjykata edhe në rastet e detyrimit të sekretit, kopje të akteve që kanë lidhje me çështje të tjera penale që ai ndjek, si dhe informacione

<sup>515</sup> Shih paragrafin e parë, të nenit 30, të KPrC.

<sup>516</sup> Po aty, neni 105.

<sup>517</sup> Po aty, neni 335.

<sup>518</sup> Po aty, neni 103 dhe pika 2, e nenit 105.

<sup>519</sup> Po aty, pika 2, e nenit 332/g.



me shkrim mbi përmbajtjen e tyre. Brenda pesë ditëve, gjykata i përgjigjet kërkesës ose e refuzon atë me vendim të arsyetuar. Këto dispozita zbatohen edhe për kërkesat e bëra nga Ministri i Rendit Publik dhe kryetari i shërbimit informativ, kur kopje të akteve dhe informacionet u duhen atyre për parandalimin e veprave penale.<sup>520</sup>

Përgjigja e gjykatës brenda pesë ditëve ndaj kërkesës së paraqitur për pranimin, apo refuzimin e saj, veçanërisht në rastin e refuzimit, i jep gjykatës autoritet deklasifikues, gjë që nuk e gjejmë shprehimisht të parashikuar në dispozitat e Ligjit “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar. Me autoritet deklasifikues gjatë zhvillimit të procedurave hetimore nga ana e organit të prokurorisë, shfaqet edhe ky organ. Megjithëse nëpunësit shtetërorë, nëpunësit publikë dhe të ngarkuarit me një shërbim publik, janë të detyruar të mos dëshmojnë për faktet sekret shtetëror, ata detyrohen të dëshmojnë për këto fakte, nëse ato janë thelbësore për çështjen dhe nëse organi kompetent shtetëror nuk ka dhënë konfirmimin me shkrim brenda 30 ditëve nga njoftimi i kërkesës për këtë qëllim, nga ana e organit të Prokurorisë.<sup>521</sup>

Jo vetëm kaq, por të dhënat ose dokumentet që lidhen me, veprat penale që përcaktohen nga Prokuroria dhe që synojnë përmbysjen e rendit kushtetues përjashtohen nga klasifikimi si sekret shtetëror. Edhe nëse përjashtimi i sekretit nuk pranohet, prokuroria thjesht njofton organin kompetent për të drejtën eskuzive që, ajo ka për akses në këto të dhëna, fakt që i jep autoritetit të saj natyrë deklasifikuese.<sup>522</sup> Këto parashikime flasin për mangësitë e mekanizmit të deklasifikimit të parashikuar në Ligjin “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### **4.8 Aksesi në dosjet e organeve publike në procedurat administrative**

Një tjetër koncept i aksesit në dosjet dhe dokumentet e autoriteteve publike, lidhet me konceptin e shtetit të së drejtës dhe parimet e qeverisjes së mirë. Sipas këtij koncepti, çdo palë<sup>523</sup> në një procedurë administrative të zhvilluar nga organet e administratës publike, kuptuar këtu organet publike, ka të drejtën e aksesit në dosjen e çështjes.<sup>524</sup>

E drejta e aksesit që çdo person gëzon për të marrë informacion nga organi publik që po zhvillon procedurën në të cilin ai është palë, lidhet me hapat dhe vendimet e marra në këtë procedurë, si dhe me kopjen ose pjesët e njësuara me origjinalin të akteve të nxjerra nga organi përkatës publik, apo të dokumenteve të tjera nën administrimin e tij.<sup>525</sup> Është e kuptueshme që edhe informacioni i mbajtur në këto dosje nuk mund të jetë tërësisht, apo

---

<sup>520</sup> Shih nenin 106, të KPrP.

<sup>521</sup> Po aty, neni 160.

<sup>522</sup> Po aty, neni 161.

<sup>523</sup> Shih pikën 7, të nenit 3 dhe nenin 33, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

<sup>524</sup> Sipas paragrafit të parë, të nenit 45, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”: “Të gjithë palët në një procedurë administrative kanë të drejtën të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure dhe të marrin kopje të tyre”.

<sup>525</sup> Shih pikën 1, të nenit 49, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

pjesërisht i aksesueshëm, nëse ai ka të bëjë me sekretin shtetëror, pasi efektivisht ai nuk mund të bëhet publik, në atë masë që parashikohet nga legjislacioni në fuqi.<sup>526</sup>

Në parim, akti administrativ me të cilin organi publik vë në dijeni subjektin e interesuar për kufizim të dhënies së informacionit të kërkuar, si pasojë e dokumentacionit të klasifikuar sekret shtetëror ka rëndësi sepse, pala e interesuar vihet në dijeni për sekretin, duke patur mundësinë të hetojë për pajtueshmërinë e klasifikimit me ligjin dhe mund të ankohet për pabazueshmëri të klasifikimit të dokumentit, sekret shtetëror. Aksesimi parimor në materialet e dosjes në këtë rast, mund të shërbejë si iniciues për kontrollin e ligjshmërisë së klasifikimit përmes shqyrtimit gjyqësor.

Por çfarë ndodh nëse marrëdhënia e të drejtës së informimit, transferohet në institutin e barrës së provës? Barra e provës për faktet e pretenduara, në një procedurë administrative të inicuar me kërkesë të palës, bie mbi këtë palë, por kjo gjë nuk përjashton edhe hetimin kryesisht nga vet organi publik, të të gjitha fakteve dhe të vlerësimit të të gjitha rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Në rastet e pretendimit me prova nga ana e palës për sjellje diskriminuese, organi publik detyrohet të provojë se faktet e paraqitura nuk përbëjnë diskriminim. Megjithëse barra e provës i takon palës, ligji nuk vendos detyrimin për të paraqitur prova që lidhen me sekretin profesional, njohja e të cilave ndalohet me ligj, apo ato që lidhen me privatësinë, si dhe prova të tjera, publikimi i të cilave mund të shkaktojë dëm material, apo moral ndaj palëve.

Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikon se, organi publik, përcakton në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ administrohen kryesisht nga organi që zhvillon procedurën administrative, kur janë në administrim të tij, apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t’i kërkojë palës vetëm elementët e nevojshme për identifikimin e tyre.<sup>527</sup> Megjithëse, ky ligj nuk parashikon një rregullim specifik se çfarë ndodh në këto raste me zhvillimin e mëtejshëm të procedurës administrative, duhet që organet publike, që zhvillojnë procedurën të përdorin memo, apo raporte mbi rezultatet e hetimeve sekrete, për të marrë një vendim kur informacioni i klasifikuar mbetet në domenin e palës. Ky përfundim është edhe më i pranueshëm kur kemi të bëjmë me sekretin shtetëror të mbajtur nga një organ tjetër i administratës publike, apo organ tjetër shtetëror, i cili paraqitet me cilësinë e palës së interesuar në procedurën administrative.

Ngjashëm, kjo teknikë e zakonshme për fshehjen e investigimeve dhe për të siguruar vetëm rezultatet për palët e procedimit mund të ndiqet në një shqyrtim gjyqësor, kur dosja dërgohet në gjykatë dhe ku palët gëzojnë akses të pavarur ndaj gjithë dosjeve të çështjes. Në KPrC parashikohet se, gjykata kompetente për nevoja të shqyrtimit gjyqësor mund të kërkojë nga ana e organeve të administratës shtetërore të dhëna me shkrim për akte dhe dokumente që ndodhen tek to. Nëse këto të dhëna kanë të bëjnë me sekret shtetëror, atëherë

<sup>526</sup> Shih nenin 46, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

<sup>527</sup> Po aty, pika 2 dhe 3, e nenit 77.

gjykata kërkon lejen e organit qëndror nga varet organi i sipërcituar. Por ndërkohë, nëse kjo kërkesë refuzohet, kërkesa e paraqitur quhet si e paparashtruar nga pala përkatëse ndërgjyqëse.<sup>528</sup> Pra, pavarësisht kërkesës së gjykatës, organi i administratës publike që mban informacion e klasifikuar ka të drejtën e refuzimit të aksesit në këtë dokument.

Megjithatë, legjislacioni ynë nuk parashikon procedurat dhe mënyrën e deklarimit të vullnetit të organit publik, në rastet e refuzimit të kërkesës së gjykatës. Sipas procedurave gjyqësore administrative Gjermane, nëse organi përkatës i administratës publike dëshiron të mbajë një informacion të fshehur ndaj gjykatës, apo ndaj palëve dhe “nëse gjykata vendos bërjen të njohur të burimit të fshehtë të informacionit, atëherë administrata mund të bllokojë këto dosje me një akt special të klasifikimit “Sperrklärung”... Ky akt duhet të jetë i shkruar dhe me arsyetimin se balancon, si interesat publike të sigurisë/sekretit nga njëra anë, ashtu dhe nga ana tjetër interesin publik, interesat e palëve private dhe një verifikim të drejtë dhe objektiv të gjykatës”.<sup>529</sup> Mungesa e rregullimit ligjor, passjell cënim të së drejtës së individit për t’u ankuar ndaj një akti administrativ, që efektivisht nuk nxirret dhe që eventualisht mohon të drejtën për akses në informacion.

#### **4.9 Siguria ushqimore dhe prezenca e aflatoksinës**

Në fillim të vitit 2013, media njoftoi publikun mbi rrezikshmërinë e substancës toksike “Aflatoksinë”, prezente në disa produkte bazë ushqimore, të pranishme në tregun shqiptar. Aflatoksina është një mikrotoksinë që ndikon në krijimin e kërpudhave organike që mund të shkaktojnë kancer. Ajo mund të gjendet në qumështin e kafshëve, si pasojë e ushqimit të kontaminuar të konsumuar nga kafshët, kryesisht nga ushqimet bimore. Norma e lartë e aflatoksinës mund të shkaktojë probleme serioze në organizmin e njeriut. Ekspozimi i gjatë i aflatoksinës mund të shkaktojë tumor në mëlçi, hemorragji, enjtje, probleme me tretjen, probleme me metabolizimin e njeriut, probleme mendore dhe deri në gjendje kome.<sup>530</sup>

Për shkak të rreziqeve dhe pasojave që ajo sjell në trupin e njeriut, i cili konsumon produkte ushqimore ku substanca gjendet në doza të larta dhe nisur nga përhapja e produkteve dhe konsumit të tyre, çështja nuk mund të konsiderohet një problem teknik, por problem i sigurisë njerëzore me pasoja të rënda për popullsinë vendase dhe për çdo konsumator tjetër, kudo eksportohen dhe konsumohen këto produkte ushqimore. Faktet treguan se, prezenca e kësaj substance në ushqimet e tregtuara, nuk ka qënë e rastësishme dhe as e kohëve të fundit. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës, në mesin e muajit Shkurt 2013, ka publikuar faktin se ka bllokuar qumësht me origjinë prodhimi nga Shqipëria dhe Bosnja, me nivel të lartë aflatoksine.

Vendet e Bashkimit Europian kanë si standard të nivelit të aflatoksinës në qumësht, 0.05 miligramë për kilogram, ndërkohë që Shtetet e Bashkuara e kanë 10 herë më të lartë. Por

---

<sup>528</sup> Shih nenin 224, të KPrC.

<sup>529</sup> Hilbrans S., (2012): “National Security vs. Individual Rights – Access to and Freedom of Information under German Law”, Berlin, viti 2012, faqe 7. Website: [www.right2info.org](http://www.right2info.org)

<sup>530</sup> Shih artikullin, “Qumështi shqiptar, AKU: Aflatoksiona mbi normat e BE”, Balkanweb, datë 26 shkurt 2013.

sipas specialistëve për sigurinë ushqimore, ne i referohemi standardeve të BE-së,<sup>531</sup> pasi dy kontinentet kanë kushte të ndryshme gjeografike dhe atmosferike. Pra, nëse kjo substancë e kalon nivelin e përcaktuar standard në produktet ushqimore sjell dëmtime të rënda për shëndetin.

Kemi të bëjmë me shëndetin publik dhe jo me raste sporadike, apo të pritshme, ndaj edhe informimi i individëve dhe popullatës në tërësi nuk mund të jetë dhe të trajtohet si çështje sekreti shtetëror, apo sensitivitet me pasoja negative për disa biznese që, në emër të fitimit rrezikojnë sigurinë dhe besueshmërinë e individit konsumator në tregun ushqimor në aspektin e cilësisë. Sipas prononcimeve të titullarëve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, i cili kontrollon tregun ushqimor, rezultatet paraprake të dala ngritën dyshimin se, norma e aflatoksinës në llojin e mallit të dyshuar dhe të ndaluar nga vendi fqinj, Kosova, ishte mbi normat e lejuara të Bashkimit Europian. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj subjekteve tregtuese, "...ka kërkuar tërheqje të mallit nga tregu vullnetarisht, deri në përfundimin e analizave në laboratorët e specializuar jashtë vendit".<sup>532</sup>

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk e deklaroi asnjëherë nivelin e aflatoksinës të konstatuar në disa produkte të qumështit të tregtuara në Shqipëri, apo edhe të destinuara për eksport. Analizat u kryen jashtë vendit, në një laborator të specializuar dhe vërtetuan se niveli i aflatoksinës ishte dy deri tre herë më i lartë, se norma që ka vendosur BE. Por, drejtori i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, pohon se ndjeshmëria e lartë e çështjes e bën autoritetin të mbajë të censuruar informacionin mbi nivelin e lartë të aflatoksinës.<sup>533</sup> Veç kësaj, ky autoritet është akuzuar edhe për mungesë të kapaciteteve të vlerësimit të rrezikut. Problematika e shfaqur bëhet edhe më serioze kur specialistë të fushës kanë pohuar se, veç qumështit, aflatoksina gjendet edhe në produkte të tjera ushqimore, si në nënproduktet e qumështit, frutat e thata dhe në grurë.

Efektivisht, siguria e individëve konsumatorë të mallrave ushqimorë është pjesë e një prej shtyllave bazë të aspektit të kuptimit të sigurisë njerëzore, ndërkohë që siguria ushqimore është një element përbërës i kësaj të fundit, duke patur në fokus individin. Ministria e Bujqësisë me anë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, luan një rol të rëndësishëm bazuar në legjislacionin specifik në fuqi, për menaxhimin e sigurisë ushqimore, si komponent mbështetës në sigurinë e vendit. Elementi kyç që mungon në tërë zinxhirin menaxhues të situatës ndërkohë që, rreziku vazhdon të jetë ende prezent vlerësoj se është mungesa e informacionit që, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit duhej t'i kishte bërë popullatës mbi

---

<sup>531</sup> Rregullorja e KE-së nr.178/2002, e plotësuar me Rregulloren nr.1642/2003, Rregulloren nr.575/2006, Rregulloren nr.202/2008 dhe Rregulloren nr.596/2009, përcakton parime dhe standarde që lidhen me sigurinë ushqimore në treg, përgjegjësinë e subjekteve tregtuese dhe detyrimin e tërheqjes nga tregu të përbërësve ushqimorë që janë jo të sigurtë, të rrezikshëm për shëndetin dhe/ose të papërshtatshëm për konsum. Website: [www.worldfoodscience.org](http://www.worldfoodscience.org)

<sup>532</sup> Shih artikullin "Qumështi shqiptar, AKU: Aflatoksiona mbi normat e BE", Balkanweb, datë 26 shkurt 2013. Institucioni homolog në Kosovë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës, ka treguar një qasje krejt të ndryshme ndaj rrezikut të shfaqur, pasi pas daljes së rezultateve se qumështi ishte i kontaminuar njoftoi gjithë qytetarët e Kosovës për këtë fakt.

<sup>533</sup> Artikulli "Shqipëri: Aflatoksina "misterioze"".

Website: [www.europaelire.org/content/article/24935784.html](http://www.europaelire.org/content/article/24935784.html)

rrezikun ushqimor dhe shëndetësor të prezencës së nivelit të aflatoksinës në ushqime, mbi standardet e lejuara të BE.

Ruajtja e fshehtësisë ndaj pasojave të ndodhura dhe potencialisht të pritshme është shembulli më i keq, i dominancës shtypëse që “interesi në dukje i sigurisë kombëtare” ushtron ndaj të drejtës për informim. Mendoj se dy janë masat afatgjata që duhen marrë përmes veprimeve të nevojshme për zgjidhjen racionale, të çështjes;

- Së pari, duhet kryer një informim real dhe i vazhdueshëm i publikut mbi rrezikun konkret dhe pasojat në rast konsumimi të ushqimeve me përmbajtje të lartë aflatoksione;
- Së dyti, duhet një menaxhim reaktiv i situatës, me largim dhe asgjесim të mallrave ushqimorë me prezencë aflatoksine mbi standardet e lejuara ligjore dhe kontroll i vazhdueshëm ndaj burimeve të rrezikut, për reduktimin dhe eliminimin e plotë të tij. Në këto rrethana mendoj se, rreziku vazhdon të jetë ende prezent në tregun vendas.

#### 4.10 Çështja e kufirit detar me Greqinë

Në datën 27.04.2009, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Greqisë kanë nënshkruar Marrëveshjen “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare”. Mungesa e kufijve detarë të përcaktuar midis dy vendeve ka iniciuar këtë marrëveshje, të bazuar në Konventën e OKB-së “Për të drejtën e detit”, ku edhe palët nënshkruese janë palë. Ndërkohë sipas dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,<sup>534</sup> marrëveshja i është paraqitur për ratifikim pas nënshkrimit të saj, Kuvendit të Shqipërisë.

Megjithëse ka qënë një nga rastet më pak të njohura nga publiku për mënyrën se si janë zhvilluar bisedimet për marrëveshje, gjykoj se kanë qënë dy faktorë kryesorë që ndihmuan transparencën e këtij procesi, të lidhur ngushtë me interesat e sigurisë kombëtare. Së pari, roli tepër aktiv dhe investigativ që media ndërmori gjatë kësaj periudhe dhe së dyti, aktivizimi i rolit të “Bilbilfryrësit”,<sup>535</sup> mbi një çështje të sigurisë kombëtare. Publiku i gjerë u vu në dijeni të marrëveshjes dhe elementëve të trajtuar në të, vetëm pasi bisedimet ndërmjet grupeve eksperte të palëve, sipas praktikës diplomatike kishin përfunduar dhe palët kishin nënshkruar marrëveshjen.

Perceptimi i krijuar në shtyp dhe publik ishte se, bisedimet për marrëveshjen ishin zhvilluar në një kohë të shkurtër, ndërkohë që, sipas shpjegimeve të dhëna nga ana e Ministrisë së

---

<sup>534</sup> Në gërmën “a”, pika 1, e nenit 121, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: “Ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj, në rastet kur ato kanë të bëjnë me: - territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake”.

<sup>535</sup> Ky rol i atribohet në këtë çështje z.Myslym Pasho, ish drejtor i Institutit të Topografisë Ushtarake të Shqipërisë, me gradën “Kolonel”. Në shtypin e përditshëm ai njihet si individ i pari dhe si oponenti profesional i marrëveshjes “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare”, nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë.

Punëve të Jashtme,<sup>536</sup> ato kishin filluar që prej vitit 2006 dhe më pas ishin bazuar në Urdhërin e Kryeministrit, nr.135 datë 23.08.2007, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përcaktimin e shelfit kontinental me vendet fqinje”. Por ky informacion nuk ishte bërë publik, pasi ishte trajtuar mbi bazën e Ligjit “Për klasifikimin e informacionit “sekret shtetëror””. Pavarësisht trajtimit zyrtar “hermetik” që këto institucione pretendojnë të kenë performuar në këtë rast, informacione thelbësore për çështjen janë bërë publike në media, në periudhën e përfundimit të bisedimeve ndërmjet grupeve të punës për përgatitjen e marrëveshjes, pra në datën 19 Mars 2009, si dhe disa muaj pas nënshkrimit.

Mbi bazën e këtyre informacioneve, ekspertë të pavarur të fushës kanë konkluduar, “...se me sa lehtësi u cënua hapur mëvetësia e Shqipërisë në Ujërat Detare, Detin Territorial, Hapësirën e Afërt Vijimore, Shtratdetin Kontinental dhe Hapësirën e Veçantë Ekonomike...aq më tepër kur kemi të bëjmë me një marrëveshje, e cila lidhet me fqinjësinë e mirë, diplomacinë dhe interesat ekonomike kombëtare”.<sup>537</sup> Pikërisht kur flitet për interesat ekonomike kombëtare, sidomos në kohën kur shteti palë nënshkruet po kalonte një krizë të thellë ekonomike, në shtyp është shprehur ideja se, “...gjeohapësira për të cilën bëhet fjalë është vijim i formacioneve karbonatike kontinentale që siç citojnë burime greke, por edhe të kompanive të huaja që janë marrë me studime të burimeve të naftës dhe të gazit, apo edhe studiues shqiptarë, përbën një shpresë të madhe për praninë e naftës dhe gazit në këto shtresa”.<sup>538</sup>

Ky mjedis oponente dhe denoncimi publik mediatik, u pasua me kërkesën që Partia Socialiste e Shqipërisë, paraqiti në Gjykatën Kushtetuese për papajtueshmëri të marrëveshjes me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.<sup>539</sup> Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.15 datë 15.04.2010, ka vendosur deklarin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të Marrëveshjes “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare”, të lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, shkelja e parë që ka ndodhur në këtë praktikë nënshkrimi të një marrëveshjeje ndërkombëtare është mungesa e plotfuqisë së lëshuar nga Presidenti i Republikës, për grupin negociator shqiptar gjatë bisedimeve dhe lidhjes së marrëveshjes objekt gjykimi, gjë që cënon thelbin e kësaj marrëveshjeje. Presidenti i Republikës është përfaqësuesi më i lartë i shtetit në marrëdhëniet me jashtë.<sup>540</sup> Si i tillë, ky institucion, në zbatim të parimit të shtetit të së drejtës të sanksionuar në nenin 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka kompetencën e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, sipas

---

<sup>536</sup> Kjo gjë është thënë në pretendimet që Ministria e Punëve të Jashtme ka parashtruar para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, gjatë gjykimit të kërkesës së Partisë Socialiste për shqyrtimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën e Shqipërisë, të marrëveshjes “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare”, të nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë.

<sup>537</sup> Shih artikullin “Pasha: Greqia kërkon marrëveshjen e vjetër për naftën dhe gazin natyror”, botuar në gazetën “Sot”, datë 6.10.2011.

<sup>538</sup> Shih artikullin “I vetmi problem hedhja poshtë e Kushtetueses”, Revista “Mapo”, datë 24.07.2013.

<sup>539</sup> Ky është edhe rasti i parë që, një marrëveshje ndërkombëtare kundërshtohet për papajtueshmëri me Kushtetutën, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

<sup>540</sup> Shih gërmën “ë”, të nenit 92, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

ligjit.<sup>541</sup> Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se, “mosmarrja e plotfuqisë nga Presidenti i Republikës për lidhjen e marrëveshjes, apo dhënien e plotfuqisë, sipas ligjit, bie ndesh me nenin 7, të Kushtetutës, i cili garanton parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.”<sup>542</sup>

Sipas Konventës mbi të Drejtën e Detit, si dokumenti bazë që ka përparësi mbi çdo rregullim tjetër juridiko-ndërkombëtar në këtë fushë, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar shkelje në; mospërcaktimin e qartë të hapësirave detare që duhej të delimitoheshin para bisedimeve; mospërputhjen mes titullit të marrëveshjes dhe objektit të saj faktik, pasi nuk ndan Shelf Kontinental, por ujërat e brendshme dhe detin territorial të Shqipërisë; mangësitë nga ana e palës shqiptare në saktësimin e bazës së brendshme ligjore, në studimin, verifikimin dhe përcaktimin paraprakisht të kriterëve kryesore mbi heqjen e vijave bazë. Gjykata konstatoi se, zbatimi vetëm i parimit të barazlargësisë strikte në marrëveshjen objekt gjykimi është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, si dhe detyrimet që burojnë nga neni 3, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.<sup>543</sup> Gjykata tërhoqi vëmendjen në mospërmbajtje të palës shqiptare në parimin e Ekitesë, për ndarjen e hapësirave detare, si parimi më i përshtatshëm në këtë rast që çon në një rezultat sa më të drejtë dhe të ndershëm mes palëve dhe në mosmarrjen në konsideratë të karakteristikave të bregdetit të vendeve, veçanërisht të pranisë së ishujve, apo masave shkëmbore në hapësirat ujore, objekt delimitimi.

Ruajtja e sovranitetit të tërësisë territoriale është një nga interesat bazë të sigurisë kombëtare të një vendi,<sup>544</sup> ndaj edhe rasti konkret flet për rëndësinë që ka luajtur informacioni në denoncimin publik të shkeljeve procedurale dhe materiale, të kësaj marrëveshjeje. Kjo formë presioni informativ vlerësoj se ka luajtur peshën e saj specifike ndaj korrigjimit të një praktike diplomatike, e cila mund të kishte rezultuar, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në cënim të sigurisë kombëtare.

Gjykoj se përdorimi i diplomacisë, në funksion të sigurisë kombëtare, në momente të caktuara ka të nevojshëm realizimin efektiv të së drejtës për informim, si një mjet që ndihmon arritjen e qëllimit madhor të mbrojtjes së interesave kombëtare. Marrëveshja në fjalë është një akt nul, por çështja mbetet ende e hapur përderisa vendet ende nuk kanë delimituar kufijtë ujorë.

Veçanërisht vlerësoj se në këtë proces, transparencja është e nevojshme, sidomos pas kësaj eksperience, e cila në kompleksitetin e saj përshfaq cënim të rëndë të interesave të sigurisë kombëtare. Përcaktimi i kufijve detarë dhe e shtratdetit kontinental vijon të mbetet një çështje e ndërlikuar dhe shumë e ndjeshme sepse ka të bëjë me kujtesën historike, trashëgiminë, zhvillimin ekonomik, marrëdhëniet ndërshtetërore, mëvetësinë kombëtare,

---

<sup>541</sup> Shih Ligjin nr.8371 datë 9.07.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, të shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>542</sup> Shih vendimin nr.15 datë 15.04.2010, të Gjykatës Kushtetuese, pika 47, faqe 19. Për më tepër kjo gjykatë konstaton se, nga pikëpamja juridiko-formale, grupi i punës nuk ka respektuar as edhe autorizimin e lëshuar nga Kryeministri për këtë qëllim, me Urdhërin nr.135 datë 23.08.2007.

<sup>543</sup> Shih vendimin nr.15 datë 15.04.2010, të Gjykatës Kushtetuese, pika 98, faqe 40.

<sup>544</sup> Mbrojtja e integritetit territorial është një nga misionet themelore të SSK, të Republikës së Shqipërisë.

shfrytëzimin e burimeve natyrore detare etj, e të gjitha këto ndikojnë drejtëpërdrejtë në Sigurinë Kombëtare, diplomacinë dhe politikën rajonale.<sup>545</sup>

## 4.11 Tragjedia e Gërdecit

Në datën 15.03.2008, në Gërdec, një fshat në afërsi të qytezës së Vorës, pak kilometra larg Tiranës dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit, ndodhi një shpërthim i fuqishëm i një sasive të madhe baruti, të siguruar nga demontimi i municioneve luftarake në një objekt të menduar së paku si objekt ushtarak dhe të shndërruar në të ashtëquajturën, fabrikë të demontimit të municioneve të shoqërisë “AlbaDemil”. Zanafilla e ngjarjes, lidhet me punën për realizimin e një nga përparësive të veprimtarisë së strukturave të FA në vend që, duke filluar nga viti 1992 ka qënë dhe mbetet demontimi i municioneve të tepërta,<sup>546</sup> të mbetura nga regjimi i para viteve 90’ në Shqipëri.

Fillimi i reformave në vitin 1992, ristrukturimi në vazhdimësi i FA dhe reduktimi i njësive dhe reparteve ushtarake bëri që, municionet të përqëndrohen në depot më të afërta duke i tejmbushur ato mbi kapacitetet deponuese, si dhe duke rritur ndjeshëm rrezikshmërinë. Ndërkaq, anëtarësimi i Shqipërisë në NATO kërkonte rishikimin e standardeve të kompletimit me municion të FA, ruajtjen, depozitimin dhe administrimin e tyre, si dhe forcimin e sigurisë dhe eliminimin e premisave për ngjarje të padëshiruara.<sup>547</sup> Pozicioni gjeografik i Shqipërisë dhe kriza në Kosovë e bënë të natyrshëm këtë interesim dhe aleanca atlantiko-veriore nuk mund të pranonte një anëtar të ardhshëm me armatime të tejkaluara, të cilat për më shumë përbënin rrezik për popullsinë dhe rajonin.<sup>548</sup>

Megjithatë, kjo ngjarje mendoj që vërtetoi se, fshehja e informacionit mbi mënyrën se si po operohej me një kompani private për demontimin e armatimeve, vendin e zgjedhur për këtë lloj veprimtarie dhe pasojat e ardhura nga abuzimi dhe keqmenaxhimi, çënonin rëndë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore përgjegjëse, pasi kishim të bënim realisht me një çështje sensitive të sigurisë kombëtare. Në këtë kontekst, një nga gazetaret prestigjioze ndërkombëtare “New York Times”, në një artikull të botuar gjatë ditëve të tragjedisë, ngriti pyetjen se, përse një vend që po atë muaj u ftua edhe në NATO, kishte lejuar vallë një fabrikë kaq të rrezikshme pranë një autostrade kryesore dhe afër të vetmit aeroport në vend.

---

<sup>545</sup> Shih artikullin “I vetmi problem hedhja poshtë e Kushtetueses”, Revista “Mapo”, datë 24.07.2013.

<sup>546</sup> Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes rezulton se, FA të Republikës së Shqipërisë, që nga viti 1992 administronin të shpërndara në të gjithë vendin, në depo, magazina dhe tunele, rreth 194.000 ton municione luftarake, të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm. Ishin me miliona predha që ruheshin nëpër depot e tunelet e ushtrisë në Bigaz, Bratilë, Bushat, Dhemblan, Gjegjan, Gramsh, Guak, Labinot, Laç, Lozhan, Macukull, Mbreshtan, Melgush, Memaj, Mengel, Mirakë, Ndroq, Noj, Qafë Mollë, Qafë Shtamë, Pigaz, Pirogosh, Shënmëri, Ullishtë, Vërtop, Voskopojë, Zallherr etj. Paragrafi është marrë nga libri i autorit Ardian Klosi, “Katastrofa e Gërdecit”, shtypshkronja K&B, Tiranë, viti 2009, faqe 13.

<sup>547</sup> Konferencë për shtyp për demontimin e municioneve të tepërta, e Zëvendësministrit të Mbrojtjes, datë 30 Mars 2012.

Website: [www.mod.gov.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=1443:konferenc-per-shtyp-per-demontimin-e-municioneve-te-tepërta&catid=293:mars&Itemid=629](http://www.mod.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=1443:konferenc-per-shtyp-per-demontimin-e-municioneve-te-tepërta&catid=293:mars&Itemid=629)

<sup>548</sup> Ardian Klosi, “Katastrofa e Gërdecit”, shtypshkronja K&B, Tiranë, viti 2009, faqe 27.



Në fakt hetimet e zhvilluara nga Prokuroria e Përgjithëshme për këtë ngjarje kanë theksuar se, shpërthimi i ndodhur në Gërdec mund të ndodhte aty nga momenti në moment, pasi personat përgjegjës kishin krijuar aty një bombë vdekjeprurëse. Në pretendën e organit të prokurorisë paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë, theksohej se; “Procesi i demontimit të municioneve u zhvillua pa asnjë rregull të domosdoshëm për vetë specifikën dhe natyrën e rrezikshme të procesit. Për mënyrën se si po zhvillohej procesi, lindja e zjarrit ishte e pashmangshme. Ky zjarr edhe mund të ndodhte në datën 15 Mars 2008, por ajo që themi me siguri të plotë është që, për nga mënyra se si zhvillohej procesi, lindja e zjarrit mund të ndodhte në çdo moment. Aq dramatike paraqitej situata e demontimit të municioneve të kalibrave jo të vegjël, sa shumë persona që punonin aty mendonin të largoheshin, por qëndronin vetëm të detyruar nga arsye ekonomike”.

Bëhet fjalë për një fabrikë demontimi municionesh luftarake, ku veç vendndodhjes krejtësisht të papërshtatëshme, fuqia punëtore e punësuar ishte e patrajnuar për procesin specifik të punës dhe pa kontrata pune.<sup>549</sup> Edhe në raportin përfundimtar të një grupi ekspertësh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët ndihmuan autoritetet shqiptare në hetimin e ngjarjes thuhej se, procesi i çmontimit ishte kryer në kushte të pasigurta pune; fabrika ishte shumë e vogël dhe e papërshtatshme për çmontim municioni. Ndërkohë, Këshilli i Ministrave e ka konsideruar këtë ngjarje si “Aksident teknologjik”,<sup>550</sup> duke konfirmuar zyrtarisht edhe pasojat e ardhura nga shpërthimi.

Sipas të dhënave zyrtare të publikuara, nga shpërthimi ka patur 26 persona të vdekur, 400 persona të plagosur, nga këta të dërguar për mjekim jashtë vendit 24, janë evakuar 4000 persona si pasojë e dëmtimit të banesave dhe ndotjes të rëndë ambientale nga elementët radioaktivë të predhave dhe janë 10.000 persona të prekur. Në Buxhetin e Shtetit rezultojnë të shpenzuara për vitin 2008, 2.39 miliardë lekë dhe për vitin 2009, 85 milionë lekë. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.336 datë 24.03.2008 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.817 datë 11.06.2008, dëmshpërblimi pasuror për shtëpitë e dëmtuara shkon në 2.570.900.412 lekë. Kjo çështje është gjykuar tashmë nga Gjykata dhe si pasojë e veprave penale të konsumuara në bashkëpunim, janë dënuar penalisht mbi 20 persona. Ky referim bëhet sipas përcaktimeve të dhëna në Vendimin nr.381 datë 12.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe të Vendimit nr.138 datë 13.02.2013 të Gjykatës së Apelit, Tiranë. Ndërkohë, Gjykata e Lartë nuk ka pranuar rekursin e paraqitur ndaj këtij vendimi.

Mbi të gjitha dhe përtej etiketimit zyrtar të ngjarjes mendoj se, keqmenaxhimi i sigurisë njerëzore i rrjedhur prej keqmenaxhimit të operimit dhe administrimit të vlerave ushtarake prodhoi kaos dhe pasiguri jo vetëm tek njerëzit, por edhe tek vetë pushtetarët. Aq e vërtetë është kjo saqë, në takimet me drejtues të institucioneve kryesore të sektorit të sigurisë, përfaqësues kryesorë të shtetit shpreheshin për mungesë të informacionit se si ishte instaluar fabrika e demontimit të municioneve në Gërdec dhe se, si organet informative

---

<sup>549</sup> Sikurse shkruhet në artikullin e gazetës “Tema”, “Punonjësi i Gërdecit: Si ndodhi shpërthimi”, datë 20.05.2009, shtetasi H.K një prej ish punëtorëve në fabrikë shprehet se: “...kujtoj se me të (drejtorin e fabrikës), nuk kam bërë ndonjë bisedë në lidhje me kushtet e punës apo pagës, sepse atje ishte njëlloj për të gjithë. Për punësimin tim dhe të gruas nuk kam firmosur ndonjë kontratë punësimi...unë nuk kam parë në ndonjë rast të bëhej trajnimi ynë për punën që do të kryenim”.

<sup>550</sup> Klasifikimi u bazua në përcaktimet e neneve 170 dhe 174, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

nuk kishin sinjalizuar për këtë rrezik potencial, për interesat e sigurisë kombëtare. E gjithë kjo situatë ndodhi kur ekzistonin mundësi të tjera alternative për demontimin e municioneve të vjetra ekzistuese dhe kur vet FA kishin infrastrukturë të përshtatëshme në zona të ndryshme të vendit, për kryerjen e këtij procesi.

Padyshim që edhe ky proces përbën një çështje të sigurisë kombëtare, por i paraprirë nga një proces i gjerë konsultimi dhe informimi me aktorët e interesuar, përfshirë edhe përfaqësues të publikut, mund të ishte arritur të gjendej një zgjidhje tjetër, më efiçente për ekonominë dhe buxhetin e një vendi si Shqipëria, që me gjasa do të krijonte shumë vende të sigurta pune, duke kontribuar edhe në ekonominë e varfër të shumicës së familjeve shqiptare.

Ngjarja ngriti çështjen se sa të mbrojtur janë vetë banorët, por njëkohësisht dhe një tjetër çështje, atë të korrupsionit, për të cilën dhe më herët ishte aluduar por që kurrë nuk ishte ilustruar në mënyrë kaq të tmerrshme.<sup>551</sup>

## 4.12 Disa përfundime

- Siguria njerëzore nuk është një koncept zëvendësues, por plotësues i sigurisë kombëtare, sepse ajo përcakton më mirë qëllimin e saj bazë për mbrojtjen e individëve dhe jo të një entiteti abstrakt, kjo pasi në fund të fundit, përfituesi i sigurisë duhet të jetë qenia njerëzore individuale.
- Qendra e vëmendjes së sigurisë njerëzore dhe të të drejtave të njeriut mbetet individi. Në referencë të DUDNJ, siguria perceptohet si një e drejtë e njeriut dhe kjo e fundit afirmohet në kuadër të të drejtave të njeriut duke u vlerësuar njëkohësisht edhe si një detyrim i vendosur ndaj shtetit, për të mos ndërhyrë në integritetin e individit. Vlerësoj se të drejtat e njeriut janë pjesë e konceptit të sigurisë njerëzore, pasi sot ato konsiderohen si “thelbi i sigurisë njerëzore”, dhe si “një kornizë normative për sigurinë njerëzore”.
- Për shkak të karakterit kufizues që kanë masat e ndërmarra në kuadër të sigurisë kombëtare ndaj të drejtave të njeriut, gjykoj se bazuar në Parimet e Johannesburgut dhe Parimet e Tshwane, mbi Sigurinë Kombëtare, Lirinë e Shprehjes dhe Aksesin në Informacion, është e nevojshme vendosja e një balance të mirëmenduar ndërmjet lirisë dhe të drejtës për t’u informuar dhe të drejtës për ta kufizuar këtë të drejtë nëpërmjet sekretit shtetëror.
- Nga një këndvështrim racional mendoj se, në parim e drejta për informim sfidohet prej ekzistencës së sekretit shtetëror, i nevojshëm për mbrojtjen e interesave të ligjshme kombëtare.

---

<sup>551</sup> Artikulli “Gërdeci, New York Times: Shpërthimi, shembull i tmerrshëm korrupsioni”, publikuar në 19 Prill 2008.

Website: [news.albanianscreen.tv/pages/news\\_detail/gerdeci\\_new\\_york\\_times\\_shperthimi\\_shembull\\_i\\_tmerrshem\\_korrupsioni](http://news.albanianscreen.tv/pages/news_detail/gerdeci_new_york_times_shperthimi_shembull_i_tmerrshem_korrupsioni) /ALB

- Nga përplasja e doktrinave që, nga njëra anë mbrojnë radikalisht të drejtën e informimit dhe e shohin sekretin si një të keqe për interesat publike dhe nga ana tjetër, të atyre që mendojnë se, sekretin luan një rol kyç në çështjet e sigurisë kombëtare, vlerësoj se shkaku i këtij kontraversialiteti qëndron në mungesën e një sistemi të gjithëpranuar mbi përcaktimin se, çfarë duhet të mbahet sekret dhe se, në ç' nivel duhet të ruhet ai.
- Është e nevojshme që marrëdhënia ndërmjet të drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare, sa i përket përdorimit të mjetit të sekretimit, të ruajë një balancë të mirëmennduar dhe të normuar, të regjimit juridik të së drejtës për informim dhe atij të mbrojtjes së sekretit. Gjykoj se, përplasja prevalue e dy regjimeve të ndryshme juridike që ndodh në këtë rast qëndron tek përcaktimi i qartë dhe i përshtatshëm i balancës ndërmjet dy komponentëve të rëndësishëm të interesit publik dhe pikërisht ndërmjet, interesit publik për transparencë në veprimtarinë e organizmit shtetëror dhe interesit publik për ruajtjen e disa informacioneve nëpërmjet sekretit shtetëror.
- Regjimi juridik i sekretit shtetëror në vendin tonë gjykoj se ka nevojë për përmirësime, sa i përket përcaktimeve ligjore që lidhen me nivele të caktuara klasifikimi, mosparashikimin e detyrimit për dhënien e arsyes justifikuese për klasifikimin e aplikuar, mosaplikimin e deklasifikimit në raste të caktuara, mosparashikimin e rrugës së ankimit ndaj klasifikimit të informacioneve shtetërore, apo mosparashikimin e një procesi të rregullt deklasifikimi. Ky regjim ka nevojë të harmonizohet me zhvillime normuese të viteve të fundit, sikundër legjislacioni për mbrojtjen e “Sinjalizuesve”.
- Shkalla e gjerë e përdorimit të video survejimit nga subjekte shtetërore ose jo, specifikisht si veprimtari nga ana e shtetit gjykoj se evokon faktin që, jo gjithmonë jemi në kushtet ideale kur shteti vepron si garantues i sigurisë njerëzore, pasi ekzistojnë probleme potenciale me respektimin e të drejtave themelore të njeriut. Për këtë arsye mendoj se është e nevojshme ruajtja e një balance midis interesit publik dhe atij privat, përmes legjislacionit që duhet të përkufizojë qartë bazën ligjore të video survejimit dhe nevojshmërinë e kufizimit të të drejtave, duke mbajtur këtu parasysh interesat e mbrojtura të sigurisë kombëtare, por pa mundur në asnjë mënyrë të dobësohet niveli i mbrojtjes së të drejtave të afirmuara nga KEDNJ.
- Qëllimi i përdorimit dhe aplikimi i sistemeve video survejuese mendoj se ka të nevojshme një bazë normative rregullatore, balancuese ndërmjet interesave të prezumuara shtetërore të sigurisë dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke paraparë dhe parandaluar shkaqet që prodhojnë pasiguritë njerëzore në praktikë. Legjislacioni ynë në këtë fushë gjykoj se ka qënë i mangët dhe fragmentar, deri para hyrjes në fuqi të Ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.
- Ligji nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, parashikon si masë shtesë sigurie të detyrueshme për subjektet publike dhe ato private, edhe përdorimin e

- sistemit të kamerave CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe, që ruajnë imazhet filmike në NRV/Server. Ai parashikon vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të kamerave të sigurisë nga subjektete respektive në bazë të procedurave ligjore të përcaktuara qartë, sikundër përcakton edhe detyrimin që, këto subjekte kanë për njoftimin e KDIMDhP dhe bërjen transparent ndaj tij të procesit, në rast instalimi të sistemit të kamerave.
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në vendimin e saj nr.60 datë 31.07.2017 është shprehur se, ky ligj ruan një balancë të drejtë dhe proporcionale ndërmjet, interesave të tregtarëve si subjekte private për të ushtruar lirinë e veprimtarisë ekonomike e të lirisë për të gëzuar qetësisht pronën e tyre, dhe të interesave të shtetit nga ana tjetër, për miratimin e një sërë normash rregulluese për marrjen e masave konkrete, siç edhe vendosja e sistemit të videove, me qëllim ruajtjen e sigurisë publike.
  - Seancat gjyqësore penale, apo civile janë në parim të hapura për median dhe publikun. Megjithatë KPrP dhe KPrC, parashikojnë raste të kufizimit të kësaj të drejte, ku vend specifik zë diskrecioni për ndalimin nga gjykata të publicitetit që mund të shkaktojë përhapjen e të dhënave sekret shtetëror. Marrëdhëniet me median dhe informimi i shtypit mbi çështje në interes të publikut janë përgjegjësi dhe oportunitet njëkohësisht i vetë gjykatave, apo prokurorëve. Publikimi on-line i vendimeve gjyqësore dhe urdhërimit nga gjykata në raste të caktuara i publikimit në media të vendimeve gjyqësore janë elementë të realizimit të së drejtës për informim, duke respektuar të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.
  - Për çdo akuzë penale dhe për çdo ndalim, personi i akuzuar, apo i ndaluar ka të drejtën e aksesit në provat që janë sjellë dhe atyre të ndodhura në dosjet e gjykatës. Megjithatë, kur personi ndiqet penalisht në gjendje të lirë dhe pas liritimit nga një akuzë, për arsye sigurie, apo për të mbrojtur efektivitetin e hetimeve të mëtejshme, aksesit i të akuzuarit në dosje mund të kufizohet, sidomos ndaj informacionit sekret shtetëror. Pamundësia e aksesit në këto raste gjykoj se dëmton të drejtën e aksesit të të akuzuarit në drejtësi, veçanërisht në çështjet ku ndërthuren elementë të sigurisë shtetërore, duke cënuar parimet e ndershmërisë së gjykimit dhe barazisë së armëve, në dëm të të akuzuarit.
  - Autoriteti deklasifikues që i njihet gjykatës, apo edhe prokurorisë, sipas KPrP për aksesim të informacioneve sekret shtetëror, mendoj se nxjerr në pah mungesë harmonizimi të legjislacionit në fuqi, sa i përket sistemit deklasifikues të sekreteve shtetërore.
  - Palët në procedurën administrative kanë akses në të dhënat dhe dokumentet e kësaj procedure, sipas parashikimeve të KPrA. Ky akses është i kufizuar kur kemi të bëjmë me informacion sekret shtetëror, qoftë ky i mbajtur nga organi zhvillues i procedurës administrative, apo edhe kur kërkohet nga ky i fundit në kuadër të hetimeve administrative, apo gjykata në hetim gjyqësor.

- Çështje konkrete të njohura nga publiku në vendin tonë kanë nxjerrë në pah nevojën për vendosjen dhe përcaktimin e një raporti të balancuar midis të drejtës për informim dhe sekretit shtetëror, pasi interesi publik evidenton prevalencën e nevojshme të së drejtës për informim, në të mirë të mbrojtjes së interesave të ligjshëm të sigurisë kombëtare. Çështjet e trajtuara të sigurisë njerëzore dhe të sigurisë kombëtare do të mund të gjenin një zgjidhje më të mirë, nëse interesi publik në të dhëna të caktuara të tyre do të shfrytëzohej si tregues për hapje të informacionit ndaj publikut.

## VII. KREU I PESTË

### PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

#### 5.1 Përfundime

- 1- E drejta e informimit është e drejtë themelore e njeriut nga më të afirmuarat në shoqëritë demokratike, e lindur bashkë me qënien njerëzore, universale dhe e patjetërsueshme. Në këtë kontekst vlerësoj se, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me afirmimin specifik që i bën asaj në nenin 23, si një e drejtë e veçantë themelore e njeriut, identifikon një kapërcim të akteve konvencionale ndërkombëtare si DUDNJ dhe KEDNJ, që e garantojnë të drejtën e informimit si derivat dhe pjesë përbërëse të lirisë së shprehjes. Kjo qasje evidenton qënien në kohezion me zhvillimet më të fundit jurisprudenciale dhe interpretative të fushës.
- 2- E drejta për informim është një instrument kundër sekretit dhe mungesës së besimit në qeverisje, në kushtet e ekzitencës së burokracisë mbytëse të shtetit autokratik. Ajo i ka paraprirë lindjes së shtetit administrativ dhe zhvillimit të shtetit administrativ modern, në të cilin mbrohen dhe respektohen të drejtat e njeriut, vendoset sistemi “Check and Balance”, krijohen tregjet e lira dhe konsolidohet demokracia.
- 3- Në përgjithësi legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, për të drejtën e informimit bazohet në parimet ndërkombëtare për hartimin e legjislacionit rregullator për këtë të drejtë, me qëllim kryesor hapjen maksimale të informacionit qeveritar ndaj publikut.
- 4- Regjimi juridik bazë i kësaj të drejte i përcaktuar fillimisht në Ligjin Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, dhe në Ligjin nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, pas shfuqizimit të tyre, përcaktohet nga dispozitat e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”. Këto ligje rregullojnë aksesin në informacion mbi veprimtarinë e përgjithshme administrative të organeve publike dhe në kuadër të Kodeve, aksesin në informacionin që i përket procedurës administrative, si një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë administrative. Ligje të tjera në fuqi në vendin tonë përcaktojnë regjime juridike specifike të së drejtës për informim, që referojnë në dispozitat e tyre regjimin bazë juridik të kësaj të drejte, të përcaktuar në ligjet e sipërcituara.
- 5- Hyrja në fuqi e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, gjykoj se ka përmirësuar në shumë elementë regjimin juridik bazë të së drejtës për informim, krahasuar me bazën ligjore që ato kanë shfuqizuar, qoftë përsa i përket veprimtarisë së përgjithshme administrative të organeve publike, qoftë edhe në kuadër të procedurave administrative. Përmirësimi është i dukshëm në të gjithë elementët e marrëdhënies juridike administrative të së drejtës për informim.

- 6- Ligji “Për të drejtën e informimit”, ka përmirësuar regjimin juridik të së drejtës për informim në lidhje me; Përcaktimin e një rrethi më të zgjeruar të subjekteve që kanë detyrim dhënien e informacionit; Ndryshimin dhe shkurtimin e sistemit të afateve për dhënien e informacionit; Parashikimin konkret që, për çdo shkelje të cilësuar në kushtet e kundërvajtjes administrative, të përcaktohet një nga llojet e dënimeve administrative të parashikuara shprehimisht në legjislacionin në fuqi rregullator për kundërvajtjet administrative; Harmonizimin me regjimet juridike të klasifikimit të informacionit; Detyrimin për të ndihmuar kërkuesin për saktësim, ose përcjellje të kërkesës për informim; Përcaktimin e saktë të kostos së pagesave për dhënien e informacionit.
- 7- Regjimet juridike bazë të së drejtës për informim të përcaktuara në ligjet që rregullojnë aksesin në informacion mbi veprimtarinë e përgjithshme administrative të organeve publike janë më të gjerë në disa elementë, se sa regjimet juridike të KPrA, që rregullojnë aksesin në informacionin për procedurën administrative. Ky dallim vërehet në rrethin e subjekteve që kanë të drejtë të kërkojnë informacion, marzhin e informacionit që është objekt i kërkimit, afatet, etj.
- 8- Veç ankimit administrativ dhe ankimit në rrugë gjyqësore në rastet e shkeljes së të drejtës për informim, Ligji Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, parashikonte rolin e AP si kujdestar për zbatimin e këtij ligji. I plotësuar me parashikimet e Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ky rol i jepte mundësi subjekteve të interesuara të ankoheshin edhe tek AP. Specifika e këtij ankimi qëndron në faktin se ai nuk ka cilësinë dhe efektet e ankimit administrativ, por gjykoj se është një mjet ligjor, i cili ezaurohet në termat e ndërmjetësimit institucional të rregulluar mbi bazën e parashikimeve të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”. Kjo mundësi ankimi ekziston ende, pavarësisht se Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, parashikon krijimin e një institucioni të ri, të pavarur, mbikqyrës ekskluziv për zbatimin e së drejtës për informim, të emërtuar KDIMDhP. Ky fakt tregon se, përmbajtja e dispozitave të Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, krijon paqartësi në lidhje me kompetencat dhe fushën e veprimit të AP, për sa i takon promovimit dhe mbrojtjes të së drejtës për informim.
- 9- Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në fuqi, përcakton se, çdo person kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative, pranë KDIMDhP.
- 10- AP ka një mandat më të gjerë se KDIMDhP, sa i takon promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por juridiksioni i tij kufizohet vetëm tek sfera shtetërore, ndryshe nga KDIMDhP, ku përfshihet edhe sfera private. KDIMDhP ka mjete më të shumta ligjore që i japin kompetenca ekzekutive detyruese, krahasimisht ndaj kompetencave rekomanduese të AP, lidhur me mbrojtjen e së drejtës për informim.
- 11- Përparësia që shfaqet në raportin midis interesit individual dhe interesit publik, në kërkesën për publikimin e një informacioni zyrtar, gjykoj se përcakton realizimin

efektiv, apo kufizimin e së drejtës për informim, në përputhje me përcaktimet e bëra në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, KEDNJ, aktet e tjera ndërkombëtare dhe me jurisprudencën zhvilluese të GJEDNJ.

- 12- Kufizimi i së drejtës themelore për informim mund të bëhet vetëm me ligj, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 17, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Kufizimi që i bëhet aksesit në informacion mund të jetë i plotë, apo i pjesshëm. Kufizimi duhet arsyetuar gjithmonë me aktin përkatës administrativ të nxjerrë nga ana e autoritetit publik.
- 13- Jetësimi i së drejtës për informim si një marrëdhënie juridike administrative gjykoj se nuk përfaqëson vetëm një dimension individual në ushtrimin e saj, pasi duke qënë një element jetik i transparencës në qeverisje dhe si një e drejtë pozitive, ajo plotësohet me mundësinë e shfrytëzimit të saj edhe nga administrata publike, në funksion të besueshmërisë dhe transparencës ndaj publikut.
- 14- Media si një subjekt i pazëvendësueshëm në përçimin e informacionit në publik, vlerësoj se nuk gëzon përparësi sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, për trajtimin e kërkesave për të drejtën për informim, pavarësisht se në jurisprudencën e GJEDNJ dhe në parime ndërkombëtare relevante, asaj i atribuohet një mbrojtje e veçantë, si aktor në realizimin efektiv të lirisë së shtypit dhe lirisë së marrjes së informacionit në interes të publikut.
- 15- Pavarësisht rolit që Kushtetuta iu ka njohur organeve të administratës shtetërore, në garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut gjatë veprimtarisë së tyre mendoj se, për vetë rëndësinë dhe filozofinë e së drejtës për informim është e nevojshme ekzistenca dhe funksionimi i institucioneve të pavarura, garantë për realizimin efektiv të saj. Gjykoj se, AP si një institucion i pavarur i parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe KDIMDhP, janë dy mekanizma jetikë mbikqyrës për mbrojtjen dhe respektimin e së drejtës për informim.
- 16- Misioni i veçantë i AP si kujdestar i zbatimit dhe respektimit të së drejtës për informim, i konkretizuar me veprimtarinë e tij në kuadër të promovimit dhe mbrojtjes të kesaj të drejte, derisa kjo kompetencë i ka kaluar KDIMDhP, vlerësoj se ka treguar një rol aktiv, jo vetëm në kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë, por edhe për ekspozimin e një modeli pozitiv zbatues dhe promovues të së drejtës për informim.
- 17- KDIMDhP është ende në fazat e krijimit të një fizionomie institucionale me profil promovues dhe mbrojtës të së drejtës për informim, ndërkohë që mund të thuhet se, ai e ka krijuar tashmë këtë profil, sa i takon promovimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
- 18- Gjendja e zbatimit dhe respektimit të së drejtës për informim, bazuar në veprimtarinë e AP, si dhe të OJF-ve në këtë fushë, rezulton të jetë problematike për shkaqe të cilat mendoj se lidhen me; mungesën e një kulture individuale të njohjes



dhe realizimit të të drejtave nga ana e publikut; mungesën e një kulture administrative për trajtimin e ankimeve në këtë fushë nga ana e administratës publike; mosefektshmërinë dhe mungesën e profesionalizimit të gjyqësorit në trajtimin e padive gjyqësore, që lidhen me të drejtën për informim, si dhe pengesave ligjore fiskale të aksesit fillestar, të palëve në gjykatë; mungesën e një jurisprudence të pasur të Gjykatës Kushtetuese; nevojën për përmirësimin e regjimit juridik të kësaj të drejte.

- 19- Pavarësisht përmirësimit të regjimit juridik të së drejtës për informim, nevojitet ende përmirësim në përmbajtjen e dispozitave të Ligjit “Për të drejtën e informimit”, për sa i takon; saktësimin dhe qartësimin të kompetencave të Avokatit të Popullit, në raport me të drejtën për informim, sipas regjimit juridik të kësaj të drejte, të përcaktuar në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”; parashikimit të një rregullimi specifik në ligj, apo me ndonjë akt tjetër nënligjor, për lehtësirat për formën e dhënies së informacionit, në rastet kur ai kërkohet nga personat me aftësi të kufizuara, pa lënë një marzh diskrecioni tërësisht të papërcaktuar në duart e autoriteteve publike mbi këtë çështje; trajtimin të refuzimit të kërkesës për formën e kërkuar të dhënies së informacionit; parashikimit të mjeteve ligjore për vënien në ekzekutim të vendimeve të KMDIDhP.
- 20- Boshllëku ligjor për mbrojtjen e individëve “Bilbilfryrës”, ekzistues deri në fund të vitit 2016, është plotësuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Pavarësisht sistemit normativ që ai ofron tashmë për mbrojtjen e aktit dhe individit “Bilbilfryrës”-“Sinjalizues”, është e nevojshme që në këtë ligj; të zgjerohet gama e përcaktuar e veprimeve, apo praktikave që mund të sinjalizohen sipas këtij ligji; të riformulohet termi “Sinjalizues”, sipas përkufizimit standardizues më të mirë; të pasqyrohen më mirë në dispozitat e ligjit elementët e kuptimit të “mirëbesimit” dhe “besimit të arsyeshëm se, informacioni ka qënë thelbësisht i vërtetë”, si kërkesa dhe komponentë bazë të legjitimitetit të aktit të “bilbilfryrjes” dhe të garantimit të mbrojtjes për individin që e kryen atë.
- 21- Siguria lidhet me reagimin e subjektit njerëzor për mbijetesë, ndërkohë që në kuadrin e shtetit komb sovran, ajo rikonceptohet si mbijetesë e shteteve sovraane në sferën ndërkombëtare. Ky zhvillim mendoj se prezanton paradigmen bashkëkohore të sigurisë, në formën e tri kornizave themelore konceptuale, përkatësisht të sigurisë individuale; sigurisë kombëtare dhe sigurisë ndërkombëtare. Nga ana tjetër, evidentohet se siguria kombëtare dhe elementët përbërës ndryshojnë nga një vend në tjetrin, në varësi të veçantive përfaqësuese shtetërore, kërcënimeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe të interesave kombëtare që kërkohet të mbrohen.
- 22- Siguria njerëzore vlerësoj se është një koncept zgjerues dhe plotësues i sigurisë kombëtare, i mbështetur në respektimin e konceptit të të drejtave të njeriut. Duke vënë në plan të parë sigurinë e individëve, kundrejt konceptit tradicional të sigurisë së shtetit, gjykoj se ajo kërkon një konsiderim të kujdesshëm të binomit siguri-pasiguri, si dhe të koncepteve të sigurisë ekonomike, ndryshimit dhe thellimit të reziqeve të reja jotradicionale ndaj njerëzve dhe shteteve, të sigurisë së ushqimit,

- mjedisit, pabarazisë ekonomike, shkeljes së të drejtave të njeriut, sigurisë individuale dhe politike, katastrofave natyrore dhe atyre të tjera. Kjo pasi në fund të fundit, përfituesi i sigurisë duhet të jetë qenia njerëzore individuale. Qendra e vëmendjes së sigurisë njerëzore dhe të të drejtave të njeriut mbetet individi.
- 23- Marrëdhënia e koncepteve të sigurisë njerëzore dhe e të drejtave të njeriut evidenton faktin që, të drejtat e njeriut janë pjesë e konceptit të sigurisë njerëzore, ndaj edhe sot të drejtat e njeriut konsiderohen si “një kornizë normative dhe thelbi i sigurisë njerëzore”.
- 24- Zhvillimet globale, që nga krijimi i shteteve sovrane, mbarimi i Luftës së Ftohtë, e deri sot, si dhe shfaqja e kërcënimeve të reja rajonale dhe globale kanë tejkaluar perceptimin klasik të rrezikut tradicional ndaj sigurisë kombëtare, të fokusuar tek lufta dhe përdorimi i forcës. Përkufizimet e shumta mbi sigurinë, rrjedhojë e studimeve të shumta në këtë fushë, vlerësoj se janë kushtëzuar nga zgjerimi i gamës së rreziqeve me degradimin mjedisor, varfërinë, pandemitë e ndryshme, HIV-Sida, terrorizimin e shfaqur në shumë forma, armët e shkatërrimit në masë, krimin transnacional dhe konfliktin ndërshtetëror.
- 25- Koncepti i ngushtë klasik i sigurisë kombëtare që qëllimonte ruajtjen e tërësisë territoriale dhe sovranitetin e vendit, që nga krijimi i shtetit të parë shqiptar e deri në vitin 1990, mendoj se lidhet me dobësinë ekzistenciale të shtetit të ri shqiptar dhe politikave izoluese të ndjekura më pas. Natyrshëm, zhvillimet demokratike pas viteve 90’, anëtarësimi në NATO dhe aspiratat për anëtarësim në BE, kanë rivlerësuar konceptet e sigurisë kombëtare, të përshtatura në dokumentet e politikës së sigurisë kombëtare të viteve 2000 dhe 2004, si dhe së fundmi të vitit 2014.
- 26- SSK, si një dokument kornizë, burimor dhe zhvillimor i sigurisë kombëtare prevalon ndaj politikave të tjera të sigurisë dhe bazohet në dokumentin themeltar të një vendi. Gjykoj se, një SSK e bën të efektshme; vlerësimi i rreziqeve dhe mundësive aktuale e të ardhshme, përshkrimi i qartë i fushës së përgjegjësisë të çdo aktori zbatues; trajtimi i kompetencës dhe krijimi i organeve mbikqyrëse të zbatimit të saj në aspektin politik, institucional dhe atë të shoqërisë civile; transparenca e procesit të formulimit dhe qartësia e koncepteve të dhëna; garantimi i konfidencialitetit në fusha të caktuara të sigurisë kombëtare dhe potencimi i rolit të demokracisë dhe zhvillimit ekonomik.
- 27- Gjykoj se, konfuzioni i vërejtur në SSK e miratuar me Ligjin nr.9322 datë 25.11.2004, në përdorimin e termonologjive të caktuara dhe përcaktimi i tërësisë së të drejtave dhe lirive të individit që shërbejnë si udhërrëfyes të ndërtimit të konceptit të strategjisë kombëtare; këndvështrimi më së shumti ndaj kërcënimeve tradicionale të sigurisë dhe mospasqyrimi i duhur i kërcënimeve dhe rreziqeve të reja; mungesa e pasqyrimin të dimensionit të duhur të sigurisë njerëzore, si dhe mosrespektimi i afatit taksativ kohor për rishikimin e këtij dokumenti, kanë evidentuar domosdoshmërinë e rishikimit dhe rikonceptimit të dokumentit të SSK.

- 28- SSK e miratuar me Ligjin nr.103/2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, në ndryshim nga dokumenti strategjik i vitit 2004, përfaqëson strategjinë e një vendi anëtar të NATO-s, rrjedhimisht duke u mbështetur në Konceptin Strategjik të NATO-s, si dhe të një vendi kandidat potencial për në BE. Nga ky këndvështrim, SSK në fuqi harmonizon rolin, misionin, përgjegjësitë, kapacitetet dhe organizimin e institucioneve të sigurisë së Republikës së Shqipërisë, me realitetin e ri të sigurisë kolektive.
- 29- Në të gjithë komponentët e SSK të miratuar në vitin 2014, kemi të shpërndara rregullime që lidhen me elementë të sigurisë njerëzore, sikundër afirmimi për respektimin e dinjitetit njerëzor, respektimin e të drejtave të njeriut, siguria shëndetësore, siguria ushqimore, siguria mjedisore, etj. Pavarësisht këtij zhvillimi përmbajtësor mendoj se, duhej theksuar si një terminologji e veçantë në të, e drejta e informimit, e cila në qëllimin dhe objektin realizues të saj përbën edhe thelbin e konceptit të transparencës. Po kështu, në përmbajtjen e saj vazhdon përdorimi i tejkualuar i termit “shtet ligjor”, ndërkohë që duke u fokusuar tek siguria njerëzore mendoj se, kërcënimet e përcaktuara mbi sigurinë e informacionit të klasifikuar, duhej të konceptoheshin në një raport më të ngushtë me “rrezikun dobiprurës”, që mund t’i sjellë informacionit të sigurisë kombëtare e drejta për informim. Pavarësisht këtyre konstatimeve, duhet vlerësuar se kjo SSK përbën një dokument të rëndësishëm konceptual, që identifikohet i mirëstrukturuar.
- 30- Eksperienca e anëtarësimit në NATO, si dhe ajo në vazhdim për anëtarësimin në BE kanë nxitur si efekte pozitive në vendin tonë një sërë reformash standardizuese perëndimore, në administratën publike, FA, drejtësi, luftën kundër korrupsionit, njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, etj. Por kjo qasje ka edhe efekte negative që lidhen me humbjen e sovranitetit kombëtar, disproporcionaliteteve standardizuese në adoptimin e legjislationit të brendshëm, apo dhe të vendosjes së prioriteteve konverguese, dinamike kjo që mendoj se nxjerr nevojën e qartësimit të pritshmërive ndaj proceseve integruese.
- 31- Karakteri kufizues i masave të ndërmarra në kuadër të sigurisë kombëtare, ndaj të drejtave të njeriut, gjykoj se nxjerr nevojën e vendosjes së një balance të mirëmenduar dhe racionale ndërmjet të drejtës për t’u informuar dhe së drejtës për ta kufizuar atë, me anë të sekretit shtetëror, si një instrument i nevojshëm për mbrojtjen e interesave kombëtare. Ky raport mendoj se duhet të ndërtohet sipas parimeve të gjithëpranuara ndërkombëtare mbi Sigurinë Kombëtare, Lirinë e Shprehjes dhe Aksesin në Informacion dhe duhet të përcaktojë qartë e në mënyrë të përshtatëshme, balancën ndërmjet dy komponentëve të rëndësishëm të interesit publik. Pikërisht balancën ndërmjet interesit publik për transparencë në veprimtarinë e organizmit shtetëror dhe interesit publik, për ruajtjen e disa informacioneve nëpërmjet sekretit shtetëror.
- 32- Aksesi në informacionin e sigurisë kombëtare është një kërkesë esenciale për zhvillimin dhe konsolidimin e një shoqërie demokratike. Aksesi siguron një mbikqyrje konstante kundër abuzimeve, keqqueverisjes dhe korrupsionit. Aksesi

- ndaj informacionit të sigurisë kombëtare, i kuptuar në kuadër të procesit të vendimmarrjes ndihmon në rritjen e besimit të publikut ndaj veprimeve të ekzekutivit. Llogaridhënia si një nga elementët bazikë të një shoqërie demokratike nuk mund të kuptohet pa transparencën, që sigurohet nëpërmjet aksesit.
- 33- Regjimi juridik i sekretit shtetëror në vendin tonë gjykoj se ka nevojë për përmirësime, sa i përket përcaktimeve ligjore që lidhen me nivele të caktuara klasifikimi, mosparashikimin e detyrimit për dhënien e arsyes justifikuese për klasifikimin e aplikuar, mosaplikimin e deklasifikimit në raste të caktuara, mosparashikimin e rrugës së ankimit ndaj klasifikimit të informacioneve shtetërore, apo mosparashikimin e një procesi të rregullt deklasifikimi. Ky regjim ka nevojë të harmonizohet me zhvillime normuese të viteve të fundit, sikundër legjislatiioni për mbrojtjen e “Sinjalizuesve”.
- 34- Vlerësoj se, sistemi i klasifikimit duhet të fokusohet në misionin e tij kryesor, të përfshirjes në të, të informacioneve që realisht dëmtojnë interesa legjitime të sigurisë kombëtare dhe jo të informacioneve që përfaqësojnë interesa të tjera. Sipas këtij vlerësimi, për çdo vendim për klasifikim informacioni, klasifikuesi duhet të japë arsyet justifikuese të klasifikimit; klasifikimi i informacionit duhet të kufizohet vetëm në rastet kur rrezikohet një dëm i vërtetë dhe domethënës ndaj sigurisë kombëtare; kohëzgjatja e klasifikimit duhet t’i nënshtrohet afateve minimum të mundshme, pasi asnjë informacion nuk mund të qëndrojë i klasifikuar përgjithnjë; sistemi i klasifikimit duhet të ketë kufij kohorë, si dhe kufizime në objektin e informacioneve të përfshira, përfshirë mekanizmat që rregullojnë gabimet e tij.
- 35- Konkurimi i interesave publikë, të së drejtës për informim dhe të mbrojtjes së sigurisë kombëtare gjykoj se duhet të anojë nga e drejta për informim, kur kemi të bëjmë me informacione që edhe pse plotësojnë kriteret për klasifikim, flasin për aktivitet kriminal të kryer nga përfaqësuesit e qeverisë, duke identifikuar kështu një rrezik eminent të sigurisë publike.
- 36- Mbikqyrja e ushtruar nga ana e AP ndaj institucioneve të sektorit të sigurisë, për zbatimin e legjislatiioni që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, e kordinuar me veprimtarinë e ekzekutivit, legjislativit dhe pushtetit gjyqësor, formëson sistemin “Check and Balance”, në sektorin e sigurisë dhe ndikon në respektimin e parimeve të përgjegjshmërisë dhe transparencës në të.
- 37- Megjithëse marzhi i mjeteve ligjore në dispozicion të AP përfshin një varietet mjetesësh me karakter jo detyrues, vërehet se ai ende nuk po përdor me efektivitet mjete të tilla koherente, sikurse ndërhyrja “Amicus Curiae”. Ky vlerësim lidhet me çështje që ndërthurin respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në çdo nivel, përtej kuptimit dhe përdorimit të “Amicus Curiae”, para gjykatës, kuptuar këtu edhe çështjet e sigurisë njerëzore. Me qëllim që të sigurohet një pjesëmarrje më e madhe nga subjektet “Amicus”, në kontekstin shqiptar nevojitet një qasje e re, që duhet të krijojë pa mëdyshje mundësinë ligjore për këtë ndërhyrje, me qëllim që baza e pranimiit apo kundërshtimit të saj të jetë e parashikuar qartësisht.

- 38- Ndërhyrja “Amicus Curiae” mund të përdoret si një mjet efikas për të rritur respektimin e të drejtave të njeriut dhe për të parandaluar shkeljen e të drejtave të afirmuara nga instrumentet kombëtare dhe ndërkombëtare, në këtë fushë, ndërkohë që mund të kthehet në një ndërhyrje shumë të dobishme që siguron një mbrojtje më të madhe të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kjo ndërhyrje mbetet një instrument me vlerë ende i pashfrytëzuar si duhet nga ato subjekte, të cilat mund të paraqiten me cilësinë e “Amicus Curiae”.
- 39- Numri i ulët i ankesave për shkeljen e së drejtës për informim nga institucionet shtetërore të sektorit të sigurisë, të paraqitura tek AP, deri në kohën kur kjo kompetencë trajtimi i kaloi ekskluzivisht KDIMDhP, gjykoj se ka si shkaqe kryesore, mosnjohjen e kësaj të drejte nga ana e publikut dhe një lloj “hermetizimi institucional”, që aplikohet nga këto institucione me justifikimin e mbrojtjes së sekretit shtetëror. Si një shkak tjetër vlerësoj edhe llojin e kompetencave me karakter jo ekzekutiv, që legjislacioni në fuqi i njeh këtij institucioni.
- 40- AP si një institucion i pavarur dhe me kompetenca jo ekzekutive, ka akses në informacionin e sigurisë kombëtare. Argumenti bazë që mbështet sigurimin e këtij aksesit është se kjo kompetencë e Ombudsmanit përbën një kërkesë esenciale për zhvillimin dhe konsolidimin e një shoqërie demokratike.
- 41- AP në këtë kontekst luan rolin e një garantuesi të respektimit të të drejtave të njeriut. Ai kontrollon ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e veprimit qeveritar në rrethanat e ekzistencës së informacionit të sekretuar mbi këto veprime, si pjesë e informacionit të sigurisë kombëtare. Kontrolli i ushtruar nga AP në këto rrethana ka treguar se, kjo ndërhyrje sjell një përfitim të pritshëm për legjitimitet të shtuar të veprimeve të kryera nga ana e organeve shtetërore, sikurse nëse evidentohet se informacioni i klasifikuar fsheh shkelje të ligjit, abuzim me të drejtat e njeriut, mungesë efëcence apo keqadministrim nga këta të fundit, pritshmëria është që të adresohet me forcë abuzimi me ligjin e sekretimit nga ana e AP.
- 42- Aksesit në informacionin e sigurisë kombëtare kërkon që AP, sikurse çdo person tjetër i autorizuar, të ruajë fshehtësinë e informacionit. Në këto kushte duhet që, AP të ketë procedura të mirëparashikuara dhe komunikim me qytetarët, me qëllim që të mbrojtë informacionin e sekretuar, ndërkohë që në të njëjtën kohë, t’i sigurojë qytetarët se të drejtat e tyre janë respektuar.
- 43- Veprimtaria e shërbimeve sekrete në thelb mendoj se është potencialisht cënuese ndaj të drejtave të njeriut dhe kufizuese ndaj transparencës. Si e tillë përshfaqet edhe veprimtaria e SHISH dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në Republikën e Shqipërisë, me funksion kryesor grumbullimin dhe analizimin e informacioneve, që lidhen me kërcënime ndaj sigurisë kombëtare.
- 44- Megjithëse këto institucione përjashtohen nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të informacionit, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve të emrave, të titujve zyrtarë, të pagave e të numrit të

- personelit, gjykoj se, kontrolli i ushtruar ndaj tyre prej ekzekutivit, gjyqësorit, Kuvendit si dhe prej institucioneve të pavaruara të kontrollit, i shërben të drejtës për informim. SHISH dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ushtrojnë veprimtarinë mbi bazën e ligjeve specifike, por mendoj se miratimi i një ligji specifik mbi mbikqyrjen e shërbimeve informative do të shërbente në rritjen e transparencës dhe standardizimit demokratik të veprimtarisë së tyre.
- 45- Konflikti në dukje ndërmjet të drejtës për informim dhe ruajtjes së sekretit shtetëror, lidhur me veprimtarinë e SHISH dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, gjykoj se duhet t'i nënshtrohet respektimit të parimeve mbi sigurinë kombëtare, lirinë e shprehjes dhe aksesin në informacion, pasi ligjet mbi bazën e të cilëve ushtrojnë aktivitetin këto institucione nuk lejojnë aksesin mbi informacionet që lidhen me këtë veprimtari.
- 46- Mbikqyrja parlamentare rrit përgjegjshmërinë në veprimtarinë e sektorit të sigurisë, por shërben edhe si një mjet informimi për çështje të rëndësishme për interesin publik. Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet veprimtarisë së Komisionit për Sigurinë Kombëtare, me cilësinë e një komisioni të përhershëm, luan një rol të rëndësishëm në këtë kontekst.
- 47- Veprimtaria e SHISH përcaktohet taksativisht në ligj se, kontrollohet nga Kuvendi, nëpërmjet Nënkomisionit të Përhershëm Parlamentar, të ngritur për këtë qëllim. Nënkomisioni ka të drejtë gjithashtu të kontrollojë përdorimin e fondeve publike që i kalojnë SHISH nga buxheti i shtetit çdo vit kalendarik. Moskrijimi i këtij nënkomisioni të përhershëm parlamentar, evidenton një çështje të moszbatimit të ligjit prej kaq vitesh, por edhe një mangësi serioze të procesit mbikqyrës ndaj veprimtarisë së SHISH, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë.
- 48- Përdorimi në shkallë të gjerë i video survejimit nga subjekte shtetërore ose private, specifikisht kur si veprimtari zhvillohet nga subjekte shtetërore gjykoj se, evokon çështjen që, jo gjithmonë jemi në kushtet ideale kur shteti vepron si garantues i sigurisë njerëzore, pasi ekzistojnë probleme potenciale me respektimin e të drejtave themelore të njeriut. Për këtë arsye mendoj se është e nevojshme ruajtja e një balance midis interesit publik dhe atij privat, përmes legjislacionit që duhet të përkufizojë qartë bazën ligjore të video survejimit dhe nevojshmërinë e kufizimit të të drejtave, duke patur parasysh interesat e mbrojtura të sigurisë kombëtare dhe duke ruajtur domosdoshmërisht nivelin minimum të mbrojtjes së të drejtave, të afirmuara nga KEDNJ.
- 49- Legjislacioni ynë në këtë fushë ka qënë i mangët, ndaj në këto kushte ishte e nevojshme nxjerrja e akteve të reja normuese, boshllëk ky i plotësuar me hyrjen në fuqi, të Ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.
- 50- Ligji nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, parashikon si masë shtesë sigurie të detyrueshme për subjektet publike dhe ato private, edhe përdorimin e sistemit të kamerave CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe, që ruajnë

- imazhet filmike në NRV/Server. Ai parashikon vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të kamerave të sigurisë nga subjektet respektive në bazë të procedurave ligjore të përcaktuara qartë, sikundër përcakton edhe detyrimin që këto subjekte kanë për njoftimin e KDIMDhP dhe bërjen transparent ndaj tij të procesit, në rast instalimi të sistemit të kamerave.
- 51- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, ka krijuar tashmë jurisprudencën e saj edhe në këtë këndvështrim, pasi në vendimin e saj nr.60 datë 31.07.2017 është shprehur se, ky ligj ruan një balancë të drejtë dhe proporcionale ndërmjet, interesave të tregtarëve si subjekte private për të ushtruar lirinë e veprimtarisë ekonomike e të lirisë për të gëzuar qetësisht pronën e tyre, dhe të interesave të shtetit nga ana tjetër, për miratimin e një sërë normash rregulluese për marrjen e masave konkrete, siç edhe vendosja e sistemit të videove, me qëllim ruajtjen e sigurisë publike.
- 52- Seancat gjyqësore qofshin penale, apo civile, në parim janë të hapura për median dhe publikun, megjithëse KPrP dhe KPrC parashikojnë raste të kufizimit të kësaj të drejte, ku vend specifik mendoj se zë diskrecioni i gjykatës për ndalimin e publicitetit që mund të shkaktojë përhapjen e të dhënave sekret shtetëror. Për çdo akuzë penale dhe për çdo ndalim, personi i akuzuar, apo i ndaluar ka të drejtën e aksesit në provat që janë sjellë dhe të atyre të ndodhura në dosjet e gjykatës. Megjithatë, aksesit i të akuzuarit në dosje mund të kufizohet për informacionin që përbën sekret shtetëror.
- 53- Autoriteti deklasifikues që i njihet gjykatës, apo edhe organit të prokurorisë, sipas KPrP për aksesim të informacioneve sekret shtetëror, nxjerr në pah mungesë harmonizimi të legjislacionit në fuqi, sa i përket sistemit deklasifikues të sekreteve shtetërore.
- 54- Eksperienca e deritashme tregon se siguria kombëtare ka mbisunduar dhe shpesh ka fituar një pozicion “ndrydhës” ndaj së drejtës për informim. Mungesa e një ndërveprimi të balancuar ndërmjet së drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare vërehet edhe në zhvillime konkrete në jetën tonë të përditëshme që, qofshin minore apo madhore, ndikojnë në cilësinë e jetës dhe sigurinë e individëve, si dhe në besueshmërinë e tyre ndaj shtetit, i cili duhet t’u japë atyre siguri.
- 55- Gjykoj se sot, nuk mund të flasim për një raport të drejtë midis të drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare në Shqipëri, në kushtet kur regjimi juridik i së drejtës për informim dhe ai i sekretit shtetëror kanë nevojë për përmirësime dhe harmonizim me legjislacionin tjetër në fuqi. Mosaplikimi tërësor i parimeve ndërkombëtare që sigurojnë konkurueshmëri dobiprurëse në raportin, e drejtë për siguri dhe e drejtë për informim, evidenton nevojën për kompatibilitet me standardet më të mira në këtë fushë, me qëllim që ti jepet dimensionit i duhur sigurisë njerëzore dhe për të përgatitur publikun dhe administratën shtetërore për proceset integruese të vendit.

56- E drejta e informimit si nocion mbetet formale dhe e pavlerë, nëse nuk mund të realizohet. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt luan regjimi juridik i përcaktuar për njohjen dhe ushtrimin e garantimit efektiv të kësaj të drejte. Ky regjim bëhet edhe më kompleks dhe ndërveprues, nëse në të përcaktohen shprehimisht institucionet mbikqyrëse të zbatimit të së drejtës.

## 5.2 Rekomandime

- Është shumë e rëndësishme dhe e nevojshme që të qartësohet në ligj kompetenca e AP, në raport me të drejtën për informim, sipas regjimit juridik të përcaktuar në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sa i takon së drejtës së ankimit nga ana e subjekteve të interesuara.
- Standardi i ri i vendosur nga Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sa i përket formave të tjera të dhënies së informacionit, në pikën 3, të nenit 14, të këtij ligji, mendoj se përkeqëson pozitën e kërkuesit në raport me autoritetin publik. Kjo pasi parësor në formën e dhënies së informacionit nuk konsiderohet më interesi i kërkuesit, por interesi i autoritetit publik, që sidoqoftë në këto rrethana nuk mund të konsiderohet gjithmonë në kushtet e interesit publik. Për këtë arsye, është e nevojshme të ketë një rregullim specifik në ligj, apo me ndonjë akt tjetër nënligjor, për lehtësirat për formën e dhënies së informacionit, në rastet kur ai kërkohet nga personat me aftësi të kufizuar, pa lënë një marzh diskrecioni tërësisht të papërcaktuar në duart e autoriteteve publike mbi këtë çështje, sikurse aktualisht ndodh në dispozitat e ligjit “Për të drejtën e informimit”.
- Nevojitet një ndryshim në dispozitat e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, që të sigurojë një trajtim më praktik dhe racional njëkohësisht për interesin publik të dhënies së informacionit, sa i takon momentit të refuzimit të kërkesës, për formën e kërkuar të dhënies së informacionit.
- Një nga mangësitë e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, është vështirësia e ekzekutimit të vendimeve, të KDIMDhP, pasi nuk parashikohet asnjë mjet ligjor për vënien në ekzekutim të vendimeve. Për këtë arsye del i nevojshëm shtimi i një parashikimi në ligj, për të mundësuar ekzekutimin me forcë të vendimeve të KDIMDhP.
- Rekomandoj zgjerimin e gamës së përcaktuar të veprimeve, apo praktikave që mund të sinjalizohen, sipas përcaktimit të bërë në nenin 1, të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Në fakt, kryefjala e gjithë kësaj veprimtarie është lufta kundër korrupsionit, por jo çdo veprim, apo praktikë e sinjalizuar mund të futet në aspektin e veprave penale të korrupsionit, por mund të përfshijë edhe elementë të tjerë shkeljeje ligjore.



- Rekomandohet të riformulohet përkufizimi i dhënë në pikën 13, të nenit 3, të Ligjit, mbi termin “sinjalizues”, sipas përkufizimeve standardizuese më të mira ndërkombëtare mbi përcaktimin e këtij termi.
- Është e nevojshme të pasqyrohen të plotë, në përmbajtjen e pikës 1, të nenit 6, të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, elementët e “mirëbesimit” dhe “besimit të arsyeshëm” se, informacioni ka qënë thelbësisht i vërtetë për kryerjen e aktit të sinjalizuesit, pasi këto janë kërkesa dhe komponentë bazë të legjitimitetit të këtij akti dhe të garantimit të mbrojtjes ligjore për individin që e kryen atë. Një qasje më racionale dhe objektive është të kërkohet që, një “sinjalizues”, “ka arsye të mirë për të besuar” se, bërja publike që ai po realizon është në të mirë të interesit publik.
- Pavarësisht faktit se në SSK në fuqi, gjenden të përfshirë elementë të rëndësishëm të sigurisë njerëzore, rekomandoj se duhet theksuar si një terminologji e veçantë në këtë përmbajtje, e drejta e informimit, që në qëllimin dhe objektin realizues të saj përbën thelbin e konceptit të transparencës.
- Rekomandoj rishikimin e përdorimit të termit “shtet ligjor” në përmbajtjen e SSK në fuqi, pasi në të vihet re një lloj disproporcioni në përdorimin e termave “sundim i ligjit” dhe “forcim i shtetit ligjor”. Koncepti i “shtetit ligjor”, nuk është më korelativ, për më tepër kur edhe nocionet e dhëna në tekstin e SSK në fuqi korrespondojnë me nocionin e “shtetit të së drejtës”.
- Duke u fokusuar tek siguria njerëzore mendoj se, kërcënimet e përcaktuara mbi sigurinë e informacionit të klasifikuar duhej të konceptoheshin në një raport më të ngushtë me “rrezikun dobiprurës”, që mund t’i sjellë informacionit të sigurisë kombëtare e drejta për informim.
- Rekomandoj rishikimin e regjimit juridik të sekretit shtetëror, të rregulluar nga ligji “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, ku duhet të adresohet; rishikimi i nivelit të klasifikimit të sekretit shtetëror “i kufizuar”, i cili krijon problematikë kufizimi të pajustificuar ndaj së drejtës për informim; parashikimi për dhënien e arsyes justifikuese për klasifikimin e aplikuar, e cila mungon në ligj; parashikimi i deklasifikimit të informacionit të klasifikuar, kur kemi ekspozim të pautorizuar të një informacioni identik, apo të ngjashëm; shtimi i një dispozite që do t’i siguronte publikut mjetin e duhur për kundërshtimin e vendimeve të autoriteteve përkatëse, nëse një informacion i caktuar duhet të jetë sekret, ose kundërshtimi i vendimeve për të mos dhënë informacion të deklasifikuar, ose për të shqyrtuar vendime të tilla.
- Rekomandoj se është i nevojshëm harmonizimi i legjislationit ekzistues mbi sistemin dhe autoritetet deklasifikuese, pasi aktualisht mendoj se nuk ekziston një sistem uniform.

- Rekomandoj rregullimin e mbikqyrjes së shërbimeve informative, me një ligj specifik, me qëllim rritjen e transparencës në veprimtarinë e tyre dhe të standardizimit demokratik të kësaj veprimtarie.
- Rekomandoj plotësimin e legjislacionit tonë të brendshëm, me parashikime për bazën e pranimit apo kundërshtimit të ndërhyrjes “Amicus Curiae”, si një qasje e re ndaj kësaj ndërhyrjeje të dobishme, me qëllim që të sigurohet një pjesëmarrje më e madhe nga subjektet “Amicus” dhe që t’u krijohet atyre pa mëdyshe mundësia ligjore për këtë ndërhyrje.
- Rekomandoj mundësinë e adoptimit të instrumentave të rinj normativ ndërkombëtarë, si pjesë të procesit të përafrimit me standardet ndërkombëtare mbi të drejtat themelore të njeriut dhe si bazë për përmirësimin e legjislacionit vendas që garanton të drejtën për informim, për më shumë akses në funksion të mirëqeverisjes. Si një hap i duhur për këtë qëllim, do të shërbente ratifikimi i Konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë.
- Rekomandoj shtimin e normave rregullatore në dokumentin e Rregullores së Brendshme të AP, të cilat do të parashikojnë procedurat e brendshme për trajtimin e ankesave të paraqitura nga ana e qytetarëve, në të cilat evidentohet nevoja për akses në informacionin e sekretuar, pjesë e informacionit të sigurisë kombëtare.

## VI. BIBLIOGRAFIA

### **Legjislacion ndërkombëtar:**

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në 10 Dhjetor 1948, aderuar nga Shqipëria në vitin 1955.
- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut e miratuar nga Këshilli i Europës, hyrë në fuqi në vitin 1953, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Ligjin Nr.8136 datë 31.07.1996.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe aksesin në drejtësi për çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin”, Aarhus, 25 Qershor 1998, e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Ligjin Nr.8672 datë 26.10.2000.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Ligjin nr.9492 datë 13.03.2006.
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, e miratuar në New York, në 16.12.1966, e ratifikuar nga Shqipëria në 4.09.1991.
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, e miratuar nga Këshilli i Europës, hyrë në fuqi në vitin 1953, e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me Ligjin Nr.8136 datë 31.07.1996.
- Konventa e Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso, e adoptuar në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, më 27.11.2008.
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB, në 20 Nëntor 1989, e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në Shkurt 1992 dhe hyrë në fuqi, në Mars 1992.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara, kundër Korrupsionit, e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me Ligjin nr.9492 datë 13.03.2006.

### **Legjislacion, dokumente të BE dhe të Këshillit të Europës:**

- Karta e të Drejtave të Njeriut të vendeve të Bashkimit Europian, e miratuar në Samitin e Nisës, në Dhjetor 2000.
- Kodi Europian i Sjelljes së Mirë Administrative, i miratuar nga ana e Parlamentit Europian, në 6 Shtator 2001.
- Protokollin shtesë nr.4, i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

- Protokoli no.1, i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.
- Protokoli Opsional i Parandalimit të Torturës (OPCAT), i ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me Ligjin nr.9094 datë 3.07.2003.
- Protokoli 11, i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, (ETS nr.155), hyrë në fuqi më 1 Nëntor 1998.
- Rregullorja e KE-së 178/2002, e plotësuar me Rregulloren nr.1642/2003, Rregulloren nr.575/2006, Rregulloren nr.202/2008 dhe Rregulloren nr.596/2009.
- Rekomandimi i Këshillit të Europës No.R (81) 19 “Mbi Mundësinë për të marrë Informacione të Mbajtura nga Autoritetet Publike”.
- Rekomandimi 2002 (2) i Këshillit të Europës, Për Aksesin në Dokumenta Zyrtare.
- Deklarata e Këshillit të Europës, mbi Lirinë e Shprehjes dhe të Informimit, e vitit 1982.
- Council of Europe, “Access to official documents-Recommendation Rec (2002) 2 of the Committee of Ministers and explanatory memorandum”, Directorate General of Human Rights, Strasbourg, viti 2003.
- Venice Commission, “Opinion on Video Surveillance in Public Places by Public Authorities and the Protection of Human Rights”, Study no.404/2006, Strasbourg, 23 March 2007.
- Venice Commission, “Opinion on Video Surveillance by Private Operators in Public and Private Spheres and by Public Authorities in the Private Sphere and Human Rights Protection”, Study no.430/2007, Strasbourg, 8 June 2007.

#### **Legjislacion i brendshëm:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998, Fletore Zyrtare Nr.28, datë 7.12.1998.
- Ligji nr.7692 datë 31.03.1993 “Për një shtojcë në Ligjin nr.7491 datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.
- Ligji nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi i Procedurës Civile, i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Ligji nr.7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.8003 datë 28.09.1995 “Kodi Penal Ushtarak”.
- Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Proçedurave Administrative”.
- Ligjin nr.8371 datë 9.07.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”.
- Ligjin nr.8391 datë 28.10.1998 “Për shërbimin informativ kombëtar”, i ndryshuar.
- Ligji nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.
- Ligji nr.8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar.
- Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.
- Ligji nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.
- Ligji nr.9549 datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”.
- Ligji nr.8572 datë 27.01.2000 “Për miratimin e Dokumentit të Strategjisë së Sigurimit të RSH”.
- Ligji nr.8577 datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.8671 datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr.8930 datë 25.07.2002 “Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për kontrollin dhe deklarimin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9171 datë 22.01.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr.9210 datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

- Ligjin nr.9322 datë 25.11.2004 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr.9367 datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9508 datë 3.04.2006 “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”.
- Ligjit nr.9663 datë 18.12.2006 “Për koncensionet”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9749 datë 4.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9858 datë 27.12.2007 “Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9888 datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të ndryshuar.
- Ligji nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.10173 datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.10221 datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Ligji nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.
- Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Ligji nr.65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”.
- Ligji nr.103/2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.
- Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

- Ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin Publik”.
- Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr.45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Ligji nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.
- Ligji nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.
- Ligji nr.84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
- Ligji nr.98/2017 “Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.166 datë 16.12.2004, i ndryshuar.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr.243 datë 28.07.1982.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr.124 datë 15.03.2001, “Për deklasifikimin e zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, që ndodhet në rrjetin kombëtar të arkivave”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr.81 datë 28.01.2008, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për asgjësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.
- Manuali “Për rregullat e trajtimit dhe sigurimin e të ndaluarve dhe arrestuarve në njësitë policore”, miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.64 datë 25.01.2010.
- Udhëzimi nr.3 datë 5.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Udhëzimi nr.46 datë 28.03.2017, i KDIMDhP “Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të Ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

### **Legjislacion i huaj:**

- Ligji Francez, No. 95-73, 28.01.1995, dhe akti nënligjor No. 96-926.

- Ligji Belg "Për klasifikimin dhe autorizimet e sigurisë", datë 11.12.1998.
- Ligji Lituanëz, "Për sekretet shtetërore dhe sekretet zyrtare", i datës 25.11.1999, i ndryshuar.
- Ligji Letonez "Për Sigurinë Kombëtare", no.473/476 datë 14 Dhjetor 2000, i ndryshuar.
- Ligjin "Për Ombudsmanin e të Drejtave të Njeriut të Bosnjës dhe Hercegovinës", Gazeta Zyrtare e Bosnjë Hercegovinës nr. 19/02.
- Ligji Rumun, "Për mbrojtjen e e informacionit të klasifikuar", nr.182 datë 12.04.2002.
- Ligji Bullgar, "Për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar", nr.45 datë 30.04.2002.
- Ligji Bullgar, i botuar në gazetën zyrtare nr.48 datë 23 Maj 2003, hyrë në fuqi në 1 Janar 2004.
- Ligji Maqedonas, "Për informacionin e klasifikuar", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.9, viti 2004, hyrë në fuqi në 5 Mars 2004, i ndryshuar.
- Ligji Kroat, "Ligji i të dhënave sekrete", i datës 13 Korrik 2007.
- Ligji nr.03/L-195 "Për Avokatin e Popullit", Fletore Zyrtare nr.80 datë 27.08.2010, e Republikës së Kosovës.
- Ligji nr.03/L-178 "Për klasifikimin e informacionit dhe hapësirës së sigurisë", i Republikës së Kosovës.
- Normat e procedurës, së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.
- Normat e procedurës, të Gjykatës Inter-Amerikane të të Drejtave të Njeriut.
- Normat e procedurës, të Komisionit Afrikan.

### **Jurisprudencë:**

#### **Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë:**

- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr.61 datë 22.11.1999.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr.49 datë 31.07.2000.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr.34 datë 8.12.2003.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr.16 datë 11.11.2004.



- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr.40 datë 16.11.2007.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr.15 datë 15.04.2010.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr.60 datë 31.07.2017.

### **Vendime të GJEDNJ:**

- Çështja De Wilde, Ooms dhe Versyp kundër Belgjikës, 18 Qershor 1971.
- Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut, Çështja X kundër Islandës, 18 Maj 1976.
- Çështja Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, 7 Dhjetor 1976.
- Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut, Çështja Klass dhe të Tjerë kundër Gjermanisë, 6 Shtator 1978.
- Çështja Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar, 26 Prill 1979.
- Çështja Lingens kundër Austrisë, 8 Korrik 1986.
- Çështja Leander kundër Suedisë, 26 Mars 1987.
- Çështja Olsson kundër Suedisë, 24 Mars 1988.
- Çështja Muller dhe të Tjerë kundër Zvicrës, 24 Maj 1988.
- Çështja Mark Intern kundër Gjermanisë, 20 Nëntor 1989.
- Çështja Autronic kundër Zvicrës, 22 Maj 1990.
- Çështja Thorgeirson kundër Islandës, 25 Qershor 1992.
- Çështja Goodvin kundër Mbretërisë së Bashkuar, 27 Mars 1996.
- Çështja Amann kundër Zvicrës, 16 Shkurt 2000.
- Çështja P.G dhe J.H kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 Shtator 2001.
- Çështja Landvreugd kundër Hollandës, 4 Qershor 2002.
- Çështja Peck kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 Janar 2003.
- Çështja Voskuil kundër Holandës, 22 Nëntor 2007.

### **Vendime të gjykatave të sistemit gjyqësor në Shqipëri:**

- Vendimi nr.7548 datë 26.12.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Doktrinë, botime, studime, raporte nga autorë të huaj:**

- Bellamy I., (1981): “Towards a theory of International Security”, Political Studies, viti 1981, Vol.nr. 29/1.
- Booth K., (1991): “Security Emancipation”, Review of International Studies, viti 1991, Vol. 17 /4.
- Buzan B., (1991): “People, States, and Fear. An agenda for international security studies in the post-cold war era”, First published by Harvester Wheatsheaf, viti 1991.
- Bentham J., (1999): “Political Tactics”, New York, University Press, viti 1999, (II: 4).
- Bygrave L. A, (2002): “Data protection Law: Approaching its Rationale. Logic and Limits”, Kluwer Law Intl., viti 2002.
- Bartholomeus L., (2005): “The amicus curiae before international courts and tribunals”, Non-State Actors and International Law, viti 2005, Vol. 209.
- Busch M., (2007): “Overlapping Institutions, Forum Shopping and Dispute Settlement in International Trade”, International Organization, Cambridge University Press, viti 2007, Vol.61.
- Claude I.L., (1956): “Swords in Plowshares. The problems and Progress of International Organization”, Random House, viti 1956.
- Colliver S., Hoffman P., Fitzpatrick J., Bowen S., (1999): “Secrecy and Liberty: National Security, Freedom of Expression and Access to Information”, Kluwer Law International, viti 1999.
- Collins A., (2010): “Studime Bashkëkohore të sigurisë”- Titulli në origjinal “Contemporary security studies”, Oxford Press University – (përkthyer) UET Press, viti 2010.
- Donnelly J., (2003): “Universal Human Rights in Theory and Practice”- Second edition, Cornell University Press, viti 2003.
- Ema R., (1995): “What is Security?”, Daedalus, viti 1995, Nr. 124 (3).
- Ellsberg D., (2002): “A Memoir of Vietnam and the Pentagon Papers”, Viking Penguin, viti 2002.

- Gary K., Murray Ch. J.L, (2001-2002): “Rethinking Human Security”, Political Science Quarterly, viti 2001-2002, Vol. nr. 116 (4).
- Gerd O., (2005): “Human security: a Challenge to international Law?” Global Governance, viti 2005, Vol. nr. 11 (2).
- Gao HS., (2006): “Amicus Curiae in WTO Dispute Settlement: Theory and Practice”, China Rights Forum, viti 2006, Nr. 1.
- Gomez KF., (2012): “Rethinking the role of amicus in International Investment Arbitration: How to draw the Line Favorably for the Public Interest Litigation”, Fordham International Law Journal, viti 2012, Vol.n35.
- Herz J. H., (1950): “Idealist internationalism and the security dilemma”, World Politics, viti 1950, Nr. 3.
- Hinsley F.H., (1963): “Power and Pursuit of Peace”, Cambridge University Press, viti 1963.
- Hedley B., (1968): “Strategic Studies and its Critics”, World Politics, viti 1968, nr. 20.
- Horta K., (2002): “Rhetoric and Reality: Human Rights and the World Bank”, Harward Human Rights Journal, viti 2002, Vol.nr. 15.
- Henk D., (2005): “Human Security: Relevance and Implications”, Parameters Summer, viti 2005.
- Jennifer L., (2004): “Psychological Well-Being over time”, Security Dialogue, viti 2004, Nr. 35.
- Kolodziej E.A., (2005): “Security and International Relations”, Cambridge University Press, viti 2005.
- Krause K., (2005): “Human Security: An idea Whose Time has come?”, Security Dialogue, viti 2005, Nr.35.
- Kerr P., (2007): “Human Security”, përfshirë në A.Collins “Contemporary Security Studies”. Oxford & New York: Oxford University Press, viti 2007.
- Krause K., (2008): “Drejt një axhende praktike të sigurisë njerëzore, Çështje të sigurisë/Security issues”, Botim i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim/Revistë e përtremuajshme, viti 2008, nr.7.
- Kerr P., (2010): “Siguria Njerëzore”, përfshirë në botimin e Alan Collins, “Studime Bashkëkohore të sigurisë”- Titulli në origjinal “Contemporary security studies”, Oxford Press University – (përkthyer) UET Press, viti 2010.

- Lippman W, (1943): “US Foreign Policy: Shield of the Republic”, Little Brown, viti 1943.
- Luciani G., (1989): “The economic content of security”, Journal of Public Policy, viti 1989, Vol.nr.8/2.
- Law D., (2007): “Praktikat më të mira në fushën e strategjisë së sigurisë kombëtare”, “Mbi zhvillimin e strategjisë së sigurisë kombëtare”, Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim, Tiranë, viti 2007.
- Luciak I., (2008): “Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia-Mjet praktik për Gjininë dhe Reformën e Sektorit të Sigurisë”, Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Amatosura (DCAF), OSCE/ODIHR, UN-INSTRAW, viti 2008.
- Levine A., “Amicus Curiae in International Investment Arbitration: The implications of an increase in third-Party participation”, Berkley Journal of International Law, viti 2011, Nr. 29.
- Makovei M., (2003): “Manualet e të drejtave të njeriut nr.2 - Liria e shprehjes, Një udhëzues për zbatimin e nenit 10 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut”, Botimi i dytë, Gent Grafik, viti 2003.
- Maenpaa O., (2006): “Openness and Access to Information in Finland”, cituar në “The World’s First Freedom of information Act-Anders Chydenius’ Legacy today”, Anders Chydenius Foundation, Art – Print Ltd, viti 2006.
- Manninen J., (2006): “Anders Chydenius and the Origins of World’s First Freedom of information Act”, cituar në “The World’s First Freedom of information Act-Anders Chydenius’ Legacy today”; Anders Chydenius Foundation, Art – Print Ltd, viti 2006.
- Mitrevska M., Grizold A., Buckovski V., Vanis E., (2009): “Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve-Rasti i Maqedonisë (paradigma e re e sigurisë)”, Bomat Grafiks, viti 2009.
- Novicki MA., Lloha E., (2003): “Komentar i shkurtër mbi Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut”, botuar nga Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, viti 2003.
- Oberleitner G., (2002): “Human Security and Human Rights”, Occasional Paper Series, viti 2002, Vol. nr.8.
- Oberleitner G., (2005): “Human security: a Challenge to international Law?”, Global Governance, viti 2005, Vol.nr. 11 (2).
- Paris R, (2001): “Human Security: Paradigm Shift or Hot Air?”, International Security, viti 2001, Vol.nr.26 (2).

- Palla W. (2002): “Gli organi di controllo e di ricevimento delle proteste dall’antichità fino al presente, passando attraverso l’ombudsman della Scandinavia”, Edizioni Athesia, Bolzano, 2002, Nr.45 (1).
- Schiffer W., (1954): “The legal Community of Mankind: A critical analysis of the Modern World Organization”, Columbia University Press, viti 1954.
- Stratford J. S., (2002): “Data protection and privacy in the United States and Europe”, IASSIST Quarterly, viti 2002.
- Sugar R., (2007): “On Combating the Abuse of State Secrecy”, The Journal of Political Philosophy, Harvard University, viti 2007, Vol. 15, nr.4.
- Shelton D., (1994): “The participation of nongovernmental organizations in international judicial proceedings”, American Journal of International Law, viti 1994, Vol.88/4.
- Taylor O., (2004): “Human Security-Conflict, Critique and Consensus: Colloquium Remarks and a Proposal for a Threshold-Based Definition, Security Dialogue, viti 2004, Nr. 35.
- Thakur R., (2004): “A Political Worldview”, Security Dialogue, viti 2004, Nr. 35.
- Villata R., (1987): “La trasparenza dell’azione amministrativa”, in Diritto Procedurale Amministrativa, Atti del XXXII Convegno di studi di scienza dell’amministrazione, viti 1987.
- Weber M., (1946): “Bureaucracy”, in Essays in Sociology, Oxford University Press, viti 1946.
- Wolfers A., (1952): “National Security” as an Ambiguous Symbol”, Political Science Quarterly, viti 1952, Vol. 67, Nr.4.
- Waltz K. N., (1979): “Theory of international Politics”, McGraw-Hill, viti 1979.
- Whitaker R., (1999): “The End of Privacy: How Total Surveillance is Becoming a Reality”, The New Press, viti 1999.
- Williams S., Woolaver H., (2006): “The Role of the Amicus Curiae before International Criminal Tribunal”, International Criminal Law Review, viti 2006, Vol. 6.
- Wills A., (2007): “Udhëzues - Të kuptuarit e mbikëqyrjes së inteligjencës”, Qendra e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Amatosura (DCAF), viti 2007.
- Waever O., Buzan B., (2010): “Pas rikthimit në teori: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e studimeve të sigurisë”, përfshirë në botimin e Alan Collins, “Studime Bashkëkohore të

sigurisë"- Titulli në origjinal "Contemporary security studies", Oxford Press University – (përkthyer) UET Press, viti 2010.

- Anders Chydenius Foundation, "The World's First Freedom of information Act-Anders Chydenius' Legacy today", Anders Chydenius Foundation, Art – Print Ltd, viti 2006.
- Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF) and Inter Parliamentary Union (IPU), Parliamentary Oversight of the Security Sector: Principles, Mechanisms and Practices (DCAF and IPU: Geneva), viti 2003.
- Article 19, "The Johannesburg Principles on National Security, Freedom of Expression and Access to Information", International Standard Series, London, November 1996, General Principles, Principle 1, gërma "b".
- Article 19, "Parime mbi legjislacionin e lirise se informacionit"- botim si pjesë e një projekti rajonal të financuar nga Bashkimi Europian, "E drejta e informimit", me pjesëmarrje të Shqipërisë, Bullgarisë, Malit të Zi, Rumanisë dhe Kroacisë, Tiranë 2001.
- Article 19, "E drejta e publikut për të ditur - Parime mbi Legjislacionin e Lirisë së Informacionit", Tiranë, viti 2001.
- Council of Europe, "Access to official documents-Recommendation Rec (2002) 2 of the Committee of Ministers and explanatory memorandum", Directorate General of Human Rights, Strasbourg, viti 2003.
- US Department of Justice, "Freedom of information Act Guide & Privacy Act Overview", Washington DC, viti 2004.
- Article 19 & Qendra për Zhvillimin Demokratik të Institucioneve, "Liria e Informimit: Manual trajnimi për nëpunësit", Shtypshkronja "Flesh", Tiranë, viti 2004.
- Article 19, "Memorandum për Ligjin shqiptar "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"", Londër, Shtator 2004.
- Raporti i vitit 1994, i Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP).
- Kofi Annan: Two concepts of Sovereignty, The economist, 18 Shtator, viti 1999.

#### **Doktrinë, botime, studime, raporte nga autorë shqiptarë:**

- Anastasi A., (2004): "E drejta kushtetuese" - cikël leksionesh, Shtëpia botuese "Pegi", viti 2004.
- Dobjani E., (2007): "E drejta Administrative" (botim i ripunuar), Shtypshkronja "Perlat Voshtina", viti 2007.

- Dobjani E., (2016): “E drejta Administrative – Pjesa e Përgjithshme”, Botues “Emal”, viti 2016.
- Faskaj-Vokopola A.: “Procedimi administrativ në Republikën e Shqipërisë”, Phd Dissertacion, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shqipëri, viti 2013.
- Gjunksi Xh., (2012): “Sfidat e Forcave të Armatosura në 100 vjet Shtet Shqiptar”, Revista Ushtarake (Qendra e doktrinës), viti 2012, nr.4.
- Islami H., Hoxha A., Panda I., Islami H., Hoxha A., Panda I., (2003): “Procedura Penale-Komentar”, Botimet Morava, viti 2003.
- Karoli K., Doda E., (2012): “Mbi konceptin e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit në periudhën e Luftës së Ftohtë”, Revista Ushtarake (Qendra e doktrinës), viti 2012, nr.4.
- Methasani E., (2003): “Enti publik, organ i administratës publike si risi në legjislacionin shqiptar dhe doktrinën juridike”, Revista Juridike, Botim i Shkollës së Magjistraturës, Nr.3.
- Mandro A., (2009): “E Drejta familjare - Familja, Fëmijët, Martesa, Bashkëshortët”, Shtypshkronja “Emal”, viti 2009.
- Omari L., (2004): “Shteti i së drejtës”, botim i dytë, Shtëpia botuese “Elena Gjika”, viti 2004.
- Ramadani R., Shehu N., Lleshi A., Miftari I., (2009): “Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare”-Vëllimi I, Akademia e Mbrojtjes “Spiro Mojsiu”, viti 2009.
- Xharo M., (2013); “Një paradigmë e re në inteligjencë...”, Akademia e Forcave të Armatosura, viti 2013, faqe 81, ISBN: 978-9928-4097-7-5
- Instituti për Studime Publike & Ligjore, Komentar- Ligji për të drejtën e informimit, botim i Institutit për Studime Publike & Ligjore, Tiranë, viti 2003.
- Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN), “Çështje të reformave në sektorin e sigurisë në Shqipëri-Rreth zhvillimit të konceptit të sigurisë kombëtare”, Volumi I, Tiranë, viti 2009.
- Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, “20 vjet reforma në sektorin e sigurisë. Harmonizimi i kuadrit kushtetues e ligjor i sektorit të sigurisë”, Gent Grafik, Tiranë 2012.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2000, i Avokatit të Popullit”, viti 2001, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2001, i Avokatit të Popullit”, viti 2002, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2002, i Avokatit të Popullit”, viti 2003, Tiranë.

- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2003, i Avokatit të Popullit”, viti 2004, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2004, i Avokatit të Popullit”, viti 2005, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2005, i Avokatit të Popullit”, viti 2006, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2006, i Avokatit të Popullit”, viti 2007, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti Vjetor 2007, i Avokatit të Popullit”, viti 2008, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2008, i Avokatit të Popullit”, viti 2009, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2009, i Avokatit të Popullit”, viti 2010, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2010, i Avokatit të Popullit”, viti 2011, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2011, i Avokatit të Popullit”, viti 2012, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2012, i Avokatit të Popullit”, viti 2013, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2012, i Avokatit të Popullit”, viti 2014, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2012, i Avokatit të Popullit”, viti 2015, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2012, i Avokatit të Popullit”, viti 2016, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Raporti vjetor 2012, i Avokatit të Popullit”, viti 2017, Tiranë.
- Avokati i Popullit, “Avokati i Popullit në Shqipëri”, Botim i dytë, viti 2003, Tiranë.
- Avokati i Popullit, Botimi “Konferenca Kombëtare - E drejta e informimit e drejtë themelore e njeriut”, Shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë, viti 2003.
- Qendra e Studimeve Parlamentare, “Monitorimi mbi zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, në institucionet qendrore”, Tiranë, viti 2005.
- Avokati i Popullit, Botimi “Të gjithë së bashku në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”, viti 2005.
- Avokatit i Popullit, Botimi “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve jashtë Shqipërisë”, viti 2006.
- Institucioni i Avokatit të Popullit-Avokati i Popullit në Shqipëri në 10 vjet veprimtari-viti 2009, Tiranë.



- Qendra "Res Publica", në botimin "E drejta e informimit në bankoprovë – studim mbi efektivitetin e ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe një krahasim me ligjin nr.8503/1999", Dhjetor 2015.

***Botime "on-line" dhe Website:***

- Axworthy Ll. on the Canadian approach, in Canada World View, Special Edition, Fall 1999. Website: [www.dfait-maeci.gc.ca/canada-magazine/wv-se1/se1t3-e.htm](http://www.dfait-maeci.gc.ca/canada-magazine/wv-se1/se1t3-e.htm)
- Alkire S., Conceptual Framework for Human Security paper presented at Kennedy School, Harvard University, 2002. Website: [www.humansecurity-chs.org/doc/0206harvard.html](http://www.humansecurity-chs.org/doc/0206harvard.html)
- Berkowitz B., "Secrecy and National Security", Hoover Institution-Stanford University, National Security nr.3, July 2004. Website: [www.hoover.org/publications/hoover-digest/article/8014](http://www.hoover.org/publications/hoover-digest/article/8014)
- Correll H., From Territorial Sovereignty to Human Security, Address to the Annual Conference of the Canadian Council of International Law 1999. Website: [www.un.org/law/counsel/ottawa.htm](http://www.un.org/law/counsel/ottawa.htm)
- Dehn G., & Calland R., "Whistleblowing the State of the Art-The role of the individual, organizations, the state, the media, the law and civil society". Website: [www.baselgovernance.org/fileadmin/docs/pdfs/Brownbag/WHISTLEBLOWING\\_intro.pdf](http://www.baselgovernance.org/fileadmin/docs/pdfs/Brownbag/WHISTLEBLOWING_intro.pdf)
- Heinbecker P., (2000): "Human Security: the Hard Edge", Canadian Military Journal, viti 2000. Website: [www.heinbecker.ca/Speeches/HumanSecurity2000forcesjournal.pdf](http://www.heinbecker.ca/Speeches/HumanSecurity2000forcesjournal.pdf)
- Howard-Hassmann R.E., "Human security: Undermining human rights?". Website: [www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2011/63-hassmann-2011.pdf](http://www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2011/63-hassmann-2011.pdf)
- Hilbrans S., (2012): "National Security vs. Individual Rights – Access to and Freedom of Information under German Law", Berlin, viti 2012. Website: [www.right2info.org](http://www.right2info.org)
- Kjaerum M., "What is a national human rights institution?". Website: [www.humanrights.dk/about+us/what+is+a+nhri](http://www.humanrights.dk/about+us/what+is+a+nhri) (6 Tetor 2010)
- Lodgaard S.: "Human Security: Concept and Operationalization". Website: [www.hsph.harvard.edu/hpcr/events/hsworshop/lodgaard.pdf](http://www.hsph.harvard.edu/hpcr/events/hsworshop/lodgaard.pdf).
- Manin B., (1997): "The principles of Representative Government", Cambridge University Press, viti 1997. Website: [www.aclu.org/national-security/secrecy](http://www.aclu.org/national-security/secrecy)
- Miller M. G., (2005): "Attaining and Maintaining National Security Advantage: Information Operations and Secrecy", Joint Information Operations Center, viti 2005, Nr.38. Website: [www.au.af.mil/info-ops/iosphere\\_spring05\\_miller.pdf](http://www.au.af.mil/info-ops/iosphere_spring05_miller.pdf)

- Rousselin M., “Rruga drejt komunitetit EuroAtlantik: Efektet e marrëdhënieve BE-NATO mbi sigurinë e Shqipërisë”, cituar në botimin e Institutit për Ndërmjetësim dhe Demokraci, “Çështje të sigurisë-9”.  
Website: [idmalbania.org/publications/alb/Çështje\\_të\\_sigurisë\\_9.pdf](http://idmalbania.org/publications/alb/Çështje_të_sigurisë_9.pdf)
- Sen A.A., “Why human Security?”, presentation at the International Symposium on Human Security, Tokyo, Qershor 2000, Website: [www.humansecurity-chs.org/doc/Sen2000html](http://www.humansecurity-chs.org/doc/Sen2000html)
- Vitalis A., “Big brother is watching you on video”, Le monde Diplomatique- English Edition 1998. Website: [mondediplo.com/1998/03/11video?var\\_s=surveillance](http://mondediplo.com/1998/03/11video?var_s=surveillance)
- Von Jhering, marrë nga Bas de Gaayu Fortman: “Rights-Based Approaches”; Any New thing under the Sun? IDEA Newsletter 2000,.  
Website: [www.carleton.ca/idea/newsletter/reports\\_122000\\_8.html](http://www.carleton.ca/idea/newsletter/reports_122000_8.html)
- History, Purpose and Philisophy of Amicus Advocacy: The AELE Amices Brief Program, by Wayne W. Schmidt. Ky informacion gjendet në Website: [www.aele.org/history.html](http://www.aele.org/history.html)
- Quasi –Party In the Guise of Amicus Curiae, (Cumberland Law Review, Volume 7, 293 (1976-1977). Ky informacion gjendet në Website: <http://heionline.org>.
- DCAF Backgrounder, “Politika e Sigurisë kombëtare”. Website: [bg\\_national-security\\_alb\(3\).pdf](http://bg_national-security_alb(3).pdf)
- DCAF Backgrounder, Komisionet Parlamentare për Mbrojtje dhe Siguri, 01/2006. Webiste: [www.dcaf.ch/publications/backgrounders](http://www.dcaf.ch/publications/backgrounders)
- History, Purpose and Philisophy of Amicus Advocacy: The AELE Amices Brief Program, by Wayne W. Schmidt, <http://www.aele.org/history.html>  
Website: [www.carleton.ca/idea/newsletter/reports\\_122000\\_8.html](http://www.carleton.ca/idea/newsletter/reports_122000_8.html).
- Deklarata e adoptuar në Workshopin mbi Marrëdhëniet mes të Drejtave të Njeriut dhe Sigurisë Njerëzore, San Hose, Kosta Rika, 2 Dhjetor 2001. Website: [www.humansecurity-chs.org/doc/sanjosedec.html](http://www.humansecurity-chs.org/doc/sanjosedec.html)
- Article 19, Qendra për Politika Alternative, Inisiativa për të Drejtat e Njeriut në Komonuelth, Komisioni i të Drejtave të Njeriut ne Pakistan- “Një model ligji për lirinë e informimit”- Korrik 2001, Website: <http://www.article19.org>
- Article 19, London, Global Campaign for Free Expression, “Promoting practical access to democracy – A survey of Freedom on Information in Central and Eastern Europe”, October 2002. Website: [europe@article19.org](mailto:europe@article19.org)
- Website: [cpi.transparency.org/cpi2011/press/](http://cpi.transparency.org/cpi2011/press/)
- Website: [www.gn.apc.org/article19](http://www.gn.apc.org/article19).

- Website: [www.the-shipman-inquiry.org.uk/5r\\_page.asp?id=4667](http://www.the-shipman-inquiry.org.uk/5r_page.asp?id=4667)
- Website: [www.canadianlawsite.ca/whistle-blower.htm](http://www.canadianlawsite.ca/whistle-blower.htm)
- Website: [www.consumerinjurylawyers.com/whistleblower/famous.html](http://www.consumerinjurylawyers.com/whistleblower/famous.html)
- Website: [www.cas.go.jp/jp/seisaku/hourei/data/WPA.pdf](http://www.cas.go.jp/jp/seisaku/hourei/data/WPA.pdf)
- Website: [www.article19.org/publications/law/legal-analyses.html](http://www.article19.org/publications/law/legal-analyses.html).
- Website: [www.aclu.org/national-security/secretcy](http://www.aclu.org/national-security/secretcy)
- Website: [www.mod.gov.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=1443:konferenca-per-shtyp-per-demontimin-e-municioneve-te-teperta&catid=293:mars&Itemid=629](http://www.mod.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=1443:konferenca-per-shtyp-per-demontimin-e-municioneve-te-teperta&catid=293:mars&Itemid=629)
- Website: [www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)
- Website: [www.avokatipopullit.gov.al/Rekomandime/Rekomandime%202007.htm](http://www.avokatipopullit.gov.al/Rekomandime/Rekomandime%202007.htm)
- Website: [www.gjk.gov.al](http://www.gjk.gov.al)
- Website: [www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf](http://www.soros.al/nosa/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf)
- Website: [www.gn.apc.org/article19](http://www.gn.apc.org/article19).
- Website: [www.hindu.com/thehindu/op/2003/03/25/stories/2003032500110200.html](http://www.hindu.com/thehindu/op/2003/03/25/stories/2003032500110200.html)
- Website: [www.carleton.ca/idea/newsletter/reports\\_122000\\_8.html](http://www.carleton.ca/idea/newsletter/reports_122000_8.html).
- Website: [www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user\\_upload/ETC-Hauptseite/manual/versionen/albanian/manual\\_vollversion\\_albanisch.htm](http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/manual/versionen/albanian/manual_vollversion_albanisch.htm)
- Website: <http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/amicus+curiae>
- Website: [www.achpr.org/about/](http://www.achpr.org/about/)
- Website: [www.worldfoodscience.org](http://www.worldfoodscience.org)
- Website: [www.mod.gov.al/index.php/agjencia-e-inteligjences-se-mbrojtjes-aim/41-agjencia-e-inteligjences-se-mbrojtjes-aim](http://www.mod.gov.al/index.php/agjencia-e-inteligjences-se-mbrojtjes-aim/41-agjencia-e-inteligjences-se-mbrojtjes-aim)
- Website: [www.respublica.org.al/informacioni-i-vonuar-eshte-informacion-i-mohuar](http://www.respublica.org.al/informacioni-i-vonuar-eshte-informacion-i-mohuar)
- Website: [www.right2info.org](http://www.right2info.org)
- Website: [www.article19.org/data/files/pdfs/standards/righttoknow.pdf](http://www.article19.org/data/files/pdfs/standards/righttoknow.pdf)

- Website: [kos.rec.org/albanian/pdf/KosBuletini%20nr5.pdf](http://kos.rec.org/albanian/pdf/KosBuletini%20nr5.pdf)
- Website: [conventions.coe.it/Treaty/en/Treaties/Html/205.htm](http://conventions.coe.it/Treaty/en/Treaties/Html/205.htm).
- Website: [conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=205&CM=1&DF=&CL=ENG](http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=205&CM=1&DF=&CL=ENG)
- Website: <http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/amicus+curiae>
- Website: <http://www.rbs2.com/amicus.htm>
- Website: [www.idp.al/raporte-vjetore/](http://www.idp.al/raporte-vjetore/)
- Website: [www.ehow.com/about\\_6587381\\_definition-whistleblowers.html](http://www.ehow.com/about_6587381_definition-whistleblowers.html)
- Website: [www.consumerinjurylawyers.com/whistleblower/famous.html](http://www.consumerinjurylawyers.com/whistleblower/famous.html)
- Website: [www.baselgovernance.org/fileadmin/docs/pdfs/Brownbag/WHISTLEBLOWING\\_intro.pdf](http://www.baselgovernance.org/fileadmin/docs/pdfs/Brownbag/WHISTLEBLOWING_intro.pdf)
- Website: [www.hindu.com/thehindu/op/2003/03/25/stories/2003032500110200.html](http://www.hindu.com/thehindu/op/2003/03/25/stories/2003032500110200.html)
- Website: [www.cas.go.jp/jp/seisaku/hourei/data/WPA.pdf](http://www.cas.go.jp/jp/seisaku/hourei/data/WPA.pdf)
- Website: [www.mod.gov.al/images/PDF/strategjia\\_sigurise\\_kombetare\\_republikes\\_se\\_shqipërise.pdf](http://www.mod.gov.al/images/PDF/strategjia_sigurise_kombetare_republikes_se_shqipërise.pdf)
- Website: [www.shish.gov.al](http://www.shish.gov.al)
- Website: [www.humansecurity-chs.org/doc/sanjosedec.html](http://www.humansecurity-chs.org/doc/sanjosedec.html)
- Website: [www.opensocietyfoundations.org/publications/global-principles-national-security-and-freedom-information-tshwane-principles](http://www.opensocietyfoundations.org/publications/global-principles-national-security-and-freedom-information-tshwane-principles).

***Botime të tjera dhe Artikuj gazetarie***

- Ardian Klosi, "Katastrofa e Gërdecit", shtypshkronja K&B, Tiranë, viti 2009.
- Artikulli, "Qumështi shqiptar, AKU: Aflatoksiona mbi normat e BE", Balkanweb, datë 26 shkurt 2013.
- Artikulli "Shqipëri: Aflatoksina "misterioze"". Website: [www.europaelire.org/content/article/24935784.html](http://www.europaelire.org/content/article/24935784.html)

- Artikulli “Pasha: Greqia kërkon marrëveshjen e vjetër për naftën dhe gazin natyror”, botuar në gazetën “Sot”, datë 6.10.2011.
- Artikulli “I vetmi problem hedhja poshtë e Kushtetueses”, Revista “Mapo”, datë 24.07.2013.
- Artikulli “Gërdeci: Shpërthimi, shembull i tmerrshëm korrupsioni”, publikuar në New York Times, 19 Prill 2008.
- Artikulli “Punonjësi i Gërdecit: Si ndodhi shpërthimi”, botuar në gazetën “Tema”, datë 20.05.2009.

### ***Abstrakt***

E drejta për informim, si e drejtë themelore e njeriut ka evoluar në procesin e njohjes dhe mbrojtjes, në kontekstin historik dhe kuadrin normativ, të konkretizuar në aktet e rëndësishme ndërkombëtare të transpozuar në legjislacionin shqiptar, pas viteve 90'. Ajo nuk është një e drejtë absolute, ndaj nevojitet mirëpërcaktimi i kriterëve ligjore, që garantojnë një proces të rregullt ligjor dhe një marrëdhënie parimisht balancuese, në raport me vlerat dhe të drejtat e tjera themelore në një shoqëri demokratike.

Siguria kombëtare, si përgjegjësi shtetërore dhe si një e mirë personale dhe politike, e konsideruar gjithnjë e më shumë në evoluimin historik të konceptit të fokusuar tek sovraniteti individual, si vlerë konkurruese dhe si e drejtë themelore e njeriut, synon që, në një mjedis dinamik sfidues të ruajë dhe zhvillojë vlerat demokratike për mirëqënien e dëshiruar shoqërore.

Elementi bashkues por dhe që krijon raportin e tensionuar kufizues njëkohësisht, ndërmjet së drejtës për informim dhe sigurisë kombëtare është informacioni i klasifikuar i sigurisë kombëtare. Ky raport delikat, duhet të gjejë një balancë të mirëpërcaktuar në konkurimin e këtyre vlerave, duke përputhur legjislacionin e brendshëm, por edhe institucionet përgjegjëse në veprimtarinë e tyre, me standardet dhe parimet ndërkombëtare zhvillimore më të mira të fushës.

### **Fjalë Kyce:**

*E drejta për informim, akte ndërkombëtare, Kushtetutë, kufizim i së drejtës, siguri kombëtare, marrëdhënie e balancuar.*

### ***Abstract***

The right to information as a fundamental human right has evolved in the process of recognition and protection in the historical context and normative framework, embodied in the important international acts transposed into Albanian legislation after the 90's. It is not an absolute right, so it is necessary to clearly define the legal criteria that guarantee a fair legal process and a principled balancing relationship, in relation to other fundamental values and rights in a democratic society.

National security, as a state responsibility and as a personal and political good, increasingly considered in the historical evolution of the concept focused on individual sovereignty, as a competitive value and as a fundamental human right, aims at a dynamic and challenging environment to preserve and develop democratic values for the desired social well-being.

The joining element but also that creates a tense, restrictive relationship at the same time, between the right to information and national security, is classified national security information. This delicate report must find a well-balanced balance in the competition of these values, matching domestic legislation, but also the institutions responsible for their activity, with the best international standards and development principles in the field.

### ***Key words:***

*Right to information, international acts, Constitution, restriction of the right, national security, balanced relation.*